



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E PRISHTINËS
OPŠTINA PRIŠTINA
MUNICIPALITY OF PRISHTINA

PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL PRISHTINA 2023-2031

LISTA E KONTRIBUESVE

Udhëheqësit e projektit			
Emri e mbiemri	Pozita	Emri e mbiemri	Pozita
Përparim Rama	Kryetar Komunës	i Donjeta Sahatçiu	Nënkryetar i Komunës
Alban Zogaj	Nënkryetar Komunës	i Mimoza Sylejmani	Menaxher i projektit
Drejtorët kontribues sektorial të planifikimit			
Emri e mbiemri	Drejtoria	Emri e mbiemri	Drejtoria
Arbër Sadiki	Urbanizëm	Krenar Xhaferi	Investime Kapitale dhe Menaxhim i Kontratave
Izet Sadiku	Shëndetësi	Ilirik Musliu	Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim
Besianë Musmurati	Arsim	Adelinë Sahiti	Mirëqenie sociale
Donika Çetta	Parqe	Doruntina Maloku	Pronë
Vigan Kastrati	Administratë	Florian Dushi	Inspektion
Donat Lushaku	Kadastër	Plator Gërdovi	Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim rural
Valbona Makolli	Financa	Arta Balaj	Kulturë
Granit Rugova	Sport		
Bashkëpunëtorët e jashtëm profesional			
Emri e mbiemri	Sektori		
Babak Davar	Bashkëpunëtor i jashtëm - Planer		
Robert Ferrier	Bashkëpunëtor i jashtëm – Arkitekt/Urbanist		
Afërdita Gashi Sinanaj	Bashkëpunëtore e jashtme - Koordinatore		
Lyra Bakija Vula	Bashkëpunëtore e jashtme profesionale		
Sami Duraku	Bashkëpunëtor i jashtëm - për çështje të infrastrukturës teknike dhe GIS		
Idriz Shala	Bashkëpunëtor i jashtëm - për çështje të demografisë dhe statistikave		
Mirdita Lahi	Bashkëpunëtore e jashtme profesionale		
Genc Simnica	Bashkëpunëtor i jashtëm profesional		
Liridon Duraku	Bashkëpunëtor i jashtëm profesional		
Erëza Bokshi	Bashkëpunëtore e jashtme profesionale		
Endrit Mecini	Bashkëpunëtor i jashtëm profesional		
Valza Berisha	Bashkëpunëtore e jashtme profesionale		

Lista e kontribuesve tjerë

Emri e mbiemri	Sektori
Sokol Xhafa	Ish-kryeshef ekzekutiv - KRU
Arsim Fetahu	Kryeshef ekzekutiv - KRU
	KEDS
Burbuqe Hana	Kryeshefe ekzekutive - PTK
Tomaž SELJAK	Kryeshef ekzekutiv - IPKO
Fisnik Osmani	Kryeshef ekzekutiv - Termokosi
Petrit Reçica	Kryeshef ekzekutiv - Pastrimi
Jashar Sherifi	U.D. Kryeshef ekzekutiv - Trafiku urban

Lista e komunitetit konsulativ

Emri e mbiemri	Sektori
Arch. Masar Dushi	Asociacioni i arkitektëve të Kosovës
Edona Durguti	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Nol Binakaj	Fondacioni kosovar Trashëgimia Kulturore pa kufij (CHwB)
Besnike Koçani	UN Habitat Kosova
Luan Nushi	Instituti për Planifikim Hapësinor
Lumnie Gashi-Shabani	NGO - Pro Planning
Prof.Ass.Dr. Ardita Byci	Fakulteti i Arkitekturës
Astrit Panxha	Klubi i Prodhuesve të Kosovës

Lista e akronimeve dhe shkurtesat

AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit	IVE	Indeksi i varfërisë më ekstreme
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës	IZhNj	Indeksi i zhvillimit njerëzor
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës	NVM	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme
BB	Banka Botërore	OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
BE	Bashkimi Evropian	RZHNJ	Raporti i Zhvillimit Njerëzor
BPV	Bruto Produkti i Vendit	ZKL	Zyra e Komuniteteve Lokale
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës	VJF	Vendbanime jo formale
ESK	Enti Statistikor i Kosovës	IKMN	Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Natyrës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar	QRTK	Qendra Regjionale e Trashëgimisë Kulturore
GND	Të ardhurat nacionale në dispozicion	ZGjC	Zyre e Gjendjes Civile
KKP	Kuvendi Komunal i Prishtinës	ShFMU	Shkollë Fillore dhe e Mesme e Ulët
MEA	Ministria e Ekonomisë dhe e Ambientit	ShML	Shkollë e Mesme e Lartë
IPH	Instituti i Planifikimit Hapësinor	MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe e Sportit
ZHEL	Zhvillimi Ekonomik Lokal	MEPTINIS	Ministria e Ekonomisë, e Punësimit, e Tregtisë, e Industrisë, e Ndërmarrësisë dhe e Investimeve Strategjike
NVM	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme	ITUZ	Impianti për trajtimin e ujërave të zeza
OJQ	Organizata joqeveritare	PRrH	Plani Rregullues i Hollësishëm
OSBE	Organizata e Sigurisë dhe e Bashkëpunimit Evropian	IP	Investitor Privat
OZHGJ	Objektivat e zhvillimit gjithëpërfshirës	Ssh	Stabiliment Shpërndarës
PHK	Plani Hapësinor i Kosovës	HZK-om	Harta Zonale e Kosovës
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal	KRUGJ	Kompania Regjionale e Ujit dhe e Kanalizimit
PZHU	Plani Zhvillimor Urban	KAB	Korniza Afatmesme Buxhetore
HZK	Harta Zonale Komunale	DAP	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim	DI	Drejtoria e Inspekcionit
UNHCR	Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për refugjatë	DMS	Drejtoria e Mirëqenies Sociale
DSH	Drejtoria e Shëndetësisë	DK	Drejtoria e Kulturës
DKA	Drejtoria e Arsimit	DS	Drejtoria e Sportit
DU	Drejtoria e Urbanizmit	DBF	Drejtoria e Buxhetit dhe e Financave
DPS	Drejtoria e Planifikimit Strategjik	DP	Drejtoria e Parqeve
		DGJK	Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrit
DSHPMSH	Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim	DB	Drejtoria e Bujqësisë

1. Përmbajtja

1.	HYRJE	15
1.1.	Informata për vendimet e kuvendit të komunës në lidhje me PZHK-në	15
1.2.	Informata për miratimet.....	15
1.3.	Informata rreth kornizës strategjike që janë marrë parasysh gjatë hartimit të PZHK-së	28
1.3.1.	Strategjitë sektoriale afatshkurta, afatmesme dhe afatgjata në nivel lokal dhe gendror.....	28
1.3.2.	Strategjitë prej planeve të mëparshme komunale	29
1.3.3.	Strategjitë rajonale ose strategjitë e komunave fqinje	30
1.4.	Udhëzimet, përgjegjësitë dhe kërkesat që burojnë nga konteksti i gjerë i planifikimit siç janë planifikuar në PHK dhe HZK.....	31
1.5.	Informata për procesin e planifikimit	31
1.6.	Përmbledhje e shkurtër e PZHK-së	32
1.6.1.	Ngjarje të rëndësishme globale me ndikim në procesin e planifikimit strategjik të komunës	32
1.6.2.	Qasja e adoptuar për strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm të komunës së Prishtinës	33
2.	PROFILI KOMUNAL DHE VLERËSIMI I GJENDJES EKZISTUESE	35
2.1.	Historia e zhvillimit të komunës.....	35
2.2.	Karakteristikat e përgjithshme të komunës.....	36
2.2.1.	Pozita gjeografike dhe karakteristikat natyrore	36
2.3.	Demografia.....	41
2.3.1.	Zhvillimi demografik	41
2.3.2.	Strukturat e popullsisë	42
2.3.3.	Projeksionet e popullsisë	45
2.4.	Ekonomia	48
2.4.1.	Tregu i punës	51
2.4.2.	Sektorët kryesor ekonomik	52
2.4.3.	Mundësitë dhe sfidat e ekonomisë së Kryeqytetit	57
	Zonat ekonomike që duhet të ndërtohen	66
2.4.4.	Investimet lokale	67
2.5.	Infrastruktura teknike	69
2.5.1.	Ujësjellësi	69
2.5.2.	Kanalizimi.....	77
2.5.3.	Kanalizimi i ujërave atmosferik	80
2.5.4.	Ujitja	81
2.5.5.	Energjia elektrike.....	81

2.5.6.	Energjia termike	90
2.5.7.	Telekomunikacioni	97
2.5.8.	Grumbullimi dhe menaxhimi i mbeturinave	101
2.6.	Infrastruktura e transportit dhe transporti	106
2.6.1.	Shtrirja dhe gjendja e rrugëve ekzistuese	107
2.6.2.	Gjendja e infrastrukturës së transportit në nivel nacional	108
2.6.3.	Gjendja e infrastrukturës rrugore në zonat kadastrale, fshatrat e Komunës së Prishtinës	109
2.6.4.	Vlerësimi i intensitetit dhe kapacitetit të kryqëzimeve dhe korsive kryesore	111
2.6.5.	Krahasimi i trendeve të shkallës së motorizimit dhe fluksit të trafikut	113
2.6.1.	Modelet e qarkullimit të trafikut	113
2.6.2.	Transporti hekurudhor	114
2.6.3.	Transporti ajror	114
2.6.4.	Transporti urban dhe ndërrurban	114
2.6.5.	Shfrytëzimi i rrugëve nga këmbësorët, biçikletat, makinat dhe metodat tjera të transportit	117
2.6.6.	Shpërndarja modale e lëvizjeve brenda pjesës urbane	118
2.6.7.	Vlerësimi i hapësirave ekzistuese për parkim	119
2.6.8.	Lëvizjet aktive	121
2.6.9.	Vlerësimi i nevojave në të ardhmen për një infrastrukturë transportuese	122
2.7.	Infrastruktura publike dhe sociale	130
2.7.1.	Shëndetësia	130
2.7.2.	Arsimi	134
2.7.3.	Administrata publike	142
2.7.4.	Mirëqenia sociale dhe komuniteti	144
2.7.5.	Kultura	145
2.7.6.	Rinia, sporti dhe rekreacioni	149
2.7.7.	Hapësirat e hapura publike dhe hapësirat e gjelbërta	153
2.7.8.	Objektet e religjionit dhe varrezat	156
2.8.	Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri	161
2.8.1.	Mjedisi	161
2.8.2.	Ndotja e ajrit	162
2.8.3.	Ndotja e ujit	163
2.8.4.	Ndotja e tokës	164
2.8.5.	Ndotja nga zhurma	165
2.8.6.	Sipërfaqet me rrezikshmëri	167
2.9.	Asetet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore	176
2.9.1.	Trashëgimia natyrore	176

2.9.2.	Trashëgimia kulturore	178
2.10.	Vendbanimet	190
2.10.1.	Karakteri urban rural dhe funksionaliteti ndërlidhës.....	190
2.10.2.	Vendbanimet sipas dinamikës së popullsisë	192
2.10.3.	Vendbanimet rurale - shtrirja, struktura dhe madhësia.....	194
2.10.4.	Vendbanimi urban – shtrirja, struktura dhe madhësia	195
2.10.5.	Raporti mes sipërfaqes së ndërtuar dhe të pa ndërtuar në kuadër të vendbanimit	198
2.10.6.	Vendbanimet joformale	199
2.10.7.	Ndërtimet pa leje	200
2.10.8.	Problematikat dhe trendët e zhvillimit	201
2.11.	Banimi	202
2.11.1.	Njësitë e banimit.....	202
2.11.2.	Banimi social	204
2.11.3.	Gjendja ekzistuese e banimit.....	204
2.11.4.	Numri i njësive të banimit sipas projeksioneve	205
2.11.5.	Banimi i përballueshëm.....	206
2.11.6.	Vlerësimi i gjendjes	206
2.12.	Shfrytëzimi i tokës	208
2.12.1.	Vlerësimi i gjendjes	211
2.13.	Kapacitetet financiare	212
3.	KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR	216
3.1.	Vizioni.....	216
3.2.	Qëllimet dhe objektivat zhvillimor.....	218
3.2.1.	Qëllimet dhe objektivat sipas fushave tematike	219
3.3.	Koncepti i zhvillimit hapësinor.....	224
	Skenarët e propozuar hapësinor.....	224
3.3.1	Elementet e konceptit të zhvillimit hapësinor	231
3.3.2	Zhvillimi sipas sektorëve	232
4	PRIORITETET STRATEGJIKE DHE PLANI I VEPRIMIT	294
4.1	Prioritetet Strategjike.....	294
4.2	Plani i veprimit.....	295
5	ZBATIMI DHE MONITORIMI	311
5.1	Dispozitat për zbatim	311
5.1.1	Formimi i ekipit.....	311
5.1.2	Informimi dhe komunikimi në procesin e zbatimit të PZHK-së së Prishtinës	313
5.1.3	Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në funksion të zbatimit të planeve	314
5.1.4	Bashkëpunimi me institucionet e nivelit qendror.....	315

5.1.5	Mbështetja administrative	316
-------	---------------------------------	-----

Lista e figurave

Figura 1	Rrjeti kryesor i kogjenerimit HES-HRS, dimensionimi gypit DN600 mm	92
Figura 2	Lidhja e autoudhëve "Ibrahim Rugova" dhe "Arbën Xhaferi" në pjesën e rrjetit rrugor të Prishtinës	108
Figura 3	Ngarkesa e trafikut në rrjetin rrugor të qytetit të Prishtinës	112
Figura 4	Linjat e transportit urban.....	115
Figura 5	Rrjeti kryesor dhe dytësor i propozuar i transportit publik në Prishtinë.....	117
Figura 6	Shpërndarja modale e lëvizjeve	119
Figura 7	Koncepti i parkingjeve	120
Figura 8	Linja metropolitane	124
Figura 9	Plani i Zhvillimit Urban	198
Figura 10	Skenari 1 - Trendi aktual	226
Figura 11	Skenari 2 - Zhvillimi Policentrik	227
Figura 12	Skenari 3 - Zhvillimi i qëndrueshëm dhe kompakt	229
Figura 13	Propozimi i unazës së qytetit dhe rrugëve primare	262
Figura 14	Klasifikimi funksional dhe kyçjet në rrjetin rrugor	262
Figura 15	Rrjeti i planifikuar i hekurudhës nëntokësore	264
Figura 16	Stacioni multimodal	265
Figura 17	Propozimi i lokacioneve për sistemin e parkimit "P&R"	267
Figura 18	Lidhja e Prishtinës në nivel rajonal dhe në korridoret pan-evropiane	271
Figura 19	Boshti Urban.....	288

Lista e tabelave

Tabela 1	Regjistrimi i popullsisë dhe ekonomive familjare në komunë (Burimi: ASK)	42
Tabela 2	Kontingjentet e popullsisë (Burimi: ASK, 2011).....	43
Tabela 3	Projeksioni i popullsisë sipas vendbanimeve	47
Tabela 4	Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas kategorive (Burimi, ASK).....	51
Tabela 5	Kapaciteti i burimeve dhe i furnizimit me ujë (Burimi: KRU Prishtina).....	69
Tabela 6	Stacionet e pompimit	70
Tabela 7	Kapaciteti i rezervuarëve	71
Tabela 8	Numri i konsumatorëve sipas veprimtarisë (Burimi: KRU Prishtina)	71
Tabela 9	Mbulueshmëria me rrjet të kanalizimit sipas vendbanimeve	78
Tabela 10	Ndotja dhe derdhja e ujërave të zeza në lumenjtë (Burimi: AMMK)	78
Tabela 11	Sipërfaqet bujqësore nën sistem të ujitjes.....	81
Tabela 12	SWOT analiza - Ujësjellësi, Kanalizimi, Ujitja dhe Drenazimi	83

Tabela 13 Kapaciteti i trafostacioneve.....	84
Tabela 14 Linjat nëntokësore	86
Tabela 15 Linjat ajrore energjetike	86
Tabela 16 SWOT analiza për rrjetin elektrik.....	89
Tabela 17 Kapacitetet termike të NP Termokos SH.A para vitit 2014	91
Tabela 18 Kapacitetet e kondensatorëve të nxehtësisë në stacionin HES	91
Tabela 19 Kapacitetet e këmbyesve të nxehtësisë në stacionin HRS	91
Tabela 20 Energjia e prodhuar, energjia e liferuar tek konsumatorët, humbjet në rrjet (rrjeti i transportit dhe i shpërndarjes) në sezonet 2015-16, 2016-2017 dhe 2017-2018, ngrohja me kogjenerim (Burimi : Plani Zhvillimor i NP "Termokos" SH.A., 2019-2029)	92
Tabela 21 Humbjet e energjisë termike në rrjetin e transportimit të energjisë termike nga kogjenerimi (Burimi: Plani zhvillimor i NP "Termokos" SH.A., 2019-2029)	92
Tabela 22 Energjia e prodhuar, liferuar dhe humbjet (Burimi: Plani zhvillimor i NP "Termokos" SH.A. 2019-2029)	93
Tabela 23 Numri i konsumatorëve (Burimi: Plani zhvillimor i NP "Termokos" SH.A. 2019-2029)	93
Tabela 24 Sipërfaqja ngrohëse (Burimi: Plani zhvillimor i NP "Termokos" SH.A. 2019-2029) ..	93
Tabela 25 Konsumi specifik për sezonë (Burimi: Plani zhvillimor i NP "Termokos" SH.A. 2019-2029)	93
Tabela 26 Kërkesa për kapacitete elektrike dhe termike (Burimi: Plani zhvillimor i NP "Termokos" SH.A. 2019-2029).....	94
Tabela 27 Të dhënat për sipërfaqen, kapacitetin dhe kërkesën për energji	95
Tabela 28 Planifikimi për konsumin e energjisë termike dhe rritjen e sipërfaqes ngrohëse	96
Tabela 29 SWOT analiza - Energjia termike	96
Tabela 30 Pikat shpërndarëse të PTK-së në Prishtinë	98
Tabela 31 SWOT Analiza - Telekomunikacioni	100
Tabela 32 Sasia e mbeturinave të gjeneruar dhe të grumbulluar	101
Tabela 33 Gjenerimi i mbeturinave sipas kategorisë së klientëve, 2020	101
Tabela 34 Numri i klientëve sipas kategorisë, 2020	101
Tabela 35 Klasifikimi i deponive ilegale	102
Tabela 36 Mbeturinat industriale	104
Tabela 37 SWOT analiza - Menaxhimi i mbeturinave	105
Tabela 38 Veçoritë e rrugëve nacionale/rajonale, Karakteristikat fizike dhe hapësinore, 2018	107
Tabela 39 Mbulueshmëria e hapësirës me infrastrukturë rrugore	107
Tabela 40 Lidhshmëria e Prishtinës me rrugët nacionale	108
Tabela 41 Kapacitetet investive për infrastrukturën e transportit	126
Tabela 42 SWOT analiza - Infrastruktura e transportit.....	127
Tabela 43 Numri i personelit në institucione shëndetësore.....	130
Tabela 44 Veçoritë fizike dhe hapësinore të institucioneve shëndetësore	130

Tabela 45 Inventari i ndërtimeve dhe hapësirave të Qendrës kryesore të Mjekësisë Familjare	131
Tabela 46 Inventari i ndërtimeve dhe i hapësirave të Qendrave të mjekësisë familjare	131
Tabela 47 Inventari i ndërtimeve dhe i hapësirave të Ambulanteve të Mjekësisë Familjare ...	132
Tabela 48 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike shëndetësore të nivelit parësor për numrin e prognozuar të banorëve 2031	132
Tabela 49 Vlerësimi i kapaciteteve financiare (€) për investime kapitale të Drejtorisë së Shëndetësisë	134
Tabela 50 Numri i institucioneve arsimore dhe nxënësve	135
Tabela 51 Numri i personelit në institucione edukativo-arsimore.....	135
Tabela 52 Veçoritë fizike dhe hapësinore të institucioneve arsimore	135
Tabela 53 Inventari i ndërtimeve dhe i hapësirave të institucioneve publike parashkollore	136
Tabela 54 Inventari i ndërtimeve dhe i hapësirave të institucioneve publike të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët	136
Tabela 55 Inventari i ndërtimeve dhe hapësirave të institucioneve publike të arsimit të mesëm të lartë	138
Tabela 56 Vlerësimi i sipërfaqeve aktuale krahas kërkesave hapësinore për institucione publike parashkollore sipas NTPH, bazuar në numrin e prognozuar të banorëve rezidentë 2031	139
Tabela 57 Vlerësimi i sipërfaqeve aktuale krahas kërkesave hapësinore për institucione publike të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët sipas NTPH, bazuar në numrin e prognozuar të banorëve 2031	139
Tabela 58 Vlerësimi i sipërfaqeve aktuale krahas kërkesave hapësinore për institucione publike të arsimit të mesëm të lartë sipas NTPH, bazuar në numrin e prognozuar të banorëve	140
Tabela 59 Vlerësimi i kapaciteteve financiare (€) për investime kapitale të Drejtorisë së Arsimit	142
Tabela 60 Inventari i ndërtesave të administratës publike	142
Tabela 61 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve të administratës publike për numrin e prognozuar të banorëve 2031	143
Tabela 62 Vlerësimi i kapaciteteve financiare (€) për investime kapitale të Drejtorisë së Administratës	143
Tabela 63 Skemat sociale sipas gjinisë.....	144
Tabela 64 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelave për institucione të mirëqenies sociale dhe komunitetit për numrin e prognozuar të banorëve 2031	145
Tabela 65 Vlerësimi i kapaciteteve financiare (€) për investime kapitale të Drejtorisë së Mirëqenies Sociale.....	145
Tabela 66 Inventari i ndërtesave kulturore	146
Tabela 67 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve kulturore	148
Tabela 68 Vlerësimi i kapaciteteve financiare (€) për investime kapitale të Drejtorisë së Kulturës	148
Tabela 69 Institucionet kulturore sportive	149
Tabela 70 Veçoritë hapësinore të hapësirave rekreative	149

Tabela 71 Klubet sportive në Komunën e Prishtinës	150
Tabela 72 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së rinisë, sportit dhe rekreacionit.....	152
Tabela 73 Vlerësimi i kapaciteteve financiare (€) për investime kapitale të Drejtorisë së Kulturës	153
Tabela 74 Inventari i hapësirave publike dhe të gjelbra në zonën urbane	154
Tabela 75 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së hapësirave të hapura publike për numrin e prognozuar të banorëve 2031	155
Tabela 76 Vlerësimi i kapaciteteve financiare (€) për investime kapitale të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.....	156
Tabela 77 Inventari i objekteve fetare	156
Tabela 78 Inventari i varrezave publike	157
Tabela 79 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së varrezave për numrin e prognozuar të banorëve 2031	159
Tabela 80 Vlerësimi i kapaciteteve financiare (€) për investime kapitale të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.....	159
Tabela 81 SWOT analiza - Infrastruktura Publike dhe sociale.....	160
Tabela 82 Ndotja e ajrit në komunën e Prishtinës, 2018.....	162
Tabela 83 Ndotësit kolektiv dhe të veçantë në regjionin e Prishtinës	163
Tabela 84 Pikat shkarkuese të ndotësve në komunën e Prishtinës.....	163
Tabela 85 Matjet dhe tejkalimet e zhurmës.....	165
Tabela 86 SWOT analiza - Mjedisi	165
Tabela 87 Niveli i erozionit në komunë të Prishtinës.....	167
Tabela 88 Sipërfaqet e ndikuara nga rrëshqitja e tokës.....	169
Tabela 89 Sipërfaqet e ndikuara nga zjarret në Komunë të Prishtinës	172
Tabela 90 Sipërfaqet e ndikuara nga vërshimet në Komunën e Prishtinës	173
Tabela 91 SWOT analiza - Sipërfaqet me rrezikshmëri	174
Tabela 92 Asetet e trashëgimisë natyrore	177
Tabela 93 Asetet e trashëgimisë arkitekturale (Burimi: MKRS, 2021)	178
Tabela 94 Asetet e trashëgimisë arkeologjike (Burimi: MKRS, 2022)	184
Tabela 95 Asetet e trashëgimisë së luajtshme (Burimi: MKRS, 2021)	185
Tabela 96 SWOT analiza – Trashëgimia kulturore	189
Tabela 97 Vendbanimet sipas popullsisë, sipërfaqes dhe dendësisë (Burimi: ASK, Ortofoto 2018)	191
Tabela 98 Klasifikimi i Vendbanimeve sipas rendit tipologjisë, dendësisë, ekonomisë dhe popullsisë	193
Tabela 99 Sipërfaqet e ndërtuara sipas vendbanimeve	198
Tabela 100 Gjendja ekzistuese dhe prioritetet për intervenim në VBJ	199
Tabela 101 Numri i ndërtimeve pa leje sipas vendbanimeve.....	200
Tabela 102 SWOT analiza - Vendbanimet.....	201

Tabela 103 Numri i familjeve përfituese të skemës sociale	204
Tabela 104 Fondi i banimit (Burimi: Lista e tatimpaguesve të TP, 2018).....	205
Tabela 105 SWOT analiza - Banimi	207
Tabela 106 Shfrytëzimi tokës sipas sipërfaqeve (ha) dhe përqindjes (Burimi: Ortofoto 2018) 208	
Tabela 107 Shfrytëzimi aktual i tokës sipas vendbanimeve.....	209
Tabela 108 Diferenca në mes të shfrytëzimit aktual të tokës sipas PZHK 2012 dhe shfrytëzimit aktual të tokës në vitin 2020	211
Tabela 109 Diferenca në mes të shfrytëzimit të tokës sipas Urban Atlas Copernicus dhe shfrytëzimit aktual të tokës në vitin 2020	211
Tabela 110 SWOT analiza - Shfrytëzimi i tokës	211
Tabela 111 Pasqyra dhe trendet e planifikimit të buxhetit sipas kategorive ekonomike (Burimi: Ligji për buxhetin e Republikës së Kosovës)	213
Tabela 112 Pasqyra dhe trendet e shpenzimit të buxhetit sipas kategorive ekonomike (Burimi: Draft raporti i auditimit për pasqyrat financiare).....	213
Tabela 113 Pasqyra dhe trendet e shpenzimit të të hyrave vetanake sipas kategorive kryesore (Burimi: Raporti i zyrtarit për të hyra).....	213
Tabela 114 Pasqyra dhe trendet e të hyrave vetanake sipas inkasimit (Burimi: Raporti i zyrtarit për të hyra).....	214
Tabela 115 Pasqyra dhe trendet e donacioneve sipas prejardhjes (Burimi: Raporti i zyrtarit për të hyra).....	214
Tabela 116 Pasqyra dhe trendet e shpenzimeve kapitale sipas sektorëve (Burimi: Raporti financiar buxhetor i komunës së Prishtinës)	214
Tabela 117 Buxheti për vitin 2021 vlerësimet për vitin 2022 dhe 2023 si dhe parashikimet deri vitin 2031.....	215
Tabela 118 Diferencat buxhetore sipas viteve deri në vitin 2031.....	215
Tabela 119 Shfrytëzimi i planifikuar i tokës	293
Tabela 120 Prioritetet strategjike	294

Lista e grafikave

Grafika 1 Numri i popullsisë 1948-2021 (Burimi: ASK)	42
Grafika 2 Piramida e popullsisë së Prishtinës (Burimi: ASK, 2011)	43
Grafika 3 Strukturat arsimore të popullsisë (Burimi: ASK)	44
Grafika 4 Parashikimi i popullsisë së komunës së Prishtinës deri në vitin 2031.....	48
Grafika 5 Mbulueshmëria me rrjet të ujësjellësit sipas vendbanimeve	72
Grafika 6 Trendet e rritjes së shërbimeve me furnizim me ujë të pijshëm për qytetarët e Prishtinës	73
Grafika 7 Përqindja e përpunimit të ujit të pijshëm, 2019.....	74
Grafika 8 Kapaciteti i ngrohjes dhe temperaturat e jashtme më 30 janar 2016	95
Grafika 9 Trendi i rritjes së shkallës së motorizimit në Kosovë	113
Grafika 10 Mënyrat më të shpeshta të lëvizjes	117

Grafika 11 Njësitë e banimit sipas tipit të vendbanimit në Komunën e Prishtinës (Burimi: ASK, 2011)	202
Grafika 12 Banesat sipas llojit dhe statusit të shfrytëzimit në komunën e Prishtinës (Burimi: ASK, 2011)	202
Grafika 13 Numri i ndërtesave të banimit sipas tipologjisë (Burimi: ASK, 2011).....	203
Grafika 14 Ndërtesat sipas viteve të ndërtimit në komunën e Prishtinës (Burimi: ASK, 2011) 203	
Grafika 15 Ndërtesat sipas katshmërisë.....	204
Grafika 16 Numri i lejeve ndërtimore në komunën e Prishtinës	205

Lista e hartave

Harta 1 Pozita gjeografike e komunës.....	36
Harta 2 Hipsometria e terrenit	37
Harta 3 Pjerrtësia e terrenit.....	37
Harta 4 Ekspozicioni i terrenit	38
Harta 5 Përbërja gjeologjike e tokës.....	38
Harta 6 Pedologjia	39
Harta 7 Hidrogjeologjia	40
Harta 8 Potencialet për energji solare.	41
Harta 9 Dendësia e popullsisë.....	45
Harta 10 Boniteti i tokës (Burimi: EULUP).....	53
Harta 11 Pasuritë nëntokësore	53
Harta 12 Infrastruktura teknike - Rrjeti i ujësjellësit	74
Harta 13 Infrastruktura teknike - Rrjeti i kanalizimit fekal dhe atmosferik	80
Harta 14 Infrastruktura teknike - Rrjeti i sistemit të ujitjes	82
Harta 15 Rrjeti elektro-energjetik.....	85
Harta 16 Energjia termike	92
Harta 17 Rrjeti i telekomunikacionit	98
Harta 18 Menaxhimi i mbeturinave	105
Harta 19 Infrastruktura e transportit.....	111
Harta 20 Rrezja shërbyese e institucioneve shëndetësore në komunë	133
Harta 21 Rrezja shërbyese e institucioneve të arsimit në komunë	141
Harta 22 Infrastruktura publike dhe sociale	143
Harta 23 Infrastruktura sportive	153
Harta 24 Hapësirat publike dhe të gjelbra	155
Harta 25 Institucionet e religjionit dhe varrezat	158
Harta 26 Sipërfaqet me rrezikshmëri – Erozioni.....	168
Harta 27 Sipërfaqet me rrezikshmëri - Rrëshqitja e dherave	169
Harta 28 Sipërfaqet me rrezikshmëri - Zonat sizmike	170

Harta 29 Sipërfaqet me rrezikshmëri – Erërat.....	171
Harta 30 Sipërfaqet me rrezikshmëri – Vërshimet	173
Harta 31 Biodiversiteti (Burimi: EULUP).....	177
Harta 32 Trashëgimia natyrore dhe kulturore.....	187
Harta 33 Kronologjia e zhvillimit të qytetit.....	196
Harta 34 Shfrytëzimi aktual i tokës (Burimi: Ortofoto 2018)	210
Harta 35 Koncepti i zhvillimi ekonomik	241
<i>Harta 36 Koncepti i zhvillimit të sistemit të ujës-jellësit.</i>	<i>244</i>
Harta 37 Koncepti i zhvillimit të sistemit të kanalizimit	246
Harta 38 Koncepti i zhvillimit të energjisë elektrike	249
Harta 39 Koncepti i zhvillimit të sistemit të ngrohjes	251
Harta 40 Koncepti hapësinor i zhvillimit të telekomunikacionit.....	256
Harta 41 Koncepti hapësinor i zhvillimit të menaxhimit të mbeturinave	259
Harta 42 Koncepti hapësinor i zhvillimit të transportit	271
Harta 43 Koncepti hapësinor i zhvillimit të institucioneve shëndetësore.....	272
Harta 44 Koncepti hapësinor i zhvillimit të infrastruktures arsimore – shkollat fillore dhe të mesme	273
Harta 45 Koncepti hapësinor i zhvillimit të infrastruktures arsimore – institucionet parashkollore	274
Harta 46 Koncepti i zhvillimit të hapësirave publike dhe sociale	275
Harta 47 Koncepti i zhvillimit të hapësirave sportive	277
Harta 48 Koncepti i zhvillimit të hapësirave të hapura publike dhe të gjelbërta	278
Harta 49 Koncepti i zhvillimit të menaxhimit të varrezave	279
Harta 50 Plani për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore	285
Harta 51 Koncepti i shfrytëzimit të tokës / i planifikuar	293

1. HYRJE

1.1. Informata për vendimet e kuvendit të komunës në lidhje me PZHK-në

Qëllimi i Planit Zhvillimor Komunal është që të sigurohet zhvillim i qëndrueshëm dhe i baraspeshuar i planifikimit hapësinor për tërë territorin e Komunës së Prishtinës, përmes qeverisjes së mirë, shfrytëzimit të përshtatshëm të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore e natyrore.

Plani Zhvillimor Komunal është dokument që hartohet për territorin e komunës së Prishtinës për periudhën kohore 2023-2031 dhe jep mundësi të vazhdimësisë së planifikimit edhe për të ardhmen (pas periudhës së caktuar). Në dokumentin e planit merren vendime afatgjata, por gjithnjë duke pasur parasysh fleksibilitetin e planit, kur dihet se në të ardhmen mund të paraqiten rrethana të reja që kërkojnë modifikime të vazhdueshme (kërkesat e ndryshme të popullsisë, ndryshimet në politikat qeveritare, parimet ndërkombëtare etj.). Gjithashtu, edhe të sigurojë qeverisje të qëndrueshme, shfrytëzim efikas të fondeve publike, përmbushje të kërkesës ligjore në përputhje me Nenin 10, Paragrafin 2.1 të Ligjit Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor, me datën 09/03/2018, Kuvendi i Komunës ka marrë Vendimin Nr. 01-350/05-57601/18 për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Prishtinës.

1.2. Informata për miratimet

Ministria e Mjedisit, e Planifikimit Hapësinor dhe e Infrastrukturës, në funksion të kryerjes së obligimeve të veta ligjore, e siguruar në përputhshmërinë e Planit Zhvillimor Komunal të Prishtinës me Planin Hapësinor të Kosovës dhe Draft Hartën Zonale të Kosovës, siguron cilësinë e procesit, pas pranimit të të dhënave digjitale, bën sigurimin e dokumentit, i cili është punuar duke u bazuar në normat teknike të planifikimit hapësinor, në përputhje me Nenin 9, Paragrafin 2.3.1. të Ligjit Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor, më datë 25/02/2010, MMPHI ka marrë vendimin 01.Nr.110-391 për dhënien e pëlqimit, për procedim të mëtejshëm të Planit Zhvillimor Komunal të Prishtinës, duke e aprovuar nga Kuvendi Komunal.

VENDIMI



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 17, pika b dhe neni 40, pika I të Ligjit për vetëqeverisje lokale të Kosovës, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, qershor 2008), nenit 5, paragrafi 1.2. nënparagrafi 1.2.1 dhe nenit 10, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, nenit 11, paragrafi 1, nënparagrafët 1.3 dhe 1.4 dhe nenit 15 të Ligjit për planifikim hapësinor nr. 04/L-174, datës 31.07.2013, si dhe Udhëzimit administrativ MMPH, nr. 11/2015, mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit zhvillimor komunal, dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01.nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 07.03.2018, miratoi këtë

VENDIM PËR

FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT ZHVILLIMOR TË KOMUNËS SË PRISHTINËS

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Miratohet Vendimi për fillimin e hartimit të Planit zhvillimor të komunës së Prishtinës.

Neni 2

Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim përkufizohet dokumenti i planifikimit hapësinor, Plani zhvillimor komunal, në harmoni me ligjin, si plan strategjik shumësektorial, i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Plani zhvillimor i komunës duhet të përfshijë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për periudhën tetë (8) vjeçare.

Neni 3

Qëllimi i hartimit

Me Planin zhvillimor komunal nga neni 1 i këtij vendimi, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të

arritur kushte optimale dhe organizimin hapësinor të komunës së Prishtinës, plotëson kërkesat ligjore për të përgatitur Planin strategjik shumësektorial, i cili përfshin planifikimin dhe zhvillimin e zonës urbane dhe rurale.

Neni 4

Kufiri i territorit

Zonat kadastrale në territorin e komunës së Prishtinës janë:

Nr.	Zona kadastrale	Shifra	Sipërfaqja në ha	Sipërfaqe në m ²
1	Hajkobillë	71907001	737,70,46	7377046
2	Hajvali	71914002	762,90,17	7629017
3	Ballaban	71912003	1 217,75,77	12177577
4	Barilevë	71902004	1 004,41,31	10044131
5	Besi	71914007	425,70,01	4257001
6	Busi	71914008	1633,68,74	16336874
7	Dabishec	71907024	1 093,32,61	10933261
8	Nëntë Jugoviq	71914021	515,54,71	5155471
9	Bërnice e Poshtme	71914024	839,42,69	8394269
10	Dragoc	71914030	922,98,46	9229846
11	Drenoc	71902031	251,62,47	2516247
12	Gillogovicë	71907014	811,54,13	8115413
13	Bërnice e Epërme	71914013	830,76,87	8307687
14	Grashticë	71914020	1 496,26,87	14962687
15	Keçekollë	71912037	3 672,51,56	36725156
16	Kolovicë	71914034	718,39,61	7183961
17	Koliq	71912039	3 985,30,82	39853082
18	Kukavicë	71914039	443,90,88	4439088
19	Lebanë	71914043	218,16,31	2181631
20	Llukar	71914045	746,63,55	7466355
21	Makoc	71914047	1 136,60,96	11366096
22	Marec	71903041	7 270,83,97	72708397
23	Matiçan	71914050	722,15,72	7221572
24	Mramor	71914052	3 777,17,80	37771780
25	Nishec	71912056	1 115,04,38	11150438
26	Novosellë	71914054	935,92,98	9359298
27	Orlloviq	71914056	188,37,53	1883753
28	Prishtinë	71914059	3 053,69,91	30536991
29	Prapashticë	71912066	2 212,58,67	22125867
30	Prugoc	71914060	396,96,94	3969694
31	Radashec	71914061	761,12,52	7611252
32	Rimanishtë	71914063	1 384,31,98	13843198
33	Sharban	71912083	1 299,07,31	12990731

34	Shashkoc	71909091	234,20,89	2342089
35	Siqevë	71914064	709,31,88	7093188
36	Slivovë	71914065	709,70,18	7097018
37	Sofali	71914066	771,79,02	7717902
38	Tenezhdoll	71914069	246,11,49	2461149
39	Trudë	71914070	587,27,41	5872741
40	Vranidoll	71914012	740,22,53	7402253
41	Zllatar	71914032	845,63,57	8456357
42	Cagllavicë	71914073	892,55,07	8925507

Gjithsej **52 319,30,70 ha** **523 193 070 m²**

Neni 5

Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i hartimit të planit është Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm e Komunës së Prishtinës.

Neni 6

Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim

Mjetet për hartimin e dokumentit të planifikimit hapësinor janë të siguruara nga buxheti i Komunës së Prishtinës. Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, koordinon procesin e hartimit të Planit zhvillimor komunal me drejtoritë sektoriale dhe ekipi konsulent mbështetës.

Neni 7

Afati i hartimit

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi, është i obliguar që Planin zhvillimor komunal ta hartojë në afat për 12 (dymbëdhjetë) muaj, që nënkupton kompletimin e dokumentacionit për prezantim në procesin e konsultimeve publike, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 8

Konsultimet publike

Projekti i Planit zhvillimor komunal para finalizimit, duhet të vihet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e Projektplanit zhvillimor komunal në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallet përmes njoftimeve publike.

Neni 9

Afati i vlefshmërisë

Dokumenti i planifikimit hapësinor, Plani zhvillimor komunal, hartohet për periudhën kohore 8 (tetë) vjeçare.

Neni 10

Gjuha zyrtare

Dokumenti i planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi, duhet të jetë në gjuhë zyrtare të Komunës dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

Neni 11

Programi

Pjesë e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit, i paraparë sipas nenin 11, pika 1.3 të Ligjit për planifikim hapësinorë, nr. 04/L-174.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-350/05-57601/18, më 09.03.2018

KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS



Agim Kuleta



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Nivela org. Org.federim Org.UNIT No i Pagine No i Stranica No Pages	01-M. -02
No i Prot. Prot. No Datum Datum Date	3455-2/21 05.10.21
PRISHTINË / A No 1	

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
13/10-2021 04-352/10-217842/21	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Kabineti i Ministrimit / Kabinet Ministra / Kabinet of the Minister

DATË/A:	23.09. 2021
REFERENC-Ë:	21/3455/MMPHI
PËR/ZA/TO:	" Komunën e Prishtinës"
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Liburn Aliu, Ministër i Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës , e ka pranuar Raportin për Vlerësim Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor të Komunës së Prishtinës me nr.prot.: 21/3455/419/DMMU, dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1.Vendimi për Pëlqim Mjedisor për Raportin për Vlerësim Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor të Komunës së Prishtinës.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr. 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307
<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Kabineti i Ministrisë / Kabinet Ministra / Kabinet of the Minister

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 28, paragrafi 1, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025, nenit 13 të Ligjit për Vlerësim Strategjik Mjedisor Nr. 03/L-230, nxjerr këtë:

V E N D I M

Komuna e Prishtinës, pajiset me **Pëlqim Mjedisor** për Raportin për Vlerësim Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor të Komunës së Prishtinës.

A r s y e t i m

Komunës së Prishtinës, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka shqyrtuar kërkesën, dokumentacionin, Raportin për Vlerësim Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor të Komunës së Prishtinës, proces verbalin e Debatit Publik për draft Raportin e Vlerësim Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor të Komunës së Prishtinës, listën e pjesëmarrësve në Debat Publik.

Faqe 2 nga 3

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave "Rilindja" kati 17, nr. 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307
<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës merr vendim për lëshuarjen e **Pëlqimit Mjedisor** për Raportin për Vlerësim Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor të Komunës së Prishtinës.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
Nr.: 21/3455/ /21 datë: 23.09.2021

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VSM
3. Inspektoratit të MMPHI-së
4. Zyrës të Sekretarit të Përgjithshëm
5. Kabinetit të Ministrit
6. Arkivi i MMPHI
7. Kuvendit të Komunës së Prishtinës

Liburn Aliu

Ministër i Ministrisë së Mjedisit,
Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.



Faqe 3 nga 3


Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave "Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307
<http://www.ks-gov.net/mmpih>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

V E N D I M

- I. Miratohet vendimi për caktimin e grupit punues për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe hartimin e Hartës Zonale të Komunës.
- II. Bartës i hartimit të dokumenteve si në pikën I është Komuna e Prishtinës, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, në bashkëpunim me drejtoritë sektoriale të Komunës.
- III. Grupi punues si në pikën I të këtij vendimi, është në këtë përbërje:
 1. Drejtoria e Urbanizmit, Drejtor, Arbër Sadiki;
 2. Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Drejtor, Krenar Xhaferi;
 3. Drejtoria e Pronës, Drejtore, Doruntina Maloku;
 4. Drejtoria e Kadastrit, Drejtor, Donat Lushaku;
 5. Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtor, Ilirik Musliu;
 6. Drejtoria e Finacave, Drejtore, Valbona Makolli;
 7. Drejtoria Shëndetësisë, Drejtor, Izet Sadiku;
 8. Drejtoria e Mirëqenies Sociale, Drejtore, Adelina Sahiti;
 9. Drejtoria e Arsimit, Drejtore, Besianë Musmurati;
 10. Drejtoria e Administratës, Drejtor, Bersant Beka;
 11. Drejtoria e Bujqësisë, Drejtor, Plator Gërdovci;
 12. Drejtoria e Parqeve, Drejtore, Donika Çeta;
 13. Drejtoria e Kulturës, Drejtore, Arta Balaj;
 14. Drejtoria Sportit, Drejtor, Granit Rugova;
 15. Drejtoria e Inspektionit, Drejtor, Florian Dushi.

IV. Detyrat e Grupit punues janë:

1. Vlerësimi i Planit Zhvillimor Komunal i Prishtinës 2012-2022 nga sektorët përkatës;
2. Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale të Komunës së Prishtinës 2022-2030 si:
 - *Mbledhja e informatave për hartimin e Profilit të Komunës,*
 - *Vlerësimi i Gjendjes;*
 - *Korniza e Zhvillimit Hapësinor;*
 - *Prioritetet Strategjike Zhvillimore dhe Plani i Veprimit;*
 - *Përgatitja e pjesës hartografike dhe tekstuale të përcaktuar me legjislacionin në fuqi;*
3. Shqyrtimi i ankesave të evidentuara në sistemin e planifikimit për sektorët përkatës.

V. Çdo punëtori e mbajtur e këtij grupi punues do të evidentohet dhe të mbahet procesverbal, i cili procesverbal do t'i dërgohet grupit paraprakisht për miratim nga punëtorja e kaluar.

VI. Grupi punues do të ketë bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe kompaninë mbështetëse të përzgjedhur.

VII. Për kryerjen e punëve, grupi punues do t'i raportojë Kryetarit të Komunës dhe Komitetit konsultativ.

VIII. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi nr. 14-020/04-0208158/18, të dt. 27.08.2018.

IX. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- Grupit punues;
- Qendrës për shërbime me qytetar;
- Në dosje.

KRYETARI I KOMUNËS
Përparim Rama





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



KRYETARI I KOMUNËS

14-010/04-012478/22, më 20 MAY 2022

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

V E N D I M

- I. Miratohet ndryshimi dhe plotësimi i vendimit 14-020/04-97931/22, të dt. 05.05.2022.
- II. Pika II e vendimit të lartcekur, plotësohet si vijon: Bartës i hartimi të dokumenteve si në pikën I është Komuna e Prishtinës, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, drejtoreshë Mimoza Sylejmani, në bashkëpunim me drejtoritë sektoriale të Komunës.
- III. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit 14-020/04-97931/22, të dt. 05.05.2022.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- DPSZHQ;
- Qendrës për shërbime me qytetar;
- Në dosje.

KRYETARI I KOMUNËS
Përparim Rama





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS



Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

V E N D I M

- I. Miratohet vendimi për formimin e Komitetit konsultativ për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale.
- II. Anëtarë të Komitetit konsultativ sipas pikës I të këtij vendimi janë:
 - **Drejtoria e Planifikimit Strategjik:**
 1. Mimoza Sylejmani, kryesuese.
 - **Drejtoria e Urbanizmit:**
 2. Arbër Sadiki.
 - **Asociacioni i arkitektëve të Kosovës;**
 3. Arch. Masar Dushi.
 - **Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;**
 4. Edona Durguti.
 - **Fondacioni Kosovar Trashëgimia Kulturore pa kufinj (CHWB):**
 5. Nol Binakaj.
 - **UN Habitat Kosova:**
 6. Besnike Koçani.

- **Instituti për Planifikim Hapësinor:**

7. Luan Nushi.

- **NGO Pro-Planning:**

8. Lumnie Gashi – Shabani,

- **Fakulteti i Arkitekturës:**

9. Prof.Ass.Dr. Ardita Byci Jakupi.

- **Klubi i Prodhuesve të Kosovës::**

10. Astrit Panxha.

III. Detyrat e Komitetit konsultativ janë:

1. Dhënia e mendimit profesional për çështjet që trajtohen në grupin punues për hartim të PZHK-së dhe HZK-së.
2. Ky komitet duhet ti jap me shkrim sugjerimet e tyre lidhur me çështjet që diskutohen.
3. Para dërgimit në MMPH dhe Kuvend, Komiteti Konsultativ do të bëjë vlerësimin e përgjithshëm të dokumentit final dhe do ti rekomandoj Kryetarit të Komunës procedimin e Planit për Miratim.

IV. Për kryerjen e punëve, komiteti konsultativ do ti raportojë Kryetarit të Komunës.

V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- Anëtarëve;
- Qendrës për shërbime me qytetar;
- Në dosje.

KRYETARI I KOMUNËS

Përparim Rama



1.3. Informata rreth kornizës strategjike që janë marrë parasysh gjatë hartimit të PZHK-së

1.3.1. Strategjitë sektoriale afatshkurta, afatmesme dhe afatgjata në nivel lokal dhe qendror

Duke marrë parasysh faktin që Plani Zhvillimor Komunal është një dokument strategjik multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor, gjatë hartimit të këtij dokumenti është me rëndësi të bëhen analiza cilësore të strategjive sektoriale afatshkurta, afatmesme dhe afatgjate të dy niveleve të planifikimit, qendror dhe lokal.

Strategjitë sektoriale të marra parasysh gjatë hartimit të PZHK-së, të organizuara sipas fushave të ndryshme tematike janë renditur si më poshtë:

Ekonomia

- Zyra e Kryeministrit - Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016-2021, Prishtinë, janar 2016;
- Qeveria e Republikës së Kosovës - Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016-2021, Prishtinë, janar 2016;
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural-Strategjia e Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Prishtinë, Strategjia për Konsolidimin e Tokës 2010-2020, Prishtinë 2010; Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2010–2020, Prishtinë 2009;
- Ministria e Ekonomisë, Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2017-2026, Prishtinë, mars 2017; Strategjia e Ngrohjes e Republikës së Kosovës 2011-2018, Prishtinë, gusht 2011;
- Ministria e Financave, Strategjia për Zhvillimin e Partneriteteve Publike-Private e Republikës së Kosovës, Prishtinë 2014;
- Ministria e Mirëqenies Sociale, Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, Prishtinë 2014;
- Ministria e Diasporës, Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018, Prishtinë, korrik 2013.

Infrastruktura teknike

- Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e mbeturinave 2013-2022, Prishtinë, 2013;
- Menaxhimi i mbeturinave komunale në Kosovë, Raport mbi gjendjen, Prishtinë, 2018;
- Raport i monitorimit dhe i vlerësimit të gjendjes mjedisore në deponitë sanitare dhe stacionet e transferimit të mbeturinave, Prishtinë, 2018;
- Ministria e Ekonomisë, Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2017-2016, Prishtinë, mars 2017;
- Strategjia e Ngrohjes e Republikës së Kosovës 2011-2018, Prishtinë, gusht 2011;
- KRUP–Plani i Biznesit 2020-2022;
- Environmental and social impact assessment for the subcomponent, rehabilitation of irrigation system in Kosovo, 2020.

Infrastruktura e transportit

- Ministria e Infrastrukturës, Strategjia Sektoriale dhe e Transportit Multimodal 2015-2025;
- Plani i Veprimit 5 vjeçar, Prishtinë, gusht 2015;
- Plani i Mobilitetit për Prishtinën, 2018.

Infrastruktura publike dhe sociale

- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021, Prishtinë, korrik 2016;
- Strategjia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar të Kosovës, Prishtinë, 2016;
- Raporti i Gjellbër, Prishtinë, 2015;
- Ministria e Shëndetësisë, Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë, Prishtinë, nëntor 2016.

Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri

- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Strategjia Kornizë për Ndryshimet klimatike në Kosovë 2019-2028;
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2020;
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për cilësinë e ajrit 2011-2021, Prishtinë, 2011;
- Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Raport përmbledhës, Gjendja e ajrit 2018, Prishtinë, janar 2018;
- Analiza e cilësisë së ajrit në Prishtinë gjatë muajit janar 2018;
- Raporti i Kadastrit të ndotësve të ujërave të Kosovës;
- Raport, Hotspotet mjedisore në Kosovë, Prishtinë, 2011;
- Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave, maj 2010, Prishtinë;
- Plani i Reagimit Kombëtar, Prishtinë, dhjetor 2010;
- Vlerësimi i Rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Prishtinë, korrik, 2016;
- Strategjia për Zvogëlim të Rrezikut nga fatkeqësitë dhe Plani i Veprimit 2016-2020.

Trashëgimia natyrore, kulturore dhe turistike

- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe e Sportit, Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme 2020, Prishtinë;
- Lista e Zonave të Mbrojtura 2020, Prishtinë;
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe e Sportit, Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2016-2026, Prishtinë, 2016;
- BE Projekti: Përkrahja për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë 2015-2018, Prishtinë, 2015;
- Udhëzues -Vlerësimi i përfshirjes dhe integritetit të trashëgimisë kulturore në planet hapësinore dhe urbanistike të nivelit lokal, të 2013-ës.

Vendbanimet, banimi dhe shfrytëzimi i tokës

- Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, Instituti për Planifikim Hapësinor, Hulumtim Rritja e zonave urbane në Komunitet e Kosovës, Prishtinë, 2018;
- Raporti Final për Studim i para-fizibilitetit teknik për analizimin e potencialit të kursimit të energjisë, si dhe mundësitë e zbatimit të tij përmes fondeve të efikasitetit të energjisë nga Komuna e Prishtinës, Draft-Programi Trevjeçar i Banimit 2017-2020;
- Vendbanimet Joformale-Hulumtimi i gjendjes ekzistuese, Raport-2005;
- Raport për gjendjen e Vendbanimeve Joformale në Kosovë, dhjetor, 2010;
- Projekt-Strategjia dhe Plani i Veprimit për Parandalimin e Vendbanimeve Joformale në Kosovë 2011-2015;
- Doracak për rregullimin e Vendbanimeve Joformale në Kosovë, tetor, 2012;
- Doracak për përfshirjen e komunitetit në procesin e rregullimit të Vendbanimeve Joformale, 2013;
- Raporti për Mbulueshmërinë e Sipërfaqes së Tokës-CLC2012, Prishtinë 2016.

1.3.2. Strategjitë prej planeve të mëparshme komunale

Është me rëndësi të kuptohet që Plani Zhvillimor Komunal bazohet në masë të konsiderueshme në planet e nivelit të njëjtë, përkatësisht në PZHK-në e periudhës kohore 2012-2022.

Qëllimet, objektivat, strategjitë dhe projektet e trajtuara në Planin Zhvillimor Komunal 2012-2022, janë bazë edhe për këtë PZHK. Edhe modelet e zhvillimit të ardhshëm hapësinor, trajtuar në PZHK-në e viteve 2012-2022 janë baza të mira, të cilat duhen marrë për bazë.

Strategjitë dhe veprimet për zbatim, janë marrë për bazë edhe për të vlerësuar arsyet, veçanërisht disa nga arsyet, se përse disa nga zhvillimet e caktuara nuk kanë arritur të zbatohen. Duke i konsideruar të rëndësishme ndryshimet ligjore, të cilat vendosin theksin e trajtimit të zonës urbane dhe zonave rurale brenda Planit Zhvillimor Komunal dhe Urban, është e udhës të konstatohet, se ky plan në të ardhmen, zëvendëson Planin Zhvillimor Urban për sa i përket disa përmbajtjeve të Zonës Urbane, prandaj në një masë të konsiderueshme ajo që është trajtuar në Planin Zhvillimor Urban me periudhë kohore prej 2012-2022, në përputhshmëri me kërkesat e Ligjit Nr. 2003/14 Për Planifikimin Hapësinor, do të jetë edhe bazë kryesore e trajtimit të qytetit.

Duhet theksuar, se Vizioni i Zonës Urbane zbërthen Vizionin e Komunës, trajton qëllimet, objektivat dhe prioritetet e specifikuar për qytetin.

Nga PZHK dhe PZHU e mëparshme, hartat e konceptit zhvillimor të mëparshme, strukturat urbane, destinimi i sipërfaqeve, janë marrë si baza kryesore së bashku edhe me harta tjera.

Për Planet Rregulluese dhe ato ideore, janë marrë në konsideratë përmbajtjet që i trajtojnë dhe obligimet ligjore, kryesisht janë bazuar gjatë hartimit të këtij dokumenti, siç janë në vijimësi: PRRH Ulpiana, PRRH Vellusha, PRRH Vreshtat, PRRH Zona Ekonomike, PRRH Tophane, PRRH Sofalia, PRRH Qendra 2, PRRH Qendra 1, PRRH Prishtina Re-Perëndim, PRRH Prishtina Re-Lindje, PRRH Prishtina Re-Qendër, PRRH Pejton, PRRH Muhaxhirët, PRRH Medrese, PRRH Mati 1, PRRH Mati 2, PRRH Mati 3, PRRH Kodra e Trimave, PRRH Lakrishtë, PRRH Kalabria, PRRH Dodona, PRRH Dardania, PRRH Arbëria 3.

1.3.3. Strategjitë rajonale ose strategjitë e komunave fqinje

Me analizat e PHK-së dhe të infrastrukturës ekzistuese teknike të nivelit qendror dhe lokal, në raport me objektivat e planeve zhvillimore strategjike të sektorëve qeveritar dhe komunal, janë trajtuar dhe integruar në procesin e hartimit të PZHK-së.

Nga listimet e përmbledhura më lartë, janë marrë parasysh të gjitha strategjitë sektoriale të nivelit kombëtar dhe lokal, ku konsiderohet, se të gjitha strategjitë e komunave fqinje janë integruar në procesin e hartimit të kësaj PZHK-je.

Fusha e ekonomisë – trekëndëshi i zhvillimit ekonomik të Kosovës merr rolin e bartësit të zhvillimit ekonomik, jo vetëm të zonës, por në të njëjtën kohë do të jetë njëra ndër shtyllat e zhvillimit të gjithmbarshëm të ekonomisë kosovare. Për këtë arsye, përpilimi i planit strategjik të zonës së kaltër, gjegjësisht të TZHEK-ut është hap i parë që mundëson zhvillimin e lokacioneve tani të identifikuar për prodhimin e energjisë elektrike. Fuqizimi i korridoreve ekonomike të përbashkëta me komunat fqinje si Fushë Kosovë, Obiliq, Lipjan dhe Podujevë.

Fusha e transportit – modernizimi i hekurudhës dhe avancimi i rrugës nacionale, ndërtimi i stacionit multimodal, fuqizimi dhe modernizimi i aeroportit dhe transportit urban janë rezultat i strategjive nacionale që ka edhe efekt rajonal.

Infrastruktura teknike – ka strategji dhe dokumente të hartuara nga kompanitë rajonale që ofrojnë shërbime nga Prishtina për komunat fqinje, si Plani i biznesit i KRU Prishtinës 2019-2021; Fizibiliteti për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza si dhe ndërtimi i kolektorëve mbledhës; "Para-Fizibiliteti Banka Evropiane 2019" (Pre-Feasibility European Bank 2019) – Fizibiliteti për energji alternative (solare), për prodhim të energjisë së ripërtëritshme për komunën e Prishtinës, Obiliqit dhe Fushë Kosovës; Plani zhvillimor i Termokos 2019-2029 për zgjerim të kapaciteteve shërbuese për Prishtinë, Fushë Kosovë dhe Obiliq.

Fusha e trashëgimisë – Plani rajonal i trashëgimisë 2015-2018, lista e aseteve të trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përhershme dhe të përkohshme, mbrojtja dhe fuqizimi i parkut të Gërmisë si aset i trashëgimisë natyrore.

Fusha e infrastrukturës sociale dhe publike- Strategjitë e arsimit (Universiteti i Prishtinës), sporti (stadiumi i qytetit), spitali etj., e trajtuar në strategji të ndryshme me efekt rajonal dhe nëpër komuna fqinje.

Fusha e sigurisë – Po ashtu trajtohet në Strategjitë e ndryshme, ku kemi ndarjet rajonale ose strategjitë e komunave fqinje, Vlerësimi i Rrethit nga Fatkeqësitë Natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Prishtinë, korrik, 2016; Strategjia për Zvogëlim të Rrezikut nga Fatkeqësitë dhe Plani i Veprimtari (2016-2020), të cilat synojnë struktura dhe organizime rajonale.

1.4. Udhëzimet, përgjegjësitë dhe kërkesat që burojnë nga konteksti i gjerë i planifikimit siç janë planifikuar në PHK dhe HZK

Bazuar në strukturat hapësinore të zhvillimit që i përcakton Plani Hapësinor i Kosovës, Komuna e Prishtinës bën pjesë në "Hapësirën e Kaltër" apo Porti i Kosovës. Kjo hapësirë karakterizohet me rajone të dendura të qendrave urbane dhe atyre rurale në zhvillim e sipër, tokë bujqësore të kualitetit të lartë, pasuri nëntokësore (linjt, Ni, Pb, zink, ari), hapësirave dhe objekteve të rëndësishme arkeologjike dhe kulturore, hapësirave të lira të gjelbra, ndërsa për nga veprimtaritë ekonomike karakterizohet me ato industriale, tregtare dhe shërbyese, si dhe veprimtaritë administrative, shëndetësore, arsimor dhe shkencore.

Vizioni për këtë hapësirë është: *"Porti i Kosovës (hapësira e kaltër)-administrative, shërbyese, tregtare, agro-industriale, turistike që paraqet pjesën veriore të Kosovës, i përbërë nga komunat: Prishtina si qendër kryesore dhe kryeqendër e Kosovës, Obiliqi, Podujeva, Fushë-Kosova, Lipjani, Drenasi dhe Shtimja që gravitojnë në qytetin e Prishtinës."*

Qëllimet e përgjithshme janë:

• Zhvillimi i rrjetit të vendbanimeve, me qeverisje e shërbime publike në favor të qytetarit, me rritje të kualitetit të jetesës së qytetarëve, punësimit, barazisë sociale:

- ZHEL për ZHEK-shfrytëzimi i përparësive konkurruese;
- Zhvillimin e lidhjeve efikase brenda urbane, ndër-urbane me hapësirat tjera dhe më gjerë, lidhjet e fuqishme rajonale përmes zhvillimit të rrjetit të infrastrukturës (rrugore, hekurudhore, ajrore, ti-së);
- Promovim i TZHEK, lokacion për grupim aktiviteteve në aspekt hapësinor, investime të huaja, kompani multinationale;
- Mbështetje aktiviteteve të H&ZH, për një ekonomi të njohurive, mbështetur nga kapacitetet organizative;
- Promovimin e Prishtinës si qendër të diturisë së rajonit, më të gjerë të Evropës Juglindore;
- Zhvillimin e aktiviteteve administrative, arsimore, shërbyese tregtare, energjetike, agro-industriale e turistike.

1.5. Informata për procesin e planifikimit

Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Prishtinës dhe Vlerësimi Strategjik Mjedisor janë hartuar nga Komuna e Prishtinës me mbështetje të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Gjatë procesit të planifikimit janë mbajtur disa takime pune të ekipit planifikues komunal në të cilat është diskutuar mbi procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal. Është bërë vlerësimi i të dhënave aktuale me të cilat dispononte komuna në atë kohë, identifikimi i nevojave për gjenerimin e të dhënave të reja si dhe mënyrat e menaxhimit të procesit të sigurimit të të dhënave të nevojshme. Është hartuar edhe Kalendari i Aktiviteteve dhe i Debateve Publike për tërë procesin e planifikimit. Përfaqësuesit e komunës si dhe ata të drejtorive janë zotuar për përpjekjet dhe procesin të mbledhjes së të dhënave. Gjatë takimeve tjera është bërë vlerësimi i të dhënave të gjeneruara pas takimit të parë, identifikimi i nevojave për gjenerimin e të dhënave të reja si dhe mënyrat e menaxhimit të procesit të sigurimit të të dhënave të nevojshme. Tutje, në takimet vijuese është diskutuar për draftin e Profilit Komunal dhe Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese, janë identifikuar

nevojat për intervenim me qëllim të plotësimit të draftit të profilit, para fillimit të debateve publike. Janë bërë përgatitjet për debatet publike, në mënyrë që ekipi i planifikimit të jenë të gatshëm t'i sinkronizojnë dhe t'i inkorporojnë sugjerimet e qytetarëve dhe grupeve tjera të interesit, pjesëmarrës në debatet publike.

Pas diskutimit publik kanë vazhduar takimet e ekipit planifikues komunal. Në këto takime është bërë përmbledhja e procesit deri në atë datë, përmbledhja e Debatit Publik për fazën e Profilit Komunal dhe Analizës së Gjendjes Ekzistuese, është diskutuar azhurnimi i të dhënave si rezultat i këtij debati si dhe është planifikuar Punëtoria për Vizionimin e Komunës dhe Skenarëve Zhvillimor për Komunën e Prishtinës. Në këtë punëtori kanë qenë pjesëmarrës përfaqësues të organeve vendimmarrëse të komunës së Prishtinës, përfaqësues të të gjitha drejtorive komunale, përfaqësues të shoqërisë civile dhe komunitetit të biznesit, si dhe përfaqësues të kompanisë konsulente.

Sugjerimet e grupeve punuese për Vizionin e Komunës, Skenarët Zhvillimor si dhe Planifikimin Sektorial janë debatuar nga të gjithë pjesëmarrësit dhe në fund janë sintetizuar. Vendimet finale për Vizionin e Komunës, Skenarët Zhvillimor si dhe Planifikimin Sektorial janë reflektuar në draft Planin Zhvillimor Komunal dhe si të tilla janë diskutuar me qytetarët e lagjeve të kryeqytetit në Debatet Publike për Vizionimin, Skenarët Zhvillimor dhe Planifikimin Sektorial, të cilat janë zhvilluar pas kësaj Punëtorie.

Nga procesi i përmbledhur më lart janë përmblytur të gjitha fazat e analizave dhe planifikimit për PZHK e kryeqytetit 2023-2031 duke përfshirë edhe vizionin, konceptet e zhvillimit hapësinor, propozimi i skenarëve për zhvillim, qëllimet dhe objektivat si dhe plani i veprimit. Sa i përket përmbajtjes së PZHK-së së kryeqytetit 2023-2031, pas kompletimit të Profilit dhe Analizës së Çështjeve, të cilat janë bërë në përputhje me U.A. MMPH Nr. 11/2015 është vazhduar me Kornizën e Zhvillimit Hapësinor si dhe me të gjitha fazat e parapara me Udhëzimin Administrativ në fjalë.

RAPORTI I SHQYRTIMIT PUBLIK

1.6. Përmbledhje e shkurtër e PZHK-së

Qasja ndaj planifikimit strategjik dhe të zhvillimit të qëndrueshëm për komunën e Prishtinës është një përgjigje ndaj ndryshimit të vazhdueshëm urban të udhëhequr në komunë dhe rolit që Kryeqyteti i Republikës së Kosovës, Prishtina luan në zhvillimin prijës të vendit si motor i saj për rritje dhe prosperitet.

Strategjitë e përshkruara në këtë dokument janë procese dinamike të mbështetura nga analiza dhe ndërhyrje multi-sektoriale dhe transdisiplinore që mbështeten në vullnetin e banorëve të Prishtinës dhe palëve të tjera të interesit, duke u mbështetur në asetet lokale dhe trashëgiminë kombëtare, të prekshme dhe të paprekshme për një cilësi më të mirë të jetës për banorët e komunës së Prishtinës. Për të qenë një mekanizëm i suksesshëm në një shumëllojshmëri të gjerë kontekstesh, strategjitë e zhvillimit urban dhe rajonal kërkojnë një shumëllojshmëri qasjesh, duke përfshirë strategjitë e rizhvillimit dhe rigjenerimit, densifikimit dhe intensifikimit, diversifikimin e aktiviteteve ekonomike, ruajtjen dhe rivitalizimin e trashëgimisë, riaktivizimin e hapësirës publike, dhe forcimin e ofrit të shërbimeve.

1.6.1. Ngjarje të rëndësishme globale me ndikim në procesin e planifikimit strategjik të komunës

Një tronditje parësore dhe e vazhdueshme në mënyrën tonë të jetesës është shkaktuar nga ndryshimet klimatike, një kontribues kryesor në të cilin sipas UN-Habitat janë zonat urbane, që përbëjnë 71 deri në 76% të emetimeve globale të CO₂. Të njëjtat qytete urbane janë qendrat kryesore të aktivitetit ekonomik ku fitohen, formohen dhe prodhohen mjetet e jetesës së miliarda njerëzve. Ndryshimi i klimës nuk nënkupton vetëm ndryshim në stilin e jetës ose konsum më racional për qindra miliona, por gjithashtu ndikon negativisht në infrastrukturë dhe përkeqëson qasjen në shërbimet bazë. Prandaj, proceset bashkëkohore gjithëpërfshirëse të planifikimit kanë identifikuar nevojën për të adresuar cënueshmërinë dhe rreziqet që sjellin ndryshimet klimatike dhe përpiqen të përfshijnë plane përshtatjeje dhe mekanizma përforcues të qëndrueshëm në strategjitë e zhvillimit urban dhe rajonal.

Një tjetër ngjarje e jashtëzakonshme që ka pasur ndikim thelbësor në mënyrën se si jetojmë, punojmë dhe luajmë është pandemia e Covid-19. Mësimet e hershme të nxjerra nga pandemia kanë qenë të lidhura drejtpërdrejt me vendet tona të punës, transportin tonë publik dhe dendësinë e lagjeve tona të banuara. UN-Habitat ka zhvilluar udhëzime për planifikimin hapësinor dhe mbetjet e ngurta në reagim të drejtpërdrejtë ndaj ndikimit të Covid-19 dhe si të zbuten ndikimet e tij.

Një zhvillim i tretë i rëndësishëm i cili është përfshirë në strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm ka një natyrë ndërsektoriale. Transformimi dixhital dhe ofrimi i qasjes së barabartë në infrastrukturën e TI-së jo vetëm që u miratua plotësisht për të anashkaluar kufizimet e vendosura në jetesën, shëndetin dhe komunitetet tona, por gjithashtu është bërë një mjet efektiv për paralajmërimin e hershëm kundër përmbytjeve të shpejta dhe ndryshimeve të papritura të motit si pasojë e ndryshimit të klimës. Prandaj, kjo qasje ndaj planifikimit strategjik dhe të zhvillimit të qëndrueshëm për komunën e Prishtinës është formuar dhe përshtatur, e cila merr parasysh:

1. Covid-19
2. Sfidat e përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike
3. Transformimi dixhital.

Të kuptuarit dhe artikulumit i përfitimeve të përbashkëta të strategjive të zhvillimit urban dhe rajonal për shëndetin urban gjeneron një efekt pozitiv më të gjerë dhe mund të tërheqë investime dhe të ulë çështjet shëndetësore lokale, si dhe cenueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike.

1.6.2. Qasja e adoptuar për strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm të komunës së Prishtinës

Ky plan strategjik i zhvillimit të qëndrueshëm për komunën e Prishtinës adopton qasjen shtyj/tërheq (Push/Pull) në ndërtimin e skenarëve të saj, përballë të dhënave dhe statistikave të kufizuara të regjistrimit të popullsisë në përgjithësi dhe për ofrimin e banesave të përballueshme dhe përmirësimi i infrastrukturës në veçanti.

Një qasje shtyj/tërheq është e orientuar nga tregu i lirë, e bazuar në rrugë drejtë zhvillimit të qëndrueshëm që synon të lidhë në mënyrë strategjike, në dizajn dhe praktikë, përpjekjet për të mbështetur ofrimin e vlerave ekonomike, mjedisore dhe sociale.

Strategjitë shtyj/tërheq ndërlidhen si në teori ashtu edhe në praktikë dhe këto strategji mund të funksionojnë së bashku për të krijuar mundësi më të qëndrueshme dhe më të përgjegjshme shoqërore për ofrimin e vlerave ekonomike, mjedisore dhe sociale për njerëzit në të gjithë komunën e Prishtinës.

Strategjitë e shtytjes janë mjete për arritjen e vizionit të komunës për Prishtinën bazuar në tërheqjen e kërkesave të menjëhershme të qytetarëve/banorëve.

Në këtë kontekst, strategjitë e shtytjes përqendrohen në përmirësimet e mundshme që mund të bëhen për të lehtësuar një proces më të menduar dhe më të qëndrueshëm zhvillimi në një epokë ku ka një mundësi për projeksione përtej të menjëhershmes, duke përfituar nga:

- një bindje e përgjithshme në mesin e banorëve të Prishtinës për të menduar në mënyrë më kreative për përdorimin e burimeve të kufizuara në tregje përtej asaj lokale;
- një tendencë për të ndërtuar asete familjare, të komunitetit dhe të grupeve profesionale;
- avancimi i sistemeve të informacionit për të menaxhuar ndryshimin.

Strategjitë e tërheqjes funksionojnë duke kuptuar kufizimet e sistemit ekzistues dhe adresojnë kërkesën e menjëhershme dhe nxitin ndërhyrjet në favor të:

- përmirësimit të mbështetjes me mbrojtjen sociale;
- ndërtimi i aftësive për jetesën e drejtuar nga kërkesa dhe "gatishmërinë në treg" (p.sh., përmes trajnimit të aftësive profesionale, ose mentorimit);
- përmirësimi i aftësive 'të buta' si besimi, negociimi ose ndërtimi i marrëdhënieve;
- ofrimi i mundësive për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla që promovojnë barazinë gjinore dhe diversitetin;

- koordinim më i madh ndërmjet drejtorive komunale;
- ndërtimi i besimit të përgjithshëm se Kosova mund t'i plotësojë nevojat e qytetarëve të saj.

Kjo qasje me dy drejtime për ndërtimin e skenarëve rrjedh nga një teori e ndryshimit, ajo përdor të dyja strategjitë shtytëse - të cilat ndëtojnë kapacitete për t'u përfshirë në tregje dhe strategji tërheqëse - të cilat zgjerojnë diversitetin dhe cilësinë e mundësive ekonomike të aksesueshme, për të sjellë më shumë përfitime dhe të qëndrueshme nga përfshirja e komuniteteve lokale.

Përderisa planet tradicionale të zhvillimit komunal përdoren për të ndikuar në shpërndarjen e ardhshme të aktiviteteve në hapësirë dhe janë:

- statike dhe në mungesë të dinamizmit për t'iu përgjigjur shpejt rrethanave lokale në ndryshim;
- shumë të fokusuar në rregullim dhe jo në ndikim dhe rezultate;
- të përgatitur mekanikisht dhe shpesh mungon angazhimi me palët e interesuara;
- të kufizuar në monitorim dhe vlerësim.

Strategjitë e Zhvillimit të Qëndrueshëm për Komunën e Prishtinës synojnë:

- fokusim në strategji;
- të jenë fleksibil për të lejuar krijimin e planeve të hollësishme lokale.

2. PROFILI KOMUNAL DHE VLERËSIMI I GJENDJES EKZISTUESE

2.1. Historia e zhvillimit të komunës

Gjurmët e para të banimit në territorin e komunës së Prishtinës datojnë që nga periudha e neolitit, rreth 6 mijë vjet më parë, ndërsa hulumtimet arkeologjike (Matiçan, Graçanicë, Tjerrtorja, Ulpianë) dëshmojnë se jeta në këto territore nuk është ndërprerë asnjëherë deri sot. Në kohët e antikitetit klasik ishte shtëpia e fisit ilir të dardanëve. Mbreti Bardhyli bashkoi fise të ndryshme në zonën e Prishtinës në shekullin e IV-të p.e.r, duke themeluar Mbretërinë Dardane. Trashëgimia e epokës klasike është ende e dukshme në qytet, i përfaqësuar nga qyteti antik i Ulpianës, i cili konsiderohej një nga qytetet romake më të rëndësishme në Gadishullin Ballkanik.¹

Gjatë sundimit romak, në afërsi të qytetit të Prishtinës u ngrit qyteti i njohur Ulpiana (Urbus splendissima), që njihej si qendër e Dardanisë ilire. Pas rënies dhe braktisjes së Ulpianës, në veriperëndim të saj u ngrit dhe u zhvillua Prishtina. Ajo përmendet për herë të parë si fshat i pafortifikuar nga Perandori Bizantin, Johan Kantakuzen, në vitin 1342. Zhvillimi i tregtisë dhe xehetarisë ndikuan në përparimin dhe zgjerimin e qytetit. Prishtina si qendër ekonomike kishte edhe tregun e vet, ndërsa përmendet edhe si qendër e organizimit të lojërave me kalorës. Gjatë shekullit XIII-XIV Prishtina merr tipare urbane, kur bëhet qendër e rëndësishme xehetare dhe tregtare në rrugën Dubrovnik-Stamboll.

Gjatë pushtimit osman në Prishtinë vendoset selia e sanxhakut, ndërsa në vitin 1530 shënohet si kasaba dhe stacion i rëndësishëm i rrugës Selanik-Sarajevë. Gjatë shek. XVII-XVIII, Prishtina pati një zhvillim të ngadalshëm, për shkak të luftërave dhe zjarreve, që e dogjën disa herë, ndërsa në shek. XIX fillon rimëkëmbja e saj. Ajo merr funksione të rëndësishme si qendër tregtare, por edhe si qendër politike dhe administrative. Në vitin 1877 Prishtina bëhet qendër e vilajetit të Kosovës. Gjatë këtij shekulli u hapën disa konsullata të vendeve evropiane, si ajo e Francës, e Anglisë, e Austrisë etj. Mirëpo, me largimin e qendrës së vilajetit në Shkup në vitin 1888, Prishtina humbi rolin administrativ dhe politik që e kishte.² Fundi i shekullit XIX shënoi një zhvillim të veçantë, me ardhjen e një influence të re të kulturës evropiane, kryesisht nga Italia dhe Austria.

Ndryshimet politike dhe administrative pas Luftës së Dytë Botërore krijuan një bazë solide për zhvillimet sociale-ekonomike që u reflektua në përkufizimin urban të Prishtinës. Zhvillimet e viteve të '50 e '60, u bazuan në paradigmen e rritjes së diferencës rurale-urbane që shkaktoi migrim domethënës të popullsisë nga zonat rurale dhe qytetet tjera të Kosovës për në Prishtinë. Ky proces, pothuajse kurrë nuk u ndal, erdhi duke u intensifikuar më shumë pas luftës së viteve 1998-99.³

¹ Kraja M. (2018), "Fjalori Enciklopedik I Kosovës", Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës

² Kraja M. (2018), "Fjalori Enciklopedik I Kosovës", Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës


³ Plani Zhvillimor Komunal I Prishtinës 2012-2022

2.2. Karakteristikat e përgjithshme të komunës

2.2.1. Pozita gjeografike dhe karakteristikat natyrore

Prishtina është qenër urbane, komunale e regjionale dhe kryeqyteti i Republikës së Kosovës. Qyteti i Prishtinës është i vendosur në koordinatat 42° 40' 0" veri dhe 21° 10' 0" lindje. Sipërfaqja e Komunës së Prishtinës është 523.21 km². Prishtina si kryeqendër e Kosovës karakterizohet me pozitë të volitshme gjeografike ngase shtrihet në udhëkryqin e rrugëve që i mundësojnë dalje dhe lidhje me detin Adriatik përmes Fushë Kosovës, me autostradën Prishtinë-Durrës, me detin Egje përmes grykës së Kaçanikut dhe luginës së Vardarit, por edhe me vendet e tjera kontinentale përmes rrugëve automobilistike në drejtim të veriut lidhet me Evropën Qendrore, ndërsa në drejtim të lindjes lidhet me Anamoravën por edhe me Luginën e Preshevës.

Komuna e Prishtinës është gjithashtu qendra më e madhe ekonomike, administrative, edukative dhe kulturore në Kosovë. Ndodhet pranë aeroportit ndërkombëtar, hekurudhës, dhe pothuajse të gjitha rrugët kryesore kalojnë nëpër territorin e kësaj komune duke e lidhur atë me komunat e tjera të Kosovës dhe me shtetet tjera të rajonit.




Harta 1 Pozita gjeografike e komunës

Veçoritë fiziko-gjeografike


Në Komunën e Prishtinës dominon relievi kodrinor-malor që përfshinë lindjen, verilindjen dhe juglindjen e komunës, ndërsa në pjesën perëndimore shtrihet rrafshira e Rrafshit të Kosovës. Prishtina ndodhet në kontaktin morfologjik dhe morfotektonik në mes të fushëgropës së Kosovës dhe Maleve Lindore, ndërsa pjesa rurale shtrihet tërësisht në pjesën kodrinoro-malore. Në aspektin e lartësisë mbidetare territori i Prishtinës shtrihet në nivele të ndryshme hipsometrike. Pika më e ulët ndodhet në pjesën e rrafshët perëndimore me 536. 9 m lartësi, ndërsa pika më e lartë ndodhet në pjesën lindore 1065 m/lmd (kodra e Butocit).

Relievin e qytetit të Prishtinës e përbëjnë terrenet e ngritura me lartësi mbidetare prej 536-730 m. Qyteti rrethohet prej shpateve në të tri anët, duke krijuar një situatë topografike amfiteatrale. Në veri dhe në lindje, pylli i Gërmisë arrin lartësinë prej 1100 m. Në perëndim, Prishtina kufizohet me shpatet e Arbërisë (ish - Dragodanit), në veri me kodrën e Pozderkës, duke vazhduar më tej me vargun e Bjeshkëve të Butovcit (Malet e Prugovcit dhe të Grashticës), në jug me lagjen e Veternikut dhe me lagjen Prishtina e Re.




Harta 2 Hipsometria e terrenit

Kodrat janë me pjerrtësi të ulët, përveç lindjes, ku pjerrtësia është relativisht më e madhe. Peizazhi natyror i territorit është i ndryshueshëm dhe i pa eksploruar. 7,09% e territorit ka pjerrtësi deri në 2°, terrene të cilat janë shumë të përshtatshme për ndërtim, 10,05% e territorit ka 2°-5° pjerrtësi, të cilat janë terrene po ashtu të përshtatshme për ndërtim, 30,94% e territorit ka 5°-12° pjerrtësi, që janë të përshtatshme për ndërtim por me investime adekuate, 51,73% e territorit ka pjerrtësi 12°-32°, terrene të pa përshtatshme për ndërtim me përjashtime të caktuara, ndërsa vetëm 0,17% e territorit të Prishtinës ka pjerrtësi mbi 32°, terrene të cilat nuk janë të përshtatshme për ndërtim.




Harta 3 Pjerrtësia e terrenit

Ekspozicioni i shpateve apo drejtimi i shtrirjes së shpateve te territorit të Prishtinës është i larmishëm dhe mund të themi që ekzistojnë të gjitha drejtimet e shtrirjes: veri, verilindje, lindje, juglindje, jug, jugperëndim, perëndim dhe perëndim.



Harta 4 Ekspozicioni i terrenit




Harta 5 Përbërja gjeologjike e tokës

Territori i gjerë i Prishtinës i takon zonës gjeologjike të Vardarit. Ajo shtrihet në planin morfologjik të Kosovës dhe përfaqëson një plan aluvional të mbuluar me sedimente të liqeneve, kurse nga ana gjeologjike është një depresion tektonik, i cili është ngritur gjatë ndryshimeve oligo-miocene.

Ndërtimi litologjik është mjaft karakteristik, ku hasen shkëmbinjtë të moshave dhe përbërjeve të ndryshme si: flish, breçke, mermer, gëlqerore, mergele, shkëmbinjtë magmatik e metamorfik (gabro, diabaze, serpentinite, mermer), pastaj rërë, zhavorr, argjilë etj.


Tipet më të përfaqësuara të tokave janë tokat e kafenjëta me pjesmarrje prej 71,73% të territorit, të cilat gjenden në terrenet e larta nën pyje, pastaj vijnë tipet e tjera si: smonica 7,53%, tokat aluviale 6,53%, deluviale 4,75% të cilat janë të përshtatshme për kultivimin e kulturave bujqësore e që gjenden në pjesën fushore të territorit, përgjat lumenjëve, ndërsa pjesën tjetër e përbëjnë tokat e kuqrrrema, rendezine, podzol-pseudoglej, litosole, ranker dhe shkëmbinjtë.



Harta 6 Pedologjia

Nga pikëpamja hidrografike, rajoni i Prishtinës është i varfër. Rrjedhat ujore të rajonit më të gjerë të qytetit, përbëhen nga Lumi i Prishtinës dhe i Vellushës, që së bashku derdhen në Sitnicë me disa përroje të përhershëm dhe periodik. Në rajonin e Prishtinës shtrihet edhe dy liqejt artificial. Liqeni i Badovcit, në juglindje të qytetit të Prishtinës, i cili u ndërtua në vitin 1960 me qëllim të ofrimit të ujit të pijshëm për Prishtinën dhe ujë për Minierën e Kishnicës, i cili po ashtu përdoret edhe për peshkim. Liqeni i Batllavës që gjendet në pjesën veriore të komunës së Prishtinës, i cili shërben si burimi kryesor i ujit të pijshëm për territorin e Prishtinës dhe Podujevës, dhe është një nga destinacionet turistike më të njohura për kosovarët.

Pjesa më e madhe e ndjeshmërisë së ujërave nëntokësore në Prishtinë është e ulët me një sipërfaqe prej 39587.76 ha apo 75.67 % të territorit, ndërsa sipërfaqja prej 2031.53 ha apo 3.88% e territorit të komunës ka ndjeshmëri shumë të lartë të ujërave nëntokësore.



Harta 7 Hidrogjeologjia

Elementet klimatike

Në aspektin klimatik Prishtina ka klimë kontinentale, që karakterizohet me vera të nxehta e të thata dhe dimra të gjatë e të ashpër. Kjo për shkak se gjendet në gjerësinë e mesme gjeografike të hemisferë veriore, larg nga deti dhe me një reliev kodrinoro-malor.

Temperatura mesatare vjetore e ajrit në Prishtinë është 9.9°C. Muajt me temperaturën mesatare më të nxehtë janë korriku (19,8°C) dhe gushti (19,6°C), ndërsa muajt me temperaturën mesatare më të ulët janë janari (-1,4°C) dhe dhjetori (0,3°C). Vlera mesatare e lagështisë së ajrit është 71,8% me luhajtje të vogla gjatë vitit.

Sasia mesatare e reshjeve është 599 mm, që paraqet njërin nga lokacionet me më se paku reshje në Kosovë. Maksimumi i reshjeve paraqitet në maj dhe nëntorë (68 mm), ndërsa minimumi i tyre në muajin shkurt (36 mm) dhe shtator (42 mm). Numri mesatar i ditëve me borë sillet nga 10,2 (janar), 8,3 (shkurt), deri në 8,1 ditë (dhjetor). Trashësia maksimale e borës ka arritur në 43 cm, ndërsa qëndrueshmëria e shtresës me borë ka zgjatur deri në 47 ditë.

Territori i Prishtinës shpeshherë përfshihet nga erërat e fuqishme, mesatarja e shpejtësisë së erës është 3,5 m/sek. Gjatë periudhave të ndryshme të vitit paraqiten erëra të forta dhe me karakter të shtrëngatave lokale, të cilat shoqërohen me dëme materiale. Erëra të forta me shpejtësi prej 17,2-20,7 m/sek paraqiten gjatë gjithë vitit, me koncentrim më të madhë gjatë dimrit dhe pranverës, kurse më rrallë gjatë verës dhe vjeshtës. Rastisje më të shpeshtë kanë erërat që fryjnë nga drejtimi i veriut dhe verilindjes.


Vranësitat luajnë rol të rëndësishëm në kushtet e motit të qytetit, por edhe në gjendjen emocionale të njerëzve. Mesatarisht gjatë vitit qielli i Prishtinës është i mbuluar me vranësira rreth 55%, me lëkundje gjatë vitit. Numri i ditëve të kthjellëta sillet nga 2,9 ditë në janar, në 13,3 ditë në gusht, ndërsa mesatarja e ditëve të vranëta luhetet nga 16,1 ditë në dhjetor, në 2,8 ditë në gusht.

Në Prishtinë dhe në Rrafshin e Kosovës ekzistojnë kushte të favorshme për paraqitjen e mjegullës, që ndërlidhet me morfologjinë e relievit, e rrethuar me male në periferi dhe e fuqizuar nga faktori njeri me termocentralet etj. Mjegulla qëndron nga disa orë, deri në disa javë. Numri mesatar i ditëve me mjegull në Prishtinë është 29.8 ditë në vit. Numri më i madh i ditëve me mjegull paraqitet në nëntor (5 ditë) dhe dhjetor (7,2 ditë), ndërsa numri më i vogël i ditëve me mjegull paraqitet në prill

(0,3 ditë) dhe në korrik (0,6 ditë). Periudha më e gjatë kohore e shënuar me mjegull në Prishtinë ishte gjatë gjysmës së dytë të dhjetorit të vitit 2013, deri në fund të gjysmës së parë të janarit 2014.

Bazuar në vërtetimet e diellosjes në katër stacionet meteorologjike të Prishtinës, Ferizajt, Prizrenit dhe Pejës, Kosova disponon një mesatare prej 2079 orë diell gjatë vitit, që përbëjnë rreth 5.7 orë diell në ditë. Prishtina, në veçanti, shfaq vlerën më të lartë të diellosjes me vlerë mesatare vjetore 2119 orë/vit, vlera mesatare gjatë ditës është 5,8 orë/ditë, ndërsa vlera më e madhe paraqitet në muajt korrik dhe gusht ndërsa më e vogël në janar. Kjo tregon potencialin e mirë të Prishtinës për diellosje.

Dielloshja varet nga shumë faktorë. Disa prej tyre janë të qëndrueshëm dhe quhen faktorë klimatike (gjerësia gjeografike, lartësia mbidetare, përhapja e masave tokësore dhe ujore etj.), ndërsa të tjerët u nënshtrihen ndryshimeve dhe quhen elemente klimatike (lagështia e ajrit, retë, temperatura e bazës dhe e ajrit, erërat etj.).



Harta 8 Potencialet për energji solare.

2.3. Demografia


2.3.1. Zhvillimi demografik

Në analizën e zhvillimit demografik të komunës së Prishtinës janë marrë të dhënat nga regjistrimet e popullsisë nga viti 1948 deri në regjistrimin e fundit atë të vitit 2011. Gjithashtu janë analizuar edhe të dhënat nga vlerësimet e popullsisë deri në vitin 2021. Për vitin 1991 janë vetëm vlerësim nga fakti se këtë regjistrim e ka bojkotuar popullsia shqiptare. Regjistrimi i fundit i popullsisë, ai i vitit 2011 prezanton vetëm numrin e popullsisë rezidente. Sipas regjistrimit të vitit 2011, komuna e Prishtinës kishte 198,897 banorë, por sipas vlerësimit zyrtar nga ASK për vitin 2021, në këtë komunë jetojnë 219,017 banorë.

Tabela 1 Regjistrimi i popullsisë dhe ekonomive familjare në komunë (Burimi: ASK)

Viti	Popullsia		Ekonomitë Familjare (EF)		Madhësia e familjes (numri i anëtareve në ekonomitë familjare)	
	Komuna	Qyteti	Komuna	Qyteti	Komuna	Qyteti
1948	41030	19631	7519	4667	5.5	4.2
1953	47985	24081	8867	5634	5.4	4.3
1961	64928	38593	12711	9059	5.1	4.3
1971	99140	69514	18771	14813	5.3	4.7
1981	141201	108083	25266	21017	5.6	5.1
1991	191501	155499	34410	29642	5.6	5.2
2011	198897	145149	40528	30768	4.9	4.7
2021	219017 ⁴					

Sipas të dhënave, komuna e Prishtinës ka pasur rritje të numrit të popullsisë nga viti 1948 deri në vitin 2021. Gjatë kësaj periudhe 73 vjeçare popullsia e komunës së Prishtinës është rritur për 177,987 banorë, apo thënë ndryshe është pesëfishuar.



Grafika 1 Numri i popullsisë 1948-2021 (Burimi: ASK)


Lëvizjet natyrore të popullsisë - Të dhënat e shtimit natyror janë analizuar nga statistikat e lindjeve dhe vdekjeve në Kosovë për vitin 2021. Gjatë vitit 2021 në komunën e Prishtinës janë shënuar 3173 lindje dhe 1631 vdekje. Bazuar në këto të dhëna është llogaritur shkalla e natalitetit, mortalitetit dhe shtimit natyror në promilë dhe në përqindje. Shkalla e natalitetit në komunën e Prishtinës ka shënuar rënie të konsiderueshme në krahasim me periudhat e më hershme kohore dhe sot është 14.5 promilë apo 1.45 %. Shkalla e mortalitetit është 7.45 promilë apo 0.75 %. Në bazë të këtyre shkalleve të natalitetit dhe mortalitetit del se shtimi natyror i popullsisë në komunë është 7.0 promilë apo 0.70 %.

2.3.2. Strukturat e popullsisë

2.3.2.1. Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë

Nga piramida e popullsisë vërehet se grup-moshat e reja 0 deri 9 vjeç, 10-19 vjeç dhe 20-29 vjeç kanë pjesëmarrje më të madhe në popullsinë e përgjithshme.

⁴ ASK, Vlerësimi I popullsisë 2021



Grafika 2 Piramida e popullsisë së Prishtinës (Burimi: ASK, 2011)

Kjo është një indikator mjaft i rëndësishëm që tregon se në të ardhmen mund të ketë natalitet të lartë, nga fakti se këto grup-mosha në të ardhmen japin një përqindje të konsiderueshme të popullsisë fertile që konsiderohet si burim i lindshmërisë. Por duhet të kemi parasysh edhe indikatorët e tjerë për projeksionin e popullsisë.

Struktura e popullsisë sipas gjinisë në komunën e Prishtinës është e baraspeshuar, me 49.9% burra/djem dhe 50.1% gra/vajza. Koeficienti i feminitetit është rreth 1,001, që do të thotë së mesatarisht në komunën e Prishtinës jetojnë 1,001 gra/vajza për çdo 1,000 burra/djem.

Popullsia aktive apo e aftë për punë, grup-mosha 15-64 vjeç përbën shumicën e popullsisë me pjesëmarrje prej 67.54%, ndërsa grup-mosha e fëmijëve dhe rinjve 0-14 vjeç merr pjesë me 25.85%, duke lënë pas grup-moshën 65 vjeç+ me pjesëmarrje të ulët në popullsinë e përgjithshme me vetëm 6.61%.

Tabela 2 Kontingjentet e popullsisë (Burimi: ASK, 2011)

<i>Kontingjentet e rëndësishëm</i>	
<i>Kontingjenti parashkollor dhe me shkollim të obligueshëm (0-14 vjet)</i>	23.37%
<i>Popullsia fertile femërore (15-49 vjet)</i>	25.03%
<i>Kontingjenti i punës (15-64/m dhe 15-59/f)</i>	59.66%
<i>Kontingjenti i moshuar (mbi 65 vjet)</i>	6.36%


2.3.2.2. Shkalla e urbanizimit

Urbanizimi është proces i rritjes së popullatës urbane, zgjerimit fizik e hapësinor të qyteteve dhe i mënyrës urbane të jetesës. Tregues i matjes së urbanizimit zakonisht merret pjesëmarrja e popullsisë e cila jeton në qytete ndaj popullsisë gjithsej. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë i realizuar në vitin 2011 në Kosovë sipas kriterit administrative jetojnë 38.3% e popullsisë në zonat urbane ndërsa popullsia rurale është 61.7%. Vlerën më të lartë të popullsisë urbane sipas komunave e ka komuna e Prishtinës me 81.3% ndërsa 18.7% është popullsi rurale.

Proceset urbanizuese në drejtim të kryeqytetit njohën ritme të larta brenda një kohe të shkurtër. Nga ana tjetër, proceset urbanizuese janë të dukshme, por jo aq të lehta për t'u fotografuar shpeshherë nga regjistrime zyrtare. Prishtina është një nga asetet që strehon një pjesë të mirë të popullatës që ka migruar nga zona të tjera të Kosovës, por jo detyrimisht, duke zhvendosur edhe zyrtarisht vendbanimin e ri apo duke e reflektuar atë në regjistrat zyrtarë. Vendbanimet urbane sipas Komunës së Prishtinës janë: Prishtina, Matigani, Çagllavica, Zllatari, Sofalia, Kolovica dhe Shkabaj.

2.3.2.3. Struktura arsimore e popullsisë

Sipas të dhënave nga ASK, pjesa më e madhe e popullsisë në komunën e Prishtinës kanë përfunduar shkollimin e mesëm të ulët (23.91%) dhe shkollimin e mesëm të lartë (39.25%). Nëse analizojmë nivelin e arsimit sipas gjinisë, 24.24% e gjinisë femërore kanë të përfunduar shkollimin e mesëm të ulët, e 41.19% e gjinisë mashkullore kanë arritur të përfundojnë shkollimin e mesëm të lartë. Një numër i konsiderueshëm i popullsisë janë të diplomuar apo kanë diploma pasuniversitare. Mirëpo në të njëjtën kohë, 2.24% e popullsisë nuk dinë shkrim dhe lexim.



Grafika 3 Strukturat arsimore të popullsisë (Burimi: ASK)

2.3.2.4. Struktura etnike

Në aspektin etnik, shqiptarët në komunën e Prishtinës përbëjnë shumicën e popullsisë (97.7%), ndërsa etnitë tjera kanë pjesëmarrje shumë të vogël dhe së bashku përbëjnë vetëm 3.3% të popullsisë së përgjithshme, 1.08% Turk, 0.8% Rom, 0.2% Ashkali, 0.2% Serb, 1.02% të tjerë.

2.3.2.5. Lëvizjet mekanike të popullsisë – Migrimet

Të kushtëzuar nga një varg faktorësh, komuna e Prishtinës është njëra ndër komunat e Kosovës me shkallën më të lartë të migrimit. Duke marrë për bazë numrin e të emigruarve në raport me popullsinë rezidente, renditet në mesin e pesë komunave me shkallën më të lartë të emigrimit. Migrimet e brendshme kryesisht kanë të bëjnë me lëvizjet fshat qytet, ku më i theksuar është migrimi drejt zonës urbane të komunës, duke shkaktuar depopullimin e disa vendbanimeve rurale.


Vendet ku më së shumti kanë emigruar qytetarët nga Prishtina janë: Gjermania, Zvicra, dhe Italia.

Sipas të dhënave që janë grumbulluar nga ASK del se ekzistojnë 29,770 banorë të komunës së Prishtinës që jetojnë jashtë Kosovës.

2.3.2.6. Dendësia e popullsisë

Komuna e Prishtinës ka një sipërfaqe prej 523.21 km², me një dendësi prej 418.8 banorë/km². Ajo përbëhet nga 42 vendbanime, prej të cilave 111.88 km² janë pjesë e zonës urbane të komunës.

Agjencia e Statistikave të Kosovës në vjetarin statistikor të vitit 2021 ka bërë një vlerësim edhe të shpërndarjes së popullsisë në territor. Natyrshëm, Prishtina dhe zonat përreth paraqesin territorin me dendësi me përqendrim më të lartë të popullatës, si rezultat i procesit të vazhdueshëm të urbanizimit.



Harta 9 Dendësia e popullsisë

2.3.2.7. Varfëria

Bazuar në të dhënat e Qendrës për Punë Sociale të komunës për numrin e familjeve dhe banorëve me asistencë sociale, në komunën e Prishtinës na paraqitet një shkallë e lartë e varfërisë ekstreme. Në këtë komunë shkalla e varfërisë ekstreme është rreth 3%, ndërsa ajo e varfërisë së përgjithshme duhet të jetë shumëfish më e lartë. Për komunën e Prishtinës, një familje përfituese e skemës sociale jeton me mesatarisht 1.13 cent/ditë.

2.3.3. Projeksionet e popullsisë

Për shkak të dinamikave të kuptueshme që ka kaluar një komunë si Prishtina, burime të ndryshme raportojnë me nuanca të ndryshme fotografinë e situatës demografike në komunë. Ajo që e bën kompleks diskutimin mbi demografinë në Komunën e Prishtinës, është larmia e fenomeneve demografike, me të cilat është përballur e gjithë Kosova, veçanërisht kryeqyteti.

Sidomos pas çlirimit të Kosovës, dinamikat e lëvizjes së popullatës brenda vendit njohën një nivel më të lartë. Proceset urbanizuese në drejtim të kryeqytetit njohën ritme të larta brenda një kohe të shkurtër. Nga ana tjetër, proceset urbanizuese janë të dukshme, por jo aq të lehta për t'u fotografuar shpeshherë nga regjistrime zyrtare. Prishtina është një nga asetet që strehon një pjesë të mirë të popullatës që ka migruar nga zona të tjera të Kosovës, por jo detyrimisht, duke zhvendosur edhe zyrtarisht vendbanimin e ri apo duke e reflektuar atë në regjistrat zyrtarë.

Një tjetër fenomen tipik për Kosovën dhe veçanërisht Prishtinën është udhëtimi ditor/javor drejt vendit të punës (commuting), kjo e bën që Prishtina të bymehet ndjeshëm gjatë ditës. Ky fenomen është relativisht i vështirë për t'u kuantifikuar, sidoqoftë, vetë ASK vlerëson që kryeqyteti Prishtina është destinacioni i mbi 56 000 personave që udhëtojnë çdo ditë. Kjo duhet t'i shtohet numrit të përgjithshëm të popullsisë rezidente kur merret parasysh numri i saktë i njerëzve që e "shfrytëzojnë" kryeqytetin duke e sjellë këtë numër mbi 200 mijë banor në qytet.

Vitet e fundit Kosova është përballur edhe me një valë lëvizjeje jashtë Kosovës (që duhet verifikuar nëse ka rezultuar në emigracion), por vetë Prishtina duket që bilancin me fenomenin ta ketë pozitiv. Mund të arsyetohet që fenomenet e migrimit dhe të emigrimit prekin në mënyrë më të dukshme kryesisht zonat rurale dhe jo aq shumë qendrat e mëdha urbane.

Për shkak të këtyre dinamikave është e natyrshme që të ketë diskutim mbi madhësinë e popullatës që arrin të kapë me shërbimet e veta Komuna e Prishtinës, prandaj një vlerësim realist

mbi popullsinë që është në rrezen e shërbimeve të Komunës së Prishtinës, duhet të bazohet në disa burime informacioni:

1. Sipas Planit strategjik të komunës së Prishtinës (2004), komuna e Prishtinës vlerësohej të ketë 420,000 banorë (350,000 banorë në zonën urbane)
2. Sipas ESI (1999), komuna e Prishtinës vlerësohej të kishte 338,000 banorë (283,000 banorë në zonën urbane)
3. Sipas Bankës Botërore dhe UNMIK (2000), komuna e Prishtinës vlerësohej të kishte 500,000 banorë
4. Sipas regjistrimit të ASK (2011), komuna e Prishtinës kishte 198,000 banorë
5. Sipas KQZ, komuna e Prishtinës ka 190,000 banorë me të drejtë vote, e rrjedhimisht llogaritet që në total komuna ka 270,000 banorë.
6. Sipas Planit Hapësinor të Kosovës 2012-2020+, si kryeqendra e Kosovës, bazuar në analiza joformale dhe informatave të marra nga disa burime, në Prishtinë jetojnë rreth 400-500,000 banorë ose përafërsisht 1/5 e gjithë popullsisë së Kosovës.
7. Sipas PZHK 2012-2020, komuna e Prishtinës vlerësohej të akomodojë 450,000 banorë (prezencë aktive e një pjese të popullatës që jeton, punon, strehohet në Prishtinë, por që zyrtarisht figuron e regjistruar në regjistrin civil të një komune tjetër)

Një nga sferat që hyn në objektin e studimit të demografisë si shkencë shoqërore, janë edhe politikat popullore dhe drejtimet e mundshme të zhvillimit të ardhshëm demografik.

Për shkak të trendit pozitiv të lëvizjeve natyrore dhe veçanërisht lëvizjeve mekanike në Komunën e Prishtinës dhe mungesës së një pasqyre reale mbi numrin e popullsisë në komunë, për arsye të migrimit kombëtar, është i domosdoshëm shfrytëzimi i burimeve të tjera (përveç ASK-së), për të ardhur deri tek vlerësimet apo supozimet e përafërta të numrit të përgjithshëm të popullsisë në Komunën e Prishtinës. Një vlerësim realist mbi popullsinë është në rrezen e shërbimeve të Komunës së Prishtinës që duhet bazuar në disa burime informacioni.

Metodologjia e hartimit të Planit Zhvillimor të Komunës së Prishtinës, ka adaptuar nocionin e popullatës rezidente, e cila është popullsia që zyrtarisht është e regjistruar dhe jeton në një territor të caktuar dhe (ii) popullatës së përgjithshme, e cila është popullsia që akseson shërbimet në një territor të caktuar dhe është aktivisht prezentë në jetën ekonomike dhe sociale, pavarësisht nëse është apo jo e regjistruar zyrtarisht në atë territor, ose është përgjatë gjithë kohës aktive në atë territor.

Në rastin e Prishtinës, duke qenë një komunë dinamike, kuptohet që ka një numër popullsie që zyrtarisht është e regjistruar dhe jeton në Komunën e Prishtinës, por shërbimet e kësaj komune merren edhe nga një pjesë e popullatës që nuk figuron e regjistruar në këtë komunë apo nuk është prezentë në gjithë vitin në këtë komunë. Të tillë janë (i) studentët që popullojnë qytetin për një kohë relativisht të gjatë, edhe pse nuk regjistrohen si banorë të qytetit, (ii) komuniteti ndërkombëtar prezent në Prishtinë (iii) një numër i konsiderueshëm njerëzish që vijnë në Prishtinë për qëllime pune brenda ditës dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre punëtor, ekonomik dhe social në Prishtinë, (iv) diaspora, e cila është ekonomikisht shumë prezentë në Prishtinë, pavarësisht që fizikisht është prezentë më pak se grupet tjera shoqërore.

Për të bërë parashikimin e afërt të popullsisë për komunën e Prishtinës për periudhën 2023-2031, është analizuar dinamika e rritjes së popullsisë bazuar në trendet e fundit 2012-2021 të zhvillimeve demografike: nataliteti, mortaliteti, shtimi natyror dhe bilanci i migrimeve.

Bazuar në të dhënat nga publikimet e vlerësimeve të popullsisë nga viti 2012 deri 2021 është llogaritur shkalla e natalitetit, mortalitetit dhe shtimit natyror në promilë dhe në përqindje. Shkalla e natalitetit në komunën e Prishtinës si mesatare nga të dhënat e vitit 2012 deri 2021 është 16 promil apo 1.6 %. Ndërsa shkalla e mortalitetit është 4.8 promil apo 0.48%. Në bazë të këtyre shkalleve të natalitetit dhe mortalitetit del se shtimi natyror i popullsisë në komunë është 11.2 promilë apo 1.12%.


Nga viti 2012 deri 2021 bilanci i përgjithshëm i migrimeve për komunën e Prishtinës është minus 6670 banorë, ky rezultat ka ndikuar që rritja vjetore e popullsisë në komunën e Prishtinës të jete

0.8% në nivel të komunës. Në bazë të këtyre të dhënave është bërë parashikimi i popullsisë për tetë vjeçarin e ardhshëm të komunës së Prishtinës.

Tabela 3 Projektioni i popullsisë sipas vendbanimeve

Nr rendor	Emri i vendbanimit	Banorë në 2011	Parashikimi për 2031
1	Ballaban	167	192
2	Barilevë	2212	2548
3	Bërnice e Epërme	1595	1837
4	Bërnice e Poshtme	549	632
5	Besi	694	799
6	Busi	814	938
7	Çagllavicë	4233	4876
8	Dabishec	108	124
9	Dragoc	178	205
10	Drenoc	590	680
11	Glllogovicë	74	85
12	Grashticë	433	499
13	Hajkobillë	72	83
14	Hajvali	7391	8514
15	Keçekollë	484	558
16	Koliq	466	537
17	Kolovicë	2545	2932
18	Kukaj	17	20
19	Lebanë	398	458
20	Llukar	1579	1819
21	Makoc	997	1149
22	Marec	432	498
23	Matiçan	13876	15985
24	Mramor	1073	1236
25	Nëntë Jugoviq	2229	2568
26	Nishec	55	63
27	Orlloviq	1035	1192
28	Prapashticë	240	276
29	Prishtinë	145149	172595
30	Prugoc	2168	2498
31	Radashec	29	33
32	Rimanishtë	595	685
33	Sinidol	959	1105
34	Siqevë	337	388
35	Slivovë	257	296
36	Sofali	1767	2036
37	Sharban	317	365
38	Shashkoc	298	343
39	Teneshdoll	359	414
40	Trudë	694	799
41	Vranidoll	1053	1213
42	Zllash	146	168
43	Zllatar	233	268

Nga kjo kuptohet që Komuna e Prishtinës, sipas një skenari të tillë të mos rritej më shumë se me 35 612 banorë rezident nga viti 2011, duke bërë që në 2031 kjo komunë të arrijë jo më shumë se në nivelin e 234,509 banorëve rezident. ASK-ja sipas të dhënave nga Regjistrimi i popullsisë 2011 vlerëson që kryeqyteti Prishtina është destinacioni i mbi **56 000**⁵ personave që udhëtojnë për qëllime pune apo studimi. Kjo duhet t'i shtohet numrit të përgjithshëm të popullsisë rezidente kur merret parasysh numri i saktë i njerëzve që e "Shfrytëzojnë infrastrukturën dhe shërbimet" e Kryeqytetit duke e sjellë këtë numër mbi **228 mijë** banor në vendbanimin Prishtinë dhe me shume se **290 500** banorë në nivel të komunës deri në vitin 2031.



Grafika 4 Parashikimi i popullsisë së komunës së Prishtinës deri në vitin 2031

2.4. Ekonomia

Plani Zhvillimor Komunal është një dokument që paraqet vizionin e Kryeqytetit për 8 vitet e ardhshme. Dokumenti është i përqëndruar kryesisht në paraqitjen e një kornize afatgjate për përmirësimin e kushteve bazë për sukses të ekonomisë së Prishtinës, për të krijuar mundësi për qytetarët e Prishtinës, bizneset, dhe gjeneratat e ardhshme që do të jetojnë në Prishtinë. Dokumenti gjithashtu adreson sfidat që mund të kufizojnë zhvillimin potencial të Kryeqytetit. Ky dokument ndërtohet mbi temat kryesore ekonomike të kësaj dekade dhe merr për bazë sfidat aktuale ekonomike të rajonit dhe më gjerë. Për më tepër, dokumenti jep një pasqyrë të ekonomisë së Kryeqytetit sot, dhe identifikon drejtimit të cilat ekonomia e Prishtinës mund të merr në tetë vitet e ardhshme.

PZHK është ndertuar në një qasje të integruar, me idenë që ekonomia e kryeqytetit është e ndikuar nga shumë faktorë, duke filluar prej kushteve bazike të jetës në qytet, sistemit të edukimit, kopshteve të fëmijëve, institucioneve të qeverisjes qendrore, qasjes në tregje lokale e ndërkombëtare, nivelit të inovacionit dhe produktivitetit të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Ky dokument paraqet vizionin e Kryeqytetit për ekonominë e saj dhe strategjitë që duhet ndjekur për të arritur këtë vizion. Është një kornizë që i jep drejtim iniciativave për zhvillim ekonomik të qytetit, dhe artikulon rolin e kryeqytetit, prioritetet dhe qasjen ndaj këtyre iniciativave.

Me këtë Plan Zhvillimor Komunal (PZHK) janë planifikuar hapësirat, infrastruktura dhe institucionet komunale që do kontribuojnë në aftësimin e resurseve humane, zhvillimin e ekonomive familjare, që do të reflektojnë në uljen e papunësisë, duke zhvilluar zona dhe sektorë, duke ngritur kapacitete dhe mundësi tjera, ashtu që shumica e qytetarëve të Prishtinës ta gjejnë veten në tregun e punës.

Prishtina do të veprojë si qytet promovues i aktiviteteve ekonomike, të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si instrument kyc i zhvillimit për të ardhmen e vendit. Duke pasur parasysh të gjithë faktorët relevant në nivelin lokal si, burimet natyrore dhe njerëzore, menaxhimin e bizneseve, interesimin nga komuniteti ndërkombëtar, përmirësimin e sistemit kreditor dhe politikave fiskale,

⁵ Publikimi NJERËZ NË LEVIZJE: analizë e mobilitetit ndërkombëtar, kombëtar dhe lokal të qytetarëve të Kosovës, fq.23.

kryeqyteti e sheh sektorin privat si një nga bartësit kryesorë për rritjen dhe zhvillimin ekonomik në të ardhmen. Ky sektor sigurisht që do të ndihmojë në ngritjen e të hyrave në buxhetin komunal. Plani është në funksion të krijimit të një klime miqësore për biznesin, diversifikimit të sektorëve ekonomik, dhe sigurimit e zhvillimit të hapësirave, përbajtjeve e infrastrukturës në komplet territorin e Komunës së Prishtinës.

Për të implementuar vizionin e zhvillimit ekonomik, Prishtina do të ndërmer veprimet e mëposhtme të cilat përfshijnë:

- Ofrimi i shërbimeve për bizneset në sektorë të ndryshëm të ekonomisë;
- Investime direkte në infrastrukturë, asete, shërbime, ngjarje dhe aktivitete të cilat e përmirësojnë funksionimin e qytetit;
- Planifikim efektiv për t'u siguruar që Prishtina bëhet një ndër qendrat e preferuara në rajon për biznes, shkollim, kulturë e sport;
- Marketing dhe promovim për të inkurajuar investimet, turizmin dhe vizitat tjera, dhe mundësitë biznesore;
- Eliminimi i barrierave administrative për ta bërë më të lehtë investimin në Prishtinë;
- Mbeshtetja e të tjerëve përmes granteve dhe ndihmave tjera, të dizajnuara për të nxitur më shumë aktivitete në biznes, por edhe sfera tjera të jetës;
- Inkurajimi i partneriteteve dhe bashkepunimit në mes entiteteve qeveritare, në mes bizneseve dhe qytetit, por edhe në mes sektorit jo-qeveritar, për të arritur qëllimet e përbashkëta.

Ekonomia e Prishtinës, sot!

Prishtina si kryeqytet i Kosovës është shtëpi e bizneseve më të mëdha të vendit, është shtëpi e shumë industrive, duke filluar nga industria e teknologjisë informative, hotelieria, turizmi, tregtia, ndërtimi, industria ushqimore e deri tek bujqësia. Prishtina është gjithashtu shtëpi e institucioneve publike, universiteteve e shumë institucioneve arsimore, organizatave ndërkombëtare dhe organizatave jo-qeveritare. Prishtina është qendra më e madhe ekonomike, administrative, edukative dhe kulturore në Kosovë. Andaj, zhvillimi ekonomik i saj është i rëndësishëm, jo vetëm për Prishtinën, por edhe për vendin e regjionin.

Administrata e kryeqytetit e ka në përgjegjësi të saj planifikimin strategjik afat-gjatë, në emër të qytetarëve të Prishtinës, por edhe qindra mijëra punëtorëve, vizitorëve dhe bizneseve që operojnë cdo ditë në kryeqytet. Shumë aspekte të ekonomisë lokale të Prishtinës varen nga puna e Qeverisë Qendrore, për shembull, korniza legjislative dhe resurset financiare me të cilat operon kryeqyteti, por, kryeqyteti mund të jep kontribut direkt dhe shumë të rëndësishëm për të promovuar mjedis dinamik biznesor dhe për të facilituar zhvillimin ekonomik.

Prishtina qytet konkurrues në rajon

Prishtina do të bëhet më konkurruese në relacion me kryeqytetet e rajonit. Si qytet me pozicion strategjik, Prishtina do të forcojë lidhjet e saj me tregjet ndërkombëtare, duke e rritur ndërrim me ekonominë rajonale, por edhe ato botërore. Fuqia e këtyre lidhjeve do të tregohet përmes rritjes së prezencës së korporatave multi-nacionale dhe rritjes së bizneseve ndërkombëtare.

Ekonomia e Prishtinës do të ndërtohet mbi disa prej sektorëve të fuqishëm që ka aktualisht, sic është industria financiare, ajo e teknologjisë informative, industria e logjistikës, tregtia me shumicë, ndërtimi, universitetet dhe edukimi, mediat dhe industritë tjera me vlerë të shtuar. Prishtina konkurruese në nivel rajoni, do të jetë qytet me diversitet, me komunitet i cili pasurohet nga studentët të cilët vijnë nga vende të ndryshme të rajonit, por edhe nga punëtorë të shumtë të qyteteve të rajonit. Duhet të theksojmë se Prishtina është qytet në të cilin veprojnë edhe shumë organizata ndërkombëtare, të cilat e rrisin nivelin e njohurive në vend. Për të konkurruar në rajon dhe më gjerë, Prishtina duhet të jetë qytet i jetueshëm, qytet ku studentët kanë dëshirë të studiojnë, qytet ku profesionistët zgjedhin për të punuar, dhe qytet ku vizitorët vijnë për festivale e për turizëm kulturor e sportiv.

Vizioni i kryeqytetit është që të ketë një ekonomi të qëndrueshme, ku arrihen norma të qëndrueshme të rritjes ekonomike, dhe ku sektorët kryesor ekonomik kanë rritje të vazhdueshme.

Nje ekonomi e cila prodhon vende pune dhe mundësi për qytetarët e saj, por edhe për të tjerët që dëshirojnë të jetojnë në Prishtinë. Një ekonomi në të cilën bizneset shohin mundësi zhvillimi.

Kryeqyteti duhet të ndihmojë bizneset që ato të rrisin produktivitetin dhe të hapen mundësi të reja për të gjithë. Zhvillimi i bizneseve dhe mirëqenia e qytetarëve të Prishtinës janë të pandashme me njëra-tjetrën. Shumë nga sfidat me të cilat përballen qytetarët e Prishtinës, janë edhe sfida të biznesit. Ne të gjithë ndajmë sfidat e njejta, si komunikacioni i ngarkuar, mungesa e parkingjeve, mungesa e hapësirave për biznese, mungesa e aftësive tek të rinjtë që kërkojnë punë, kaosi urbanistik, menaxhimi i mbeturinave e shumë probleme tjera. Largimi i barrierave për zhvillim të biznesit dhe rritja e produktivitetit në Prishtinë, janë vizioni për të ardhmen. Bizneset e vogla dhe ndërmarrjet e sapo krijuara (start-up) janë motorri i ekonomisë së kryeqytetit, andaj kryeqyteti duhet t'i mbështes në çdo formë, edhe me financa, për t'u rritur dhe për të krijuar vende të reja të punës për të rinjtë tanë.

Siç e kemi theksuar disa herë deri tash, ekonomia e Prishtinës është ekonomia më e madhe në vend dhe ekonomia me sektorët me vlerën më të lartë të shtuar. Është ekonomia me lidhjet më të fuqishme ekonomike në rajon, por edhe më gjerë. Është ekonomia me rrjetin më të mirë infrastrukturor, me resurset kryesore humane, dhe me nderlidhjet më të mira kulturore e sportive. Prishtina posedon përparësitë e rëndësishme ekonomike, duke përfshirë një mjedis të pjekur tashmë të tregtisë, të financave, të logjistikës dhe të teknologjisë informative. Prishtina ka resurset humane më të sofistikuar në vend, por edhe të rajonit.

Ekonomia e kryeqytetit është shumë e orientuar drejtë shërbimeve. Prishtina është shtëpi e sektorit financiar, ku të gjitha bankat e mëdha kanë zyrat e tyre kryesore. Komuniteti i teknologjisë informative dhe shumë ndërmarrje të mëdha ndërkombëtare të këtij sektori janë gjithashtu të vendosura në Prishtinë. Sektori i telekomunikimeve është gjithashtu i vendosur në kryeqytet. Shërbimet profesionale si konsulencat biznesore, kontabiliteti, konsulencat ligjore, dhe shërbimet teknike e inxhinierike. Në dekadën e fundit, Prishtina është shëndrruar gjithashtu në qytet të studimeve, ku janë vendosura dhjetëra universitete publike e private, me numër të madh të studentëve, të cilët vijnë nga qytetet tjera të vendit, por edhe nga rajoni.

Prishtina është edhe qytet i madh turistik, sidomos gjatë stinës së verës. Është qytet mikpritës për shumë familje që vijnë nga Diaspora jonë, por edhe për shumë turistë që vizitojnë Prishtinën për festivalet që organizohen gjatë verës e për aktivitetet sportive. Në një ditë të zakonshme, rreth 400.000 qytetarë frekuentojnë kryeqytetin, për të punuar, për të bërë biznes, për t'u shkolluar, për të bërë shopping, për të ndjekur ndeshje sportive, për të ndjekur shfaqje të ndryshme, apo për të qenë pjesë e argëtimit në qytet. Sipas studimit të fundit të Bankës Botërore⁶, mbi 130.000 makina në ditë hyjnë në qytetin e Prishtinës.

Në Prishtinë në dekadën e fundit janë krijuar disa grupe të mëdha të industrive, të cilat funksionojnë në periferi apo në hyrjet e saj. Këto grupe të industrive dallojnë për nga madhësia dhe mund të shtrihen në një rrugë të vetme, apo edhe të jenë të vendosura në zona më të mëdha.

Janë pesë industri të rëndësishme dhe strategjike të vendosura në kryeqytet:

Shërbimet financiare dhe të konsulencës, i cili grup është i vendosur kryesisht në qendër të qytetit të Prishtinës;

Industria e teknologjisë informative, e cila është gjithashtu e shtrirë në qendër të qytetit, por në raste të caktuara edhe në periferi;

Tregtia me shumicë dhe pakicë, e cila është e shtrirë në masë të madhe në periferi të Prishtinës, në rrugën që lidhë Prishtinën me Fushë-Kosovën dhe në rrugën që lidhë Prishtinën me Lipjanin;

Industria e ndërtimit, e cila ka pasur një zhvillim të jashtëzakonshëm në dy dekadat e fundit; dhe

⁶ Banka Botërore (2022)

Sipas të dhënave të regjistrimit të fundit të popullsisë (2011) Komuna e Prishtinës ka të regjistruar rreth 200.000 banorë. Në territorin e Komunës së Prishtinës janë mbi 40.000 ekonomi familjare dhe rreth 60.000 njësi të banimit. Në pjesën rurale të Prishtinës jetojnë mbi 55.000 banorë, 9.700 ekonomi familjare dhe 15.300 njësi të banimit. Ndërsa, në zonat më periferike të pjesës urbane (Matiçan, Hajvali, Çagllavicë, Kolovicë, Sofali, Zllatar etj.) jetojnë rreth 30.000 banorë dhe 6.000 ekonomi familjare.

Gjithsej të punësuar, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë më 2011, në Komunën e Prishtinës kanë qenë rreth 55.000 persona. Sipas Zyrës për Punësim në Prishtinë, numrin e përgjithshëm të papunëve më së shumti e përbëjnë qytetarët e Prishtinës, me 26.000 të papunësuar, prej të cilëve 9.000 janë femra, gjegjësisht 35.5%, ndërsa sa i përket kualifikimit të punëkërkuësve, punëkërkuës të pakualifikuar janë 17.222, prej tyre femra 5.219 ose 66%.

2.4.1. Tregu i punës

Gjeografikisht, regjioni i Prishtinës, llogaritet për 58% të krijimit të vendeve neto të punës, në raport me regionet tjera, ku kishin krijim një shifror të vendeve të punës. Tregu i punës, karakterizohet me norma të larta të mosaktivitetit dhe papunësisë. Shumë njerëz mbesin të papunë, edhe pse vendet e hapura të punës nuk plotësohen, për shkak të mospërputhjes së shkathtësive. Kjo mund të jetë për disa arsye, përfshirë këtu krijimin e numrit të vogël të vendeve të reja të punës, arsyet e lidhura me familjen apo arsyet tjera për mosaktivitet, ose puna në sektorin joformal e që shpesh është vështirë të matet. Një faktor tjetër kontribues është edhe mospërputhja mes llojeve të arsimit dhe shkathtësive, të cilat duhet t'i ofrojnë punëkërkuësit, dhe arsimin-shkathtësitë, të cilat i kërkojnë punëdhënësit në cilëndo kohë.⁷

Numri i ndërmarrjeve në Komunën e Prishtinës është rreth 50.000, pjesa më e madhe u takon ndërmarrjeve tregtare me pakicë dhe shumicë, hoteleria dhe akomodimi mbi 5.000, kurse ndërtimtaria mbi 3.000. Tregtia mbizotëron si një formë më e zakonit e bizneseve në Kosovë, Prishtina po ashtu ka një numër të theksuar të bizneseve prodhuese, biznese ndërtimi dhe një sërë biznesesh të natyrës shërbyese.

Tabela 4 Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas kategorive (Burimi, ASK)

Përshkrimi i aktiviteteve	Numri	%
<i>C - Industria përpunuese, prodhimtaria</i>	3276	7.58
<i>D - Furnizimi me rrymë gaz, avull dhe klimatizim</i>	170	0.39
<i>E - Ujësjellësi, kanalizimi, menaxhimi i mbeturinave dhe aktivitetet e riparimit</i>	165	0.38
<i>F - Ndërtimtaria</i>	2832	6.56
<i>G - Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve motorike dhe</i>	15082	34.92
<i>H - Transporti dhe magazinimi</i>	2978	6.89
<i>I - Hoteleria dhe akomodimi</i>	4372	10.12
<i>J - Informimi dhe komunikimi</i>	2775	6.42
<i>K - Aktivitetet financiare dhe të sigurimit</i>	426	0.99
<i>L - Aktivitetet e patundshmërisë</i>	657	1.52
<i>M - Aktivitetet profesionale shkencore dhe teknike</i>	4297	9.95
<i>N - Aktivitetet shërbyese dhe të përkrahjes</i>	1567	3.63
<i>O - Administrimi publik dhe i mbrojtjes, sigurimi i detyruar social</i>	185	0.43
<i>P - Arsimi</i>	584	1.35
<i>Q - Aktivitetet e shëndetit njerëzor dhe të punës sociale</i>	885	2.05
<i>R - Artet, argëtimi dhe rekreacioni</i>	761	1.76

⁷ Seria e raporteve për vendet e punës, Publikimi nr.5, Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Banka Botërore. Prishtinë, 2017

<i>S - Aktivitetet tjera shërbyese</i>	2178	5.04
<i>T - Aktivitetet e ekonomive shtëpiake si punëdhënës</i>	2	0.00
<i>U - Aktivitetet e organizatave dhe organeve të huaja</i>	3	0.01
Totali	43195	100.00

2.4.2. Sektorët kryesor ekonomik

2.4.2.1. Ndërtimtaria

Sektori i ndërtimtarisë në Kosovë përfshinë një gamë të gjerë të aktiviteteve ekonomike, nga nxjerrja e lëndës së parë, prodhimit të produkteve të ndërtimtarisë, deri tek dizajnimi, ndërtimi, menaxhimi dhe kontrolli i punëve ndërtimore, mirëmbajtja e tyre, rinovimi, demolimi sikurse edhe riciklimi i mbetjeve inerte të ndërtimit. Ndërtimtaria është një ndër sektorët më të zhvilluar ekonomik në Prishtinë, që nga pas lufta. Sipas Open Business (industria e ndërtimtarisë u rendit si industria e dytë sipas madhësisë, duke i përfshirë dy nga firmat më të mëdha në Kosovë. Në Komunën e Prishtinës janë të regjistruara 2,832 ndërmarrje që merren me ndërtimtari, vetëm në vitin 2018 janë regjistruar 197 biznese të reja që ushtrojnë këtë veprimtari. Lagjet, në të cilat më së shumti u zhvillua ndërtimi i banimit të lartë, në 20 vitet e fundit janë: Dodona, Lakrishte, Arbëria, Mati, Lagjja e Spitalit, Kalabria, Lagjja e Muhaxherëve dhe Tophane. Ndërsa, lagjet në të cilat u zhvillua banimi i ulët-shtëpi të veçanta janë: Qëndresa, Arbëria, Hajvalija, Sofalia, Matiçani dhe së fundmi Zllatari.

2.4.2.2. Tregtia


Tregtia është një sektor tjetër ekonomik që ka pasur një zhvillim të hovshëm gjatë dekadës së fundit. Rrjeti i objekteve tregtare është i përhapur mjaft mirë në të gjitha vendbanimet. Sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë punëson numrin më të madh të punëtorëve. Konkurrenca në tregti ka bërë të dukshëm përmirësimin e shërbimeve tregtare, me furnizim të mirë dhe të shumëllojshëm me mallra të konsumit të gjerë (artikuj ushqimorë, veshmbathje, pajisje shtëpiake etj.). Gjithashtu, shumë ndërmarrje tregtojnë artikuj industrialë, si: materiale ndërtimore, karburante, materiale elektrik dhe teknikë të bardhë. Ndërmarrjet tregtare me shumicë dhe pakicë në Komunën e Prishtinës janë në një numër prej mbi 15,000, të cilat kanë një mbulueshmëri në tërë territorin e komunës.

Bujqësia

Aktualisht në fshatrat e Komunës së Prishtinës, bujqësia është sektori më i rëndësishëm i ekonomisë, megjithatë, prodhimi bujqësor në këtë rajon është i ulët në raport me kushtet agroekologjike që posedon, potencialet prodhuese dhe produktivitetit përkatës që haset në vendet e zhvilluara. Fshatrat e Komunës së Prishtinës, në raport me vendet tjera me produktivitet të lartë të punës në prodhimtarinë bimë primare, realizojnë rendimente të ulëta të prodhimit. Faktorët që ndikojnë në realizimin e rendimenteve të ulëta janë të shumtë, nga të cilët për këtë rajon mund t'i veçojmë: niveli i zbatimit të ulët në teknologjinë e prodhimtarisë, përdorimin e farërave dhe inputeve tjera jocalësore, mungesa e lagështisë gjatë periudhës së vegjetacionit, sidomos për misër, jonxhë dhe bimë industriale (rregullariteti jo i drejtë i reshjeve gjatë vitit dhe deficit i tyre gjatë periudhës vegjetative).


Bujqësia është një ndër degët bazë të ekonomisë dhe si e tillë luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e një regjioni apo komune. Rreth 30% e territorit të komunës është tokë bujqësore, që d.m.th. gati gjysma e territorit komunal është tokë buke. Në bazë të të dhënave, mbi 7900ha janë sipërfaqe bujqësore, duke llogaritur tokat bujqësore, livadhet dhe vendbanimet që shfrytëzojnë kopshtet në parcelat e tyre kadastrale. Prodhimtaria bimë në rajonin e fshatrave të Prishtinës është e strukturuar ngjashëm me atë në nivel vendi. Dominim absolut kanë drithërat. Llogaritet, se me drithëra dhe bimë industriale në Komunën e Prishtinës, çdo vit mbillen rreth mbi 1.700ha. Aktualisht, ekzistojnë tendenca për kalim nga sistemi i ekonomive të vogla në ato të mesme (ferma komerciale). Ekonomitë e vogla, fermerët do të vazhdojnë të ekzistojnë, kryesisht nëpër fshatra të larta. Numri i ekonomive të vogla me fermerë nuk do të rritet. Fermat komerciale (25-50 lopë qumështore, 30-60

ha) do të zhvillohen në ultësirat më pjellore. Zhvillimi i kësaj situatë do të nxitet nga zhvillimi i industrisë së qumështit dhe mishit, si dhe industrisë së përpunimit të ushqimit të kafshëve.



Harta 10 Boniteti i tokës (Burimi: EULUP)

2.4.2.3. Pasuritë nëntokësore dhe sipërfaqësore



Harta 11 Pasuritë nëntokësore

Sipas të dhënave territori i Komunës së Prishtinës ka një shumëllojshmëri të përmbajtjeve të resurseve nëntokësore dhe sipërfaqësore. Mineralet, të cilat gjenden në sasi më të mëdha në Komunën e Prishtinës janë Pb, Zn, Ag, Au, të cilat mbulojnë një sipërfaqe prej mbi 3600ha apo 47% të sipërfaqeve me elemente minerare në komunë, po ashtu si resurs tjetër mineral në sasi më të

lartë gjendet magnezi me një mbulueshmëri prej 1075ha apo 14% të elementeve minerare në Komunën e Prishtinës.

2.4.2.4. Zonat ekonomike

Komuna e Prishtinës nuk ka zonë ekonomike të veçantë sipas Ligjit për Zonat Ekonomike. Nyjet kryesore ekonomike në Komunën e Prishtinës shtrihen në aksin rrugor Prishtinë-Fushë Kosovë dhe Prishtinë-Ferizaj. Me Planin Zhvillimor Komunal dhe me Planin Zhvillimor Urban 2013-2022, janë definuar lokacionet për veprimtari ekonomike, nyjet strategjike për zhvillim (aksi Prishtinë-Aeroport), Zona Industriale ekzistuese prej 60ha dhe Zona Ekonomike prej 600ha.

Zona Ekonomike. Në kuadër të territorit të komunës është planifikuar Zona Ekonomike, me pozitë në pjesën veriperëndimore të qytetit të Prishtinës me sipërfaqe $S=612.00ha$. Kjo pjesë ka një pjerrtësi relativisht të lartë që e bën jo të përshtatshme për funksione industriale. Sipas Planit Rregullues Urban, Zona Ekonomike, tërë pjesa trajtohet si zonë ekonomike, industriale dhe mikse (veprimtari ekonomike dhe banim). Momentalisht kjo zonë në pjesën më të madhe është e mbuluar me banim, por në pjesë të caktuara janë të zhvilluara një numër i madh i bizneseve, fatkeqësisht pa infrastrukturë përcjellëse adekuate për zhvillim ekonomik.

Në këtë zonë planifikohet të investohet në infrastrukturën bazë, në mënyrë që kjo pjesë e qytetit të jetë atraktive për biznese vendore por edhe të huaja. Ndërtimi i unazës së qytetit, në këtë pjesë, do t'i jep qasje kësaj zone në rrugë dhe do ta bëjë atraktive për zhvillimin e industrisë dhe biznesit.

Zona ekonomike-biznesore (aksi Prishtinë-Ferizaj). Kjo zonë ekonomike-biznesore, shtrihet jo vetëm në kuadër të territorit komunal të Komunës së Prishtinës, por vazhdon edhe në territor të Komunës së Graçanicës, përgjatë aksit Prishtinë-Ferizaj.

2.4.2.5. Industria Prodhuese dhe Përpunuese

Si rezultat i tranzicionit ekonomik të dy dekadave të fundit, edhe Prishtina është përballur me fenomenin e deindustrializimit. Si rezultat i vonës së privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, shumica e tyre pësuan humbje të tregjeve dhe zvogëlim të punësimit ose bankrotim total. Mungesa e tokës, e cila do të ishte e përshtatshme për të zhvilluar industri prodhuese-përpunuese, është sfidë e vazhdueshme për investitorët e brendshëm dhe të jashtëm. Duhet shikuar më hollësisht mundësitë për dhënie me koncesion të tokave të përshtatshme për veprimtari ekonomike. Kjo duhet bërë për të nxitur zhvillimin e veprimtarive të industrisë prodhuese-përpunuese dhe Prishtina të marrë primatin lider i regjionit për zhvillim industrial.

Gjithashtu, në kuadër të shfrytëzimit të planifikuar të tokës, të bëhet identifikimi i hapësirave të përshtatshme industriale në Komunën e Prishtinës. Në kuadër të planifikimit të investimeve komunale, prioritet t'u jepet investimeve në hapësira industriale ekzistuese dhe krijimit të hapësirave të reja industriale.

2.4.2.6. Shërbime të ndryshme profesionale

Përveç tregtisë në Prishtinë, shërbimet e ndryshme profesionale janë gjithashtu të zhvilluara. Aktivitetet ekonomike shërbyese që përbëjnë edhe përparësinë konkurruese të Prishtinës, janë kryesisht të koncentruara në hapësirën urbane të qendrës dhe në zonat urbane të lagjeve: Dardania, Ulpiana, Kodra e Diellit, Lakërishta, Qendra dhe Aktashi. Në zonën e Qendrës, dominojnë institucionet administrative të pushtetit qendror dhe lokal, hotelet, restorantet, bankat, objektet kulturore, lokalet tregtare me pakicë dhe selitë e zyrave të bizneseve të ndryshme. Organizimi hapësinor i qendrës, ruan vlerat dhe standardet urbane të realizuara kryesisht në periudhën e para vitit 2000, ndërsa pas vitit 2000 kemi fenomenin e shëndërrimit të hapësirave banesore në përdhese

dhe të kateve të para të banesave kolektive, në lokale afariste për qëllime komerciale. Në zonat e tjera të urbanizuara në kuadër të veprimtarive terciare, ushtrohet aktivitet i llojllojshëm i shërbimeve, duke dominuar tregtia me pakicë dhe restorantet. Në vitet e fundit, Komuna e Prishtinës ka luajtur një rol kyç në ofrimin e mundësive për zhvillimin panairëve në qendër të qytetit, duke përkrahur kështu promovimin e bizneseve të vogla, artizanateve dhe ekonomive familjare. Në të ardhmen, nevojitet rritja e kapaciteteve të zonave të biznesit në Komunën e Prishtinës-tregjet me shumicë e pakicë, tregu i automjeteve, tregu i bagëtisë dhe produkteve të bagëtisë, tregje sipas nevojës dhe kërkesës.

Planifikimi i ardhshëm duhet të orientohet drejt identifikimit të hapësirave të pashfrytëzuara dhe dhënia e tyre në shfrytëzim si stimulim për tërheqje të bizneseve të huaja dhe vendore.

2.4.2.7. Turizmi, akomodimi dhe shërbimi i ushqimit

Turizmi – Turizmi është një sektor mjaft i rëndësishëm për zhvillim ekonomik. Ndikimi direkt i turizmit sjell shtim të të hyrave, zhvillim të veprimtarive ekonomike që përbëjnë ekonominë turistike, përfshirë: hotelerinë-akomodimin, transportin, tregtinë, institucionet kulturore, rritjen e punësimit, standardit jetësor, investimet, dhe zhvillimin e viseve të pazhvilluara. Në anën tjetër, turizmi ka ndikim indirekt në ato ekonomi, të cilat furnizojnë ekonominë turistike, duke përfshirë: bujqësinë, ndërtimtarinë, industrinë artizanale. Rajoni i Prishtinës është destinacioni kryesor i turizmit në Kosovë në forma të ndryshme: turizmin malor, kulturor (festat artistike, panairët, koncertet, festivalet, muzetë), turizmi familjar, turizmi dental, turizmin rinor dhe ekoturizmin.

Vlerësohet se Prishtina është dominante si destinacion turistik në Kosovë, por njëkohësisht tregon se ka shumë hapësirë për avancim të sektorit, konkretisht për të rritur numrin e vizitorëve, përjetimin e tyre dhe si rezultat qëndrimin e tyre së bashku me shpenzimet. Gjithashtu, duke u bazuar në numrin e rezervimeve që bëhen online në raport me format tjera, transformimi digjital do të ofrojë mundësi të rritjes së numrit të vizitorëve dhe konsumatorët ta kenë më të lehtë t'i ndajnë përshtypjet e tyre përmes vlerësimeve online. Gjithashtu, nevojitet përmirësimi i rrjedhës së informacionit përmes qëndrave informuese, shenjëzimit, katalogjeve dhe mjeteve tjera digjitale.

Qendra Historike e Prishtinës përbën një nga zonat identitare të qytetit, ku janë të koncentruara objektet kryesore të trashëgimisë kulturore. Që të promovohet kjo zonë dhe të ofrohet qasje në të, planifikohet të projektohet një rrugë, që do t'i përshkojë të gjitha monumentet arkitektonike-kulturore. Me këtë projekt, parashihet gjithashtu të intervenohet edhe në elemente arkitektonike të zonës, rehabilitim të disa shtëpive banuese, si dhe në aspekte tjera infrastrukturore (ndriçim publik, shenjëzim etj.).

Pazari i Vjetër i Prishtinës përfaqëson një nga zonat më të vjetra të qytetit, ndonëse ka ndryshuar me kohë duke e humbur origjinalitetin, ende funksionon si treg për shitje të perimeve, frutave dhe produkteve të bulmetit. Ky pazar do të ridimensionohet në një model të ri investimi dhe në hapësirë komunitare. Përveç tregtimit të prodhimeve bujqësore, do të ofrojë produkte artizanale, kafe dhe bare tradicionale përreth dhe hapësirë për zhvillimin e aktiviteteve artistike kulturore, siç janë festat, panairët dhe të ngjashme.

Sa i përket Gërmisë, mbrojtja e kësaj hapësire duhet shtuar, prioritet duhet të jetë shpyllëzimi, apo rrallimi i pyjeve ku është e nevojshme, dhe ripyllëzimi i hapësirave të shpyllëzuara pa kontroll. Qasja e qytetarëve në drejtim të Gërmisë duhet të jetë më direkte dhe e lehtësuar, t'i shtohen dhe funksione tjera rekreative, që janë ekomiqësore dhe multifunksionale. Mbrojtja e festivaleve kohën e fundit, në Gërmi, ka rrezikuar florën dhe faunën, vendimet e ardhme për festivale të tilla të bëhen me kujdes dhe të merren masa përkatëse për mbrojtje. Shtigjet ekzistuese të këtij parku nuk janë të parapara për kategori të ndryshme të turistëve. Këto shtigje do të zhvillohen dhe do të përshtaten për të gjitha grupet e turistëve, sipas interesave të tyre rekreacionale (p.sh. për ecje, vrapim, biçikleta etj.).

Strehimorja e Arinjve (Sanctuary Bear Prishtina) gjendet në afërsi të qytetit të Prishtinës, është një park kombëtar-vend kujdesi për arinjtë e shpëtuar nga robëria më parë në Kosovë.⁸ Janë evidentuar një numër solid i vizitorëve në strehimore, por gjithsesi vlerësohet nevoja e organizimit të një transporti specifik, i cili do t'i lehtësonte vizitat e turistëve pa automobil.

Kultura e kafes (makiatos) është karakteristike për Prishtinën. Në gjithë qytetin operojnë rreth 1000 bare dhe restorante. Ato janë të koncentruara kryesisht në qendër të qytetit. Për më shumë, në Prishtinë janë katër qendra të mëdha të shoppingut: dy janë brenda qytetit, ndërsa dy të tjera në magjistralen për Ferizaj. Këto qendra nxisin ardhjen e vizitorëve njëditor nga vendet tjera të Kosovës.

Turizmi rural: Bujqësia dhe turizmi janë ndër industritë që po zgjerohen me ritme më të shpejta në shumë vende në rajon, por kohëve të fundit edhe në Kosovë. Potenciali i agroturizmit për të krijuar marrëdhënie sinergjike midis këtyre dy sektorëve të rëndësishëm është pranuar gjerësisht nga planifikuesit dhe politikbërësit. Agroturizmi është një lloj hibridizimi i sistemit bujqësor që bashkon elementet e bujqësisë dhe të turizmit, për të krijuar ofertë për produktet dhe shërbimet bujqësore, gjithashtu edhe për të ofruar eksperiencë për turistët. Agroturizmi në Prishtinë është një sektor me potencial të madh. Vendndodhja gjeografike e qytetit, peizazhet e jashtëzakonshme, tradita e kahershme e mikpritjes, kuzhina e pasur me shumë teknika tradicionale gatimi dhe produktet tradicionale e bëjnë Prishtinën vend me potencial për zhvillim të agroturizmit. Ky sektor momentalisht nuk gjen zhvillim të duhur edhe përkundër potencialeve hapësinore dhe pejzazhore, të cilat Komuna e Prishtinës i posedon. Kohëve të fundit ky sektor ka filluar të shtrijë fillet e para të zhvillimit në disa zona të caktuara nga biznesmenë individualë. Ky sektor, në të ardhmen duhet të shihet si prioritet i komunës, në aspektin e zhvillimit dhe orientimit të zhvillimit, duke përcaktuar hapësira dhe hartuar strategji në aspektin e gërshetimit të sektorit të bujqësisë dhe turizmit rural.

Agroturizmi konsiderohet, jo vetëm një sektor që mund të ndihmojë promovimin turistik dhe zhvillimin ekonomik, por edhe si një sektor që do të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit dhe në ruajtjen dhe promovimin e identitetit kulturor dhe lokal.

2.4.2.8. Aktivitetet tjera

Në Prishtinë, si kryeqytet, janë të koncentruara mediat kryesore publike dhe private, pastaj OJQ-të, organizata dhe institucione ndërkombëtare, andaj monitorimi medial nga shoqëria civile në zbatimin e ligjit dhe realizimin e premtimeve të qeverisjes komunale, është më i rregullt dhe më aktiv, në krahasim me komunat tjera të Republikës së Kosovës. Kjo, për qeverisjen komunale dhe për qytetarët, përbën një përparësi, pasi që prania e tyre në territorin e komunës nënkupton një qasje më kritike ndaj qeverisjes komunale. Prishtina paraqet potencialin më të madh për punësim dhe aktivitet ekonomik, kryesisht për shkak të përqendrimit të popullatës dhe të aktiviteteve administrative e ekonomike që paraqet në këto raste kryeqyteti.

Pavarësisht normave pozitive të rritjes ekonomike në dekadën e fundit, mundësitë e komunës për të ndikuar në rritjen ekonomike janë të limituara. Një ndër problemet kryesore për shfrytëzimin e potencialit ekonomik, ndërlidhet me menaxhimin e pronës komunale dhe mungesës së pronës komunale. Realizimi i projekteve strategjike të komunave, duhet të bëhet përmes thjeshtimit të procedurave për përdorim të pronës komunale, në raport me investitorët potencial, andaj për këtë nevojitet të rritet prona komunale.

Komuna duhet të planifikojë fondin e tokave për dhënie në shfrytëzim dhe të ofrojë kushte dhe infrastrukturë përcjellëse në pronat komunale, për të mundësuar realizimin projekteve strategjike në nivel lokal.

⁸ Komuna e Prishtinës (2018) Narrativa e Prishtinës

2.4.3. Mundësitë dhe sfidat e ekonomisë së Kryeqytetit

Produktiviteti i ekonomive të qyteteve ndikohet nga shumë faktorë, duke filluar nga efienca e infrastrukturës, lidhja në mes bizneseve, resurset humane dhe aftësitë e tyre, llojet e shërbimeve, jetueshmëria e qytetit dhe mirëqenia e popullsisë në përgjithësi. Shumë me rëndësi është edhe niveli i inovacionit në qytet.

Në mënyrë që kryeqyteti të bëhet më konkurrues në rajon por edhe në Evropë, nevojitet të kemi baza të fuqishme në ekonomi, duke përfshirë:

- Resurse humane me njohuri moderne dhe me aftësi për tregun e punës;
- Bazë financiare dhe infrastrukturë për të konvertuar idetë në inovacion;
- Infrastrukturë të qëndrueshme për ujë, mbeturina, dhe energji;
- Lidhje fizike e qëndrueshme përmes transportit rrugor, rrjeteve të rrugëve për këmbësorë, dhe lidhje me ekonominë tjera rajonale;
- Rrjete të fuqishme të telekomunikimeve dhe internetit; dhe
- Lidhje të mira me tregjet ndërkombëtare.

Produktiviteti i firmave: vetëm një sektor privat dinamik mund të zhvillojë qytetin dhe të arrihet një standard më i lartë i jetës. Krijimi i vendeve të reja të punës dhe rritja ekonomike do të varen nga aftësia e administratës së kryeqytetit për të krijuar një mjedis të favorshëm ku firmat produktive lulëzojnë. Dinamizmi i sektorit privat në Prishtinë, në vitet e fundit, ka qenë premtues, por nuk mjafton për të krijuar një sektor privat vibrant, i cili do ta zhvendoste qytetin në një rritje më të qëndrueshme, më gjithëpërfshirëse, dhe më të qëndrueshme.

Trendet demografike që influencojnë ekonominë e qytetit – në dekadën e fundit ka pasur një dyndje të madhe të popullsisë së Kosovës drejtë kryeqytetit. Kjo për shkak të vendeve të punës në institucionet qendrore, por edhe për shkak të shkollimit të studimeve. Prishtina është një prej qyteteve më të mëdha edhe në aspektin e krijimit të familjeve të reja, ku numri i kurorëzimeve është mbi 1000 në vit. Ky trend krijon kërkesë për banim të ri në qytet.

Ndikimi i teknologjisë në transformimin e bizneseve, por edhe individëve – zhvillimi i teknologjive dhe sistemeve të reja informative mund të gjeneroj ndryshime të mëdha në ekonominë e Prishtinës në dekadën e ardhshme. Adaptimi i teknologjive të reja pritet të luaj rol kyç në rritjen e produktivitetit të firmave, shtimin e konkurrencës dhe specializimin e firmave.

Plani Zhvillimor Komunal identifikon katër prioritetet strategjike të cilat do të japin rezultatet e nevojshme për arritjen e vizionit të kryeqytetit. Prioritetet strategjike fokusohen në ndertimin e bazave ekonomike për sukses, marrjen e veprimeve për të adresuar sfidat e identifikuara dhe shfrytëzimin e përparësive për të arritur zhvillim ekonomik. Këto prioritetet strategjike janë:

- Fuqizimi i konkurrueshmërisë së Prishtinës;
- Përmirësimi i produktivitetit dhe kapaciteteve të qytetit;
- Promovimi i mundësive të Prishtinës; dhe
- Tërheqja e investimeve të jashtme.

Për të arritur vizionin, në fushën e zhvillimit ekonomik, planifikohen sa më shumë investime në ekonominë dhe industrinë informative, për të cilën planifikohet hapësirë, infrastrukturë e zbatim duke filluar me edukim dinjitoz; infrastrukturë teknike, transport, dhe infrastrukturë publike e sociale të pershtatshme.

Bujqësia është pjesë shumë e rëndësishme e ekonomisë së Prishtinës – kërkohet rritje e përkrahjes për sektorin e blegtorisë, gjedhtarisë, bletarisë, prodhimtarisë organike, perimtarisë, dhe kultivimin e pemëve të imta. Gjithashtu, në mënyrë që të zhvillohet bujqësia kërkohet ndërtimi i stallave, furnizimi me pajisje për mjelje, ftohje dhe dhoma të qumështit, pajisje për përgatitjen e ushqimit të koncentruar dhe racioneve të kafshëve dhe përmirësim i infrastrukturës përcjellëse në fermë.

Kryeqyteti duhet të përmirësojë, zgjerojë dhe avancojë sistemin e ujitjes. Duhet më shumë përkrahje për bujqit në kultivimin e bimëve mjekuese dhe aromatike, financim të pikave të reja grumbulluese për bimë mjekuese dhe aromatike.

Përkrahje nga Komuna për fuqizimin e pikave grumbulluese, frigoriferike, duke u fokusuar më shumë në çështjet që ndihmojnë plasimin e produkteve në treg. Mbështetja në ngritjen e kapaciteteve të fermerëve përmes trajnimeve; me trajnime do të përkrahen kryesisht fermerët e hortikulturës (pemëve dhe perimeve), blegtorisë dhe bletarisë. Përkrahja e grave në biznes, kryesisht grave që merren me përpunimin e pemëve dhe perimeve, përmes kësaj përkrahjeje do të bëhet fuqizimi i ekonomive shtëpiake dhe promovimi i produkteve tradicionale "home-made", të grave punëtore të Prishtinës.

Qyteti i Prishtinës në mënyrë të përhershme duhet të angazhohet në promovimin e ngjarjeve të shumta industriale dhe tregtare që ndodhin në qytetin e Prishtinës. Një ndër to mund të jenë panairët e shumta të prodhimeve industriale dhe tregtare vendore. Prishtina si kryeqytet ofron turizëm tregtar përmes aktiviteteve të shumta tregtare prej qendrave të mëdha tregtare të cilat tërheqin një numër të madh të qytetareve nga gjithë territori i Kosovës, por edhe nga vendet fqinje deri tek tregjet tradicionale që organizohen në komunën e Prishtinës. Përveç qendrave tregtare komuna e Prishtinës ofron një numër të panairëve të ndryshme promovuese dhe tregtare të produkteve vendore të cilat panairë tërheqin një numër të madh qytetareve në kryeqytet.

Ky dokument planifikimi njërin nga qëllimet e ka edhe ri-zhvillimin (zonat që munden të rrënohen dhe rihvillohen) e zonave të caktuara për efekte ekonomike (rritjen e vlerës së potencialit ekonomik dhe fizik) por edhe duke ulur shkallën e rrezikshmërisë nga vjetërsia dhe dëmtimi i strukturave.

- Tregu te Ulpiana dhe korridori deri te katedralja;
- Lagjja Pejton;
- Rruga Agim Ramadani (zona afër parlamentit).

Ky dokument planifikon zhvillimin e qëndrueshëm dhe të mençur të tregtisë industrisë dhe gastronomisë:

- Prishtina si kryeqytet do të vazhdojë të jetë qendra kryesore e Kosovës por edhe e rajonit sa i përket kapaciteteve dhe hapësirave për tregti të mallrave ushqimore, teknologjisë, materialeve dhe makinerive ndërtimore, elementeve tjera etj;
- Tregtia me shumicë do zhvillohet në korridoret kryesore zhvillimore por edhe disa zona të veçanta tregtare brenda qytetit;
- Tregtia me pakicë do shtrihet në gati të gjitha pjesët e zonës urbane por edhe zonat rurale;
- Tregu i banimit do jetë i larmishëm dhe i konsoliduar;
- Tregu i automjeteve do akomodohet në mënyrë adekuate;
- Kujdes do i kushtohet edhe funksionimit të tregut të përhershëm dhe tregjeve ditore në disa zonaduke përfshirë edhe ri-zhvillimin e tregun e vjetër;
- Gastronomia, shërbimet hotelerie, restoranteve dhe kafeneve;
- Industria e lehtë dhe rëndë, planifikimin e disa zona të veçanta industriale brenda qytetit.

Zhvillimi ekonomik tregtar dhe industrial është përqendruar kryesisht në pjesën perëndimore të Prishtinës dhe atë në zonën ekonomike rrugës për në Fushë Kosovë, e cila zonë ka qenë e promovuar me PZHK-në e kaluar. Njëkohësisht, zhvillim ekonomik i ndërmarrjeve të vogla dhe mesme është përqendruar përgjatë akseve të rrugëve kryesore në drejtim të Ferizajit, Gjilanit, Mitrovicës dhe Podujevës.

Gastronomia/Horeca - zhvillimi dhe promovimi i gastronomisë shihet si një faktor i rëndësishëm i zhvillimit dhe promovimit të kuzhinës dhe traditave tona si dhe zhvillimin e turizmit në vendin tonë. Gastronomia/Horeca në komunën e Prishtinës luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik, ku punëson një numër të madh të qytetarëve. Aspekti i ofrimit të shërbimeve hotelerie ushqimorë ka

një traditë të lashtë, e cila tërheqë një numër të madh të turistëve në komunën e Prishtinës. Prishtina organizon dhe duhet të vazhdojë organizimin e festivaleve apo panairove të ndryshme në promovimin e gatimeve tradicionale dhe pjatave me koncepte të ndryshme të përgatitura të gastronomisë shqiptare.

Prishtina si kryeqytet që në vizionin e saj e ka rininë, ofron jetë natës atraktive me një numër të madh të lokaleve të natës dhe diskotekave, ku në shumë raste për shkak të zhurmës hasin në probleme të shpeshta në zhvillimin e aktiviteteve të tyre, prandaj duhet të mendohet në destinimin e një lokacioni të përshtatshëm ku mund të zhvillohen këto aktivitete.

Ky dokument planifikimi njërën nga qëllimet e ka edhe definimin e zonave, zhvillimin e infrastrukturës dhe kapaciteteve për zhvillimin e sektorit të **energjisë** si dhe infrastrukturës energjetike me fokus tek energjia e ripërtrishme.

Për këtë qëllim synohet:

- Për fillim energjia e ngrohje synohet të zhvillohet me fazën e dytë të kogjenerimit;
- Planifikohet ngrohje edhe nga energjia diellore (solare), ngrohje me panele solare;
- Mbulim me ngrohje i disa zonave të reja të Prishtinës nga faza e parë e gasifikimit në sisteme dhe zona të vogla, deri sa të jetësohet gazsjellësi për Kosovën rrjedhimisht edhe Prishtinën;
- Projektet e EU-së për ndërtesa me sisteme të veçanta të ngrohjes me panele solare, dhe sisteme tjera;
- Eficiencë energjetike tek banimi dhe objektet publike;
- Ndriçimi publik me energji të ri-përtrishme; dhe
- Sistemi i ftohjes së Prishtinës përmes ko-gjenerimit.

Ky dokument planifikimi njërën nga qëllimet e ka edhe identifikimin e fushave dhe shërbimeve për partneritete publiko private (PPP) ose modalitete tjera si elemente të rëndësishme e zhvillimit ekonomik. Dokumenti synon ofrimin e shërbimeve në disa fusha e sektorë si dhe përmirësimin cilësor:

- Do vazhdoj në kompletimin e fushës së infrastrukturës së transportit, paketa e parkingjeve mundet të kompletohet përveç disa parkingjeve që janë dhanë me PPP;
- Disa shërbime nga infrastruktura publike dhe sociale (përvoja me çerdhe, shërbime tjera të nivelit parashkollor, shkollor e universitar dhe infrastruktura tjetër publike, deri te aktivitetet dhe infrastruktura kulturore sportive mund të analizohen si aset për PPP ose modalitete tjera (duhet të jenë rezultat i studimeve të arsyeshmërisë fizibiliteti);
- Edhe shërbimet e ndryshme teknike, të sigurisë nëpër zonat dhe institucionet e ndryshme por edhe fusha e sektorë tjera si banimi etj.

Ky dokument planifikimi njërën nga qëllimet e ka edhe zhvillimin e kapaciteteve dhe infrastrukturës për zhvillimin e **Turizmit** në përgjithësi dhe turizmit të mençur në veçanti.

- Prishtina do të zhvilloj turizmin Urban dhe Rural, brenda zonës urbane do zhvillohen të gjitha llojet e turizmit ndërsa në disa zona rurale kryesisht agro-turizmi;
- Zona historike, trashëgimia kulturore në përgjithësi por edhe ajo arkitektonike, historike, shpirtërore janë asete të rëndësishme që do shfrytëzohen për zhvillimin e turizmit (me plan sipas kompetencave do të intervenohet ashtu që këto asete të jenë në funksion të zhvillimit ekonomik bazuar në studime dhe koncepte bashkëkohore);
- Në disa zona rurale do zhvillohet infrastruktura dhe elemente rekreativo atraktive për të nxitur dhe zhvilluar edhe një lloj agroturizmi (produkte bujqësore, bujtina, staza ecje, fusha dhe elemente sportive dhe rekreative, kapacitetet hoteliere, restorantet dhe përmbajtjet tjera të nevojshme);
- Prishtina do zhvilloj një zonë rekreative në afërsi të Obiliqit;

- Prishtina do të zhvilloj shumë elemente në zonën urbane për ta bërë Prishtinën tërheqëse, atraktive për t'u vizituar nga turistët (mbrojtja dhe zhvillimi i disa aseteve të trashëgimisë, vlerave dhe institucioneve të kulturës, sportit, distriktet inovative, hapësirave për lojëra, si dhe do zhvilloj më tutje kapacitetet hoteliere, restorantet dhe elementet tjera të infrastrukturës së qëndrueshme turistike); dhe
- Prishtina do zhvilloj identitetin, markën, turizmin virtual, riorganizimi i sektorit të mikpritjes dhe argëtimit.

Turizëm konferenciar/shkencor - Qyteti i Prishtinës, duke pasur parasysh traditën e shumë të organizim të ngjarjeve të shumta shkencore, dhe duke marrë parasysh vizionin për të ardhmen e saj, atraktiv dhe me ekonomi të njohurive, duhet të planifikojë për mbështetje të konferencave të shumta shkencore dhe profesionale, konferenca për më shumë ndërkombëtarë. Kjo do të sjellë rritje të të ardhurave për qytetin, meqë paraja jo vetëm do të shkojë për ngjarjen e tillë, por do të shkojë dhe në jetë të natës, akomodim, ngjarje kulturore etj. Qytetet botërore i lidhin ato dhe i kombinojnë ngjarjet e shumta kulturore dhe ngjarjeve sportive apo shkencore për të pasur një laramani të ngjarjeve. Sot në botë turizmi shkencor dhe i konferencave është një ndër gjeneratorët e shumë të të ardhurave për qytete të shumta. Konkurrimi i Prishtinës në këtë kuptim do të ishte shumë i favorshëm për të.

Turizmi shëndetësor - Qyteti i Prishtinës mund të jetë konkurrent në ofrimin e shërbimeve shëndetësore në mënyrë të organizuar (siç e bën Shkupi apo Tirana). Qytetarët tanë nga diaspora gjatë pushimeve në Kosovë, i bëjnë të gjitha vizitat nëpër klinika të ndryshme mjekësore si stomatologji, estetike, mbjellje të flokëve etj. Qytetet në rajon dhe në botë, e kanë dhe turizmin shëndetësor të ndërlikuar me ngjarje kulturore dhe turistike ku mund të jetë shumë i favorshëm për qytetin e Prishtinës në aspektin ekonomik. Megjithatë turizmi shëndetësor nuk duhet vlerësuar vetëm si një shërbim shëndetësor apo vetëm si një shërbim turistik. Tërësia e shërbimeve turistike, që u ofrojnë njerëzve një jetesë më të shëndetshme, mund të trajtohen në kuadrin e turizmit shëndetësor. Disa mundësi konkrete për këtë janë "turizmi mjekësor", që përmbledh ndërhyrjet kirurgjike apo trajtimet e tjera mjekësore nëpër spitale; "turizmi natyrës i kombinuar me mjekësi", që ofron shlodhje dhe qetësim psikofizik në komplekset natyrore; si dhe "turizmi i të moshuarve dhe i personave me aftësi të kufizuara", i cili krijon mundësinë e pjesëmarrjes në aktivitete sociale të llojllojshme dhe atë të akomodimit për një kohë të gjatë në hotele apo qendra rehabilitimi. Të gjitha këto mundësi mund të vlerësohen si turizëm shëndetësor të cilat komuna e Prishtinës mund të ofroj. Turizmi shëndetësor, në bashkëpunim me shërbime turistike dhe ato shëndetësore, kontribuon dukshëm në zhvillimin e të dy sektorëve, duke rritur investimet dhe punësimin jo vetëm në sektorin e turizmit, por edhe në atë të shëndetësisë, turizmi shëndetësor siguron më shumë rritje ekonomike dhe punësimin.

Turizmi kulturor - Qyteti i Prishtinës duke u bazuar në resurset e trashëgimisë kulturore, historisë së qytetit, ngjarjeve të shumta e të reja historike të kohës së re, ngjarjeve të shumta muzikore, artistike, mund të jetë Qendër e Artit dhe e Kulturës Bashkëkohore Moderne, me të cilën duhet të mbajë dhe kultivojë përmes marketingut, konkurseve të shumta ndërkombëtare për ngjarje kulturore, që të mbajë dhe kultivojë pozitën e saj konkurruese. Mbështetja për marketing të qytetit të Prishtinës, duhet të shkojë për të gjitha pikat e forta të qytetit dhe me të cilat ka pse të mburret dhe të josh të tjerët për të ardhur dhe kaluar e shpenzuar në kryeqytet. Hapave të tillë është duke shkuar Prishtina. Kualiteti i jetës në kuptim të zbatimit të shumta që ofron qyteti duhet të jetë motiv dhe shtytje për investime të shumta nga qyteti në kombinim me partnerët privat, porse gjithsesi duke e parë këtë si një pjesë të strategjisë për Rritjen Ekonomike të Qytetit të Prishtinës. Joshja përmes marketingut të qytetit duhet të shikohet si favor në joshjen e vizitorëve që të vijnë dhe qëndrojnë në Prishtinë, për më pak apo më shumë ditë, për të jetuar dhe/apo punuar, për të investuar, argëtuar, parë një koncert apo marrë pjesë në një festival.

Prishtina është destinacioni i parë turistik dhe port kryesor ajror në Kosovë. Numri i vizitorëve të huaj që kanë vizituar Prishtinën gjatë viteve rritet me më shumë se 10 mijë vizitorë në vite. Prishtina

është një vend i njohur si një qendër universitare studentësh nga vende të rajoneve si Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia dhe përfaqëson një rrafshnaltë të kombinimit të kulturës vendase, osmane dhe jugosllave. Njerëzit e saj janë njerëz që njihen për mikpritjen dhe tolerancën fetare. Rreth 23% e popullsisë i përkasin grupmoshës 16-27, të cilët gjithashtu janë shumë optimist.

Qendra Historike e Prishtinës përbën një nga zonat identitare të qytetit, ku janë të koncentruara objektet kryesore të trashëgimisë kulturore. Që të promovohet edhe me tutje kjo zonë është përcaktuar zona historike dhe zona mbrojtëse e zonës historike ku kërkohet që të bëhet një plan i veçantë.

Turizmi rekreativ e sportiv – Qyteti i Prishtinës me të rinjtë e saj brenda qytetit, kapacitetet e shumta të rinjve studentë, do të mund të organizon konkurse për ngjarje të shumta ndërkombëtare të pranueshme për ngjarje të ndryshme sportive, siç janë maratona vrapimi, gara çiklizmi, turnire të ndryshme sportive që mund të tërheqin ekipe sportive të ndryshme nga rajoni dhe më gjerë. Aktivitetet e tilla do të mund të ofrojnë kënaqësi për qytetarët dhe vizitorët. Prishtina në këto ngjarje ka traditë, vetëm se do të duhej të shikoheshin dhe të punohet se si të promovohen së bashku me organizimin e tyre. Qyteti i Prishtinës do të duhej të mbështeste dhe të ndiqte iniciativat e tilla me investime kapitale, të cilat investime do të mund të përdoren për ngritje të kualitetit të jetës. Të gjitha sportet vetanake, noti, mundja, boksi, sportet marcialë si dhe sportet grupore dhe të afërta me shoqërinë prishtinase si futboll dhe basketbolli do të mund të mbështeten dhe të jenë qasje shumë e logjikshme dhe efikase në ngritjen e cilësisë së jetës, mbajtjen e të rinjve në qytet, joshjen e të rinjve në studime, joshjen e familjeve të reja dhe të kualifikuara të jetojnë dhe veprojnë në Prishtinë. Komuna e Prishtinës planifikon hapësira rekreative sportive të cilat hapësira do të ofronin dhe përmbushnin kërkesat e të rinjve dhe ekipeve të kategorive të ndryshme sipas nevojave të tyre.

Turizmi rural bujqësor - Komuna e Prishtinës ka analizuar potencialet e mundshme të zhvillimit të agro- turizmit, këto potenciale janë akomoduar në skenarët zhvillimor të komunës për vitet në vazhdimësi duke e mbështetur me objektiva dhe veprime konkret në arritjen e zhvillimit të këtij turizmi mjaft aktual në vend dhe më gjerë. Se si do të arrihet fuqizimi dhe zhvillimi i turizmit rural komuna ka paraqitur disa objektiva kryesore:

- Promovimi i politikave dhe sistemeve të qëndrueshme dhe të përqendruara në ushqim cilësor;
- Të promovohen dhe të zgjerohen mundësitë që konsumatorët dhe turistët të blejnë ushqim vendor, përfshirë tregjet lokale;
- Ruajtja dhe promovimi i traditave të veçanta lokale të ushqimit në nivel të BE-së dhe me organe të tilla si Këshilli i Shijes dhe Ushqim i Ngadaltë;
- Ritmi i diversifikimit ekonomik bujqësor është dhe do të jetë e nevojshme në komunitetin bujqësor;
- Ndërlidhja e bujqësisë prodhuese me turizëm rural.

Për ta përmbledhur gjithë këtë, mund të thuhet që rritja e prodhimeve agro-kulturore dhe rritja e agroturizmit mund të bëhet përmes ndihmës së ndërtimit të një kulture ushqimore vendore, përmes sigurimit të një përfshirjeje më të madhe lokale në prodhimin dhe përpunimin vendor dhe krijimin e tregjeve për fermerë.

Ky dokument planifikimi njërën nga qëllimet e ka edhe zhvillimin e transportit, infrastrukturës së transportit dhe sa më shumë elemente të transportit të mençur. Ekonomia e Prishtinës e cila me këtë PZHK planifikohet si magnet i zhvillimit ekonomik, është e lidhur ngushtë me tregtinë e jashtme, për këto funksione është planifikuar zhvillimi i mëtejshëm i rrjeteve (ndër) kombëtare të infrastrukturës së transportit dhe transportit tokësor e ajror por edhe lidhje me transportin detar.

- Planifikohet lidhje e mirë me korridoret ndërkombëtare me infrastrukturën e transportit rrugor e cila planifikohet të zgjerohet përmes përfundimit të autostradave ndërkombëtare (me theks te autostrada Prishtinë – Gjilan – Serbi, Prishtinë – Podujevë – Serbi si dhe negocimi

- për lidhjen me Maqedoninë e Veriut dhe korridoret ndërkombëtare) që janë në ndërtim e sipër, dhe përmirësimit të kapacitetit të rrugëve nacionale dhe rajonale në nivel vendi;
- Infrastruktura e transportit rrugor duhet të zgjerohet përmes përfundimit të autostradave ndërkombëtare që janë në ndërtim e sipër dhe përmirësimit të kapacitetit të rrugëve nacionale dhe rajonale në nivel vendi;
 - Planifikohet lidhja e Prishtinës me korridoret hekurudhore ndërkombëtare përmes modernizimit të linjës hekurudhore ndërkombëtare - Linja 10 (148 km e gjatë) prej Fushë Kosovës në Maqedoni (linja jugore) dhe prej Fushë Kosovës në Serbi (linja veriore) si dhe lidhjes nëpërmes Linjës 7 hekurudhore Fushë Kosovë – Prishtinë - Kufiri me Serbinë-korridore ndërkombëtare. Duhet të theksohet se edhe linjat e reja ose modernizim i linjave është planifikuar: linja hekurudhore (Fushë Kosovë – Klinë – Pejë) të jetë linjë një-binarësh dhe e elektrifikuar, linja hekurudhore (Klinë – Prizren) të jetë linjë një-binarësh dhe e elektrifikuar, linja e re hekurudhore (Kramovik – Gjakovë), linja e re hekurudhore (Prizren – Durrës në Shqipëri), Linja e re hekurudhore (Ferizaj – Gjilan – Bujanoc në Serbi) si dhe Linja e re hekurudhore (Pejë – Bijelo Polje në Malin e Zi) linjë me dy binarë paralel dhe elektrifikuar;
 - Prishtina do të jetë zonë LOGJISTIKE që tërheq korridorin Durrës – Nish – Selanik duke e kompletuar dhe modernizuar infrastrukturën e transportit dhe duke planifikuar platformën për shpërndarjen e transportit të mallrave (HUB) tek stacioni multimodal;
 - Sa i përket lidhjeve me transportin ajror planifikohet mirëmbajtje e lidhjes me autobus dhe lidhje e re hekurudhore Prishtinë – Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, si dhe vijat ndërkombëtare, lidhje me Aeroportin e Tiranës, Shkupit, Kukësit etj.
 - Fuqizimi dhe modernizimi i infrastrukturës për lidhjet me portin e Durrësit, Shën Gjinit etj
 - Në funksion të Prishtinës Metropolitane fuqizimi i lidhjeve dhe infrastrukturës së transportit dhe modaliteteve;
 - Planifikohet zhvillimi i mëtejshëm i transportit urban, urban-rural, metropolitan, ndër-urban dhe ndërkombëtarë si në vëllim, cilësi dhe shpejtësi duke u ndërlidhë edhe me komponentët "SMART";
 - Zgjerimi dhe modernizimi edhe i stacionit të autobusëve; dhe
 - Zgjerimi dhe modernizimi edhe i stacionit hekurudhor në Prishtinë.

Ky dokument planifikimi njërën nga qëllimet e ka edhe zhvillimin e kapitalit njerëzor, me institucione dhe infrastrukturë shkollore publike dhe private. Në kushtet e ekonomisë së re, ekonomisë së bazuar në dituri, kapitali njerëzor i mishëruar në popullsinë e Prishtinës është aset ekonomik më i rëndësishëm i vendit. Ashtu si edhe në vendet e tjera, suksesi i sistemit arsimor në ofrimin e shkathtësive kyçe që kërkohen në tregun e punës do të jetë një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e ardhshëm ekonomik. Qasja e barabartë në një sistem arsimor modern është gjithashtu një faktor po aq i rëndësishëm. Në këtë drejtim, Prishtina do të kompletoj dhe fuqizoj infrastrukturën shkollore publike dhe private dhe do të ofroj hapësira për këto institucione. Një faktor tjetër veçanërisht i rëndësishëm për ekonominë e Prishtinës por edhe të tërë Kosovës është arsimimi modern në promovimin e shkathtësive kyçe të cilat nxisin vetëpunësimin. Së fundi, nivelet më të larta të rezultateve në arsim rrisin shanset edhe për të konkurruar me sukses në tregjete huaja të punës, krahas tregut të brendshëm.

Ky dokument planifikimi njërën nga qëllimet e ka edhe zhvillimin e institucioneve dhe infrastrukturës sportive publike dhe private. Në kushtet e ekonomisë së tregut, sporti është aset dhe industri ekonomike shumë e rëndësishme e vendit. Ashtu si edhe në vendet e tjera, suksesi i sistemit të sportit në ofrimin e cilësive dhe shkathtësive kyçe që kërkohen në sportin ndërkombëtarë do të jetë i një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e ardhshëm ekonomik. Në këtë drejtim, Prishtina do të kompletoj dhe fuqizoj infrastrukturën sportive publike dhe private dhe do të ofroj hapësira për këto institucione. Një faktor tjetër veçanërisht i rëndësishëm për ekonominë e Prishtinës por edhe të tërë Kosovës është zhvillimi i të gjitha disiplinave sportive moderne. Së fundi, nivelet më të larta të

rezultateve në sport rrisin shanset edhe për të konkurruar me sukses në klubet e huaja, krahas klubeve brenda Kosovës.

- Prishtina do planifikoj hapësirat por edhe lehtësoj kushtet për institucionet sportive publike e private ekzistuese të të gjitha niveleve (me theks në Futboll);
- Prishtina do planifikoj hapësirat por edhe lehtësoj kushtet për institucionet sportive publike e private që eventualisht mundën të ofrohen me kërkesa qoftë për infrastrukturë, hapësirë, kushte etj;
- Analizoj dhe mundësoj bashkëpunim deri te partneritetet;
- Inicij debat për nevojat e disiplinave të sportit dhe do mundësoj kushtet të mjedisit fizik për institucionet, infrastrukturën dhe aktivitetet që lidhen me këto kërkesa në komplet territorin e komunës dhe kryeqytetit.

Ky dokument planifikimi njërin nga qëllimet e ka edhe zhvillimin e institucioneve dhe infrastrukturës shëndetësore publike dhe private. Shëndetësia përpos aspektit social dhe cilësisë së jetës ka ndikim të madh edhe në ekonomi. Në këtë drejtim, Prishtina do të kompletoj dhe fuqizoj infrastrukturën shëndetësore publike dhe private dhe ofroj hapësira për këto institucione, një faktor tjetër veçanërisht i rëndësishëm për ekonominë e Prishtinës por edhe të tërë Kosovës është zhvillimi i të gjitha reparteve dhe shërbimeve. Së fundi, cilësia më e lartë dhe rezultatet në shëndetësi rrisin shanset edhe investime brenda Prishtinës/Kosovës dhe mos shpenzim të mjeteve të shumta financiare për trajtim jasht vendit sikur se deri tani.

- Prishtina do të ndertoj Spitalin e Qytetit;
- Prishtina do planifikoj hapësirat por edhe lehtësoj kushtet për institucionet shëndetësore publike e private ekzistuese të të gjitha niveleve dhe repartet;
- Prishtina do planifikoj hapësirat por edhe lehtësoj kushtet për institucionet shëndetësore publike e private që eventualisht mundën të ofrohen me kërkesa qoftë për infrastrukturë, hapësirë, kushte etj.
- Analizoj dhe mundësoj bashkëpunim deri te partneritetet;
- Inicij debat për nevojat e spitaleve, reparteve shëndetësore por edhe industrisë së prodhimit të barnave dhe do mundësoj kushtet të mjedisit fizik për institucionet, infrastrukturën dhe aktivitetet që lidhen me këto kërkesa në komplet territorin e komunës dhe kryeqytetit;

Ky dokument planifikimi njërin nga qëllimet e ka edhe zhvillimin e kapitalit njerëzor (fuqisë së përgatitur punëtore). Ekonomia e Prishtinës bazohet në masë të madhe në kapitalin njerëzor të saj. Planifikohen investime në kapitalin njerëzor të cilat do të japin rezultatet e tyre në faza të mëvonshme, por kthimi në investime është i sigurt. Një fuqi punëtore më e aftë do të siguroj jo vetëm normë më të lartë të rritjes ekonomike, por edhe rritje gjithëpërfshirëse. Themelimi i shkollave profesionale dhe ndërlidhja e tregut të punës do t'i mundësoj fuqisë punëtore nga familjet e varfra të fitojnë aftësitë dhe shkathhtësitë e duhura për t'u integruar në tregun e punës. Prishtina me këtë plan synon ngritjen e aftësive të fuqisë punëtore. Në një kohë kur papunësia në vend është shumë e lartë, paradoksi është se shumë ndërmarrje kanë problem të gjejnë punëtorë të shkathët. Mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar i dekurajon investimet dhe është pengesë për ndërmarrjet tona që të rrisin produktivitetin dhe konkurrencshmërinë e tyre.

Ky dokument planifikimi njërin nga qëllimet e ka edhe prodhimin dhe përpunimin e materialeve ndërtimore dhe mobilerive duke alokuar hapësirë, krijuar infrastrukturë dhe kapacitete për përpunim të drurit, metalit plastikës etj. Sektori i ndërtimtarisë në vazhdimësi është duke u zhvilluar me një shpejtësi të madhe në gjithë botën, ky trend ka prekur edhe qytetin e Prishtinës i cili është duke u ndërtuar me një fluks të madh. Ky sektor është një ndër sektorët me potencial të lartë ekonomik në vend i cili sektor punëson një numër të madh të qytetarëve të cilët punojnë drejtpërdrejt në ndërtim apo në aktivitete që ndërlidhen me ndërtimtarinë. Duke analizuar potencialet ekonomike të sektorit të ndërtimtarisë dhe aktiviteteve që ndërlidhen me këtë sektor si: depo ndërtimore, betonierat,

hapësira për makineri ndërtimore është e domosdoshme të planifikohet një hapësirë që do të centralizonte këtë sektorë të rëndësishëm ekonomik.

Ky dokument planifikimi njërin nga qëllimet e ka edhe zhvillimin e Bujqësisë dhe bujqësisë së mençur duke alokuar zona dhe infrastrukturë për grumbullim, përpunim dhe konservim të pemëve dhe perimeve, industri të përpunimit të miellit, industri të mishit, qumështit etj, lidhja e zingjirit ekonomik bujqësor, ri pyllëzimi dhe pyllëzimi me dru industrial i zonave të caktuara. Komuna e Prishtinës synon me plan të ketë ekonominë bujqësore (veprimtari ekonomike në të cilën fitohen produkte finale me origjinë bimore dhe shtazore) të zhvilluar. Prishtina do të jetë lider në:

- Zinxhirin bujqësorë: Grumbullim – Përpunim (Trajtim) - Konservim dhe Tregtim të pemëve, Perimeve, Qumështit, Bimëve, etj, përfshirë frigoriferët për ruajtje;
- Modernizimi i tregut të produkteve bujqësore;
- Rritja e kapaciteteve agro-prodhuese dhe përpunuese, deri 2028;
- Diversifikimi dhe zhvillimi i bizneseve të vogla bujqësore duke u bazuar në burime lokale dhe kryesisht për agro-turizëm;
- Integrim i bujqësisë alternative me turizmin, ferma agro-turizmi, vreshtari, frutikulturë;
- Industri të përpunimit të miellit dhe të mishit;
- Zhvillim i blegtorisë për agro-turizëm;
- Ri-pyllëzim dhe pyllëzim me dru me kapacitete mjedisore si pjesë e bujqësisë së mençur dhe dru industrial në zona të caktuara të komunës së Prishtinës.

Prishtina do planifikoj hapësirat por edhe lehtësoj kushtet për zhvillimet bujqësore qoftë me iniciativë publike ose private që eventualisht munden të ofrohen me kërkesa qoftë për infrastrukturë, hapësirë, kushte zhvillimore. Prodhimi i qëndrueshëm bujqësor është shfaqur si një nevojë për të gjetur mënyra të prodhimit bujqësor që nuk degradojnë resurset natyrore dhe që në të njëjtën kohë sjellin prodhime bujqësore dhe të ardhura të larta. Meqenëse bujqësia varet kryesisht nga shërbimet e ofruara nga ekosistemet, bujqësia e qëndrueshme synon të zvogëlojë ndikimet negative mjedisore antropogjene përmes përdorimit të teknologjive të avancuara në ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së burimeve natyrore. Qëllimi i planit është zhvillimi i sistemit bujqësor që është produktiv dhe fitimprurës, ruan bazën e burimeve natyrore, tokën bujqësore me kualitet të lartë në pjesën veriore të qytetit të Prishtinës, konkretisht në fshatrat Bernicë e Epërme dhe e Poshtme, Prugoc, Barilevë, Drenoc dhe Vranidoll, mbron mjedisin dhe rritë cilësinë dhe sigurinë e ushqimit. Po ashtu, është identifikuar dhe përkrahur sektori i agro-turizmit si potencial i zhvillimit, i cili sjellë mundësi të zhvillimit ekonomik, duke mundësuar një ndërlidhje mes prodhimit në fermë dhe gastronomisë në zonat rurale me potencial të zhvillimit të kësaj veprimtarie.

Agro-industria (përpunimi) si sektorë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik do të fuqizohet në të mirë të krijimit të një stabiliteti ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës. Bujqësia dhe agrobiznesi po zhvillohen me shpejtësi, tregjet ndërkombëtare po liberalizohen, sjellja e konsumatorëve po ndryshon dhe tregjet e reja si bioenergji dhe biokarburantet po evoluojnë. Duke marrë parasysh sipërfaqen e kufizuar të tokës për një familje, si dhe dendësinë e popullsisë, është e qartë se në kushtet aktuale vetëm bujqësia nuk mund të sigurojë zhvillim të suksesshëm rural. Megjithatë, në viset rurale janë duke u zhvilluar disa biznese që mund të kenë perspektivë edhe më tutje: grumbullimi dhe përpunimi i produkteve bujqësore (me theks të veçantë pemët), përpunimi i drurit që kohëve të fundit po zhvillohet mjaftë shumë, bizneset për grumbullimin e kërpudhave dhe frutave të tjera pyjore, bletaria, bimët mjekuese, prodhimi dhe përpunimi i mishit. Një mundësi tjetër ka të bëjë me turizmin fshatar, i cili është fare pak prezent. Pra, duke pasur parasysh gjitha mundësitë dhe potencialet që ka komuna e Prishtinës do të ishte e rëndësishme krijimi i një zone agro- industriale ku do të orientonte dhe përqendronte industrinë bujqësor.

Sektori i qumështit, një nga sektorët më të rëndësishëm, organizohet në disa ndërmarrje prodhuese dhe tregtare, të cilat merren me përpunimin dhe grumbullimin e qumështit nga fermerët nëpër shumë pika grumbulluese. Produktet kryesore janë: qumështi i pastëruar, kosi me kajmak,

jogurti, djathi, specia me ajkë, kajmak i freskët shtëpiak, dhe gjiza. Shitja e prodhimeve bëhet kryesisht në tregun e brendshëm.

Për ta realizuar konceptin hapësinor, Komuna (DBZHR) ka paraparë disa objektiva dhe projekte në aspektin e zhvillimit të blegtorisë.

Ky dokument planifikimi njërin nga qëllimet e ka edhe zhvillimin e modeleve të kontraktimit të jashtëm, TIK-u, programimi dhe procesi i zhvillimit dhe fuqizimit të bizneseve në funksion për tregjet brenda Prishtinës, Kosovës e sidomos në tregjet e jashtëm:

- Bazuar në faktet nga analiza e gjendjes së globalizimi është një koncept gjithnjë e më i theksuar në të gjitha dimensionet, dhe bota po lëvizë drejt një tregu të vetëm. Në këtë proces të liberalizimit të tregut, jo me kufi tërreptë tregtar për vendet.
- Prishtina planifikon që kontraktimin e jashtëm ta trajtoj si një shans dhe mundësi për zhvillim, korporatat shumëkombëshe duhet të kenë interes: Së pari, kostot e punës janë më të lira, është e lehtë të hysh në treg, qasja në lëndët e para, zinxhiri i furnizimit dhe aktivitetet e logjistikës janë më të lehta sesa vendet perëndimore, të gjitha këto ulin shpenzimet operative.
- Për këto arsye edhe shumë të tjera disa nga kompanitë planifikohet se munden ti transferojnë aktivitetet e tyre të brendshme dhe të drejtat e vendimit për veprim tek furnitorët ose kompanitë e Prishtinës. Këto kompani të huaja mund të punësojnë ndonjë kompani nga Prishtina për të bërë një pjesë të punës së saj, në vend që të përdorë punonjësit e saj për ta bërë atë.
- Përmirësimi i cilësisë së produktit ose shërbimit, hyrja në tregje më të mëdha dhe rritja e numrit të klientëve të bizneseve të tjera janë objektiva të kësaj komponente.
- Prishtina do futë në lëvizje kapitalin njerëzor dhe infrastrukturë të bollshme me kosto të ulët
- Qeveria komunale e Prishtinës dhe ajo e Kosovës duhet të orientohet në marrëveshje të jashtme si një prionier për zbutjen e papunësisë por edhe zhvillimit ekonomik, si një platformë ekonomike që përshpejton futjen e teknologjive të reja, fondeve të mëdha të brendshme dhe formë e investimeve të qëndrueshme
- Planifikohet të shfrytëzohet mundësia e globalizimit që ka prekur të gjithë botën dhe vendet e zhvilluara dëshirojnë të përdorin fuqinë punëtore të lirë të vendeve në zhvillim, lëndët e para, energjinë etj. Ata kanë filluar të përfitojnë nga më shumë mundësi. Kompanitë përdorin vendet në zhvillim për prodhim, për shkak të kostove më të ulëta duke kryer këto vende arritën të krijojnë një zinxhirë vlerash më efikase.
- Plani e merr si referim ekonominë e njohur, duke forcuar kështu prezencën në territorin e biznesit dhe qendrave të reja (BQR) dhe inkubatorëve, ashtu që me lidhjen e kërkimeve me botën e korporatave mund të ndihmojë fillimin e procesit të ndërmarrjeve të reja, dhe në këtë drejtim për kompani fillestare duhet sigurohen: Hapësirat adekuate, përkrahje me ngritje të kapaciteteve për operim në këto tregje (për bashkëpunim të mirë në rrjetet ndërkombëtare të biznesit, parakushti kryesor për ndërmarrjet është që të kemi një platformë të fortë kombëtare të shkencës themelore me dalje në biznesin e aftësive R&D. Ky është roli i BIC dhe i inkubatorëve), Infrastrukturë adekuate etj.
- Prishtina do planifikoj hapësirat por edhe lehtësoj kushtet për zhvillimin e modeleve të kontraktimit të jashtëm, TIK-u, programimit dhe procesi i zhvillimit dhe fuqizimit të bizneseve në funksion për tregjet brenda Prishtinës, Kosovës e sidomos në tregjet e jashtëm;
- Prishtina do planifikoj hapësirat por edhe lehtësoj kushtet për zhvillimet e tilla që eventualisht munden të ofrohen me kërkesa qoftë për infrastrukturë, hapësirë, kushte etj;
- Analizoj dhe mundësoj bashkëpunim deri te partneritetet, Inicijoj debat për nevojat e zhvillimit e lartpërmendura do mundësoj kushtet të mjedisit fizik për të gjithë të interesuarit, infrastrukturën dhe aktivitetet që lidhen me këto kërkesa në komplet territorin e komunës dhe kryeqytetit;

Ky dokument planifikimi njërën nga qëllimet e ka edhe bashkëpunimin me komunat fqinje. Në funksion të zbatimit të konceptit të Trekëndëshit të Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, Prishtinës Metropolitane por edhe të interesave të ndërsjella me komunat fqinje, PZHK e Prishtinës do vihet në funksion të zhvillimit të përbashkët ekonomik.

- Funksionalizimi i planifikuar i korridoreve zhvillimore Prishtinë - Lipjan, Prishtinë – Graçanicë, Prishtinë – Obiliq, Prishtinë – Podujevë;
- Funksionalizimi i planifikuar i zonës Ekonomike Prishtinë – Fushë Kosovë;
- Zona ekonomike me Obiliqin dhe zona rekreative turistike;
- Rritjes së bashkëpunimit në shfrytëzimin e potencialeve turistike si vlerave të trashëgimisë kulturore, natyrore dhe potencialeve tjera;
- Ndërtimit, funksionalizimit dhe modernizimit të infrastrukturës së transportit dhe transportit dukepërfshirë edhe Stacionin Multimodal e hekurudhën;
- Rritjes së bashkëpunimit në shfrytëzimin e resurseve tjera minerare (nëntoksore) dhe pasurive sipërfaqësor përfshirë energjinë e ripërtrishme;
- Rritjes së bashkëpunimit në shfrytëzimin e Infrastrukturës teknike dhe sociale;
- Rritjes së bashkëpunimit në përmirësimin e cilësisë së tokës, ujit, ajrit dhe reagim ndaj fatkeqësive deri te reziliencia.

Ky dokument planifikimi njërën nga qëllimet e ka edhe krijimin e kushteve dhe infrastrukturës për zhvillimin e sektorit të ndërtimtarisë. Ndërtimtaria është zhvilluar si në kuptimin e materialeve, teknologjive dhe elementeve të para-fabrikua, dhe të gjitha munden të përdoren në atë që quhet zgjidhje e mençur:

- Ofrohen zona për prodhim dhe përpunim të materialeve ndërtimore (prodhimi i betonit, zhavorrit, asfaltit dhe materialeve tjera si dhe përpunimi i drurit, metalit, plastikës etj);
- Zyrtat e kompanive dhe byrove projektuese mund të vendosen gjithandej zonës urbane por me fokus në korridoret zhvillimore;
- Duhet planifikohet edhe zona të caktuara për makineritë e kompanive dhe depot e materialeve ndërtimore;
- Riorganizimi i sektorit të ndërtimit, ndërtim bashkohor dhe i përballueshëm;
- Duhet mendohet edhe tërheqja e ndonjë prodhuesi vendor ose ndërkombëtar të makinerive dhe veglave të ndërtimit.

Zonat ekonomike që duhet të ndërtohen

Fatkeqësisht, Komuna e Prishtinës, nuk ka ndjekur trendin e komunave tjera në krijimin e një zone ekonomike, të mbështetur në Ligjin për Zona Ekonomike. Me PZHU janë të detajuara një zonë ekonomike dhe dy zona industriale. Zonat industriale shtrihen në aksin rrugor Prishtinë-Fushë Kosovë. Nuk ekzistojnë të dhëna apo studime lidhur me strukturën e bizneseve dhe punësimit ose të dhëna më të detajuara lidhur me aktivitetin ekonomik në këto zona. Zgjerimi i hapësirave ku do të koncentroheshin veprimtaritë ekonomike dhe industriale, u planifikuan edhe në Planin Strategjik 2004 për Prishtinën. Plani kishte planifikuar zonat ekonomike dhe industriale duke i vendosur në dy tërësi hapësinore:

- 1) Në kuadër të zonave industriale ekzistuese përgjatë aksit Prishtinë-Fushë Kosovë, dhe
- 2) Duke planifikuar zgjerim të zonave ekonomike-industriale për 600ha të shtrira në pjesët veriperëndimore të komunës.

Vlerësimi rezultoi se në kuadër të zonave ekzistuese, nuk u zhvillua industri prodhuese apo përpunuese, por aty u vendosën një sërë objektsh arsimore dhe u zhvilluan veprimtari tregtare, por jo në masë të kënaqshme. Gjithashtu, në këto hapësira u zhvillua banimi joformal ndër vite. Zgjerimi i zonave industriale ekonomike për 600ha shtesë, nuk ndodhi, ndonëse u hartua edhe një Plan Rregullues Urban-Zona Ekonomike, me qëllim të lehtësimit të vendosjes së veprimtarive. Këto

biznese ishte paraparë të shfrytëzojnë infrastrukturë ndërlidhëse, dy unaza të jashtme, të cilat përshkak se nuk u ndërtuan, bizneset të tërhequra nga inercioni, shumica e tyre komerciale dhe industriale, u vendosën në mënyrë të paplanifikuar përgjatë korridorit Prishtinë-Lipjan, lokacion ku furnizimi i bizneseve ishte më efektiv dhe më i shpejtë.

Zhvillimi më i madh ka ndodhur në aksin rrugor Prishtinë-Ferizaj që është vetëm hapësirë e identifikuar, pa infrastrukturë përcjellëse dhe në shumë raste shumë afër banimit. Për zhvillimin e kapaciteteve industriale në këtë zonë, prioritet duhet dhënë edhe aktiviteteve ekonomike që bëjnë punësim më të madh, janë industri të pastra, nuk janë shpenzues të mëdhenj të energjisë elektrike dhe të ujit industrial.

Në kuadër të Komunës së Prishtinës, nevojitet krijimi i një **Zone të lirë ekonomike apo Parku teknologjik**, ku me koncentrimin e veprimtarive të ndryshme ekonomike, do të mundësohej infrastrukturë adekuate, dhe do të ofroheshin lehtësime të ndryshme.

Zhvillimi i zonave ekonomike rrugës për Fushë-Kosovës, në Veternik, rrugës për Mitrovicë, në drejtim të Obiliqit nga Qendra e Panairëve, në drejtim të Podujevës, në drejtim të Graçanicës, në zona të tjera publike dhe private, duke promovuar dhe integruar edhe komunat e vogla përreth në qasjen e zhvillimit metropolitan të Prishtinës.

2.4.4. Investimet lokale

Ndër instrumentet kryesore që ka komuna për nxitjen e zhvillimit ekonomik janë investimet kapitale në infrastrukturë. Komuna e Prishtinës ka investuar në një sërë projektesh kapitale, siç janë investimet në Trafikun Urban si pjesë e reformimit të transportit publik, investimet në fabrikën e ujit në Shkabaj, projektin e kogjenerimit për ngrohjen qendrore të qytetit, investimet në infrastrukturë, në shëndetësi e arsim, si dhe projektet e planifikuara, sidomos ato në partneritet publiko-privat. Dhënia për shfrytëzim afatgjatë dhe partneriteti publiko-privat (PPP), janë dy modele të mundshme të financimit të projekteve infrastrukturore, të cilat duhen shqyrtuar drejt jetësimit sa më efikas të sigurimit të infrastrukturës.

Zhvillimi i projekteve kapitale nëpërmjet PPP, has në disa sfida zhvillimore, si: kohëzgjatja ligjore dhe teknike e hartimit të dokumentacionit për PPP dhe mosintegrimi i standardeve ndërkombëtare të ndërtimit kontraktual FIDIC gjatë kontraktimit dhe zbatimit të projekteve kapitale.

Sfidat

- Ndotja e mjedisit nga termocentralet që ndikon në zhvillimin e bujqësisë
- Migrimi i popullsisë për shkak të mungesës së mundësive të punësimit
- Përshtatja e edukimit me nevojat e tregut;
- Stimulimi i krijimit të NVM-ve në sektorin e prodhimit;
- Ofrimi i infrastrukturës për bizneset industriale shkaku i moskoncentrimit të tyre;
- Përmirësimi i klimës për bizneset e reja;
- Rritje e kërkesës për shërbime (hapësira publike, parking dhe rrjete të shërbimeve);
- Zbatimi i ngadalshëm i Planit të Mobilitetit;
- Ofrimi i shërbimeve më të mira të transportit publik;
- Presion për infrastrukturë rrugore adekuate për banim të mirëfilltë dhe veprimtari ekonomike cilësore;
- Oferta e ulët e opsioneve të muzeve, teatrove, sallave koncertale etj., veçanërisht bashkëkohore dhe moderne;
- Organizimi i festivaleve regjionale-ndërkombëtare për të rinjtë me infrastrukturën ekzistuese;
- Mungesa e linjave ajrore me tarifë të ulët;
- Numër i ulët i produkteve turistike në Parkun e Gërmisë.
- Mungesa e politikave stimuluese për zhvillimin e turizmit rural

Nevojat zhvillimore

Për Komunën e Prishtinës, rindërtimi i informacioneve kadastrale është tejet i nevojshëm për arsye të zhvillimeve shumë dinamike të ndodhura në kohë dhe mos-azhurnimi i titullarëve juridik të pronave për një periudhë të gjatë kohore.

- Rritja e aftësisë konkurruese dhe eksportuese të NVM-ve përmes futjes së standardeve;
- Intensifikimi i bashkëpunimit komunë-biznese për partneritete publiko-private;
- Investimi në hapësira industriale ekzistuese dhe të reja;
- Krijimi i një zone të lirë ekonomike apo Parku Teknologjik;
- Rritja e kapaciteteve të Zonave të Biznesit në Komunën e Prishtinës-tregjet me shumicë e pakicë, tregu i automjeteve, tregu i bagëtisë dhe i produkteve të bagëtisë, tregje sipas nevojës dhe kërkesës;
- Themelimi i parqeve të biznesit dhe zonave industriale, zhvillimi i një nyjelloreje për mallra (HUB);
- Dhënia me koncesion-qiraja e tokave ekonomike;
- Identifikimi i hapësirave të pashfrytëzuara dhe dhënia e tyre në shfrytëzim si stimulim për tërheqje të bizneseve të huaja dhe vendore;
- Identifikimi i hapësirave industriale në Komunën e Prishtinës;
- Identifikimi pikave (lokacioneve) strategjike me potenciale të jashtëzakonshme zhvillimore të cilat do t'i japin zhvillim gjithë zonës;
- Identifikimi i profileve të veçanta (identitare) të fshatrave si mundësi/potencial i zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm i përqendruar tek mbajtja popullsisë lokale përmes krijimit të mirëqenies ekonomike dhe sociale;
- Zhvillimi i një Tregu të Ri për qytetin;
- Dhënia me koncesion apo me forma tjera e tokave me destinim bujqësinë dhe blegtorinë;
- Ndërtimi i hapësirave të kampingut përmes PPP-ve;
- Dhënia me koncesione e hapësirave për ndërtim e pushimoreve në Malësinë e Gollakut apo përmes PPP-ve;
- Ndërtimi dhe funksionalizimi i infrastrukturës për kulturë, si muzetë, teatrot dhe sallat koncertale;
- Promovimi i turizmit dental;
- Rivitalizimi i qendrës historike të Prishtinës;
- Shndërrimi i Pazarit të Vjetër të qytetit në atraksion turistik;
- Caktimi i një hapësire të hapur, të destinuar për festivale muzikore;
- Ridimensionimi i shtigjeve në Parkun e Gërmisë;
- Zhvillimi i projekteve të mëdha të investimeve publike nëpërmjet dhënies në shfrytëzim dhe PPP;
- Krijimi dhe kompletimi i një sistemi efektiv të komunikacionit, për qytetin dhe zonën e gjerë urbane, mënjanimi i komunikacionit tranzit; implementimi i dy unazave për organizimin e sistemit të transportit;
- Zhvillimi i rregullt dhe i besueshëm i linjave të transportit publik, duke përfshirë linja të reja të lehta të transportit hekurudhor dhe modernizimi i mjeteve të transportit publik;
- Projektimi i linjave të transportit publik, në favor të zonave industriale dhe zonës ekonomike;
- Ruajtja dhe forcimi i linjave hekurudhore me polaritete të ndryshme urbane (aeroporti, stacioni i autobusëve, qendra e qytetit etj.);
- Rindërtimi i kadastrës, sidomos në zonën urbane dhe suburbane;
- Forcimi dhe rritja e cilësisë së arsimit, sistemit parauniversitar dhe universitar dhe atij profesional; nevojiten hapësira për mikpritje dhe kongrese, për udhëtarë biznesi (e turistë);
- Përmirësimi i ofrimit të hapësirës dhe mjeteve për të rinjtë: kulturore (libra dhe qendra të mësimi etj.), sportive (qendra sportive në ndërtesat e shkollave fillore etj.), sociale;
- Ndërtimi i deponisë për mbeturinat nga konstruksioni dhe demolimi, përkatësisht riciklimi i tyre;

- Zhvillimi i inkubatorëve hapësinor specifik për përkrahje, për ndërmarrjet e reja;
- Projekti për përkrahjen e teknologjisë së avancuar-Smart City;
- Zyra, qendra për promovimin e investimeve dhe turizmit në Prishtinë;
- Nxitja e zhvillimit në zonën ekonomike në afërsi të Gazimestanit;
- Kultivimi i perimeve në mjedise të mbrojtura-serra dhe avancimi i prodhimit të patates;
- Ndërtimi i pjesës së segmentit të unazës së qytetit (udhëkryqi Gjilan-Ferizaj deri tek Pishina e Gërmisë);
- Ndërtimi i unazës nga rruga e Fushë-Kosovës deri në rrugën e Podujevës;
- Vazhdimi i rrugës B, faza e tretë dhe e katërt e ndërtimi i rrugës A.

2.5. Infrastruktura teknike

2.5.1. Ujësjellësi

Furnizimi me ujë i Prishtinës daton që nga kohët e hershme nga burimet natyrale të Gërmisë, kurse më vonë nga pusët në Kolovicë. Prishtina në vitin 1961 kishte 38.593 banorë. Po këtë vit fillon shfrytëzimi i Liqenit akumulues të Badovcit për furnizimin e qytetit të Prishtinës dhe rrethinës me ujë të pijes. Nga vitet 1979 paralelisht me rritjen e zhvillimeve urbanistike në qytetin e Prishtinës dhe të rrethinës, fillon edhe rritja e kërkesave për ujë të pijes dhe largimin e ujërave të ndotura, ku arrihet të shtohen sasitë e ujit të pijes me burimin nga Liqeni i Batllavës, burimeve nëntokësore në Fushë-Kosovë dhe Obiliq, për të investuar edhe në rrjetin shpërndarës të ujit të pijes dhe ujërave të zeza.

2.5.1.1. Burime e ujit për furnizimin e qytetit të Prishtinës

Liqeni i Batllavës - Ka vëllim prej 45.500.000 m³ ujë dhe furnizon qytetin e Prishtinës me 65%. Ky liqen paraqet resursin kryesor të ujit të pijes për territorin e Komunës së Prishtinës, i ndërtuar në vitin 1960-1963, fillimisht për furnizim me ujë teknik për kompleksin energjetik në Obiliq dhe më pas nga viti 1982 është shëndërruar në resurs ujqor për ujë të pijes, për regjionin e Prishtinës. Në Shajkoc (Albanik) është e ndërtuar fabrika e përpunimit të ujit me kapacitet maksimal prej 900 l/sec.

Liqeni i Badovcit - Ka vëllim prej 38.400.000 m³ dhe furnizon qytetin e Prishtinës me ujë me 35%, është ndërtuar në vitin 1960 për furnizim me ujë të pijes, ujitje dhe ujë teknik për Minierën e Kishnicës. Nga viti 1980 ky liqen kryesisht përdoret për ujë të pijes për qytetin e Prishtinës dhe zonën periferike. Në Badovc është ndërtuar fabrika për përpunimin e ujit me kapacitet 400 l/sec. Burimet nëntokësore të Kolovicës dhe burimi i Gërmisë paraqesin resurset natyrore, prej të cilave është furnizuar Qyteti i Prishtinës në vitet 1950-1970.

Liqeni i Ujmanit - Sasia bruto e ujit të akumuluar në këtë liqe, atëherë kur niveli i ujit arrin në kuotën maksimale është 350.000.000 m³. Në Shkabaj është ndërtuar fabrika për përpunimin e ujit me kapacitet 700l/sec dhe për furnizimin e banorëve të Prishtinës, Fushë Kosovës dhe Obiliqit. Fabrika është ndërtuar në periudhën kohore 2016-2018, e cila është lëshuar për përdorim në vitin 2018.

Burimet e Kolovicës - Kanë kapacitet prej 50 l/sec. Në vitin 1982, pas ndërtimit të sistemit të Batllavës dhe rritjes së ndotjes nuk janë më në funksion, përderisa Burimi i Gërmisë me kapacitet prej 15 l/sec, përdoret si furnizuesi kryesor i Pishinës së Gërmisë, ujërat nëntokësore në Lagjen Pejton, Lakrishtë, Kalabri (Emshir), Vellusha, edhe pse në sasi jo shumë të mëdha, një pjesë e tyre do të mund të shfrytëzoheshin si potencial ujqor për krijimin e parqeve përreth ambienteve banuese, ujitjen e gjelbërimit dhe për pastrimin e rrugëve.

Burimet e lartcekura rreth furnizimit me ujë për qytetin e Prishtinës janë paraqitur edhe në formë tabelare më poshtë:

Tabela 5 Kapaciteti i burimeve dhe i furnizimit me ujë (Burimi: KRU Prishtina)

Burimet sipërfaqësore

Numri i **Lokacioni i burimeve**
burimeve

Vëllimi (m³)

Kapaciteti i prodhimit
(furnizimit)

1	<i>Liqeni i Batllavës</i>	45.000.000	900 (l/s)
2	<i>Liqeni i Badovcit</i>	38.400.000m ³	400 (l/s)
3	<i>Liqeni i Ujmanit</i>	350.000.00m ³	700 (l/s)
Burimet nëntokësore			
<i>Numri i burimeve</i>	<i>Lokacioni i burimeve</i>	<i>Kapaciteti i prodhimit (furnizimit)</i>	
1	<i>Kolovicë-Fusha e Pajtim</i>	50 (l/s)	
2	Gërmi	15 (l/s)	

Duke u bazuar në tabelën e mësipërme dhe raportet e KRU Prishtina, kapacitetet e burimeve ujore për Prishtinën, me të cilat menaxhon KRU Prishtina arrijnë prurjet prej Q=2065 l/s.

2.5.1.2. Stacionet e pompimit

Kryeqyteti Prishtinë, ka një sistem shumë kompleks të prodhimit dhe përpunimit të ujit. Aktualisht, uji i papërpunuar merret nga liqenet akumuluese, kanalet e ujitjes, burimet nëntokësore-puset etj. Sasia e përgjithshme e ujit të përpunuar e vënë në dispozicion të konsumatorëve brenda sistemit të KRU Prishtina Sh.A. pompohet minimalisht një herë dhe maksimalisht 4 herë. Prandaj, kostoja e prodhimit dhe shpërndarjes është e lartë nga (konsumi i madh i energjisë elektrike, kimikateve dhe amortizimi i pompave-elektromotorëve).

Liqeni i Batllavës - Fabrika për përpunimin e ujit në Shajkoc

Fabrika e përpunimit të ujit në Shajkoc (komuna e Podujevës), ujin e papërpunuar e merr në liqenin artificial akumulues (përmes pompimit) në Batllavë. Sipërfaqja e akumulimit në kuotën maksimale ka madhësinë prej 2,69 km². Sasia bruto e ujit të akumuluar në kuotën maksimale është 45.500.000 m³.

Liqeni i Badovcit - Fabrika për përpunimin e ujit në Badovc

Fabrika e përpunimit të ujit në Badovc, ujin e papërpunuar e merr në Liqenin artificial akumulues (përmes pompimit) me të njëjtin emër.

Liqeni i Ujmanit - Fabrika për përpunimin e ujit në Shkabaj

Fabrika e përpunimit të ujit në Shkabaj, ujin e papërpunuar e merr në Liqenin Ujmanit, përmes kanalit të hapur, i cili vjen nga Liqeni, ku nga aty, uji përmes stacioneve të pompave me kapacitet prej 2x400 kv, dërgohet në fabrikë, në Shkabaj. Kapaciteti i instaluar i përpunimit të ujit është 700 l/s. Puna e testimit të stabilimenteve për përpunim të sasisë së instaluar të ujit është bërë dhe është treguar e suksesshme. Uji i papërpunuar për këtë fabrikë merret në liqenin artificial akumulues në Gazivodë (Ujman). Sasia bruto e ujit të akumuluar në këtë liqe, atëherë kur niveli i ujit arrin në kuotën maksimale është 350.000.000 m³.

Tabela 6 Stacionet e pompimit

Nr.	Emri dhe lokacioni	Fuqia e pompave	Kapaciteti l/s
1	Batllavë-Fabrika Shkabaj	3x800	950
2	Besi		5
3	Besi Bërnice	2x550	800
4	Badovc-Fabrika Badovc	2x200	550
5	Parku i Qytetit	2x45	300
6	Kodra e Trimave-1	1x132	200
7	Mirditë-1	1x50	200
8	Sofali-1	2x15	20
9	Bregu i Diellit	2x15	25
10	Fabrika Shkabaj	Objektet prodhuese 3x400, Millosheve 2x350, 690 Shkabaj 2x250	
11	Fabrika Shkabaj-Rezervuari Arbëri	Nuk ka pompa vetëm rezervuar	

12 Fabrika Shkabaj- Nuk ka pompa vetëm rezervuar
Rezervuari Shkabaj

Rezervuarët

Rezervuarët, në total kanë një vëllim prej 56.500 m³ dhe janë pjesë e furnizimit me ujë të pijes, të tilla janë edhe stacionet e pompave që janë në pjesët e ndryshme të Prishtinës.

Tabela 7 Kapaciteti i rezervuarëve
Rezervuarët

Numri	Emri dhe lokacioni	Kapaciteti (m³)
1	Arbëri-Prishtinë	15000
2	Shkabaj-Prishtinë	10000
3	Mirditë-1-Prishtinë	700
4	Mirditë-2-Prishtinë	10000
5	Mirditë-3-Prishtinë	7500
6	Kodra e Trimave-1-Prishtinë	5000
7	Kodra e Trimave-2-Prishtinë	7500
8	Vreshta-Prishtinë	1000
9	Gërmi-Prishtinë	32
10	Sofali-Prishtinë	500
11	Bardhosh-Prishtinë	50
12	Albanik-Podujevë	7000
13	Fabrika Shkabaj	

Konsumatorët

Tabela 8 Numri i konsumatorëve sipas veprimtarisë (Burimi: KRU Prishtina)
Elementet

	NJOU
Nr. i konsumatorëve në amvisëri	73,476
Nr. i konsumatorëve në biznese të vogla	9590
Nr. i konsumatorëve në biznese të mëdha	1,022
Nr. i konsumatorëve në institucione	501
Nr. total i konsumatorëve	84,589

Pjesëmarrja e numrit të konsumatorëve sipas kategorive në totalin e numrit të konsumatorëve

% e konsumatorëve në amvisëri	86.86%
% e konsumatorëve në biznese të vogla	11.34%
% e konsumatorëve në biznese të mëdha	1.21%
% e konsumatorëve në institucione	0.59%
% totale e konsumatorëve	100.00%

Kategorizimi dhe struktura në përqindje e konsumatorëve të KRU Prishtina SH.A. sipas raportit të planit të biznesit 2021-2023 (gjatë vitin 2020) është në tabelën vazhduese:


Aktualisht ndërmarrja nuk ka informacion se sa është numri i konsumatorëve të lidhur ilegalisht në rrjetin e ujësjetës dhe të atyre konsumatorëve që faturohen sipas leximit të ujëmatësit, por që kanë lidhur ujin jashtë ujëmatësit. Ndërmarrja vlerëson, se numri i konsumatorëve të kyçur ilegalisht nuk tejkalon 4% nga numri total i konsumatorëve që marrin shërbim.

Në Komunën e Prishtinës furnizimi me ujë përcillet me probleme të shumta. Aspekti i furnizimit me ujë është njëri ndër problemet më të theksuara, për arsye të mungesës së ujit dhe infrastrukturës së dobët.

KRU Prishtina, e cila është përgjegjëse për furnizim me ujë për qytetaret e Komunës së Prishtinës me kapacitete aktuale që posedon, nuk arrin të sigurojë sasinë e ujit të nevojshëm për qytetarët, e si rezultat i saj, reduktimet e furnizimit me ujë janë të larta, ku në pjesë periferike të qytetit niveli i reduktimeve arrin deri 6 orë në ditë. Po ashtu, problem tjetër që çon deri në niveli të tillë të reduktimit është infrastruktura e dobët e ujësjellësit në zona të caktuara, ku diametri i gypave nuk i përmbush kërkesat për furnizim me ujë dhe si rezultat i saj kemi kolapsim të rrjetit të ujësjellësit. Shqetësim tjetër i theksuar janë edhe humbjet e ujit në rrjet, si pasojë e keqpërdorimeve me kyçje ilegale dhe dëmtimit të rrjeteve të vjetra të sistemit të ujësjellësit.

2.5.1.3. Inventari i infrastrukturës ekzistuese - Mbulueshmëria

Bazuar në profilin dhe gjendjen aktuale mbulueshmëria e vendbanimeve rurale me rrjet të ujësjellësit nga 42 vendbanime që ka Prishtina, sipas zonave kadastrale, 19 vendbanime rurale posedojnë rrjet të ujësjellësit me ujë të pijes që menaxhohen nga KRU Prishtina, ndërsa 23 vendbanime nuk kanë rrjet të ujësjellësit dhe këto vendbanime ujin e sigurojnë nga pusët individuale. Zona urbane ka një mbulueshmëri të mirë me rrjet të ujësjellësit me rreth 95% të zonës urbane, e cila është e mbuluar me rrjet dhe qytetarët kanë qasje në ujë të pijes, ndërsa sa i përket zonës rurale, gjendja në aspektin e shtrirjes së gypave të ujësjellësit është më e vogël, ku përqindja e mbulueshmërisë është rreth 43.90%. Në aspektin social një numër prej 5628 banorëve nuk kanë rrjet të ujësjellësit në formë të organizuar, si e tillë komuna do të planifikoj zgjerimin e rrjetit edhe në vendbanimet që nuk kanë rrjet, por me prioritet më të lartë për ato vendbanime që kanë numër më të madh të banorëve si: Maramori, Koliqi, Tenezhdolli, Zllatari etj.



Grafika 5 Mbulueshmëria me rrjet të ujësjellësit sipas vendbanimeve

2.5.1.4. Gjendja e rrjetit të ujësjellësit në Komunën e Prishtinës

Rrjeti i ujësjellësit në Komunën e Prishtinës nuk është në gjendje më të mirë të mundshme, pasi që në zona të caktuara të qytetit ende ekziston rrjeti i vjetër i ndërtuar 50 vjet më parë. Rrjete të atëhershme që përbehen nga asbest çimento, material i cili është shumë i dëmshëm për shëndetin e njeriut. Gypat datojnë nga vitet '50. Si pasojë e vjetërsisë, ka dhe humbje relativisht të larta, rreth 50% janë humbje teknike dhe humbje komerciale.

Menaxhimi i sistemit të furnizimit me ujë të pijes dhe ujëra të zeza, bëhet nga kompania publike Ujësjellësi Rajonal Prishtina, i cili ofron shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza në tetë komuna.


Gypat kryesor që sjellin ujin nga Liqeni i Batllavës dhe i Badovcit janë gypa të përbërë nga çeliku, me një diametër 900 mm respektivisht 600 mm në një gjendje të mirë fizike.

Rrjeti i ujësjellësit në përbërje primare dhe sekondare ka materialet nga çeliku, PVC, AC, HDPE dhe PE-100-RC, ku sipas kalkulimeve të marra nga Autoriteti Rregullativ dhe KRU Prishtina, na del me përbërje: Rrjeti Primar 80% është nga materiali i çelikut, 15% nga materiali HDPE dhe Rrjeti Sekondar 5% Çelik , 5%PVC , 35% AC , 35% HDPE, 20% PE-100-RC.

2.5.1.5. Furnizim me ujë të pijes⁹

Zona e shërbimit me ujë në fushëveprimtarinë e KUR Prishtina, për sa i përket shkallës së mbulueshmërisë me shërbime, numrit të konsumatorëve, profilin të konsumatorëve, rritjes së numrit të banorëve, rritjes së zhvillimit ekonomik, mënyrës së përpunimit dhe distribuimit të ujit, është shumë e ndryshueshme dhe e komplikuar, duke marrë parasysh zhvillimet e shpejta të ndërtimit në zona të reja, si Prishtina e Re, Kodrina etj.

Zona e shërbimit, kryesisht ballafaqohet me mosharmonizimin e planeve zhvillimore të komunës dhe planeve strategjike KRUP.




Grafika 6 Trendet e rritjes së shërbimeve me furnizim me ujë të pijshëm për qytetarët e Prishtinës

Krahas rritjes së numrit të popullatës në zonën e shërbimit që është mbi mesataren e rritjes në Republikën e Kosovës, KRUP Prishtina do t'i kushtojë kujdes të shtuar edhe përfshirjes sa më të madhe të banorëve në rrjetin e furnizimit.

2.5.1.6. Përpunimi dhe distribuimi i ujit


Problem themelor që rëndon afarizmin e rregullt të ndërmarrjes, është përcaktuar sasia e ujit që humbet, qoftë si humbje teknike apo si humbje komerciale. Në grafikonin në vazhdim është paraqitur trendi mujor i sasisë së ujit të përpunuar dhe sasisë së ujit të adresuar tek konsumatorët përmes faturave mujore të shërbimit. Sipas grafikonit, sasia më e madhe e ujit të përpunuar është në muajt e verës, ku kërkesat për ujë janë më të mëdha me një përqindje prej 9,50 apo 3,338,016 m³, total për punim dhe distribuimi i ujit i KRUP për Komunën e Prishtinës është 34,841,309 m³.

⁹ Plani i biznesit i KRU Prishtina 2019-2020.



Grafika 7 Përqindja e përpunimit të ujit të pijshëm, 2019

Cilësia e përgjithshme e ujit të pijshëm në Kosovë, por e dhe në Prishtinë që u ofrohet konsumatorëve nga KRU-Prishtina dhe që monitorohet nga Qendra e Ujit e IKSHPK-së në kuadër të përgjegjësi të saj për monitorim të jashtëm të përcaktuara në UA 16/2012, ka arritur një përputhshmëri me 99.20% sa i takon standardeve mikrobiologjike të cilësisë së ujit, ndërsa 98.00% sa i takon standardeve kimike, duke rezultuar në një nivel të përgjithshëm të përputhshmërisë prej 98.30%. Kjo shkallë e përputhshmërisë është bazuar në rezultatet e testeve të bëra nga laboratorët rajonal të Shëndetësisë Publike (QRSHP).



Harta 12 Infrastruktura teknike - Rrjeti i ujësjellësit

2.5.1.7. Vlerësimi i nevojave për të ardhmen

Sipas Udhëzimit Administrativ për norma dhe standarde të planifikimit hapësinor, janë përcaktuar kërkesat për ujë për kokë banori, ujë për shfrytëzim për nevojat konsumuese, ujë për pije dhe amvisëri, të gjitha janë radhitur sipas kategorisë:

- për vendbanime ≥ 100001 banorë: ≥ 300 litra/banor;

- për vendbanime $\geq 20001-100000$ banorë: $\geq 250-300$ litra/banor; për vendbanime $\geq 20001-100000$ banorë: $\geq 200-250$ litra/banor; për vendbanime $\geq 5001-20000$ banorë: $\geq 150-200$ litra/banor; për vendbanime < 5000 banorë: $\geq 100-150$ litra/banor.

Për mbulimin e këtyre nevojave, komuna në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të menaxhimit të furnizimit me ujë, duhet planifikuar zhvillimi i resurseve të reja ujore, si vijon:

Duke u bazuar në projeksionet (mesatare) e numrit të banorëve për vitin 2031 (8 vjet) prej 290,509 banorë, me normë të përdorimit 150 l/d/b (sipas normave teknike të planifikimit hapësinor) për zona rurale. Pas kalkulimeve nevojitet të ngriten kapacitetet ekzistuese të furnizimit me ujë, sipas projeksionit (skenarit mesatar) prej së paku $Q_{max} = 6791.0 \text{ m}^3/\text{ditë}$ apo $Q_{max} = 138.0 \text{ l/s}$ dhe të ndërmerren veprimet e nevojshme, për të eliminuar humbjet që shkakton rrjeti i vjetërsuar i ujësjellësit.

Gjersa për të plotësuar nevojat afatgjate të banorëve për 30 vjet të ardhme, komuna duhet të lartësojë kapacitetet ekzistuese në $Q_{max} = 9329.0 \text{ m}^3/\text{ditë}$ apo 188.0 l/s , për të furnizuar me ujë të gjitha vendbanimet rurale.

Duke u bazuar në projeksionet për numër të banorëve për vitin 2031 (8 vjet), prej 290,509.0 banorë (skenari mesatar), me normë të përdorimit 150 l/d/b (sipas normave teknike të planifikimit hapësinor) për zonën urbane. Pas kalkulimeve, nevojiten të ngriten kapacitete ekzistuese të furnizimit me ujë sipas projeksionit (skenarit mesatar) prej së $Q_{max} = 142924.0 \text{ m}^3/\text{ditë}$ apo $Q_{max} = 550 \text{ l/s}$ dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të eliminuar humbjet që shkakton rrjeti i vjetërsuar i ujësjellësit.

Për të plotësuar nevojat afatgjate të banorëve për 30 vjet të ardhme me numër të banorëve 340293.0 dhe shtim të popullatës prej 2 % me normë të përdorimit $N_p 300 \text{ l/d/b}$ (apo skenarit, me numër total 616394 banorë, komuna duhet të lartësojë kapacitetet ekzistuese në $Q_{max}=212377.0 \text{ m}^3/\text{ditë}$ apo $Q_{max} = 4570 \text{ l/s}$, për të furnizuar me ujë gjithë zonën urbane.

Pra, marrë parasysh që ngritja e kapaciteteve prodhuese të fabrikës së ujit në Shkabaj prej 700 l/s, ndërrimi i gypave të rrjetit ekzistues dhe i rezervuarëve e klorinatorëve sipas Direktivës së BE-së për ujë të pijes (98/83/EC) është prioriteti më i lartë i komunës, por buxheti i komunës për investime është i kufizuar, për ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit.

Për të monitoruar humbjet në rrjetin e ujësjellësit, nevojitet të instalohen ujëmatësit zonal brenda qytetit dhe vendbanimeve rurale. Zonat e burimeve nuk janë të mbrojtura sipas Udhëzimit Administrativ për Zonat e Mbrojtura Sanitare, kështu që nevojitet të zbatohen masat mbrojtëse.

Kapacitetet e nevojshme të infrastrukturës së zgjeruar apo të re

Sipas analizës së vlerësimit të gjendjes së infrastrukturës së ujësjellësit, numrit të prognozuar të banorëve për secilin vendbanim deri në vitin 2028, përfshirë edhe banorët jorezident, kërkesës mesatare sipas udhëzimit administrativ për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, ndërtimit të hovshëm të njësive banesore si dhe ndërtimit të lagjeve me ndërtime individuale, komuna ka nevojë që për **ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme të furnizimit me ujë në të gjithë komunën deri në vitin 2031 të bëjë:**

- Rritjen e kapaciteteve të rezervuarëve, kaptazheve, fabrikave për përpunimin e ujit dhe ndërtimin e rezervuarëve të rinj në zonat e reja të zhvillimit të qytetit dhe të fshatrave;
- Rehabilitimin e sistemit të ujësjellësit të Prishtinës.

Për zvogëlimi dhe monitorimin e humbjeve të ujit të pijshëm në rrjetin ekzistues për 5% çdo vit:

- Studimi i fizibilitetit për rrjetin e ujësjellësit të Prishtinës dhe fshatrave (mundësia e identifikimit dhe e planifikimit të vendosjes së ujëmatësve zonal);
- Zëvendësimi (ndërtimi) i gypit transportues nga materiali i çelikut në materiale standarde PE- 100-RC apo të ngjashme nga Liqeni i Batllavës deri tek rezervuari në Arbëri;
- Zëvendësimi (ndërtimi) i gypit transportues me material të çelikut në material standard PE-100- RC apo të ngjashme nga Liqeni i Badovcit deri tek rezervuari në Mirditë/Velani;

- Zëvendësimi (ndërtimi) i gypit të çelikut nga stacioni i pompave në Mirditë/Velani në drejtim të Rezervuarit Kashagi;
- Zëvendësimi (ndërtimi) i rrjetit të vjetër nga AC në PE-100-RC me sistem të ri në disa rrugë të qytetit;
- Ndërtimi i pusëve dhe krijimi i zonave matëse të reja në zonën urbane dhe në zonat rurale (montimi i ujëmatësve zonal të mençur dhe mundësi të lidhjes me data logger);
- Hapje e pusëve të reja për rritje të kapacitetit të ujit në zonat rurale;
- Riparimi dhe ndërtimi i sistemeve të ujësjellësit në zonat rurale;
- Mbrojtja e zonave të burimeve të ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore.

Rritja e mbulueshmërisë me shërbime të furnizimit me ujë në zonat pa shërbime:

- Shtrirja e infrastrukturës me rrjet të ujësjellësit në vendbanimet rurale që kanë mungesë të furnizimit me ujë;
- Ndërtimi i rrjetit të ri të ujësjellësit në zonat e reja të qytetit me sisteme të ujësjellësit SMART (sisteme të mençura) me lexim dhe kontrollim elektronik;
- Hapje e pusëve të reja për rritje të kapacitetit të ujit në zonat rurale;
- Riparimi dhe ndërtimi i sistemeve të ujësjellësit në zonat rurale;
- Studimi i fizibilitetit-rritja e kapaciteteve akumuluese të ujit: (pellgu i Lumit Prishtevka dhe i Lumit Vellusha);
- Hidrosistemi i Iber Lepencit.

Nevojat zhvillimore për të ardhmen për furnizim me ujë:

- Rehabilitimi dhe zgjerimi i sistemit të ujësjellësit në zona të reja të zhvillimit ndërtimor;
- Hapja e pusëve të reja në disa vendbanime rurale;
- Rehabilitimi i stacioneve të pompave;
- Rritja e vëllimit të rezervuarëve dhe ndërtimi i rezervuarëve të rinj;
- Mbrojtja e burimeve sipërfaqësore dhe nëntokësore të ujit;
- Zëvendësimi (ndërtimi) i gypave të vjetër AC, Çelik me PE-100-RC dhe zgjerimi i rrjeteve primare të reja në qytet;
- Ndërtimi i rrjeteve të reja në të gjitha fshatrat, ku nuk ka rrjet të ujësjellësit;
- Krijimi i zonave dhe nënzonave për vendosjen e matësve të ujit (DMA), për menaxhimin e humbjeve teknike dhe financiare të ujit;
- Studimi i fizibilitetit, rritja e kapaciteteve akumuluese të ujit: (pellgu të Lumit Prishtevka dhe Lumit Vellusha);
- Studim i fizibilitetit mbi rrjetin e ekzistues të ujësjellësit, duke përfshirë planifikimin dhe ridizajnimin e rrjetit primar të rrjetit të ujësjellësit (modelimi hidraulik) për qytetin.

Konkluzionet e përgjithshme për ujësjellësin-Të gjeturat kyçe

Pjesa më e madhe e qytetarëve në zonën rurale 50% e tyre nuk kanë qasje në rrjetin e ujësjellësit, pra janë të privuar nga kjo e drejtë elementare, ndërsa pjesa urbane ka mbulueshmëri 95%. Furnizimi me ujë nuk është në gjendje të mirë, ka reduktime të theksuara, sidomos gjatë sezonit të verës, ku reshjet janë të vogla dhe niveli i Liqenit të Badovcit dhe të Batllavës zvogëlohet, gjendja si e tillë nuk arrin të bëjë furnizimin konstant të qytetarëve me ujë të pijes.

Infrastruktura e rrjetit është e dobët, sidomos në pjesën e vjetër të qytetit, ku infrastruktura është ndërtuar shumë vite më parë. Këta gypa janë të përbërë nga materialet e AC, të cilët nuk preferohen të përdoren për furnizim të qytetarëve me ujë. Nga raportet e KRU Prishtina, humbjet e ujit janë në nivel të lartë si pasojë e vjetërsisë së infrastrukturës, kyçjeve ilegale si dhe mungesës së ujëmatësve zonal, të cilët do të monitoronin ujin e shpenzuar në mënyrë të saktë. Përveç humbjeve të ujit dhe mungesës, në bazë të analizave gjejmë edhe keqpërdorime të mëdha të ujit, duke shfrytëzuar atë për ujitje në bujqësi apo pastrim të sipërfaqeve publike.

2.5.2. Kanalizimi

Prishtina ka sistem të largimit të ujërave të ndotura me mbulueshmëri përrreth 95% të popullatës, por nuk janë të kontrolluara dhe të sistemuara, dhe në të njëjtën kohë nuk ka sistem të trajtimit të ujërave të zeza. Sistemi i largimit të ujërave të ndotura në qytet komplementohet me sistemet e ngjashme në zona rurale, ku ende nuk e ka të mbuluar zonën as 50% në vendbanimet rurale.

Dy lumenjtë kryesor janë Sitnica dhe Llapi. Sitnica është pranuesi kryesor i kanalizimeve nga të gjitha vendbanimet e Prishtinës, prandaj shkalla e ndotjes është mjaft e lartë. Vetëm tri fshatra kanë një sistem primar të trajtimit të ujit, i cili gjendet me lokacion në fshatin Mramor.

- Gypi prurës në impiant është 150 mm,
- Kapaciteti i impiantit është 2400 PE (banorë ekuivalent),
- Maksimumi ditor i ujërave të ndotura në hyrje $Q_d = 500 \text{ m}^3/\text{dite} = 5,78 \text{ l/s}$.

Impianti përbëhet nga dy SBR reaktorë (Sequencing Batch Reactors). Procesi i trajtimit kontrollohet përmes kompjuterëve industrial, uji i trajtuar me gravitet shkarkohet në receptor.

Ndërsa qyteti dhe pjesët tjera nuk i trajtojnë fare ujërat e zeza. Konfiguracioni i terrenit bën të mundur që kanalizimi të shkojë në dy qytetet fqinje, Fushë Kosovë dhe Obiliq. Largimi i kanalizimeve në Prishtinë bëhet në mënyrë gravitacionale dhe dy mbledhësit kryesorë janë lumenjtë Prishtina dhe Vellusha. Një pjesë e zonës urbane shkarkon kanalizimin nëpërmjet Kodrës së Trimave që drejtohet për në fshatin Shkabaj.

Qasja e qytetarëve në rrjetin e kanalizimit në zonën rurale është më e vogël, në raport me zonën urbane, ku 50% e banorëve nuk gëzojnë të drejtën e qasjes në rrjet të kanalizimit.

KRU Prishtina, në gjithë zonën e shërbimit ka në shfrytëzim 1093 km të rrjetit primar të dimensioneve dhe materialeve të ndryshme. Në të shumtën e rasteve, ky rrjet është i përzier edhe me kanalizimin e ujërave atmosferike. Ndërmarrja përmes personelit, mekanizimit dhe pajisjeve teknike që posedon, bën: pastrimin, deblokimin dhe sanimin në çdo kohë dhe në çdo vend në zonën e shërbimit të të gjitha defekteve, bllokimeve dhe pengesave tjera.

Komuna e Prishtinës në vitin 2018 ka inauguruar fabrikën për trajtimin e ujërave të zeza në fshatin Mramor, i cili ka një kapacitet prej 2400 PE, ku maksimumi i hyrjeve ditore është $500 \text{ m}^3/\text{dite} = 5,78 \text{ l/s}$, impiant i cili përmbush nevojat për trajtimin e ujërave të zeza, për një zonë të caktuar të Prishtinës, ndërsa pjesa më e madhe e komunës, ujërat e zeza i shkarkon në kuadër të degëve të lumenjve dhe vazhdojnë tutje.

Sa i përket problemeve në aspektin e menaxhimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit të kanalizimit gjatë vitit 2018 janë paraqitur 3696 raste të bllokimeve në kanalizim, ku gjatë kësaj periudhe janë kryer gjithsej 3892 intervenime në deblokim të kanalizimit, pastrim të pusetave dhe vendosje të kapakëve të pusetave në gjithë zonën e shërbimit të KRUP.

Rrjeti i kanalizimit në aspektin e mirëmbajtjes ka probleme dhe sfida, duke pasur parasysh se vetëm në vitin 2018 ka pasur mbi 3696 raste të bllokimeve të rrjetit në zona të caktuara si dhe dëmtime të shumta të pusetave.


2.5.2.1. Inventari i infrastrukturës ekzistuese - Mbulueshmëria

Mbulueshmëria e vendbanimeve me rrjet të kanalizimit në Komunën e Prishtinës nga 42 vendbanime në zonën rurale, 19 vendbanime posedojnë rrjet të kanalizimit, pra ujërat e ndotura të 23 vendbanimeve derdhen në lumenj apo hapësira të ndryshme natyrore.

Aspekti i mbulueshmërisë në grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza në Komunën e Prishtinës nuk është në gjendje të mirë, duke pasur parasysh se mbi 54% e vendbanimeve nuk posedojnë rrjet të kanalizimit të fekaleve.

Në aspektin social, një numër prej 5628 banorëve, nuk kanë rrjet të kanalizimit në formë të organizuar, për një problem të tillë, komuna duhet të planifikojë zgjerimin e rrjetit edhe në vendbanimet që nuk kanë rrjet, por me prioritet më të lartë për ato vendbanime që kanë numër më të madh të banorëve, si: Koliqi Tenezhdolli, Zllatari etj.

Tabela 9 Mbulueshmëria me rrjet të kanalizimit sipas vendbanimeve



2.5.2.2. Ndotja e lumenjve dhe shkarkimet e ujërave të zeza

Komuna e Prishtinës nuk ka impiant për trajtimin e ujërave të zeza, i cili do të trajtonte ujërat e zeza për gjithë territorin e komunës. Mungesa e impiantit i detyron që, ujërat e zeza të shkarkohen në lumenjtë, të cilët shtrihen në territorin e komunës.

Tabela 10 Ndotja dhe derdhja e ujërave të zeza në lumenjtë (Burimi: AMMK)

Komuna	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Vendshkarkimi
Prishtinë	Qyteti	43 0245	Prishtevka
	Bardhosh	2 150	Lumi Llap
	Barilevë	4 200	Lumi Llap
	Besi	907	Lumi Llap
	Hajvali	6 000	Gračankë
	Përroi i Njelmët	1 000	Ujëra nëntokësore
	Prugoc-Leban	800	Lumi Llap
	Shkabaj	1 500	Sitnicë
	Trudë	540	Lumi Llap
	Vranidoll	870	Lumi Llap

Siç shihet nga tabela, lumi më i ngarkuar në Komunën e Prishtinës është padyshim Prishtevka, i cili mund të thuhet, se është shëndërruar në rrjedhë lumore, pikërisht nga ujërat e zeza të mbi 430000 banorëve të kryeqytetit. Lumi i dytë më i ngarkuar është Llapi me rreth 9450 banorë, Graçanka me 6000 banorë dhe Sitnica me 1500 banorë. Në ujëra nëntokësore shkarkojnë ujërat e zeza rreth 1000 banorë.

2.5.2.3. Vlerësimi i nevojave për të ardhmen

Bazuar në vlerësimin e gjendjes ekzistuese të infrastrukturës së kanalizimit të ujërave të zeza dhe atmosferike, numrit të prognozuar të banorëve për secilin vendbanim deri në vitin 2028, përfshirë edhe banorët jorezident, ndërtimit të hovshëm të njësive banesore si dhe ndërtimit të lagjeve me ndërtime individuale, janë identifikuar 23 vendbanime, të cilat kanë nevojë për rrjete të reja të ujërave të ndotura.

Për gjithë vendbanimet e cekura (të reja) kapaciteti i gypave, si për ujërat e ndotura, atmosferike dhe ato industriale, projeksioni i tyre duhet të bëhet sipas normave teknike të planifikimit hapësinor. Në komunë është i planifikuar ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza, gjithashtu edhe ndërtimi i kolektorëve për ndërtimin e impiantit në dalje të Fushë-Kosovës.

Në mënyrë që të mënjanoen problemet ekzistuese në rrjetin e kanalizimit, pjesa e rrjetit që mbledh ujërat e zeza dhe atmosferike, duhet të ketë rrjet të ndarë për mbledhjen e tyre.

Duke marrë parasysh që ujërat e zeza ndotin lumenjtë, komuna duhet të ndërtojë impiante për trajtimin e ujërave të zeza. Bazuar në studimin e WYG International, të financuar nga Komisioni Evropian, komuna ka nevojë urgjente për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura (të zeza).

Sipas Studimit të Fizibilitetit, këto projekte janë paraparë të ndërtohen në faza:

Faza 1 Impianti në (Fushë Kosovë dhe Obiliq) + kolektorët kryesor + interceptorë primar të kanalizimeve në pjesët urbane. Qëllimi është për të marrë të gjitha ujërat e zeza ekzistuese të larguara nga lumenjtë Prishtevka, Vellusha dhe Matiçan, për t'i transferuar në Impiant (WWTP).

Faza 2-Zgjerim i sistemeve të kanalizimeve në vendet rreth pjesëve urbane, ku nuk ka kanalizim, shtimi i konsumatorëve të rinj.

Faza 3-Zëvendësimi dhe përmirësimi i kanalizimeve ekzistuese në pjesët urbane për të siguruar kapacitet adekuat dhe zvogëlimin e derdhjes së ujit të shirave në lumenj, me gypa të PESN 8, PESN 10, PESN 12.

Kapacitetet e nevojshme të infrastrukturës së zgjeruar apo të re

Bazuar në kapacitetet ekzistuese të shkarkimit dhe kërkesën mesatare 100-150 litra/banor për vendbanime < 5000 banorë: dhe për vendbanime 50001-100000 banorë 250-300 litra/banor.

Komuna ka nevojë për secilin vendbanim që do të rritet, duhet të planifikohet edhe një dimensionim i ri i tërë sistemit të kanalizimit të ujërave të ndotura, duke u bazuar në UA për Normat Teknike të Planifikimit.

Infrastruktura e dobët e kanalizimit ka nevojë për investime të reja, kryesisht në zonën urbane dhe në disa zona rurale:

- Ndërtimi i kolektorëve në drejtim të impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura;
- Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në zona industriale dhe ekonomike;
- Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza;
- Zëvendësimi i kolektorëve ekzistues në zonën urbane me qëllim të krijimit të një sistemi funksional;
- Kolektori kryesor për zonat periferike të qytetit;
- Kolektorët kryesor në fshatrat përreth;
- Zëvendësimi i gypave të vjetër dhe zëvendësimi i tyre me gypa të rinj në zonën urbane;
- Zëvendësimi i rrjeteve të kanalizimit në zonat rurale;
- Ndarja e ujërave të ndotura nga ato atmosferike në pjesët, ku sistemi është i përbashkët;
- Ndërtimi i kanalizimeve atmosferike në zonat potencialisht të vërshuara;
- Studimi i fizibilitetit për ujërat atmosferike dhe trajtimi i tyre.

Ndarja duhet të bëhet me identifikimin dhe hartimin e një projektit kryesor, i cili do të bëhet në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës dhe KRU Prishtina.

Kapacitetet e nevojshme të infrastrukturës së zgjeruar apo të re

- Infrastruktura e dobët e drenazhimit, e cila ka nevojë për investime të reja, kryesisht në zonën urbane dhe në disa zona rurale;
- Ndërtimi i rrjetit të ujërave atmosferike dhe të drenazhimit në gjitha rrugët e reja, të cilat planifikohen të ndërtohen në zonën urbane;
- Trajtimi-shfrytëzimi i ujërave atmosferike (për ujitje dhe nevoja tjera të qytetarëve);
- Zëvendësimi i gypave të vjetër me të rinj në zonën urbane;
- Ndërtimi i rrjeteve të kanalizimit atmosferik në zonat rurale;
- Ndarja e ujërave të ndotura nga ato atmosferike në pjesët ku sistemi nuk është i ndarë;

- Ndarja do të bëhet me identifikimin dhe hartimin e një projekti kryesor, i cili do të bëhet në bashkëpunim me komunën dhe KRU Prishtina.

Sfidat kryesore në menaxhimin e kanalizimit

- Ofrimi i shërbimeve me rrjet të kanalizimit për gjithë qytetarët e komunës;
- Eliminimi i pikave shkarkuese të ujërave të zeza;
- Ndërtimi i impiantit për trajtim të ujërave të zeza dhe kolektorëve;
- Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në zonat problematike;
- Kalimi i menaxhimit të rrjetit të kanalizimit në kuadër të KRU Prishtina;
- Mundësia e shtrirjes së rrjetit të kanalizimit atmosferik dhe ndarja e tyre nga ujërat e zeza (të ndotura).


Nevojat zhvillimore për të ardhmen

- Finalizimi i impiantit dhe i kolektorëve për trajtimin e ujërave të zeza në Komunën e Prishtinës;
- Kyçja e të gjitha rrjeteve të kanalizimit në kuadër të kolektorëve;
- Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrjeteve të reja dhe atyre ekzistuese;
- Zgjerimi i shërbimeve me kanale për largimin e ujërave atmosferike.

2.5.3. Kanalizimi i ujërave atmosferik

Vetëm 20% e zonës urbane (qytetit) nga e gjithë zona, e ka të ndarë rrjetin e ujërave atmosferike nga ato të zeza, pjesa tjetër e qytetit nuk kanë rrjet të kanalizimit atmosferik fare.

Për arsye të mosekzistimit të një ndarjeje të ujërave të zeza nga ato atmosferike, në pjesë të caktuara, ku shtrihen rrugët periferike të qytetit, në shumë raste krijohen vështirësi, deri në përmytje (vërshime) të mëdha, si pasojë e të reshurave të mëdha të shiut. Gjithashtu, duke u bazuar në raportet sektoriale, për vendbanimet rurale (fshatrat), shumica e tyre kanë kanalizim të përbashkët.



Harta 13 Infrastruktura teknike - Rrjeti i kanalizimit fekal dhe atmosferik

2.5.3.1. Vlerësimi i nevojave në të ardhmen (Infrastruktura e kanalizimit atmosferik)

Me përjashtim të zonës urbane që ka rreth 10% rrjet të kanalizimit atmosferik, të gjitha vendbanimet tjera nuk kanë rrjet të kanalizimit atmosferik (drenazhimit). Një pjesë e rrjetit që shtrihet

në rrugët periferike të zonës urbane, rrjeti ekzistues krijon vërshime gjatë të reshurave të mëdha të shiut, për arsye se nuk ekziston një ndarje e mbledhjes së ujërave të zeza dhe të reshurave atmosferike. Problemet më të shpeshta, me të cilat ballafaqohet ky rrjet janë: mungesa e një plani gjithëpërfshirës, mungesa e mirëmbajtjes së duhur, uzurpime të ndryshme nga qytetarët e papërgjegjshëm, kyçja e ujërave të zeza në këto kanale etj. Të gjitha problemet e përmendura më sipër janë shkaktarë të drejtpërdrejt të dëmtimit të vazhdueshëm të kanaleve ekzistuese. Në këtë situatë, edhe reshjet më të vogla atmosferike janë rrezik permanent për derdhjen e pakontrolluar të ujërave nga kanalet, duke vërshuar dhe dëmtuar seriozisht rrugët dhe hapësirat e ndryshme të qytetit.

Konkluzionet e përgjithshme për kanalizimin-Të gjeturat kyçe

Në zonën rurale 30% e tyre nuk kanë qasje në rrjetin e kanalizimit fekal, të cilët janë të privuar nga kjo e drejtë elementare, ndërsa pjesa urbane vetëm 5%.

Infrastruktura e rrjetit ekzistues është e dobët, sidomos në pjesën e vjetër të qytetit, ku infrastruktura është ndërtuar shumë vite më parë. Dimenzionimi jo adekuat i tubacioneve dhe vjetërsia e tyre, janë ato të cilat shkaktojnë probleme në funksionimin e rrjetit.

Mbulueshmëria me rrejt të kanalizimit atmosferik në zonën urbane është e vogël, vetëm 10% e rrjetit është e ndarë nga ujërat e zeza, ndërsa pjesa tjetër është e përzier.

Kanalizimi i ujërave të ndotura dhe ato atmosferike përveç se nuk është i ndarë në kolektorët primar dhe sekondar në rrugët e qyteti, i cili shkon në drejtim të ITUN, gjithashtu nuk është i ndarë edhe në oborret (parcelat) e objekteve kolektive dhe individuale.

Shkarkimi i ujërave industriale bëhet në forma të pakontrolluara dhe në shumicën e rasteve nuk trajtohet fare.

Ujërat e ndotura, të cilat shkarkohen nga zonat përreth liqeneve janë të rënda, bizneset e ndryshme përreth liqeve nuk bëjnë trajtime adekuate dhe me standarde të kërkuara sipas direktivave të BE-së dhe është duke u krijuar ndotje e vazhdueshme në vazhdimësi.


2.5.4. Ujitja

Rreth 42.226 ha të tokave bujqësore të Kosovës ujitën. Sipërfaqet e tokave përgjatë lumenjve të mëdhenj janë më të përshtatshme për ujitje. Rreth 50.000 ha të tokave bujqësore janë shumë të përshtatshme për ujitje dhe rreth 100.000 ha të tjerë do të mund të ishin të favorshme me disa masa përmirësuese. Pjesa më e madhe e tokës së ujitur është në regjionin e Pejës me rreth 13.915 ha të sipërfaqes së përgjithshme të tokës së kultivuar bujqësore, ndërsa pjesa më e vogël në regjionin e Gjilanit me 1.781 ha.

Në Komunën e Prishtinës janë 9.155 ha tokë bujqësore, prej të cilave sipërfaqe të kultivuara bujqësore janë 8.508 ha, ku prej tyre sipërfaqe të ujitura janë 647 ha. Tokat bujqësore në Komunën e Prishtinës ujitën përmes kanalit të Ibër Lepencit që kalon në pjesën perëndimore të Komunës së Prishtinës dhe prek territorin e fshatrave si (Bardhosh, një pjesë të Bërnices së Poshtme, Lebanin, një pjesë të fshatit Trudë, Besi, Barilevë dhe Drenoc).

Tabela 11 Sipërfaqet bujqësore nën sistem të ujitjes

<i>Komunat</i>	<i>Sipërfaqja e ujitur (ha)</i>	<i>Sipërfaqja e përgjithshme e tokave të kultivuara bujqësore (ha)</i>	<i>Gjithsej (ha)</i>	<i>sipërfaqe</i>
<i>Prishtina</i>	<i>647</i>	<i>8,508</i>	<i>9,155</i>	



Harta 14 Infrastruktura teknike - Rrjeti i sistemit të ujitjes

Ujitja dhe kullimi janë një nga faktorët kryesor me ndikim të drejtpërdrejt në rritjen e qëndrueshme të prodhimit bujqësor në vend. Megjithatë reshjet mesatare vjetore janë të bollshme, gjatë verës bien vetëm 20% e sasisë së tyre. Për të siguruar një bilanc optimal, është e domosdoshme ujitja me 3000-5000 m³/ha dhe kullimi veçanërisht gjatë periudhës së dimrit, me një hidromodul 4-5 litra/sek/ha. Komuna e Prishtinës në aspektin hidrografik apo të burimeve ujore, është e pasur, duke ditur se në territorin e komunës kalojnë disa lumenj, kështu që mundësia e ujitjes së tokave bujqësore është e lartë. Në kuadër të komunës ekziston sistemi i ujitjes së tokave bujqësore për disa zona të caktuar, sistem i cili është i menaxhuar nga kompania regionale Ibër Lepenci. Në Komunën e Prishtinës kalojnë rreth 25,331.83 metra rrjet i ujitjes, 24533.60 metra kanal i hapur dhe 6528.60 metra tubacion, ku ujitjen rreth 647 ha tokë bujqësore.

Sistemi i ujitjes së tokave bujqësore në Komunën e Prishtinës është i ndërtuar vite me parë dhe si rezultat i saj ka probleme në funksionimin e tij në formën më të mirë. Ndër problemet kryesore, të cilat afektojnë mosfunksionimin adekuat të rrjetit të ujitjes janë zhvillimi i banimit në toka ku janë nën sistem të ujitjes. Ndër problemet me të theksuara në kuadër të ujitjes së tokave bujqësore, është ndërtimi apo shndërrimi i zonave nën sistem të ujitjes në toka ndërtimore dhe si rezultat i saj këto toka tashmë janë të pashfrytëzueshme për zhvillim bujqësor. Sipas informatave rrjeti i ujitjes së tokave bujqësore nuk është në nivel të mirë në zona të caktuara, për shkak të zhvillimeve të shumta dhe si rezultat i saj këto kanale mbyllen dhe bëhen të pashfrytëzueshme për përdorim.

2.5.4.1. Inventari i infrastrukturës ekzistuese – Mbulueshmëria

Mbulueshmëria e tokës bujqësore me rrjet të ujitjes: Mbulueshmëria me rrjet të ujitjes së tokave bujqësore është e vogël, rreth 647 ha tokë bujqësore ujitet në Komunën e Prishtinës, një nivel i ulët, duke pasur parasysh kushtet topologjike të terrenit, sasinë e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore në pjesët e rrafshit, ku toka bujqësore është e kualitetit të mirë, por në bazë të të dhënave edhe kjo sipërfaqe e pakët e cila është e ujitur është humbur në masë të madhe.

2.5.4.2. Vlerësimi i nevojave për të ardhmen

Rrjeti i sistemit të ujitjes duhet të ofrojë shërbime shfrytëzuesve në rrjet të sistemit të ujitje, në mënyrë që të krijohen kushtet optimale për ujitjen e tokës bujqësore në territorin e komunës së

Prishtinës dhe mbrojtjen e saj nga ujërat e tepërta me qëllim të shtimit të rendimenteve të prodhimeve bujqësore.

Komuna e Prishtinës duhet të rregulloj dhe përmirësoj sistemin e ujitjes në ato zona ku ka pasur ndërtime mbi sistemin e ujitjes. Duhet të shikohet në ato tokat bujqësore, ku janë ndërtuar apo shndërruar nga zonat nën sistem të ujitjes në toka ndërtimore, dhe si rezultat i saj disa lokacioneve të tokave tashmë janë të pashfrytëzueshme për zhvillim bujqësor në mungesë të rrjetit funksional, projekcioni i tyre duhet të bëhet sipas normave teknike të planifikimit hapësinor, dhe ti ofrohet mundësia e ujitjes së tokave.

Tabela 12 SWOT analiza - Ujësjellësi, Kanalizimi, Ujitja dhe Drenazhimi

Përparësitë	Dobësitë
95% e popullatës në zonën urbane furnizohet me ujë dhe 45% të asaj rurale; - Cilësia është e mirë e ujit; - Vazhdimësia e ndërtimit të kanaleve të reja; - Implanti për trajtimin e ujërave të zeza; - Qasja e gypave primare dhe sekondare në kolektorë që bart ujërat e zeza në impiant; 45% e vendbanimeve me rrjet të ujësjellësit; - Ofrimi i ujitjes optimale, përkundër kushteve minimale; - Krijimi i zonave për monitorimin e ujit - Krijimi i katër zonave DMA.	- Mosshfrytëzimi i kapaciteteve të ujit për nevoja të pijes; 5% e popullsisë në zonën urbane nuk kanë qasje në ujësjellës; 56% vendbanimeve rurale nuk kanë rrjet të ujësjellësit; - Moskrijimi i zonave për monitorimin e ujit të përpunuar dhe distribuar-krijimi i zonave-DMA; - Ende reduktim i lartë i furnizimit me ujë në ditë; - Mosshfrytëzim i burimeve ekzistuese të ujit për nevoja të qytetarëve; - Rrjeti pjesërisht i vjetër i ujësjellësit dhe gypa nga materiali AC në disa zona; - Mungesa e sistemit të akumulimit të ujërave; - Domosdoshmëria e shfrytëzimit të pompave në disa pjesë të qytetit (lagjet në zonat e larta); - Mungesa e kyçjes së disa fshatrave në rrjetin kryesor; - Shfrytëzimi jo i duhur i ujit (abuzimet); - Mungesa e koordinimit ndërmjet kompanive publike; - Rrjeti i vjetër i gypave primare dhe sekondare; - Rrjeti i vjetëruar i kanalizimit; 54% e vendbanimeve janë pa rrjet të kanalizimit; - Përzierje e rrjetit të kanalizimit me atë atmosferik; - Mungesa e rrjetit atmosferik; - Ndotja e ujit në kanalet e ujitjes; - Sipërfaqe e vogël e ujitur; - Mënyra primitive e ujitjes.

Mundësitë	Rreziqet
- Shfrytëzimi i investimeve të jashtme; - Garantët qeveritar; - Aplikimi i arritjeve teknologjike; - Trajnimi i stafit; - Studimi i fizibilitetit për rrjetin e ujërave atmosferike; - Studimi i fizibilitetit për rrjetin e ujësjellësit dhe caktimin e zonave DMA; - Ekzistenca e legjislacionit përkatës; - Ridizajnimi i sistemit të ujitjes (futja e kanaleve të hapura në tubacione); - Inkorporimi i kanaleve të reja të ujitjes në sistemin menaxhues të KRU Prishtina.	- Mos ndërrimi i gypave të vjetër të ujësjellësit; - Cenimi i kualitetit-sigurisë së ujit, si pasojë e rrjetit të vjetërsuar; - Humbjet e mëdha të ujit në rrjet; - Keqpërdorimi i ujit; - Mospjesëmarrja e komunitetit në vendimmarrje në procesin e ndërtimit të impiantit (çështja e eksproprijimit); - Politika joadekuate; - Dëmtimi i rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit dhe ujitjes.

2.5.5. Energjia elektrike

Energjia, në kushtet bashkëkohore, është një ndër resurset e pazëvendësueshme të zhvillimit ekonomik, të ngritjes dhe mbajtjes në nivel të standardit jetësor dhe mirëqenies sociale në përgjithësi. Sektori energjetik tash për tash nuk është në gjendje të bëjë furnizimin e pandërprerë gjatë 24 orëve. Bazuar në burimet nga KEK-u, nevojat për energji elektrike janë diku 320 MW, gjë që bën të konkludojmë, se furnizimi është në limitin e kërkesave. Sistemi i rrjetit elektro-energjetik nuk arrin t'i plotësojë kërkesat e banorëve, madje në shumë pjesë edhe është vjetruar.

Furnizimi i qytetit bëhet përmes 10 trafo-stacioneve:

TS-Prishtina -1, me 63+63 MVA-2 trafo; 110/35 kV

TS- Prishtina -2, me 31.5+63 MVA-2 trafo; 110/10 kV

TS-Prishtina -3, me 31.5+40 MVA-2 trafo; 110/10 kV

TS-Prishtina-4-2 trafo 150 MVA; 220/110 kV

TS-Prishtina-5, me 40+40 MVA-2 trafo me kapacitet 110/20 kV

Si dhe 45 trafostacione, të cilat furnizojnë me rrymë vendbanimet rurale, me kapacitet të pamjaftueshëm (35.6 MVA).

Kufijtë administrativ të qytetit të Prishtinës, nuk janë edhe kufij përcaktues të furnizimit dhe shpërndarjes me energji elektrike. Kjo do të thotë që nga trafo stacionet kryesore që ndodhen në territorin e qytetit, përpos fshatrave të qytetit, furnizohen edhe pjesët tjera të komunave fqinje ose anasjelltas.

Tabela 13 Kapaciteti i trafostacioneve
Emri i trafostacionit dhe vendndodhja

Prishtina 2–110 K. e Prishtinës Taukbahqe

Prishtina 2–35 K. e Prishtinës

Të dhënat teknike


110/10 kV; (31.5+63) MVA

35/10 kV; 2x (2x8) MVA

<i>Prishtina 5-K. e Prishtinës Kodra e trimave</i>	<i>110/10 (20) kV; 2x40 MVA</i>
<i>Prishtina 1- K. e Prishtinës Fabrika e amortizatorëve</i>	<i>110/10 (20) kV; 2x63 MVA</i>
<i>Prishtina 3- K. e Prishtinës Lulishtja</i>	<i>110/10 (20) kV; 2x40 MVA</i>
<i>Prishtina 4- K. e Prishtinës Hajvali</i>	<i>220/110 kV; 3x150 MVA</i>
<i>Koliq - K. e Prishtinës</i>	<i>35/10 kV; (2x2.5) MVA</i>
<i>Besi - K. e Prishtinës</i>	<i>35/10 kV; (1x4) kV</i>
<i>Badovc - K. e Graçanicës</i>	<i>35/10 kV; (2x8) kV</i>

Në territorin e qytetit të Prishtinës, brenda këtij plani, kalojnë ose ka linja të tensioneve 220 kV, 110 kV, 35 kV, 10 kV dhe 0.4 kV. Është vetëm një linjë 110 kV, e cila nisët nga TS 220/110 kV (Prishtina 4) dhe shkon në Gjilan. Linjat 35 kV që i furnizojnë trafostacionet 35/10 kV kryesisht janë të vjetra, të ndërtuara në shtylla të betonit. Që të gjitha janë linja ajrore me përçues Al/Fe 95/15 mm². Shumica prej linjave 10 kV janë të vendosura në shtylla të drurit dhe linja ajrore me përçues Al/Fe 35/6 mm.

E gjithë komuna ka një total prej 65836 konsumatorëve të regjistruar në sektorin e ekonomive familjare. Të gjitha këto lidhen në rrjetin prej 0.4 kV. Në këtë rrjet janë të lidhura 13864 metra elektrike si konsumatorë biznesi. Konsumatorët e mëdhenj të energjisë elektrike janë të lidhur me rrjetin 10 kV ose 35 kV. Këta janë të njohur gjithashtu si konsumatorë industrial. Në Prishtinë janë 276 të tillë.



Harta 15 Rrjeti elektro-energetik

Furnizimi me energji elektrike bëhet nga KEK-u përmes energjisë së prodhuar në termocentralet e Obiliqit. Furnizimi me energji elektrike është jo i qëndrueshëm dhe i pamjaftueshëm, ka ndërprerje të shpeshta të rrymës elektrike. Arsyet për këtë janë kapacitetet e kufizuara të termocentraleve të Obiliqit dhe humbjet teknike e ato administrative dhe defektet e shpeshta në rrjet. Rrjeti elektrik është i vjetruar dhe shumica e objekteve të banimit furnizohen me energji nga kabllo mbetokësore, të cilat

të shumtën e rasteve janë në gjendje të keqe dhe janë burim rreziku për qytetarë. Rinovimi i këtij sistemi të vjetruar dhe ndërtimi i kapaciteteve të reja duhet të jenë në prioritet të lartë. Ndërprerjet e shpeshta të energjisë elektrike implikojnë përdorimin e burimeve tjera të energjisë, siç janë gjeneratorët, të cilët janë gjithashtu burim i ndotjeve të ajrit dhe zhurmës së madhe.

Sipas informacioneve të siguruara nga KEK-u dhe KOST-i, aspekti i furnizimit me energji elektrike në Komunën e Prishtinës i gjithë territori i komunës ka mbulueshmëri me rrjete, që do të thotë, çdo qytetar i komunës ka qasje në energji elektrike, por përkundër qasjes në energji, ky sektor ka probleme dhe sfida në aspektin e furnizimit të rregullt me energji të qytetarëve.

Sa i përket problemeve dhe sfidave në aspektin e energjisë elektrike, si në nivelin nacional ashtu edhe komunal, është rrjeti elektrik, i cili është i vjetër, pra infrastruktura është vjetruar, duke filluar nga telat shpërndarës, të cilët janë të shtrirë pothuaj në të gjithë qytetin dhe gjendja siç janë momentalisht, është shumë e rrezikshme për qytetarët. Po ashtu shtyllat, në të cilat mbështetet rrjeti, një pjesë e madhe janë nga druri dhe në gjendje jo të mirë fizike, si rezultat i infrastrukturës së dobët çdo vit kemi humbje të jetës së njerëzve nga energjia elektrike.

Problem tjetër, i cili duhet të theksohet është rrjeti i tensionit të lartë, i cili kalon në Komunën e Prishtinës, kryesisht lagjet Sofali, Kalabri, Prishtina e Re, gjendja fizike e këtij rrjeti nuk është në nivel të kënaqshëm, edhe ky rrjet kalon mbi shtëpi banimi, pra nuk ka një tampon-zonë mbrojtëse të respektuar, si rezultat i këtyre konsiderohet rrezik i lartë për jetën e qytetarëve.

Mungesa e investimeve në sistemin e rrjetit të shpërndarjes: Investimet e pamjaftueshme në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike kanë bërë që ky sistem të mos përballojë ngarkesën në rritje, veçanërisht të mos përballojë ngarkesën në sezonin e dimrit. Kjo ka pasur për pasojë nivelin shumë të lartë të humbjeve teknike që ka rënduar vazhdimisht sistemin.

Investimet në kapacitete gjeneruese: Me gjithë faktin se komuna ka resurse të mëdha energjetike, si zona kodrinore-malore, të cilat kanë potencial për krijim të energjisë së ripërtëritshme, por nuk ka pasur asnjë investim në ndërtimin e kapaciteteve të reja apo rehabilitimin e kapaciteteve ekzistuese që do të mundësonte një furnizim stabil me energji elektrike.

Shiritat mbrojtës rreth linjave elektro-energjetike

Shfrytëzimi i shiritave rregullohet me norma teknike dhe me ligje përkatëse (UA), më tutje këto konsiderohen si zona të sigurisë dhe shërbejnë për ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e tyre në vazhdimësi.

Tabela 14 Linjat nëntokësore

Nr.	Linja kabllorike nëntokësore	Ekzistuese	Planifikuara
1	2x110 kV	16	20
2	110 kV	12	16
3	35 kV	10	10
4	20 kV	6	8
5	10 kV	4	6

Tabela 15 Linjat ajrore energjetike

Nr.	Linja ajrore energjetike	Ekzistuese	Planifikuara
1	2x110 kV	30	40
2	110 kV	20	30
3	35 kV	16	20
4	20 kV	12	15
5	10 kV	10	12

Qasja, aktivitetet e punës, përgjegjësitë dhe detyrat në këto zona janë të rregulluara me ligjin e miratuar mbi energjinë elektrike, e udhëzimet administrative mbi zonat nën dhe rreth stabilimenteve energjetike.

Bazuar nga normat që u cekën më lartë për këtë qëllim për linja energjetike kabllorike nëntokësore, duhet të sigurohen korridore, ndërsa korridoret rreth largpërçuesve, kur ndërtohen si linja ajrore është e nevojshme që t'i sigurohet një shirit mbrojtës me dimensione të përcaktuara në tabelën e mëposhtme.

2.5.5.1. Ndërtimi i rrjetit

Rekomandimet nga Plani Shtesë investues për vitet 2018-2023:

Duke u bazuar në planet zhvillimore sektoriale të hartuara si pjesë e Planit Zhvillimor Komunal, Planit Zhvillimor Urban dhe Planit Rregullues Urban të Prishtinës, poashtu rekomandimet, edhe duke marrë për bazë gjendjen ekzistuese të rrjetit energjetik dhe atij të telekomit, është analizuar në tërësi, nga të gjithat janë nxjerrë përfundime, se është i nevojshëm zgjerimi i kapaciteteve energjetike në Komunën e Prishtinës.

Rekomandimet nga Plani Shtesë investues për vitet 2018-2023:

- Rritja dhe përmirësimi i kapaciteteve të tensionit të mesëm në nënstacionet ekzistuese 110/35 kV (zgjerimi i NS 110/35 kV me transformatorë të rinj me transformim 110/10(20)kV–zgjerimi i kapaciteteve të TM 10(20) kV);
- Rehabilitimi i përgjithshëm i sistemit dhe ngritja e kapaciteteve të tensionit të mesëm për të mundësuar ndryshimin e nivelit të operimit të tensionit të rrjetit;
- Zëvendësimi i transformatorëve 10/0.4 kV me transformatorë 20(10)/0.4 kV;
- Zëvendësimi i linjave 10 kV të vjetërsuara dhe të mbingarkuara me linja të reja 20 kV;
- Zëvendësimi i shtyllave të drurit me shtylla betoni duke i zëvendësuar edhe pajisjet tjera përcjellëse 20 kV (izolatorë, konzolla etj.);
- Zëvendësimi i kabllorëve të vjetra me vaj 10 kV me kablo të reja të nivelit 20 kV;
- Zëvendësimi i përçuesëve, shtyllave dhe transformatorëve 10/0,4 kV të dëmtuar, për të qenë në pajtueshmëri me standardet dhe për të garantuar siguri publike dhe të furnizimit;
- Ndërtimi i NS 10 (20)/0.4 kV të reja në rrjetin e ngarkuar të tensionit të ulët;
- Shtimi i fuqive të transformatorëve tek ata të ngarkuar me mbi 70%, apo ndërrimi i këtyre transformatorëve me transformatorë më pak të ngarkuar;
- Rikonstruimi dhe rikonfigurimi i rrjetave 0.4 kV me prioritet në qendra të qytetit me rrjet të ri kabllor dhe me puseta.

Rregulloret e IEC, IEEE dhe ANSI për projektet e reja, linjat urbane të furnizimit me energji elektrike dhe ato telekomunikuese duhet të ndjekin të njëjtat trase dhe të ndërtohen njëkohësisht. Forma e kanalit dhe e puseta për shtrirjen e rrjetit dhe instalimeve elektrike, rekomandimet dhe rregulloret e lartshënuara, obligojnë që SEE dhe SK të realizohen në mënyrë që, në të gjitha rrugët e asfaltuara, në njërën anë të trotuarit, të rezervuar për këtë qëllim, në thellësi mbi 750 mm, të ndërtohet i ashtuquajti kanalizimi kabllorik.

Numri dhe dimensionimi i gypave fleksibil të vendosur në kanalizimin kabllorik, përcaktohet në varësi nga nevoja dhe është dashur të definohet në projektin detal zbatues. Zakonisht, një kanalizim kabllorik përmban gypa të brinjëzuar me diametër prej 100 mm, 160 mm dhe 200 mm që përforcohen me rërë.

Në këta gypa vendosen:

- Linja të tensionit 10 (20) kV me kablo XHP 49A 240 mm². Me këtë bëhet furnizimi i trafostacioneve të blinduara me herës 10 (20)/0.4 kV dhe fuqi 400 kVA, 630 kVA dhe 1000 kVA;
- Linja e tensionit 400/231V me kablo PP00 4x95 mm² për furnizimin e ndërtesave për banim kolektiv;
- Linja e tensionit 400/231V me kablo PP00 4x25 mm² ose 4x16 mm² për furnizime të ndriçimit publik dhe banimeve individuale;
- Linja të kabllorëve të komunikimit (kablo me fije optike apo STP 4x0.75 mm²);
- Përgjatë trasës së kanalizimit kabllorik duhet ndërtuar puseta me dimensione dhe forma të ndryshme sipas rastit;

- Në trasa të linjave të shumëfishta, ndërtohen puseta të kombinuara–Elektrike-Telekom.

Pusetat kanë thellësi së paku 1.8 m dhe dimensione të brendshme së paku 1.8 mx1.2 m. Puseta e përbashkët është e ndarë me mur betoni 20 cm, në atë për rrymë dhe në atë për komunikim dhe kanë hyrje (vrime) të ndara. Pusetat për kryqëzime të linjave të tensionit të ulët dhe linjave telekomunikuese, mund të ndërtohen si të ndara dhe mund të kenë edhe dimensione më të vogla (por jo më të vogla se 1.2x1.2x1.2m). Hyrja në puseta bëhet nëpër vrimën me formë rrethore me diametër së paku 75 cm. Në kapak duhet shkruar për puseta rryme–ELEKTRIKA, ndërsa për ato të komunikimit–TELEKOM.

Trafostacionet 10(20)/0.4 kV duhet të kenë fuqi të mjaftueshme për të furnizuar të gjithë konsumatorët me tension 230/400 $\pm$ 10% V. Në rast se transformatorët furnizojnë objekte me banesa kolektive, me qëllim të ruajtjes së ambientit përreth objekteve, atëherë kur të ka mundësi teknike, rekomandohet që transformatorët të vendosen në brendi të objektit të ndërtuar.

Trafostacionet e vendosur në brendi të objektit, duhet të plotësojnë kushtet teknike të parapara me standarde për objekte të tilla si vendi ku montohen trafostacionet duhet të ketë qasje për piruj, karroca, të jenë të mbrojtur nga vërshimet dhe t'u sigurohet ventilimi. Ndërkohë, duke marrë për bazë gjendjen ekzistuese, do të analizohen kërkesat dhe kushtet për furnizim të sigurt dhe cilësor me energji elektrike të konsumatorëve në Komunën e Prishtinës.

Sfidat

- Trafostacionet 35/10 kV kryesisht janë të vjetruara;
- Linjat 35 kv, 10 kv dhe pjesërisht 0.4 kV janë të vjetra dhe janë të mbingarkuara, sidomos gjatë dimrit;
- Trafostacionet 10 (20)/0.4 kV janë të mbingarkuara;
- Linjat 0.4 kV janë me shtylla të vjetra dhe përçues të mbingarkuar;
- Ekziston shpërndarje asimetrike e ngarkesave të shpenzuesit të fundit dhe mospërshtatje e tyre me trafostacione furnizuese;
- Një pjesë e shtyllave të ndriçimit publik të korodura dhe të pa galvanizuara;
- Grumbullim i kablove ABC (gërshet) dhe linjave ajrore në shtylla druri pa ndonjë rregull të caktuar;
- Gërshetimi i linjave ajrore me kablo koaksiale të ofruesve të telekomunikacionit dhe televizionit pa ndonjë rregull të caktuar.

2.5.5.2. Efiçienca e energjisë

Komuna e Prishtinës ka në dispozicion disa dokumente të rëndësishme progresive drejtë hapave konkret për efiçencë të energjisë, duke përfshirë:

- Plani komunal i veprimit për efiçencë të energjisë (PKVE) 2019-2021
- Plani i veprimit për Qytetin e Gjelbër të Prishtinës (PVQGJ) të aprovuar në vitin 2021.

Plani i Veprimit i EE për Komunën e Prishtinës analizon tre çështje kryesore: 1) situatën e furnizim-kërkesës së energjisë deri në vitin 2031; 2) strukturën institucionale për shërbimet energjetike komunale dhe 3) përgatitjen e paketës financiare, të investimeve të kërkuara, dhe të ndërtimit të afateve kohore për zbatimin e secilës masë të EE/BRE në bazë të rekomandimeve të parashtruara nga Plani i veprimit tre vjeçar i EE për Komunën e Prishtinës. Komuna e Prishtinës është poashtu në përgatitje të një plani të qëndrueshëm për Energjinë dhe klimën.

2.5.5.3. Ndriçimi publik

Në kuadër të rrjetit të energjisë elektrike, rëndësi të veçantë ka edhe ndriçimi publik në rrugët e vendbanimeve të komunës së Prishtinës. Ndriçimi publik është një element kyç që mundëson rritjen e sigurisë për banorët e zonave, qoftë për këmbësorë ose për pjesëmarrës në trafik. Sipas të dhënave të siguruar nga drejtoritë përkatëse, në komunën e Prishtinës nga 577.04 km rrugë në total të shtrira, 405.87km prej tyre kanë ndriçim publik ekzistues. Ndërsa, komuna planifikon pajisjen e 110 km rrugë të tjera me ndriçim publik.

2.5.5.4. Vlerësimi i nevojave për të ardhmen

Tabela 16 SWOT analiza për rrjetin elektrik

Përparësitë	Dobësitë
- Rezervat e mjaftueshme të linjtit për të prodhuar energji elektrike dhe termike me çmime konkurruese; - Përvoja industriale për prodhim dhe eksplotim të linjtit në Kosovë; - Kapacitete transmetuese ndërlidhëse të mjaftueshme që mundësojnë tregti ndërkufitare; - Resurset humane të mjaftueshme për të rekrutuar dhe zhvilluar staf me shkathtësi që mund t'u përgjigjen kërkesave të sektorit; - Baza ligjore në harmoni me direktivat e BE-së; - Republika e Kosovës është anëtare e Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë së EJT; - Mekanizma institucional adekuat për funksionimin e sektorit të energjisë, në veçanti autoritetet e pavarura rregullatore dhe operatori i pavarur i sistemit të transmissioinit dhe tregut të energjisë elektrike; - Potenciale relativisht të favorshme të BRE-ve, që mundësojnë diversitet të burimeve të energjisë; - Zhvillimi i tregut të përbashkët të energjisë elektrike Kosovë-Shqipëri; - Potencial i lartë për efikasitetin e energjisë.	- Mirëmbajtje joadekuate e rrjetit energjetik; - Rrjet i vjetërsuar me shtylla nga druri; - Kabllo të tensionit të lartë kalojnë mbi shtëpi banimi; - Kapacitete gjeneruese aktuale të vjetruara që nuk sigurojnë prodhim të qëndrueshëm të energjisë elektrike; - Nivel i lartë i humbjeve teknike dhe komerciale në sistemin e shpërndarjes; - Mundësi të kufizuara për vetëfinancim të investimeve; - Ngecja në ritmin e investimeve për modernizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve prodhuese ; - Furnizim jo i sigurt me energji elektrike dhe termike; - Pjesëmarrja e ulët e BRE-ve në prodhimin e energjisë elektrike; - Varësi e pjesshme nga importi i energjisë elektrike; - Efikasiteti i ulët në procesin e prodhimit dhe shfrytëzimit të energjisë; - Tregu i pazhvilluar dhe pjesëmarrje e ulët e sektorit privat për financimin e masave të EE-së; - Ndotja e mjedisit nga minierat e linjtit dhe nga prodhimi i energjisë; - Përdorim i lartë i energjisë elektrike për ngrohje; - Mosoperimi i KOSTT si Zonë Rregulluese e pavarur.
Mundësitë	Rreziqet
- Kërkesa në rritje për energji në Kosovë dhe rajon, mundësi për zhvillim të shpejtë të sektorit të energjisë; - Ristrukturimi dhe reformimi i plotë i sektorit të energjisë në përputhje me Direktivat e BE-së; - Liberalizimi i tregut në nivel rajonal dhe zhvillimi i sektorit me kapital privat; - Mundësia e tërheqjes së investitorëve strategjikë;	- Rritjet e paparashikueshme të çmimeve të importit të produkteve të lëndëve të lëngëta djegëse dhe pengesat e paparashikueshme të furnizimit me produkte të naftës; - Krizat e mundshme financiare globale, me ndikim negativ në investimet nga jashtë; - Vazhdimi i obstrukcioneve nga Serbia në sektorin e energjisë - Rritja e çmimeve të energjisë elektrike dhe rritja e kërkesës për import deri në ngritjen e

• Ndërtimi i ngrohësve qendrorë në qytetet më të mëdha; • Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe rritja e investimeve në shpërndarjen e energjisë elektrike; • Rritja e EE në prodhimin e energjisë dhe shfrytëzimi eficient i energjisë nga konsumatorët fundorë;	• kapaciteteve të reja prodhuese; • Mungesa e energjisë elektrike në dispozicion në rajon; • Mosfunksionimi i tregut të hapur dhe konkurrent të energjisë elektrike në rajon.
--	---

2.5.6. Energjia termike

Termokosi është themeluar në vitin 1970, si kompani e ngrohjes qendrore. Më 1974 kompania Termokos e Prishtinës iu bashkua Ndërmarrjes Banësore të Prishtinës. Më vonë është themeluar Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM), në kuadër të të cilit ka vepruar Departamenti për mbikëqyrjen e ndërmarrjeve publike, në mesin e të cilave bënte pjesë edhe Termokosi.

Nga viti 2006 është korporatizuar dhe nga atëherë vepron si kompani publike NP Termokos SHA. Nga Qershori i vitit 2008 funksionon nën mbikëqyrjen e Komunës së Prishtinës.

Termokosi është furnizues lokal për Ngrrohje Qendrore (NQ) në Prishtinë. Sezoni ngrohës zakonisht fillon me 15 tetor dhe mbaron me 15 prill të vitit vijues. Termokosi është përgjegjës për pjesën primare, ndërsa pjesa sekondare (pompën qarkulluese, vertikale në ndërtesa dhe radiatorët në apartamente etj.) është përgjegjësi e konsumatorëve, i pa definuar ende në bazë të Ligjit të Ngrrohjes. Riparon dhe mirëmban rrjetin primar, gjithashtu kryen faturimin dhe inkasimin e faturave të ngrohjes në çdo banesë.

Kapaciteti furnizues i instaluar:

- Dy kaldaja me mazut kapacitetit termik 58 MW, $2 \times 58 = 116$ mV.
- Dy kaldaja me naftë të Ngrrohtës e Spitalit (tepricë e sistemit të NQ për furnizim emergjent) 7 MW secila 14 mV.
- Rrjeta primare - trase 77 km.
- Numri i nënstacioneve 411.
- Viti i themelimit të Ngrrohtës në Fushë-Kosovë 1982.
- Kapaciteti furnizues i instaluar: dy kaldaja me mazut të kapacitetit 2×0.814 mV.
- Temperatura e projektuar për sistemin banesor të ngrohjes $-18^{\circ}\text{C} / + 20^{\circ}\text{C}$. Sistemi i ngrohjes qendrore në Prishtinë është instaluar gjatë viteve të '70.
- Furnizon me energji termike (ngrohje) rreth 13.500 konsumatorë (rreth 12.400 amvisëri dhe rreth 1.100 subjekte afariste-institucione publike).
- Sipërfaqja ngrohëse rreth 1,250,000.00 m².

Kapacitetet teknike të Termokosit para ngrohjes me kogjenerim

Kapacitetet e prodhimit të ngrohjes nëpërmes mazutit deri në vitin 2014 kanë qenë 116 mV.

Rrjeti primar i tubacionit prej 77 km dhe 3500 m³ të kapacitetit të ujit, i instaluar në vitet '70, në pjesën e urbanizuar të Prishtinës, 385 nënstacione (200 banesore, 185 afariste apo institucione) me këmbyes të nxehtësisë pjesërisht të vjetër, ofrojnë cilësi të dobët të ngrohjes dhe shpenzim të lartë të energjisë elektrike.

Që nga sezoni ngrohës 2014/2015, në sajë të realizimit të Projektit të Kogjenerimit NP Termokos SHA shfrytëzon avullin e Termocentralit Kosova B për prodhimin e energjisë termike (ngrohje).

Lidhja me dy njësitë gjeneruese të TC Kosova B ka mundur ngritjen e kapaciteteve teknike deri në $2 \times 70 = 140$ MW.

Tabela 17 Kapacitetet termike të NP Termokos SH.A para vitit 2014

Njësia gjeneruese	Kapaciteti instalues	Shkalla e shfrytëzimit (%)	Kapaciteti në dispozicion	Lënda djegës e	Konsumi i lëndës djegëse kg/mVh	Viti i prodhimit/instalimit	Vendi
Kaldaja me ujë të nxehtë	2*58=116mW	85	98.6mWh	Mazut	105	1978	Termokos
	2*7=14mWh	90	12.6mWh	Dizel	96	1983	Ngrohtorja e QKUK
	4mWh	90	3.6mWh	Mazut	96	2003	Termokos
Total kapaciteti	134mWh		114.8mWh				

Projekti i kogjenerimit

Projekti i kogjenerimit paraqet një investim kapital shumë të rëndësishëm dhe përfshinë këta komponentë:

- Ndërtimin e rrjetit të transportit të energjisë termike – gyp sjellësi TC Kosova B-NP Termokos ShA;
- Kyçjen në njësinë B1 dhe B2 me kapacitetet nominale $2 \times 70 = 140$ mWth
- Ndërtimin e stacionit të ekstraktimit të energjisë termike në TC Kosova B (kondensatorët e nxehtësisë dhe pajisjet përkatëse të kyçjes në turbina);
- Ndërtimin e stacionit të pranimi të energjisë termike në NP “Termokos” ShA (këmbyesi i nxehtësisë dhe pajisjet përkatëse të kyçjes në rrjetin e shpërndarjes);
- Zëvendësimin e gypave të vjetër me gypa të rinj të paraizoluar;
- Rehabilitimin komplet të 50 nënstacioneve të sistemit të ngrohjes dhe instalimin e matësve të energjisë;
- Zgjerimin e rrjetit për lidhje të reja për konsumatorët e rinj;
- Instalimin e sistemit për monitorim dhe kontroll të nënstacioneve nga distanca SCADA;
- Sistemin e kogjenerimit, i cili përmban në vete:
- Hapësira, ku bëhet marrja e avullit në dy njësitë gjeneruese: B1 dhe B2 të Termocentralit Kosova B. Marrja e avullit bëhet në mes të turbinës me presion të mesëm dhe asaj të ulët, në dy njësitë gjeneruese E të Termocentralit Kosova B, kapaciteti maksimal i marrjes së avullit 70 mW fuqi termike,

Stacioni HES-Heat Extraction Station (Stacioni për nxjerrjen e nxehtësisë), i cili ndodhet në zonë në Termocentralin Kosova B, dy kondensatorë të nxehtësisë: 2×70 mW.

Tabela 18 Kapacitetet e kondensatorëve të nxehtësisë në stacionin HES

Kondensatorët	Kapaciteti instaluar	Kapaciteti i operativ	Viti i prodhimit	Vendi
Stacioni HES TC Kosova B	2*70mWth	140mWth	2014	TC Kosova B

Stacioni HRS–Heat Receiving Station (Stacioni për pranimin e nxehtësisë), ky stacion, i cili ndodhet në Termokos, kapaciteti i tre këmbyesve 3×50 mW.

Tabela 19 Kapacitetet e këmbyesve të nxehtësisë në stacionin HRS

Këmbyesi	Kapaciteti instaluar	Kapaciteti i operativ	Viti i prodhimit	Vendi
Stacioni HRS Termokos	3*50mWth	150mWth	2014	Termokos

Rrjeti kryesor, i cili lidh dy stacionet HES-Obiliq dhe HRS-Prishtinë, në gjatësi 11.5 km, qark i mbyllur (qarkullim i detyruar me pompa qarkulluese).





Figura 1 Rrjeti kryesor i kogjenerimit HES-HRS, dimensioni gypit DN600 mm



Harta 16 Energjia termike

2.5.6.1. Inventari i infrastrukturës ekzistuese

Tabela 20 Energjia e prodhuar, energjia e liferuar tek konsumatorët, humbjet në rrjet (rrjeti i transportit dhe i shpërndarjes) në sezonet 2015-16, 2016-2017 dhe 2017-2018, ngrohja me kogjenerim (Burimi : Plani Zhvillimor i NP "Termokosi" SH.A., 2019-2029)

Sezoni	Të prodhuara mWhth	Të liferuara mWhth	Humbjet mWhth	Humbjet %
2015/2016	198,686.00	165,196.45	33,598.55	17%
2016/2017	225,438.00	196,462.20	28,975.80	13%
2017/2018	223,738.00	199,861.75	23,876.25	11%

Tabela 21 Humbjet e energjisë termike në rrjetin e transportimit të energjisë termike nga kogjenerimi (Burimi: Plani zhvillimor i NP "Termokosi" SH.A., 2019-2029)

Sezoni	Të prodhuara	Të liferuara	Humbjet mWhth	Humbjet %
--------	--------------	--------------	---------------	-----------

	<i>mWhth</i>	<i>mWhth</i>		
2014/2015	152,397.00	149,806.00	2,591.00	1.7%
2015/2016	198,696.00	193,340.00	5,356.00	2.8%
2016/2017	225,438.00	220,078.00	5,360.00	2.4%
2017/2018	223,738.00	219,954.00	3,784.00	1.7%
Total	800,269.00	783,178.00	17,091.00	2.1%

Konsumi aktual dhe paraprak

Pas funksionalizimit të kogjenerimit ku është arritur një furnizim më cilësor, konsumi në vazhdimësi ka shënuar rritje.

Të dhënat për furnizimin-konsumin gjatë sezoneve të kaluara janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 22 Energjia e prodhuar, liferuar dhe humbjet (Burimi: Plani zhvillimor i NP "Termokos" SH.A. 2019-2029)

Sezoni	Të prodhuara <i>mWhth</i>	Të liferuara <i>mWhth</i>	Humbjet <i>mWhth</i>	Humbjet %
2013/2014	51,528.21	41,804.43	9,723.79	19%
2014/2015	158,068.08	127,889.79	30,198.28	19%
2015/2016	198,686.00	165,087.45	33,598.55	17%
2016/2017	225,438.00	196,462.20	28,975.80	13%
2017/2018	223,738.00	199,861.75	23,876.25	11%

Tabela 23 Numri i konsumatorëve (Burimi: Plani zhvillimor i NP "Termokos" SH.A. 2019-2029)

Sezoni	2013/2014	2014/2015	2015/2016	2016/2017	2017/2018
Shtëpiak	10,732	11,125	11,578	11,872	12,299
Biznesor/Institucional	610	726	805	997	1160
Total	11,342	11,851	12,383	12,869	13,459

Tabela 24 Sipërfaqja ngrohëse (Burimi: Plani zhvillimor i NP "Termokos" SH.A. 2019-2029)

Sipërfaqja ngrohëse (*m*²)

Sezoni	2013/2014	2014/2015	2015/2016	2016/2017	2017/2018
Shtëpiak	632,417.10	655,773.00	685,130.00	698,602.00	728,530.27
Biznesor/Institucional	391,708.41	394,106.15	476,225.90	506,715.45	542,268.03
Total	1,024,125.51	1,049,879.15	1,161,355.90	1,205,317.45	1,270,798.30

Tabela 25 Konsumi specifik për sezonë (Burimi: Plani zhvillimor i NP "Termokos" SH.A. 2019-2029)

Sezoni	<i>Sipërfaqja m</i> ²	<i>Konsumi MWhth</i>	<i>Konsumi specifik për sezonë kWth/m</i> ²
Konsumatorët shtëpiak	728,530.30	117,136.32	160.78
Konsumatorët biznesor/institucional	542,268.00	82,725.38	152.55
Total	1,270,798.30	199,861.70	313.33

Kërkesa aktuale për energji termike në rrjetin e shpërndarjes së Termokosit, vlerësohet se arrin përafërsisht 225 GWhTH për sezon. Vlerësimet e parallogaritura, tregojnë, se rreth 25 GWhTH janë humbjet e energjisë termike, kështu që afërsisht 200 GWhTH u shpërndahet konsumatorëve. Kërkesa specifike për ngrohje shkon në 124 kWTH/m². Kjo është gjithashtu shifër e ulët, veçanërisht duke marrë parasysh që furnizimi me ngrohje është i shtyrë nga prodhimi.

Kapaciteti i shfrytëzuar dhe në dispozicion

Në tabelën e mëposhtme, është paraqitur kërkesa për kapacitet të konsumatorëve për katër sezona, në të cilën janë përfshirë:

- Kapaciteti elektrik për sezon (MWh/hEL),
- Energjia termike e realizuar për sezon (MWhTH),
- Kapaciteti mesatar termik (MWTH),
- Kapaciteti termik maksimal (të pikut) në (MWTH).

Tabela 26 Kërkesa për kapacitete elektrike dhe termike (Burimi: Plani zhvillimor i NP "Termokos" SH.A. 2019-2029)

Sezoni	Kapaciteti elektrik për sezonë (MWh/h)	Energjia termike e realizuar për sezonë (MWhth)	Kapaciteti mesatar termik (MWth)	Kapaciteti termik maksimal (të pikut) (MWth)
2014/2015	24,352	152,397	47	80.4
2015/2016	30,745	198,696	46	90.8
2016/2017	34,837	225,438	52	83.8
2017/2018	34,532	223,738	52	73.9

Në sezonet 2014-15 dhe 2015-2016 janë bërë teste të performancës së sistemit, prandaj ngarkesa e regjistruar për pikun ditor nuk është ngarkesë reale e kërkuar nga konsumatorët në atë kohë.


Aktualisht, furnizimi me ngrohje është i shtyrë nga prodhimi, prandaj kapaciteti është konstant. Kjo ilustron në figurën vijuese, ku paraqitet shfrytëzimi i kapacitetit në një ditë tipike sezonale. Siç mund të vërehet nga diagrami, kapaciteti maksimal për ngrohje arrin deri në 70 MWTH, ndërsa kapaciteti i humbjeve të ngrohjes arrin deri në 10 MWTH, kështu që vetëm 60 MWTH kapacitet termik u ofrohet konsumatorëve në një hapësirë totale të ngrohjes prej 1,334.000 m².

Kapaciteti specifik i ngrohjes është vetëm 45 W/m² që është shifër shumë e ulët. Nënstacionet nuk janë të kontrolluara dhe rrjeti i qytetit nuk është i balancuar. Kështu që, ndërtesat afër Termokosit tejnxehen dhe temperatura e kthimit është tepër e lartë, ndërsa në ndërtesat që gjenden më larg Termokosit, nuk ofrohet ngrohje e mjaftueshme.

Në diagramin vijues (figura 46) paraqiten kapacitetet mesatare mujore sipas sezoneve. Duke krahasuar kapacitetet termike mesatare mujore për katër sezonet e kaluara, vlera më e madhe e kapacitetit termik mesatar ka arritur në 60 MWTH në muajin janar të sezonit 2017-2018.

Ngarkesa aktuale e pikut

Bazuar në temperaturat e jashtme në qytetin e Prishtinës, ngarkesa e pikut shfaqet gjatë muajve dhjetor dhe janar. Normalisht, ngarkesa e pikut në rrjetet determinohet nga temperaturat e jashtme (atmosfera) dhe orarit ditor. Mëngjesi dhe mbrëmja janë intervalet me kërkesa më të mëdha për energji termike.



Grafika 8 Kapaciteti i ngrohjes dhe temperaturat e jashtme më 30 janar 2016

Faktorët ndikues në kërkesën për kapacitet dhe për energji termike

Një numër faktorësh kanë ndikim përcaktues në kapacitetin termik dhe sasinë e energjisë termike. Ndër kryesoret janë: masat për përmirësimin e kualitetit të ngrohjes dhe efijencës së energjisë, ndikimi i projekteve zhvillimore dhe parametrat projektues, gjegjësisht temperatura projektuese.

Përmirësimi i kualitetit të furnizimit

Është i njohur fakti se në disa pjesë të qytetit (veçanërisht Kodra e Diellit), cilësia e ngrohjes është më e dobët. Një masë e domosdoshme për përmirësimin e furnizimit është balancimi hidraulik i sistemit dhe implementimi i kontrollit automatik në nënstacione.

Kjo masë, do të ndikojë në shfrytëzimin efikas të kapacitetit termik dhe furnizim në mënyrë të balancuar për të gjitha rajonet e shpërndarjes-furnizimit, rrjedhimisht edhe aktivizimin e konsumatorëve pasiv. Vlerësimet paraprake tregojnë se kapacitetit specifik (për njësi të sipërfaqes-m²) do të jetë 80 W/m², ndërsa konsumi specifik do të arrijë në 160 kW/m² për sezon.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur, sipërfaqja ngrohëse e lidhjeve ekzistuese, përfshirë edhe aktivizimin e konsumatorëve pasiv dhe përlogaritjet përkatëse të kapaciteteve termike dhe kërkesës për energji termike.

Tabela 27 Të dhënat për sipërfaqen, kapacitetin dhe kërkesën për energji

Lidhjet ekzistuese	Hapësira e ngrohur	Kapaciteti	Kërkesa
Ulpiana	189,667 m ²	15,173 kW	30,347 MWh
Qendra	136,242 m ²	10,899 kW	21,799 MWh
Dardania	312,410 m ²	24,993 kW	49,986 MWh
Kodra e Diellit	214,754 m ²	17,180 kW	34,361 MWh
Institucionet	481,352 m ²	38,508 kW	77,016 MWh
Total	1,334,425 m²	106,754 kW	213,508 MWh

Parashikimi i kërkesës për energji termike për periudhën 2019-2029

Tabela 28 Planifikimi për konsumin e energjisë termike dhe rritjen e sipërfaqes ngrohëse

Sezoni	2019 /202	2020 /202	2021 /202	2022 /202	2023 /202	2024 /202	2025 /202	2026 /202	2027 /202	2028 /202
	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9
Ngarkesa maksimale (MWth)	92.0	105.	115.	120.	130.	140.	140.	140.	140.	140.
Prodhi i energjisë termike (MWth)	160.	466.	700.	818.	063.	288.	288.	288.	288.	288.
Kapaciteti vjetor i rezervuar elektrik MWh/h	42,4	48,3	53,0	55,3	59,9	64,5	64,5	64,5	64,5	64,5
Energjia furnizuar (MWth)	250,	288,	316,	330,	361,	389,	391,	393,	393,	393,
Humbjet në rrjetin e shpërndarjes (MWh)	27,8	28,5	31,2	32,6	31,4	33,8	29,6	29,6	29,6	29,6
Sipërfaqja/m ²	1,59	1,84	2,01	2,10	2,30	2,48	2,51	2,51	2,51	2,51
	7,19	3,14	8,67	6,44	7,06	4,53	1,53	1,53	1,53	1,53
	5.00	4.00	7.00	9.00	4.00	1.00	7.00	7.00	7.00	7.00

2.5.6.2. Vlerësimi i gjendjes

Gypat e instaluar në vitet '70 në rrjet, pothuaj tani janë ndërruar mbi 70% me gypa të rinj. Kapaciteti aktual nga KEK-u (TC-B) për furnizim me ngrohje është 140 MWh. Ky kapacitet mundëson zgjerim të rrjetit ekzistues në lagjet, ku është shtrirja e rrjetit ekzistues.

Me projektin e zgjerimit të rrjetit të ngrohjes në qytetin e Prishtinës të financuar nga BE-ja, është përfshirë lagjia Kalabria (Emshiri) dhe disa objekte publike në rrjetin ekzistues, gjithashtu edhe modernizimi i nënstacioneve termike, i cili mundëson kursim të energjisë termike.

Mbulueshmëria e qytetit me ngrohje tani përfshinë 40-50% e territorit të qytetit të Prishtinës. Modernizimi i nënstacioneve është duke u bërë, ku na mundëson menaxhimin më të mirë të ngrohjes. Me dyfishim të kapaciteteve termike nga KEK-u, në 280 MW, qyteti do të ketë mbulueshmëri në 80% të territorit të qytetit të Prishtinës.

Tabela 29 SWOT analiza - Energjia termike

Përparësitë	Dobësitë
- Modernizim i nënstacioneve me kontroll nga distanca të cilat ndikojnë në kursim të energjisë termike; - ngrohje e pandërprerë 24h me sistem të kogjnerimit për konsumatorët e kyçur në rrjetin e ngrohjes; - Objektet e reja me efikasitet; - Gypat e paraizoluar, të cilët ndikojnë në efikasitet të energjisë termike; - Përdorimi i teknologjive të reja;	- Kapacitetet ekzistuese të burimit të energjisë të cilat ndikojnë në pamundësinë për kyçjeve të gjithë konsumatorëve të rinj; - Kapaciteti i kufizuar i gypave ekzistues - Mos aplikim i teknologjive të reja; - Mundësi të kufizuara për vetë financim të investimeve;
Mundësitë	Kërcënimet
- Rehabilitimi në vazhdimësi i rrjetit ekzistues të ngrohjes nga Termokosi dhe donacionet; - Ngrohja e disa lagjeve në Prishtinë me energji të	Krizat e mundshme financiare globale, me ndikim negativ në investimet nga jashtë.

ripërtëritshme - energji diellore, gaz;

- Vendosja e matësve të energjisë termike në objekte banesore;
- vendosja e matësve të energjisë termike në njësi banimi;
- Kyçja e objekteve të reja ku ende nuk janë kyçur në lagjet e Prishtinës;
- Mundësia e shfrytëzimit të gazit për ngrohje kur të bëhet gazsjellësi.

2.5.7. Telekomunikacioni

2.5.7.1. Shërbimet komunikuese mobile

Në Kosovë janë dy operatorë të licencuar për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese mobile, Telekom i Kosovës, si operator publik shtetëror dhe IPKO Telecommunication, si operatori i vetëm privat. Të dy operatorët mbulojnë territorin e Prishtinës me shërbime të telefonisë mobile me zë (voice) dhe me të dhëna (data).

Mbulueshmëria me shërbimet e zërit në Komunën e Prishtinës është e kënaqshme, përfshirë edhe zonat rurale në përjashtim të vendbanimeve me popullsi të vogël të zonave malore, ku ndihet mungesa e sinjalit 3G dhe LTE.

Shërbimet data që ofrohen janë një përfshirje e gjerë e teknologjive nga EDGE/GPRS, 3G/VCDMA dhe 4G/LTE. Mbulueshmëria me këto shërbime është e koncentruar në zonat më të banuara, ndërsa duhet të bëhen përmirësime në zonat rurale dhe rritje e kapaciteteve në zonat urbane.

2.5.7.2. Shërbimet telekomunikuese fikse, internet dhe DTV

Shërbimet telefonike fikse të Postë-Telekomit të Kosovës (PTK), në qytetin e Prishtinës, janë të mbuluara me rrjetin e telefonisë fikse, ndërsa nëpër disa vendbanime rurale, nuk ekziston.

Sa i përket rrjetit fiks të ofrimit të shërbimeve të qasjes në internet dhe DTV në Komunën e Prishtinës, bazuar në të dhënat e dërguara nga operatorët, vërehet se Komuna e Prishtinës qëndron mirë në ofrimin e shërbimeve të internetit, të cilat ofrojnë shpejtësi shumë të larta dhe nivele të garantuara të kualitetit të shërbimeve të internetit, në krahasim me rrjetin mobil. Operatorët e licencuar, ofrojnë shërbime kryesisht në zonat urbane dhe në disa zona rurale, ku përqendrimi i qytetarëve/banesave është më i madh. Ndërsa në zonat e largëta dhe më pak të banueshme këta operatorë nuk ofrojnë shërbime. Në këto zona shërbimet ofrohen nga operatorë lokal, shpeshherë të pa licencuar dhe me kualitet jo të kënaqshëm të shërbimit. Ofrimi i shërbimeve bëhet përmes sistemit kabllor HFC (Hybrid Fiber Coax) në mbi 70% të rasteve dhe në 30% të rasteve përmes GPON (Fiber).

Gjendja aktuale e infrastrukturës së telekomunikacionit në Komunën e Prishtinës është relativisht e mirë, ekzistojnë disa kompani (operatorë ekonomik) që bëjnë shpërndarjen e rrjetit të internetit. Operatorët e licencuar që operojnë në Komunën e Prishtinës ofrojnë shërbimet e internetit, TV digjital dhe disa prej tyre edhe telefonitë FIX-e e që janë: Telekom i Kosovës, rrjeti i kompanisë Ipko, rrjeti i kompanisë Kujtesa, rrjeti i kompanisë Artmotion, rrjeti i kompanisë Telkos. Shpërndarja e teknologjive dhe e rrjetave të avancuara në Prishtinë është zhvilluar me një ritëm jo të rregullt dhe në mënyrë të pakoordinuar.

Infrastruktura e rrjetit të telefonisë fikse nuk është e shtrirë në të gjithë territorin e komunës, kryesisht fshatrat malore nuk posedojnë rrjet të kabllovikut nga asnjë operator që vepron në nivel komunal.


Tabela 30 Pikat shpërndarëse të PTK-së në Prishtinë

Emri i pikës	Lidhja me kablo optike	Shpërndarjet në:
Bardhosh	Po	Bardhosh, Leban, Besi, Trudë dhe
Matiçan	Po	Matiçan, Zllatar
Hajvali	Po	Hajvali
Sofali	Po	Sofali
Iliria	Po	Kolovicë dhe në qytetin e Prishtinës
Çagllavicë	Po	Çagllavicë

Zonat rurale, në të cilat ka mungesë të infrastrukturës dhe shërbimeve me internet janë: Fshati Prapashticë, Mramor, Keqekollë, Koliq, Makovc, Kukaj, Slivovë, Marec, Rimanishtë, Nishec.

Sipas të dhënave të ofruara nga operatorët, ofrimi i shërbimeve në nivel të ekonomive familjare është relativisht i mirë, duke përjashtuar disa vendbanime apo qytetarë, të cilët jetojnë në vise më të thella rurale, ku shërbimet arrihen më vështirë, ndërsa pjesa më e madhe e qytetareve mbi 90% gëzojnë qasje në shërbime, të cilat i ofrojnë operatorët.

Shërbimet telefonike fikse të Telekomit të Kosovës (PTK), në qytetin e Prishtinës, janë të mbuluara me rrjetin e telefonisë fikse), ndërsa nëpër disa vendbanime rurale, nuk ekziston.



Harta 17 Rrjeti i telekomunikacionit

2.5.7.3. Posta

Posta e Kosovës ofron shërbimet e kryera me pagesë për dërgimin e dërgesave të postës së letrave, pakove, urdhërpagesave si dhe shërbimet e kryera me pagesë, të cilat sigurohen nëpërmjet mjeteve për pranimin dhe dërgimin e dërgesave postare.

Në Komunë të Prishtinës, Posta e Kosovës ofron shërbimet e saj përmes 22 pikave shërbyese, 20 pika shërbyese në zonën urbane dhe 2 pika shërbyese në zonën rurale.

Në vijim janë paraqitur lokacionet e zyrave postare në Komunë të Prishtinës:

- Rr. Agim Ramadani, nr. 190;
- Rr. UÇK-së, nr. 66;
- Rr. Mark Sopi, Hyrja 1;

- Blloku II, Hyrja 1, Rr. Ismajl Dumoshi, p.n., Taukbahqe;
- Rr. Bulevardi Nëna Terezë, QB-Vala, nr.8;
- Rr. Agim Ramadani, nr. 477;
- Sheshi Bill Clinton, Blloku V, Hyrja 2;
- Objekti Qendror i Postës, rr. Dardani, p.n.;
- Rr. Enver Maloku, Kodra e Diellit, p.n.;
- Qendra spitalore (QKUK);
- Objekti i ARC-së, Rr. Luan Haradinaj, nr. 151 kati përdhësë;
- Stacioni Qendror i Autobusëve, Rr. Bill Clinton, p.n.;
- Rr. Ibrahim Lutfiu, nr. 21, Prishtinë;
- Rr. Ilir Konushevc, nr. 200;
- Objekti Postar i QTP-së, p.n. Zona Industriale;
- Rr. Tringë Smajli, nr. 12;
- Rr. Nekibe Kelmend, i p.n.-Pallati i Drejtësisë;
- Objekti i Fak. Ekonomik, Rr. Agim Ramadani, p.n.;
- Objekti i vjetër K.K. Prishtinë, Rr. UÇK-së, nr. 2;
- Objekti i ri K.K. Prishtinë, Rr. Radovan Zogoviq, p.n.;
- Rr. Dëshmorët e Gollakut, p.n., Hajvali;
- Rr. Mehmet Devaja-Fshati Bardhosh, p.n.

2.5.7.4. Vlerësimi i nevojave për të ardhmen

Duke parë që mbulueshmëria me shërbime me zë është e kënaqshme, përmirësimet duhet të orientohen kryesisht në shërbimet data. Nevoja për kapacitete më të mëdha nga shfrytëzuesit është gjithnjë në rritje, kjo tregon që edhe për zonat me mbulueshmëri të mirë në ditët e sotme, në një të ardhme jo të largët, nuk do të jetë e mjaftueshme. Për këtë nevojitet përmirësim në infrastrukturë dhe teknologji.

Për të përmbushur kërkesat e qytetarëve për kapacitete të mjaftueshme, operatorët duhet që të:

- Rrisin numrin e BTS-ve në zonat me koncentrim më të madh të qytetarëve. Mënyrë me e përshtatshme për ta bërë këtë, rekomandohet që të ndërtohet BTS e përbashkët nga të dy operatorët,
- Rrisin kapacitetet duke zëvendësuar transportin me wireless, me atë me fije optike. Edhe në këtë rast mund të përdorin infrastrukturë të përbashkët nëntokësore që mund të jetë pronë e operatorëve, pronë publike komunale, apo edhe ndonjë operatori të shërbimeve FIX-e, të cilët do ta ndajnë të njëjtën infrastrukturë gjithashtu.

Trendi global i shërbimeve telekomunikuese mobile po shkon drejtë teknologjisë 5G. Nevojat e qytetarëve për kapacitete më të mëdha në shërbimet mobile, kryesisht në data edhe në Kosovë, obligon operatorët që të implementojnë teknologjinë 5G. Për të implementuar projekte të ndryshme si: Smart Home, Internet of Things etj., është e domosdoshme të implementohet teknologjia 5G.

Parakushtet për ta implemetuar këtë teknologji të re janë: përmirësimet në infrastrukturë, kryesisht në transport, lirim i brezave të reja frekuencore nga autoriteti rregullator, siç janë brezat 800 MHz për zonat rurale, brezat 2100 MHz dhe 2600 MHz për mbulimin e zonave me popullsi më të dendur.

Sa i përket shërbimeve telekomunikuese fikse, vlerësohet se duhet të bëhen këto përmirësime:

- Infrastrukturë–Duhet të ndërtohet infrastruktura e përbashkët nëntokësore për të gjithë operatorët. Infrastruktura të përdoret edhe për operatorët që ofrojnë shërbime telekomunikuese mobile. Zgjidhja ideale do të ishte që infrastruktura primare të jetë pronë komunale apo e një operatori dhe të mirëmbahet nga vetëm një ekip, i cili pastaj jepet në shfrytëzim për operatorët.
- 100% e infrastrukturës në zonat urbane duhet të kalojë në infrastrukturë nëntokësore, ashtu sikurse edhe rrjetet primare, furnizimet në zonat rurale të bëhen me infrastrukturë

nëntokësore, ndërsa në zonat me banim më të ulët, të lejohet edhe infrastruktura ajrore, por me shtylla të sigurta nga betoni.

- Të sigurohet që së paku dy operatorë që ofron shërbime kualitative dhe kontent të licencuar, të ofrojnë shërbime për secilin qytetar të Prishtinës. Kjo për shkak se konkurrenca rritë cilësinë dhe jep lehtësime financiare për qytetarët.
- Të bëhen lehtësime për operatorët që kalojnë nga HFC në GPON, pasi që me këtë veprim ju mundësojnë shërbime shumë më të mira dhe kualitative qytetarëve.
- Avancimet në teknologji - Trendi global i shërbimeve telekomunikuese është përmes fibrës optike. Përparësitë e fibrës optike me teknologjitë tjera janë të shumta, si: kosto më të lirë të implementimit dhe më e rëndësishmja cilësi dhe kapacitet i pakrahasueshëm kundrejt teknologjive tjera.

Tabela 31 SWOT Analiza - Telekomunikacioni

Përparësitë	Dobësitë
• Shërbimet ekzistuese që ofrojnë mbulueshmëri; • Mbulueshmëria e mirë me shërbime interneti dhe DTV në zonat urbane; • Nivel i kënaqshëm i konkurrencës në zonat urbane; • Mbulueshmëri minimale edhe në zonat rurale; • Përditësimi i infrastrukturës prej operatorëve; • Shfrytëzimin e granteve (kombëtare e ndërkombëtare) për përmirësimin e infrastrukturës.	• Rrjeti nëpër shtylla të KEDS-it pakontrolluar; • Jo stabiliteti energjetik në vend; • Mungesa e shërbimeve të FIX-it nëpër fshatra; • Mos unifikimi i rrjeteve nga operatorët që ofrojnë shërbime telekomunikuese. • Rrjeti i vjetërsuar; • Mbi 80% ofrojnë shërbime me kablo koaksiale; • Shërbimet fiber to home në nivel minimal; • Cilësia jo e kënaqshme e shërbimeve; • Ndërprerje të shpeshta të shërbimeve që lidhen me rrjetin e vjetërsuar dhe furnizimin jo stabil me energji elektrike.
Mundësitë	Rreziqet
• Shfrytëzimi i investimeve të jashtme; • Planifikimi dhe ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore nga komuna; • Shtrirja e gypave në të gjitha rrugët kryesore; • Eliminimi i rrjetit nëpër shtylla; • Infrastruktura e përbashkët për të gjithë operatorët; • Infrastruktura nëntokësore të jetë pronë komunale që mundëson rritjen e cilësisë dhe konkurrencës së mirëfilltë; • Realizimi i të hyrave nga shfrytëzimi i infrastrukturës.	• Largimi i shtyllave nga KEDS pa shtrirjen e gypave nëntokësore për operatorët e telekomunikimeve që mund t'i lë qytetarët pa shërbim; • Për shkak të mungesës së konkurrencës në zonat rurale, mundësohet ofrimi i shërbimeve pirate nga operatorë të paautorizuar dhe të pa licencuar; • Vazhdimi i infrastrukturës së pa unifikuar nga operatorët; • Cilësia e shërbimit.

2.5.8. Grumbullimi dhe menaxhimi i mbeturinave

Sistemi aktual i menaxhimit të mbeturinave komunale në Kosovë është i paqëndrueshëm në aspektin mjedisor. Mbledhja, transportimi dhe asgjësimi i MK-ve, nuk ofrohet për të gjithë, prandaj mbeturinat e pa mbledhura hidhen ose digjen dhe kjo ndikon negativisht në shëndetin e njeriut si dhe në ujë, ajër, tokë dhe biodiversitet. Ngjashëm, mbeturinat e rrezikshme (në rrjedhën e mbeturinave komunale) nuk mblidhen, nuk trajtohen ndaras, përfundojnë të deponuara bashkë me MK-të dhe paraqesin rrezik për mjedisin.

Grumbullimi dhe Menaxhimi i mbeturinave bëhet nga Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi ShA, e cila mbulon zonën urbane dhe 12 fshatra të komunës. Nuk ka ndarje të mbeturinave mes zonave urbane edhe rurale të Prishtinës. Nuk ka mbledhje të selektuar të mbeturinave, megjithëse kohëve të fundit po bëhen përpjekje që të implementohet ky sistem në disa zona të caktuara të qytetit.

Bazuar në raportin për sasinë e grumbulluar të mbeturinave dhe duke pasur parasysh numrin e banorëve të shërbyer, mund të llogaritet norma e gjenerimit të mbeturinave për kokë banori në ditë, që në nivel vendi rezulton të jetë 0.74kg/banor/ditë.

Andaj, duke marrë parasysh numrin prej 198,897 banorësh (ASK, 2011), sasia vjetore e mbeturinave që mblidhet nga kompania rajonale Pastrimi ShA në Prishtinë është 81,885 ton/vit pa llogaritur mbeturinat nga klientët publik dhe komercial.

*Tabela 32 Sasia e mbeturinave të gjeneruar dhe të grumbulluar
Të dhëna të përgjithshme*

				Sasia e mbeturinave të grumbulluara		Gjenerimi i mbeturinave	
Nr. banorë ve	Nr. Banorë të shërbyer	Nr. Ekonomi ve familjare	Nr. Ekonomi ve familjare të shërbyer	Mbeturina të përziera komunale të grumbulluara (ton/vit)	Mbeturina të përziera komunale të grumbulluara (kg/vit)	Gjenerimi i mbeturinave ve për kokë banori (kg/vit)	Gjenerimi i mbeturinave ve për kokë banori (kg/ditë)
198,897	317,151	40,528	58,003	81,885	81,885,000	258.19	0.71

Komuna e Prishtinës ka deponinë regjionale të mbeturinave në Mirash, deponi e mbeturinave sanitare e cila është ndërtuar në vitin 2004-2006. Ka filluar të operojë në vitin 2006 dhe ka një jetëgjatësi deri në vitin 2026. Madhësia e deponisë së Mirashit është 40 hektar dhe me një kapacitet 3,500.000 m³. Kjo deponi përveç Prishtinës ju shërben edhe komunave tjera si: Obiliq, Fushë-Kosovë, Lipjan, Graçanicë dhe Drenas. Të dhëna në dispozicion për sasinë e mbeturinave të mbledhura dhe të deponuara në vitin 2020, në deponinë e Mirashit janë paraqitur në tabelën në vazhdim.

Tabela 33 Gjenerimi i mbeturinave sipas kategorisë së klientëve, 2020

Kategoria	Gjenerimi sipas klientëve (ton/vit)		
	Klient i amvisërisë	Klient publik	Klient komercial
Urban dhe rural	81,885	34,907.03	128,428
Total	81,885	34,907.03	128,428

Mbulueshmëria dhe lloji i klientëve

Komuna e Prishtinës sipas raportit të AMMK-së numri i klientëve është rreth 80 mijë, klientët e amvisërive dominonin me 87%.

Tabela 34 Numri i klientëve sipas kategorisë, 2020

Kategoria	Numri i klientëve		
	Klient i amvisërisë	Klient publik	Klient komercial
Urban dhe rural	69,412	9,904	5,790
Total	69,412	9,904	5,790

2.5.8.1. Deponitë ilegale

Gjatë muajit Prill 2021 është bërë evidentimi dhe regjistrimi i deponive ilegale në të gjitha komunat e Kosovës. Deponitë e regjistruara për nga madhësia e tyre janë klasifikuar në tri kategori:

- Deponi të mëdha
- Deponi të mesme
- Deponi të vogla.

Ky klasifikim është bërë duke vlerësuar vizualisht vëllimin e deponive.

Kategorizimi tjetër i deponive ilegale është bërë edhe sipas kompozicionit të mbeturinave, si:

- Deponi e mbeturinave komunale
- Deponi e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënit
- Deponi e mbeturinave të rrezikshme
- Deponi e mbeturinave të vëllimshme
- Deponi e mbeturinave tjera

Hedhja ilegale e mbeturinave është një problem i zakonshëm në tërë Kosovën, po ashtu edhe në Komunën e Prishtinës. Deponitë ilegale të raportuara në vitin 2021, gjatë hulumtimit në teren janë paraqitur të eliminuara, sipas kodifikimit me numër 0 në rastin kur janë konstatuar si të pastruara. Sipas vlerësimit në terren, në Komunën e Prishtinës janë pastruar 4 deponi ilegale.¹⁰

Raporti i fundit që është publikuar në vitin 2022 ka identifikuar dy deponi ilegale, të shpërndara në të gjithë territorin e komunës. Sa i përket madhësisë së deponive ilegale, të dyja i takojnë kategorisë së deponive të mëdha. Sipas kompozicionit të mbeturinave, njëra prej deponive i takon kategorisë së mbeturinave të ndërtimit dhe rrënit dhe tjetra i takon kategorisë së mbeturinave tjera.

*Tabela 35 Klasifikimi i deponive ilegale
Deponitë ilegale sipas madhësisë*

Deponi e vogël (1-5 thasë mbeturinash 200l)	
Deponi e mesme (6-20 thasë mbeturinash 200l)	
Deponi e madhe (>20 thasë mbeturinash 200l)	2

Deponitë ilegale sipas kompozicionit të mbeturinave

Mbeturina komunale	
Mbeturina të ndërtimit dhe rrënit	1
Mbeturina industriale të rrezikshme	
Mbeturina të vëllimshme	
Mbeturina tjera	1

2.5.8.2. Asetet komunale për menaxhimin e mbeturinave

Komuna e Prishtinës ka numrin më të madh të makinerisë për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave me gjithsej 40 kamionë (me kompaninë publike "Pastrimi"). Gjithashtu, është raportuar edhe për pajisje të tjera, duke përfshirë 2 traktorë, asete komunale dhe 1886 kontejnerë.

2.5.8.3. Inventari i infrastrukturës ekzistuese në nivel lokal dhe qendror

Në Prishtinë, mbeturinat grumbullohen nga kompania rajonale "Pastrimi" SH.A. Komuna e Prishtinës është 100% pronare e kompanisë dhe ka zgjedhur një bord i cili përbëhet vetëm nga anëtarë të komunës. Ndërmarrja Pastrimi ka një staf prej rreth 678 punonjës që ofrojnë shërbime

¹⁰ Raporti i deponive ilegale për Komunën e Prishtinës, GIZ 2022

çdo ditë. Kuvendi komunal ka zgjedhur komisionin e aksionarëve dhe komisioni ka zgjedhur bordin dhe drejtorin ekzekutiv.

Çmimi për shërbimin e ofruar është rreth 5 euro, shumë kjo e njëjtë për të gjithë llojet e konsumatorëve. Rreth 86% e qytetarëve paguajnë për shërbimin. Mbeturinat deponohen pa u klasifikuar apo ricikluar sipas llojit në deponinë rajonale të Prishtinës në Mirash të komunës së Obiliqit. Kjo deponi është e hapur dhe ka një sistem të kullimit.

Menaxhimi dhe mbulueshmëria e grumbullimit të mbeturinave: që nga viti 2018 Komuna e Prishtinës ka arritur mbulueshmërinë në menaxhimin dhe grumbullimin e mbeturinave në të gjithë territorin e komunës. Në zonën urbane në pikat e grumbullimit, mbledhja e mbeturinave bëhet çdo ditë, ndërsa në zonat rurale mbledhja e mbeturinave bëhet një herë në javë sipas orareve të caktuara. Problemi është se në lagje të caktuara nuk kemi pika grumbulluese të mbeturinave dhe si e tillë mbeturinat hidhen në hapësira të ndryshme, ku krijohen numër i madh i deponive ilegale, gjithashtu problem është mosfunksionimi i 12 pikave grumbulluese nëntokësore në zonën urbane, ky fakt vështirëson mbledhjen e mbeturinave në ato zona.

2.5.8.4. Nevojat për të ardhmen - Infrastruktura e menaxhimit të mbeturinave

Edhe pse grumbullimi i mbeturinave bëhet në gjithë territorin e komunës, infrastruktura fizike nuk është e mjaftueshme dhe bashkëkohore. Andaj rritja e kapaciteteve të shërbimeve dhe menaxhimit më të mirë është më se e nevojshme në vitet në vazhdimësi.

Për një menaxhim dhe grumbullim efikas të mbeturinave është e nevojshme planifikimi i deponive transite brenda territorit të komunës, deponi të cilat do t'i plotësonin kushtet mjedisore dhe të sigurisë shëndetësore, si dhe do të mundësonin një grumbullim dhe menaxhim më të lehtë të mbeturinave brenda qytetit.

Përveç krijimit të kushteve infrastrukturore, është më së e nevojshme gjithashtu ndarja e territorit të qytetit në zona të menaxhimit, që do të ishin më lehtë të menaxhueshme. Kështu në bazë të prioriteteve të investohet në infrastrukturë bashkëkohore dhe të integruar të grumbullimit të mbeturinave.

Mbeturinat nga ndërtimi-demolimi dhe mbeturinat inerte: Sipas Udhëzimit Administrativ (UA) Nr. 07/2015, menaxhimi i këtij lloji të mbeturinave është obligim i komunës. Sipas këtij Udhëzimi Administrativ, komuna në bashkëpunim me komunat përreth, mund ta ndërtojë një deponi për mbeturinat nga ndërtimi-demolimi me qëllim që të mos degradohet edhe më tej mjedisi. Ky UA, gjithashtu përcakton kriteret për përzgjedhjen e vendeve të përshtatshme për këtë lloj të mbeturinave, ku ndër më të rëndësishmet janë: Vendet e përshtatshme për deponimin e këtij lloji të mbeturinave që më parë janë shfrytëzuar për eksploatim me qëllim të mbushjes së gropave, kanaleve të ndryshme të formuara në mënyrë të natyrshme, vende të degraduara, si rezultat i erozionit ose rrëshqitjeve të dheut apo vende tjera të ngjashme.

Siç është përmendur edhe më lartë, është përgjegjësi e komunës t'i trajtojë mbetjet e demolimit-inerte. Mund të thuhet, se të gjitha komunat në Kosovë kanë mbetur prapa në krijimin e deponive-vendeve të përshtatshme për depozitimin e këtyre mbeturinave. Komuna e Prishtinës ka problem në aspektin e grumbullimit të mbeturinave inerte, pasi që nuk ka ndonjë deponi legale për grumbullimin dhe trajtimin e këtij lloji të mbeturinave. Sipas raportit të vlerësimit të gjendjes në menaxhimin të mbeturinave, në komunë pas mbeturinave shtëpiake, mbeturinat inerte përbëjnë përqindjen më të lartë të deponive ilegale me rreth 14.6%.

Nga informacionet në dispozicion, është vënë re se komuna aktualisht nuk angazhohet mjaftueshëm në parandalimin e këtij fenomeni, pasi që ky lloj i mbeturinave mbledhet si mbeturinë normale nga kompanitë me vullnet të mirë, por në anën tjetër, rritja në sasinë e mbeturinave, të cilat nuk janë të detyruar që t'i mbledhin, ndikon edhe në çmimin që ata duhet të paguajnë për deponitë.

Të gjitha planet komunale të menaxhimit të mbeturinave kanë të trajtuar mbetjet inerte dhe zgjidhjet që duhet të ndërmerren nga komunat. Për këtë qëllim, komunat duhet të angazhohen më tepër në përmbytjen e kërkesave të përcaktuara dhe të dakorduara prej tyre në këto plane.

Mbeturinat Industriale: Format e krijimit të deponive industriale janë të natyrave të ndryshme varësisht nga destinimi i prodhimit apo veprimtarisë. Po thuaj, çdo industri në të kaluarën ka trashëguar deponi apo mbetje të rrezikshme, të cilat kanë efekte negative në mjedis. Gjithashtu, pos këtyre mbetjeve të deponuara në deponi veçanërisht nga metalet e rënda, substanca në forma të ndryshme agregate kanë mbetur një kohë të gjatë pa u përdorur nëpër stabilimente, depo dhe reparte industriale. Me kalimin e kohës, disave nga këto substanca kimike iu ka skaduar afati apo janë degraduar, duke ndryshuar përbërjen e tyre dhe konsiderohen si substanca me rrezikshmëri të lartë. Një sasi e tyre janë të ambalazuara, por shumë sosh kanë mbetur të pambrojtura dhe të ekspozuara në mjedis. Deri më tani për reduktimin e rrezikut nga substanca të këtilla janë bërë aktivitete në disa ndërmarrje, kryesisht duke u mbështetur nga donacionet dhe aktivitetet e KFOR-it dhe FSK-së. Si rezultat i prodhimit të ndryshëm industrial, ndërprerjes së prodhimit dhe aktiviteteve të tjera, hasen edhe shumë materiale të rrezikshme. Në tabelën vijuese janë prezantuar të dhëna për llojet e këtyre mbeturinave, lokacionet e deponimit-magazinit dhe sasinë e tyre.

Tabela 36 Mbeturinat industriale

<i>Lloji i mbeturinave</i>	<i>Sasia-Njësi</i>	<i>Lokacioni</i>	<i>Komuna</i>
<i>Substanca kimike të ngurta</i>	<i>231.80 kg</i>	<i>Laboratori në Kishnicë</i>	<i>Prishtinë</i>
<i>Fuqi plastike me acide</i>	<i>9 fuqi</i>	<i>Laboratori në Kishnicë</i>	<i>Prishtinë</i>
<i>Kuti të plastikës të panjohura</i>	<i>15 copë</i>	<i>Laboratori në Kishnicë</i>	<i>Prishtinë</i>

Mbeturinat shëndetësore: Mbeturinat shëndetësore janë një problematik tjetër në komunën e Prishtinës pasi që nuk ka ndonjë hapësirë ku mund të trajtohen si të tilla, dhe për këtë arsye mund të kenë pasoja të mëdha në shëndetin e njeriut.


Institucionet shëndetësore në Komunën e Prishtinës dhe QKUK, brenda një viti prodhojnë një sasi prej 128,857 mijë/kg mbeturina shëndetësore, ku pjesa më e madhe e këtyre mbeturinave trajtohet në impiantin për trajtimin e mbeturinave shëndetësore në Prishtinë, ndërsa mbeturinat nga institucionet private nuk kanë një trajtim të duhur, si rezultat hidhen në hapësira të papërshtatshme dhe bëhen të rrezikshme për shëndetin e njerëzve.

Ky impiant është i vendosur në hapësirat e QKUK-së. Kapaciteti i këtij impianti për trajtimin e mbeturinave medicinale është 250 deri në 300 kg gjatë një cikli dhe brenda ditës mund të zhvillohen 5 deri në 6 cikle. Nga institucionet shëndetësore publike në këtë impiant, trajtohen mbeturinat spitalore nga shtëpitë e shëndetit të qytetit të Prishtinës dhe nga QKUK-ja, kurse një sasi e vogël vjen edhe nga institucionet private shëndetësore, si nga KFOR-i dhe EULEX-i. Gjendja në këtë impiant është e mirë. Impianti punon me kapacitet të plotë. Sasia mesatare mujore e mbeturinave medicinale që trajtohen në këtë impiant është rreth 11.000 kg.

Mbeturinat shtazore: Mbeturinat shtazore mund të konsiderohen si mbeturinat më problematike që bien nën përgjegjësinë e komunës. Këto mbeturina janë mjaft problematike, për shkak se nuk pranohen nga deponitë, megjithatë ka raste që deponitë i pranojnë këto mbeturina në mungesë të hapësirës së duhur për trajtimin e tyre.

Në shumicën e rasteve, burimet e këtyre mbeturinave nuk mund të identifikohen pasi që depozitohen si mbeturina të tjera komunale dhe depozitimi i tyre bëhet gjatë natës, kur inspektorët komunal nuk janë në detyrë. Identifikimi i mishtoreve dhe i fabrikave të përpunimit të mishit është i nevojshëm, por përderisa nuk ekziston ndonjë zgjidhje institucionale, propozohet që këto mbeturina të mbledhen dhe të depozitohen ndaras, ku më vonë pas ndërtimit të deponisë do të na jepte idenë mbi kapacitetin e gjenerimit të këtij lloji të mbeturinave, më pas do të mundësohet krijimi i një baze të duhur të të dhënave që do të shërbente për të identifikuar nëse ndonjë nga këto mbeturina depozitohen në mënyrë të paligjshme. Duke ndjekur parimin Ndotësi paguan, këto aktivitete të veçanta të menaxhimit dhe të trajtimit të mbledhjes së mbeturinave shtazore kërkojnë një tarifë të veçantë.

Komuna e Prishtinës nuk ka deponi, e cila i trajton mbetjet shtazore, këto mbeturina trajtohen në forma të ndryshme, të cilat janë ilegale, komuna duhet të planifikojë që të rezervojë një hapësirë, ku do të trajtohen këto lloje të mbeturinave.



Harta 18 Menaxhimi i mbeturinave

2.5.8.5. Vlerësimi i kapaciteteve të nevojshme të infrastrukturës së zgjeruar apo të re

Kapacitetet teknike - Sipas analizës së vlerësimit të gjendjes së infrastrukturës së mbeturinave, infrastruktura e nevojshme për zgjerim të kapaciteteve për menaxhim të mbeturinave janë:

- Ngritja e kapaciteteve të nevojshme për ndarje të mbeturinave në burim
- Krijimi i një strategjie për riciklim të mbeturinave
- Shënjimi dhe rregullimi i infrastrukturës së deponisë për mbeturina inerte
- Krijimi i deponive transite
- Eliminimi i deponive ilegale
- Ndërtimi i deponisë për mbetje shtazore

Kapacitetet financiare – Ndërmarrja shërbyese Pastrimi gjatë vitit 2020 ka arkëtuar një buxhet prej 2,952,813.00 Euro, i cili përdoret për paga dhe mëditje, amortizim si dhe përmirësim të kapaciteteve infrastrukturore për menaxhimin më të mirë të mbeturinave.

Investimet kapitale të planifikuara për zhvillim janë:

- Deponimi dhe riciklimi i mbeturinave ndërtimore – 656,203 euro
- Ndërtimi i deponive transite të mbeturinave – 331,562 euro
- Ndërtimi i deponisë për trajtimin e mbeturinave të rrezikshme – 991,146 euro

Tabela 37SWOT analiza - Menaxhimi i mbeturinave

Përparësitë	Dobësitë
• Deponia në Mirash; • Impianti për trajtimin e mbeturinave shëndetësore; • Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave; • Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave ; • Komiteti komunal për mbrojtje të mjedisit.	• Shërbime jo të mira në menaxhim të mbeturinave; • Mungesë e deponisë për mbeturina inerte/demolimit. • Mungesa e auditimit mjedisor; • Mungesa e stacioneve të vogla transferuese për mbledhjen dhe selektimin e mbeturinave në zonat rurale; • Mosndarje e mbeturinave në burim; • Raportimet e parregullta mbi gjendjen e ofrimit të

	shërbimeve;
	• Numër i lartë i deponive ilegale; • Sasi e lartë e mbeturinave industriale dhe sanitare; • Burime të ndotjes radioaktive; • Mungesë e hapësirave për trajtim të mbeturinave shtazore.
Mundësitë	Rreziqet
• Fushata vetëdijesuese; • Krijimi i Eko-taksës; • Angazhimi i OJQ-ve mjedisore.	• Rritja e ndotjes; • Shfaqja e sëmundjeve infektive; • Ndotje e tokave bujqësore.

Të gjeturat kyçe sipas analizës në aspektin e grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave janë të radhitura:

- Mbulueshmëria e gjithë territorit me shërbime në aspektin e grumbullimit të mbeturinave;
- Mungesa e deponisë për trajtimin e mbeturinave inerte/demolimit, komuna nuk ka të caktuar hapësirën, e cila do t'i trajtonte këto lloje të mbetjeve, në të ardhmen duhet të planifikohet një hapësirë që do të përmbushte kriteret, si në aspektin vëllimor dhe atë natyror.
- Mungesa e deponisë për trajtimin e mbetjeve shtazore, komuna nuk ka hapësirë të definuar për trajtimin e mbetjeve shtazore, andaj është i domosdoshëm planifikimi i hapësirës, ku do të trajtoheshin këto lloje mbetjesh.
- Deponitë ilegale, sipas raportit mbi menaxhimin e mbeturinave numri i deponive ilegale është i lartë, vetëm në vitin 2021 kemi të regjistruara 277 deponi ilegale, ku pjesa më e madhe e këtyre deponive janë si pasojë e mungesës së deponisë për grumbullimin e mbeturinave inerte/demolimit apo atyre vëllimore.

2.6. Infrastruktura e transportit dhe transporti

Duke marrë parasysh pozitën gjeografike të Prishtinës në nivel të Kosovës dhe më gjerë dhe rolin e saj si kryeqytet i Republikës së Kosovës, gjatë viteve të fundit, sidomos pas luftës, janë bërë zhvillime të shumta që kanë rezultuar me rritjen e migrimit të popullsisë në Prishtinë. Sot në këtë qytet kemi një trafik të dendur në pjesën e hyrjes nga rrugët kryesore të Kosovës, rajonale dhe rrugët tjera lokale. Zhvillimet e kohëve të fundit në zonat pranë qytetit të Prishtinës, janë përqendruar kryesisht në rrugët kryesore, të cilat çojnë në Prishtinë. Ndërtimet e objekteve janë kryesisht komerciale, biznese të vogla ose banesore. Zhvillimi dhe rritja e përqendrimit të këtyre lloj objektiv, si dhe rritja e shpejtë e zhvillimeve të ndryshme, ka bërë që gjendja momentale e trafikut të jetë e ngarkuar, sidomos përgjatë rrjetit kryesor të rrugëve.

Në territorin e komunës së Prishtinës, aktualisht janë dy lloj mjete transporti që përdoren: transporti rrugor dhe transporti hekurudhor. Transporti rrugor ka rolin kryesor në transportin e udhëtarëve dhe të mallrave. Prishtina është e lidhur me rrugë, jo vetëm në linja interurbane, por edhe ndërkombëtare që lidhen me shtetet fqinje. Të gjitha këto linja rrugore çojnë tek stacioni kryesor-Stacioni i Autobusëve të Prishtinës. Ndërmodaliteti mes rrugëve dhe hekurudhave duhet të shtyjë drejt ndërtimit të rrugëve dhe terminaleve të hekurudhave pranë njëra-tjetrës, sepse deri tani ndodhen larg dhe lidhen nëpërmjet rrugës Prishtinë-Fushë Kosovë.

Niveli i motorizimit ka ndryshuar në mënyrë drastike pas vitit 1999. Si rrjedhojë, rrjeti rrugor duhet të zgjerohet me më shumë rrugë, kushtet e të cilave duhet të jenë më të mira për t'u përballur me numrin e tanishëm të automjeteve që shfrytëzojnë këto rrugë. Në kuadër të rrjetit të përgjithshëm të infrastrukturës rrugore, mungojnë shtigjet për biçikleta. Në disa raste sistemi i sinjalizimit të rrugëve nuk është i harmonizuar me standardet evropiane për nga forma, ngjyra dhe dimensionet. Rrjeti i hekurudhës vepron nga stacioni kryesor në Fushë-Kosovë dhe mundëson lidhjen ndërkombëtare

me dy shtetet fqinje (Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë). Linjat hekurudhore janë rreth 333 km, duke mos përfshirë linjat industriale që janë gjithsej 103 km. Këto linja, lokomotivat dhe vagonët e tyre nuk janë në kushte të mira dhe kërkojnë investime të mëdha. Gjendja momentale duhet të përmirësohet sa më shpejt që është e mundur. Aeroporti është jashtë territorit të Prishtinës dhe lidhet nëpërmjet Fushë-Kosovës e Lipjanit me kryeqytetin, me një distancë prej 16 km. Terminali i autobusëve ndodhet në zonën urbane në Prishtinë. Stacioni hekurudhor ndodhet në Fushë-Kosovë, 6 km larg Prishtinës.

2.6.1. Shtirja dhe gjendja e rrugëve ekzistuese

Infrastruktura rrugore në Komunën e Prishtinës është e organizuar në katër nivele: Autoudha, Rrugë Nacionale, Rrugë Rajonale dhe Rrugë Lokale.

Nëpër territorin e Komunës së Prishtinës kalojnë rrugët magjistrale, të cilat kanë karakter tranzit nëpër zonën urbane, por të rëndësishme për të mundësuar komunikimin me qytetet tjera të Republikës së Kosovës dhe shteteve tjera përreth, rrugët lokale, të cilat lidhin zonën urbane me vendbanimet përreth dhe rrugët nëpër vendbanime.

Tabela 38 Veçoritë e rrugëve nacionale/rajonale, Karakteristikat fizike dhe hapësinore, 2018

Kategoria e rrugëve	Gjatësia (m)	Gjatësia (km)
Autoudhë	12634.09	12.63
Rrugë nacionale	110656.05	110.66
Rrugë rajonale	3626.54	3.63
Rrugë lokale	1303742.39	1303.74
Totali:	1430659.07	1430.66

Tabela 39 Mbulueshmëria e hapësirës me infrastrukturë rrugore

Sipërfaqja e mbuluar me rrugë	Sipërfaqja m ²	Sipërfaqja ha
Sipërfaqja e rrugëve	7672956.16	846.35

2.6.1.1. Autoudhët

Rrjeti rrugor i Prishtinës shërben si nyje e lidhjes së autoudhëve Ibrahim Rugova dhe Arbën Xhaferi, të cilat janë funksionale dhe mundësojnë lidhjen e qytetit të Prishtinës me rrjetin rrugor ndërkombëtar. Përmes autoudhës Ibrahim Rugova, mundësohet lidhja e qytetit të Prishtinës me Shqipërinë dhe Serbinë, ndërsa autoudha Arbën Xhaferi mundëson lidhjen e qytetit me shtetin e Maqedonisë së Veriut.

Njëkohësisht, përmes autoudhës Arbën Xhaferi, në të cilën është planifikuar të lidhet autoudha Agim Ramadani (R7.1), mundësohet qasje e lehtë dhe lidhje me kryeqendrën edhe zonave të pjesës lindore të Kosovës.

Karakter i këtyre rrugëve është me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare, sepse përmes tyre përveç se mundësohet lidhja me shtetet fqinje, mundësohet qasja në korridoret pan-evropiane me karakter ndërkombëtar: korridorin 8 dhe korridorin 10.




Figura 2 Lidhja e autoudhëve “Ibrahim Rugova” dhe “Arbën Xhaferi” në pjesën e rrjetit rrugor të Prishtinës

2.6.1.2. Rrugët nacionale dhe rajonale

Tabela 40 Lidhshmëria e Prishtinës me rrugët nacionale

Nr.	Emërtimi i rrugëve	Gjatësia
1	Prishtinë–Prizren-kufiri me Shqipërinë (N25)	85 km
2	Prishtinë–Pejë-kufiri me Malin e Zi (N9)	100 km
3	Prishtinë–Merdare (Pika kufitare me Serbinë, N25)	37 km
4	Prishtinë–Mitrovicë-kufiri me Serbinë (N2)	80 km
5	Prishtinë–Ferizaj-kufiri me Maqedoninë Veriore (N2)	70 km

Përmes rrugëve rajonale dhe rrugëve tjera lidhëse, disa prej të cilave kanë qasje në rrugët nacionale, u mundësohet qasje e lehtë në kryeqendër edhe komunave fqinje Obiliq, Graçanicë, Lipjan dhe Fushë-Kosovë. Këto rrugë, kryesisht janë me nga dy korsi trafiku, por një pjesë e madhe e tyre ka kaluar edhe në nivel të rrugëve me katër korsi. Po ashtu, nga pjesët periferike të qytetit, ku rrugët nacionale integrohen në rrjetin e rrugëve të Prishtinës, qarkullimi i trafikut ka kaluar nga rruga me dy korsi në rrugë me katër korsi (dy korsi trafiku për secilën kahe).

2.6.2. Gjendja e infrastrukturës së transportit në nivel nacional

Parametrat teknik të autoudhëve dhe rrugëve nacionale në përgjithësi i plotësojnë kriteret e projektimit dhe në aspektin infrastrukturor ofrojnë kushte të mira për qarkullim të mjeteve motorike. Në hyrje të qytetit, janë realizuar punime në rehabilitimin dhe rikonstruimin e këtyre rrugëve me qëllim të përmirësimit të kushteve të qarkullimit dhe ofrimit të qasjes më të lehtë për pjesëmarrësit në trafik. Këto rrugë kryesisht janë me nga dy korsi, por një pjesë e madhe e tyre ka kaluar edhe në nivel të rrugëve me katër korsi. Po ashtu nga pjesët periferike të qytetit, ku rrugët nacionale integrohen në rrjetin e rrugëve të Prishtinës, rrjedha e trafikut ka kaluar nga rruga me dy korsi, në rrugë me katër korsi (dy korsi trafiku për secilën kahe).

Nga pikëpamja e infrastrukturës, Prishtina është nyja kryesore, ku bashkohet rrjeti më i rëndësishëm infrastrukturor i vendit. Prishtina është në një pozicion gjeografik mjaft të favorshëm, si në kontekstin rajonal ashtu dhe në atë kombëtar. Në nivel nacional, Prishtina është e lidhur mirë

me të gjitha skajet më të largëta të vendit dhe me shtetet fqinje. Nga Prishtina kalojnë autoudhët, rrugët më të rëndësishme nacionale dhe rajonale, hekurudhore dhe vija ajrore ndërkombëtare.

Më konkretisht:

- Afërsia strategjike me Aeroportin e Ndërkombëtar Adem Jashari (16 km nga qendra e qytetit);
- Lidhja me pjesën jug-lindore të vendit dhe Shqipërinë nëpërmjet Rrugës së Kombit (autoudhën Ibrahim Rugova-R7);
- Lidhja me pjesën jugore të vendit dhe Maqedoninë e Veriut nëpërmjet autoudhës Arbën Xhaferi- R6;
- Përmes autoudhës Arbën Xhaferi, në të cilën është planifikuar të lidhet autoudha Agim Ramadani (R7.1);
- Rrjeti rrugor i Prishtinës, përveç se përfshinë një kryesore lidhëse ndërmjet autoudhëve R7 dhe R6, shërben edhe si qendër e lidhjes së rrugëve nacionale të Republikës së Kosovës. Lidhja e kryeqendrës me qytetin e Prizrenit dhe pikat kufitare në Morinë dhe Merdare, mundësohen përmes rrugës nacionale N25.
- Përmes rrugës nacionale N2, Prishtina lidhet me qytetin e Mitrovicës dhe Ferizajt, gjegjësisht përmes kësaj rruge mundësohet qasja në pikat kufitare Jarinjë, Bërnjak dhe Han i Elezit.
- Pjesë e rrjetit rrugor të Prishtinës është edhe rruga nacionale N9, përmes së cilës kryeqendra lidhet me qytetin e Pejës dhe pikën kufitare me Malin e Zi, në Kullë.

Në pjesët, ku kryqëzohen rrugët nacionale N2 dhe N9 si dhe N25 dhe N2, si forma të kontrollit të trafikut janë zgjedhur kryqëzimet me disnivel dhe në këto nyje nuk paraqiten probleme në aspektin e funksionalitetit të trafikut dhe aspektin e sigurisë.

Pas analizës së gjendjes së autoudhëve, rrugëve nacionale dhe rajonale është konstatuar se:

- Parametrat teknik të autoudhëve, rrugëve nacionale në përgjithësi i plotësojnë kriteret e projektimit dhe në aspektin infrastrukturor ofrojnë kushte të mira për qarkullim të mjeteve motorike;
- Rrugët kryesore që lidhen me pjesë tjera të Kosovës janë shumë të ngarkuara nga qarkullimi i automjeteve;
- Mungesa e rrugëve unazore, ka diktuar funksionin radial të këtyre rrugëve, të cilat sjellin fluks të lartë të trafikut nga qendra tjera të Kosovës dhe më gjerë;
- Kycjet e pakontrolluara dhe në kundërshtim me kriteret, bashkë me standardet teknike për kycje në rrugë nacionale dhe rajonale, kanë ndikuar në uljen e kapaciteteve dhe të sigurisë në trafik.

2.6.3. Gjendja e infrastrukturës rrugore në zonat kadastrale, fshatrat e Komunës së Prishtinës

Viteve të fundit Komuna e Prishtinës ka bërë disa investime të mira në përmirësimin e rrugëve nëpër fshatra, duke investuar në asfaltimin e disa rrugëve dhe shtrimin e zhavorrit në disa të tjera. Këto investime janë bërë fillimisht në rrugët kryesore që lidhin fshatrat me njëra-tjetrën dhe mund të konsiderohen si rrugë lokale. Përqendrimi më i madh i vendbanimeve është përgjatë rrugëve magjistrale dhe rajonale, ndërsa një fenomen i tillë ndodh kryesisht për shkak të ndërtimeve të bizneseve individuale, me qëllim të punësimit dhe të gjenerimit të të ardhurave për nevojat familjare. Rritja e numrit të banorëve në këto rrugë dhe mungesa e infrastrukturës së duhur kanë krijuar nevojën për zhvendosje dhe për përmirësim të rrugëve, trotuareve dhe shtigjeve për biçikleta. Fshatrat, të cilat nuk kalojnë nëpër rrugët kryesore dhe rajonale, janë të lidhura nëpërmjet rrugëve lokale, por nuk kanë përqendrimin e nevojshëm të vendbanimeve siç duhet të jetë përgjatë rrugëve magjistrale dhe rajonale. Rrugët lokale, ku përfshihen edhe rrugët urbane, kryesisht janë me nga dy korsi të trafikut (me nga një korsi për kahe), përveç pjesës urbane në brendi të qytetit, ku rrugët primare, të cilat lidhin qendrën e qytetit dhe institucionet kryesore janë me nga dy korsi të trafikut për kahe.

Ngarkesa e rrugëve nacionale dhe rajonale, të cilat gravitojnë drejt pjesës qendrore të qytetit është edhe si rezultat i mungesës së rrugëve unazore, të cilat do të devijonin trafikun tranzit drejt pjesëve qendrore të qytetit.

Skema e rrugëve unazore aktualisht bazohet në:

- Një unazë qendrore (apo unaza e qendrës) brenda së cilës përqendrohen të gjitha aktivitetet kryesore në Prishtinë;
- Një unazë tjetër e qytetit për të cilën është hartuar projekti, por ende nuk ka filluar realizimi. Unaza e qytetit është parashikuar edhe nga planet zhvillimore paraprahe (PZHU 2012-2022 dhe PZHK 2012-2022). Pas kërkesës për financim që ka bërë Republika e Kosovës, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), ka pranuar kërkesën për financimin e Unazës së qytetit të Prishtinës. BERZH tashmë ka ndarë mjetet për konsulencë, për studimin përfundimtar të fizibilitetit dhe dizajnit preliminar. Fillimi i realizimit të këtij projekti është paraparë të fillojë brenda vitit 2023.

Një çështje kryesore në zgjerimin e infrastrukturës rrugore, mbetet shpërndarja në distancën mes vendbanimeve nëpër fshatra. Sigurisht, një ndarje e tillë e zonave të populluara na ka orientuar drejt formimit të shumë rrugëve që deri tani kanë mbetur të patrajuara, gjatë viteve nuk janë mirëmbajtur dhe ndonjëherë gjatë dimrit është e vështirë që edhe të kalohen nga bora.


Pas analizës së gjendjes së infrastrukturës rrugore në zonat kadastrale dhe fshatrat e Komunës së Prishtinës, është konstatuar, se rrugët urbane brenda qytetit, në aspektin e funksionalitetit, përgjithësisht ofrojnë qasje të mirë për pjesëmarrësit në trafik, përveç lëvizjeve të pamotorizuara, por për shkak të kërkesës së madhe për trafik të automjeteve në orët e pikut vështirësohet operimi i trafikut dhe shoqërohet me bllokime trafiku, gjithashtu në zona të caktuara, në brendi të lagjeve të qytetit, paraqiten vështirësi në operimin e trafikut për shkak të parametrave teknik të rrugëve, të cilat rezultojnë të pamjaftueshme për të përballuar kërkesat për qarkullimin e automjeteve dhe për shkak të kërkesave të mëdha për parkingje në afërsi të rrugës.

Rrugët tjera lokale, të cilat mundësojnë lidhjen me zonat periferike dhe fshatrat e Komunës së Prishtinës, në disa raste, nuk kanë gjerësinë e mjaftueshme dhe elementet gjeometrike të tyre nuk ofrojnë kushte të mira për qarkullim, sidomos mungesa e sinjalistikës, trotuareve dhe shtigjeve për çiklistë, shkakton vështirësi për automjete, këmbësorë dhe çiklistë.

Rrjeti i rrugëve lokale është i pakategorizuar, pa funksion të qartë dhe dizajn adekuat. Kyçjet nga rangu më i ulët në rangun më të lartë bëhen pa kriteret teknike dhe të sigurisë, për pasojë qarkullimi është i vështirësuar dhe ka probleme me kapacitetin e rrugëve. Problemet më të theksuara paraqiten në lagjet me objekte shumëbanesore, në veçanti në zonat me dendësi të madhe si Qendra dhe në akset kryesore të zonave tjera të banimit, si: Lakrishtë (Bulevardi Bill Klinton), Ulipanë (Rruga Fehmi Lladrovci dhe Dëshmorët e Kombit), Qyteza Pejton (Rruga Ukshin Hoti), Lagjja e Studentëve (rruga Afrim Zhitia).

Unaza qendrore (apo unaza e qendrës) brenda të cilës përqendrohen të gjitha aktivitetet kryesore në Prishtinë, është shumë e ngarkuar dhe përpos ngarkesës së udhëkryqeve kryesore përgjatë kësaj rruge unazore, paraqiten edhe probleme tjera të nivelit të shërbimit në pjesë të ndryshme të rrugëve.

Zona e bizneseve dhe industrisë karakterizohen me rrjet më të rregullt të rrugëve dhe me profil më të gjerë se në zonat tjera, ka qasje të mirë dhe komunikacion të rrjedhshëm, kryesisht përgjatë rrugëve nacionale dhe rajonale. Ndërsa, "Zona ekonomike" e cila shtrihet në pjesën veri-përëndimore të qytetit, e cila është paraparë të ndahet në disa destinime (zona industriale, industriale mikse, zona komerciale, komerciale mikse, mikse banim dhe banim komerciale), nuk është e kompletuar me infrastrukturën e nevojshme rrugore, sidomos si rezultat mos realizimit të unazës së qytetit e cila do të kalonte përgjatë kësaj zone.



Harta 19 Infrastruktura e transportit

2.6.4. Vlerësimi i intensitetit dhe kapacitetit të kryqëzimeve dhe korsive kryesore

Pas analizës së të dhënave nga matjet e qarkullimit të automjeteve në rrjetin rrugor të qytetit të Prishtinës¹¹ është vlerësuar, se rrugët më të ngarkuara nga qarkullimi i automjeteve janë: Rrugët nacionale N9 (e cila lidh qytetin e Prishtinës me Fushë-Kosovën) dhe N2 (që lidh qytetin e Prishtinës me Mitrovicën dhe Ferizajn në drejtim të Shkupit). Në këto rrugë brenda 12 orëve (nga 06:00-18:00) qarkullojnë rreth 25000-45000 automjete/12 h në të dy drejtimet.

Në qendër të qytetit, ngarkesa më e madhe nga qarkullimi i automjeteve paraqitet në rrugën: Bulevardi Bill Klinton, në të cilin qarkullojnë rreth 48 000 automjete/12 h dhe Fehmi Lladrovci, në të cilat qarkullojnë rreth 33000 automjete/12 h.

Situata e ngarkesës së trafikut në rrjetin rrugor në qytetin e Prishtinës është treguar në figurën e mëposhtme:

¹¹ Mott MC Donald, Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban




Figura 3 Ngarkesa e trafikut në rrjetin rrugor të qytetit të Prishtinës

Pas analizës së qarkullimit në degët hyrëse të udhëkryqeve kryesore, në rrjetin e qytetit të Prishtinës është konstatuar se udhëkryqet të cilat kanë probleme me kapacitetin janë:

- Udhëkryqi në disnivel në kryqëzimin e rrugëve nacionale M² dhe M25.2 (në Veternik);
- Rrethrotullimi në rrugën nacionale M² (në Lagjen Kalabria) dhe rrethrotullimi në kryqëzimin e rrugëve Fehmi Lladrovci dhe Dëshmorët e Kombit (Rrethi i Flamurit);
- Rrethrotullimi në disnivel në kryqëzimin e rrugëve nacionale M² dhe M9 (në Lakrishtë);
- Rrethrotullimi në kryqëzimin e rrugëve Tirana, Ahmet Krasniqi dhe Zagrebi (në Arbëri);
- Rrethrotullimi në kryqëzimin e rrugëve UÇK, Ilir Konushevcu dhe Agim Ramadani (afër Kuvendit Komunal);
- Udhëkryqi në kryqëzimin e rrugëve Garibaldi, Ukshin Hoti dhe Luan Haradinaj dhe Dritan Hoxha (afër sheshit Ismail Qemali);
- Rrethrotullimi në kryqëzimin e rrugëve Fehmi Lladrovci dhe Arbnor dhe Astrit Dehari (afër Spitalit);
- Udhëkryqi në kryqëzimin e rrugëve Arbënor e Astrit Dehari dhe Holger Pedersen (afër EULEX-it);
- Rrethrotullimi në kryqëzimin e rrugëve Muharrem Fejza, Arbënor e Astrit Dehari dhe Rruga B.


Duke marrë parasysh gjendjen e ngarkesës së udhëkryqeve, sfidat kryesore do të jenë:

- Përmirësimi i nivelit të mbingarkesës në trafik dhe i vonesave gjatë udhëtimit në qytet, i cili aktualisht është shumë i lartë;
- Ballafaqimi me ngarkesën e lartë të trafikut në rrugët kryesore që lidhen me pjesën tjetër të Kosovës, si dhe qendrën e qytetit. Ngarkesa e trafikut nuk ka të bëjë vetëm me orët kulmore, por edhe periudhave tjera kohore të udhëtimit;
- Përmirësimi i kapacitetit dhe nivelit të shërbimit për një numër kryqëzimesh dhe segmentesh të rrjetit rrugor që aktualisht janë të mbingarkuara përtej kapacitetit të tyre në të gjithë qytetin e Prishtinës;
- Menaxhimi dhe rregullimi parkingjeve. Ka nivele të larta të aktivitetit të parkimit afatgjatë në qendër të qytetit, me shumë hapësira të parregulluara ose të menaxhuara në mënyrë joefektive (çështje të zbatimit);

- Akomodimi i të gjithë pjesëmarrësve në trafik, duke krijuar kushte për lëvizje të lirë dhe të sigurt për lëvizjet jomotorike (këmbësorët dhe çiklistët).

2.6.5. Krahاسimi i trendeve të shkallës së motorizimit dhe fluksit të trafikut

Bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), në vitin 2020, rreth 356962 automjete janë regjistruar në Kosovë ose vetëm 0.3% më shumë se në vitin 2019. Nga viti 2011 shkalla e motorizimit në Kosovë është rritur në mënyrë të vazhdueshme, përveç në periudhën 2015-2016 ka pasur një rënie me rreth 7%. Rritja më e madhe në numrin e automjeteve ishte midis periudhës kohore 2012-2013 (rreth 22%) dhe 2014-2015 (rreth 16%), ndërsa në vitet tjera, rritja ka qenë nga 3-6%.



Grafika 9 Trendi i rritjes së shkallës së motorizimit në Kosovë

2.6.1. Modelet e qarkullimit të trafikut

Varësisht nga mënyrat dhe territori nëpër të cilin zhvillohet, qarkullimi në Komunën e Prishtinës realizohet nga mjete të qarkullimit rrugor dhe hekurudhor. Në mungesë të infrastrukturës adekuate hekurudhore dhe gjendjes jo adekuate të mjeteve, qarkullimi hekurudhor përfaqëson vetëm një pjesë shumë të vogël të komunikacionit tokësor.

Pas analizës së rezultateve nga anketimet e realizuara për nevojë të hartimit të PMQU¹² lidhur me mënyrën e udhëtimeve, është konstatuar se forma më e përhapur e udhëtimit realizohet nga veturat, rreth 35%. Udhëtimet me autobus dhe në këmbë përbëjnë 24%, respektivisht 23.5% të udhëtimeve, gjë që është pozitive sa i përket kërkesës së përgjithshme për udhëtim të qëndrueshëm në qytet. Më shumë se 50% e të anketuarve komentuan se vendosja e pajisjeve dhe infrastrukturës së përmirësuar të çiklizmit (duke përfshirë korsitë e çiklizmit etj.) do t'i inkurajonte ata ta shfrytëzonin më shumë këtë mënyrë të udhëtimit, prandaj ka disa shenja inkurajuese që sigurimi i masave të reja në rrugë, për të përmirësuar kushtet dhe sigurinë për çiklistët, do t'i inkurajonte ata ta konsideronin këtë mënyrë të udhëtimit. Nga analiza e mësipërme është konstatuar, përdorimi shumë i lartë i automjeteve personale për lëvizje ditore. Efikasiteti i ulët dhe mbulueshmëria me rrjetin e Transportit Urban ka ndikuar në përdorimin e automjeteve personale nga qytetarët. Sikurse në tërë Kosovën edhe në territorin e Prishtinës, infrastruktura hekurudhore përballet me një gjendje jo të mirë. Kjo gjendje ka ndikuar në mos përdorimin e hekurudhës si një formë e transportit, por në përgjithësi modeli më i përhapur i qarkullimit të jetë trafiku rrugor e kryesisht përdorimi i automjeteve private.

¹² MottMcDonald, *Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban*

2.6.2. Transporti hekurudhor

Rrjeti hekurudhor përshkon Komunën e Prishtinës, i cili lidh atë me Mitrovicën, me Pejën dhe me Maqedoninë e Veriut. Pra, Prishtina është një kryesore e lidhjes së qyteteve të mëdha përmes infrastrukturës hekurudhore si dhe lidhjen e Kosovës me shtetet fqinje. Në territorin e Komunës së Prishtinës kalon 20781.33 metra infrastrukturë hekurudhore.

2.6.3. Transporti ajror

Komuna e Prishtinës nuk posedon transport ajror, qytetarët e Prishtinës e shfrytëzojnë Aeroportin Adem Jashari në Lipjan për nevojat e tyre, i cili ka një distancë prej 20 km që arrihet për një kohë prej 30 minutash. Po ashtu qytetarët e Komunës së Prishtinës shfrytëzojnë Aeroportin e Shkupit për të realizuar udhëtimet e tyre, distanca e të cilit është 110 km, ku arrihet për një kohë prej 1 orë e 30 minuta.

2.6.4. Transporti urban dhe ndërrurban

Në Komunën e Prishtinës operojnë 34 linja për transportin e udhëtarëve me autobusë, 24 prej të cilave janë linja komunale dhe urbane periferike, ndërsa 11 prej tyre janë linja urbane, të cilat kanë të rregulluar itineraret e tyre si në vijim:

- Linja 1: Prishtinë–Fushë Kosovë,
- Linja 1/A Prishtinë-Aeroporti Adem Jashari, Lipjan,
- Linja 2: Prishtinë-Kastriot (Obiliq),
- Linja 3: Lagjja Mat (te Rrethi)-fsh. Bardhosh,
- Linja 3/A: Rr. 27 Nëntori-Lagjja e Spitalit,
- Linja 3/B: Bardhosh (Bardhoshët)-Prishtinë (Arkivi i Kosovës),
- Linja 3/C: Sinidoll-Rruga B
- Linja 4: Mat-Pishina e Gërmisë,
- Linja 5: Sofali-Prishtinë-Zona industriale,
- Linja 6: L. Fidanishtja-L. Arbëria (Dragodan)-Arkivi i Kosovës,
- Linja 6A: L. Arbëria (Dragodan) , te Varrezat-Tregu me shumicë,
- Linja 7: L. Kolovica e Vjetër-Kombinati i tekstilit Kosova,
- Linja 7/A : L. Vreshtat, rr. Xhavit Ahmeti-Arkivi i Kosovës,
- Linja 7/B : Llukar-Prishtinë-Zona ind,
- Linja 7/C: Kalabri-Qendër-Sh. Ekonomike-Stacioni i Autobusëve,
- Linja 8: Grashticë-Prishtinë (Arkivi i Kosovës),
- Linja 9: Lagjja e Matit (Matiçan)-Tregu me shumicë,
- Linja 9/A: Lugmir (Zlutar)-Prishtinë-Zona industriale,
- Linja 10: Hajvali-Prishtinë,
- Linja 11: Barilevë-Prishtinë,
- Linja 12: Lagjja e Llumnicëve (Barilevë)-Prishtinë (Stacioni hekurudhor),
- Linja 13: Sharban-Lluzhan-Prishtinë,
- Linja 14: Glllogovicë-Prapashticë-Prishtinë,
- Linja 15: Keqekollë-Grashticë-Prishtinë ,
- Linja 16: Siqevë-Bërnice-Prishtinë ,
- Linja 17: Busi-Mramor-Prishtinë.
- Linja 18: Viti e Marefcit-Slivovë-Prishtinë,
- Linja 19: Kishnicë-Prishtinë,
- Linja 20: Shashkovc-Shushicë-Prishtinë,
- Linja 21: Llapje Sellë-Çagllavicë-Prishtinë,
- Linja 22: Teneshdoll-Prishtinë,
- Linja 23: Koliq-Grashticë-Prishtinë,
- Linja 24: Ballaban-Keqekollë-Prishtinë,
- Linja 25: Rimanishtë-Besi-Prishtinë,
- Linja 26: Hajkobillë-Dabishefc-Prapashticë-Prishtinë.

[illegible]

Përveç transportit urban dhe ndërrurban, Komuna e Prishtinës në aspektin e komunikimit të linjave të autobusëve ka lidhje me të gjitha qytetet e Kosovës, po ashtu stacioni i autobusëve në Prishtinë ka linja të rregullta edhe me shtetet fqinje apo linja internacionale, si me Shqipërinë, Magedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbinë.

- Shumë autobusë janë të vjetër dhe nuk i plotësojnë kërkesat teknike dhe standardet e kërkuara për transportin modern të udhëtarëve në aspektin e qasjes dhe niveleve të emetimit (standardet e motorit);
- Ka zona të qytetit që aktualisht nuk kanë qasje në një shërbim të rregullt të autobusëve (ose kanë nivel të kufizuar të shërbimit), me disa rrugë aktualisht shumë të ngushta për të akomoduar autobusët standard;
- Oraret e pakoordinuara dhe mosintegrimi i shërbimeve dhe linjave të autobusëve në të gjithë qytetin, zvogëlojnë mundësitë për shërbime lidhëse për pasagjerët;
- Sistemi i biletimit është jotërheqës dhe i paintegruar, ku për çdo itinerar-shërbim kërkohet një biletë e veçantë, përveç autobusëve shtetëror të cilët ofrojnë edhe bileta ditore (të vlefshme 24 orë);
- Mungojnë të dhënat dhe informatat lidhur me hollësitë e shërbimit të autobusëve/vendndaljeve, duke përfshirë emërtimin, shenjat dhe informatat (kryesisht oraret) në vendndaljet e autobusëve;
- Mungesa e masave prioritare të dedikuara për autobusë, duke përfshirë shiritat e veçantë për autobusë dhe platformat për hyrje-daljet nga autobusi në vendndalje. Shumë autobusë përballen me problemin e automjeteve të parkuara në vendndalje apo në afërsi të tyre, duke kufizuar kështu qasjen në anësoren e sheshtë të trotuarit;
- Shumë dokumente dhe të dhëna të transportit publik japin informata të ndryshme dhe shpesh kontradiktore. Nuk ka një pasqyrë të plotë të rrugëve dhe operatorëve të

autobusëve, të numrit të linjave të autobusëve, itinerareve të linjave të autobusëve, me të dhëna jo të plota të transportit publik në dispozicion;

- Ka gjithashtu mungesë të të dhënave për operatorët e transportit publik sa i përket shfrytëzimit të autobusëve-shërbimeve, si dhe pajisjeve në vendndalje etj., dhe
- Shumë shërbime operojnë në rrugë të ngjashme, madje ka dëshmi të dyfishimit të shërbimit që kërkon vëmendje të veçantë në kuadër të rishikimit të përgjithshëm dhe rristurimit të rrjetit të qytetit.

2.6.4.1. *Transporti publik në qytetin e Prishtinës–Koncepti i ri sipas PMQU të Prishtinës*

Zhvillimi i një sistemi të integruar të transportit publik është qëllimi kryesor i strategjisë që synon përmirësimin e qasjes në të gjithë qytetin dhe përmirësimin e lidhjes ndërmjet vendbanimeve të tjera urbane, në partneritet me ofruesit e transportit publik. Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU)¹³ për qytetin e Prishtinës, është përqendruar në përmirësimin e shërbimeve të autobusëve në Prishtinë, duke përfshirë zbatimin e më shumë masave për të përmirësuar kohën dhe besueshmërinë e udhëtimit. Në kuadër të këtij plani, është propozuar rritja e nivelit të shfrytëzimit të transportit publik përmes rrjetit të ri kryesor të autobusëve që do të ofrojë shërbim më të shpejtë dhe më të shpeshtë. Nga ana tjetër, kjo do të tërheqë një numër më të madh të shfrytëzuesve, e shoqëruar me një qasje të re të projektimit për vendet kryesore, ku mund të ndërrohet mënyra e transportit (pikat e transferimit–hubs) për të krijuar kapacitete shtesë dhe lehtësi lëvizjeje për udhëtarët, me vonesë minimale mes shërbimeve. Përveç shërbimeve të reja bazë që janë propozuar, rekomandohet një nivel tjetër shërbimi, të ashtuquajturat shërbime dytësore, të cilat do të operojnë me shpeshtësi më të ulët sesa shërbimet kryesore, por do të sigurojnë lidhje të rëndësishme me zonat e banimit, periferitë e qytetit dhe fshatrat.

Skema e re e rrjetit të autobusëve është strukturuar si vijon:

- **Rrjeti kryesor:** Synon rritjen e mbulueshmërisë dhe frekuencën e shërbimeve të autobusëve si një alternativë tërheqëse, krahas përdorimit të automjeteve për udhëtime për në qendrën e qytetit. Një ndër objektivat kryesore të këtyre shërbimeve është sigurimi i shpejtësive më të besueshme operative dhe orareve më të besueshme për të ndihmuar në tërheqjen e pasagjerëve të rinj. Rrjeti kryesor përfshin linjat aktuale të shërbimit të autobusëve 1-7.
- **Rrjeti dytësor-plotësues:** Në mbështetje të rrjetit kryesor, janë projektuar një varg rrugësh dytësore ose plotësuese që do të lidhnin qendrën kryesore urbane me zonat periferike (të banimit), si dhe më gjerë. Këto shërbime dytësore gjithashtu do të lidhnin më shumë zona rurale dhe zona periferike të qytetit me qendrën kryesore urbane. Rrjeti plotësues përfshin linjat e shërbimit të autobusëve numër 10-21 dhe 2A, 2B dhe 2C.

Rrjeti gjithashtu siguron lidhje të reja me Komunën e Podujevës, lagjet Kalabria dhe zonën periferike Shkabaj, ku shpeshtësia e shërbimit të autobusëve bazohet në llojet e destinimit të sipërfaqeve dhe nivelin e përdorimit. Në përgjithësi, rrjeti i ri do të ofrojë një nivel të përmirësuar të shërbimit (ose të paktën të njëjtë në disa zona) në të gjithë qytetin në krahasim me kushtet ekzistuese. Në përgjithësi, rrjeti i ri i propozuar përfshin gjithsej 22 shërbime të autobusëve me linjat që ofrojnë mbulueshmëri të mirë në të gjithë qendrën e qytetit dhe rrethinat. Asnjë prej shërbimeve ose linjave të autobusëve nuk janë të njëjta me ato ekzistuese dhe koncepti i rrjetit të ri synon të përmirësojë qasjen dhe cilësinë e përgjithshme të shërbimeve të transportit publik. Rrjeti përfshin edhe një qasje të re për shkëmbimin e përmirësuar mes mënyrave të ndryshme të transportit si dhe mes linjave (për shembull, krijimin e pikave të reja të transferimit), ku pjesët e linjave të reja përputhen me shtrirjen ekzistuese të linjave. Rrjeti i ri i propozuar është paraqitur më poshtë.

¹³ Mott MÇdonald, *Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban*





Figura 5 Rrjeti kryesor dhe dytësor i propozuar i transportit publik në Prishtinë¹⁴

2.6.5. Shfrytëzimi i rrugëve nga këmbësorët, biçikletat, makinat dhe metodat tjera të transportit

Rrugët e qytetit të Prishtinës në kuadër të zhvillimit të transportit (lëvizjeve), karakterizohen me përdorues të ndryshëm. Për përmbushjen e kërkesave për transport, lëvizjet realizohen në formë të:

- Lëvizjeve të motorizuara (veturat për përdorim personal dhe autobusët urban) dhe
- Lëvizje të pamotorizuara (lëvizja e këmbësorëve dhe e çiklistëve).

Formë tjetër të transportit-lëvizjeve në kuadër të qytetit nuk realizohet. Në mbështetje të aktiviteteve dhe të angazhimit të qytetarëve për lëvizje ditore, është zhvilluar një anketim gjithëpërfshirës online për të siguruar një pikëpamje të përgjithshme nga banorët, bizneset dhe vizitorët në Prishtinë në aspekte të ndryshme që kanë të bëjnë me komunikacionin dhe transportin¹⁵.



Grafika 10 Mënyrat më të shpeshta të lëvizjes

Bazuar në anketimet gjithëpërfshirëse për mënyrat e lëvizjeve, është konstatuar se automjetet personale dominojnë në strukturën e përgjithshme të qarkullimit me rreth 54% (23% si drejtues të automjeteve dhe 31% në cilësi të bashkëudhëtarëve), ndërsa transporti urban shfrytëzohet rreth 24%, transporti me furgon (kombibus) me rreth 5% dhe shërbimet taksi shfrytëzohen rreth 2%. Nga ana tjetër, në kuadër të lëvizjeve të pamotorizuara, prania e këmbësorëve në strukturën e përgjithshme

¹⁴ Mott Maçdonald | Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban të Prishtinës (PMQU).

¹⁵ Mott Maçdonald | Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban të Prishtinës (PMQU).

të qarkullimit-ecja në këmbë është me rreth 15%, ndërsa përdorimi i biçikletës është shumë i ulët me vetëm 0.6%.

Duke analizuar dimensionet dhe shtrirjen e rrjetit rrugor të qytetit të Prishtinës, rezulton se:

- Në shumicën e gjatësisë së rrjetit përgjatë rrugëve primare, prioritet i është dhënë lëvizjeve të motorizuara në kuptimin e akomodimit të lëvizjeve;
- Në shumicën e gjatësisë së trotuareve, paraqiten pengesa fizike konstruktive, automjete të parkuara në mënyrë gjatësore. Edhe përkundër masave të ndërmarra nga organet komunale për ndarje fizike në mes lëvizjeve të këmbësorëve dhe automjeteve përgjatë rrugëve kryesore të qytetit të Prishtinës, duke vendosur pengesa fizike, përsëri gjerësia e hapësirës së dedikuar është e pamjaftueshme.
- Kalimi i rrugës nga këmbësorët, përveç nënkalimit në rrugën Bill Clinton, realizohet në nivel të njëjtë me lëvizjen e automjeteve. Për shkak të fluksit të madh të qarkullimit të këmbësorëve, në pika të caktuara të kalimit, vërehet ndikimi i lëvizjes së këmbësorëve në qarkullimin e automjeteve, duke krijuar pengesa në lëvizje.

Përgjatë rrugëve kryesore, qarkullimi i lëvizjeve, në shumicën e kryqëzimeve është i rregulluar me sinjalizim ndriçues.

Lëvizja e pamotorizuar përmes biçikletave aktualisht është në një nivel shumë të ulët të përdorimit (rreth 0.6 % e lëvizjeve). Kjo gjë mund të arsyetohet me disa nga specifikat e qytetit të Prishtinës:

- mungesa e shtigjeve për lëvizje të çiklistëve;
- perceptimi për mungesë të sigurisë së lëvizjes me biçikletë;
- mungesa e informimit për dobithë përfituese (benefitet) e lëvizjes me biçikletë;
- mungesa e inkurajimit në përdorimin e biçikletës; dhe
- terreni i papërshtatshëm në disa zona të qytetit (pjerrtësia e madhe).

Përgjatë rrugëve dytësore, pothuajse në tërë gjatësinë paraqitet mungesa e lëvizjes komode të lëvizjeve të pamotorizuara (këmbësorëve dhe biçiklistëve), ku ekzistojnë trotuare në gjerësi të pamjaftueshme, si dhe në pjesët, ku nuk ekzistojnë trotuaret, lëvizja realizohet në hapësira të përbashkëta të qarkullimit me automjetet. Lëvizja e biçiklistëve, realizohet pa asnjë shënim përkatës përgjatë sipërfaqes qarkulluese, duke shfrytëzuar skajin e djathtë të shiritit qarkullues. Kalimi i rrugës nga këmbësorët dhe biçiklistët, realizohet në të njëjtin nivel, ku në pjesë të caktuara mungojnë sinjalizimet përkatëse për vendkalim të këmbësorëve. Vështirësitë paraqiten sidomos gjatë lëvizjes natën nga këmbësorët dhe biçiklistët.

Në përgjithësi, rrjeti rrugor i qytetit të Prishtinës shfrytëzohet nga automjetet për përdorim personal, transport urban, këmbësorët dhe biçiklistët. Formë tjetër e lëvizjes nuk aplikohet. Shikuar gjendjen e rrjetit rrugor, formën, dimensionin dhe rregullimin e qarkullimit, mund të konstatojmë se prioritet për akomodim i është dhënë lëvizjes së motorizuar.

2.6.6. Shpërndarja modale e lëvizjeve brenda pjesës urbane

Sipas anketimit të familjeve¹⁶, shpërndarja modale e lëvizjeve varësisht nga mosha është dhënë në Figurën vijuese:

¹⁶ PMQU (SUMP- HOUSEHOLD MOBILITY SURVEY REPORT), 2017.




Figura 6 Shpërndarja modale e lëvizjeve

Siç vërehet edhe në figurën e mësipërme, brenda zonës urbane lëvizjet realizohen më tepër duke ecur në këmbë (nga 36-52%), por edhe përdorimi i automjeteve personale merr një përqindje të lartë, sidomos tek mosha e re dhe e mesme. Varësisht nga mosha, përqindja e përdorimit të automjeteve personale ndryshon nga rreth 6-29%. Transporti urban arrin një përqindje nga 20-28% që është nën nivelin e shfrytëzimit të transportit urban në vendet evropiane¹⁷, ndërsa prania e biçikletave në strukturën e përgjithshme të qarkullimit mbetet ende nën 1%. Niveli i ulët i përdorimit të biçikletës për lëvizje ditore, pos tjerash është edhe si rezultat i mungesës së infrastrukturës adekuate për biçikleta.

2.6.7. Vlerësimi i hapësirave ekzistuese për parkim

Në vitet e fundit Prishtina ka pasur një rritje të konsiderueshme në përdorimin e automjeteve private dhe të dhënat sugjerojnë, se kjo rritje është duke vazhduar edhe në ditët e sotme. Dihet se nivelet e larta të përdorimit të automjeteve shpesh krijojnë probleme si mbingarkesa në trafik, e cila shpesh përkeqësohet në periudhat kulmore. Tashmë ka kërkesa të larta për parkim në rrugë në qytet nga bizneset, banorët si edhe vizitorët në zonat komerciale, zonat tregtare dhe zonat e rekreacionit. Pjesën më të madhe të ditës, hapësirat e parkimit në dispozicion në Prishtinë, nuk mund të plotësojnë kërkesën dhe kështu dihet, se ka shumë nevojë që të përmirësohet menaxhimi i hapësirave të kufizuara të parkimit në dispozicion. Hulumtimi ka zbuluar se qendra e qytetit dhe zonat e banueshme periferike përballen me probleme të parkimit që shpesh rezultojnë në vende të mbingarkuara dhe me probleme të ndërlidhura me sigurinë rrugore. Me rritjen e nivelit të përdorimit të automjeteve në zonat urbane, përfshirë edhe Prishtinën, është e rëndësishme të menaxhohet kërkesa për udhëtime dhe të kontrollohen zonat e parkimit në mënyrë më efektive si pjesë e strategjisë së re të transportit. Duhet të përmirësohet menaxhimi i aktivitetit të parkimit, përfshirë hapësirat në rrugë dhe jashtë rrugës si pjesë e strategjisë holistike për qytetin që synon balancimin e nevojave të transportit dhe mënyrave tjera të transportit, të tilla si transporti publik dhe mënyrat aktive (ecja dhe çiklizmi).

¹⁷ Modal shares in selected European Capitals. Author's elaboration on data from (EPOMM, 2018).

se përdorimi i parkingut–raporti i numrit të vendparkimeve të zëna për një periudhë kohore, në krahasim me hapësirën totale në dispozicion, tregon se, më shumë se gjysma e përdoruesve qëndrojnë për periudha të gjata kohore (p.sh. banorët e periferisë-banorët e qyteteve tjera);

- **Shfrytëzim i dobët i hapësirave të parkimit** - Është konstatuar se ekzistojnë nivele shumë të ulëta të rotacionit në zonat qendrore urbane, duke theksuar se hapësirat e parkimit nuk janë shumë efikase. Në disa raste, për një periudhë prej 12 orëve, një vendparkim përdoret vetëm nga dy automjete;
- **Kostoja e ulët e parkimit** - Parkimi i automjeteve është relativisht me kosto të ulët në Prishtinë, në shumë hapësira që ofrojnë parkim pa pagesë. Shumë nga vendparkimet në zonën urbane nuk janë të kufizuara në kohë dhe shfrytëzohen për periudha të gjata nga njerëzit që i parkojnë automjetet e tyre në qendër të qytetit (p.sh. personat që banojnë në periferi apo në qytete tjera);
- **Niveli i lartë i parkingjeve private jashtë rrugës** - Brenda qendrës së qytetit ekziston një numër i madh i parkingjeve private të automjeteve, të cilat ofrojnë kosto të ulët të parkimit pa kufizime kohore. Këto hapësira rrisin nivelin e lëvizjes së automjeteve në/nga qendra e qytetit;
- **Mungesa e zbatimit të rregullave të parkimit** - Zbatimi i rregullave është kërkesë kryesore e çdo strategjie të suksesshme të parkimit, në Prishtinë ekzistojnë burime të kufizuara në dispozicion për menaxhimin dhe kontrollimin në mënyrë efektive të aktivitetit të parkimit në qendër të qytetit.

2.6.8. Lëvizjet aktive

Është me rëndësi që të mbështeten planet investuese në infrastrukturën e mobilitetit urban përmes promovimit të sjelljes së qëndrueshme të udhëtimit, drejt inkurajimit të përdorimit të mënyrave më aktive të udhëtimit, siç janë ecja dhe çiklizmi. Kjo përfshin përmirësimin e kushteve për ecje dhe çiklizëm, ofrimin e shtigjeve të sigurta, të qasshme dhe të përshtatshme për këto mënyra jo të motorizuara. Ekzistojnë një varg opsionesh-konceptesh të mundshme për përfshirje në strategjinë e lëvizjeve aktive, duke përfshirë:

- zhvillimin e koncepteve strategjike të rrjetit të shtigjeve për këmbësorë dhe çiklizëm me standarde të miratuara të projektimit, të ofruara për lloje të ndryshme të shtigjeve të këmbësorëve dhe të çiklistëve në të gjithë qytetin. Kjo do të përfshijë udhëtime në qendër të qytetit, si dhe ato në vende më periferike, siç janë lagjet rezidenciale lokale dhe komunitetet periferike;
- skema e zonës së zgjeruar për këmbësorë në qendër të qytetit, duke zgjeruar zonën që të përfshihen rrugët e afërta, për të siguruar një zonë më të gjerë në të mirë të këmbësorëve dhe
- masat për të ndihmuar mobilitetin e personave me nevoja të veçanta, futjen e masave të tjera për të ndihmuar personat e verbër, me të pamur të pjesshëm (p.sh. shtrimi i sipërfaqes me material të dhëmbëzuar në vendkalimet e këmbësorëve).

Në kuadër të Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU) janë evidentuar çështjet kryesore lidhur me lëvizjet aktive.

Përmbledhja e çështjeve kryesore, sipas këtij Plani është si në vijim:

- shtigjet e këmbësorëve të cilësisë së dobët dhe mungesa e hapësirave të sigurta dhe të përshtatshme të kalimit të rrugës;
- çiklistët përbëjnë më pak se 1% të përdoruesve të transportit në Prishtinë, mund të bëhet shumë më shumë për të rritur këtë shifër;
- çështjet e sigurisë për këmbësorët dhe çiklistët në zonat urbane: Suksesi i zonës së centralizuar të këmbësorëve në qendër të Prishtinës vazhdon të ofrojë hapësirën për pjesën më të madhe të aktivitetit të këmbësorëve në qendër të qytetit, duke siguruar një mjedis të sigurt. Mund të bëhet edhe më shumë për të zgjeruar zonën, për të ofruar komoditet më të madh për këmbësorët në qendër të qytetit;

- mungesa e rrjeteve të integruara të shtigjeve për këmbësorë dhe çiklistë, duke marrë parasysh gamën e gjerë të llojeve të udhëtimit në të gjithë qytetin dhe udhëtimit për aktivitete të ndryshme, shkollë dhe punë, duhet të zhvillohen koncepte të reja të rrjetit të shtigjeve për këmbësorë dhe çiklistë për të identifikuar shtigjet kyçe për destinacionet kryesore, me qëllim identifikimin dhe zbatimin e masave për të përmirësuar komoditetin, qasjen dhe sigurinë e këmbësorëve.

2.6.9. Vlerësimi i nevojave në të ardhmen për një infrastrukturë transportuese

Infrastruktura transportuese duhet të planifikohet dhe zhvillohet me një perspektivë afatgjatë, në të cilën merren parasysh nevojat e ardhshme dhe zhvillimet e ardhshme urbane, hapësinore dhe teknologjike. Është thelbësore që zhvillimi i ri të mundësojë një transport të qëndrueshëm, duke përfshirë largimin e trafikut tranzit nga brendia e qytetit, krijimin e kushteve për lëvizje aktive dhe qasjen më të mirë në transportin publik.

Për një infrastrukturë transportuese dhe funksionale në të ardhmen është e nevojshme:

- krijimi i një rrjeti rrugor me një hierarki të qartë dhe të finalizuar, i cili do të devijojë trafikun tranzit nëpër qytet dhe të kufizojë përdorimin e papërshtatshëm të rrugëve urbane;
- sigurimi i unazës së qytetit është element kyç, i cili duhet të ketë prioritet;
- krijimi i mundësisë për korsi të biçikletave (transportit alternativ) me qëllim të veçantë në ndërlidhjen në mes lagjeve të banimit dhe shkollave në mënyrë që të mundësohet lëvizje e shpejt dhe e sigurt e fëmijëve dhe stafit në relacionin shtëpi – shkollë dhe anasjelltas;
- rishikimi i transportit publik me fokus të veçantë në ndërlidhjen lagje banimi-shkollë-institucione me qëllim të stimulimit të përdorimit të tij nga qytetarët si mjeti më i përshtatshëm për lëvizje nëpër qytet.

2.6.9.1. Përmirësimi i unazës së qendrës (Unaza qendrore)

Në kuadër të rrjetit rrugor urban të qytetit të Prishtinës është funksionale unaza e qendrës, por është e nevojshme të bëhen përmirësime në aspektin e operimit të trafikut, gjegjësisht ndryshimit të regjimeve të trafikut dhe funksionalitetit më të mirë të formave të kontrollit, në mënyrë që të mundësohet akomodim më i mirë i të gjithë përdoruesve të rrugës, rritje e nivelit të sigurisë, operim më i lehtë i transporti publik dhe në përgjithësi kualitet më i mirë në qarkullim.

2.6.9.2. Ndërtimi i unazës së qendrës (Unaza qendrore)

Me qëllim të përmirësimit e të integritetit të qytetit dhe devijimin e fluksit transit të trafikut, eliminimin e bllokimeve të trafikut në pjesën qendrore, përmirësimin e sigurisë në trafik dhe mbrojtjen e ambientit, është e nevojshme realizimi i ndërtimit të unazës së qendrës. Unaza e qendrës do të ketë për qëllim përmirësimin e shpërndarjes së rrugëve urbane, me krijimin e trotuareve dhe shtigjeve për çiklistë. Unaza e qendrës duhet të jetë një bulevard i gjerë i qytetit, me karakter urban joperiferik. Kjo do të lejojë qasje dhe parking përgjatë një rruge paralele të shërbimit. Ajo mund të caktojë hapësirë për të gjithë përdoruesit e rrugës (korsi veturash, një korsi e dedikuar për autobus, shtigje për çiklistë, rrugë shërbyese, parkim në linjë dhe në fund një trotuar të gjerë). Kalimi nga rrugët kryesore në rrugë shërbyese duhet të jetë i mundur vetëm në udhëkryqe, në mënyrë që të mos ndërpritet qarkullimi i trafikut. Pjesa më e madhe e unazës së qendrës qëndron në zonat ekzistuese ose të planifikuara urbane, dallimet mund të ekzistojnë, por në të ardhmen afatgjatë duhet të lejohet një uniformitet përgjatë gjithë gjatësisë së bulevardit, duke rritur njohjen e rrugës, si element i rëndësishëm i Prishtinës. Vazhdimësia duhet të jetë e garantuar në pjesën për vettura dhe korsi të autobusëve, këmbësorë dhe shtigjet e çiklistëve. Jashtë zonave urbane në vendparkingje, stacionet e autobusëve duhet të planifikohen në atë mënyrë që si të tilla mund të largohen.

Parku i Gërmisë është zona kryesore e gjelbër për banorët e Prishtinës dhe për këtë arsye mund të konsiderohet si një pjesë e zonës urbane, ajo duhet të përmirësojë qasje në shumë pika, mundësi për t'u parkuar jashtë, mundësi për të arritur me autobus dhe me biçikletë. Unaza e qendrës është parashikuar edhe nga planet zhvillimore paraprahe (PZHU 2012-2022 dhe PZHK 2012-2022). Pas kërkesës për financim që e ka bërë Republika e Kosovës, Banka Evropiane për Rindërtim dhe

Zhvillim (BERZH) ka pranuar kërkesën për financimin e Unazës së brendshme të qytetit të Prishtinës. BERZH tashmë ka ndarë mjetet për konsulencë për studimin përfundimtar të fizibilitetit dhe dizajnit preliminar. Fillimi i realizimit të këtij projekti është paraparë të fillojë brenda vitit 2020.

2.6.9.3. Unaza e qytetit

Me qëllim të përmirësimit e të integritit të qytetit dhe devijimin e fluksit të trafikut, eliminimin e bllokimeve të trafikut në pjesën qendrore, përmirësimin e sigurisë në trafik dhe mbrojtjen e ambientit, është e nevojshme realizimi i ndërtimit të unazës së qytetit. Unaza e qytetit do të ketë për qëllim përmirësimin e shpërndarjes së rrugëve urbane, me krijimin e trotuareve dhe shtigjeve për çiklistë. Unaza e qytetit duhet të jetë një bulevard i gjerë i qytetit, me karakter urban joperiferik. Kjo do të lejojë qasje dhe parking përgjatë një rruge paralele të shërbimit. Ajo mund të caktoj hapësirë për të gjithë përdoruesit e rrugës (korsi veturash, një korsi e dedikuar për autobus, shtigje për çiklistë, rrugë shërbyese, parkim në linjë dhe ne fund një trotuar i gjerë). Kalimi nga një rrugë kryesore në një rrugë shërbyese duhet të jetë i mundur vetëm në udhëkryqe, në mënyrë që të mos ndërpritet qarkullimi i trafikut. Pjesa më e madhe e unazës së qytetit qëndron në zonat ekzistuese ose të planifikuara urbane, dallimet mund të ekzistojnë, por në të ardhmen afatgjatë duhet të lejohet një uniformitet përgjatë gjithë gjatësisë së bulevardit, duke rritur njohjen e rrugës, si element i rëndësishëm i Prishtinës. Vazhdimësia duhet të jetë e garantuar në pjesën për vettura dhe korsi të autobusëve, këmbësorë dhe shtigje për çiklistë. Jashtë zonave urbane në vendparkingje, stacionet e autobusëve duhet të planifikohen në atë mënyrë që si të tilla mund të largohen.

Unaza e qytetit është parashikuar edhe nga planet zhvillimore paraprake (PZHU 2012-2022 dhe PZHK 2012-2022). Pas kërkesës për financim që e ka bërë Republika e Kosovës, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) ka pranuar kërkesën për studimin përfundimtar të fizibilitetit dhe dizajnit preliminar.

2.6.9.4. Unaza e jashtme

Unaza e jashtme ka qenë e propozuar në Planin Strategjik Zhvillimor Urban të Prishtinës (PZHU 2004-2020) dhe në Planin Zhvillimor Komunal (PZHK 2004-2020).

Në kuadër të Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU) është bërë studimi i rrugëve unazore (përfshirë edhe unazën e jashtme). Pas analizës dhe vlerësimit të këtyre rrugëve unazore, është konstatuar se do të ishte më praktike të mos vazhdohet me ndërtimin e kësaj unaze.

Arsyet për mos ndërtimin e unazës së jashtme sipas PMQU-së, janë:

- mungesa e popullsisë: unaza rrugore është planifikuar përgjatë një zone, e cila përgjithësisht shfaq një nivel të ulët të dendësisë së popullsisë;
- mungesa e kërkesës: ky aspekt është i lidhur ngushtë me densitetin e popullsisë për sa i përket nivelit të kërkesës që do të ndihmonte në justifikimin e ndërtimit. Kjo mungesë e kërkesës ndikohet edhe nga afërsia dhe shtrirja paralele e Unazës së Qytetit, e cila po ashtu do të tërheqë udhëtimet;
- kostoja e investimit: për shkak të fushëveprimit të këtij projekti dhe terreni përreth, kostoja e përgjithshme e ndërtimit do të jetë shumë e lartë dhe duke pas parasysh nivelin potencial të ulët të kërkesës, vlera e përgjithshme e parasë shfaqet të jetë relativisht e ulët.

Është vlerësuar, se në këtë fazë të zhvillimeve, unaza e jashtme nuk është e nevojshme dhe nuk do të ketë ndikim të madhe në rrjedhën dhe orientimin e trafiku, prandaj duhet të bëhet një rivlerësim dhe fizibilitet për ndërtimin apo mosndërtimin e kësaj unaze.

2.6.9.5. Linja Metropolitane - Zhvillimi i transportit publik “mbi shina” (Light Rapid Transit – LRT)

Ka potencial për zhvillimin e një linje të re të transportit publik mbi shina (Light Rapid Transit – LRT), do të ishte i mundur duke rehabilituar hekurudhën ekzistuese nga Fushë-Kosova deri në Prishtinë, duke zgjatur linjën në veri të qytetit afër këtyre emërtimeve: Lidhja e Lezhës, Vëllezërit Fazilu, Ilir Konushevci apo edhe më tej në veri. Ekziston një opsion për zgjatje të mundshme në të

ardhmen deri në aeroport, me qëllim të ofrimit të një lidhjeje të transportit publik të besueshme dhe me cilësi të lartë. Sistemi do të kishte mundësi të integrohej plotësisht me rrjetin e autobusëve të qytetit, si dhe me rrjetet e këmbësorëve dhe çiklistëve.



Figura 8 Linja metropolitane

2.6.9.6. Ndërtimi i një Stacioni multimodal

Duke marrë parasysh strategjitë e zhvillimit të trafikut urban dhe transportit publik në Prishtinë, është e nevojshme krijimi i një Terminali multifunksional për Transportin Publik në Prishtinë.

Ekziston një gamë e gjerë e opsioneve-koncepteve të mundshme për transformimin e cilësisë së ofrimit të transportit publik në Prishtinë, përfshirë zgjidhjet përmes transportit të shpejtë publik. Zhvillimi i një forme të re të transportit publik, si një shërbim i ri me cilësi më të lartë të transportit publik mbi shina në Prishtinë do të integrohet me shërbimin e autobusëve dhe do të zvogëlojë mbingarkesën në përfundim të qytetit.

Me këtë sistem të transportit intermodal, mund të përcaktohet edhe një lloj i ri i transportit, respektivisht një qasje inovative, përfshirë këtu edhe përdorimin e sistemeve aktuale të transportit, duke lëvizur nga një përdorim i pavarur dhe i paintegruar i sistemeve tradicionale në një sistem më të integruar.

Koncepti i përgjithshëm në drejtim të planifikimit të parkingut të automjeteve dhe të stacionit është një nga fusha e mbivendosjes dhe linjat që thuren së bashku për të formuar një tërësi vazhdimisht të ndryshueshme.

Stacioni duhet të përmbajë program bazik të hapësirës së pritjes, parkingje për biçikleta, tualete dhe dyqane.

2.6.9.7. Pikat e reja të transferimit të autobusëve

Përveç krijimit të një Stacioni të Ri qendror të autobusëve në Prishtinë, propozohen të zhvillohen një sërë pikash të transferimit më të vogla të ndërrimit të autobusëve që do të lehtësonin një transferim të lehtë dhe pa pengesa, ndërmjet shërbimeve të ndryshme të autobusëve, me mënyrat tjera të udhëtimit, si çiklizmi dhe udhëtimi me taksì. Është identifikuar një numër i lokacioneve potenciale në qytet për këto pika të transferimit (bus hubs), duke përfshirë lokacionet e Parko dhe Udhëto (Park and Ride)—objekte, ku parkohen veturat dhe udhëtimi vazhdohet me transport publik,

taksi, biçikletë apo në këmbë) që kanë për qëllim të ndërpresin trafikun e veturave për në qendër të qytetit.

2.6.9.8. Zhvillimi i një koncepti të ri i rrjetit të autobusëve në mbarë qytetin

Zhvillimi i një hierarkie i rrjetit të ri të thjeshtuar të autobusëve:

- ekzistojnë opsionet për krijimin e një rrjeti kryesor të bazuar në mbulueshmërinë e përmirësuar dhe shpeshtësinë e shërbimeve për të ofruar një alternativë atraktive, kundrejt përdorimit të makinave për udhëtime në qendrën e qytetit. Për të tërhequr pasagjerë të rinj, kërkohet shpejtësi operationale dhe orare më të besueshme,
- rrjeti kryesor do të mbështetet nga një varg linjash dytësore ose ndihmëse që do të lidhnin qendrën kryesore urbane me zonat periferike (të banimit), si dhe më gjerë. Rrjeti i tillë do të lidhë më shumë zona rurale dhe zona periferike të qytetit me qendrën kryesore urbane.

2.6.9.9. Zhvillimi i Sistemeve Inteligjente të Transportit (SIT) për qytetin e Prishtinës

Qëllimi i tyre është optimizimi i menaxhimit të infrastrukturave dhe platformave logjistike, duke riorganizuar flukset e trafikut, në mënyrë që të promovojnë riekulibër midis mënyrave të ndryshme të transportit dhe të inkurajojnë përdorimin më të madh të modeleve më të qëndrueshme të transportit. Kjo do të sigurojë të gjitha përfitimet që SIT sjellin në përmirësimin e sigurisë dhe cilësisë së jetës së qytetarëve evropiane edhe në terma ekonomikë e të punësimit, në sektorët e prodhimit dhe kërkimit, gjithashtu do të shoqërohet me reduktim të kostove të jashtme e të brendshme të transportit.

2.6.9.10. Zhvillimi i politikës për parkim në Prishtinë

Vendosja e zonës së parkimit me pagesë në qendër të qytetit. Fazat e mëtejshme të parkimit me pagesë duhet të futen në zonat e afërta të banueshme, për t'i mbrojtur këto zona nga rritja e aktivitetit të parkimit nga personat që nuk janë banorë.

Zhvillimi i sistemit Parko dhe Udhëto (Park & Ride – P&R)

Në Prishtinë duhet synuar themelimin e konceptit Parko dhe Udhëto (Park & Ride–P&R), ku parkingjet e makinave që gjenden në distanca më të mëdha nga qendra e qytetit, janë të lidhura përmes një shërbimi tërheqës të transportit publik me qendrën kryesore urbane. Sigurimi i hapësirave të parkimit në periferi të qytetit, ka për qëllim të ndërpresë trafikun e udhëtarëve, të turistëve dhe banorëve lokal, për t'i transportuar ata në qendër të qytetit përmes lidhjes së shpejtë, të shpeshtë dhe me cilësi të lartë të transportit publik. Kjo do të zvogëlojë nivelin e mbingarkesës në qendër të qytetit dhe do të mundësojë që hapësira të rialokohet për qëllime tjera.

2.6.9.11. Lidhja në mes të kryeqytetit dhe rrjetit (ndër) kombëtar

Vlerësimi i mëposhtëm është bazuar në mundësinë për të përforcuar anën perëndimore të Prishtinës si një korridor infrastrukturor, për të riorganizuar fluksin ekstra-urban të njerëzve dhe mallrave në qytet dhe jashtë tij. Autoudha është ndërtuar në anën perëndimore të qytetit, ndërsa pak më larg në anën perëndimore shtrihet edhe një linjë hekurudhore, ku stacioni për pasagjerë (nuk i plotëson standardet ndërkombëtare) është i vendosur 8 km nga Prishtina, në jug të stacionit të udhëtarëve qëndron një stacion hekurudhor i mallrave (joadekuat). Kjo është lidhja hekurudhore, me origjinë si linjat e shërbimit për industrinë dhe minierat, të cilat janë ende ekzistuese, por shpesh të papërdorshme (një prej këtyre lidhjeve kalon në afërsi të zonës së aeroportit, e vendosur në anën jugperëndimore). Lidhur me rrugët në hyrje, por edhe në brendinë e qytetit të Prishtinës, nuk ekziston një strukturë hierarkike e rrugëve.

2.6.9.12. Vlerësimi i kapaciteteve investive nga fusha e infrastrukturës së transportit

Bazuar në planifikimi e investimeve kapitale nga fusha e infrastrukturës së transportit si ndërtimi i unazës së qendrës dhe unazës së qytetit, stacioni multimodal, ndërtimi i rrugës A, vazhdimi i

ndërtimit të rrugës C, implementimi i masave të PMQU-së, rrjedhë se komuna e Prishtinës do të ketë nevojë për sigurimin e kapitalit investues për realizimin e projekteve të përmendura.

Tabela 41 Kapacitetet investive për infrastrukturën e transportit

	2018-2020			2021-2023			2024-2026			2027-2029		
	Granti për kryeqytet	Subvencione dhe transfere	Investime kapitale	Granti për kryeqytet	Subvencione dhe transfere	Investime kapitale	Granti për kryeqytet	Subvencione dhe transfere	Investime kapitale	Granti për kryeqytet	Subvencione dhe transfere	Investime kapitale
Prishtina	22,61 8,496			37,9 92,4 41			43,8 49,2 61			52,5 74,9 65		
Total		5,45 0,43 0	74,8 62,6 21		27,8 42,7 00	79,4 40,5 70		29,2 34,8 35	82,3 60,7 48		30,6 96,5 77	85,7 11,7 17
Grante qeveritare			10,5 29,7 78		15,7 24,2 00	2,94 0,00 0		16,5 10,4 10	3,08 7,00 0		17,3 35,9 31	3,24 1,35 0
Të hyrat vetanake		5,45 0,43 0	63,4 56,7 20		12,1 18,5 00	51,1 47,4 47		12,7 24,4 25	53,7 04,8 19		13,3 60,6 46	56,3 90,0 60
Financim i jashtëm						25,0 67,5 77			25,5 68,9 29			26,0 80,3 07
Financim nga huamarrja			876, 123			285, 546						
Administrata dhe Personeli		270, 000	435, 000		6,63 0,90 0	980, 000		6,96 2,44 5	1,02 9,00 0		7,31 0,56 7	1,08 0,45 0
Grante qeveritare					4,20 0,00 0	300, 000		4,41 0,00 0	315, 000		4,63 0,50 0	330, 750
Të hyrat vetanake		270, 000	435, 000		2,43 0,90 0	680, 000		2,55 2,44 5	714, 000		2,68 0,06 7	749, 700
Financim i jashtëm												
Financim nga huamarrja												
Buxhet dhe Financa			500, 000			750, 000			787, 500			826, 875
Grante qeveritare												
Te hyrat vetanake			500, 000			750, 000			787, 500			826, 875
Financim i jashtëm												
Financim nga huamarrja												

Shërbime publike	320,000	17,121,207		15,160,000		15,918,000		16,713,900
Grante qeveritare		3,509,926						
Të hyrat vetanake		13,323,781		6,804,141		7,144,348		7,501,565
Financim i jashtëm				8,355,859		8,773,652		9,212,335
Financim nga huamarrja		287,500						

Tabela 42 SWOT analiza - Infrastruktura e transportit

Përparësitë	Dobësitë
- Lidhjet e trafikut me pjesën tjetër të Kosovës nëpërmjet transportit rrugor; - hekurudhor dhe trafikut ajror; - Investimet e Komunës në përmirësimet e rrugëve që lidhin fshatrat me njëra-tjetrën (rrugë lokale); - Prezenca e transportit publik dhe përmirësimi i flotës së autobusëve publik urban; - Ekziston një infrastrukturë bazë e transportit; - Prishtina ndodhet në udhëkryqin e dy korridoreve të transportit të një rëndësie ndërkombëtare (rruga 6 dhe 7); - Rritja e pjesëmarrjes së sektorit privat në të gjitha mënyrat e transportit; - Zhvillimi i shërbimeve të autobusëve urban dhe ndërurbane.	- Mungesa e një strukture të qartë dhe një hierarki funksionale e rrjetit rrugor; - Mbingarkesa e trafikut, problemet e parkimit, të sigurisë së lëvizjes, ndotjes janë pjesë e përditshmërisë për banorët e Prishtinës. Standard i ulët i rrugëve, veçanërisht lidhje jo të mira mes qytetit dhe fshatrave dhe rrugë të këqija në zonat e lagjeve dhe brenda fshatrave; - Gjendje e keqe e hekurudhës dhe stacionit kryesor hekurudhor jashtë qendrës së qytetit (Fushë-Kosovë); - Sistem i transportit publik me përmasa të pamjaftueshme dhe i pajisur keq; - Motorizimi: një numër i konsiderueshëm i makinave janë të vjetra dhe dukshëm nën nivelin e mesatares së vjetërsisë në vendet evropiane; - Gjendje e vështirë për lëvizje të lirë dhe të sigurt për këmbësorët dhe çiklistët (zakonisht ka mungesë të trotuareve, shtigje për këmbësorë dhe biçikleta); Zakonisht në këto vende gjenden makina të parkuara; - Mungesa dhe menaxhimi joadekuat i parkingjeve; - Aeroporti, stacioni hekurudhor dhe stacioni i autobusëve të Prishtinës janë larg njëri-tjetrit; - Sinjalizimi i rrugëve me shenja të trafikut nuk është në harmoni me standardet evropiane; - Zbatimi jo i duhur i normave teknike të planifikimit, shpeshherë ndërtimet janë bërë ngjitur me cepin e rrugëve kryesore, duke përjashtuar mundësinë për zgjerim; - Unaza qendrore e veriut paraqet pengesë për qendrën historike;

	• Administrimi dhe efikasiteti i ulët i trafikut urban; • Standardet e ulëta të sigurisë së trafikut; • Qasje e dobët në transportin urban në zonat rurale; • Mungesë e korsive të veçanta për autobusë në të gjitha zonat urbane.
Mundësitë	Rreziqet
• Lidhje të mira infrastrukturore përmes autoudhës dhe projekteve të tjera në planifikim e sipër; projekti i Unazës së Qendrës dhe disa rrugëve kryesore brenda zonës urbane; • Lidhja e Prishtinës me korridoret pan-evropiane përmes lidhjeve rrugore dhe hekurudhore (Korridoret pan-evropiane VIII dhe X); • Strukturimi i një rrjeti funksional dhe të integruar; • Ndërtimi i një sistemi që integron disa forma transporti; • Ofrim i shërbimeve të transportit dhe lidhjen e Prishtinës me aeroportin ndërkombëtar "Adem Jashari".	• Rritje potenciale e trafikut të motorizuar në mungesë të zhvillimit të transportit publik dhe mungesës së një strukture të qartë dhe një hierarki funksionale e rrjetit rrugor; • Bashkëpunimi joadekuat në mes të nivelit lokal dhe qendror në planifikimin dhe realizimin e projekteve infrastrukturore; • Buxhet i pamjaftueshëm nga komuna për realizimin e projekteve të rëndësishme të infrastrukturës së transportit dhe pamjaftueshmëri e granteve nga niveli qendror.

Sfidat kryesore në fushën e trafikut dhe të transportit

Sistemi i trafikut dhe transportit në qytetin e Prishtinës po përjeton efektet dhe transformimet që lidhen me ndryshimet dhe zhvillimet në mjedisin urban. Sfidat kryesore me të cilat Komuna e Prishtinës do të përballë në aspektin e transportit të qëndrueshëm, përbëjnë orientimin për strategjinë e re, objektivat dhe veprimet që do të karakterizojnë PZHK-në e Prishtinës si instrumenti kryesor i planifikimit të transportit për qytetin.

Pas analizës më të thelluar të strukturës, organizimit dhe jetës së qytetit, është vlerësuar se disa nga sfidat kryesore me të cilat përballë Komuna e Prishtinës janë:

- Menaxhimi i trafikut dhe siguria rrugore – Urbanizimi akut dhe i shpejtë i Prishtinës, për shkak të migracionit të brendshëm masiv, solli për fillim një mungesë të përgjithshme të infrastrukturës teknike, përfshirë infrastrukturën e nevojshme rrugore. Po kështu, kjo çoi në një lidhje të dobët me pjesët qendrore të qytetit, në rritjen e udhëtimeve vajtje-ardhje për në punë, bllokimin e trafikut dhe uljen e sigurisë rrugore.
- Ngarkesa e trafikut dhe ulja e shpejtësisë mesatare të udhëtimit – Ndër sfidat kryesore në qytetin e Prishtinës është përballja me trafikun gjithnjë në rritje dhe ngarkesa në rrjetin rrugor dhe përmirësimi i shpejtësisë mesatare të udhëtimit.
- Reduktimi i automjeteve personale për lëvizje në qytet - Automjetet personale vazhdojnë të jenë zgjidhja e vetme në qytetin e Prishtinës. Reduktimi i numrit të mjeteve motorike private që qarkullojnë në bërthamën urbane të qytetit dhe adresimi i çështjeve të trafikut të mbingarkuar në qendër të qytetit.
- Largimi i trafikut tranzit nga pjesët qendrore të qytetit - Përveç vëllimeve të larta të qarkullimit të automjeteve dhe tejngarkesës në hyrje të disa udhëkryqeve të caktuara, kapaciteti i infrastrukturës rrugore në brendi të qytetit është i pamjaftueshëm ose i kufizuar. Kjo ndodh edhe për shkak të mungesës së rrugëve unazore që aktualisht

mungojnë (p.sh. unaza e qytetit të Prishtinës). Përmes unazës së qytetit do të mundësohej largimi i trafikut tranzit nga pjesa qendrore e qytetit.

- Infrastruktura rrugore joadekuade – Rrjeti rrugor i qytetit të Prishtinës nuk ka një strukturë të qartë dhe një klasifikim funksional të rrjetit rrugor. Kyçjet e pakontrolluara nga niveli i rrugëve me karakter më të ulët, kyçen drejtpërdrejtë dhe pa respektuar hierarkinë në rrugë kryesore.
- Kërkesa e madhe për parkingje (sidomos në pjesën qendrore të qytetit) dhe mungesa e zbatimit të Ligjit për parkime - Nivel i lartë i aktivitetit të parkimit afatgjatë në qendër të qytetit dhe mungesa e zbatimit të rregullave të parkimit, do të jetë sfida kryesore e çdo strategjie të suksesshme të parkimit, duke vlerësuar burimet e kufizuara në dispozicion në Prishtinë, për menaxhimin dhe kontrollimin në mënyrë efektive të aktivitetit të parkimit në qendër të qytetit
- Përmirësimi i kushteve infrastrukturore për lëvizje të lirë dhe të sigurt të lëvizjeve jomotorike- përshkrim i shkurtër - Shtigjet e këmbësorëve të cilësisë së dobët, mungesa e hapësirave të sigurta dhe të përshtatshme të kalimit të rrugës si dhe mungesa e rrjeteve të integruara të shtigjeve për këmbësorë dhe çiklistë do të jenë sfida për përmbushjen e kërkesave për lëvizje aktive në Prishtinë.
- Rritja e efikasiteti të Transportit Publik - Implementimi i masave të transportit publik nga PMQU do të jetë një sfida, me të cilën do të përballë Komuna e Prishtinës. I gjithë sistemi i transportit publik mbështetet tek transporti me autobus. Edhe pse cilësia e mjeteve është përmirësuar (sidomos me vënien në qarkullim të 51 autobusëve të rinj), shpeshtësia e shërbimit është e pamjaftueshme, kapaciteti është i ulët dhe mbulueshmëria është e pamjaftueshme. Po kështu, numri i korsive të dedikuara për autobusët është i kufizuar dhe nuk respektohet qëllimi i destinimit të korsisë vetëm për autobus.
- Përzgjedhja e lokacionit adekuat për stacionin multimodal - Krijimi i një stacioni multimodal është më se i nevojshëm për Komunën e Prishtinës, por jo vetëm. Në planet strategjike paraprake, është paraparë një lokacion i përafërt në zonën industriale ndërmjet Prishtinës dhe Fushë-Kosovës, në mes të rrugës së unazës së brendshme dhe rrugëve Prishtinë-Fushë Kosovë dhe Prishtinë-Mitrovicë, duke përdorur hekurudhën ekzistuese dhe pastaj duke u shtrirë në qendër të qytetit. Zhvillimet e reja në afërsi të këtij lokacioni mund të shkaktojnë vështirësi në përzgjedhjen e lokacionit adekuat.
- Bashkëpunimi me nivelin qendror (MI dhe MMPH) për kategorizimin funksional të rrjetit rrugor - Nevoja për harmonizimin e qëndrimeve dhe përgjegjësisë në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe klasifikimin funksional të rrjetit rrugor ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal, gjithashtu do të jetë sfida për Komunën e Prishtinës.
- Krijimi i Policisë Komunale për zbatimin e plotë të rregullave për qarkullim rrugor – Ka më shumë se dy vjet që kur Ligji për Prishtinën ka hyrë në fuqi, ligj ky që përveç tjerash, i mundëson Prishtinës të ketë Polici të Veçantë, ende nuk ka gjetur zbatim. Krijimi i Policisë Komunale do të jetë sfida për zbatimin e të gjitha rregullave të trafikut në Komunën e Prishtinës.
- Procedurat joadekuade të mbledhjes së të dhënave, formatet e të dhënave dhe praktikatat e raportimit – Krijimi i një databaze me të dhënat e rëndësishme lidhur me menaxhimin, sigurinë dhe ngarkesën e trafikut do të jetë një sfida për përmirësimin e trafikut në Prishtinë.
- Reduktimi i efekteve negative të transportit komercial (transportit të mallrave) - Duke përcjellur trendet e zhvillimit të qytetit dhe nevojën për përdorimin e transportit të mallrave, menaxhimi i transportit të mallrave do të jetë një sfida shtesë për Prishtinën.
- Reduktimi i ndotjes së ajrit dhe emisioneve të CO2 që vijnë nga sektori i transportit - Për t'i reduktuar emetimet nga automjetet, sfida për Komunën e Prishtinës mbetet rritja e përdorimit të transportit publik urban për ta përshpejtuar eliminimin e autobusëve me naftë dhe zëvendësimin e tyre.

2.7. Infrastruktura publike dhe sociale

2.7.1. Shëndetësia¹⁸

Të gjitha institucionet shëndetësore kryesore janë të vendosura në Komunën e Prishtinës, ku ofrojnë shërbime për qytetarët e Prishtinës dhe gjithë popullsinë e vendit, si Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK), Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, Instituti për Transfuzionin e Gjakut, Qendra Diagnostike, Shërbimet Mjekësore të Emergjencës etj., të cilat janë nën menaxhimin e nivelit qendror.

Shërbimi publik shëndetësor parësor në Komunën e Prishtinës ofrohet përmes:

- 1 Qendër kryesore e mjekësisë familjare (QKMF),
- 16 Qendra të mjekësisë familjare (QMF),
- 14 Ambulanca të mjekësisë familjare (AMF),
- 1 Poliklinikë e stomatologjisë (PS),
- 1 Qendrës së mjekësisë urgjente (QMU).

Tabela 43 Numri i personelit në institucione shëndetësore

	Mjek specialist	Mjek	Infermiere (pediatrike, akušerike)	Laborant	Teknik (farmacistë, stomatolog)	Stomatolog	Specialistë stomatolog	Shofer	Higjienist	Administratë	Tjerë
QKMF	43	8	84	13	8	0	0	0	7	7	9
QMF	96	25	225	24	24	11	9	0	8	0	0
AMF	3	6	16	0	0	0	0	0	11	0	0
PS	0	0	0	0	36	11	11	0	1	0	1
QMU	10	8	44	0	4	0	0	12	0	7	3

Tabela 44 Veçoritë fizike dhe hapësinore të institucioneve shëndetësore

	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e objektit (m ²)
QKMF	0.50	6880
QMF	2.35	12040
AMF	/	1376
PS	0.083	780
QMU	0.20	1200

¹⁸ Drejtoria e Shëndetësisë, Komuna e Prishtinës

Tabela 45 Inventari i ndërtimeve dhe hapësirave të Qendrës kryesore të Mjekësisë Familjare

Sipërfaqja parcelës (m ²)	Sipërfaqja objektit (m ²)	Reparti	Mjek Specialist	Mjek	Infermiere (pediatrike, Laborant	Teknik (farmacist, stomatolog,	Stomatolog	Spec. stomatolog	Shofer	Higjieniste	Administratë
5000	6880	Shërbimi specialistik	7	1	8						
		Mjekësia familjare	13	3	25						
		Vaksinimi	2	3	10						
		Pediatri	7		15						
		QMG	4	1	13	1					
		RO-Kabineti	2			5					
		Laboratori	1			12					1
		SISH									6
		Barnatorja	1			3					
		Mjekësia e punës	6		13						

Tabela 46 Inventari i ndërtimeve dhe i hapësirave të Qendrave të mjekësisë familjare
Reparti

	Sipërfaqja parcelës (m ²)	Sipërfaqja objektit (m ²)	Mjek specialist	Mjek	Infermiere (pediatrike, akusherike)	Laborant	Teknik (farmacist stomatolog, radiologji)	Stomatolog	Spec. stomatolog	Shofer	Higjieniste	Administratë
QMF I - Tophane	479	340	9		13	2	2	1	1			
QMF II - Kodra e Trimave	3569	1050	4	1	11	2	1	1				
QMF III - Qyteti i vjetër	512	660	6	1	12	2						
QMF IV - Medrese	2607	800	10	3	27	2	5	2	1			
QMF V - Dardani	1224	4100	22	3	39	5	3				2	
QMF VI - Bregu i Diellit	3515	1800	15	2	30	3	2	2				
QMF VII - Kalabri	4450	1050	3	1	10	1	2	1	1			
QMF VIII - Arbëri		300	3	2	8	1	1		1			
QMF IX - Vneshtat	1664	300	3	2	10	1	1		1			
QMF X - Rr. 1 Tetori Velania	1835	300	3	1	9		2		2			
QMF XI - Lagjja e Muhaxherëve	652	0	7		14							
QMF - Hajvali	1600	300	3	4	12	2	2	2			4	
QMF - Besi	1000	300		4	11	1	1	1			2	
QMF - Mati I	2100	370	4		10	1	1	1	1			
QMF - Mati II	1700	370	4	1	9	1	1		1			
QMF - Veternik	1408											

Tabela 47 Inventari i ndërtimeve dhe i hapësirave të Ambulanteve të Mjekësisë Familjare Reparti

	Sipërfaqja e parcelës (m ²)	Sipërfaqja e objektit (m ²)	Mjek specialist	Mjek	Infermiere (pediatrike, ginekologjike)	Laborant	Teknik (farmacistë stomatolog, radiologjisë)	Stomatolog	Spec. stomatolog	Shofer	Higjieniste	Administratë
AMF Kishnicë	2160	120		1	1						1	
AMF Mramor	2892	138		1	1						1	
AMF Slivovë	901	53			1						1	
AMF Viti	795	53			1							
AMF Bullaj (Marec)	702	54									1	
AMF Shkabaj	1320	120	1		2						1	
AMF Llukar	1080	120	1		1						1	
AMF Keqekoll	800	0	1		1						1	
AMF Koliq	1274	98			1							
AMF Bardhosh	2200	200		2	4						1	
AMF Barilevë	1800	200		1	1						1	
AMF Rimanishte	630	90			1						1	
AMF Sharban	650	130		1	1						1	
AMF Qendra e studentëve												

Në Komunën e Prishtinës gjendet edhe Klinika Universitare e Kosovës, e cila mbulon një sipërfaqe prej rreth 50 hektarë, në të cilën sipërfaqe gravitojnë një numër i madh i institucioneve shëndetësore, të cilat janë nën kompetencat e nivelit qendror.

2.7.1.1. Institucionet shëndetësore të nivelit parësor

Duke marrë parasysh supozimin që në vitin 2031 në Komunë të Prishtinës do të banojnë rreth **290,508 banorë** rezidentë, sipërfaqen aktuale të parcelave kadastrale prej **71,356.6 m²** dhe normën minimale prej **0.20 m²/banor** për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike shëndetësore të nivelit parësor, për 8 vitet e ardhshme komuna e Prishtinës ka **13,255.6 m²** hapësirë më shumë se sa nevojitet sipas NTPH.

Tabela 48 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike shëndetësore të nivelit parësor për numrin e prognozuar të banorëve 2031

	Nr. i përgjithshëm i prognozuar i banorëve 2031	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Zone Urbane	208,398	42,252.7	0.2	41,679.6	+573.7
Zone Rurale	82,110	29,103.9	0.2	16,422	+12,681.9
Gjithsej	290,508	71,356.6	0.2	58,101.6	+13,255.6

Bazuar në kërkesë minimale për rreze të mbulueshmërisë të Normave Teknike të Planifikimit Hapësinor për organizimin hapësinor të QMF-ve dhe AMF-ve, shtirjen ekzistuese dhe të planifikuar, rezulton që në zonën urbane dhe atë rurale ka shtrirje të mirë të institucioneve publike të Kujdesit Parësor Shëndetësor.

2.7.1.2. Institucionet shëndetësore të nivelit dytësor

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 1.20 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve shëndetësore të nivelit dytësor që përfshijnë:


- Ndërtesat e spitaleve të përgjithshme dhe specialistike me njësitë përbërëse;
- Ndërtesat e poliklinikave specialistike;
- Ndërtesat e ambulancave specialistike;
- Ndërtesat e ambulancave stomatologjike;
- Ndërtesat e qendrave të shëndetit mendor me Shtëpinë për integrim në bashkësi;
- Ndërtesat e qendrave të transfuzionit të gjakut;
- Ndërtesat e qendrave të rehabilitimit fizik dhe klimatik;
- Ndërtesat e qendrave të mjekësisë sportive;
- Ndërtesat e qendrave të mjekësisë së punës;
- Ndërtesat e qendrave rajonale të shëndetësisë publike;
- Ndërtesat e qendrave për rehabilitimin e të dëgjuarit dhe të folurit.

Duke marrë parasysh supozimin që në vitin 2031 në Komunë të Prishtinës do të banojnë rreth **290,508 banorë** rezidentë, sipërfaqen aktuale të parcelave kadastrale prej **10,723.8 m²** dhe normën minimale prej **1.20 m²/banor** për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike shëndetësore të nivelit dytësor, komunës i mungojnë gjithsej **337,885 m²** sipërfaqe të parcelave kadastrale për ofrimin e shërbimeve shëndetësore të këtij niveli.

Shumica e këtyre ndërtesave janë të shpërndara nëpër territorin e zonës urbane të komunës. Në të njëjtën kohë, sipas NTPH sipërfaqet e tilla duhet të planifikohen në vendbanimet me popullsi më të madhe së 10,000 banorë, rrjedhimisht në Prishtinë dhe Matiqan. Kështu, vlerësohet se mbulueshmëria hapësinore me këto institucione është e kënaqshme.

2.7.1.3. Institucionet shëndetësore të nivelit tretësor

Kryeqyteti ofron shërbimet shëndetësore të nivelit tretësor përmes Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, e cila shtrihet në një sipërfaqe prej **377,096.6 m²** në zonën urbane të komunës.



Harta 20 Rrezja shërbyese e institucioneve shëndetësore në komunë

2.7.1.4. Vlerësimi i kapacitetit financiar dhe teknik

Bazuar në trendin e fondeve të alokuara nga buxheti qendror apo komunal për tre vjetët paraprak dhe tre ato vijueset, në rast se nuk ka ndryshime të theksuara në vija buxhetore, rezulton që kapaciteti i përgjithshëm financiar i Drejtorisë së Shëndetësisë për realizimin e projekteve kapitale për vitin 2021-2029 është € 4,129,775⁴⁴, €0.00 nga granti qeveritar dhe €4,129,775 nga të hyrat vetanake.

Tabela 49 Vlerësimi i kapaciteteve financiare (€) për investime kapitale të Drejtorisë së Shëndetësisë

	2018-2020		2021-2023		2024-2026		2027 -2029	
	Subvencionet dhe transferet	Investime kapitale	Subvencionet dhe transferet	Investime kapitale	Subvencionet dhe transferet	Investime kapitale	Subvencionet dhe transferet	Investime kapitale
Gjithsej	-	1,810,000	120,000	1,190,000	126,000	1,249,500	132,300	1,311,975
Grantet qeveritare	-	-	-	-	-	-	-	-
Të hyrat vetanake	-	1,810,000	120,000	1,190,000	126,000	1,249,500	132,300	1,311,975
Financim i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-	-
Financimi nga huamarrja	-	-	-	-	-	-	-	-

2.7.2. Arsimi¹⁹

Në nivel komunal, procesi arsimor zhvillohet në tri nivele, arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm. Komuna e Prishtinës ka gjithsej 70 institucione edukativo-arsimore e aftësuese (IEAA) të të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar, ku vijnë procesin edukativ-arsimor gjithsej 45,438 fëmijë e nxënës. Të dhënat e hollësishme për këto institucione janë të prezantuara në tabelën në vijim.

- 8 Institucione parashkollore-publike;
- 6 Institucione parashkollore me bazë në komunitet;
- 1 Institucion parashkollor me partneritet publiko-privat;
- 42 Shkolla fillore dhe të mesme të ulëta-publike dhe 22 paralele të ndara;
- 6 Shkolla të mesme të larta - Gjmnaze publike;
- 7 Shkolla të mesme të larta - Shkolla profesionale.

Shumica e shkollave në Komunën e Prishtinës punojnë në dy ndërrime, por ka edhe një numër të konsiderueshëm të shkollave që punojnë vetëm në një ndërrim.

Është me rëndësi të përmendet se në kuadër të disa SHFMU-ve ekzistojnë paralele të ndara fizike, të cilat funksionojnë në kuadër të shkollave amë, por ekzistojnë në lokacione të ndryshme, prandaj numri i objekteve fizike të SHFMU-ve është më i madh se 42 (të gjitha këto detaje mund të gjenden në Shtojcën 2 të këtij dokumenti). Në kuadër të disa SHFMU-ve në zonat e thella rurale të Komunës së Prishtinës funksionojnë 22 paralele në të cilat zhvillohet mësimi. Gjithashtu duhet përmendur që në Komunën e Prishtinës ekziston edhe një shkollë e mesme e lartë profesionale publike (Shtjefën Gjeçovi), e cila nuk menaxhohet nga Komuna e Prishtinës, por është nën menaxhimin e agjencisë përkatëse për arsimin profesional. Vlen të përmendet fakti që numri i nxënësve dhe interesimi për të ndjekur mësimin në shkolla profesionale është shumë i vogël.

¹⁹ Plani zhvillimor i arsimit për Komunën e Prishtinës, 2018-2022

Përveç IEAA-ve të sipërpërmendura, në Komunën e Prishtinës veprojnë edhe rreth 40 institucione parashkollore private, me gjithsej 1702 fëmijë, 7 institucione arsimore private të nivelit të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët (klasa I-IX) dhe 9 institucione arsimore private të nivelit të arsimit të mesëm të lartë (klasa X-XII), me gjithsej 2316 nxënës, të gjitha këto të licencuara nga MASHT-i.

Tabela 50 Numri i institucioneve arsimore dhe nxënësve

Institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese të nivelit të arsimit parauniversitar në Komunën e Prishtinës

Institucionet sipas niveleve	Numri i institucioneve	Numri i fëmijëve/nxënësve		
		M	F	GJ
Institucione parashkollore-publike	9	854	765	1619
Institucione parashkollore-me bazë në komunitet	6	209	197	406
Institucione parashkollore-me partneritet publiko-privat	1	65	66	131
Shkolla fillore dhe të mesme të ulëta-publike	42	16765	16156	32921
Shkolla të mesme të larta-gjimnaze-publike	6	2289	3070	5359
Shkolla të mesme të larta-shkolla profesionale	7	2805	2197	5002
Gjithsej	70	22987	22451	45438

Në kuadër të DKA-së së Komunës së Prishtinës janë 18 të punësuar, përfshirë dhe pozitën e drejtorit të DKA-së. Kurse, në kuadër të IEAA-të publike të të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar të Komunës së Prishtinës, DKA ka të punësuar gjithsej 3170 persona. Të dhënat e të punësuarve sipas llojit, nivelit dhe gjinisë janë të prezantuara në tabelën 51.

Sa i përket cilësisë së shërbimeve të arsimit, sipas të dhënave të siguruara konstatohet që raporti nxënës/mësimdhënës në institucionet publike arsimore është 7.53 nxënës/mësimdhënës në institucionet parashkollore, 20.17 nxënës/mësimdhënës në institucionet e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët dhe 8.33 nxënës/mësimdhënës në institucionet e arsimit të mesëm të lartë. Sipas këtyre shifrave, vlerësohet se cilësia e shërbimeve të arsimit, sidomos të atij fillor dhe të mesëm të ulët kanë nevojë urgjente për përmirësim, me shtim të kapaciteteve njerëzore profesionale.

Tabela 51 Numri i personelit në institucione edukativo-arsimore

Niveli i institucionit	Gjinia	Lloji i personelit			Gjithsej personel
		Mësimdhënës	Personel administrativ	Personel ndihmës	
Institucione parashkollore	M	27	3	29	59
	F	188	15	52	255
	GJ	215	18	81	314
Shkolla fillore dhe të mesme të ulëta	M	365	49	203	617
	F	1267	63	94	1424
	GJ	1632	112	297	2041
Shkolla të mesme të larta	M	250	23	103	376
	F	393	16	30	439
	GJ	643	39	133	815
Gjithsej personel	M	642	75	335	1052
	F	1848	94	176	2118
	GJ	2490	169	511	3170

Tabela 52 Veçoritë fizike dhe hapësinore të institucioneve arsimore

Niveli i institucionit	Sip. parcelës (ha)	Sip. ndërtuar (ha)	Sip. objektit (m ²)	Hapësirat e gjelbra
------------------------	--------------------	--------------------	---------------------------------	---------------------

Institucionet parashkollore	3.05	1.638	12,297.64	1.90
Shkolla fillore dhe të mesme të ulëta	38.86	8.14	14,3523.03	31.16
Shkolla të mesme të larta	10.49	2.16	45,836.31	8.33

Tabela 53 Inventari i ndërtimeve dhe i hapësirave të institucioneve publike parashkollore

Emri i institucionit	Fëmijë meshkuj të regjistruar	Fëmijë femra të regjistruar	Edukatore (nr.)	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lirë (ha)	Etazhiteti (P)	Sipërfaqja e klasave (m ²)	Numri i klasave (nr.)	Për vizitor	Për zyrtar
IP Dielli	8	17	23	0.51	0.13	0.38	P+1	694,87	11	0	5
IP Yllkat	102	116	26	0.32	0.20	0.12	P+2	1985	13	2	1
IP Fatosat	135	115	28	0.31	0.15	0.16	P+1	64	13	5	0
IP Xixëllonjat	64	50	14	0.24	0.04	0.19	P+1	199	7	0	0
IP Buzëqeshja	79	48	17	0.25	0.05	0.25	P+0	180	8	5	0
IP Ardhmënia	64	65	17	0.34	0.12	0.23	P+0	1200	7	4	4
IP Lulevera	89	63	19	0.12	0.08	0.04	P+0		9	0	0
IP Gëzimi Ynë	225	185	43	1.07	0.24	0.83	P+0	787.85	21	0	0
Në ndërtim e sipër				0.491	0.098	0.393	P+1				

Tabela 54 Inventari i ndërtimeve dhe i hapësirave të institucioneve publike të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët

Emri i institucionit	Nxënës meshkuj të regjistruar	Nxënës femra të regjistruar	Mësimdhënës (nr.)	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lirë (ha)	Etazhiteti (P)	Sipërfaqja e klasave (m ²)	Numri i klasave (nr.)	Për vizitor	Për zyrtar
SHFMU Afrim Gashi	349	289	27	0.81	0.26	0.55	P+2	1333	31	0	1
SHFMU Ali Kelmendi	142	151	20	1.44	0.06	1.38	P+1	0	23	5	0
SHFMU Andon Z. Çajupi	45	37	40	0.77	0.30	0.47	P+1	1116	18	1	0
SHFMU Asim Vokshi	325	305	36	1.40	0.59	0.81	P +2	1210	22	0	20
SHFMU Avni Rustemi	92	87	18	1.40	0.23	1.17	P	1176	21	6	4
SHFMU Azemi e Salihu			14	1.15	0.25	0.90	P	0		0	0
SHFMU Dardania	956	980	74	0.44	0.32	0.12	P+2	2176	34	0	0
SHFMU Dëshmorët e 1921	8	4	17	1.55	0.21	1.34	P	240	6	10	5
SHFMU Ditët e Minatorit	63	57	24	0.51	0.49	0.02	P+1	1620	6	15	6
SHFMU Ditët e Minatorit (PNF	22	16	/	1.50	0.43	1.07	P	1140	6	12	5

Shashkoc)													
SHFMU Ditët e Minatorit (PNF Sushicë)	8	9	/	1.00	0.51	0.49	P	640	4	12	5		
SHFMU Dituria	153	132	16	1.00	0.34	0.66	P	309.05	6	0	0		
SHFMU e Gjelbër	332	339	30	0.50	0.30	0.20	P+1	560	10	0	0		
SHFMU Elena Gjika	808	802	77	0.49	0.12	0.37	P	1248	26	0	0		
SHFMU Emin Duraku	331	307	40	0.48	0.28	0.20	P	1872	39	3	12		
SHFMU Faik Konica	726	674	62	2.90	0.43	2.47	B+P+1	1458	27	0	0		
SHFMU Fan S. Noli	7	10	8	1.41	0.55	0.86	P+1 P	3456	8	0	0		
SHFMU Fan S. Noli (PNF Roga e Gërbeshit)	1	1	1	1.40	0.23	1.17		500	4	0	0		
SHFMU Filip Shiroka	44	60	15	1.04	0.44	0.60	P	320	8	0	0		
SHFMU Gjergj Fishta	548	530	59	1.00	0.61	0.39	P+1	1,560	26	0	1		
SHFMU Hasan Prishtina	1064	1025	82	0.72	0.16	0.56	P+3	2079	33	0	0		
SHFMU Hilmi Rakovica	739	709	57	0.42	0.21	0.21	B+P+1	1624	29	30	0		
SHFMU Iliria	779	743	77	0.52	0.17	0.35	P+1	1344	24	0	1		
SHFMU Isa Boletini	64	47	13	0.35	0.15	0.20	P+2	532	11	0	0		
SHFMU Ismail Qemali	1467	1469	109	0.72	0.01	0.71	P+1	5700	40	0	0		
SHFMU Liria	4	4	7	0.66	0.07	0.59	P+1	3760	8	0	0		
SHFMU Mehmet Gjevori	220	196	27	0.90	0.58	0.32		0		0	0		
SHFMU Meto Bajraktari	782	719	66	2.40	1.87	0.53	B+P+1	1674	31	0	0		
SHFMU Mitrush Kuteli	263	204	30	1.00	0.61	0.39	P+2	768	16	0	0		
SHFMU Naim Frashëri	497	446	64	1.00	0.30	0.70	P+1	1980	37	0	10		
SHFMU Nazim Gafurri	37	39	57	0.50	0.20	0.30	P	0		0	0		
SHFMU Nëna Terezë	113	94	19	0.28	0.04	0.24	P	288	6	0	0		
SHFMU Nëna Terezë (PNF Sharban)	17	21	8	0.27	0.03	0.24	P	336	7	0	0		
SHFMU Nëna Terezë (PNF Teneshdoll)	34	45	8	0.70	0.03	0.68	P+1	432	9	0	0		
SHFMU Nexhmi Mustafa	189	166	23	0.33	0.08	0.25	P	630	12	1	1		
SHFMU Nexhmi Mustafa (PNF Lebanë)	10	13	4	0.25	0.10	0.15	P	150	3	0	0		
SHFMU Nexhmi Mustafa (PNF Prugoc)	91	111	12	0.40	0.04	0.36	P+1	410	9	0	0		
SHFMU Nexhmi	34	35	12	0.60	0.15	0.45	P	270	8	0	0		

Mustafa"(PNF Rimanishtë)												
SHFMU Pavarësia	748	706	49	0.29	0.08	0.21	P+1	16800	20	0	0	
SHFMU Pjetër Bogdani	325	336	40	0.40	0.06	0.34	B+P+1+ NK	576	18	0	0	
SHFMU Qamil Batalli	35	32	27	0.18	0.02	0.16	P+2	1242	23	2	5	
SHFMU Ramiz Sadiku	2	4	2	1.38	0.10	1.28	P	2688	8	0	0	
SHFMU Rilindja	3	1	13	0.55	0.03	0.52	P	432	9	0	0	
SHFMU Rilindja (PNF - Kurtaj)		1	6	1.00	0.08	0.92	P+1	232.2	6	0	0	
SHFMU Shkëndija	414	407	35	0.10	0.04	0.06	P+1	1064	19	10	20	
SHFMU Tefik Çanga	31	30	10	0.50	0.06	0.44	P	640	8	0	1	
SHFMU Tefik Çanga (PNF Ballaban)	5	6	9	0.73	0.05	0.68	P	340	4	0	1	
SHFMU Tefik Çanga (PNF Podaj)	7	12	3	0.28	0.01	0.27	P	340	4	0	1	
SHFMU Teuta	26	21	8	0.38	0.05	0.33	P	550	9	5	2	
SHFMU Xhavit Ahmeti	439	430	52	1.30	0.81	0.49	P	1449	27	10	10	
SHFMU Xhemail Mustafa	566	577	47	0.61	0.60	0.01	P+1	1056	22	0	0	
SHFMU Zenel Hajdini	647	647	71	0.80	0.50	0.30	P+1	1000	30	1	0	
SHFMU 7 Marsi	290	288	28	1.49	0.60	0.89	P+2	896	16	10	10	

Tabela 55 Inventari i ndërtimeve dhe hapësirave të institucioneve publike të arsimit të mesëm të lartë
Emri i institucionit

	Nxënës meshkuj	Nxënës femra të	Mësimdhënës (nr.)	Sipërfaqja parcelës (ha)	Sipërfaqja ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lirë (ha)	Etazhiteti (P)	Sipërfaqja klasave (m ²)	Numri i klasave (nr.)	Për vizitor	Për zyrar
SHML Sami Frashëri	449	622	53	0.86	0.22	0.64	P+2	1,333	33	11	21
SHML Xhevdet Doda	155	249	55	0.74	0.29	0.46	P+2	1,008	21	15	2
SHML Eqrem Çabej	254	556	34	0.44	0.29	0.15	P+1	1,226	24	1	1
SHML Dr. Ali Sokoli	207	522	39	1.07	0.61	0.46	P+1	1,710	30	4	8
SHML 28 Nëntori	705	393	72	0.42	0.19	0.23	P+2	1500	22	15	5
SHML Hoxhë K. Prishtina	655	617	76	0.77	0.54	0.23	P+2	1,176	21	15	6
SHML 7 Shtatori	129	69	21	0.10	0.05	0.05	P	550	7	0	4
SHML Abdyl Frashëri	259	175	40	2.50	0.20	2.30	P+2	819	13	5	20
SHML Prenk Jakova	36	88	64	0.39	0.28	0.11	P+1	1,236	28	0	0
SHML Gjini Gazulli	620	202	60	0.78	0.45	0.33	P+3	918	24	0	1
SHML Medreseja Aludin	381	321	33	1.19	0.52	0.67	P+3	1,248	26		
Gjimnazi i Specializuar Matematikor	77	53	31	1.00	0.50	0.50	P	1,200	20	8	8
SHML Ahmet Gashi	180	216	63	0.80	0.55	0.25	P	1,248	26	0	1

2.7.2.1. Institucionet e arsimit parashkollor

Normat minimale për sipërfaqen e parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike të arsimit parashkollor janë si në vijim:

- Ndërtesat e çerdheve: 0.30 m²/banor dhe
- Ndërtesat e kopshteve: 1.00 m²/banor.

Normat teknike për planifikim hapësinor kanë përcaktuar 1.30 m² sipërfaqe minimale për parcela kadastrale të destinuara për institucione publike parashkollore për kokë banori. Duke marrë parasysh supozimin që në Komunë të Prishtinës do të ketë **290,508 banorë rezidentë** dhe sipërfaqen aktuale të parcelave kadastrale të institucioneve publike parashkollore prej **67,220.1 m²**, Komunës i mungojnë gjithsej **310,440.3 m²** sipërfaqe të parcelave kadastrale për ofrimin e shërbimeve të institucioneve publike parashkollore.

Tabela 56 Vlerësimi i sipërfaqeve aktuale krahas kërkesave hapësinore për institucione publike parashkollore sipas NTPH, bazuar në numrin e prognozuar të banorëve rezidentë 2031

Vendbanimi	Numri i prognozuar i banorëve 2031	Sipërfaqja e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Zonë urbane	208,398	66,379.5	1.3	270,917.4	-204,537.9
Zonë rurale	82,110	840.6	1.3	106,743	-105,902.4
Gjithsej	290,508	67,220.1	1.3	377,660.4	-310,440.3

Sa i përket mbulueshmërisë së lagjeve urbane të destinuara për banim me institucione publike parashkollore, 21 lagjet urbane të paraqitura në vijim nuk kanë institucione publike parashkollore: Aktash, Bërnice e Ulët, Kolovica, Muhaxherët, Prishtina e Re- zona qendër, Arbëria 1, Dodona, Lakrishte, Prishtina e Re- zona lindore, Taslixhe, Arbëria 2, Medrese, Mati 2, Prishtina e Re- zona perëndimore, Vreshtat, Mati 3.

Përpos institucioneve publike parashkollore, në Komunë të Prishtinës ka numër të konsiderueshëm të institucioneve private parashkollore, ku janë të regjistruar mbi 70% të fëmijëve.

Bazuar në kërkesën minimale për rreze të mbulueshmërisë prej 300m-500m të Normave Teknike të Planifikimit Hapësinor për organizimin hapësinor të institucioneve parashkollore publike në zonë urbane, shtrirjen ekzistuese dhe të planifikuar, rezulton që për të plotësuar nevojat hapësinore në të ardhmen, duhet të planifikohen edhe disa institucione parashkollore publike shtesë në këto lagje: Kodra e Trimave 1, Kodra e Trimave 2, Medrese, Kolovicë, Vreshtat, Taslixhe, Zona Historike, Velani, Dodona, Muhaxherët, Mati 1, Prishtina e Re Zona Qendër, Prishtina e Re Zona Perëndimore, Kalabri, Arbëri 2, Arbëri 1, Hajvali etj.

2.7.2.2. Institucionet e arsimit para-universitar

Normat minimale për sipërfaqen e parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët janë si në vijim:

- Ndërtesat e shkollave fillore: 1.60 m²/banor dhe
- Ndërtesat e shkollave të mesme të ulëta 1.20 m²/banor.

Duke marrë parasysh supozimin që në Komunë të Prishtinës do të ketë **290,508 banorë rezidentë** dhe sipërfaqen aktuale të parcelave kadastrale të institucioneve publike të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët prej **427,702.1 m²**, komunës i mungojnë gjithsej **385,720.3 m²** sipërfaqe të parcelave kadastrale për ofrimin e shërbimeve të këtyre institucioneve.

Tabela 57 Vlerësimi i sipërfaqeve aktuale krahas kërkesave hapësinore për institucione publike të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët sipas NTPH, bazuar në numrin e prognozuar të banorëve 2031

Vendbanimi	Numri i prognozuar i banorëve	Sipërfaqja e parcelave	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së
------------	-------------------------------	------------------------	--------------------------------------	---	-------------------------

	2031	kadastrale (m ²)	(m ²)		nevojshme (m ²)
Zonë urbane	208,398	269,154.8	2.8	583,514.4	-314,359.6
Zonë rurale	82,110	158,547.3	2.8	229,908	-71,360.7
Gjithsej	290,508	427,702.1	2.8	813,422.4	-385,720.3

Sa i përket rrezes së mbulueshmërisë së lagjeve urbane të destinuar për banim, shumica e sipërfaqeve të lagjeve urbane është e mbuluar me institucione publike të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët.

Përpos institucioneve publike të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët, në Komunë të Prishtinës ka numër të konsiderueshëm të institucioneve private të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët, ku janë të regjistruar mbi:

- 25% të fëmijëve në arsim parafillor;
- 8% të fëmijëve në arsim fillor dhe të mesëm të ulët.

Bazuar në kërkesë minimale për rreze të mbulueshmërisë prej 600 m të Normave Teknike të Planifikimit Hapësinor për organizimin hapësinor të institucioneve publike të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët në zonë urbane, shtirjen ekzistuese dhe të planifikuar, rezultojnë që për të plotësuar nevojat hapësinore në të ardhmen, duhet të planifikohen së paku:

- 1 institucion publik të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët në pjesën juglindore të lagjes Kodra e Trimave;
- 1 institucion publik të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët në pjesën jugperëndimore të lagjes urbane Prishtina e Re Zona Qendër;
- 1 institucion publik të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët në pjesën juglindore të lagjes urbane-Hajvali.
- 1 institucion publik i arsimit fillor dhe të mesëm të ulët në lagjen Veternik

Normat minimale për sipërfaqen e parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike të arsimit të mesëm të lartë janë si në vijim:

- Ndërtesat e shkollave të mesme të larta 1.00 m²/banor.

Duke marrë parasysh supozimin që në Komunë të Prishtinës do të ketë **290,508 banorë rezidentë** dhe sipërfaqen aktuale të parcelave kadastrale të institucioneve publike të arsimit të mesëm të lartë prej **427,702.1 m²**, Komunës i mungojnë gjithsej **127,575.5 m²** sipërfaqe të parcelave kadastrale për ofrimin e shërbimeve të këtyre institucioneve publike.

Tabela 58 Vlerësimi i sipërfaqeve aktuale krahas kërkesave hapësinore për institucione publike të arsimit të mesëm të lartë sipas NTPH, bazuar në numrin e prognozuar të banorëve

Vendbanimi	Numri i prognozuar i banorëve 2031	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Zonë urbane	208,398	155,535.5	1	208,398	-52,862.5
Zonë rurale	82,110	7,397	1	82,110	-74,713
Gjithsej	290,508	162,932.5	1	290,508	-127,575.5

Sa i përket rrezes së mbulueshmërisë së lagjeve urbane të destinuar për banim, shumica e lagjeve urbane kanë institucione publike të arsimit të lartë:

Përpos institucioneve publike të arsimit të mesëm të lartë, në Komunë të Prishtinës ka numër të konsiderueshëm të institucioneve private të arsimit të mesëm të lartë, ku janë të regjistruar mbi 15%.

Bazuar në kërkesë minimale për rreze të mbulueshmërisë prej 1,500 m të Normave Teknike të Planifikimit Hapësinor për organizimin hapësinor të institucioneve publike të arsimit të mesëm të

lartë në zonë urbane, shtirjen ekzistuese dhe të planifikuar, rezulton që për të plotësuar nevojat hapësinore në të ardhmen, duhet të planifikohen së paku:


- 1 institucion publik të arsimit të mesëm të lartë, në pjesën qendrore të lagjes urbane Kodra e Trimave 2;
- 1 institucion publik të arsimit të mesëm të lartë, në pjesën jugore të lagjes urbane Mati 2;
- 1 institucion publik të arsimit të mesëm të lartë, në pjesën qendrore të lagjes urbane Hajvali.

Bazuar në kërkesë minimale për rreze të mbulueshmërisë prej 4700 m të Normave Teknike të Planifikimit Hapësinor për organizimin hapësinor të institucioneve publike të arsimit të mesëm të lartë në zonë rurale, shtirjen ekzistuese dhe të planifikuar, rezulton që për të plotësuar nevojat hapësinore në të ardhmen ka nevojë për të ndërtuar institucione të arsimit të mesëm të lartë publik, për të mbuluar pjesën e vendbanimeve rurale që shtrihen në pjesën qendrore dhe lindore të territorit komunal.

2.7.2.3. Institucionet e arsimit të lartë

Kryeqyteti ofron shërbime të arsimit të lartë në kuadër të Universitetit publik të Prishtinës, i cili shtrihet në një sipërfaqe prej **252,711.03 m²**. Kjo sipërfaqe në këtë dokument konsiderohet si zonë teknologjike, në të cilën zhvillohen hulumtime shkencore, arsim shkencor i nivelit të lartë dhe zhvillim teknologjik.

Përveç institucioneve publike të arsimit të lartë, në Komunë të Prishtinës ka numër të konsiderueshëm të institucioneve private të arsimit të lartë, në cilësinë e kolegjeve dhe shkollave të larta profesionale.



Harta 21 Rrezja shërbyese e institucioneve të arsimit në komunë

2.7.2.4. Vlerësimi i kapacitetit financiar dhe teknik

Bazuar në trendin e fondeve të alokuara nga buxheti qendror apo komunal për tre vitet paraprake dhe tre vitet vijuese, në rast kur nuk ka ndryshime të theksuara në vija buxhetore, rezulton që

kapaciteti i përgjithshëm financiar i Drejtorisë së Arsimit për realizimin e projekteve kapitale për vitin 2021–2029 është €7,907,06945, €0.00 nga granti qeveritar, €7,607,008 nga të hyrat vetanake dhe €300,061 përmes financimit nga huamarrja.

Tabela 59 Vlerësimi i kapaciteteve financiare (€) për investime kapitale të Drejtorisë së Arsimit

	2018 - 2020		2021 - 2023		2024 - 2026		2027 - 2029	
	Subvencione	Investime	Subvencione	Investime	Subvencione	Investime	Subvencione	Investime
	t transferet	dhe kapitale	t transferet	dhe kapitale	t transferet	dhe kapitale	t transferet	dhe kapitale
<i>Gjithsej</i>	210,000	1,480,000	250,000	2,258,190	262,500	2,371,100	275,625	2,489,654
<i>Grantet Qeveritare</i>	-	-	-	-	-	-	-	-
<i>Të Hyrat vetanake</i>	210,000	1,475,459	250,000	2,163,008	262,500	2,271,158	275,625	2,384,716
<i>Financim i jashtëm</i>	-	-	-	-	-	-	-	-
<i>Financimi nga huamarrja</i>	-	4,541	-	95,182	-	99,941	-	104,938


2.7.3. Administrata publike

Ndërtesat administrative dhe publike janë të përqendruara në pjesën më të madhe në qytetin e Prishtinës, si qendër komunale. Në këtë qytet janë të shtrira institucionet e nivelit komunal, si Kuvendi i Komunës, Zyra Komunale e Punësimit, Zyra e Postës dhe Telekomit, Shërbimet bankare, Zjarrfikësit, Stacioni Policor dhe objekte tjera. Përveç institucioneve administrative nën menaxhimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës, në Komunën e Prishtinës gravitojnë edhe institucionet administrative të nivelit qendror si: Kuvendi i Kosovës, Objekti i Qeverisë, Zyra e Bashkimit Evropian, objektet ministrore, agjencitë e ndryshme dhe një numër i madh i objekteve administrative në menaxhim qendror.

Një zhvillim i tillë i rrjetit të institucioneve publike, ka bërë që banorët e komunës për kryerjen e shumicës së shërbimeve administrative të orientohen në qytet. Përqendrimi i këtyre shërbimeve në qendrën komunale në njërën anë si dhe ekzistenca e infrastrukturës rrugore jo e mirë në anën tjetër, bëjnë që qasja në ndërtesat publike të mos jetë gjithmonë e lehtë ndërsa shfrytëzimi i shërbimeve të jetë i kufizuar.

Tabela 60 Inventari i ndërtesave të administratës publike

<i>Objekti / Institucioni</i>	<i>Sip. e ngastrës</i>	<i>Sip. e zhvilluar</i>	<i>Etazhiteti</i>
<i>Kuvendi Komunal 2 objektet</i>	1.10	0.31	P+3
<i>KRU Prishtina</i>	16.35	3.65	P
<i>KRM Pastrimi</i>	3.70	0.30	P+1
<i>Zyra e gjendjes civile-Ulpianë</i>			
<i>Zyra e gjendjes civile-Dardani</i>			
<i>Zyra e gjendjes civile-Kodra e Trimave</i>			
<i>Zyra e gjendjes civile-Xhamia e Llapit</i>			
<i>Zyra e gjendjes civile-Bregu i Diellit</i>			
<i>Zyra e gjendjes civile-Muhaxherët</i>			
<i>Objektet policore</i>	2.45	1.20	P+2
<i>Zjarrfikësit</i>	0.57	0.10	P+2
<i>Termokos</i>	1.36	0.30	P+2
<i>Qendra për regjistrim civil dhe të automjeteve</i>	0.12	0.06	B+P+5



Harta 22 Infrastruktura publike dhe sociale

2.7.3.1. Vlerësimi i nevojave të ardhshme

Komuna e Prishtinës si kryeqyteti i Republikës së Kosovës, është nikoqir i të gjitha shërbimeve administrative të nivelit qendror, duke përfshirë ministrinë, agjencitë dhe funksionet tjera publike administrative. Për këtë arsye, sasia e sipërfaqeve të destinuara për këto shërbime tejkalon shumëfish normat teknike të planifikimit hapësinor.

Duke marrë parasysh supozimin që në vitin 2031 në Komunë të Prishtinës, numri i banorëve rezidentë do të jetë **290,508**, sipërfaqen aktuale të parcelave kadastrale prej **807,556.7 m²** dhe normën minimale prej **0.62 m²/banor** të parcelave të destinuara për institucione të administratës publike, komuna e Prishtinës tejkalon për 627,441.7 m² sipërfaqet e destinuara për institucione të administratës publike.

Tabela 61 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve të administratës publike për numrin e prognozuar të banorëve 2031

	Nr. i prognozuar i banorëve 2031	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar kokë (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për përgjithshme banori kërkohet (m ²)	Bilanci i që sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Zonë urbane	208,398	686,637.7	0.62	129,206.8	557,430.9
Zonë rurale	82,110	120,919.0	0.62	50,908.2	70,010.8
Gjithsej	290,508	807,556.7	0.62	180,115	627,441.7

2.7.3.2. Vlerësimi i kapacitetit financiar dhe teknik

Bazuar në trendin e fondeve të alokuara nga buxheti qendror apo komunal për tre vitet paraprake dhe tre vitet vijuese, në rast kur nuk ka ndryshime të theksuara në vija buxhetore, rezultojnë që kapaciteti i përgjithshëm financiar i Drejtorisë së Administratës për realizimin e projekteve kapitale për vitin 2021–2029 është € 23,993,36246, € 14,186,250 nga granti qeveritar dhe €9,807,112 nga të hyrat vetanake.

Tabela 62 Vlerësimi i kapaciteteve financiare (€) për investime kapitale të Drejtorisë së Administratës

2018 - 2020	2021 – 2023	2024 - 2026	2027 - 2029
-------------	-------------	-------------	-------------

	Subvencionet dhe transferet	Investime kapitale	Subvencionet dhe transferet	Investime kapitale	Subvencionet dhe transferet	Investime kapitale	Subvencionet dhe transferet	Investime kapitale
Gjithsej	270,000	435,000	6,630,900	980,000	6,962,445	1,029,000	7,310,567	1,080,450
Grantet qeveritare	-	-	4,200,000	300,000	4,410,000	315,000	4,630,500	330,750
Të hyrat	270,000	435,000	2,430,900	680,000	2,552,445	714,000	2,680,067	749,700
vetanake								
Financim i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-	-
Financimi nga-huamarrja	-	-	-	-	-	-	-	-

2.7.4. Mirëqenia sociale dhe komuniteti

Në komunën e Prishtinës në kuadër të institucioneve të mirëqenies sociale dhe komunitetit funksionojnë 4 qendra ditore për të moshuar, me gjithsej 8 punëtorë. Sa i përket personave me aftësi të kufizuar që kërkojnë vëmendje të veçantë nga institucionet relevante, numri total i tyre është 30,432, ndërsa ndarja sipas moshës dhe skemës është si më poshtë:

Tabela 63 Skemat sociale sipas gjinisë

Skema	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Kompensimi i Arsimit	1234	1013	2247
FSK	52	8	60
Kompensimi për të verbrit	96	88	184
Pensioner Familjar	1	414	415
Pen. Invalidor i Punës	5	2	7
Kompensimi për Para dhe Tetraplegjikët	160	137	297
TMK	112	10	122
Pensionet Trepça	117	16	133
Pensioner Baze	4695	10341	15036
Pensioner Kontribut pagues	7296	2676	9972
Pensioner për persona me aftësi të kufizuar	874	1085	1959

Shtëpia për të moshuar në komunën e Prishtinës shërben 60 të moshuar, ndërsa sipas të dhënave nga drejtoria e mirëqenies sociale të komunës, 5 fëmijë gjenden në strehim familjar. Numri i viktimave të dhunës është shumë i lartë në komunë, rreth 300 raste të dhunës në familje në vit, prandaj institucionet për përkujdesjen e viktimave të tillë duhet të planifikohen në komunë.

2.7.4.1. Vlerësimi i nevojave të ardhshme

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej:

- 0.25 m²/banor për institucionet e shërbimeve sociale dhe familjare dhe
- 0.20 m²/banor për ndërtesat e institucioneve të komunitetit.

Duke marrë parasysh supozimin që në vitin 2031 në Komunë të Prishtinës, numri i banorëve rezidentë do të jetë **290,508**, sipërfaqen aktuale të parcelave kadastrale prej **14,324.8 m²** banorë dhe normën minimale prej **0.45 m²/banor** parcelave të destinuara për institucione të mirëqenies sociale dhe komunitetit, atëherë komunës i mungojnë gjithsej **116,403.8 m²** sipërfaqe të destinuara për institucione të mirëqenies sociale dhe komunitetit.

Tabela 64 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelave për institucione të mirëqenies sociale dhe komunitetit për numrin e prognozuar të banorëve 2031

	Nr. i prognozuar i banorëve 2031	Sipërfaqja e aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme për përkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Zonë urbane	208,398	14,324.8	0.45	93,779.1	-79,454.3
Zonë rurale	82,110	0	0.45	36,949.5	-36,949.5
Gjithsej	290,508	14,324.8	0.45	130,728.6	-116,403.8

2.7.4.2. Vlerësimi i kapacitetit financiar dhe teknik

Bazuar në trendin e fondeve të alokuara nga buxheti qendror apo komunal për tre vitet paraprake dhe tre vitet vijuese, në rast kur nuk ka ndryshime të theksuara në vija buxhetore, rezultojnë kapaciteti i përgjithshëm financiar i Drejtorisë së Mirëqenies Sociale për realizimin e projekteve kapitale për vitin 2021– 2029 është € 2,774,20047, € 0.00 nga granti qeveritar dhe € 2,774,200 nga të hyrat vetanake.

Tabela 65 Vlerësimi i kapaciteteve financiare (€) për investime kapitale të Drejtorisë së Mirëqenies Sociale 2018 - 2020 2021 – 2023 2024 - 2026 2027 - 2029

	Subvencion et dhe e transferet	Investimet kapitale	Subvencion et dhe e transferet	Investimet kapitale	Subvencion et dhe e transferet	Investimet kapitale	Subvencion et dhe e transferet	Investimet kapitale
Gjithsej			200,000	680,000	210,000	714,000	220,500	749,700

Grantet qeveritar e

Të hyrat 320,000

vetanake

Financim

i jashtëm

Financim

i nga

huamarrj

a

2.7.5. Kultura

Prishtina, si kryeqytet, ka një numër të madh të organizatave kulturore aktive që përbëjnë pjesën më të madhe të jetës dhe ngjarjeve kulturore në Kosovë. Sidoqoftë, Prishtina ballafaqohet me nevoja të shumta si rrjedhojë e problemeve të rastitura në përmirësimin e gjendjes aktuale, në kapacitetet humane në institucionet ekzistuese, në çështjen e investimit dhe atë të hapësirave të nevojshme për realizimin e aktiviteteve. Për më shumë, Komuna e Prishtinës has edhe në probleme sa i përket legjislacionit, duke qenë në mospërputhje me kërkesat e institucioneve kulturore.

Në përputhje me përgjegjësitë ligjore, Drejtoria e Kulturës është e përkushtuar me Arkivin Komunal të udhëheqë Teatrin “Dodona”, Bibliotekën Komunale “Hivzi Sylejmani” me degët e saj, dhe Qendrën Kulturore të Fëmijëve. Drejtoria përpilon, rishikon dhe modifikon veprimet juridike të raporteve juridiko-civile kontraktuale në lidhje me institucionet e kulturës të Komunës së Prishtinës, dhe së bashku me ministrinë përkatëse realizon projektet kulturore. Institucionet vartëse të lartpërmendura, përkundër faktit që janë funksionale, ato janë të pakta në numër, nuk janë të shfrytëzueshme në tërësi, si dhe vuajnë në aspektin e kapaciteteve humane si dhe profileve të nevojshme për të zhvilluar aktivitete kulturore e inovative. Institucione të tilla, me menaxhimin dhe funksionalizimin adekuat, do të shërbenin edhe si hapësira publike për zhvillim të aktiviteteve nga organizatat joqeveritare (OJQ), pasi që mungesa e hapësirave është një nga problemet që e bën të pamundur organizimin e aktiviteteve kulturore nga shoqëria civile. Ky rifunksionalizim do të

mundësonte përfitim të dyanshëm; zhvillim të qëndrueshëm të institucioneve në fjalë si dhe bashkëpunim me OJQ-të për përdorim të hapësirave të disponueshme.

Tabela 66 Inventari i ndërtesave kulturore

Objekti / Institucioni	Lokacioni	Sip. e ngastrës (Ha)	Sip. e zhvilluar	Etazhiteti
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës	Prishtinë	0.55	0.30	3B+P+3
Biblioteka Hivzi Sylejmani	Prishtinë	0.97	0.25	P+1
Teatri Kombëtar	Prishtinë	0.20	0.17	P+2
Orkestra Filarmonike e Kosovës	Prishtinë	0.12	0.04	B+P+1
Galeria e Arteve e Kosovës	Prishtinë	0.15	0.10	P+1
Muzeu Kombëtar	Prishtinë	0.20	0.10	P+2
Qendra Kinematografike e Kosovës	Prishtinë	0.05	0.04	B+P

Muzeu i Qytetit

Muzetë sigurojnë gjallëri kulturore brenda komuniteteve të ndryshme të një qyteti, duke ofruar një përvojë lokale për popullatën vendore si dhe ndërkombëtare. Deri tani, Prishtina është në mungesë të një Muzeu të Qytetit, e në nevojë shumë të madhe për të. Muzeu i Qytetit do të ruante, prezantonte dhe promovonte historinë e qytetit, arkeologjinë, arkitekturën, trashëgiminë kulturore, dhe atë shpirtërore e jo-materiale. Muzeu i Qytetit do të na ndihmonte të rimendojmë historinë, vlerësojmë strukturat shoqërore përgjatë periudhave të ndryshme kohore, të nxisim dialog kulturor e shoqëror, e të promovojmë arkitekturën, të kaluarën dhe kulturat që i kanë mbijetuar kohës dhe ndryshimeve shoqërore e politike në qytet. Në arritje të këtij qëllimi, duke konsideruar të gjitha aspektet e lartpërmendura, Drejtoria e Kulturës ka filluar themelimin e grupit punues që do të punojë në krijimin e konceptit të Muzeut të Prishtinës dhe të operimit të brendshëm me staf profesionistë të trajnuar në fushat e tyre përkatëse.

Biblioteka Hivzi Sylejmani

Është themeluar 70 vjet më parë dhe kjo është një nga bibliotekat më të mëdha në lidhje me numrin e librave në inventarin e saj, gati 100.000. Të gjitha këto libra janë në shërbim për lexuesit e regjistruar në bibliotekë. Në kuadër të bibliotekës Hivzi Sylejmani operojnë edhe një numër i degëve, të cilat janë të shpërndara në nivel komunal: Pallati Rinisë, Keqekollë, Bardhosh, Slivovë, Koliq, Hajvali dhe Llukar.

Galeria e Qytetit

Galeritë e arteve, përveç prezantimit dhe promovimit të punës së artistëve vendas e ndërkombëtarë për publikun e gjerë, ato edhe shërbejnë si hapësira të disponueshme për qytetarët të kalojnë kohë të lirë e kualitative, si vendtakim për të rinjtë dhe si një mekanizëm komunikimi mes artistëve dhe komunitetit. Qyteti i Prishtinës është në mungesë të një Galerie të Qytetit, si në aspektin fizik-hapësinor ashtu edhe përmbajtësor. Themelimi i një galerie përfshinë më shumë sesa prezantimin dhe promovimin e artistëve vendas, është një mundësi për bashkëpunim me artistë të ndryshëm ndërkombëtarë, që do të tërheqin artdashësit dhe turistët në qytet si një destinacion turistik dhe në anën tjetër do të kishte ndikim edhe ekonominë lokale. Përderisa skena e artit të një qyteti zhvillohet, është e rëndësishme të mbahet një sistem i brendshëm i ekuilibruar që do të mund të mbështesë projekte të fokusuara në qytet, rajon si dhe në vende të tjera ndërkombëtare. Galeria e Qytetit do të i ndihmonte qytetarëve të Prishtinës të shfrytëzojnë dhe kontribuojnë në historinë e artit e të skenës kulturore të qytetit, të jenë pjesë aktive e ndryshimeve shoqërore, politike e kulturore, dhe të formojnë komunitete më të vogla kulturore që punojnë drejt qëllimeve dhe aspiratave të përbashkëta.

Teatri i Qytetit

Ligji i Republikës së Kosovës parasheh një Teatër për secilin qytet të shtetit të Kosovës. Mbi këtë bazë, Teatri “Dodona” konsiderohet si teatri i qytetit të Prishtinës, andaj krijimi i një teatri të ri nuk është i lejuar me dispozita ligjore. Sidoqoftë, Drejtoria e Kulturës është në rishikim të mundësive për investim në hapësira të ndryshme të Teatrit “Dodona”, që janë në nevojë për renovim dhe rifunksionalizim për të arritur përdorimin optimal të objektit për ngjarje dhe aktivitete artistike e kulturore. Në bashkëpunim me Drejtorinë dhe Këshillin e Teatrit “Dodona”, Drejtoria për Kulturë ka filluar përgatitjet graduale për aktivizimin dhe funksionalizimin e këtij institucioni. Përveç restaurimeve të nevojshme në objekt, një ndër qëllimet e tjera fillestare është plotësimi i numrit të artistëve të Ansambllit rezident të Teatrit “Dodona”, për t’u mundësuar zhvillimin adekuat të punës dhe për të përmbushur nevojat e publikut.

Salla Koncertale

Konsiderata më e rëndësishme për një sallë koncertale, përtej akustikës së saj, është marrëdhënia që ajo vendos mes muzikës, artistëve dhe komunitetit. Prishtina, si kryeqytet, është një ndër të paktët që ende ka mungesë të një Salle Koncertale për organizim të koncerteve me theks të veçantë në muzikën klasike, operë dhe muzikën jazz. Si shtëpi e orkestrës, hapësira e Sallës Koncertale do të ftoj publikun e Prishtinës të ndjek koncerte e ngjarje kulturore edhe në zhanre të tjera muzikore si rock, pop, muzikë popullore, instrumentale etj., që kërkojnë një audiencë e hapësirë më të madhe të disponueshme. Duke pasur në konsideratë rëndësinë dhe vlerën që ky institucion do të sillte në sferën kulturore në qytet, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës ka filluar puna për të realizuar projektin e Sallës Koncertale me prioritet të lartë. Prania fizike e një salle koncertale do të krijoj një përshtypje të menjëhershme dhe të qëndrueshme të komunikimit të drejtpërdrejt me komunitetin, duke i dhënë asaj rolin e nxitjes së dialogut dhe zhvillimit kulturor-muzikor si kombëtarisht ashtu edhe ndërkombëtarisht.

Qendra Kulturore e Fëmijëve në Komunën e Prishtinës

Qendra Kulturore e Fëmijëve në Prishtinë, si institucion me lokacion në Pallatin e Rinisë, është themeluar dhe funksionon në kuadër të Drejtorisë së Kulturës. Përkundër ekzistimit të qendrës, institucioni ka nevojë për ristrukturim të hapësirës dhe investim, apo krijim të një hapësire të re të përshtatshme. Qendrat Kulturore të Fëmijëve të propozuara, sikur ajo në Hajvali, Llukar etj., do të rindërtohen dhe aktivizohen me modele të reja të menaxhimit sa i përket resurseve humane dhe përmbajtësore. Drejtoria e Kulturës është e përkushtuar në zhvillimin e Qendrave Kulturore që promovojnë një mjedis arsimor pozitiv e jo-formal për të rinjtë brenda qytetit. Qendrat ekzistuese dhe ato të propozuara do të ofrojnë një sferë të gjerë aktiviteteve për të rinjtë, duke përfshirë ato sportive, punëtori edukative, kulturore, artistike, trajnime zhvillimore, dhe diskutime e debate të shumta mbi çështjet aktuale rinore. Qendrat Kulturore do të shërbejnë si një urë lidhëse mes të rinjve dhe komunitetit lokal, duke inkurajuar qytetari aktive dhe vullnetarizëm për të bërë ndryshimet e nevojshme në komunitet.

Muzeu i Shtëpive Shkolla – Muzeu i Herticëve (Shtëpia shkollë e familjes Hertica)

Sistemi paralel i edukimit gjatë viteve të 90-ta është një nga organizimet më të rralla që kombet e shtypura e të privuara nga sistemi i arsimit shtetëror kanë aplikuar ndonjëherë. Andaj, duke vlerësuar historinë dhe vullnetin e popullit për t’u arsimuar në atë periudhë në shtëpi-shkolla, Drejtoria e Kulturës konsideron krijimin e Muzeut të Herticëve, Muzeu i Shtëpive Shkolla, si një formë e dokumentimit dhe përkujtimit të zemërgjerësisë dhe sakrificës së familjeve që kanë dhënë shtëpitë e tyre për shkolla. Tani, duke gëzuar të drejtën për arsim, është e rëndësishme që periudha e sistemit paralel të shkollimit të kujtohet dhe shpjegohet, për të kuptuar dhe vlerësuar gjendjen e tanishme të arsimit nga e tërë popullata, e posaçërisht nga të rinjtë në vend.

Qendrat e Komunitetit

Qendrat e Komunitetit kanë për qëllim ofrimin e hapësirave ku njerëzit bashkohen për të punuar në projekte më të gjera të komunitetit. Qendrat do të ofrojnë klase dhe ngjarje multi-disiplinore, si aktivitete artistike dhe krijuese, edukative, fizike, sociale e kulturore. Hapësirat e Qendrave të Komunitetit do të jenë të disponueshme për përdorim edhe nga artistë të sferave të ndryshme të artit për veprimtari, punëtori dhe praktika ushtruese, me kosto të ulët apo pa pagesë. Natyra multi-

disiplinore e qendrave është thelbësore për të inkurajuar edhe anëtarë të rinj të komunitetit të përfshihen në aktivitete dhe të zhvillojnë një qytetari aktive krijuese e reaguese. Ndër tjerash, Qendrat e Komunitetit gjithashtu do të zhvillojnë një kulturë të mirëqenies në të gjithë shëndetin shoqëror, mendor dhe fizik.

Festivalet dhe Aktivitetet e Tjera Kulturore të Qytetit

Drejtoria e Kulturës, me anë të thirrjeve për subvencione, ka mbështetur dhe vazhdon të mbështesë festivale dhe aktivitete të ndryshme në sferën e muzikës, filmit, teatrit, artit bashkëkohor, artit vizual, inovacionit, librit etj. Sidoqoftë, përveç përkrahjes, këto festivale e aktivitete kanë nevojë për hapësira akomoduese për organizim adekuat, andaj krijimi i Sallës Koncertale për organizimin e koncerteve e festivaleve të muzikës është me prioritet të lartë. Sa i përket festivaleve muzikore të hapura (p.sh. Sunny Hill Festival), Prishtina ka nevojë për hapësira me të gjitha kushtet për organizim të ngjarjeve në ambient të hapur. Për më shumë, qyteti i Prishtinës ka nevojë edhe për hapësira për zhvillim të artit bashkëkohor e vizual, studio për artistë, hapësira për prodhim të punëve (punëtori), kinema alternative për festivale të filmit, institucione multidisiplinore, etj. Organizimi i projektit të Manifesta Biennal 14 Prishtina do të ketë si një ndër rezultatet kryesore të dala edhe krijimin e një institucioni të qëndrueshëm multidisiplinor që do të funksionojë si një hapësirë për zhvillimin e sferave të ndryshme të artit e kulturës në vend.

Normat minimale për sipërfaqen e parcelës së infrastrukturës së kulturës janë si në vijim:

- 0.25 m²/banor për ndërtesat e bibliotekave dhe
- 0.20 m²/banor për ndërtesat e teatrove.

Duke marrë parasysh supozimin që në vitin 2031 në Komunë të Prishtinës, numri i banorëve rezidentë do të jetë **290,508**, sipërfaqen aktuale të parcelave kadastrale prej **23,187.5 m²** dhe normën minimale prej **0.45 m²/banor** për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve kulturore, komunës i mungojnë gjithsej **107,541.1 m²** sipërfaqe për institucione kulturore.

Tabela 67 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve kulturore

	Nr. i prognozuar i banorëve 2031	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Zonë urbane	208,398	21,613.4	0.45	93,779.1	-72,165.7
Zone rurale	82,110	1,574.1	0.45	36,949.5	-35,375.4
Gjithsej	290,508	23,187.5	0.45	130,728.6	-107,541.1

2.7.5.1. Vlerësimi i kapacitetit financiar dhe teknik

Bazuar në trendin e fondeve të alokuara nga buxheti qendror apo komunal për tre vitet paraqite dhe tre vitet vijuese, në rast kur nuk ka ndryshime të theksuara në vija buxhetore, rezultojnë që kapaciteti i përgjithshëm financiar i përbashkët i Drejtorisë së Kulturës për realizimin e projekteve kapitale për vitin 2021– 2029 është € 17,445,93548, € 1,891,500 nga granti qeveritar dhe € 15,554,435 nga të hyrat vetanake.

Tabela 68 Vlerësimi i kapaciteteve financiare (€) për investime kapitale të Drejtorisë së Kulturës

	2018 - 2020		2021 – 2023		2024 - 2026		2027 - 2029	
	Subvencion et transferet	Investim dhee kapitaleet	Subvencion et transferet	Investim dhee kapitaleet	Subvencion et transferet	Investim dhee kapitaleet	Subvencion et transferet	Investim dhee kapitaleet
Gjithsej	560,000	1,683,000	1,330,000	4,204,000	1,396,500	4,414,200	1,466,325	4,634,910
Grantet qeveritare	-	-	600,000	-	630,000	-	661,500	-

Të hyrat 560,000 1,683,00 730,000 4,204,00 766,500 4,414,20 804,825 4,634,91
 vetanake 0 0 0 0
 Financim
 i jashtëm
 Financimi
 nga
 huamarrj
 a

2.7.6. Rinia, sporti dhe rekreacioni

Në kuadër të Sektorit të Rinisë të Komunës së Prishtinës, vepron KVRL (Këshilli i Veprimit Rinor Lokal), i cili ka mision përforcimin e organizatave rinore brenda komunave përkatëse, si dhe ndërtimin e një vizioni të përbashkët për rininë, po ashtu në kuadër të sektorit të rinisë ekziston edhe Qendra Rinore, e cila është hapësirë e funksionalizuar për zhvillimin e veprimit të të rinjve.

Sektorit i rinisë bashkëpunon me Departamentin e Rinisë pranë MKRS-së, organizata vendore dhe ndërkombëtare.

Sektorit i rinisë në bashkëpunim me KVRL-në, Qendrën Rinore si dhe Organizata të shumta realizojnë projekte/aktivitete të ndryshme varësisht nga kërkesat/nevojat e të rinjve.

Disa nga aktivitetet që Sektorit i Rinisë organizon janë:

- Aktivitete të ndryshme rinore për Ditën e Pranverës, 21 mars;
- Aktivitete të ndryshme rinore për Ditën Ndërkombëtare të Librit, 23 prill;
- Aktivitete të ndryshme rinore për Ditën Ndërkombëtare të Rinisë 12 gusht;
- Aktivitete të ndryshme rinore për shënimin e Muajit të Rinisë, shtator.

Tabela 69 Institucionet kulturore sportive

Objekti / Institucioni	Lokacioni	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e zhvilluar (ha)	Viti i ndërtimit	Kapaciteti i ulëseve	Nr. i të punësuarve
Pallati i Rinisë	Prishtinë	2.95	2.95	1975	8000	125
Salla e Tetorit	Prishtinë	0.55	0.30	/	2000	
Stadiumi Fadil Vokrri	Prishtinë	1.85	1.85	1953	13500	
Stadiumi KF Flamurtarit	Prishtinë	1.10	1.10	1968	5000	15
Stadiumi KF 2 Korrikut	Prishtinë	1.70	1.70	1990	1000	
Stadiumi KF Ramiz Sadiku	Prishtinë	1.55	1.55	1950	5000	14

Në Komunën e Prishtinës gjenden një numër i konsiderueshëm i hapësirave rekreative të shtrira në tërë territorin e Komunës, veçoritë hapësirave të këtyre hapësirave janë të paraqitura në tabelën e poshtme.

Tabela 70 Veçoritë hapësirave rekreative

Institucionet rekreative	Lokacioni	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lire (ha)
Stadiumi, Matiqan	Matiqan	0.60	0.00	0.00
Stadiumi, Hajvali	Hajvali	2.00	0.00	0.00
Fushë sportive (Prishtinë pro Basket)	Prishtinë	0.10	0.00	0.00
Fushë sportive	Arbëri	0.20	0.17	0.03

Fushë sportive	Mati I	0.22	0.18	0.04
Fushë sportive	Vneshta	0.07	0.05	0.02
Fushë sportive	Hajvali	0.73	0.00	0.00
Fushë sportive	Grashticë	0.23	0.00	0.00
Fushë sportive	Dardani	0.05	0.00	0.00
Fushë sportive	Ulpianë	0.08	0.00	0.00
Fushë sportive 2	Ulpianë	0.12	0.00	0.00
Fushë sportive 3	Ulpianë	0.14	0.00	0.00
Fushë sportive	Dardani	0.33	0.25	0.08
Fushë sportive	Dardani	0.05	0.00	0.00
Fushë sportive mbyllur	Bregu i diellit	0.15	0.10	0.05
Fushë sportive	Kodra e Trimave	0.07	0.00	0.00
Fushë sportive mbyllur	Sharban	0.20	0.18	0.02
Fushë sportive	Prishtinë	0.07	0.00	0.00
Fushë sportive	Çagllavicë	1.70	1.50	0.20
Fushë sportive	Dardani	0.07	0.00	0.00
Fushë sportive	Prishtinë	0.15	0.00	0.00
Fushë lojë e hapur	Bregu i diellit	0.50	0.00	0.50
Fushë lojë e hapur	Ulpianë	0.13	0.00	0.13
Fushë lojë e hapur	Ulpianë	0.05	0.00	0.05
Fushë lojë e hapur	Aktash	0.15	0.00	0.15
Hapësirë Sportive	Bërnice e Poshtme	13.20	0.00	13.20

Në Komunën e Prishtinës janë të regjistruara rreth 105 klube sportive, të cilat ushtrojnë aktivitete të ndryshme sportive.

Tabela 71 Klubet sportive në Komunën e Prishtinës
Klubet sportive në Komunën e Prishtinës

1	Shoqëria Bjeshkatore Prishtina	54	Klubi i Karatesë dhe Judos Fan
2	Klubi i Futbollit Prishtina	55	Klubi i Tenisit Prishtina
3	Klubi i Basketbollit Prishtina	56	Klubi i Shenjëtarisë Polici
4	Klubi i Shenjëtarisë Zenel Hajdini	57	Klubi i Peshëngritjes Vreshta-Prishtinë
5	Klubi i Notit SCAN-COLOR JYSK Prishtinë (Termopan)	58	Klubi i Peshëngritjes Prishtina
6	Klubi i Karatesë Dardania Prishtinë	59	Klubi i Kick Box-it Prishtina
7	Klubi i Karatesë Prishtina	60	Auto Klubi Prishtina-DTM-Prishtina
8	Klubi i Karatesë Kosovari-Prishtinë	61	Klubi i Volejbollit Prishtina Junior
9	Klubi i Shahut Prishtina	62	Klubi i Taekëondos DON
10	Klubi i Karatesë Ardhmëria-Prishtinë	63	Klubi i Shenjëtarisë dhe i Shigjetarisë Gërmia
11	Klubi Çiklistik Prishtina	64	Klubi i Futbollit Besëlidhja
12	Klubi i Hendbollit Prishtina-Femrat	65	Klubi i Boksit Gollaku
13	Klubi i Pingpongut KOSOVA-Prishtinë	66	Klubi i Futbollit Hajvalia
14	Klubi i Shenjëtarisë HAJVALIA – Hajvali	67	Akademia e Sporteve Luftarake Universiteti
15	Klubi i Boksit PRISHTINA–Prishtinë	68	Klubi i Karatesë UNSU Prishtinë
16	Aeroklubi PRISHTINA –Prishtinë	69	Shoqata e Paraglajdzmit të Kosovës
17	Klubi i Shenjëtarisë Dardania-Prishtinë	70	Akademia e gjimnastikës Universiteti

18	Klubi i Futbollit FLAMURTARI-Prishtinë	71	Klubi i Tenisit dhe golfit Diellix
19	Klubi i Futbollit 2 KORRIKU-Prishtinë	72	Klubi Forta Thai Boxing
20	Klubi Atletik PRISHTINA–Prishtinë	73	Klubi i Notit Step
21	Klubi i Futbollit RILINDJA–Prishtinë	74	Klubi i Zhytjes Prishtina
22	Klubi i Futbollit Ramiz Sadiku–Prishtinë	75	Klubi i Taekëndo-së Agimi
23	Shoqata për K.& Mb. e Pëllumbave Pëllumbi	76	Thundër Taekëndo Club
24	Klubi i Notit PRISHTINA–Prishtinë	77	Racing Club Prishtina
25	Klubi i Futbollit KOSOVA–Prishtinë	78	Shkolla e futbollit Arsenal
26	Klubi i Karatesë IPPON–Prishtinë	79	Klubi Alpin Prishtina
27	Klubi i Karatesë BATLLAVA–Prishtinë	80	Klubi Kick Box Rigoro Gym Prishtina
28	Klubi i Karatesë Vajzat e Dardanisë Prishtinë	81	Klubi i Miniglofit First Block
29	Klubi i Hendbollit PRISHTINA–Meshkujt	82	Klubi Alpin Dardania
30	Klubi i Judos POLICI–Prishtinë	83	Klubi i Shenjëtarisë Prishtina
31	Klubi i Karatesë KOSOVA–Prishtinë	84	Klubi i Basketbollit M-junior Prishtina
32	Shoqata e Peshkatarëve Sportiv KRAPI Prishtinë	85	Klubi i Kick Boxi Martial Arts Gym
33	Klubi i Karatesë PAYTON–Prishtinë	86	Klubi i Volejbollit Prishtina Volley-Meshkujt
34	Klubi Fitnes Bodibilding Arnoldi-Prishtinë	87	Klubi i Karatesë AS Prishtina
35	Klubi i Taeëkëndos Prishtina-Prishtinë	88	Klubi i Parkourit ATOM³RUN
36	Klubi i Karatesë Bardhoshi–Bardhosh	89	Klubi i Pingpongut DODONA
37	Klubi i Skitarisë Prishtina–Prishtinë	90	Klubi i Shahut DARDANIA
38	Klubi Çiklistik AS Prishtina – Prishtinë	91	Klubi i Xhudos Prishtina
39	Klubi i Pingpongut Shkolla e Pingpongut	92	Klubi As Peshku Prishtina
40	Klubi i Pingpongut Prishtina-Meshkujt- Femrat	93	Klubi Atletik Gërmia
41	Klubi i Shahut Kosova–Prishtinë	94	Klubi i sporteve të ujit Zenit Aquatic Club
42	Klubi i Mundjes Prishtina–Prishtinë	95	Shoqata Bjeshkatore Alpiniste Shkëmbi
43	Shoqata Sportive Vigani	96	Klubi i Notit Nemo OP
44	Shkolla e Basketbollit Prishtina Pro Basket	97	Shkolla e Notit Zenit
45	Shkolla e Basketbollit Eurobasket	98	Klubi i sporteve të ujit H2O
46	Klubi i Taeëkëndos & Hapkido-së "Tigër"	99	Klubi i Miniglofit Tick Media Minigolf Club
47	Klubi i Volejbollit "Prishtina"-Meshkujt	100	Klubi Gërmia 555
48	Klubi Taekëondo-së & Hapkido-së Olympic Art	101	FC Prishtina Futsal
49	Klubi i Shahut Drejtësia	102	KV Prishtina Volley Femrat
50	Klubi i Karatesë Përparimi	103	Klubi i Parkourit Parkour School Prishtina
51	Akademia e Arteve Marciale	104	Klubi i Basketbollit të femrave Prishtina
52	Klubi Automobile Club Kosova	105	Klubi i Notit SHARK

2.7.6.1. Vlerësimi i nevojave për të ardhmen

Normat minimale për sipërfaqen e parcelës së infrastrukturës së institucioneve sportive dhe fushave rekreative janë si në vijim:

Sipas numrit të banorëve në vendbanim:

- ≤ 5000 banor: $2.50 \text{ m}^2/\text{banor}$;
- $\geq 5001-20,000$ banor: $4.50 \text{ m}^2/\text{banor}$;
- Mbi $20,001$ banor: $5.00 \text{ m}^2/\text{banor}$.

Duke marrë parasysh supozimin që në vitin 2031 në Komunë të Prishtinës, numri i banorëve rezidentë do të jetë **290,509**, sipërfaqen aktuale të parcelave kadastrale prej **368,943 m²** dhe normën minimale prej **2.50–5.00 m²/banor** për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve rinisë, sportit dhe rekreacionit, komunës deri në vitin 2031 duhet të zhvillojë së paku **977,814.1 m²** sipërfaqe shtesë të parcelave kadastrale për institucione- hapësira të rinisë, sportit dhe rekreacionit.

Tabela 72 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së rinisë, sportit dhe rekreacionit


		Nr. i prognozuar i aktuale banorëve 2031	I Sipërfaqja e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar kokë (m ²)	e Sipërfaqja për përgjithshme banori që (m ²)	e Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)	
Vendbanimet banorë	≤	5000	37,415	60,427.6	2.5	93,537.5	-33,109
Vendbanimet 20000 banorë		5001-24,499		124,406.3	4.5	110,245.5	14,160.8
Vendbanim banorë	≥	20001	228,595	184,109.1	5	1,142,975	-958,865.9
Gjithsej			290,509	368,943	2.50-5.0	1,346,758	-977,814.1

Bazuar në kërkesë minimale për rreze të mbulueshmërisë prej 800 m të Normave Teknike të Planifikimit Hapësinor për organizimin hapësinor në fushat sportive dhe rekreative, shtrirjen ekzistuese dhe të planifikuar, rezulton që në zonë urbane duhet të planifikohen së paku:

- 1 fushë sportive dhe rekreative në pjesën juglindore të lagjes urbane Prishtina e Re Zona Qendrore;
- 1 fushë sportive dhe rekreative në pjesën veriore të lagjes urbane Prishtina e Re Zona Perëndimore;
- 1 fushë sportive dhe rekreative në pjesën jugore të lagjes urbane Hajvali;
- 1 fushë sportive dhe rekreative në pjesën qendrore të lagjes urbane Kolovicë.

Për të plotësuar numrin e vlerësuar të sipërfaqeve të nevojshme bazuar në NTPH, në zonat rurale duhet të planifikohet krijimi i hapësirave të përshtatshme për infrastrukturë të rinisë, sportit dhe rekreacionit. Për të plotësuar nevojat e sporti në këto zona do të përdoret politika e zhvillimit: " fushat e sportit në kuadër të shkollave do të shërbejnë edhe për komunitetin jashtë orarit mësimor". Në bazë të kësaj politike të zhvillimit në bashkëpunim me drejtorin e arsimit nevojiten këto terrene sportive në kuadër të shkollave :

- 1 fushë sportive në fshatin Marec;
- 1 fushë sportive në fshatin Ballaban;
- 1 fushë sportive në fshatin Hajkobillë;
- 1 fushë sportive në fshatin Slivovë / lagjen Thanisht.



Harta 23 Infrastruktura sportive

2.7.6.2. Vlerësimi i kapacitetit financiar dhe teknik

Bazuar në trendin e fondeve të alokuara nga buxheti qendror apo komunal për tre vitet paraprake dhe tre vitet vijuese, në rast kur nuk ka ndryshime të theksuara në vija buxhetore, rezultojnë kapaciteti i përgjithshëm financiar i përbashkët i Drejtorisë së Kulturës për realizimin e projekteve kapitale për vitin 2021– 2029 është € 17,445,93549, € 1,891,500 nga granti qeveritar dhe € 15,554,435 nga të hyrat vetanake.

Tabela 73 Vlerësimi i kapaciteteve financiare (€) për investime kapitale të Drejtorisë së Kulturës

	2018 - 2020		2021 – 2023		2024 - 2026		2027 - 2029	
	Subvencionet dhe transferet kapitale	Investime kapitale	Subvencionet dhe transferet kapitale	Investime kapitale	Subvencionet dhe transferet kapitale	Investime kapitale	Subvencionet dhe transferet kapitale	Investime kapitale
Gjithsej	560,000	1,683,000	1,330,000	4,204,000	1,396,500	4,414,200	1,466,325	4,634,910
Grantet qeveritare			600,000		630,000		661,500	
Të hyrat vetanake	560,000	1,683,000	730,000	4,204,000	766,500	4,414,200	804,825	4,634,910
Financim jashtëm								
Financimi nga huamarrja								

2.7.7. Hapësirat e hapura publike dhe hapësirat e gjelbërta²⁰

Hapësirat publike në Komunën e Prishtinës janë të shtrira në disa kategori: sheshe, parqe, hapësira të gjelbra rekreative dhe hapësira të gjelbra përgjatë rrugëve dhe në oaza të gjelbra. Sipas


²⁰ Të dhëna të gjeneruara nga GIS, Drejtoria e parqeve, Komuna e Prishtinës

NTPH, hapësirat e gjelbra përfshijnë parqet publike ose hapësirat e lira për shfrytëzim nga këmbësorët ose çiklistët dhe fushat e hapura sportive dhe rekreative.

Tabela 74 Inventari i hapësirave publike dhe të gjelbra në zonën urbane

<i>Lloji i hapësirës publike</i>	<i>Kategoria</i>	<i>Sipërfaqja (m²)</i>
Sheshi Nënë Tereza	Shesh	14,980.56
Sheshi Skënderbeu	Shesh	6,607.37
Sheshi Ibrahim Rugova	Shesh	5,977.52
Sheshi Zahir Pajaziti	Shesh	6,229.15
Sheshi Dëshmorëve	Shesh	5,222.50
Parku i Gërmisë	Park	19,490,000.00
Parku i Qytetit	Park	73,332.95
Parku Toukbahçe	Park	130,145.02
Parku Fidanishte	Park	34,148.54
Parku i Arinjve	Park	168,200.13
Parku Heroinat	Park memorial	3,525.47
Parku rekreativ-sportiv 1 Tetori	Hapësirë e gjelbër rekreative	5,362.10
Parku i Spitalit	Hapësirë e gjelbër rekreative	2,804.30
Parku Dardania	Hapësirë e gjelbër rekreative	8,223.76
Parku Ulpianë	Hapësirë e gjelbër rekreative	26,927.11
Parku te Rilindja	Hapësirë e gjelbër rekreative	7,128.73
Parku i Arbërisë	Hapësirë e gjelbër rekreative	25,000.00
Parku i Ri i Arbërisë	Hapësirë e gjelbër rekreative	14,000.00
Fontana e qytetit	Hapësirë e gjelbër rekreative	5,589.43
Parku përgjatë Lumit Vellusha, në parkun Toukbahçe	Hapësirë e gjelbër	39,876.61
Hapësirë e gjelbër në Dardani	Hapësirë e gjelbër	5,365.17
Hapësirë e gjelbër në Velani	Hapësirë e gjelbër	27,585.73
Hapësirë e gjelbër në Bregun e Diellit	Hapësirë e gjelbër	73,268.24
Hapësirë e gjelbër në Ulpianë	Hapësirë e gjelbër	42,028.60
Hapësirë e gjelbër në Kalabri	Hapësirë e gjelbër	199,991.17
Hapësirë e gjelbër në Lakrishtë	Hapësirë e gjelbër	18,276.03

Përveç hapësirave publike dhe të gjelbërta në zonën urbane, sipërfaqe të tilla shtrihen edhe në zonën rurale, ndonëse në forma të shkëputura dhe të shpërndara në mënyrë jo konsistente në aspektin hapësinor.



Harta 24 Hapësirat publike dhe të gjelbra

2.7.7.1. Vlerësimi i nevojave për të ardhmen

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej:

- 1.00 m²/banor parqe publike në kuadër të lagjes;
- 2.00 m²/banor parqe publike në kuadër të vendbanimit;
- 1.00 m²/banor breza të gjelbër përgjatë rrugëve.

Duke marrë parasysh supozimin që në vitin 2031 në Komunë të Prishtinës, numri i banorëve rezidentë do të jetë **290,508 banorë**, sipërfaqen aktuale të parcelave kadastrale prej **1,081,935 m²** dhe normën minimale prej **4.00 m²/banor** për sipërfaqe për hapësira të hapura publike, komuna duhet të alokojë së paku edhe **80,097 m²** sipërfaqe të destinuara për hapësira të hapura publike, kryesisht në zonën rurale.

Tabela 75 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së hapësirave të hapura publike për numrin e prognozuar të banorëve 2031

	Nr. i prognozuar i banorëve 2031	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Zonë urbane	208,398	910,779.09	4	833,592	+77,187
Zone rurale	82,110	171,156.0	4	328,440	-157,284
Gjithsej	290,508	1,081,935	4	1,162,032	-80,097

2.7.7.2. Vlerësimi i kapacitetit financiar dhe teknik

Bazuar në trendin e fondeve të alokuara nga buxheti qendror apo komunal për tre vitet paraqike dhe tre vitet vijuese, në rast kur nuk ka ndryshime të theksuara në vija buxhetore, rezultojnë kapaciteti i përgjithshëm financiar i përbashkët i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim për realizimin e projekteve kapitale për vitin 2021–2029 është € 55,899,82950, € 8,107,929 nga granti qeveritar, € 21,450,055 nga të hyrat vetanake dhe € 26,341,845 përmes financimit të jashtëm.

Tabela 76 Vlerësimi i kapaciteteve financiare (€) për investime kapitale të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

	2018 - 2020		2021 - 2023		2024 - 2026		2027 - 2029	
	Subvencio net dhe transferet	Investime kapitale	Subvencio net dhe transferet	Investime kapitale	Subvencio net dhe transferet	Investime kapitale	Subvencio net dhe transferet	Investime kapitale
Gjithsej	320,000	17,121,207		15,160,000		19,778,919		20,960,910
Grantet qeveritare		3,509,926	-	-	-	3,860,919	-	4,247,010
Të hyrat vetanake	320,000	13,323,781	-	6,804,141	-	7,144,348	-	7,501,565
Financimi jashtëm	-	-	-	8,355,859	-	8,773,652	-	9,212,335
Financimi nga huamarrja	-	287,500	-	-	-	-	-	-

2.7.8. Objektet e religjionit dhe varrezat

Në Komunën e Prishtinës sipas regjistrimit të fundit të popullsisë mbi 95% e popullsisë i përkasin religjionit islam. Prishtina ka 45 xhami, 3 kisha ortodokse, 1 kishë katolike, 2 kisha protestante dhe 1 katedrale.

Tabela 77 Inventari i objekteve fetare


Vendbanimi	Kategoria	Sipërfaqja e parcelës (ha)
Pejton	Katedralja Prishtinë	0.77
Arbëri	Kishë Ortodokse	0.25
Bërnice e Poshtme	Kishë Ortodokse	0.24
Taslixhe	Kishë Ortodokse	0.75
Ulpianë	Kishë Katolike	0.39
Bardhosh	Xhami	0.06
Barilevë	Xhami	0.06
Dabishecë	Xhami	0.04
Dardani	Xhami	0.20
Dodona	Xhami	0.05
Grashticë	Xhami	0.12
Hajkobillë	Xhami	0.20
Hajvali	Xhami	0.04
Kalabri	Xhami	0.06
Keqekollë	Xhami	0.06
Kodra e Trimave 1	Xhami	0.05
Kodra e Trimave 1	Xhami	0.96
Kodra e Trimave 2	Xhami	0.07
Koliq	Xhami	0.07
Kolovicë	Xhami	0.21
Makoc	Xhami	0.22
Makoc	Xhami	0.08
Mati 3	Xhami	0.49

Mramor	Xhami	0.06
Muhaxherë	Xhami	0.05
Muhaxherë	Xhami	0.03
Prishtina e Re	Xhami	0.05
Prishtinë	Xhami	0.04
Prishtinë	Xhami	0.07
Prishtinë	Xhami	0.04
Prishtinë	Xhami	0.03
Prishtinë	Xhami	0.04
Prugovc	Xhami	0.07
Siçevë	Xhami	0.23
Sofali	Xhami	0.14
Tophane	Xhami	0.04
Tophane	Xhami	0.03
Vellushë	Xhami	0.04
Vellushë	Xhami	0.05
Vreshta	Xhami	0.08
Prishtinë	Xhamia e Çarshisë	0.08
Prishtinë	Xhamia e Mbretit	0.09
Tophane	Xhamia e Sudi Efendisë	0.03
Dardani (në ndërtim)	Xhamia e Madhe	0.81

Tabela 78 Inventari i varrezave publike
Vendbanimi

Vendbanimi	Kategoria	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lirë (ha)
Ballaban	Myslimane	0.59	0.09	0.5
Bardhosh	Ortodokse	0.48	0.2	0.28
Bardhosh	Myslimane	0.36	0.08	0.28
Barilevë	Myslimane	0.91	0.41	0.5
Bernice e poshtme	Myslimane	0.44	0.4	0.04
Besi	Myslimane	0.29	0.18	0.11
Busi	Katolike	0.29	0.01	0.28
Busi	Myslimane	1	0.6	0.4
Bërnice e Epërme	Myslimane	1.09	0.39	0.7
Çagllavicë	Ortodokse	0.39	0.34	0.05
Dabishec	Myslimane	0.04	0.02	0.02
Dragoc	Myslimane	0.35	0.2	0.15
Drenoc	Myslimane	0.82	0.3	0.52
Grashticë	Myslimane	1.5	0.3	1.2
Hajkobillë	Katolike	0.31	0.08	0.23
Hajkobillë	Myslimane	0.25	0.05	0.2
Hajvali	Myslimane	1.04	0.7	0.34
Keqekollë	Ortodokse	0.15	0.05	0.1
Keqekollë	Myslimane	1.11	0.45	0.66
Koliq	Katolike	0.28	0.12	0.16
Koliq	Myslimane	2.84	0.23	2.61
Kolovice	Myslimane	0.64	0.12	0.52

Kukaj	Myslimane	0.16	0.06	0.1
Llukar	Ortodokse	0.57	0.4	0.17
Llukar	Myslimane	1.029	0.12	0.909
Makoc	Myslimane	0.68	0.54	0.14
Marec	Varrezat e dëshmorëve	1.82	0.05	1.77
Marec	Myslimane	2.06	0.33	1.73
Matiqan	Myslimane	2.25	1.68	0.57
Mramor	Myslimane	1.9	0.43	1.47
Mramor	Katolike	0.35	0.1	0.25
Mramor	Varrezat e dëshmorëve	0.13	0.1	0.03
Mramor	Ortodokse	0.09	0.07	0.02
Nishec	Myslimane	0.14	0.04	0.1
Orlloviq	Myslimane	1.12	0.55	0.57
Prapashticë	Myslimane	1.95	0.44	1.51
Prishtine	Myslimane	30.54	16.12	14.42
Prishtinë	Katolike	5.01	3.42	1.59
Prishtinë	Hebraike	0.7	0.21	0.49
Prugoc	Myslimane	0.98	0.48	0.5
Rimanishtë	Myslimane	0.92	0.1	0.37
Rimanishtë	Katolike	0.22	0.07	0.15
Sharban	Myslimane	0.85	0.2	0.65
Slivovë	Myslimane	0.76	0.4	0.36
Sofali	Ortodokse	0.12	0.02	0.1
Teneshdoll	Ortodokse	0.2	0.07	0.13
Teneshdoll	Myslimane	0.15	0.07	0.08
Vranidoll	Katolike	0.13	0.02	0.11
Vranidoll	Myslimane	0.44	0.13	0.31



Harta 25 Institucionet e religjionit dhe varrezat

2.7.8.1. Vlerësimi i nevojave për të ardhmen

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 1.50 m²/banor për sipërfaqe të parcelave të destinuara për varreza.

Duke marrë parasysh supozimin që në vitin 2031 në Komunë të Prishtinës, numri i banorëve rezidentë do të jetë **290,508 banorë**, sipërfaqen aktuale të parcelave kadastrale prej **692,639.9 m²** dhe normën minimale prej 1.50 m²/banor për sipërfaqe për varreza, komuna ka tejkuluar për **256,877.9 m²** normën minimale të hapësirave të nevojshme të destinuara për varreza në zonën urbane dhe atë rurale.

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë caktuar minimumin e 1.50 m²/banorë për sipërfaqe të parcelave të destinuara për varreza. Me konsideratën se në vitin 2031 pritet të ketë **290,508 banorë** rezidentë në Komunën e Prishtinës, dhe sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale është **692,639.9 m²**, komuna aktualisht tejkalon me **256,877.9 m²** normën minimale të hapësirave të nevojshme të destinuara për varreza, si në zonën urbane apo rurale. Duke marrë parasysh nevojën për një varrezë katolike në zonën urbane, është e rëndësishme të konsiderojmë këtë aspekt gjatë planifikimit.

Tabela 79 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së varrezave për numrin e prognozuar të banorëve 2031

	Nr. prognozuar banorëve 2031	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme për përkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Zonë urbane	208,398	392,080.5	1.5	312,597	79,483.5
Zonë rurale	82,110	316,363.3	1.5	123,165	193,198.3
Gjithsej	290,508	708,443.8	1.5	435,762	+272,681.8

2.7.8.2. Vlerësimi i kapacitetit financiar dhe teknik

Bazuar në trendin e fondeve të alokuara nga buxheti qendror apo komunal për tre vitet paraqite dhe tre vitet vijuese, në rast kur nuk ka ndryshime të theksuara në vija buxhetore, rezulton që kapaciteti i përgjithshëm financiar i përbashkët i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, për realizimin e projekteve kapitale për vitin 2021–2029 është € 55,899,82951, € 8,107,929 nga granti qeveritar, € 21,450,055 nga të hyrat vetanake dhe € 26,341,845 përmes financimit të jashtëm.

Tabela 80 Vlerësimi i kapaciteteve financiare (€) për investime kapitale të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

	2021 - 2023		2024 - 2026		2027 - 2029	
	Subvencio net dhe e transferet	Investim kapitale	Subvencio net dhe e transferet	Investim kapitale	Subvencio net dhe e transferet	Investim kapitale
Gjithsej	320,000	17,121,207	15,160,000	19,778,919	20,960,910	20,960,910
Grantet qeveritare		3,509,926	-	3,860,919	-	4,247,010
Të hyrat vetanake	320,000	13,323,781	6,804,141	7,144,348	7,501,565	7,501,565
Financimi jashtëm	-	-	8,355,859	8,773,652	9,212,335	9,212,335
Financimi	-	287,500	-	-	-	-

Tabela 81 SWOT analiza - Infrastruktura Publike dhe sociale

Përparësitë	Dobësitë
- Numri i mjaftueshëm i institucioneve shëndetësore të nivelit parësor në zonën urbane dhe rurale; - Numri i mjaftueshëm i institucioneve shëndetësore të nivelit dytësor; - Qendër kryesore e administratës publike në nivelin qendror; - Llojllojshmëria e institucioneve kulturore; - Llojllojshmëria e infrastrukturës sportive dhe rekreative; - Numri i mjaftueshëm i hapësirave të hapura dhe të gjelbërta në zonën urbane; - Numri i mjaftueshëm i hapësirave të dedikuara për varreza publike.	- Hapësira e pamjaftueshme në disa pre, shkollave të mesme të larta; - Numri i vogël i studentëve të orientuar në drejtimet me rëndësi për zhvillimin e komunës si turizëm, hotelieri, agrobiznes; - Mungesa e Spitalit Rajonal; - Mungesa e ofrimit të shërbimeve shëndetësore në disa fshatra; - Mungesa e shtëpisë për të moshuar që plotëson nevojat aktuale; - Hapësira e pamjaftueshme e QPS për shërbimet e kërkuara; - Numri i madh i kërkesave në raport me numrin e përfituesve të asistencës; - Mungesa e kodit të veçantë buxhetor për rastet sociale; - Mungesa e objekteve kulturore sidomos nëpër fshatra; - Mungesa e objekteve dhe terreneve sportive nëpër fshatra; - Mungesa e hapësirave të mjaftueshme për varreza në qytet dhe në disa fshatra; - Mungesa e hapësirave për Zyrrat e Gjendjes Civile.
Mundësitë	Kërcënimet
- Ndërtimi i Spitali të Përgjithshëm; - Programet e ndryshme që financojnë në formë granti apo donacioni përmirësimin e hapësirave shkollore në zonën urbane dhe rurale; - Granti specifik nga MASHT për sigurimin e asistentëve profesionalë për fëmijët me nevoja të veçanta; - Zhvillimi profesional i mëtijmë i mësimeve; - Përkrahja me programe të ndryshme të donatorëve që e ndihmojnë avancimin e sektorit të shëndetësisë qoftë me grante, pajisje teknologjike apo asistencë teknike; - Ndërtimi i kapaciteteve të reja për banim social (Programi i banimit social); - Shfrytëzimi i fushave sportive në kuadër të shkollave për përdorim nga komuniteti; - Implementimi i komponentës SMART.	- Zvogëlimi i nxënësve në zonat rurale dhe rritja e numrit të nxënësve në zonën urbane; - Rritja e trendit të braktisjes së shkollimit; - Ndërlidhja e pamjaftueshme e kurrikulave mësimore me kërkesat e tregut të punës; - Buxheti i kufizuar për zhvillimin e infrastrukturës publike dhe sociale; - Kërcënimet ekonomike (kriza globale financiare) kostot në rritje të kujdesit shëndetësor; - Rritja e numrit të shfrytëzuesve të asistencës sociale për shkak të zhvillimit të ulët ekonomik dhe rritjes së papunësisë; - Rritja e shkallës së varfërisë; - Rritja e numrit të moshuarve në kategorinë e rasteve sociale; - Mungesa e fondeve të nivelit qendror për të paguar punëtorë shtesë në institucione publike dhe sociale; - Mungesa e partneriteteve publiko private si alternative të qëndrueshme për aktivitete dhe infrastrukturë sportive, kulturore, por edhe shkencë në komunë; - Rritja e delikuencës dhe ekstremizmit tek të rinjtë si pasojë e mungesës së hapësirave të pamjaftueshme kulturore dhe rekreative; - Ndërrimi i strukturës së popullsisë, për shkak të ikjes së popullatës së re jashtë vendit;

- Ikja e popullsisë së aftë për punë dhe ekspertëve jashtë vendit.

Sfidat kryesore

Gjatë vlerësimit të gjendjes ekzistuese të infrastrukturës sociale janë identifikuar sfidat vijuese:

- mungesa e tokës në pronësi komunale në zonën urbane;
- mungesa e buxhetit komunal për shpronësimin e tokave me çmim të lartë në zonë urbane;
- mirëmbajtja e standardit të shërbimeve në objektet shëndetësore;
- ndërlidhje jo e volitshme e Arsimit për Aftësimin Profesional me kërkesat e tregut të punës;
- mungesa e kushteve për kryerjen e punës praktike nëpër shkolla (punëtoritë, laboratorët, rrjeti i teknologjisë informative);
- buxheti i kufizuar për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës shkollore;
- sigurimi i hapësirave-kushteve për punë për funksionimin e bashkësive lokale;
- grumbullimi i objekteve administrative në një vend;
- akomodimi i kërkesave për banim për persona të riatdhesuar;
- buxheti i pamjaftueshëm për të përmbushur kërkesat për asistencë sociale;
- ofrimi i politikave lokale për programe të banimit social të integruar;
- zbutja e varfërisë dhe papunësisë;
- ndërtimi i objekteve të reja të kulturës, artit, sportit e rekreacionit dhe përmirësimi i qasjes në këto objekte për të gjithë banorët e komunës së Prishtinës;
- mirëmbajtja adekuat e objekteve të artit, sportit, kulturës, rekreacionit, komunitetit në nënqendra;
- sigurimi i hapësirave të reja publike për nënqendrat dhe për zonën urbane, si dhe standardizimi i mirëmbajtjes;
- mirëmbajtja e objekteve fetare dhe objekteve përcjellëse;
- sigurimi i hapësirave të reja për varrezat dhe mirëmbajtjen adekuat të tyre.

Përkundër arritjeve të qëllimeve të shumta dhe punës së vazhdueshme të Drejtorisë së Kulturës, Prishtina si komunë është ende në mungesë të Strategjisë për Kulturë, ku do të qartësoheshin objektivat dhe qëllimet për një periudhë afatgjatë.

Komuna e Prishtinës ballafaqohet me mungesë dhe mos funksionim të infrastrukturës ligjore si në aspektin e menaxhimit të institucioneve, ashtu edhe të buxhetit që do të siguronte programe të pasura vjetore dhe resurse më të mëdha humane për menaxhim adekuat e të përditësuar, duke lënë anash modelin e vjetër - klasik të menaxhimit. Kosova ende nuk ka ligj për institucione të pavarura të cilat do të menaxhoheshin nga borde të OJQ-ve, me vetëm buxhetin bazik të siguruar nga shteti, që do të siguronte qëndrueshmëri të institucioneve kulturore. Në këtë mënyrë do të krijoheshin institucione aktive, moderne, të qasshme, e atraktive për publikun e të gjitha moshave.

2.8. Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri

2.8.1. Mjedisi

Në territorin e Komunës së Prishtinës dominon një peizazh malor që përfshinë lindjen, verilindjen dhe juglindjen, ndërsa territori perëndimor i komunës shtrihet në rrafshin e Kosovës. Ujërat që e karakterizojnë këtë rajon janë: Liqeni i Badovcit, Lumi Llap, Prishtevka dhe Vellusha, por edhe Liqeni i Badovcit, pyjet, mineralet dhe tokat bujqësore duhet të konsiderohen si burime natyrore me potencial për zhvillim.

Në përgjithësi, gjendja e natyrës dhe e mjedisit në zonën rurale të Kosovës, por edhe e Prishtinës, vlerësohet më e mirë sesa ajo urbane. Edhe në këtë zonë sistemi i menaxhimit të mjedisit si uji, ajri, toka, mbeturinat dhe përgjithësisht kujdesi për natyrën, ka nevojë të përmirësohet duke përcjellë trendet për nevojat evropiane

Gjendja e përgjithshme mjedisore e qytetit të Prishtinës nuk mund të cilësohet ndryshe, veçse një gjendje jo e kënaqshme si në gjithë Republikën e Kosovës, qoftë në pjesët urbane, rurale apo përreth zonave industriale. Qasja akoma e ulët në kanalizime, furnizimi me ujë të pijshëm sanitar, ujërat urbane, industriale pa trajtim adekuat, menaxhim i kufizuar i mbeturinave, ndotja enorme e ajrit, zhurma e lartë, emetimet e antenave të telefonisë mobile, kujdesi jo i duhur ndaj gjelbërimit në qendër të qytetit dhe mungesa e vendeve për pushim e rekreacion, janë indikatorët kyç që alarmojnë për veprime të ngutshme në financim dhe përmirësim të mjedisit në Qytetin e Prishtinës. Qytetin e Prishtinës e karakterizon një trafik shumë i dendur, me numër të madh makinash, vende të pakta për parkim dhe cilësi jo e duhur e karburanteve, që drejtpërdrejtë ndikojnë në ndotjen e ajrit dhe rrezikimin e shëndetit të popullatës. Sektori energjetik është një ndër ndotësit më të mëdhenj të mjedisit në Kosovë, posaçërisht në rajonin e Prishtinës.

2.8.2. Ndotja e ajrit

Ndotja e ajrit paraqet një problem kritik mjedisor nëpër viset urbane, por në nivel të shtetit ndotja është e nivelit më të ulët. Cilësia e ajrit është veçanërisht e ulët në zonën e Prishtinës, Obiliqit, Drenasit dhe të Mitrovicës. Gazrat kryesorë të kontaminimit janë dioksidi i sulfurit (SO₂), oksidet e azotit NO dhe NO₂ (NO_x), ozoni (O₃), plumbi (Pb), dioksidi i karbonit (CO₂), grimcat (PM Apo pluhuri) dhe dioksina.

Në territorin e Komunës së Prishtinës ndotja e ambientit është mjaft e madhe. Në disa nga ndërmarrjet publike private përdoren materie të rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe e ndotin ambientin, siç janë: gaz butani, thartira, materiali bazë për prodhimin e hidrogjenit etj. Ndotës potencial të ajrit, ujit, por edhe tokës janë: KEK-u, Depoja e hedhurinave, automjetet e vjetra, trajtimi joadekuat i ujërave të zeza, depot e derivateve etj. Sipas shënimeve të siguruara nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, ndotja e ambientit në territorin e komunës është 22% për ajrin, 19% për ujin dhe 20% për tokën.

Monitorimi i cilësisë së ajrit, i cili është në shkallë të kufizuar në Kosovë, kryhet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) që bën menaxhimin me dy stacione. Njëri gjendet afër ndërtesës Rilindja në qendër të Prishtinës, afër rrugës me qarkullim të dendur dhe është i konfiguruar për të matur vetëm fraksionet PM₁₀ dhe PM_{2.5}, ndërsa tjetri është stacion në periferi në objektin e IHMK-së, i pajisur me analizues automatik për dioksid të sulfurit, okside të azotit, monoksid të karbonit, ozon dhe grimca të imta (PM₁₀ ose PM_{2.5}), po ashtu Komuna e Prishtinës ka 6 nënstacione që bëjnë monitorimin e ajrit.

Të dhënat për cilësinë e ajrit nga IHMK, tregojnë se PM tejkalon dukshëm kufirin nga KE-ja për koncentrimin mesatar vjetor prej 40 mikrogramëve për metër kub (µg/m³) për PM₁₀, si në qendër të qytetit (ish-ndërtesa e Rilindjes) ashtu edhe në periferi (në stacionin e IHMK), ku shpeshherë tejkalon vlerën kufitare të ditës (që nuk duhet të tejkalohet më shumë se 35 herë në vit) prej 50 µg/m.

Tabela 82 Ndotja e ajrit në komunën e Prishtinës, 2018

Periodha kohore e matjes	Stacione t e matjes	PM ₁₀ (µg/m ³)	PM _{2.5} (µg/m ³)	O ₃ (µg/m ³)	NO ₂ (µg/m ³)	SO ₂ (µg/m ³)	CO (mg/m ³)
Janar	Prishtinë -IHMK	74.50	64.7	25.9	*	7.5	4.2
	Prishtinë -Rilindja	77.50	66.2	22.1	48.6	8.2	3.2
Prill	Prishtinë -IHMK	12.00	8.2	52.4	31.1	4.4	0.2
	Prishtinë -Rilindja	15.20	13.8	50.2	38.3	6.3	0.8
Shtator	Prishtinë	*	*	40	13.5	14.5	*

	-IHKM						
	Prishtinë	*	*	18.6	19.5	28.8	2.9
	-Rilindja						
Nëntor	Prishtinë	59.7	44.1	22.4	45.6	3.9	0.8
	-IHKM						
	Prishtinë	56.7	40	27.8	42.3	1.8	0.68
	-Rilindja						
Mesatarja e ndotjes		49.27	39.50	32.43	34.13	9.43	1.83

2.8.3. Ndotja e ujit

Lumi i Prishtinës - Monitorimi i këtij lumi bëhet në Bresje të Fushë Kosovës para derdhjes së tij në lumin Sitnica. Ky nuk mund të quhet lum, sepse nuk plotëson asnjë kriter të tij, është kolektor i të gjitha ujërave të shkarkuara urbane etj., të kryeqytetit të Kosovës, gjithashtu ka tejkallim të sasisë së nitrates, materie të suspenduara, shpenzim kimik dhe biokimik të oksigjenit, mungesë të oksigjenit të tretur, detergjente etj.

Sasia e oksigjenit të tretur (O₂ tretur) vërehet se varijon nga stacioni në stacion, por mund të themi se në të gjitha rrjedhat e këtij pellgu ka sasi të mjaftueshme përpos në Lumin e Prishtinës në Bresje që sasia e O₂ është e ulët. Krahasuar me komunat tjera dhe bazuar në madhësinë e saj, në Komunën e Prishtinës evakuimi i ujërave të zeza në vendbanimet jashtë qytetit është pak i organizuar. Janë vetëm 8 vendbanime me kanalizim publik apo kanalizim vetjak, ku tre prej tyre janë të pjesshme. Gjithashtu në komunën e Prishtinës kalojnë edhe lumenjtë si Llapi dhe Graçanka si dhe disa përroska të vogla në zonat rurale të cilat janë të ndotura nga kanalizimet.

Tabela 83 Ndotësit kolektiv dhe të veçantë në regjionin e Prishtinës²¹

Regjion	Komuna	Ndotësit kolektiv	Ndotësit e veçantë
Prishtina	Prishtinë	12	7
	Fushë Kosovë	12	2
	Drenas	14	1
	Podujevë	9	9
	Shtime	3	0
	Lypjan	10	4
	Kastriot	7	1
	Graçanicë	8	1
Gjithsej		75	25

Tabela 84 Pikat shkarkuese të ndotësve në komunën e Prishtinës

Komuna	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Vendshkarkimet
Prishtinë	Qyteti	430 245	Lumi i Prishtinës
	Bardhosh	2 150	Lumi Llap
	Barilevë	4 200	Lumi Llap
	Besi	907	Lumi Llap
	Hajvali	6 000	Lumi Graçanka
	Prroni i Njelmët	1 000	Ujëra nëntokësore
	Prugovc-Leban	800	Lumi Llap
	Shkabaj	1500	Lumi Sitnicë

²¹ Kadastr i ndotësve të ujërave

Ndër problemet dhe sfidat më të theksuara në Komunën e Prishtinës janë:

Problemi i shkarkimit të ujërave të ndotura në lumenj apo hapësira sipërfaqësore: Prishtina si shumë komuna tjera në Kosovë ka problem dhe sfidë të lartë në menaxhimin e derdhjeve të ujërave të zeza, derdhjet kryesisht kryhen në kuadër të lumenjve. Krahësuar me komunat tjera dhe bazuar në madhësinë e saj, në Komunën e Prishtinës evakuimi i ujërave të zeza në vendbanimet jashtë qytetit është pak i organizuar.

Ruajtja e cilësisë, resursit dhe e burimeve të ujit, mungesa e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza: Lumi më i ngarkuar në Komunën e Prishtinës është padysim Prishtevka, i cili mund të thuhet se është shndërruar në rrjedhë lumore, pikërisht nga ujërat e zeza të mbi 430,000 banorëve të kryeqytetit. Lumi i dytë mjaft i ngarkuar është Llap, me rreth 9450 banorë, më pas Graçanka me 6000 banorë dhe Sitnica me 1500 banorë. Në ujëra nëntokësore shkarkojnë ujërat e zeza rreth 1000 banorë.

Monitorimi i ndotjes së ujit, monitorimi i cilësisë së ujit është i mangët, punë të cilën e bën Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Prishtina, si kryeqytet i Kosovës, duhet të ketë më shumë pika për matjen e shkallës së ndotjes së ujit, duke marrë parasysh që në përgjithësi nuk ka resurse të mjaftueshme ujore.

Monitorimi i lumit Prishtina bëhet në Bresje të Fushë-Kosovës para derdhjes së tij në Lumit Sitnica. Bazuar në karakterin e tij si rrjedhë ujore, lumi Prishtina mund të konsiderohet si kolektor i të gjitha ujërave të shkarkuara urbane të kryeqytetit të Kosovës. Gjithashtu ka tejkalim të sasisë së nitrateve, materie të suspenduara, shpenzim kimik dhe biokimik të oksigjenit, mungesë të oksigjenit të tretur, detergjente etj.

Nga analiza e gjendjes në komunë e bërë nga grupet punuese sa i përket cilësisë, resursit dhe burimeve ujore, është konstatuar se shqetësimi kryesor ka të bëjë me mbrojtjen e cilësisë, resursit dhe burimeve të ujit. Parashikohet edhe zhvillimi dhe menaxhimi i burimeve të ujit për plotësimin e nevojave për të sotmen dhe të ardhmen.

2.8.4. Ndotja e tokës

Ndikimi i vazhdueshëm nga aktivitetet njerëzore sjell deri të degradimi i sipërfaqeve tokësore, duke shkaktuar edhe pasojat të dëmshme mjedisore dhe socio-ekonomike. Sfidat janë që të parandalohet degradimi i tokave dhe ndotja e tyre përmes masave dhe politikave specifike për mbrojtjen e tokave.

Tokat në Kosovë ndryshojnë në përbërjen e tyre, kjo është e rëndësishme për shëndetin e njeriut sepse materiali bazë (përbërja e shkëmbit nga i cili formohet dheu), topografia, klima, përbërja organike dhe koha, do të rezultojë me toka me përbërës të ndryshëm fizik dhe kimik. Përbërja e dheut do të ndikojë në atë sesa ujë mund të mbajë, organizmat e gjallë që i mbështetë dhe cilat reagime kimike (gjithashtu e ciklet ushqyese) ka gjasa të shfaqen.

Duke e konsideruar tokën si një burim thelbësor dhe kryesisht jo të rinovueshme, bazuar në analizën e grupeve punuese, gjerësinë e dijes, të kuptuarit e sistemeve të tokës dhe rolin kyç që luan toka brenda sistemit të gjerë të mjedisit, vazhdimi i humbjes së tokës do të kishte efekte shkatërruese në jetën tonë.

Bujqësia, pylltaria dhe një varg aktivitetesh që janë të varura nga toka do të kërcënoheshin, deri tek furnizimi me ujë e lëndë ushqyese për rritjen e bimëve dhe përkrahjen fizike të bimëve dhe gjallesave tjera. Një varg funksionesh e lidhesh me ruajtjen e ekosistemeve. Për shkak të kësaj game të gjerë të funksioneve që kryhen nga toka dhe marrëdhëniet e saj me mjedisin tjetër, komponenti i tokës nuk është konsideruar si e izoluar, andaj në fazën e analizës, i është kushtuar rëndësi e veçantë dhe për këtë arsye parashihet: mbrojtje fizike dhe cilësore e tokës. Përpos mbrojtjes së ajrit dhe ujit, planifikohet edhe futja e politikave për mbrojtjen e tokës, për të siguruar lidhjen e humbur në mbrojtjen e mjedisit edhe në komunën e Prishtinës.

Faktorët kryesorë që shkaktojnë humbje të tokës në Kosovë dhe në Komunën e Prishtinës janë:

- Zgjerimet e përhershme të vendbanimeve-ndërtimeve;
- Zhvillimet e industrisë dhe mbeturinat e krijuara nga këto lloj zhvillimesh, gërmimesh etj.;
- Ndërtimet e rrugëve dhe autoudhave;
- Mbeturinat e ekonomive familjare dhe gropat e mbushura me mbeturina;
- Erozioni;
- Gërmimet e pakontrolluara.

Humbja e tokës bujqësore nga ndërtimet- Pas Luftës së Fundit në Kosovë, sidomos Prishtina si kryeqendër është zhvilluar shumë sa i përket banimit, në kuptimin hapësinor shumë sipërfaqe të tokave janë zënë me ndërtime, duke uzurpuar tokën bujqësore.

Degradimi i tokave bujqësore dhe ndotja e tyre. Ndikimi i vazhdueshëm nga aktivitetet njerëzore ka sjell deri tek degradimi i sipërfaqeve tokësore në Komunën e Prishtinës, duke shkaktuar edhe pasoja të dëmshme mjedisore dhe socio-ekonomike. Sfida është që të parandalohet degradimi i tokave dhe ndotja e tyre përmes masave dhe politikave specifike për mbrojtjen e tokave.

2.8.5. Ndotja nga zhurma

Ndotja akustike është veçanërisht e rëndë në vendet në zhvillim, kjo i përket edhe Prishtinës. Ndotja i detyrohet kryesisht trafikut rrugor, ku në zona të dendura të trafikut rrugor, nivele të presionit akustik gjatë ditës mund të arrijnë 70 dB (A).

Tabela 85 Matjet dhe tejkalimet e zhurmës

Nr.	Qytetet e Kosovës	Zhurma e matur në dB min-max	Mesatarja në dB	Zhurma e lejuar në dB	Tejkalimi në %
1	Prishtinë	69.6-77.00	73.3	55	133.27
2	Gjilan	64.2-73.00	68.6	55	124.72
3	Pejë	64.6-74.00	69.3	55	126.00
4	Prizren	66.00-73.2	69.6	55	126.54
5	Mitrovicë	63.8-77.8	70.8	55	128.72

Në mënyrë që vendbanimet të mbrohen nga tejkalimi i nivelit të zhurmës së lejuar, është e nevojshme të ndërtohen pengesa dhe të zhvillohen breza të gjelbër në mes të korridoreve të automjeteve motorike dhe vendbanimeve. Shfrytëzuesi i pajisjeve, të cilat prodhojnë zhurmë dhe vibracion, mund të vë në qarkullim ose të përdorë pajisjet sipas kushteve të parapara për aplikimin e masave mbrojtëse, për zvogëlimin e zhurmës dhe vibracionit, respektivisht të bëjë përdorimin e impianteve, pajisjeve, makinave, mjeteve transportuese dhe aparateve, të cilat lirojnë zhurmë deri në nivelin e paraparë me ligj të veçantë.

Si problem i madh llogaritet niveli i lartë i zhurmës, i cili është i pranishëm, si ditën, ashtu edhe natën. Kjo zhurmë krijohet nga fabrikat, edhe pse nuk janë shumë në numër, nga aktivitetet private, qofshin këto lokale apo kafiteri. Burimet kryesore të zhurmës së mjedisit përfshijnë: trafikun, industrinë, ndërtimin etj. Matje të nivelit të zhurmës ka edhe Komuna e Prishtinës në pjesë të ndryshme të qytetit, por akoma nuk ka matje të përditshme, siç e definon Ligji për Mbrojtjen nga zhurma. Për arritjen e qëllimeve të cekura, duhet të hartohen dy dokumente themelore, të cilat trajtojnë të gjitha aspektet e efekteve të zhurmës: Harta Strategjike e zhurmës dhe Plani i Veprimit për mbrojtje nga zhurma.

Tabela 86 SWOT analiza - Mjedisi

Përparësitë	Dobësitë
• Ka Ligjin për Prishtinën Nr. 06/L-012; • Prania e zonave natyrore të mbrojtura, prania e qytetit me peizazhin e mbrojtur	• Ndotja e ajrit në formë pluhuri me PM₁₀ dhe PM_{2.5}; • Ndotja e ajrit nga Ngrohtëtorja në Prishtinë; • Ndotja e ajrit nga Termocentrali në Obiliq; • Përdorimi i lëndëve joadekuata për ngrohje;

• Qyteti i Prishtinës me pozitë qendrore në Kosovë, me koncentrim të institucioneve qeveritare, administrative e zhvillimore, hulumtuese të rëndësishme; • Ka Stacione për Monitorimin e Cilësisë së Ajrit; • Vullnet politik për zbatimin e reformave në mjedis; • Ka sistem të ngrohjes qendrore të Qytetit- Termokosin.	• Mungesa e filtrave të tymtarëve të Obiliqit; • Mungesa e filtrave të tymtarëve të shtëpive individuale; • Organizimi i dobët i komunikacionit, i cili shkakton vonesa në rrugë dhe emisione të gazrave; • Mungesa e gjelbërimit të lartë në kopshtet individuale dhe hapësirat publike; • Akoma në komunikacion kemi automjete të viteve '80 e '90; • Mungesa e trajtimit të ujërave të zeza industriale, spitalore dhe atmosferike; • Deponitë ilegale; • Rrjeti i dobët infrastrukturës teknike (ujësjellësi, kanalizimi, akoma kemi sistem azbest çimento të gypave të ujësjellësit); • Mungesa e sasisë dhe cilësisë së ujit të pijshëm, • mungesa e një strategjie për sigurimin dhe shfrytëzimin e ujit të pijshëm; • Uzurpimi i burimeve të ujit nga shfrytëzues ilegal; • Shfrytëzimi joracional i tokës nga ndërtimet; • Shpyllëzimi i tokës pyjore, dëmtimi i ekosistemeve pyjore; • Ndotja e konsiderueshme e dheut nga agjentët industrialë, bujqësorë, aktivitetet komerciale; • Mungesa e një plani, i cili i paraqet në mënyrë të qartë zonat ndërtimore dhe shfrytëzimet tjera zhvillimore; • Taksë e ulët për Leje Mjedisore dhe Leje Mjedisore Komunale; • Ndërtime të paligjshme në Parkun e Gërmisë; • Implementimi i pakët i aktiviteteve në ndërgjegjësimin dhe vetëdijësimin e komuniteteve për krijimin e një komuniteti të sigurt dhe të qëndrueshëm; • Tejkalmi i vlerave të ndotësve të ajrit (PM₁₀, PM₂, NO₂, Blozë etj..) në qendër dhe në periferi të Prishtinës, në krahasim me vlerat e lejuara; • Zbatim i dobët i ligjit; • Tejkalmi i vlerave të lejuara të zhurmës në zonat sensitive; • Buxheti i limituar për sektorin e mjedisit; • Menaxhimi i dobët i të gjitha llojeve të mbeturinave të krijuara në Komunën e Prishtinës, sidomos deponimi i tyre. Mungon selektimi dhe riciklimi i të gjitha llojeve të mbeturinave.
Mundësitë	Rreziqet
• Përdorimi i lëndëve të pastra djegëse për t'i zëvendësuar lëndët djegëse, të cilat emitojnë gazra në nivel të lartë, vendosja e filtrave në tymtarët e termo-elektraneve në Obiliq dhe të tymtarëve të shtëpive individuale në Komunën e Prishtinës; • Shtrirja e sistemit të ngrohjes në gjithë territorin e Prishtinës; • Identifikimi dhe ndarja e zonave të	• Krijimi i Perceptimi për Prishtinën si jostabile dhe me ndotje të lartë të ajrit, tokës dhe ujit; • Humbja e të interesuarve për investime në lëmin e mjedisit; • Dëmtim i pakthyeshëm i ekosistemeve lumore dhe tokësore; • Thatësira—konsiderohet si kërcënim për furnizimin me ujë gjatë sezonit të verës, kur temperaturat janë më të larta dhe reshjet e

ndjeshme ndaj ndotjes së ajrit;	shiut më të rralla;
• Shtimi i pikave për monitorimin e cilësisë së ajrit;	Humbja e vlerave të peizazhit të mbrojtur Gjermia;
• Mbështetje e donatorëve në fushën e mjedisit;	Humbja e disa ekosistemeve me rëndësi për rajonin, si rezultat i dëmtimit të rrugëve komunikuese mes ekosistemeve;
• Fushatat për vetëdijesimin e popullatës për mbrojtjen e mjedisit, duke filluar nga mënyra e trajtimit të mbeturinave shtëpiake, deri tek mënyra e shfrytëzimit racional të energjisë.	Largimi i disa llojeve bimore dhe shtazore nga habitatet në këtë rajon.
• Zgjerimi i hapësirave gjelbëruese në Prishtinë që kishin bërë ruajtjen e ekuilibrit mjedisor;	
• Vullnet politik për zbatimin e reformave në mjedis;	
• Zbatimi i programeve për riciklim të mbeturinave;	
• Rritja e buxhetit për sektorin e mjedisit në Komunën e Prishtinës;	
• Krijimi i rezervuarëve individual (për ruajtjen e ujit nga shirat);	
• Hapja e lumenjve të mbuluar në të ardhmen;	
• Modernizimi i shërbimit meteorologjik;	
• Ruajtja dhe menaxhimi i parqeve;	
• Arritja e një mënyre shumë më efikase e menaxhimit të mbeturinave në qytetin e Prishtinës (në aspekt kohe të grumbullimit, trajtimit të tyre, riciklimit etj.). Mundësia e aplikimit të komponentës SMART, duke filluar nga ruajtja e energjisë, deri tek menaxhimi i mbeturinave dhe shfrytëzimi racional i ujit.	

2.8.6. Sipërfaqet me rrezikshmëri

2.8.6.1. Erozioni


Erozioni është proces natyror i zhvendosjes së materialit të shkapërderdhur, si dheut, baltës, gurëve etj., nën ndikimin e erës, ujit ose nën ndikimin e gravitacionit. Erozioni është proces natyror, i cili në disa raste i rritet intensiteti nën ndikimin e aktivitetit të njeriut.

Erozioni në territorin e Prishtinës është i paraqitur edhe në zonën urbane, mirëpo edhe në zonën rurale të komunës si fshatrat në të cilët kalojnë lumenjtë e kësaj komune rrezikon natyrën e pasuritë shoqërore dhe private, të krijuara dhe të planifikuara nga njerëzit. Erozioni manifestohet me degradimin e tokës bujqësore, pyjore, rrjetit rrugor, hekurudhor, me degradimin e objekteve ndërtimore dhe vendbanimeve.

Tabela 87 Niveli i erozionit në komunë të Prishtinës

Kategoritë e erozionit për Komunë të Prishtinës	Sipërfaqe ha	%
Erozion shumë i fortë	16052.17	30.69
Erozion i fortë	6538	12.50
Erozion mesatar	16125.12	30.83
Erozion i dobët	13589.68	25.98
Totali	52304.97	100.00

Andaj komuna e Prishtinës duhet të planifikojë reduktimin e shkallës së erozionit përmes pyllëzimit në zonat e identikuara me erozion të lartë, ndërgjegjësimin e qytetarëve për mbrojtjen e pyjeve nga shpyllëzimet e mëtejshme dhe kontrollin e duhur të zhvillimeve të reja.



Harta 26 Sipërfaqet me rrezikshmëri – Erozioni


2.8.6.2. Rrëshqitja e tokës

Dheu në Rrafshin e Dukagjinit është më i butë dhe më zhavorik, ndërsa Rrafshi i Kosovës ka dheun me bazament më të fortë, ku kjo e fundit është edhe më e sigurt për ndërtim. Nga të gjitha pjesët e Kosovës, më karakteristike del të jetë toka e kryeqytetit, jo vetëm nga ndërtimet, por edhe nga përbërja e saj. Vlen të theksohet se në Prishtinë dita-ditës janë duke u shtuar ndërtimet e larta.

Rrëshqitja e dheut në territorin e Prishtinës është evidente në lagjen Arbëria për shkak të përbërjes pedologjike të tokës dhe dheut të hedhur-vendosjes që mund të shkaktojë dëme të konsiderueshme në lagjet e përmendura. Nga ky rrezik që vlerësohet të jetë me shkallë të lartë, do të pësonin dëme të mëdha 50-60 familje me 350-400 anëtarë. Dukuria e rrëshqitjes së tokës në komunën e Prishtinës janë të ndikuara edhe zonat rurale si Llukar, Koliq, Keqekollë, Nishec, Dabishec.

Lokacionet me potencial të rrëshqitjes së dheut, të evidentuara janë:

- Rruga Malush Kosova-Prishtina e Re;
- Lagjja Arbëri, Rr. Bashkim Fehmiu;
- Veterniku, ana e majtë, apo pjesa perëndimore e Prishtinës së Re;
- Zona afër rrugës magjistrale Prishtinë - Grashticë, afër Pompës së karburanteve Nasa Petrol dhe hapësira mbi të, me rrezikshmëri të lartë;
- Rrëshqitje e dheut në rrugën Siqevë–Radashec (rruga e gurëthyesit);
- Rrëshqitje e dheut në fshatin Prapashticë afër lagjes Fanaj;
- Rrëshqitje e dheut në fshatin Dabishec, për shkak të ujërave nëntokësore;
- Rrëshqitje e dheut dhe gurëve në fshatin Marec, në rrugën Viti–Bullaj;
- Rrëshqitje e dheut Busi-Slivovë në lagjen Mukat (Tullar);
- Rrëshqitje e dheut, Keqekoll-Ballaban.



Harta 27 Sipërfaqet me rrezikshmëri - Rrëshqitja e dherave


Tabela 88 Sipërfaqet e ndikuara nga rrëshqitja e tokës
Fatkeqësia Sipërfaqja e afektuar (ha)

	2015	2016	2017	2018
Rrëshqitjet	9	1	1	6
2.8.6.3. Tërmetet				

Tërmeti është fenomen që shkaktohet nga çlirimi i papritur i energjisë së grumbulluar, i cili shkakton krijimin e valëve sizmike. Në sipërfaqen e tokës, tërmeti shfaqet në dridhjet ose zhvendosjet e tokës, e nganjëherë edhe nën krijimin e dallgëve detare. Në të gjitha këto raste, tërmeti mund të shkaktojë dëme të mëdha njerëzore dhe materiale.

Është fakt që tërmetet paraqesin fatkeqësi të mëdha natyrore në zonat aktive sizmologjike, ku në një zonë të tillë ndodhet edhe Prishtina, e cila ka shkallën e rrezikshmërisë deri në 9 mk. Përgjatë historisë, dëmet e shkaktuara nga këto tërmete janë shënuar ndër vite, kanë ndodhur në: 1922, 1931, 1963, 1979, kurse më të vonshmet kujtohen dridhjet e tokës në vitet: 1980, 1983, 1984, 2000, 2002 dhe ato gjatë vitit 2008. Lëvizje, të cilat mund të përsëriten edhe në të ardhmen, duke vlerësuar shumë të lartë edhe rrezikun e fatkeqësisë, i cili kërkon veprim të menjëhershëm, prioritet trajtues të lartë, në rast se pasojat do të shkaktonin dëme të mëdha.

Pasojat e tërmetit në zonën sizmologjike, ku ndodhet territori i Komunës së Prishtinës, sidomos qyteti, me objektet e banimit kolektiv, ndërmarrjet publike, objektet tjera shumëkatëshe do të rrezikoheshin në shkallë të lartë, prandaj pikërisht për këtë, duhen planifikuar edhe masat për evakuimin dhe strehimin e popullsisë së rrezikuar, sigurimin e gjërave të domosdoshme ushqimore, veshmbathjet dhe medikamentet në sasi të domosdoshme nga institucionet përkatëse që veprojnë në territorin e komunës. Kjo do të jetë njëra nga detyrat kryesore që duhet të ndërmerret si masë mbrojtëse kundër rrezikut nga tërmeti eventual.



Harta 28 Sipërfaqet me rrezikshmëri - Zonat sizmike

2.8.6.4. Rrokullisjet e masave shkëmbore dhe ortekët e dëborës


Prishtina nuk ka një lartësi mbidetare të lartë dhe nuk është e rrethuar me male të larta, mundësia e rrezikimit të popullsisë nga dëbora është e mundshme, në periudhën e rrezikut shumë të rrallë (1 herë në vit ose më pak), me dëme të vogla për popullsinë dhe në dëme materiale. Rrugët më të rrezikuara gjatë sezonit dimëror janë rrugët kodrinore-malore të fshatrave të Gollakut. Ortekët e borës dhe ngricat, të cilat në një masë të konsiderueshme pengojnë funksionimin e përshtatshëm në mundësinë e furnizimit me prodhime vitale, ndërprerjen e komunikacionit, pamundësinë e ofrimit të ndihmës mjekësore në pjesët rurale të komunës (Llukar, Koliq, Keqekollë, Prapashticë, Nishec, Dabishec, Hajkobillë, Gllgovicë, Zllash, Kukaj, Dragoc).

2.8.6.5. Erërat

Territori i Prishtinës shpeshherë përfshihet nga erërat e fuqishme, mesatarja e shpejtësisë së erës është 3,5 m/sek. Gjatë periudhave të ndryshme të vitit paraqiten erëra të forta dhe me karakter të shtrëngatave lokale, të cilat shoqërohen me dëme materiale. Erëra të forta me shpejtësi prej 17,2-20,7 m/sek paraqiten gjatë gjithë vitit, me koncentrim më të madhë gjatë dimrit dhe pranverës, kurse më rrallë gjatë verës dhe vjeshtës. Rastisje më të shpeshtë kanë erërat që fryjnë nga drejtimi i veriut dhe verilindjes.

Erërat edhe në vitet e kaluara e kanë goditur Komunën Prishtinës, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale.

Faktorët që ndikojnë në intensitetin e rreziqeve nga erërat e fuqishme, konsiderohen të jenë: distanca e konsiderueshme nga bregdeti, relievi me pyje të mbuluara me vegjetacion, të cilat mund të ndikojnë ndjeshëm në frenimin natyror, duke zvogëluar intensitetin e erërave.



Harta 29 Sipërfaqet me rrezikshmëri – Erërat

2.8.6.6. Sipërfaqet me ndotje të lartë (Hot spotet)²²

Menaxhimi i mbeturinave bëhet nga Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi Sh.A. Mbulimi me shërbim për grumbullimin e mbeturinave është në tërë territorin e Prishtinës, duke përfshirë edhe tërë zonat rurale, së bashku me menaxhimin e faturimit të qytetarëve me faturë të mbeturinave.

Sasia e mbeturinave komunale (të amvisërisë) të grumbulluara dhe të bartura brenda vitit 2018 është 65,254 t, nga dyqanet dhe tregjet 5,077 t dhe mbeturina nga ndërtimi 899 t.

Një problem specifik mjedisor paraqitet nga gropat josanitare, si ajo në Marec 1 dhe në Marec 2, deri tek Përroi i Djaloshit-Miniera e Artanës që janë groza të mbushura me metale të rënda, duke zënë një sipërfaqe prej 2,38 ha.

Janë zhvilluar pilot projekte për ndarjen e mbeturinave, për fillim në lagjen Dardania, ndërsa projekte të tilla së shpejti do të fillojnë edhe në lagje tjera të Prishtinës.

Është bërë hulumtimi i hapësirave për vendosje të kontejnerëve të mbeturinave, duke përfshirë edhe hulumtime për caktimin e numrit të tyre në lagjet Dardania, Bregu i Diellit, Tasligje, jemi në veprim e sipër edhe për zonën Qendër, duke përfshirë lagjet Tophane, Lakërishtë, Lagjen e Muhagjerëve.

Është ndërtuar dhe funksionalizuar qendra e kompostimit në komunë, e cila me praktika të ekonomisë qarkore do të ndihmojë ndërmarrjet publike dhe fermerët me prodhimin e plehut organik.

Komuna e Prishtinës menaxhon dy platforma digjitale, të cilat lidhen drejtpërsëdrejti me mirëmbajtje të mjedisit. Platforma digjitale për Pjesëmarrje në Publik dhe platforma Ndreqe.com, në të cilat publikohen problemet mjedisore të raportuara nga qytetarët dhe intervenohet nga kompanitë e kontraktuara nga komuna.

²² Menaxhimi i mbeturinave komunale në Kosovë

2.8.6.7. Sipërfaqet e rrezikuara nga zjarri²³

Komuna e Prishtinës që nga viti 2000 e deri me sot ka pasur një numër të madh të rasteve nga zjarri, ku ka pasur edhe viktime, më poshtë janë listuar raste nga më të ndryshmet, të cilat kanë ndodhur në Komunën e Prishtinës.

Numri i përgjithshëm i zjarreve gjatë periudhës 2005-2010:

- zjarre në objektet e banimit familjar = 223 raste;
- zjarre në objektet publike shkolla = 245 raste,
- zjarre në objektet e biznesit privat lokale afariste = 15 raste,
- zjarre në trafostacionet për shpërndarjen e rrymës elektrike dhe në ormanët e rrymës elektrike = 124 raste;
- zjarre në automjete të udhëtarëve = 163 raste;
- zjarre në deponitë e mbeturinave = 7 raste;
- zjarre në pyje, fusha, ngastra bujqësore, ushqim i thatë i kafshëve = 64 raste.

Viktimat njerëzore:

- viktime nga zjarret janë shënuar = 37 raste;
- të plagosur nga zjarret janë shënuar = 29 raste.

Rastet e zjarreve të mëdha gjatë kësaj periudhe:

- zjarr në masivin pyjor Barilevë dhe Besi, viti 2010 në sipërfaqe prej 30 hektarësh;
- zjarr në malet e Gërmisë, viti 2007 në sipërfaqe prej 10 hektarësh;
- zjarri në Zonën Industriale, në vitin 2009;
- zjarri në Qendrën Tregtare Benaf, viti 2010.

Tabela 89 Sipërfaqet e ndikuara nga zjarret në Komunë të Prishtinës
Fatkeqësia Sipërfaqja e ndikuar(ha)

	2015	2016	2017	2018
Zjarret pyjore	590	242	691	544

Pyjet e Komunës së Prishtinës janë të prirura për t'u prekur nga zjarret gjatë gjithë vitit, e sidomos në pranverë dhe gjatë verës jashtëzakonisht të nxehtë dhe të thatë. Shkaqet e zjarreve janë në radhë të parë me karakter:

- antropogjenik (pakujdesia e njerëzve);
- djegia për kullota;
- vënia e zjarreve me qëllim e interesa personale dhe natyrore (të rralla apo të pamundshme).

2.8.6.8. Vërshimet

Në Komunën e Prishtinës vërshimet kanë ndodhur me rastin e daljes nga shtrati lumenjtë dhe përroskat, siç është Lumi i Prishtinës dhe degët e saj. Pjesët e prekura të Komunës së Prishtinës nga këto vërshime, janë: Llukari, Besia, Makofci, Mramori, Keqekolla, Bërnica, Prugofci, Kodra e Trimave, Kalabria dhe Hajvalia.

Rajoni i Prishtinës i takon zonës me sasi më të vogla mesatare të të reshurave, vetëm me 582.0 mm për metër katror në vit (sipas të dhënave të IHMK), mirëpo ndodh që të ketë edhe reshje të mëdha atmosferike, të cilat mund të shkaktojnë dëme të konsiderueshme, sidomos në qytet (lagjet: Fusha e Pajtit, Lagjja e Spitalit, Lagjja e Kolovicës, fshati Shkabaj) që vjen si pasojë e ndërtimeve pa leje adekuate, futjes së lumenjve dhe përrenjve në tubacion.


²³ Plani i mbrojtjes nga zjarri

Rreth 32% e shkollave, 28% e spitaleve, 24% e drejtimeve kryesore të rrugëve dhe 11% e stacioneve të policisë, janë të vendosura në zona të rrezikuara nga përmbytja e shiut.

Tabela 90 Sipërfaqet e ndikuara nga vërshimet në Komunën e Prishtinës

Fatkeqësia	Sipërfaqja e ndikuar (ha)			
	2015	2016	2017	2018
Vërshimet	23	30	17	28

Faktori njeri me aktivitetin e vet ka shkaktuar dëme të mëdha përgjatë shtratit lumor në rrjedhjen e mesme dhe të poshtme, ku në disa raste janë edhe të pariparueshme. Nxjerrja ilegale e inerteve përgjatë pellgut lumor, pa kritere, ka shkaktuar degradim të shtratit lumor, ku pasojat janë të mëdha gjatë periudhave të lagështa të vitit që manifestohen me vërshime. Ndërtimi i objekteve të banimit, objekteve ekonomike dhe objekteve tjera përgjatë shtretërve të lumenjve si dhe hedhja e mbeturinave të ngurta dhe shkatërrimi i botës bimore përgjatë brigjeve lumore, ka ndikuar që ato regjione t'i jenë ekspozuar rrezikut permanent nga vërshimet. Komuna e Prishtinës duhet të bëjë një studim të veçantë për vërshimet, sidomos në zonën urbane dhe rezultatet e këtij studimi duhet të trajtohen me masat mbrojtëse përkatëse.



Harta 30 Sipërfaqet me rrezikshmëri – Vërshimet

Zonat (lokacionet) me potencial rreziku nga vërshimet:

- përroska e ujit nga fshati Makoc deri tek Fusha e Pajtimit;
- përroska e ujit nga fshati Lugmir, Mati 1 dhe Lagja e Spitalit dhe një pjesë e lagjes Kalabria–kolektori pjesa e papërfunduar;
- lumi nga fshati Llukar në mes të kolektorit dhe kanalit të hapur deri tek Fusha e Pajtimit,
- përroska tek Përroi i Njelmët;
- përroska në fshatin Hajavli nga Pallati i Drejtësisë, kalon përgjatë rrugës së vjetër nga Ambulanca, deri në rrugën magjistrale Prishtinë–Gjilan;
- përroska e ujit në fshatin Mramurë nga lagjja Spahiaj dhe Balaj deri në Suteskë;
- përroska e ujit në fshatin Barilevë, lagjja Verbovci dhe Brestovci;
- përroska e ujërave atmosferike dhe atyre fekale (të ndotura) nga Pallati i Drejtësisë–lagjja Byqmeti dhe nën rrugën magjistrale Prishtinë–Gjilan, deri tek Lumi Graqanka;
- lumi Llap, i cili kalon nëpër fshatrat e territorit të Komunës së Prishtinës.

Në mënyrë që të mënjanoen dëmet nga vërshimet në të ardhmen, komuna duhet të:

- planifikojë mbrojtjen nga vërshimet, përmes rregullimit të shtretërve të lumenjve dhe përroskave të tokave, të cilat kanë bonitet të lartë dhe masa tjera për të mbrojtur dhe ngritur shkallën e bonitetit;
- pastrimi, përmirësimi i shtratit të lumenjve dhe planifikimi i argjinaturave (brigjeve të ngritura artificialisht) do të minimizonte përmbytjet;
- rregullimi i sistemit të drenazhimit për zona të ndryshme, duke mundësuar kullimin e këtyre zonave nga uji i grumbulluar nga reshjet atmosferike;
- ndërtimi i sistemit të drenazhimit në zonën e hapësirave të lira për rekreacion;
- rritja e hapësirave gjelbëruese, mbjellja e pemëve të ndryshme në zonat, ku janë të rrezikuara nga vërshimet.

Tabela 91 SWOT analiza - Sipërfaqet me rrezikshmëri

Përparësitë	Dobësitë
• Pjesa më e madhe e territorit të Komunës së Prishtinës është e mbuluar me pyje; • Komuna ka një plan për mbrojtjen nga zjarri; • Ka pajisje për matjen e zhurmës; • Prishtina nuk ka qenë asnjëherë e goditur nga ndonjë termet a ortek ose vërshime të përmasave shkatërruese; • Komuna e Prishtinës ka një plan për menaxhimin e mbeturinave; • Ekzistojnë dokumente bazike kombëtare: Dokumenti për Vlerësimin e Rreziqeve nga FNFT (në nivel vendi dhe lokal) dhe Plani i Reagimit Kombëtar.	• Mungesa e rezervuarëve të ujit në vendet, ku janë të rrezikuara potencialisht nga zjarret; • Sipërfaqe të shpyllëzuara; • Humbja e tokës bujqësore nga erozioni; • Shtretër të ngushtë të lumenjve që rritin mundësitë për erozion dhe vërshime; • Rugë të ngushta për intervenimin e zjarrfikësve; • Rrjeti i vjetër i ujësjellësit që çon shpeshherë në vërshime sipërfaqësore në disa lagje të Prishtinës; • Mungesa e zbatimit të ligjeve në fuqi; • Shfrytëzimi joracional i hapësirës; • Zgjerimi i qytetit me ndërtime, zënia e tokës bujqësore; • Buxheti; • Zjarrvënia nga faktori antropogjen (njeri); • Përmbytja si rezultat i mungesës së rrjetit të drenazhimit. • Mungesa e ndarjes së kanalizimit atmosferik nga ai fekal
Mundësitë	Rreziqet
• Organizimi i trajnimeve, mbi vetëdijësimin e popullatës për rrezikun dhe pasojat që mund të vijnë nga veprimtaria e erozionit, ortekut, rrëshqitjet e dheut, zjarret etj.; • Pyllëzimi i hapësirave ku janë të afektuara nga erozioni, rrëshqitjet e dheut; • Ndërtimi i mureve mbrojtëse në rrugët që janë të rrezikuara nga rrëshqitjet e dheut p.sh. tek lagja Arbëria;	• Paraqitja e sëmundjeve të organeve respiratore; • Degradimi i tokës; • Humbja e pakthyeshme e biodiversitetit; • Humbja e peizazheve; • Zvogëlimi i tokës bujqësore; • Tejkalimi i normave të lejuara nga OBSH-ja me PM^{2.5} dhe PM¹⁰.

- Komuna e Prishtinës duhet të përkrahë përdorimin e lëndëve djegëse më cilësore;
- Të pajisen dhe të mbështeten zjarrfikësit me pajisje adekuate për menaxhim të zjarreve;
- Sigurimi i brezave mbrojtës për lartpërçuesit elektrik në fshatrat malore për zvogëlimin e mundësisë së zjarreve;
- Shfrytëzimi i ujërave nëntokësore për ujitjen e parqeve, rrugëve;
- Krijimi i akumulimeve artificiale;
- Aplikimi i metodave SMART për këtë fushë;
- Mundësia e aplikimit të komponentës SMART;
- Lagunave me destinim mbrojtës nga vërshimet dhe shfrytëzimi i ujit për ujitje dhe rekreacion;
- Përcaktimi i zonave të evakuimit në rast të tërmetit.

Sfidat kryesore:

- sigurimi i fondeve për projektet që përmirësojnë mjedisin;
- parandalimi i ndotjes së ajrit;
- menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave;
- trajtimi dhe eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave;
- parandalimi i ndotjes së sipërfaqeve ujore nga ujërat e zeza;
- ruajtja e cilësisë së ujit dhe e burimeve ujore që përdoren për ujë të pijshëm nga degradimet mjedisore, si dhe menaxhimi i qëndrueshëm i tyre;
- parandalimi i ndotjes nga zhurma;
- parandalimi i rrëshqitjeve të dheut dhe erozionit;
- vetëdijesimi për ruajtjen e pyjeve nga zjarret dhe prerjet ilegale;
- krijimi i një trupe koordinuese nga niveli qendror dhe lokal për marrjen e masave për zvogëlimin e ndotjes së ajrit nga termo-elektranat në Obiliq dhe komponentëve tjera ndotëse, në kohët e pikut dimëror dhe pikut veror.

Nevojat Zhvillimore:

- Ndërrimi i filtrave në termocentralet në Obiliq, do ta zvogëlonte ndotjen e ajrit në Prishtinë;
- Vendosja e filtrave në shtëpitë individuale, në mënyrë që të zvogëlohet ndotja e ajrit nga përdorimi i lëndëve djegëse joadekuate;
- Ulja e numrit të automjeteve, përmes përmirësimit të transportit publik;
- Promovimi i përdorimit të mjeteve jomotorike të transportit ose mjeteve transportuese me emetim të ulët të gazrave;
- Rritja e sipërfaqeve të gjelbra dhe krijimi i brezit të gjelbër në pjesën perëndimore;
- Bizneset, të cilat përdorin lëndë djegëse të kontrollohen dhe të obligohen të pajisen me LMK (përmirësimi i ventilimit dhe cilësisë së lëndës djegëse);
- Vendosja e brezave dhe e shiritave të gjelbër me kapacitete për absorbim të aerosolëve, gazrave azotike, të sulfurit dhe karbonike, metaleve të rënda përgjatë rrugëve kryesore të Prishtinës;
- Rivitalizimi i parqeve ekzistuese dhe krijimi i parqeve të reja;

- Mbrojtja dhe kultivimi i pyjeve të reja edhe me kapacitete për thithje të gazrave që e ndotin ajrin;
- Përcaktimi i kriterëve për sipërfaqet e gjelbra të detyrueshme në lejet e reja të ndërtimit, me prioritet në qytetin e Prishtinës dhe nënqendrat;
- Shfrytëzimi i energjisë nga burime të ripërtëritshme si alternativë e pastër e prodhimit të energjisë;
- Planifikimi i nivelit të tolerueshëm të ndotjes nga zhurma konform kërkesave ligjore, me theks të veçantë në zonat me veprimtari të ndjeshme (afër shkollave, spitaleve dhe zonave të banimit etj.);
- Hartimi i Hartës Strategjike të Zhurmës dhe Planit të Veprimit për mbrojtje nga zhurma;
- Pasurimi i florës dhe faunës në të gjithë territorin, bazuar në hulumtimin rreth biodiversitetit në komunën e Prishtinës që duhet të hartohet;
- Rivitalizimi i ekosistemeve pyjore për parandalimin e shkatërrimit të habitateve të shumëllojve bimore dhe shtazore në territorin e Komunës së Prishtinës;
- Themelimi i parkut botanik, monumentit të natyrës dhe muzeut të natyrës;
- Reduktimi i shkallës së erozionit përmes aplikimit të masave teknike për parandalim të erozionit;
- Nevoja për përpilimin e hartave mikrosizmike për zonën urbane në Komunën e Prishtinës;
- Planifikimi i tampon zonave për parandalimin e shpërndarjes së zjarrit;
- Ndërtimi i rezervuarëve të ujit në zonat rurale për zjarrfikësit;
- Vendosja e hidrantëve në zonat e banuara, ku është e mundur.

2.9. Asetet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore

2.9.1. Trashëgimia natyrore

Komuna e Prishtinës në territorin e saj përmban një vlerë të mbrojtur natyrore. Sipas kategorisë së përcaktuar nga Instituti i Kosovës për mbrojtjen e Natyrës dhe Ligji nr. 03/L-233 për mbrojtjen e natyrës, Gërmia vlerësohet si park i natyrës, me rëndësi shkencore, edukative, kulturore dhe turistike.

Gërmia është një masiv malor i pasur me lloje bimore e shtazore, bashkësi bimore dhe me një peizazh të mrekullueshëm. Gërminë jo pa arsye e quajmë tarraca e gjelbër e Prishtinës, mushkëritë e kryeqytetit, qendra e çlodhjes dhe fuqizimit. Nga hulumtimet e deritashme janë të evidentuara 610 lloje të florës vaskulare të grumbulluara në 82 familje dhe 83 lloje kërpudhash duke mos llogaritur taksonet e 2 barërave të këqija, atyre ruderalet dhe bimëve tjera të ulëta. Prej tyre 5 lloje janë endemike dhe 12 lloje mjekësore. Vegjetacionin pyjor të Gërmisë e përbëjnë 4 bashkësi pyjore: Bashkësia e shpërdhit dhe qarrit (prej 600-700 m lartësi mbidetare), bashkësia e bungut dhe shkozës (800 m), bashkësia e bungut (820- 870 m) dhe bashkësia e ahut (1000 m). Kompleksiteti i biotopeve natyrore të Gërmisë siguron kushte për jetesën e një sërë llojesh shtazore. Sipas hulumtimeve të bëra deri më sot dhe sipas shënimeve të literaturës në regjionin e Gërmisë janë regjistruar: 5 lloje ujëtoksorësh, 7 lloje të rrëshqitësve, 19 lloje të gjitarëve dhe 30 lloje të shpendëve.

Masivi malor i Gërmisë edhe pse në përgjithësi i ka ruajtur vlerat e veta natyrore, megjithatë ndikimi negativ i faktorit antropogjen nuk ka kaluar pa lënë gjurmët e veta. Janë të dukshme dëmtime të ekosistemeve të ndryshme përmes eksploatimit të pyjeve dhe si rezultat i kësaj dukurie është paraqitë erozioni dhe rrëshqitja e tokës. Po ashtu kjo ka ndikuar edhe në çrregullimin dhe zvogëlimin e rrjedhave të ujit, e cila ka shkaktuar edhe ndryshueshmëri në strukturën e bashkësive jetësore bimore dhe shtazore. Meqenëse Gërmia paraqet një rajon shumë të rëndësishëm dhe interesant në aspektin floristik, vegjetativ, faunistik dhe turistikë-rekreativ është e domosdoshme që të ndërmerren masa adekuate për mbrojtjen e saj nga degradimi i mëtejshëm.

Përveç vlerave të krahasueshme të natyrës që ofron Parku i Gërmisë, në komunë vlerësohet të ketë shumë asete të tjera që paraqiten si vlera të shtuara të trashëgimisë natyrore të kryeqytetit.


Së fundmi, nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës si organ qendror për mbrojtjen e natyrës ka përgatitur elaboratin: Studimi për arsyeshmërinë profesionale për marrjen në mbrojtje të vlerës së natyrës “Trungu i Thanës” (*Cornus mas*), në fshatin Butovc të Prishtinës, si Monument i Natyrës. Ky trung i përket kategorisë së tretë dhe ka vjetërsi afro 200-250 vjet. Përveç këtij studimi të bërë, fatkeqësisht asete të tjera nuk janë identifikuar nga institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e tyre, përkatësisht nga Instituti për mbrojtjen e natyrës, duke lejuar degradimin e tyre të ndikuar nga zhvillimet përreth.

Tabela 92 Asetet e trashëgimisë natyrore

Vendbanimi	Emri	Kategoria	Statusi ligjor	Sipërfaqja (ha)
Prishtinë	Peizazhi i mbrojtur - Gërmia	Peizazh mbrojtur	i I mbrojtur	1949

2.9.1.1. Biodiversiteti

Prishtina, si shumica e vendeve të Kosovës, po përballlet me problemin e humbjes së biodiversitetit. Faktori kryesor që ka shkaktuar kërcënim serioz për ekzistencën e shumë llojeve bimore dhe shtazore, padyshim është faktori njeri, ndërkaq shpyllëzimet masive, shfrytëzimi intensiv i tokës, ndotjet e ajrit dhe ujit, si dhe gjuetia e pakontrolluar, janë vetëm disa nga faktorët tjerë që vazhdojnë të rrezikojnë biodiversitetin. Nga të gjitha këto, humbja e sipërfaqeve pyjore që ka përfshirë me të madhe ekosistemin natyror, është një nga problemet më emergjente për natyrën e Prishtinës. Reduktimi i sipërfaqeve pyjore dhe degradimi i vazhdueshëm i tyre ka ardhur, kryesisht si pasojë e shfrytëzimit pa kritere të zonave pyjore. Si pasojë e këtyre ndikimeve rrjedh edhe kërcënimi për zhdukjen e shumë llojeve bimore dhe shtazore, sidomos në rajonin e Gërmisë, zonë e mbrojtur tani. Kafshët e rralla në vendin tonë, si: ujku, derri i egër, kaprolli, dhelpra, vjedulla, dreri, dhia e egër, macja e egër, lepuri, ketri, thëllëza, shqiponja, petriti, pata e egër, lejlaku etj., janë të rrezikuara të pakësohen, si pasojë e dëmtimit dhe ndryshimeve të habitateve të tyre, nga gjuetia e pakontrolluar, varfërimi dhe degradimi i ekosistemeve, erozioni dhe shpyllëzimi. Për llojet shtazore është shqetësuese, sidomos gjuetia e ushtruar gjatë periudhës së riprodhimit, ndërsa për llojet bimore, grumbullimi i tyre gjatë fazës së lulëzimit dhe nxjerrja me rrënjë.



Harta 31 Biodiversiteti (Burimi: EULUP)

Për menaxhimin më efikas të biodiversitetit në komunë e Prishtinës planifikohen të krijohen këto institucione: Kopshti Botanik, Instituti i Natyrës dhe Muzeu i Natyrës, të gjitha propozohen të zënë në një hapësirë të përbashkët.

2.9.2. Trashëgimia kulturore

Komuna e Prishtinës ruan pasuri të madhe të trashëgimisë kulturore, të krijuar gjatë shekujve të kaluar, nga parahistoria deri më sot. Kjo pasuri kulturore mijëvjeçare e trashëguar në variacione me tipologji të shumëllojshme të kulturës materiale dhe jomateriale, është dëshmi autentike për identitetin, historinë, kulturën dhe civilizimin mijëvjeçar të vendit dhe popullatës së tij. Njëherazi, kjo pasuri kulturore mijëvjeçar cilësohet kapital i çmuar nacional me vlera dhe rëndësi për zhvillime të qëndrueshme shumëdimensionale, përfshirë aspektin ekonomik, politik, kulturor dhe të mirëqenies shoqërore. Ruajtja e aseteve të trashëgimisë kulturore për brezat pasardhës është përcaktuar si detyrim Kushtetues i shoqërisë bashkëkohore dhe ky detyrim në Republikën e Kosovës realizohet përmes ndërmarrjes së masave të mbrojtjes juridike dhe teknike, të bazuar me vlerësime, studime dhe plane sipas parimeve dhe kriterëve ligjore dhe standard profesionale ndërkombëtare të përcaktuar për trashëgimi kulturore, planifikim hapësinor dhe zhvillimor.²⁴

Përgjatë dy dekadave të fundit, me qëllim të ruajtjes së potencialit të trashëgimisë kulturore, në përputhje me parime dhe trende bashkëkohore ndërkombëtare, institucionet përgjegjëse kanë zhvilluar aktivitete sistematike në identifikimin, dokumentimin dhe përcaktimin e aseteve në mbrojtje ligjore, si dhe krijimin Listës së Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të përkohshme, e cila, për herë të parë është krijuar nga Ministria e Kulturës (MKRS) në vitin 2012. Kjo listë është plotësuar për çdo vit, ndërsa në nivelin e Kosovës, për momentin në fuqi janë:

- Lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme, përfshirë 23 asete të përcaktuara, prej të cilave 6 i takojnë komunës së Prishtinës
- Lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme, përfshirë 1635 asete të përcaktuara, prej të cilave 152 i takojnë komunës së Prishtinës
 - Trashëgimi arkitekturore, 113 asete, në përbërje sipas tabelës 63;
 - Trashëgimi arkeologjike, 30 asete, në përbërje sipas tabelës 64;
 - Trashëgimi të luajtshme, 16 asete, në përbërje sipas tabelës 65.

Tabela 93 Asetet e trashëgimisë arkitekturore (Burimi: MKRS, 2021)

Vendbanimi	Emri	Viti	Statusi ligjor	Kategoria
Prishtinë	Ndërtesa e ish Pallatit të Shtypit "Rilindja"- Salla e shtypshkronjës	1971	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Materniteti "Nëna Terezë"	1992	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Keqekollë	Shtëpi Kullë e Ismet Xhemailit	Shek. XX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	New Born	2008	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Biblioteka Kombëtare e Kosovës Pjetër Bogdani	Shek. XX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Rezidenca e Presidentit Dr. Ibrahim	Shek. XX	I mbrojtur	Monument / Ansambël

²⁴ Convention on the Protection and Promotion of the Diversity of Cultural Expressions, UNESCO 2015.

	Rugova			/
Prishtinë	Banka Qendrore e Kosovës-BQK	1976	I mbrojtur	Ansambël Monument
				/
Prishtinë	Galeria e Arteve të Kosovës-GAK	Vitet e 60-ta	I mbrojtur	Ansambël Monument
				/
Prishtinë	Hotel GRAND	1978	I mbrojtur	Ansambël Monument
				/
Prishtinë	Instituti Albanologjik	1975	I mbrojtur	Ansambël Monument
				/
Prishtinë	Rektorati i Universitetit të Prishtinës	Vitet '60	I mbrojtur	Ansambël Monument
				/
Prishtinë	Pallati i Rinisë dhe i Sporteve	1874-1982	I mbrojtur	Ansambël Monument
				/
Prishtinë	Teatri Kombëtar i Kosovës	Shek. XX	I mbrojtur	Ansambël Monument
				/
Prishtinë	Shtëpi banimi Tophane	Shek. XIX-XX	I mbrojtur	Ansambël Monument
				/
Prishtinë	Kompleksi i Mitropolisë	Shek. XIX	I mbrojtur	Ansambël Monument
				/
Prishtinë	Xhamia e Pirinazit	Shek. XVI	I mbrojtur	Ansambël Monument
				/
Prishtinë	Shtëpi banimi (e Hyjnilerëve)	Shek. XIX	I mbrojtur	Ansambël Monument
				/
Prishtinë	Varreza Hebraike në Taukbahqe	Shek. XIX-XX	I mbrojtur	Ansambël Monument
				/
Prishtinë	Kompleksi i Çarshisë së Vjetër	Shek. XVI, (Shek. XIX)	I mbrojtur	Ansambël Monument
				/
Prishtinë	Xhamia e Çarshisë	Shek. XVI	I mbrojtur	Ansambël Monument
				/
Prishtinë	Xhamia e Jashar Pashës	Shek. XIX	I mbrojtur	Ansambël Monument
				/
Prishtinë	Shatërvani i Vjetër	Shek. XVII	I mbrojtur	Ansambël Monument
				/
Prishtinë	Muzeu i Kosovës	Shek. XIX	I mbrojtur	Ansambël Monument
				/
Prishtinë	Kulla e Sahatit	Shek. XIX	I mbrojtur	Ansambël Monument
				/
Prishtinë	Biblioteka Hivzi Sylejmani	Shek. XX-1930	I mbrojtur	Ansambël Monument
				/
				Ansambël

Prishtinë	Hamami i Madh	Shek. XIV-XV	I mbrojtur	Monument / Ansambël Monument / Ansambël Monument / Ansambël Monument / Ansambël Monument /
Prishtinë	Xhamia e Llapit	Shek. XV-XVI	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument /
Prishtinë	Shtëpi banimi-Luan Rudi	Shek. XVIII	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument /
Prishtinë	Shkolla Fillore Elena Gjika	Shek. XX-1926	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument /
Prishtinë	Arkivi i Prishtinës	Shek. XIX	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument /
Prishtinë	Shtëpi banimi-Familja Qarri	Shek. XVIII	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument /
Prishtinë	Shtëpi banimi-Hani i Sahit Agës	Shek. XVIII	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument /
Prishtinë	Shtëpi banimi-Kurtesh Sylejmani	Shek. XVIII-1880	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument /
Prishtinë	Shtëpi banimi -Bujar Xheli	Shek. XIX	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument /
Prishtinë	Shtëpi banimi-Ismail Sahatçiu	Shek. XVIII	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument /
Prishtinë	Shtëpi banimi-Adil Adili	Shek. XIX	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument /
Prishtinë	Hamami i Vogël	Shek. XV	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument /
Prishtinë	Instituti për TBC	Shek. XIX	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument /
Prishtinë	Shtëpi banimi-Rashit Rashiti	Shek. XIX	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument /
Prishtinë	Shtëpi banimi-Brahim Brahimi	Shek. XIX	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument /
Prishtinë	Shtëpi banimi-Shefqet Mehmeti	Shek. XX	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument /
Prishtinë	Shtëpi banimi-Osman Asllani	Shek. XIX	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument /
Prishtinë	Shtëpi banimi-Zejnullah Qaushi	Shek. XIX	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument /
Prishtinë	Shtëpi banimi-Hajdar Riza	Shek. XX	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument /
Prishtinë	Shtëpi banimi-Musli Hoxha	1927	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël

Prishtinë	Shtëpi banimi-Gëzim Konjusha	Shek. XIX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Shtëpi banimi-Mirnije Lleshi	Shek. XIX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Teqe-Fatime Shehu	Shek. XIX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Shkolla e Parë Shqipe	Shek. XIX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Shtëpi banimi-Sali Safqe	Shek. XIX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Shtëpi banimi-Muharrem Sejdiu	Shek. XIX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Shtëpi banimi-Imer Berisha	Shek. XIX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Shtëpi banimi-Fitim Gjata	Shek. XIX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Shtëpi banimi-Kemail Veseli	Shek. XIX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Çezmja-në Sheshin Dr. Ibrahim Rugova	Shek. XIX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Vetfarmi	Shek. XX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Shtëpi banimi-Fatime Shehu		I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Ish kadastri i komunës	Shek. XX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Shtëpi banimi-Atifete Jusufi	Shek. XIX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Varrezat Hebraike (Arbëri)	Shek. XIX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Stacioni i trenit	Shek. XX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Varrezat e LNÇ	1945	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Ish-spitali i TBC-së (Ministria e Shëndetësisë)	Shek. XX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Trafo e rrymës	Shek. XX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Shtëpi banimi-te tregu	Shek. XIX	I mbrojtur	Monument / Ansambël

Prishtinë	Xhamia e Koptëve	Shek. XIV (XVI)	I mbrojtur	Monument / Ansambël Monument
Prishtinë	Shtëpi banimi-Selatin Hallaqi	Shek. XX	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument
Prishtinë	Strukturat e Hamamit të Pashës	Shek. XX	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument
Prishtinë	Gjykata Komunale	Shek. XIX	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument
Prishtinë	Gjykata e Qarkut	Shek. XX	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument
Prishtinë	Shtëpi banimi-Faruk Ajeti	Shek. XX	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument
Prishtinë	Gjimnazi Sami Frashëri	Shek. XX	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument
Prishtinë	Ndërtesa e RTK-së	Shek. XX	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument
Prishtinë	Banim Kolektiv-Kryqi i Kuq	Shek. XX	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument
Prishtinë	Xhamia e Sudi Efendisë	Shek. XIX	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument
Prishtinë	Xhamia Alaudin	Shek. XVIII	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument
Prishtinë	Xhami e Jusuf Qelebiut	Shek. XIX	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument
Prishtinë	Shtëpi banimi-Igballe Globederi	Shek. XIX	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument
Prishtinë	Qendra e Rehabilitimit-Nëna dhe fëmija	Shek. XX	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument
Prishtinë	Muzeu i Pavarësisë së Kosovës Ibrahim Rugova	Shek. XX	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument
Prishtinë	Hotel Union	Shek. XX	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument
Prishtinë	Shtëpia e Herticëve	1989	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument
Prishtinë	Kisha Shën Ndou	Shek. XIX	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument
Prishtinë	Shtëpi banimi-Gazmend Abrashi	Shek. XIX	I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël Monument
Prishtinë	Burgu i Idealit		I mbrojtur	Ansambël Monument / Ansambël

Prishtinë	Ndërtesa e ish pallatit të shtypit "Rilindja"-salla e shtypshkronjës	1971	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Materniteti "Nëna Terez"	1992	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Shkabaj	Tyrbja Bajraktari	Shek. XIV	I mbrojtur	Zonë e Veçantë e Mbrojtur
Gazimestan	Monumenti Memorial i Gazimestanit	Shek. XX	I mbrojtur	Zonë e Veçantë e Mbrojtur
Çagllavicë	Galeria e Arteve-Agim Çavdërbasha	Shek. XX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Marec	Mulliri në hyrje të fshatit Marec	Shek. XIX-XX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Marec	Mulliri në dalje të fshatit Marec	Shek. XIX-XX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Barilevë	Shtëpi-Kullë e familjes Ndreci-Rexha		I mbrojtur	Monument / Ansambël
Bellasicë	Shtëpi me Cetma në Bellasicë		I mbrojtur	Monument / Ansambël
Keqekollë	Shtëpia e Mulla Ademit	Shek. XVIII-XIX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Koliq	Hambari në Koliq		I mbrojtur	Monument / Ansambël
Grashticë	Mulliri në Grashticë		I mbrojtur	Monument / Ansambël
Glllogovicë	Mulliri në Glllogovicë		I mbrojtur	Monument / Ansambël
Kukaj	Shtëpi banimi-Daut Xhemshiti	Shek. XIX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Kukaj	Kompleks-Etnoteatri	Shek. XIX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Milevcë	Kompleks banimi-Selim Ismaili	Shek. XIX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Besi	Shtëpi banimi-Idriz Bllaca	Shek. XX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Vranidollë	Stacioni i trenit	Shek. XX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Mramor	Mulliri i Sinan Gashit		I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Ëmbëltorja Elida	Shek. XX	I mbrojtur	Monument / Ansambël

Prishtinë	Qendra Historike e Prishtinës	Shek. XV-XXI	I mbrojtur	Fusha e konservimit arkitektural
Prishtinë	Shtëpia e lindjes së Adem Demaçit	Shek. XIX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Shtëpia e Adem Demaçit	Shek. XX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Qendra Tregtare Gërmia	1970-1972	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Ndërtesa e Radio Prishtinës		I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Monumenti i Skënderbeut		I mbrojtur	Monument / Ansambël
Mramor	Mulliri i Avdullah Gashit	Shek. XXI	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prapashticë	Xhamia në Prapashticë	Shek. XIX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Teatri Dodona	Shek. XX	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Kino Rinia	1953	I mbrojtur	Monument / Ansambël
Prishtinë	Mulliri i Isuf Hoxhës		I mbrojtur	Monument / Ansambël

Tabela 94 Asetet e trashëgimisë arkeologjike (Burimi: MKRS, 2022)

Emri	Periodha	Statusi ligjor	Kategoria
Tjerrtorja-lokaliteti neolitik (Vend zbulimi i Hyjneshës në Fron)	Parahistori	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Mbetje të Hamamit të vjetër	Mesjetë	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Lokaliteti arkeologjik shumëstresor në Gërmi	Parahistori, mesjetë	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Gjurmët e nekropolit mesjetar në Matiqan	Mesjetë	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Gërmadhat e kishës varrezore të Shën Arkangjelit dhe gurë varresh të Periudhës Osmane	Mesjetë	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Gërmadhat e vjetra të Kishës së Shashkocit për potesin Qeliat	Antikiteti i vonë	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Gërmadhat e Kishës Mesjetare me varre	Mesjetë	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Lokalitetet arkeologjike parahistorike të një areali në Plandishtë dhe Shevarikë	Parahistori	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik

Lokaliteti arkeologjik Italaja në Kulinë	Parahistori	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Lokaliteti arkeologjik Neolitik në Bardhosh	Parahistori	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Lokaliteti arkeologjik Neolitik në Barilevë	Parahistori	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Lokaliteti arkeologjik Çuka në Barilevë	Parahistori	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Rrënojat e Mullirit të Pashës	Shek. XIX	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Lokaliteti Parahistorik në Grashticë	Parahistori Bronzi i vonë	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Fortifikata e antikitetit të vonë - Gjyteti i Grashticës	Antikitet i vonë	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Lokaliteti Parahistorik në Keqekollë	Parahistori (Bronzi i vonë)	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Kalaja e Antikitetit të vonë në Koliq	Antikitet i vonë	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Lokaliteti arkeologjik - Quka e Drazhnjës	Parahistori, Antikë	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Fortifikata-Gradina e Sofalisë	Parahistori, Antikë	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Kalaja e antikitetit të vonë në Kolovicë	Antikitet i vonë	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Kalaja e antikitetit të vonë në Sharban	Mesjetë	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Lokaliteti arkeologjik - Kulina në Slivovë	Mesjetë	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Kalaja antike në Butoc	Antikë	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Gjurmë të minierave antike në Majën e Mprehtë në Shashkoc	Romake, Antikitet i vonë, Mesjetë	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Vendbanim Parahistorik në Trudë	Parahistori	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Gjurmët e kalasë në Siçevë	Parahistori, Antikë	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Rrënojat e një vile romake në Mramor	Romake	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Fortifikata Guri i B1etës në Marec	Antikë e vonë	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Gradishta e Marecit	Antikë e vonë	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik
Gjyteti (Kalaja) e Marecit	Antikë e vonë	I mbrojtur	Lokalitet Arkeologjik

Tabela 95 Asetet e trashëgimisë së luajtshme (Burimi: MKRS, 2021)

Vendbanimi	Emri	Viti	Statusi ligjor
Tjerrtores, Prishtinë	Figurinë antropomorfe	Neolit i vonë	I mbrojtur / I propozuar
Bardhosh, Prishtinë	Figurinë antropomorfe	Neolit i vonë	I mbrojtur
Bardhosh, Prishtinë	Figurinë antropomorfe	Neolit i vonë	I mbrojtur
Bardhosh, Prishtinë	Figurinë antropomorfe	Neolit i vonë	I mbrojtur
Bardhosh, Prishtinë	Figurinë antropomorfe	Neolit i vonë	I mbrojtur

Bardhosh, Prishtinë	Figurinë antropomorfe në formëtë kentaurit	Neolit i vonë	I mbrojtur
Bardhosh, Prishtinë	Figurinë antropomorfe e tipit Hyjnesha e ulur në fron	Neolit i vonë	I mbrojtur
Tjerrtoe, Prishtinë	Kupa binjake	Neolit i vonë	I mbrojtur
Bardhosh, Prishtinë	Kulluese	Neolit i vonë	I mbrojtur
Bardhosh, Prishtinë	Furrë në miniaturë	Neolit i vonë	I mbrojtur
Bardhosh, Prishtinë	Furrë në miniaturë	Neolit i vonë	I mbrojtur
Bardhosh, Prishtinë	Furrë në miniaturë	Neolit i vonë	I mbrojtur
Bërnice e Poshtme, Prishtinë	Urnë	1500-1100 p.e.s.	I mbrojtur
Matiçan, Prishtinë	Unazë	Mesjetë e hershme	I mbrojtur
Prishtinë	Deklarata e Pavarësisë	2008	I mbrojtur
Prishtinë	Portreti i Nënë Terezës	2016	I mbrojtur

Nisur nga kërkesat ligjore të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, asetet në mbrojtje përveç vlerave atribuese, nuk kanë të përcaktuar parametrat themelore të mbrojtjes si perimetrit dhe zonat mbrojtëse të tyre. Në këtë kuadër mungojnë konturat e kufirit të perimetrit të bërthamës/hapësirës së asetit dhe zona e mbrojtjes rreth tij, pronësia e ndërtesave dhe parcelave, referencat gjeografike, gjendja me kërkesat për mirëmbajtje apo mundësitë e rigjenerimit për përdorim dhe riparim/restaurim, si dhe kushtet dhe limitet/ndalesat ndaj zhvillimeve bashkëkohor. Si pasojë e mungesës së përcaktimit të perimetrit dhe zonës mbrojtëse, hapësirat e aseteve të trashëgimisë kulturore ende nuk janë regjistruar në planet kadastrale apo dhe, as përcaktuar sipërfaqe të mbrojtura në Planin Hapësinor të Kosovës, Harta Zonale dhe Planin Zhvillimor të Komunës, përveç 6 asetet në mbrojtje të përhershme dhe zonave të veçanta të mbrojtura.

Përveç Listave të trashëgimisë kulturore në mbrojtje, MKRS ka DB e trashëgimisë kulturore të RKS, në të cilën janë të identifikuar dhe regjistruar edhe shumë potenciale të tjera përgjatë proceseve të inventarizimit të trashëgimisë kulturore të realizuar që nga viti 2001. Por, këto potenciale me vlera të pakontestueshme ende nuk janë cilësuar asete në mbrojtje ligjore.²⁵

Prandaj, asetet e trashëgimisë kulturore në mbrojtje, përfshirë ato në zonën urbane dhe rurale, kryesisht paraqiten në gjendje të vështirë teknike apo me pamje restaurimi jociësor, shumica të braktisura dhe pa përkujdesë e mirëmbajtje. Këto zhvillime të pakontrolluar hapësirat e aseteve të trashëgimisë kulturore në mbrojtje, në mënyrë sistematike po sjellin degradim të autenticitetit dhe integritetit tyre hapësinor, fizik, historik, kulturor dhe ekonomik.²⁶


Prishtina e Vjetër është mjedis urban historik i zhvilluar në kontinuitet përgjatë harkut kohorë shumëshekullor, me gjurmë të dukshme të jetesës nga antikiteti (pa përjashtuar parahistorinë), mesjeta dhe deri në kohën bashkëkohore. Në peizazhin historik urban të saj radhiten numër i konsiderueshëm i monumenteve në mbrojtje dhe ndërtesa publike shumë të çmuara të arkitekturës moderne të shek. XX. Ky sfond i ndërtimeve të krijuar në periudha të ndryshme kohore janë të karakterit profan, utilitar, banimi tradicional, kulture, administrate, arsimit, komerciale, religjioze, etj. Ndërkaq, numri i konsiderueshëm i aseteve (monumenteve) në mbrojtje, kryesisht janë të koncentruara në bërthamën e Qytetit të Vjetër.²⁷

²⁵ Databaza e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës <https://dtk.rks-gov.net>

²⁶ Trashegimianerrezik.com (CHWB, Prishtinë) CHWB.org/Kosovo

²⁷ Raporti i gjetjeve arkeologjike në ndërtesën e sh. XV Hamami i Vjetër i Prishtinës, CHWB, 2009.

Ruajtja dhe zhvillimi i vlerave atribuese të trashëgimisë kulturore të Qytetit të Vjetër të Prishtinës është detyrim i shoqërisë bashkëkohore për brezat pasardhës. Ky detyrim duhet realizuar sipas parimeve dhe praktikave të suksesshme ndërkombëtare, gjithherë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të mirëqenies shoqërore, kulturore, ekonomike dhe mjedisore²⁸. Duke konsideruar vlerat atribuese të trashëgimisë kulturore që posedon Qyteti i Vjetër i Prishtinës, në muajin mars 2019, Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (QRTK) në Prishtinë ka hartuar dokumentacionin dhe nga tetori i vitit 2020 Qendra Historike e Prishtinës është listuar në listën e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme në nënkategorinë: Fushat e konservimit arkitekturor.²⁹ Në kuadër të propozimit të QRTK Prishtinë, përfshihen edhe ndërtesat e arkitekturës moderne të shek. XX, të cilat detyrimisht duhet ruajtur si asete të trashëgimisë kulturore arkitektuale me vlera atribuese kulturore, historike, teknologjike, mjedisore dhe kapital ekonomik. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është duke zhvilluar projektin për studim të fizibilitetit dhe plan të menaxhimit për Qendrën Historike të Prishtinës, përmes "Programit për integrimin e trashëgimisë kulturore në planifikim hapësinor" në bashkëpunim edhe me Komunën e Prishtinës.



Harta 32 Trashëgimia natyrore dhe kulturore

2.9.2.1. Vlerësimi i gjendjes aktuale – Trashëgimia kulturore

Sipas analizës së hollësishme të gjendjes aktuale, potenciali i trashëgimisë kulturore të Komunës së Prishtinës, kryesisht paraqitet në situatë të pafavorshme, larg përkujdesjes së duhur ligjore, institucionale dhe profesionale. Kjo gjendje shqetësuese e potencialit të trashëgimisë kulturore përfshinë game të gjerë të problemeve të ndërlidhura me shumë faktor dhe akter. Bazuar në faktet evidente, si kryesore theksohen çështjet sipas radhës së parastruar.

1. Komuna e Prishtinës posedon potencial të trashëgimisë kulturore përtej 158 asete të vendosur në Listën e Trashëgimisë Kulturore të mbrojtjes të përcaktuar nga MKRS. Në Listë nuk janë përfshirë shumë asete të regjistruar në DB e Trashëgimisë Kulturore të MKRS.
2. Asetet e trashëgimisë arkeologjike shumëshiresore të përcaktuar në mbrojtje, nuk janë në gjendje të mirë teknike, pa menaxhim, mbikëqyrje, mirëmbajtje dhe pakushte për vizitor. Asetet e trashëgimisë arkitekturore në mbrojtje, kryesisht janë të rrezikuara nga restaurimet

²⁸ Recommendation on the Historic Urban Landscape, UNESCO 2011.

²⁹ Propozimi për mbrojtjen e Qendrës Historike të Prishtinës, QRTK Prishtinë, mars 2019

jocilësore që zhvillohen në trende të pa harmonizuara me kërkesat e mbrojtjes dhe të konservimit të vlera të tyre ndërlidhëse apo autenticitetit dhe integritetit historik, kulturor, fizik dhe hapësinor. Përreth monumenteve në mbrojtje zhvillohen ndërtime të reja në trende të pa harmonizuar sipas kushteve dhe kriteret që kërkon ruajtja e zonave të mbrojtjes së tyre nga ndërtimet e reja.

3. Asetet të trashëgimisë arkeologjike dhe arkitekturore nuk kanë të përcaktuar atributet e vlerave që përmbajnë, kushtet me kriteret e mbrojtjes së autenticitetit dhe integritetit të tyre, as përshkrimin e gjendjes me nevojat e ndërhyrjeve riparuese emergjente. si dhe as kufizimet/ndalesat ndaj zhvillimeve dhe shfrytëzimit bashkëkohor apo planet e menaxhimit me akterët përgjegjës.
4. Asetet të trashëgimisë arkeologjike dhe arkitekturore me status në mbrojtje të përkohshme, nuk kanë të përcaktuar kufirin e perimetrit të hapësirës/bërthamës së asetit në mbrojtje dhe zonën e mbrojtjes përreth perimetrit. Në mungesë të përcaktimit të perimetrit dhe zonës mbrojtëse, perimetri dhe zona mbrojtëse e aseteve i referohen ligjit për Trashëgimi Kulturor.
5. Asetet të trashëgimisë arkeologjike dhe arkitekturore me status në mbrojtje të përkohshme qëndrojnë shumëfishë përtej afatit ligjor, me pasoja në detyrimin e shtetit për kompensimin e humbjeve të pronarëve.
6. Infrastruktura brenda dhe jashtë aseteve të trashëgimisë kulturore në mbrojtje është e vjetërsuar dhe paraqet rrezik për avari. Në asetet e trashëgimisë kulturore, qasja për vizitorë është e vështirë për arsye të mungesës së shenjëzimit.
7. Komuna, krahas posedimit të potencialit të madh të trashëgimisë kulturore, nuk ka strategji apo politika dhe institucion përgjegjës për menaxhimin e zhvillimit dhe të mirëmbajtjes së këtij kapitali si potencial për zhvillimin e turizmit kulturor dhe të punësimit, si dhe as Muze për përkujdesje, interpretim dhe prezantim të historisë dhe trashëgimisë kulturore me vlera dhe rëndësi lokale, nacionale dhe universale. Mungon politika e lehtësirave fiskale që përcaktohet si e drejtë ligjore për pronarët e trashëgimisë kulturore.

Nisur nga rëndësia dhe detyrimet ligjore të përcaktuara për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, në politikat e zhvillimit dhe planifikimit urban të Komunës si objekt prioritar përcaktohet: ruajtja dhe rigjenerimi i aseteve të trashëgimisë kulturore me të gjitha atributet e vlerave ndërlidhëse të tyre në funksion përmirësimit të mirëqenies shoqërore në aspektin e zhvillimit ekonomik, kulturor, arkitekturor, mjedisor, turizmi dhe punësimi.

Realizimi i objektivit të specifikuar përfshinë ndërmarrjen e masave kryesore paralele sipas përmbajtjes së parashtruar në vijim:

- Hartimi i Strategjisë dhe Programit për konservim/rigjenerimin e aseteve dhe sipërfaqeve të trashëgimisë kulturore në mbrojtje, në funksion zhvillimi të qëndrueshëm shoqëror, ekonomik, mjedisor dhe të punësimit.
- Themelimi dhe funksionalizimi i Zyrës së Komunës për Rigjenerimin e Aseteve dhe sipërfaqeve të trashëgimisë kulturore/trajnimi i personelit.
- Përcaktimi i statusit të mbrojtjes dhe konturat e Prishtinës së Vjetër si aset i trashëgimisë kulturore, përfshirja në Planin Hapësinor dhe Hartën Zonale të Kosovës dhe të Komunës, si dhe hartimi i Studimit dhe Planit të Konservimit.
- Krijimi i inventarit të aseteve të trashëgimisë kulturore të Komunës së Prishtinës, në ndërlidhje me Inventarin apo DB të MKRS, planet e demarkacionit të perimetrit dhe zonave të mbrojtjes rreth tyre, si dhe kriteret e mbrojtjes.
- Vendosija e lokacioneve të aseteve të trashëgimisë kulturore në planet kadastrale, Planin Hapësinor dhe Hartën Zonale të Kosovës dhe të Komunës, me qëllim të definimit të sipërfaqeve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe përcaktimit të kushteve për përdorim dhe zhvillimin e tyre, si dhe për klasifikim të zonave të veçanta.
- Identifikimi dhe regjistrimi i trashëgimisë arkitekturore të shek. XX/ ndërtesat publike/ dhe peizazhet kulturore për mbrojtje dhe konservim/rigjenerim.
- Identifikimi dhe ndërmarrja e masave të shpëtimit të aseteve të trashëgimisë kulturore në rrezik, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për trashëgimi kulturore.
- Identifikimi dhe dokumentimi i trashëgimisë kulturore jomateriale/shpirtërore;

- Identifikimi dhe dokumentimi i trashëgimisë kulturore të luajtshme e ndërlidhur me territorin e Komunës së Prishtinës/ Krijimi i koleksionit publik të trashëgimisë së luajtshme, themelimi dhe funksionalizimi i Muzeut të Komunës së Prishtinës.
- Organizimi i kampanjave sistematike për vetëdijesimin publik rreth rolit dhe rëndësisë së trashëgimisë kulturore.
- Krijimi i bashkëpunimit me institucione të specializuara ndërkombëtare për konservim/rigjenerim të trashëgimisë kulturore.
- Krijimi politikave investimeve dhe financimit për konservimin/rigjenerimin e trashëgimisë kulturore përmes partneritetit publiko privat dhe lehtësirave fiskale.

Tabela 96 SWOT analiza – Trashëgimia kulturore

Përparësitë	Dobësitë
• Peizazh historik i pasur me asete të trashëgimisë kulturore në variacione të shumëllojshme të trashëgimisë kulturore arkitekturore dhe arkeologjike të krijuar nga parahistoria deri me sot, të shpërndara në zona rurale dhe urbane dhe në lokacione atraktive natyrore. • Popullsia e re, ku dominon mosha nën 19 vjeç mbi 40%, të interesuar për identitetin e tyre dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore. Kornizë ligjore dhe strategji të qeverisë sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare për ruajtjen dhe rigjenerimin e trashëgimisë kulturore në funksion të mirëqenies shoqërore dhe ekonomike. • Institucionet qendrore profesionale, të koncentruara në Prishtinë, me profesionist të disiplinave të ndryshme të trashëgimisë kulturore që mbështeten me buxhet sistematik nga shteti. Studimet, restaurimet dhe kërkimet arkeologjike me botime, në mënyrë sistematike financohen nga shteti, grante dhe fonde jo të vogla ndërkombëtare. • Qendër e administratës nacionale me koncentrim të madh të institucioneve ndërkombëtare, qendër universitare, kulturore dhe tregtare. Hotelieri që promovon ushqimin e pasur tradicional	• Monumentet dhe lokalitete të amortizuara, në gjendje jo të mire teknike për përdorim bashkëkohor dhe infrastrukturë të pazhvilluar për vizitor. Në zonën e Prishtinës së Vjetër, zhvillimet ndërtimore bëhen në mënyrë të pa harmonizuar me kriteret e ruajtjes dhe mbrojtjes së trashëgimisë arkitekturore. • Mungesa e programeve të arsimit profesional për teknikat e ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore, si perspektivë e punësimit të tyre dhe në të mirën e avancimit të sistemit të mirëmbajtjes së aseteve të trashëgimisë kulturore. Migrimi i të rinjve jashtë vendit, në mungesën e mundësive të profilizimit dhe punësimit. • Mungesa e përcaktimit të sipërfaqeve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore në Planin Hapësinor dhe zhvillimore si dhe kushtet e ruajtjes, të konservimit dhe planet e programet e rigjenerimit, me mundësitë përkatëse të zhvillimit të potencialit për nevojat bashkëkohore, në dobi ekonomike, kulturore, arkitekturore, mjedisore, turizmi, punësimi, etj. Projekte dhe punimet e restaurimit të monumenteve përfundojnë me punime jocilësore, meqenëse ushtrohen nga persona të pa kualifikuar dhe të palicensuar nga shteti. • Mungesa e bashkëpunimit të nivelit lokal me atë qendror, duke përfshirë MKRS dhe MMPHI. • Mungesa e politikave dhe programeve të investimeve për zhvillim të ekonomisë dhe punësimit, të bazuar në potencialin e trashëgimisë kulturore dhe partneritetin publiko privat dhe lehtësirat fiskale. Nuk ka marketing dhe vend të përshtatshëm të përhershëm për shitjen e produkteve zejtare tradicionale. Profesionit i ciceronit për turist, ushtrohet në mënyrë joprofesionale, meqenëse mungon

licencimi i tyre.	
Mundësitë	Rreziqet
• Mbrojtja dhe rigjenerimi i krijimtarisë kulturore mijëvjeçare të Kosovës, si pasuri me attribute të vlerave universal dhe të rëndësisë nacional për identitetin dhe zhvillime të qëndrueshme në dobi shumëdimensional të vendit dhe të popullatës. • Performancë pozitive për shoqërinë e Kosovës, në përmbushjen e detyrimeve kolektive të përcaktuar për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, si bazë themelore drejtë përfitimit të fondeve investive ndërkombëtare për rigjenerimin e aseteve të trashëgimisë kulturore në funksion të mirëqenies shoqërore dhe zhvillimit qëndrueshëm ekonomik, kulturor, arkitekturor, ekologjik, punësimi, etj. • Baza ligjore mundëson lehtësira fiskale dhe investime të partneritetit publiko privat si dhe nga fonde zhvillimore ndërkombëtare. Avancimi i kapaciteteve institucionale dhe njohurive profesionale sipas trendeve dhe praktikave të suksesshme ndërkombëtare në domenin e rigjenerimit, konservimit dhe restaurimit të aseteve të trashëgimisë kulturore. • Transformimi i disa banesave tradicionale në restorante përgjatë viteve të fundit, janë shndërruar në vende atraktive për mysafir, me përfitime të larta ekonomike, të punësimit dhe arkitekture. Investitorë privat dhe publik janë të interesuar për investime në qendër të qytetit.	• Asetet e trashëgimisë kulturore në mbrojtje janë të nënshtruar rrezikut të shembjes dhe demolimit për t'u zëvendësuar me ndërtesa të reja. Monumentet në mbrojtje dhe ndërtesat publike të trashëgimisë arkitekture të shek. XX, janë të nënshtruara transformimeve të papërshtatshme të autenticitetit dhe integritetit të tyre hapësinor, fizik, historik, kulturor dhe estetik. • Humbja e identitetit mijëvjeçar të shoqërisë së Kosovës, me pasoja të pariparueshme për brezat pasardhës. • Aplikimi i sanksioneve ndaj autoriteteve shtetërore nga institucione ndërkombëtare dhe nacionale të drejtësisë për shkatërrim dhe dëmtim të palejuar të trashëgimisë kulturore si e drejtë themelore universal e njeriut. • Humbja e kapitalit atraktiv për krijimin e mjediseve jetësore të këndshme, me perspektivë të sigurtë për zhvillim të turizmit.

2.10. Vendbanimet

2.10.1. Karakteri urban rural dhe funksionaliteti ndërlidhës

Prishtina është kryeqendra urbane dhe administrative e Kosovës. Ajo është vendbanimi më i madh në Kosovë bazuar në numrin e popullsisë, por edhe kryeqendra politike dhe ekonomike e gjithë vendit. Për më tepër, aty janë përqendruar edhe funksionet kryesore të arsimit dhe shëndetësisë.

Komuna e Prishtinës përbëhet nga 42 vendbanime, të cilat shtrihen në një territor prej 523.21 km², prej të cilave 111.88 km² i takojnë zonës urbane të komunës (sipas kufirit të PZHU 2012-2022).

Nga i gjithë territori i komunës, 11,604.30 ha janë tokë bujqësore dhe rreth 31,978.80 ha janë përcaktuar si pyje.

Sipas regjistrimit të popullatës së vitit 2011, në këtë komunë akomodohet një popullatë prej 198,897 banorë. Në tabelën e mëposhtme janë klasifikuar vendbanimet e komunës së Prishtinës sipas karakterit urban/rural të përcaktuar me UA nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor:

Tabela 97 Vendbanimet sipas popullsisë, sipërfaqes dhe dendësisë (Burimi: ASK, Ortofoto 2018)

Vendbanimi	Klasifikimi (Urban/Rural)	Popullsia (2011)	Sipërfaqja (km ²)	Sipërfaqja (ha)	Dendësia (b/km ²)
Prishtinë	Vendbanim i madh urban	145149	30.54	3053.7	4753.22
Matiçan	Vendbanim i vogël urban	13876	7.22	722.2	1921.35
Hajvali	Vendbanim shumë i vogël urban	7391	7.63	762.9	968.80
Çagllavicë	Vendbanim shumë i vogël urban	4233	8.93	892.6	474.23
Kolovicë	Vendbanim i madh rural	2545	7.18	718.4	354.26
Bardhosh	Vendbanim i mesëm i madh rural	2229	5.16	515.5	432.40
Barilevë	Vendbanim i mesëm i madh rural	2212	10.04	1004.4	220.23
Prugoc	Vendbanim i mesëm i madh rural	2168	3.97	397	546.10
Sofali	Vendbanim i mesëm i madh rural	1767	7.72	771.8	228.95
Bërnice e Epërme	Vendbanim i mesëm i madh rural	1595	8.31	830.8	191.98
Llukar	Vendbanim i mesëm i madh rural	1579	7.47	746.6	211.49
Mramor	Vendbanim i mesëm i madh rural	1073	37.77	3777.2	28.41
Vranidoll	Vendbanim i mesëm i madh rural	1053	7.40	740.2	142.26
Orlloviq	Vendbanim i mesëm i madh rural	1035	1.88	188.4	549.36
Makoc	Vendbanim i mesëm rural	997	11.37	1136.6	87.72
Busi	Vendbanim i mesëm rural	814	16.34	1633.7	49.83
Besi	Vendbanim i mesëm rural	694	4.26	425.7	163.03
Trudë	Vendbanim i mesëm rural	694	5.87	587.3	118.17
Rimanishtë	Vendbanim i mesëm rural	595	13.84	1384.3	42.98
Drenoc	Vendbanim i mesëm rural	590	2.52	251.6	234.50
Bërnice poshtme	Vendbanim i mesëm rural	549	8.39	839.4	65.40
Keçekollë	Vendbanim i vogël rural	484	36.73	3672.5	13.18
Koliq	Vendbanim i vogël rural	466	39.85	3985.3	11.69
Grashticë	Vendbanim i vogël rural	433	14.96	1496.3	28.94
Marec	Vendbanim i vogël rural	432	72.71	7270.8	5.94
Lebanë	Vendbanim i vogël rural	398	2.18	218.2	182.40
Teneshdoll	Vendbanim i vogël rural	359	2.46	246.1	145.88
Siqevë	Vendbanim i vogël rural	337	7.09	709.3	47.51
Sharban	Vendbanim i vogël rural	317	12.99	1299.1	24.40
Shashkoc	Vendbanim i vogël rural	298	2.34	234.2	127.24
Slivovë	Vendbanim i vogël rural	257	7.10	709.7	36.21
Prapashticë	Vendbanim i vogël rural	240	22.13	2212.6	10.85

Zllatar	Vendbanim i vogël rural	233	8.46	845.6	27.55
Dragoc	Vendbanim shumë i vogël rural	178	9.23	923	19.28
Ballaban	Vendbanim shumë i vogël rural	167	12.18	1217.8	13.71
Dabishec	Vendbanim shumë i vogël rural	108	10.93	1093.3	9.88
Glllogovicë	Vendbanim shumë i vogël rural	74	8.12	811.5	9.12
Hajkobillë	Vendbanim shumë i vogël rural	72	7.38	737.7	9.76
Nishec	Vendbanim shumë i vogël rural	55	11.15	1115	4.93
Radashec	Vendbanim shumë i vogël rural	29	7.61	761.1	3.81
Kukaj	Vendbanim shumë i vogël rural	17	4.44	443.9	3.83
Novosellë	Vendbanim shumë i vogël rural		9.36	935.9	0.00

Nëse vendbanimet e komunës së Prishtinës kategorizohen sipas funksionit administrativ, kryeqytet pa dyshim që është vendbanimi i Prishtinës, por që në vete përfshinë edhe vendbanimet tjera sub-urbane të cilat janë pjesë e zonës urbane të komunës. Vendbanimet të cilat kanë potencial të zhvillimit si qendra lokale duke ofruar shërbime administrative, shëndetësore, arsimore e kulturore për banorët e tyre dhe fshatrave përreth konsiderohen të jenë Mramori, Bardhoshi dhe Keqekolla.

2.10.2. Vendbanimet sipas dinamikës së popullsisë

Sa i përket dendësisë së banorëve për vendbanim vërehet se dendësia më e lartë e popullsisë është në pjesën urbane, ku mesatarisht jetojnë rreth 4753 banorë në një km².

Në tabelën e mëposhtme janë klasifikuar vendbanimet mbi bazën e disa karakteristikave bazë të cilat i dallojnë nga njëra tjetra. Vendbanimet mund të jenë hapësirë rurale, hapësirë sub-urbane dhe hapësirë urbane. Tipologjia e zhvillimit në këto vendbanime është disa llojesh. Në disa raste ajo është lineare; zakonisht kur zhvillimi shkon përgjatë një aksi transporti, i koncentruar; kur zhvillimi është tradicional dhe në funksion të zhvillimit të tokës bujqësore, dhe i shpërndarë; zakonisht kur vendbanimet janë zhvilluar si pasojë e proceseve urbanizuese ose atyre të fragmentarizmit të tokës bujqësore.

Vendbanimet janë të ndryshme edhe nga pikëpamja e intensitetit ndërtimor çka në të shumtën e rasteve i bën edhe të dallojnë në karakterin e tyre urban apo rural të zhvillimit. Nga ana tjetër këto vendbanime janë zhvilluar edhe bazuar në karakteristikat morfologjike dhe topografike duke u klasifikuar sipas karakterit të tyre natyral të zhvillimit në; malor, i rrafshët apo i përzier.

Për shkak të vendodhjes dhe marrëdhënies ndërmjet tyre këto vendbanime kanë në themel të tyre edhe bazë të ndryshme ekonomike. Nga kjo pikëpamje ato janë klasifikuar në vendbanime me identitet; bujqësor, shërbimesh apo të përziera. Në vitet e fundit këto vendbanime kanë përjetuar dinamika të ndryshme të popullsisë. Përkrah klasifikimeve të mësipërme është me interes të shihet se cilët nga këto vendbanime kanë pësuar rënie të numrit të popullatës dhe cilat prej tyre kanë pësuar rritje të popullsisë.

Ajo çfarë vihet re në tabelën e mëposhtme është një pjesë e vendbanimeve kanë njohur rritje të popullsisë. Për rrjedhojë këto vendbanime janë edhe subjekt i rritjes së nevojave për shërbime, infrastrukturë dhe hapësira më të mëdha të karakterit urban. Një pjesë e këtyre vendbanimeve janë të karakterit rural, ndërsa një pjesë e vendbanimeve janë të karakterit sub-urban.

Por ajo që bie në sy është fakti që në pjesën dërrmuese të vendbanimeve sub-urbane dallohet një rritje e popullatës. Në vendbanime si Bërnice, Hajvali, Matiçan, Sofali e Çagllavicë është lehtësisht e kuptueshme që graviteti rreth Prishtinës urbane ka bërë që këto zona sub-urbane të pësojnë rritje të popullsisë dhe rritje të aktivitetit të karakterit urban.

Tabela 98 Klasifikimi i Vendbanimeve sipas rendit tipologjisë, dendësisë, ekonomisë dhe popullsisë

Vendbanimi	Kategoria e rendit hapësinor	Morfologjia hapësinore	Dendësia ndërtimore	Relievi	Identiteti ekonomik	Statusi i popullsisë
Prishtinë	Hapësirë urbane	I shpërndarë	E lartë	I rrafshit 600-650 m	Përzier	Rritje e popullsisë
Ballaban	Hapësirë rurale	I shpërndarë	Mesatare	Përzier 750-850 m	Bujqësor	Rënje e popullsisë
Barilevë	Hapësirë rurale	Linear	Mesatare	Përzier 600-650 m	Bujqësor	Rritje e popullsisë
Besi	Hapësirë rurale	I shpërndarë	E ulët	Përzier 650-700 m	Bujqësor	Rritje e popullsisë
Busi	Hapësirë rurale	I shpërndarë	Mesatare	Malor 750-900 m	Bujqësor	Rënje e popullsisë
Bërnice e Epërme	Hapësirë urbane	sub- I shpërndarë	Mesatare	I rrafshit 600-650 m	Përzier	Rritje e popullsisë
Bërnice e Poshtme	Hapësirë urbane	sub- I shpërndarë	Mesatare	I rrafshit 550-600 m	Përzier	Rënje e popullsisë
Dabishec	Hapësirë rurale	I shpërndarë	E lartë	Përzier 850-950 m	Bujqësor	Rënje e popullsisë
Dragoc	Hapësirë rurale	I shpërndarë	Mesatare	Malor 850-950 m	Bujqësor	Rënje e popullsisë
Drenoc	Hapësirë rurale	Linear	Mesatare	I rrafshit 550-600 m	Bujqësor	Rritje e popullsisë
Glllogovicë	Hapësirë rurale	I shpërndarë	Mesatare	Përzier 850-950 m	Bujqësor	Rënje e popullsisë
Grashticë	Hapësirë rurale	I shpërndarë	Mesatare	Përzier 750-950 m	Bujqësor	Rënje e popullsisë
Hajkobillë	Hapësirë rurale	I shpërndarë	E lartë	Përzier 850-950 m	Bujqësor	Rënje e popullsisë
Hajvali	Hapësirë urbane	sub- I shpërndarë	E ulët	I rrafshit 650-750 m	Bujqësor	Rritje e popullsisë
Keqekollë	Hapësirë rurale	I shpërndarë	Mesatare	Malor 850-1000 m	Bujqësor	Rënje e popullsisë
Koliq	Hapësirë rurale	I shpërndarë	Mesatare	Malor 850-1000 m	Përzier	Rënje e popullsisë
Kolovicë	Hapësirë urbane	sub- I shpërndarë	Mesatare	Përzier 750-800 m	Përzier	Rritje e popullsisë
Kukaj	Hapësirë rurale	Linear	Mesatare	Malor 950-1050 m	Përzier	Rënje e popullsisë
Lebanë	Hapësirë rurale	I shpërndarë	E lartë	I rrafshit 600-650 m	Bujqësor	Rritje e popullsisë
Llukar	Hapësirë urbane	sub- Linear	E ulët	Përzier 700-800 m	Bujqësor	Rritje e popullsisë
Makoc	Hapësirë rurale	Linear	E ulët	Përzier 700-800 m	Bujqësor	Rritje e popullsisë
Marec	Hapësirë rurale	I shpërndarë	Mesatare	Malor 950-1050 m	Bujqësor	Rritje e popullsisë
Matiçan	Hapësirë urbane	sub- I shpërndarë	Mesatare	Përzier 650-700 m	Përzier	Rritje e popullsisë
Mramor	Hapësirë rurale	I shpërndarë	E ulët	Përzier 850-950 m	Bujqësor	Rritje e popullsisë
Nishec	Hapësirë rurale	I shpërndarë	E lartë	Malor 900-1050 m	Bujqësor	Rritje e popullsisë
Novosellë	Hapësirë rurale	I shpërndarë	Mesatare	Malor 600-700 m	Përzier	Rritje e popullsisë
Nëntë Jugovic	Hapësirë rurale	I shpërndarë	E ulët	I rrafshit 550-600 m	Bujqësor	Rritje e popullsisë
Orlovic	Hapësirë rurale	I shpërndarë	E ulët	I rrafshit 600-650 m	Përzier	Rritje e popullsisë

Prapashticë	Hapësirë rurale	I shpërndarë	Mesatare	Malor 1000-1050 m	Bujqësor	Rritje e popullsisë
Prugoc	Hapësirë rurale	Linear	E ulët	I rrafshit 550-600 m	Bujqësor	Rritje e popullsisë
Radashec	Hapësirë rurale	I shpërndarë	E ulët	Përzier 800-950 m	Bujqësor	Rritje e popullsisë
Rimanishtë	Hapësirë rurale	I shpërndarë	Mesatare	Përzier 700-750 m	Bujqësor	Rritje e popullsisë
Sharban	Hapësirë rurale	I shpërndarë	Mesatare	Përzier 750-800 m	Bujqësor	Rritje e popullsisë
Shashkoc	Hapësirë rurale	I shpërndarë	E lartë	Përzier 750-800 m	Bujqësor	Rritje e popullsisë
Siqevë	Hapësirë rurale	Linear	Mesatare	Përzier 700-800 m	Përzier	Rritje e popullsisë
Slivovë	Hapësirë rurale	I shpërndarë	E ulët	Përzier 750-800 m	Bujqësor	Rritje e popullsisë
Sofali	Hapësirë urbane	sub- I shpërndarë	E ulët	Përzier 750-900 m	Përzier	Rritje e popullsisë
Tenezhdoll	Hapësirë rurale	I shpërndarë	E ulët	Përzier 650-700 m	Bujqësor	Rritje e popullsisë
Trudë	Hapësirë rurale	I shpërndarë	Mesatare	Përzier 600-650 m	Bujqësor	Rritje e popullsisë
Vranidoll	Hapësirë rurale	I shpërndarë	E ulët	Përzier 650-700 m	Bujqësor	Rritje e popullsisë
Zllatar	Hapësirë urbane	sub- Linear	Mesatare	Malor 800-900 m	Përzier	Rritje e popullsisë
Çagllavicë	Hapësirë urbane	sub- I shpërndarë	Mesatare	I rrafshit 600-650 m	Përzier	Rritje e popullsisë

Në përfundim, një pjesë e vendbanimeve të karakterit urban apo rural kanë pësuar rritje, ndërkohë që pjesa më e madhe e vendbanimeve rurale kanë njohur rënie të popullatës për shkak të proceseve urbanizuese.

Trendet domethënëse për zhvillimin urban, mund të gjenden veçanërisht në pjesën jugore të Prishtinës, ku komuna po zhvillon planet rregulluese për Prishtinën e Re. Zhvillimet sikur ato të Fshati Ndërkombëtar, disa ndërtesa të tjera (Presidenca, Pallati i Drejtësisë etj.) dhe ndërtesat e tjera administrative, janë karakteristike e kësaj pjese të qytetit. Gjithnjë e më shumë banorë kërkojnë objekte luksoze, me sipërfaqe më të mëdha dhe me oborr. Investitorët dhe ndërtimtarët janë duke iu përgjigjur pozitivisht këtyre kërkesave.

Në zonat rurale, vendbanimet karakterizohen me objekte të banimit individual, objekte ekonomike-bujqësore, shkollë, objekte fetare, ambulancë, disa dyqane dhe varreza në periferi. Në shumicën e rasteve këto përmbajtje përfaqësojnë elementet e siluetës dominante në arkitekturë.

Në dekadën e fundit kanë ndodhur lëvizje të shpejta të ndërtimeve të ndërtesave shumëbanesore, që pothuajse e kanë dyfishuar numrin e banorëve që jetojnë në këto ndërtesa. Mungesa e planeve rregulluese në disa lagje, sidomos presioni nga kërkesa e qytetarëve për të zgjidhur çështjen e banimit, shpesh ka rezultuar me ndërtime të paplanifikuara dhe pa leje si dhe me cilësi të dobët.

2.10.3. Vendbanimet rurale - shtrirja, struktura dhe madhësia

Rrjeti i vendbanimeve rurale në komunën e Prishtinës paraqet një heterogjenitet të shtrirjeve dhe një mozaik interesant të përhapjes hapësinore. Qasja e analizës së rrjetit, sistemit dhe e strukturës së vendbanimeve rurale në komunën e Prishtinës, sipas shumë karakteristikave fizionomiko-morfologjike, funksionale dhe demografike, paraqet specifikë të rrallë, që kërkon hulumtime të hollësishme, dhe ndërdisiplinore. Territori i komunës së Prishtinës karakterizohet me numër të madh vendbanimesh për njësi sipërfaqesh. Ky numër vendbanimesh është i koncentruar në një sipërfaqe prej 523.21 km², në të cilën gjenden vendbanime, nga të cilat 41 janë vendbanime rurale dhe një

vendbanim urban - Prishtina. Madhësia mesatare e vendbanimeve në vitin 1981 ishte 9 km² (ndaj 7,5 të mesatares së Kosovës) dhe me numër mesatar të popullsisë për një vendbanim prej 3444 banorë, që ishte me e madhe se mesatarja e Kosovës 1445.

Për arsye të rritjes së numrit të popullatës (shkalla e lartë e natalitetit, migrimi), qyteti i nevojiteshin hapësira të reja banimi. Kjo kërkesë theksohet sidomos me shkatërrimet e bëra gjatë luftës. Si rrjedhojë, në vitet e fundit qyteti është zgjeruar (rritur) dhe rindërtuar shumë. Që nga viti 1999, numri i banorëve të qytetit është rritur për 1500 banorë në vit. Një numër i madh i ndërtimeve nuk kanë fare leje ndërtimi. Aktualisht, thuhet se lëshohen rreth 200 leje ndërtimi të objekteve të banimit.

Në Komunë shtrihen 3 vendbanime, sipërfaqja e të cilave është e ndërtuar mbi 10% brenda kufijve të vendbanimit: Prishtina, Lebana dhe Zllatari.

Kolovica, Llukari, Siçeva, Slivova, Truda, Çagllavica, Besia, Vranidolli, Hajkobilla, Busia, Makoci, Sofalia dhe Gllgovica janë vendbanimet, sipërfaqja e të cilave është e ndërtuar 7-10% brenda kufijve të vendbanimit.

Barileva, Bërnica e Epërme, Maticani, Prugoci, Sharbani, Mramori, Mareci, Orlovici dhe Bërnica e Poshtme janë vendbanimet, sipërfaqja e të cilave është e ndërtuar 5-7% brenda kufijve të vendbanimit.

Ballabani, Keqekolla, Hajvalia, Grashtica, Nëntë Jugovic, Novosella, Prapashtica, Nisheci, Dabisheci, Kukavica, Dragoci, Drenoci, Rimanishta, Teneshdolli, Koliqi, Radisheci dhe Shashkoci janë vendbanimet, sipërfaqja e të cilave është e ndërtuar 0-5% brenda kufijve të vendbanimit.

2.10.4. Vendbanimi urban – shtrirja, struktura dhe madhësia

Zona urbane - Qyteti i Prishtinës shtrihet në pjesën verilindore të Kosovës dhe ka sipërfaqe prej 11 022 ha, përfshirë Gërminë. Zona urbane duke mos përfshirë Gërminë ka një sipërfaqe prej 7027 ha. Prishtina ka shtrirje në gjerësi gjeografike prej 42°40'00'' dhe gjatësi prej 21°20'15'', me pozitë qendrore në Gadishullin Ballkanik.

Relievi i Prishtinës e përbëjnë terrenet e ngritura me lartësi mbidetare prej 535-730 m. Qyteti rrethohet prej shpatijeve në të tri anët, duke krijuar një situatë topografike amfiteatrale. Në veri dhe në lindje, pylli i Gërmisë arrin lartësinë prej 1100 m. Në perëndim, Prishtina kufizohet me shpatijet e Arbërisë (ish-Dragodanit), në veri me kodrën e Pozderkës, në lindje me pyllin e Gërmisë duke vazhduar më tej me vargun e Bjeshkës së Butovcit (malet e Prugovcit dhe Grashticës), dhe në jug e juglindje me Veternikun dhe me vendbanimin e Matit.

- Në veri, qyteti kufizohet me zonat kadastrale Bërnice e Epërme, Bërnice e Poshtme dhe Llukar;
- Në lindje, qyteti kufizohet me zonën kadastrale Makoc, Mramor, Novosellë;
- Në jug, qyteti kufizohet me zonën kadastrale Çagllavicë;
- Në perëndim, qyteti kufizohet me komunën e Fushë Kosovës dhe fshatin Shkabaj.


2.10.4.1. Zhvillimi historik i zonës urbane ndër vite

Prishtina për herë të parë paraqitet në shek. XV dhe kishte vetëm 392 shtëpi dhe 10 lagje. Ajo kishte filluar të zgjerohet nga aspekti sipërfaqësor me 29 lagje dhe me 629 shtëpi në vitet 1569-1570. Ndërsa, në mesjetën e vonshme saktësisht në vitin 1689 ajo u zgjerua gjithsej me 4000 shtëpi. Ndër lagjet më të vjetra të qytetit të Prishtinës njihen si: ajo e Hynilerëve, Çekliqëve, Kacallarëve, Llokaqit, Kollaçit, Pozderës, Katër Llullave, e Xhamisë së Llapit, Tophanës, Muhaxherëve, etj. Më 1811, qyteti vlerësohet të ketë pasur 12000 banorë.

Zhvillimi i planifikuar i qytetit të Prishtinës në të kaluarën, kronologjikisht, planifikimi dhe rregullimi i hapësirës ka qenë:

- Plani i rregullimit të Prishtinës, (1937) - përfshinte sipërfaqe prej 192,72 ha dhe numër të planifikuar të popullsisë prej 16.000 banorësh;

- Plani i përgjithshëm urbanistik (1953), me periudhë kohore deri 1980, kurse qyteti ishte planifikuar për 50.000 banorë, në sipërfaqe prej 950 ha;
- Planit direktivë i trafikut dhe dedikimit të sipërfaqeve të qytetit (1967), për 100.000 banorë, në sipërfaqe prej 1950 ha;
- Plani i përgjithshëm i Prishtinës për periudhën (1988), deri në vitin 2000, për numër të banorëve 225.000 dhe me sipërfaqe prej 4335 ha. Paraqet dokumentin e parë të kompletuar, me të cilin qytetit i përcaktohet korniza e një qyteti bashkëkohor. Fatkeqësisht, shkak i konfliktet politike ky plan pak ka pasur mundësi që të zbatohet.
- Plani Strategjik i Prishtinës 2004- 2020, qyteti ishte planifikuar për 600.000 banorë, në sipërfaqe prej 950 ha³⁰.



Harta 33 Kronologjia e zhvillimit të qytetit

Kronologjia e zhvillimit të vendbanimit urban të Prishtinës (1916, 1948, 1972, 1982, 2000, 2012, 2020). Prishtina, ishte një qytet që shtrihej në mes dy lumenjsh të vegjël të quajtur “Prishtevka” dhe “Vellusha”. Në vitet e 1950-ta u mbulua lumi Vellusha, kurse në vitet 1970-ta u mbulua edhe lumi Prishtina. Këta lumenj u shndërruan në sistem të kanalizimit. Si rezultat i këtyre veprimeve, gjeografia natyrore e qytetit të vjetër mbeti e fshehur.

Në vitin 1947, Prishtina u bë qendër administrative e Kosovës, ku ajo kishte filluar të ndërtohej me infrastrukturë institucionale dhe urbane. Qyteti i Prishtinës pas Luftës së Dytë Botërore e kishte fituar funksionin më të rëndësishëm ekonomik dhe administrativ-politik dhe në vitin 1964 shpallet kryeqytet i Kosovës.

Gjegjësisht, pas këtij vendimi administrativ, qyteti përjeton një zhvillim urbanistik të hovshëm që ja ndërron dukjen nga një qytezë me tipare otomane në një qytet bashkëkohor. Vitet e 1970-ta sjellin një ndryshim thelbësor në karakterin e qytetit, të ndikuara nga hapja e Universitetit të Prishtinës dhe rritja e ndikimit politik të Prishtinës. Në këto dy dekada ndërtohen lagjet Ulpiana, Dardania, Lakrishtja, Bregu i Diellit, Arbëria (ish- Dragodani) dhe të gjitha objektet identifikuese të Prishtinës.

Struktura urbane në Zonën historike të qytetit

³⁰ Plani i Përgjithshëm Urbanistik i Prishtinës-PPU- 2000.

Sipas planifikimit me planin urbanistik të vitit 1953, gjatë viteve të 60-ta dhe 70-ta, ishin rrënuar lagje të tëra së bashku me Çarshinë e Vjetër, ku kjo e fundit ishte qendra e qytetit të Prishtinës, por ky fakt e kishte dërguar drejt shkatërrimit të arkitekturës popullore shqiptare të periudhës të sundimit otoman. Ndërtesat historike, kryesisht të banimit, ishin rrënuar dhe zëvendësuar me ndërtime të reja të një përmase krejtësisht tjetërfare, sipas frymës moderniste që ishte predominante në atë kohë në Evropë, nën moton e “një qyteti urban modern”. Ndërtesat që mbijetuan u transformuan në vitet e pasluftës pa ndonjë udhëzim të planifikimit urban. Ndonëse rindërtimi është bërë brenda kornizave të vendndodhjes së strukturës së vjetër, vëllimi dhe madhësia e ndërtesave të reja shpesh i kanë cenuar parimet më themelore të ajrosjes natyrore dhe të ndriçimit natyror.

Megjithëse, më 1976, Komuna e Prishtinës hartoi Planin rregullues për zonën e vjetër të qytetit të Prishtinës - Zona Historike e Prishtinës - me qëllim të ruajtjes së strukturave të vjetra, implementimi iu pengua ndikuar nga rrethanat politike më vonë.

Ndërtesat e arkitekturës moderne

Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, në qytet u shfaqën ndërtesat e para publike të cilët projektoheshin nga arkitekt të cilët kishin studiuar nëpër shkollat me ndikim të madh të Stilit Internacional, principet e së cilës padyshim manifestoheshin në veprat e tyre. Në këtë kategori mund të radhiten: Hoteli „Bozhuri i Kosovës“, rikonstruksioni i ndërtesës së Këshillit Ekzekutiv, Ndërtesa Administrative „Farmed“.

Nga të gjitha frymët arkitekturore botërore, në Prishtinë më e pranishmja e kësaj kohe, padyshim që është brutalizmi. Pallati i Shtypit, Kompleksi i Fakultetit Teknik, Ndërtesa e Kontabilitetit Shoqëror, Ndërtesa e Institutit Albanologjik, janë vetëm disa nga më të shquarat e kësaj kategorie. Krahas tyre, jo pak ndërtesa vijnë në frymë të konstruktivizmit në arkitekturë, si: Ndërtesa e SDK dhe Qendra sportive-rekreative „Boro e Ramiz“.

Një kategori e veçantë, janë edhe ndërtesat të cilat mbartin në vete karakteristika të theksuara të regjionalizmit kritik. Biblioteka Kombëtare e Universitare dhe Ndërtesa e Mensës së Studentëve, paraqesin dy rastet më domethënëse të kësaj kategorie.

Nëse marrim parasysh gjithë spektrin e gjerë të ndërtesave publike të realizuara me prirje të ndryshme arkitekturore, është një tregues se arkitektët që vepruan dhe realizuan në Prishtinë në mes viteve 1945-1990, ishin plotësisht të njoftuar me të gjitha të arriturat arkitekturore botërore dhe se ishin të zotët që ato njohuri t'i realizonin praktikisht brenda kontekstit specifik shoqëror prishtinas, duke rezultuar me një produksion arkitekturor specifik po aq sa ishte specifik dhe jashtë serik edhe vet rendi shoqëror në të cilën ato lindën.

2.10.4.2. Struktura dhe morfologjia urbane

Zona urbane - qyteti i Prishtinës përbëhet prej tri strukturave të ndryshme urbane:

Pjesa e vjetër e qytetit - Zona historike e Prishtinës, e ndërtuar deri në Luftën e Dytë Botërore, kur qyteti kishte pamjen e një “kasabaje”. Kjo zonë nuk e ka të ruajtur indin e vjetër të rrugëve, por që nuk i ka të ruajtura shumë nga strukturat e vjetra, të cilat në vazhdimësi po zëvendësohen me struktura të reja, duke e humbur karakterin historik dhe identitetin e kësaj zone, por dhe të qytetit të Prishtinës në tërësi;

Pjesa e “re” nga viti 1945 deri 1989, që u zhvilluan gjatë periudhës së socializmit. Këto pjesë urbane të qytetit me struktura komplekse shoqërore (banesore, publike dhe ekonomike), që janë zhvilluar pas Luftës së Dytë Botërore, dhe të cilat kryesisht janë të përqendruar rreth e përqark pjesës së vjetër të qytetit, në qendër dhe në pjesën jugore të qytetit;

Pjesët sub-urbane të qytetit të shpërndara pas vitit 1999, kur Prishtina pati transformime në proporcione të jashtëzakonshme. Këto zhvillime janë të shpërndara në periferi të qytetit, që përbëhen prej strukturave kryesisht të kombinuara të karakterit të banimit me destinime ekonomike, të cilat morën hov në periudhën e pasluftës së vitit 1999, të iniciuara nga sektori privat.

Derisa disa lagje ekzistuese të Prishtinës janë menaxhuar në mënyrë të tillë që mbajnë strukturat volumetrike që i kanë, disa të tjera janë ndryshuar në mënyrë drastike nga ndërtimet e paplanifikuara dhe pa kriter, që e kanë shkatërruar peizazhin.

Zonat urbane kanë një dendësi më të lartë të banesave kolektive. ndërsa në zonat sub-urbane ka kryesisht banesa individuale. Në dekadën e fundit kanë ndodhur lëvizje të shpejta të ndërtimeve të banesave kolektive, që pothuajse e kanë dyfishuar numrin e banorëve që jetojnë në ndërtesa shumëkatëshe. Mungesa e planeve rregulluese në disa lagje, dhe sidomos presioni nga kërkesa e qytetarëve për të zgjidhur çështjen e banimit, shpesh ka rezultuar me ndërtime të paplanifikuara dhe pa leje si dhe me cilësi të dobët.

Trend domethënës për zhvillimin urban mund të gjenden veçanërisht në pjesën jugore të Prishtinës, ku komuna po zhvillon planet rregulluese për “Prishtinën e Re”. Zhvillimet spontane të zonës ekonomike, “Fshati Ndërkombëtar”, disa ndërtesa të tjera (Presidenca, Pallati i Drejtësisë, etj.), si dhe ndërtesat e tjera me leje, janë karakteristikë e kësaj pjese të qytetit.




Figura 9 Plani i Zhvillimit Urban

Morfologjia urbane varet gjithashtu edhe nga rrjeti i rrugëve. Në këtë rast, sistemi i qarkoreve (unazave) po të zbatoheshin do të kishin ndryshim të madh në morfologjinë urbane të qytetit. Sipas PZHU janë planifikuar rrugë në formë qarkore në brendi dhe për qark qytetit të Prishtinës. Në konceptin e PZHU, që të mundësohet zhvillimi i mëtejshëm i qytetit, janë të nevojshme tri qarkore përmbajtësore të trafikut:

- rruga qarkore (e jashtme) e qytetit;
- rruga qarkore e brendshme;
- rruga qarkore qendrore.

2.10.5. Raporti mes sipërfaqes së ndërtuar dhe të pa ndërtuar në kuadër të vendbanimit

Sipërfaqja e ndërtuar në kuadër të vendbanimeve është paraqitur në tabelën e mëposhtme, ku është kalkuluar sipërfaqja e zonës kadastrale si vendbanim.

Tabela 99 Sipërfaqet e ndërtuara sipas vendbanimeve

Zona Kadastrale	Sipërfaqja (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar	Sipërfaqja e ndërtuar	Zona Kadastrale	Sipërfaqja (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar	Sipërfaqja e ndërtuar
-----------------	-----------------	-----------------------	-----------------------	-----------------	-----------------	-----------------------	-----------------------

		(ha)	(%)			(ha)	(%)
Ballaban	1217.8	7.83	1	Marec	7270.8	32.47	0.45
Barilevë	1004.4	95.37	9	Matiçan	722.2	333.49	46
Bërnice e Epërme	830.8	173.09	21	Mramor	3777.2	94.41	2
Bërnice e poshtme	839.4	60.7	7	Bardhosh	515.5	140.78	27
Besi	425.7	26.87	6	Nishec	1115	4.93	0.44
Busi	1633.7	26.87	2	Novosellë	935.9	3.7	0.4
Çagllavicë	892.6	362.72	41	Orloviq	188.4	46.63	25
Dabishec	1093.3	5.54	1	Prapashticë	2212.6	18.94	1
Dragoc	923	17.27	2	Prishtinë	3053.7	1379.3	45
Drenoc	251.6	17.27	7	Prugoc	397	127.43	32
Glllogovicë	811.5	5.89	1	Radashec	761.1	3.47	0.5
Grashticë	1496.3	21.69	1	Rimanishtë	1384.3	22.63	2
Hajkobillë	737.7	4.64	1	Sharban	1299.1	18.34	1
Hajvali	762.9	325.59	43	Shashkoc	234.2	18.27	8
Keçekollë	3672.5	33.45	1	Siqevë	709.3	14.96	2
Koliq	3985.3	26.78	1	Slivovë	709.7	14.29	2
Kolovicë	718.4	70.13	10	Sofali	771.8	47.13	6
Kukaj	443.9	2.67	1	Teneshdoll	246.1	16.85	7
Lebanë	218.2	19.29	9	Trudë	587.3	28.35	5
Llukar	746.6	53.24	7	Vranidoll	740.2	50.71	7
Makoc	1136.6	34.88	3	Zllatar	845.6	14.52	2

2.10.6. Vendbanimet joformale

Sipas "Raportit të gjendjes ekzistuese të Vendbanimeve Joformale në Kosovë" të hartuar nga MMPH në dhjetor të vitit 2010, në komunën e Prishtinës janë identifikuar 7 vendbanime joformale. Që nga ajo kohë, komuna e Prishtinës ka trajtuar këto vendbanime duke ofruar infrastrukturën e nevojshme për ngritjen e cilësisë së jetës për qytetarët e këtyre zonave. Këto intervenime janë konkretizuar me plane rregulluese urbane të hartuara në Kodrën e Trimave, në lagjen Dodona dhe Ramiz Sadiku.

Sipas analizave të gjendjes ekzistuese, infrastruktura publike është rregulluar në këto vendbanime. Prioritet për intervenim mbetet iniciimi i procedurave përkatëse ligjore për zgjidhjen e çështjeve pronësore.

Tabela 100 Gjendja ekzistuese dhe prioritetet për intervenim në VBJ

Vendbanimi	Sipërfaqja	Nr. banorëve	Nr. njësive të banimit	Infrastruktura Publike/Teknike	Çështjet pronësore	Gjendja fizike e VBJ	Prioritet për intervenim
Dodona	9.16 ha	1920	480	Mungon çerdhe,E ka qasje në rrjetzgjidhur të ujësjellësit dhe kanalizimit	paShtëpi mesatare/ të vjetërsuara	Çështjet pronësore, infrastruktura rrugore	
Kodra e trimave	10.31 ha	6800	1700	Mungon çerdhe,E ka qasje në rrjetzgjidhur të ujësjellësit	paShtëpi mesatare/ të vjetërsuara	Çështjet pronësore, infrastruktura rrugore	

Ramiz Sadiku	2.3 ha	160	40	Infrastrukturë adekuate	E zgjidhur	paShtëpi mesatare/ të vjetërsuara	Çështjet pronësore, infrastruktura rrugore
--------------	--------	-----	----	-------------------------	------------	-----------------------------------	--

2.10.7. Ndërtimet pa leje

Përderisa ndërtimi i hovshëm pas luftës në Kosovë, sidomos në kryeqytet ndihmoi në ngritjen e urbanizimit, gjithashtu ka rezultuar me shumë objekte të ndërtuara pa leje. Kjo ka komprometuar tregun e pronave dhe ka ndikuar në posedim të pasigurt të pronës sepse ndërtesat pa leje nuk mund të regjistrohen në kadastrë ose në mënyrë të ligjshme të transferohen, shfrytëzohen ose të përdoren si kolateral.

Numri më i lartë i ndërtimeve pa leje gjendet në zonat kadastrale Prishtinë, Matëçan, Hajvali dhe Çagllavicë.

Bazuar në regjistrin e ndërtimeve pa leje, në të gjitha vendbanimet e komunës së Prishtinës del se janë 44,771 ndërtime pa leje, prej të cilave 5,873 prej tyre janë në proces të legalizimit. Pjesa e mbetur e objekteve të ndërtuara pa leje duhet të trajtohen sipas Ligjit nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

Tabela 101 Numri i ndërtimeve pa leje sipas vendbanimeve

Vendbanimet	Numri i ndërtimeve pa leje	Vendbanimet	Numri i ndërtimeve pa leje
Prishtinë	24,958	Marec	250
Matëçan	3,306	Besi	242
Hajvali	2,346	Grashticë	234
Çagllavicë	2,138	Koliq	209
Bërnice e Epërme	1,086	Dragoc	200
Barilevë	1,048	Prapashticë	188
Prugoc	976	Siqevë	183
Kolovicë	763	Lebanë	167
Bardhosh	694	Slivovë	151
Llukar	550	Shashkoc	144
Sofali	514	Ballaban	124
Keqekollë	506	Zllatar	117
Vranidoll	454	Tenezhdoll	115
Bërnice e Poshtme	443	Sharban	109
Mramor	408	Glllogovicë	83
Busi	352	Dabishec	70
Makoc	320	Nishec	67
Drenoc	291	Hajkobillë	66
Orlovicë	288	Radashec	27
Rimanishtë	275	Kukaj	23
Trudë	274	Novosellë	12
Gjithsej	44,771		

2.10.8. Problematikat dhe trendet e zhvillimit

Në vendbanimet rurale me perspektivë jo optimiste për zhvillim trendi më i zakonshëm është migrimi drejt Prishtinës çka jep efekte të frenimit të zhvillimit vendor në këto vendbanime. Dobësimi i lidhjes me tokën dhe me mundësinë e zhvillimit të saj në një kontekst rural e stimulon këtë trend jo pozitiv për këto lokalitete.

Në vendbanime ku ka një trend të rritjes së popullatës dhe zhvillimit shtohet tendenca për zgjerim të vendbanimit dhe të shërbimeve në këto vendbanime.

Nga pikëpamja e planifikimit ka një seri problematikash që shfaqen në procesin e hartimit dhe zbatimit të planeve ekzistuese. Së pari në shumë raste ka një mospërputhje midis parashikimeve të PZHU dhe parashikimeve që PRRH të ndryshme kanë planifikuar. Në shumë raste rrjeti rrugor nuk respekton rrjetin rrugor të parashikuar nga PZHU. Gjithashtu edhe parametrat e zhvillimit nuk janë shpesh herë në harmoni midis dokumenteve të planifikimit. Kjo ka sjellë edhe një handicap në zbatimin e këtyre dokumenteve. Në shumë raste PRRH nuk janë bazuar në një projeksion bashkëkohor dhe të përgjithshëm për të gjithë territorin e Prishtinës. Gjithashtu në shumë raste verifikohet që zhvillimi në terren nuk ka marrë trajtat e parashikuara nga dokumentet e planifikimit qoftë PZHU apo PRRH.

Në territor mungon një strukturë e lexueshme e territorit çka vështirëson edhe organizimin e shërbimeve dhe të infrastrukturës në mënyrë bashkëkohore dhe të planifikuar.

Prandaj është e domosdoshme që PZHK si dokument i nivelit më të lartë hierarkik dhe si një akt më i fundit administrativ të shterojë këtë hendek dhe mospërputhje duke përcaktuar përfundimisht parametrat e zhvillimit bazuar në një projeksion më gjithëpërfshirës për Prishtinën si dhe duke lënë detyra të qarta në plotësimin ndryshimin e dokumenteve të planifikimit të niveleve më të ulëta.

*Tabela 102 SWOT analiza - Vendbanimet
Përparësitë*

- **Infrastruktura teknike bazike relativisht e mirë e vendbanimeve në përgjithësi;**
- **Lidhja e mirë e vendbanimeve me qendrën e Prishtinës;**
- **Qasja e mirë e vendbanimeve në shërbime komunale;**
- **Programi 3 vjeçar i banimit;**
- **Banim relativisht i ri;**
- **Rritje e vazhdueshme e shërbimeve publike në disa vendbanime.**

Dobësitë

- **Vendbanime të zhvilluara në formë korridoresh;**
- **Zhvillime të shpërqendruara jashtë zonës urbane**
- **Humbja e tokës bujqësore për shkak të zgjerimit të vendbanimeve;**
- **Parcelimi i madh i pronave në zonën urbane dhe rurale;**
- **Banimi ende jo i përballueshëm për disa shtresa të popullatës;**
- **Banimi social ende i pazhvilluar**
- **Shumë vendbanime paraqesin një dendësi tepër të ulët për të garantuar shërbimet bazë**

Mundësitë

- **Prishtina vazhdon të jetë qendra më atraktive për banim dhe është synim për pjesën më të madhe të migruesve në Kosovë;**
- **Pozicioni gjeografik i Prishtinës në mes të korridoreve rajonale**
- **Vetëdija dhe Vëmendja në rritje e pushtetit qendror;**
- **Potenciali i sektorit privat për banim;**
- **Ligji për “Prishtinën kryeqytet”.**

Rreziqet


- **Trendet e emigrantëve jashtë Kosovës**
- **Rritja e presionit për banim në qytet dhe zvogëlim i madhësisë së familjes (një familje = një njësi banimi)**
- **Klima ‘konfliktuale rajonale’.**

2.11. Banimi

2.11.1. Njësitë e banimit

Banimi është një pjesë e rëndësishme e planifikimit hapësinor, duke pasur parasysh se banimi zë një sipërfaqe të tokës dhe kështu përmban një komponent të dimensionit hapësinor. Mënyra në të cilën zhvillohet banimi në kuptim të llojit dhe madhësisë dhe lokacionit ku ai zhvillohet, ndikon në gjëra të tjera të tilla si arsim, shëndetësi, infrastrukturë, punësim dhe mirëqenie sociale në përgjithësi.

Analiza e fondit të banimit shqyrton trendët ekzistuese në aspektin e sasisë dhe vendndodhjes së ndërtesave të banimit. Sipas Regjistrimit të popullsisë 2011, në Prishtinë ka pasur 59420 njësi banimi, nga këto, 83% e njësive të banimit ishin të vendosura në qendrat urbane dhe 17% gjendeshin në zonat rurale.




Grafika 11 Njësitë e banimit sipas tipit të vendbanimit në Komunën e Prishtinës (Burimi: ASK, 2011)


Shumica e njësive të banimit janë të vendosura në qytetin e Prishtinës por edhe në vendbanimet afër Prishtinës si: Matëçan, Hajvali, Çagllavicë etj., ndërsa koncentrim më i ulët i njësive të banimit është pjesa lindore e komunës.

2.11.1.1. Ndërtesat e pashfrytëzuara dhe mundësia e ripërdorimit të tyre

Sipas grafikës 13, afër 39976 apo 67.3 % të njësive të banimit janë të shfrytëzuara nga një apo më shumë banorë, ndërsa 15402 njësi banimi apo 25.9 % janë të pa banuara (e dedikuara për shitje, qira etj.).



Grafika 12 Banesat sipas llojit dhe statusit të shfrytëzimit në komunën e Prishtinës (Burimi: ASK, 2011)




Grafika 13 Numri i ndërtesave të banimit sipas tipologjisë (Burimi: ASK, 2011)


Varësisht nga tipologjia ndërtesat mund të përfshijnë më shumë se një njësi banimi. Tipologjia e shtëpive të veçuara, është shumë e zakonshme në tërë Kosovën: Kjo reflekton kulturën e jetesës dhe aspiratat e popullatës lokale për të jetuar në shtëpi të mëdha të ndara, me sipërfaqe të konsiderueshme të tokës. Ekziston një trend i vazhdueshëm i ndërtimit të shtëpive të tipit të veçuar, kryesisht nga individ privat për nevojat e tyre, dhe deri në një shkallë të ndërtesave shumëkatëshe të banimit të tipit të bllokut të banesave që kryesisht ndodhen në qendrën e qytetit të Prishtinës dhe në zonën kadastrale të Matiçanit.

2.11.1.2. Trendet e ndërtimit për banim

Niveli i zhvillimit të sektorit të banimit në komunën e Prishtinës ka qenë mjaft i qëndrueshëm që nga viti 1970-1980. Rreth 45% e fondit ekzistues të banimit në Prishtinë është ndërtuar pas luftës së vitit 1999.



Grafika 14 Ndërtesat sipas viteve të ndërtimit në komunën e Prishtinës (Burimi: ASK, 2011)



Grafika 15 Ndërtesat sipas katshmërisë

Sipas grafikës vërehet se afër 28.7% e ndërtesave janë një katëshe, ndërsa mbi 11 mijë apo afër 47% ndërtesave janë dy katëshe.

2.11.2. Banimi social

Komuna e Prishtinës ka bërë përpjekje të vazhdueshme në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të saj. Në vitin 2016 ka përfunduar dy Programe të banesave sociale me qira jo profitabile në Hajvali përmes ndërtimit të 2 blloqeve banesore, secili bllok brenda vetes ka 50 njësi banesore që do të thotë përmes këtij Projekt Programi banesor do të përfitojnë 100 familje.

Gjatë vitit 2017 Komuna e Prishtinës ka ndarë 50 njësi banesore për familjet në nevojë, nga gjithsej 331 familje aplikuese. Këto familje janë akomoduar në ndërtesën e banimit social të ndërtuar në Hajvali të Prishtinës.

Tabela 103 Numri i familjeve përfituese të skemës sociale
Nr. i familjeve përfituese të asistencës sociale

Periudha	Numri i familjeve
2013	1,864 familje me 7,323 anëtarë
2014	1,878 familje me 7,389 anëtarë
2015	1,578 familje me 6,213 anëtarë
2016	1,686 familje me 6,557 anëtarë
2022	1,341 familje me afër 5137 anëtarë ³¹ (raporti nga muaji Gusht 2022)

2.11.3. Gjendja ekzistuese e banimit

Bazuar në vlerësimin e Planit Hapësinor të Kosovës (PHK) 2010-2020+, ekziston sipërfaqe banimi prej 18,65 m² për kokë banori ndërsa madhësia mesatare e familjes është 6.5 anëtarë për familje. Plani raporton se 93,7% e sipërfaqes ekzistuese të banimit është i zënë me banim individual dhe 6,23% nga banimi kolektiv. Sigurimi i sipërfaqes së mjaftueshme të banimit është një nga sfidat kryesore të identifikuar nga PZHK-ja.

Bazuar në numrin e tatimpaguesve në komunën e Prishtinës ekziston 57.70% banim kolektiv; 42.30% individual. Me një zgjerim shumë pasiv të fondit publik të banimit, fondi i banimit është duke u zgjeruar kryesisht nga sektori privat; dhe shpesh karakterizohet me parregullsi dhe mungesë të kriterëve. Andaj, janë identifikuar problemet dhe potencialet në sektorin e banimit.

³¹ <https://ask.rks-gov.net/media/7048/statistikat-e-mir%C3%ABqenies-sociale-gusht-2022.pdf>

Tabela 104 Fondi i banimit (Burimi: Lista e tatimpaguesve të TP, 2018)


Zona Kadastrale	Kategoria	Numri	Sipërfaqja (m ²)
Zona urbane	Apartament	34,769	2,554,748
	Shtëpi	22,464	3,133,142
Zona rurale	Apartament	7,547	596,954
	Shtëpi	8,561	1,168,014

Ndërtesat e vjetra të banimit me shumë njësi si ato të ndërtuara nga viti 1954 e tutje, vlerësohen të jenë në gjendje jo të mirë fizike. Struktura e objekteve të tilla është kryesisht e dëmtuar nga dëmet e krijuara në suvatimin e mbështjellësit të ndërtesave, mbindërtimet pa leje dhe hapjet e mureve të jashtme apo rrezimet e mureve të brendshme në katet përdhese duke dëmtuar objektet. Gjithashtu, paraqitet nevoja për rinovim të instalimeve elektrike, instalimeve të ngrohjes dhe ashensorëve.

Me iniciativë të Komunës së Prishtinës përmes ndërmarrjes Publike Banesore, blloqe të vjetra të banimit me shumë njësi kanë filluar të mirëmbahen. Atyre u bëhet fasadimi, rregullohet ndriçimi i përbashkët, riparimi i dritareve, pastrimi i ollukëve, vendosja e ashensorëve etj. Në mënyrë që të gjitha problemet me ndërtimë relativisht të vjetra të arrijnë në nivelin e kënaqshëm, përgjegjësia nuk do të duhej të mbetej vetëm te autoritetet komunale. Pikërisht banorët, që edhe posedojnë këto banesa, duhet të luajnë një rol qendror në procesin e rinovimit të tyre.

2.11.3.1. Ndërtimet e reja

Është evidente se në shumë pjesë të qytetit, e veçanërisht në lagjet si Matë 1, Kalabria, Arbëria e në zonat kadastrale Hajvali, Çagllavicë e Bernicë e Epërme, vërehet qartë një aktivitet i dendur në ndërtimë të reja. Numri i lejeve ndërtimore të dhëna që nga viti 2012 deri në vitin 2022 (shtator), për ndërtim të objekteve është 1607 leje³². Në krahasim me komunat tjera, ky numër është i lartë.



Grafika 16 Numri i lejeve ndërtimore në komunën e Prishtinës

Aktualisht sipas të dhënave nga komuna e Prishtinës lëshohen mesatarisht 150 leje për ndërtimë të reja në vit. Nëse supozojmë që 50% e këtyre lejeve është për ndërtimë shumë banesore, dhe mesatarja e njësive të banimit për ndërtesa shumë banesore është 30, llogaritet që çdo vit fondi i banimit në komunë të rritet për rreth 2500 njësi të banimit.

2.11.4. Numri i njësive të banimit sipas projeksioneve

Komuna e Prishtinës, në veçanti në zonën urbane, duhet të planifikojë njësitë e reja të banimit bazuar në parashikimet demografike dhe në harmoni me trendin e zvogëlimit të madhësisë së ekonomisë familjare.

Bazuar në parashikimet për rritje të popullsisë (kapitulli për demografi), deri në vitin 2031 parashikohet rritje përafërsisht prej 71,000 banorë në komunën e Prishtinës (duke i përfshirë edhe

³² <https://prishtinaonline.com/drejtore/urbanizmit-ndertimit/lejet-e-leshuara/lejet-2020>

personat që janë në lëvizje afër 56,000 banorë). Numri i ekonomive familjare parashikohet të rritet përafërsisht për 17,750 ekonomi familjare.

Vlen të ceket fakti që projeksionet për numrin e njësive të banimit në komunën e Prishtinës i bërë më lartë, nuk ka marrë parasysh edhe nevojat për banim që mund të rezultojnë nga trendët e ndryshme të zhvillimit ekonomik në kryeqytet. Hapja e vendeve të reja të punës në sektorët kryesor ekonomik në kryeqytet do të tërheqin qytetarë nga e gjithë Kosova dhe rrjedhimisht nevojat për njësi të banimit do të rriten në masë të madhe. Pavarësisht numrit të konsiderueshëm të njësive të banimit të pa shfrytëzuara në komunë, vlerësohet se trendët e zhvillimit ekonomik në sektorin e teknologjisë, arsimit dhe shkencës do të ndikojnë dukshëm në rritjen e kërkesave për banim nga banorë të rinj potencial të kryeqytetit.

2.11.5. Banimi i përballueshëm

Nevojat për banim janë më tepër se sa të rasteve sociale, duke marrë parasysh se çmimi mesatar i një njësie banimi është 800 euro/m². Ngase edhe shumë familje të cilët kanë ndonjë anëtar të punësuar, janë në pamundësi që të ndërtojnë shtëpi apo të blejnë banesë dhe kanë nevojë për një mundësi më të përballueshme të sigurimit të banesës me një qira të përballueshme.

Sipas kërkesave zyrtare në Komunën e Prishtinës, numri i familjeve të cilat kërkojnë strehim, meremetim dhe ndërtim të shtëpisë deri më tani është 281.

2.11.6. Vlerësimi i gjendjes

Sa i përket banimit, duke ju referuar të dhënave për strukturat e ndërtuara, 72% janë të destinuara për banim, të cilat janë të ndara në 3 kategori: në Banim individual; Banim kolektiv; dhe në Banim me funksione të tjera në pajtueshmëri. Ndërsa në aspektin e shfrytëzimit të tokës banimi i lartë përbën mbi 57% të të gjithë sektorit të banimit. Sa i përket njësive të banimit në dispozicion, del se 26% e tyre janë të pa-shfrytëzuara, prandaj është e domosdoshme që në të ardhmen planifikimi i njësive të reja të banimit të bëhet në bazë të parashikimeve demografike, por edhe duke përcjellë trendin e rritjes së ekonomive familjare.

Në Prishtinë ka një tendencë në rritje për banim për shkak të përqendrimit të popullsisë dhe rritjes së pretendimit për cilësi më të mirë banesore. Është interesant të shihet që nga njëra anë ka një tendencë për intensifikim të ndërtimit banesor e cila reflekton nevojitën për të ofruar banim më çmime të përballueshme për banorët, dhe nga ana tjetër ndërtime që shtrihen në periferi me karakter banim individual dhe kryesisht për shtresa që kërkojnë dhe përballojnë një cilësi më të lartë ndërtimi banesor.

Trendet e tilla, prej të cilave derivojnë kërkesat e ardhshme për banim, në vete përmbajnë edhe gjëra të tjera, si:

- rritjen e numrit të familjeve që migrojnë në Prishtinë;
- madhësia e familjeve zvogëlohet (anëtarë/familje);
- rritjen e të ardhurave familjare;
- numër i lartë i banesave të ndërtuara;
- çmimet e banesave ndryshojnë nga lagje në lagje.

Në Komunën e Prishtinës, në aspektin e banimit social, situata është relativisht e mirë, por kemi 281 kërkesa aktive për strehim. Komuna deri tani ka punuar vetëm në drejtim të ofrimit të banimit për rastet e rënda sociale, përmes programeve të banesave sociale me qira jo-profitabile. Deri tash ka ofruar banim për 100 familje në vitin 2016, dhe 50 familje të tjera në vitin 2017. Sa i përket kategorive tjera të banimit, si ai i përballueshëm, deri me tani nuk ka ndonjë projekt konkret për këtë grup. Megjithatë, shihen tendencat e komunës për planifikim për këto kategori, përmes iniciativës së Ndërmarrjes Publike Banesore me koncept projektin Lagjja Model, në Bërnice.

Vlerësohet se tematika e banimit si një element kyç për cilësi të mirë të jetës së gjithë qytetarëve, sidomos me diversitetin e madh të banorëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve të kryeqytetit, duhet të trajtohet në mënyrë më të detajuar me strategji të banimit në nivel lokal ku edhe bëhet vlerësimi i nevojave për banim në komunë në vazhdimësi.

Sa i përket dendësisë së banorëve për vendbanim vërehet se dendësia më e lartë e popullsisë është në qytetin e Prishtinës, ku mesatarisht jetojnë rreth 4753 banorë në një km².

Tabela 105 SWOT analiza - Banimi
Përparësitë

Dobësitë

• Ndërtimi i banesave të reja; • Përkushtimi i fuqishëm nga administrata për zgjidhjen e çështjeve të banimit; • Fond me banesa relativisht të reja dhe të ndërtuara duke përdorur material të cilësisë së mirë; • Iniciativa për zhvillimin e banimit për familje me të hyra të ulëta (banim i përballueshëm financiarisht); • Ligji për financimin e Programeve të Veçanta të Banimit; • Rregullorja e komunës për banim social.	• Një numër i njësive të banimit nuk i plotësojnë standardet hapësinore të banimit; • Mungesa e politikave dhe strategjive të banimit; • Niveli i ulët i fondeve financiare për banim social; • Mungesë e tokës për ndërtim me infrastrukturë përkatëse për banim social; • Shkalla a madhe e ndërtimeve pa leje; • Mungesa e themelimit të Shoqatave të Pronarëve për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi; • Mungesa e sektorit të Banimit • Mos përkrahja e donatoreve; për ndërtimin e objekteve për banim social; • Ndërtime intensive, veçanërisht që nga viti 2000, prezenca e ndërtimeve të paplanifikuara dhe joformale.
Mundësitë	Kërcënimet
• Planifikimi kompakt i zonave të banimit; • Mundësi për rritje të densitetit të banimit; • Kampanjë komunale për leje ndërtimore; • Kampanjë komunale dhe menaxhim i procesit të legalizimit.	• Supozohet se modelet tradicionale të banimit, me shumë gjenerata - familje të mëdha, do zvogëlohen e me këtë do të rriten kërkesat shtesë për banim individual; • Tendenca për ndërtimin e banimit pa planifikim përkatës dhe pa leje ndërtimore.

Sfidat:

- Kontrollimi i zhvillimit jashtë zonës urbane, në zonat rurale;
- Zhvillimi i pa balancuar i vendbanimeve;
- Ruajtja e zonave të banimit brenda vendbanimeve përkitazi me planet hapësinore;
- Koncentrimi i kontrollit të zhvillimeve për industri në zonën industriale ekzistuese ;
- Mungesa e politikave lokale fiskale për rregullimin e banimit të përballueshëm;
- Balancimi i kërkesës për banim me ndërtimet e reja në dispozicion (fondi aktual banesor);
- Menaxhimi i presionit në zona të caktuara për ri-zhvillim - Kërkesat e mëdha të qytetarëve dhe ndërtuesve/investitorëve për objekte shumë banesore në zonën urbane;
- Moszbatimi i politikave dhe strategjive për banim në nivel qendror dhe lokal;
- Menaxhimi dhe mirëmbajtja e dobët e ndërtesave të banimit në bashkëpronësi;
- Nevoja për formimin e Divizionit për Banim, në kuadër të Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm;

- Sigurimi i banimit të përshtatshëm (social dhe i përballueshëm) për familjet me të ardhura të ulëta dhe familjet tjera;
- Mungesa e Fondit të Banimit në nivel qendror;
- Rritja e banimit përgjatë rrugëve; shfrytëzimi jo racional i hapësirës;
- Lidhja ndërmjet banimit individual dhe kolektiv në zonat urbane.

Nevojat zhvillimore:

- Hartimi i Ligjit për Banim;
- Politikat për banim dhe zhvillim urban;
- Rritja e banimit për t'i përmbushur kërkesat;
- Interesi i sektorit privat për investime;
- Krijimi dhe menaxhimi i politikave të qerasë për banesa, lokale dhe tokë ndërtimore (prona komunale).

2.12. Shfrytëzimi i tokës

Komuna e Prishtinës ka një sipërfaqe totale prej 53,222 ha, nga e cila 59.9% janë pyje dhe kullosa, 21.73% janë tokë bujqësore, 7.87% banim i përhershëm, 1.61% rrjetet rrugore, 0.1% industri dhe pjesa tjetër e territorit të komunës shfrytëzohet nga kategori të tjera si në tabelën më poshtë.

Në vazhdim janë të paraqitura të gjitha shfrytëzimet ekzistuese të territorit të Komunës së Prishtinës në sipërfaqe për hektar si dhe në përqindje.

Tabela 106 Shfrytëzimi tokës sipas sipërfaqeve (ha) dhe përqindjes (Burimi: Ortofoto 2018)

	Sipërfaqja (ha)	Përqindja
Trupat ujore sipërfaqësore	217.193	0.408%
Banim	4209.829	7.909%
Toka bujqësore	10693.956	20.09%
Infrastruktura publike/sociale	490.305	0.921%
Zonë e mbrojtur	1,948.876	3.661%
Zonë e veçantë e mbrojtur	55.157	0.103%
Zonë komerciale	394.674	0.743%
Infrastruktura rrugore	846.36	1.59%
Zonë e mbrojtur arkeologjike/historike	204.621	0.384%
Toka pyjore	31868.450	59.88%
Zonë minierë sipërfaqësore	44.292	0.083%
Tokë kalimtare	1701.918	3.19%

Zonë rekreative turistike	82.844	0.16%
Zonë ushtarake e sigurisë	87.67	0.164%
Zonë teknologjike	25.272	0.047%
Zonë industriale	58.382	0.11%

Sipërfaqja pyjore në Komunën e Prishtinës ndahet në dy lloje, të shfrytëzimeve ekzistuese, si tokë pyjore me 31868.450 ha dhe zonë e mbrojtur që përfshinë Parkun e Gërmisë me sipërfaqe prej 1,949 ha, ku së bashku këto zona formojnë një sipërfaqe pyjore prej 33,817.326 ha apo 63.541% e gjithë territorit të komunës së Prishtinës.

Sipërfaqet bujqësore shtrihen kryesisht në vendbanimet në veri të zonës urbane të komunës, ku edhe është i shtrirë rrjeti i sistemit të ujitjes nga Ibër Lepenci. Këto vendbanime përfshijnë Orlovicën, Bërnicën e Poshtme, Bardhoshin, Drenocin, Barilevën, Prugocin, Besinë dhe Lebanën. Gjithashtu në jug-lindje të komunës së Prishtinës, vendbanimi i Kukavicës, Marecit, Dragocit, Slivovës dhe Busisë kanë sipërfaqe të mëdha bujqësore.

Sipërfaqet e ndërtuara janë të shtrira në tërë territorin e komunës, mirëpo vendbanimet me më së shumti sipërfaqe të tilla janë Prishtina, Matëçani, Çagllavica, Hajvalia, Orloviçi, Kolovica dhe Sofalia të cilat përbëjnë zonën urbane të kryeqytetit, dhe të gjitha vendbanimet nëpër të cilat kalon rruga rajonale që lidhë komunën e Prishtinës me atë të Podujevës.

Sipërfaqet ujore në komunë përbëhen nga rrjedhat e lumenjve si Sitnica, Llapi, Prishtevka e Vellusha, por edhe nga dy liqenet Badoci i cili shtrihet në jug të komunës, përkatësisht në vendbanimin Novosellë dhe Batllava i cili shtrihet në veri të komunës, në vendbanimin e Ballabanit.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shfrytëzimet e tokës sipas vendbanimeve në komunën e Prishtinës:

Tabela 107 Shfrytëzimi aktual i tokës sipas vendbanimeve

Vendbanimi	Sipërfaqe Bujqësore	Sipërfaqe Pyjore	Sipërfaqe ndërtuar	e Sipërfaqe rrugore
Prishtinë	464.89	36.82	2608.51	249.40
Matëçan	48.38	63.16	819.03	38.59
Hajvali	270.43	178.17	362.64	21.27
Çagllavicë	397.56	0	638.30	62.19
Kolovicë	37.98	508.52	250.99	10.70
Bardhosh	359.51	0	144.28	11.69
Barilevë	460.14	419.65	117.01	7.52
Prugoc	204.12	52.26	130.83	9.72
Sofali	0.79	691.12	90.07	11.13
Bërnice e Epërme	198.47	441.13	187.37	12.47
Llukar	120.91	522.57	114.43	9.23
Mramor	648.10	2993.51	105.24	30.33
Vranidoll	170.62	502.08	61.54	5.99
Orloviq	98.73	0	110.78	8.72
Makoc	92.83	985.67	52.10	6.01
Busi	389.29	1178.08	53.12	13.20
Besi	125.25	250.01	47.26	3.18
Trudë	131.40	393.59	56.84	5.44

Tabela 108 Diferenca në mes të shfrytëzimit aktual të tokës sipas PZHK 2012 dhe shfrytëzimit aktual të tokës në vitin 2020

Kategoria shfrytëzimit	e Sipas PZHK – 2012-2022 sip/ha	Sipas Shfrytëzimit Aktual sip/ha	Diferenca në ha	Diferenca në %
Tokë bujqësore	20358.03 ha	10693.95 ha	-9,664.08 ha	-52.529%
Tokë pyjore	30000.08 ha	33,817.32 ha	3,817.24 ha	+10.2%

Në mungesë të informacioneve nga Plani Zhvillimor Komunal 2012 – 2022 në fuqi, janë siguruar informacione nga programi Urban Atlas Copernicus për sipërfaqet me shfrytëzim Tokë bujqësore, Banim, Pyje dhe Infrastrukturë rrugore për vitin 2012, kjo për një analizë më të saktë rreth shfrytëzimit të tokës.

Tabela 109 Diferenca në mes të shfrytëzimit të tokës sipas Urban Atlas Copernicus dhe shfrytëzimit aktual të tokës në vitin 2020

Kategoria shfrytëzimit	e Sipas Urban Atlas Copernicus, Viti - 2012 sip / ha	Sipas Shfrytëzimit Aktual sip / ha	Diferenca në ha	Diferenca në %
Tokë bujqësore	17621.78	10693.95 ha	-6,927.83	-39.31%
Banim	2511.78	4209.82 ha	1,698.04	+67.60%
Pyje	29.698.44	33,817.32 ha	4,118.88	+13.86%
Infrastruktura rrugore	635.82	846.36 ha	211.54	+33.27%

Nga të dy tabelat vërehet qartë **humbja e tokës bujqësore gjatë viteve 2012-2020.**

2.12.1. Vlerësimi i gjendjes

Gjatë analizës së profilit për komunën e Prishtinës kemi disa gjetje kyçe në të gjitha fushat e shfrytëzimit të Tokës.

Sfidat kryesore për sa i përket shfrytëzimit të tokës kanë të bëjnë me zhvillimin e pakontrolluar të ndërtimit dhe atë të shprehur në dy forma:

1. Humbja e tokës bujqësore nga ndërtimet e objekteve të banimit dhe atyre të afarizmit. Ky fenomen Komunës së Prishtinës i ka kushtuar me humbjen e gati 9000 ha tokë bujqësore vetëm gjatë periudhës 2012-2020.
2. Zhvillimi i vendbanimeve edhe jashtë kufijve ndërtimor të përcaktuar me PZHK 2012-2020 edhe përkundër faktit që kufijtë ndërtimorë ishin më se të mjaftueshëm për nevojat zhvillimore të projektuara. Në këtë kontekst kemi vendbanime të cilët nuk janë zhvilluar brenda kufinjëve ndërtimor edhe përkundër hapësirës së lirë të mjaftueshme, por kanë dalur jashtë atyre kufijve.

Gjithashtu edhe projekcioni demografik për vitin 2031 bashkë me nevojat për banim dhe aktivitete ekonomike konform këtij projekcioni diktojnë faktin që nuk ka nevojë për zgjerim të kufijve në vendbanimet rurale. Prandaj, kjo PZHK duhet të parasheh konsolidim të sipërfaqeve të ndërtuara nëpër vendbanime, duke përcaktuar kufijtë ndërtimor dhe rrjedhimisht duke mbrojtur resurset natyrore të komunës si tokën bujqësore dhe atë pyjore.

Tabela 110 SWOT analiza - Shfrytëzimi i tokës
Përparësitë

- **Struktura urbane është kompakte,**
- **Qendra e qytetit është e fuqishme.**
- **Rritje e sipërfaqeve Komerciale për 209.38 ha për periudhën 2012 deri 2020.**
- **Sipërfaqe Ujore/Liqej atraktiv me**

Dobësitë

- **Shpërndarja urbane dhe shfrytëzimi joefikas në periferi.**
- **Buxheti i ulët për shpronësime, duke marrë parasysh rritjen e vlerës së tokës.**
- **Ndërtimet ilegale në tokë bujqësore dhe**

sipërfaqe prej 144.79 ha.

- *Zona rekreative dhe turistike me sipërfaqe 144.04 ha dhe zona të tjera me potencial të lartë për këto zhvillime.*
- *Zbatimi i veprimeve që dalin nga Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban*
- *Gjithsej 28 zona kadastrale me mbi 150 ha sipërfaqe të tokës Pyjore.*

humbje e tokës bujqësore me një sipërfaqe prej - 3169.96 ha.

- *Fragmentimi i tokës bujqësore në parcela të vogla.*
- *Mungesa e konsolidimit të tokës (komasacionit).*
- *Vendbanime me shtrirje të shpërndarë.*
- *Vendbanime me shtrirje lineare përgjatë rrugëve kryesore.*
- *Krijimi i korridoreve të zonave ekonomike në mënyrë të pa kontrolluar.*
- *Mungesa e sistemit të ujitjes dhe infrastrukturës rrugore për tokën bujqësore.*
- *Humbje e tokave bujqësore*

Mundësitë	Rreziqet
• <i>Ndërprerja e ndërtimeve në zonat bujqësore.</i> • <i>Përcaktimi i kufijve ndërtimor në zonat urbane, zhvillim i kontrolluar i ndërtimeve si dhe densifikim i hapësirave të lira për ndërtim në zonë urbane.</i> • <i>Përcaktimi i kufijve ndërtimor në zonat rurale, zhvillim i kontrolluar i ndërtimeve.</i> • <i>Përcaktimi dhe mbrojtja e zonave bujqësore</i> • <i>Përcaktimi i zonave për konsolidim të tokave bujqësore</i> • <i>Caktimi i zonave turistike për turizëm veror dhe dimëror si dhe mundësi zhvillimi të agroturizmit në disa fshatra.</i>	• <i>Ndërtimet pa leje përgjatë rrugëve në vendbanime rurale.</i> • <i>Humbja e tokës bujqësore</i> • <i>Humbja e tokës pyjore.</i> • <i>Krijimi i vendbanimeve të shpërndara dhe lineare.</i> • <i>Vështirësim deri në pamundësim të aplikimit të masave komasative në tokën bujqësore</i> • <i>Rritje e pakënaqësisë qytetare.</i>

2.13. Kapacitetet financiare

Në përputhje me kërkesat ligjore, Komuna e Prishtinës ka hartuar KAB-in me të cilën është planifikuar buxheti dhe orientimi i shpenzimeve publike në tri vitet e ardhshme 2021-2023, si dhe parashikimet deri në vitin 2031. Planifikimi i politikave në nivel komunal, është bazuar kryesisht në të dhënat e përgjithshme për rritjen buxhetore në nivel të Qeverisë qendrore, siç parashihet në KASH 2021-2023, si dhe bazuar në nevojat zhvillimore drejt sektorëve prioritarë të komunës.

Në bazë të planifikimeve, shpenzimet buxhetore për Komunën e Prishtinës do të shënojnë rritje graduale për tre vitet e ardhshme, ndërsa vërehet se buxheti nuk do të pësojë ndryshime të theksuara në strukturën e tij. Krahas rritjes së tërësishme të buxhetit të komunës, shpenzimet kapitale dhe subvencionet gjatë kësaj periudhe tre vjeçare do të shënojnë ngritje të pjesëmarrjes në strukturën e tërësishme të buxhetit. Sipas planifikimeve, buxheti i komunës së Prishtinës deri në vitin 2031 do të shënoj një rritje rreth 27%.

Tabela 111 Pasqyra dhe trendet e planifikimit të buxhetit sipas kategorive ekonomike (Burimi: Ligji për buxhetin e Republikës së Kosovës)

Kategoria ekonomike:	Buxheti i planifikuar- viti:							
	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Rroga dhe paga:	27,050,00	28,108,7	28,044,5	30,277,1	31,704,2	31,897,3	32,014,90	31,300,00
Mallra dhe shërbime:	7,385,405	7,393,19	7,637,91	13,432,7	18,011,4	19,962,5	20,100,00	21,198,93
Shpenzime komunale:	1,793,000	1,793,00	1,793,00	1,793,00	2,000,00	2,000,00	2,100,000	2,200,000
Subvencione dhe transfere:	2,210,000	1,816,81	1,816,81	1,816,81	6,063,02	11,280,9	4,000,000	4,786,215
Shpenzime kapitale:	24,268,35	26,772,0	22,731,3	24,954,2	29,955,0	26,685,0	28,592,83	31,184,18
Gjithsej:	62,706,75	65,883,7	62,023,6	72,273,9	87,733,8	91,825,7	86,807,74	90,669,33

Tabela 112 Pasqyra dhe trendet e shpenzimit të buxhetit sipas kategorive ekonomike (Burimi: Draft raporti i auditimit për pasqyrat financiare)

Kategoria ekonomike:	Buxheti i shpenzuar- viti:							
	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Rroga dhe paga:	27,404,64	27,900,6	28,128,9	29,420,5	30,008,5	30,895,8	31,449,32	22,183,76
Mallra dhe shërbime:	9,008,155	7,418,32	7,834,54	11,619,4	15,596,5	18,828,4	19,474,94	16,304,65
Shpenzime komunale:	2,079,910	1,791,29	1,776,48	1,784,54	2,351,81	1,829,70	1,987,860	1,509,384
Subvencione dhe transfere:	1,621,155	1,655,65	1,506,07	1,715,57	11,847,9	2,073,43	9,973,053	4,621,177
Shpenzime kapitale:	24,411,61	20,008,8	17,803,5	16,793,4	18,845,7	16,636,3	17,410,32	4,731,208
Gjithsej:	64,525,48	58,774,7	57,049,5	61,333,5	78,650,5	70,263,8	80,295,51	49,350,19

Tabela 113 Pasqyra dhe trendet e shpenzimit të të hyrave vetanake sipas kategorive kryesore (Burimi: Raporti i zyrtarit për të hyra)

Kategoria e të hyrave vetanake:	Të hyrat- viti:							
	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Tatimi në pronë:	5,623,402	7,176,27	6,961,32	6,975,29	7,601,29	6,220,48	10,659,13	6,909,429
Regjistrimi i automjeteve:	530,345	563,650	597,125	625,917	647,850	651,003	721,405	562,478
Lejet e ndërtimit:	6,536,565	10,546,5	9,697,72	7,877,04	9,747,95	9,226,06	13,176,30	8,039,556
Regjistrimi i trashëgimisë:	581,153	649,950	665,851	759,900	896,851	786,151	1,223,700	790,650
Ndërrim i destinimit të tokës:	458,045	508,999	518,241	697,186	1,157,09	991,241	1,214,857	964,597
Dokumentet e gjendjes civile:	265,282	302,087	301,075	290,052	300,866	192,607	267,688	177,069
Veprimtaritë afariste:	78,668	83,887	70,180	63,227	49,750	89,850	107,100	99,050
Shfrytëzimi i pronës publike:	989,231	1,122,53	849,158	575,616	306,070	35,499	52,927	39,291
Participimet në Arsim dhe	1,319,463	1,314,41	1,226,10	1,160,09	1,142,61	794,079	1,067,348	825,076
Tjera:	1,870,118	2,174,30	3,646,68	10,981,7	9,566,24	5,849,40	6,938,138	3,385,546
Gjithsej:	18,252,27	24,442,6	24,533,4	28,486,2	31,416,5	24,836,3	35,428,60	21,792,74

Tabela 114 Pasqyra dhe trendet e të hyrave vetanake sipas inkasimit (Burimi: Raporti i zyrtarit për të hyra)

Të hyrat - viti								
Kategoria e të hyrave vetanake:	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Direkte	16,955,104	23,587,571	22,732,137	24,035,333	26,827,106	24,836,384	35,428,601	21,792,740
Indirekte	1,297,168	855,091	1,801,334	4,450,904	4,589,491	1,445,895	2,000,270	1,552,514
Gjithsej	18,252,273	24,442,662	24,533,471	28,486,236	31,416,597	26,282,279	37,428,870	23,345,254

Tabela 115 Pasqyra dhe trendet e donacioneve sipas prejardhjes (Burimi: Raporti i zyrtarit për të hyra)

Donacionet - viti								
Kategoria e të hyrave vetanake:	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Të brendshme	-	-	-	1,500	-	-	-	-
Të jashtme	215,656	199,002	80,868	77,038	16,545	79,741	71,973	34,897
Gjithsej	215,656	199,002	80,868	78,538	16,545	79,741	71,973	34,897

Tabela 116 Pasqyra dhe trendet e shpenzimeve kapitale sipas sektorëve (Burimi: Raporti financiar buxhetor i komunës së Prishtinës)

Shpenzimet kapitale - viti								
Spektori	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Infrastruktura sociale dhe publike:	1,816,544	4,952,181	3,385,424	4,321,978	5,214,206	3,548,248	2,512,637	921,734
Infrastruktura transportuese:	5,798,193	11,825,124	8,182,612	8,625,370	10,105,823	8,927,929	11,087,448	3,566,581
Infrastruktura teknike:	16,796,879	3,231,561	6,235,489	3,846,126	3,525,716	3,944,942	3,810,236	242,893
Gjithsej:	24,411,616	20,008,865	17,803,525	16,793,474	18,845,745	16,421,119	17,410,321	4,731,208

Tabela 117 Buxheti për vitin 2021 vlerësimet për vitin 2022 dhe 2023 si dhe parashikimet deri vitin 2031

Nr	Kategoria ekonomike	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028	Viti 2031
1	Paga dhe shitesa	€32,014,905	€31,300,000	€32,470,000	€32,632,350	€32,795,512				
2	Mallra dhe shërbime	€20,100,000	€21,198,930	€25,000,000	€26,000,000	€27,000,000				
3	Shpenzime komunale	€2,100,000	€2,200,000	€2,700,000	€2,800,000	€2,900,000				
4	Subvencione	€4,000,000	€4,786,215	€5,150,000	€5,500,000	€5,800,000				
5	Investime kapitale	€28,592,837	€31,184,188	€40,355,981	€45,292,943	€48,709,220				
	Totali	€86,807,741	€90,669,333	€105,675,981	€112,225,293	€117,204,732				

Tabela 118 Diferencat buxhetore sipas viteve deri në vitin 2031

Nr	Kategoritë ekonomike	Diferenca /2022/2021	Diferenca /2023/2022	Diferenca /2024/2023	Diferenca /2025/2024	Diferenca /2026/2025	Diferenca /2027/2026	Diferenca /2028/2027	Diferenca /2031/2028
1	Paga Dhe Mëditje	€714,905	€1,170,000	€162,350	€163,162				
2	Shërbime Dhe Mallra	€1,098,931	€3,801,070	€1,000,000	€1,000,000				
3	Shpenzime Komunale	€100,000	€500,000	€100,000	€100,000				
4	Subvencione	€786,215	€363,785	€350,000	€300,000				
5	Investime Kapitale	€2,591,352	€9,171,793	€4,936,962	€3,416,277				
	Totali	€5,291,402	€15,006,648	€6,549,312	€4,979,439				

3. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Korniza e Zhvillimit Hapësinor të Komunës së Prishtinës paraqet zhvillimet e planifikuara dhe orientimet e zhvillimit socio-ekonomik, infrastrukturor dhe hapësinor në të ardhmen. Caqet e zhvillimit afatgjatë janë përcaktuar përmes një bashkëpunimi dhe pjesëmarrje në diskutime e debate gjithëpërfshirëse. Ndërsa e gjithë kjo është realizuar në bazë të vlerësimit të gjendjes ekzistuese të komunës, SWOT analizës si dhe kapaciteteve zhvillimore dhe investuese të komunës.

Vizioni i PZHK-së 2023-2031 së Prishtinës ndjek parimet dhe udhëzimet e agjendave dhe konventave ndërkombëtare për planifikim të qëndrueshëm. Ky vizion ka për synim të krijojë një qytet që ndjek një zhvillim ekonomik, social dhe mjedisor të qëndrueshëm, duke u bazuar në parimet e Agjendës Habitat III të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Agjendës 2030 – Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (Sustainable Development Goals – SDGs), si dhe Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike (United Nations Framework Convention on Climate Change - UNFCCC). Në këtë vizion, planifikimi hapësinor i Prishtinës do të jetë i përqendruar dhe i koordinuar në ndërtimin e infrastrukturës së qytetit, përdorimin e qëndrueshëm të hapësirave të ndërtimit, mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit, qasjen e barabartë të qytetarëve ndaj shërbimeve dhe burimeve natyrore, si dhe promovimin e energjisë së ripërtëritshme dhe ndërtimin e një ekonomie dhe shoqërie të qëndrueshme. Ky vizion shpreh përkushtim ndaj zhvillimit të qëndrueshëm të Prishtinës, duke ndjekur udhëzimet dhe parimet e agjendave dhe konventave ndërkombëtare për planifikim të qëndrueshëm.

3.1. Vizioni

Territori i Komunës së Prishtinës 20 vitet e fundit është zhvilluar duke u bazuar në përcaktimet hapësinore të planeve paraprake, si atyre të nivelit qendror, edhe atyre të nivelit lokal.

Vizionet për Prishtinën ndër vite kanë rrjedhë nga vizioni i dhënë për regjionin e Prishtinës, sipas Planit Hapësinor të Kosovës (PHK) që identifikon regjionin, si:

“Porti i Kosovës (Hapësirë e kaltër) - Zonë e gjallë dhe me prosperitet, ku qytetet tentojnë zhvillimin e vazhdueshëm të planifikuar urban, konkurrenë me njëra tjetrën e në të njëjtën kohë të bashkuara e kooperative, atraktive për të jetuar dhe punuar në to. Prishtina si kryeqytet, me seli të qeverisë dhe zyrave diplomatike, lidhje të mira me qytetet fqinje kosovare dhe ato jashtë kufijve, përmes rrjetit të infrastrukturës fizike (rrugore, hekurudhore, ajrore, energjetike) si dhe asaj administrative dhe institucionale. Të lidhura në rrjet, qytetet në këtë zonë krijojnë kushte të volitshme për veprimtari ekonomike, industriale, komerciale dhe shërbuese. Në qendër të zonës së kaltër, parashihet TZHEK - Trekëndëshi i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, si kurriz i zhvillimit ekonomik me interes kombëtar, burim i të ardhurave për ekonominë kosovare si dhe zonë e mundshme për investitorët e kompanive ndërkombëtare. Arsyet për një përcaktim të tillë të zhvillimit të ardhshëm hapësinor të TZHEK-ut janë: 1) afërsia e qytetit të Prishtinës si qendër e ardhshme më e madhe administrative, arsimore, shkencore dhe shërbuese në Kosovë si vend i mundshëm joshës për investitorë të vendit dhe të huaj, 2) korridoret kryesore të infrastrukturës rrugore, hekurudhore, ajrore, telekomunikimeve dhe energjisë, 3) Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës si pikë strategjike për ndërlidhje me botë në aspektin e shkëmbimit të mallrave dhe njerëzve 4) Afërsia e korridoreve evropiane.”³³

³³ Planit Hapsinor i Kosovës 2010-2020+

Duke u bazuar në këtë plan dhe këtë përcaktim për Komunën e Prishtinës, kanë ndërtuar vizionet nëpërmjet të cilave është zhvilluar komuna deri tash, Plani Zhvillimor Komunal dhe Plani Zhvillimor Urban. Më saktësisht këto plane e shohin Prishtinën si:

***“Prishtina - port i regjionit urban metropolitan, funksionale dhe e integruar, e administruar dhe me qeverisje të mirë; Port i gjelbër, me ekonomi të njohurive, i shkëmbimeve kulturore, diplomacisë, konkurrencte në regjion.”**³⁴*

***“Prishtina, kryeqyteti i Kosovës, me një rol metropolitan, i njohur për zhvillimin ekonomik, urbanizmin modern dhe efikas, shërbimet cilësore, i integruar mirë në proceset rajonale dhe internacionale, qendër e pasur kulturore, edukative dhe sportive, me shërbime të fuqishme intelektuale dhe financiare, si dhe jetë cilësore për të gjithë qytetarët e saj.”**³⁵*

Përveç planeve ekzistuese dhe planifikimeve strategjike, korniza e zhvillimit hapësinor të Prishtinës, duhet të bazohet edhe në përcaktimet e dala nga Ligji nr. 06/I-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën, ligj i cili rregullon organizimin dhe funksionimin e Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, i cili ka status të veçantë juridik sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ky Ligj përcakton se “Territori i Kryeqytetit është i njëjtë me territorin e Komunës së Prishtinës të përcaktuar me Ligjin përkatës për caktimin e Kufijve Administrativ të Komunave”.³⁶ Sipas këtij neni, çdo planifikim në këtë Projekt duhet me doemos të parasheh gjithë sipërfaqen e Komunës, si territor me interes për zhvillimin e Prishtinës, por edhe më gjerë, interes qendror.

Të gjitha analizat, vlerësimet, trendët, projeksionet, prognozat dhe konkludimet, rezultuan se Prishtina duhet të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme, duke planifikuar zhvillim të zonave të banimit, zonave industriale, rekreative, turistike, që të jenë pozitive për mjedisin, ekonominë dhe mirëqenien e popullsisë, sot dhe në të ardhmen. PZHK duhet të sigurojë zhvillim të balancuar, me kusht që zhvillimet ekonomike të mos jenë në konflikt me fushat tjera siç janë: mjedisi, shëndeti dhe siguria e popullatës.

Duke u bazuar në atë se çka parasheh niveli qendror për komunën, por edhe idetë e potencialet e nivelit komunal, është konstatuar se Komuna e Prishtinës do të zhvillohet bazuar në vizionin konkret të përcaktuar më poshtë :

“Prishtina praktike, e pastër, e gjelbër dhe e përjetimeve”

Prishtina praktike – Qendër metropolitane me zhvillim dinamik e të qëndrueshëm social, ekonomik dhe mjedisor. Një kryeqytet i fokusuar në cilësinë e jetës së qytetarëve. Një kryeqytet 7-minutësh, që përmes mobilitetit të qëndrueshëm ofron nxitje të ekonomisë lokale, mirëqenie, cilësi më të mirë të ajrit si dhe forcon ndjesinë e komunitetit. Një Prishtinë reziliente, me aftësi absorbimi, rikuperimi dhe përgatitje në rast të fatkeqësive natyrore, ekonomike dhe sociale. Kryeqytet gjithpërfshirës i cili fuqizon dhe zhvillon potencialet e llojllojshme të fshatrave. Destinacion i pashmangshëm i Ballkanit perëndimor për përjetimin e trashëgimisë kulturore, natyrore dhe shpalosjen e historisë. Një kryeqytet smart, i cili përmes teknologjisë dhe inovacioneve përmirëson shërbimet e ofruara për qytetarët.

³⁴ Plani Zhvillimor Urban 2012-2022

³⁵ Plani Zhvillimor Komunal 2012-2022

³⁶ Ligji nr. 06/I-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën, Neni 2, pika 2

Prishtina e pastër dhe e gjelbër – Një kryeqytet me ambient të pastër dhe kualitet të mirë të resurseve natyrore (ajrit, ujit dhe tokës). Atraktiv për qytetarët dhe vizitorët në aspektin e pastërtisë, sidomos përmes menaxhimit efikas të mbeturinave. Kryeqytet eco-friendly i bazuar në lëvizjen e lirë të qytetarëve kryesisht përmes rrjetit modern të transportit publik dhe shtigjeve të gjelbra.

Prishtina e përjetimeve - Prishtina do jetë referencë ndërkombëtare për promovimin e kulturës së paqes e qytetërimit, dashurisë dhe zhvillimit social, me një jetë cilësore që promovon kohezionin social dhe solidaritetin në zhvillim. Vatër e mbështetjes dhe inkurajimit të zhvillimit të talenteve të shumta të rinisë së vendit, në sport, art, kulturë e çdo fushë tjetër.

3.2. Qëllimet dhe objektivat zhvillimor

Për përcaktimin e qëllimeve dhe objektivate zhvillimore të Komunës, ky dokument merr për bazë dhe harmonizim zhvillimet me dispozitat e “Planit Hapësinor të Kosovës-Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+”, me Qëllimet e përgjithshme:

- Zhvillimi i rrjetit atraktiv të qyteteve të planifikuara, me qeverisje e shërbime publike në favor të qytetarit, me rritje të kualitetit të jetës së qytetarëve, punësimit dhe barazi sociale.
- Mbështetje ZHEL për ZHEK – shfrytëzimi i përparësive konkurruese,
- Zhvillimin e lidhjeve efikase brenda urbane, ndër urbane me hapësirat tjera dhe më gjerë lidhjet e fuqishme rajonale përmes zhvillimit të rrjetit të infrastrukturës (rrugore, hekurudhore, ajrore, TI-së).
- Promovim i TZHEK, lokacion për grupim aktiviteteve në aspekt hapësinor, investime të huaja, kompani multinationale,
- Mbështetje aktiviteteve H&ZH, për një ekonomi të njohurive, mbështetur nga kapacitetet organizative,
- Promovimi i Prishtinës si qendër e diturisë të rajonit më të gjerë të Evropës Juglindore.
- Zhvillim i aktiviteteve administrative, arsimore, shërbyese tregtare, energjetike, agro-industriale e turistike.

Përveç qëllimeve të përgjithshme të dala nga Plani Hapësinor i Kosovës, qëllimet dhe objektivat e këtij projekti bazohen dhe mbështesin edhe Qëllime të Agjendave dhe Konventave ndërkombëtare. Gjithashtu, ky plan mbështet fuqishëm konceptet e fundit për zhvillimin e qyteteve Smart/të mençura, qyteteve reziliente, të gjelbra, kompakte dhe të qëndrueshme. Qëllimet e këtij projekti harmonizohen dhe mundësojnë arritjen e Qëllimeve të këtyre agjendave, gjithmonë duke i mundësuar komunës të jetë në vija me zhvillime ndërkombëtare, si një hap drejt krijimit të mundësive për bashkëpunim ndërkombëtar dhe koordinim të donacioneve.

Qëllimet e veçanta, të cilat do të prezantohen në fushat tematike të PZHK-së, të mbështetura në hulumtimin e gjerë dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese, paraqesin sintezën e qëllimeve të prezantuara nga drejtoritë komunale, institucionet tjera publike lokale dhe qendrore, shoqërisë civile, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2031, dhe objektiva e qëllime të tjera nga konventat dhe agjendat ndërkombëtare. Objektivat e propozuara janë SMART (Specifike, të Matshme, të Arritshme, Reale dhe të lidhura për afatet kohore) që synohen për t’u arritur për një periudhë kohore specifike.

3.2.1. Qëllimet dhe objektivat sipas fushave tematike

3.2.1.1. Zhvillimi ekonomik

Qëllimi 1: Zhvillim i qëndrueshëm dhe i mençur i tregtisë dhe sektorëve të industrisë

Objektivi 1.2.: Ri-zhvillimi i zonave të caktuara me potencial ekonomik (tregu vjetër, tregu Ulpianë, tregu gjelbër, tregu automjeteve etj.) deri në vitin 2031

Objektivi 1.4.: Zhvillimi i zonave të përshtatshme për energji alternative

Objektivi 1.5.: Krijimi i kushteve për zhvillimin e sektorit të ndërtimtarisë

Qëllimi 2: Avancimi mëtutjeshëm i shërbimeve të kontraktimit të jashtëm

Objektivi 2.1.: Krijimi i hapësirave për zhvillimin e modeleve për kontraktim të jashtëm deri në vitin 2031

Objektivi 2.2.: Zhvillimi i modeleve për kontraktim të jashtëm deri në vitin 2031

Objektivi 2.3.: Sigurimi i kushteve të nevojshme për zhvillimin e kontraktimit të jashtëm (hapësirat e punës, infrastruktura dhe rrjeti, etj.) deri në vitin 2031

Qëllimi 3: Zhvillimi i bujqësisë dhe bujqësisë së mençur me infrastrukturë adekuate

Objektivi 3.1: Rritja e sipërfaqeve me kultura bujqësore deri në vitin 2027

Objektivi 3.2: Ngritja e kapaciteteve përpunuese për prodhime bujqësore blegtorale dhe BMA deri në vitin 2025

Objektivi 3.3.: Krijimi i zinxhirit bujqësor – Grumbullim, përpunim, konservim dhe tregtim

Objektivi 3.4.: Stimulimi i diversifikimit dhe zhvillimit të NVM-ve bujqësore

Qëllimi 4: Zhvillimi i turizmit

Objektivi 4.1: Hartimi i strategjisë për zhvillimin e turizmit rural

Objektivi 4.2: Rritja e numrit të shtëpive pritëse (bujtinave) dhe kapaciteteve të ngjashme akomoduese (restorantet me ushqim tradicional).

Objektivi 4.3: Zgjerimi i rrjetit të shtigjeve për ecje dhe çiklizëm.

Objektivi 4.4.: Rritja e kapaciteteve fizike dhe njerëzore për zhvillimin e turizmit

Objektivi 4.4.: Zhvillimi i profileve të veçanta (identitare) të fshatrave si mundësi/potencial i zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm i përqendruar tek mbajtja popullore lokale përmes krijimit të mirëqenies ekonomike dhe sociale;

Qëllimi 5: Bashkëpunim i qëndrueshëm me komunat fqinje

Objektivi 5.1.: Krijimi i kushteve për zbatimin e konceptit të Trekëndëshit të Zhvillimit Ekonomik të Kosovës dhe Prishtinës Metropolitane.

3.2.1.2. Infrastruktura teknike

Qëllimi 1: Furnizim i mjaftueshëm me ujë cilësor

Objektivi 1.1: Ofrimi i shërbimeve të qëndrueshme të furnizimit me ujë në të gjithë komunën deri në vitin 2031;

Objektivi 1.2: Zvogëlimi dhe monitorimi i humbjeve të ujit të pijshëm për 20% deri në vitin 2026;

Objektivi 1.3: Rritja e mbulueshmërisë me shërbime të furnizimit me ujë në të gjithë komunën deri në vitin 2031.

Qëllimi 2: Menaxhim i qëndrueshëm i infrastrukturës së ujërave të zeza

Objektivi 2.1: Parandalimi i ndotjes së ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor nga ujërat e zeza deri në vitin 2031;

Objektivi 2.2: Zgjerimi dhe ri-vitalizimi i rrjetit të kanalizimit atmosferik dhe fekal në zonën urbane deri në vitin 2026.

Qëllimi 3: Menaxhim i qëndrueshëm i rrjetit të përmirësuar të ujitjes

Objektivi 3.1: Zgjerimi, funksionalizimi dhe mirëmbajtja e sistemit ekzistues të ujitjes Ibër-Lepenc.

Qëllimi 4: Furnizim stabil dhe i pandërprerë i energjisë elektrike

Objektivi 4.1.: Sigurimi i furnizimit me energji të pandërprerë për të gjitha kategoritë e konsumatorëve dhe sigurimin e cilësisë në furnizimin me energji elektrike, deri në vitin 2031;

Objektivi 4.2: Rritja e kapaciteteve të furnizimit me energji të ripërtërishme deri në vitin 2031;

Objektivi 4.3: Prodhim i energjisë së ripërtërishme elektrike deri në vitin 2031.

Qëllimi 5: Shërbime cilësore të energjisë termike

Objektivi 5.1: Shfrytëzim maksimal i kapaciteteve ekzistuese të sistemit të ngrohjes qendrore;

Objektivi 5.2: Inkurajim i sistemit të kogjenerimit për prodhimin e energjisë termike;

Objektivi 5.3: Prodhim i energjisë termike për ngrohje me energji të ripërtërishme solare.

Qëllimi 6: Infrastrukturë e telekomunikimit me shërbim efektiv

Objektivi 6.1: Avancim i pajisjeve dhe shërbimeve telekomunikuese;

Objektivi 6.2: Shtrirje e rrjetit të telekomunikimit në të gjithë vendbanimet e komunës deri në vitin 2026.

Qëllimi 7: Menaxhim i qëndrueshëm i mbeturinave

Objektivi 7.1.: Ofrimi i qasjes së lehtë për grumbullimin e mbeturinave;

Objektivi 7.2.: Funksionalizimi i deponisë dhe trajtimi i mbeturinave inerte;

Objektivi 7.3.: Inkurajimi i ekonomisë qarkore ;

Objektivi 7.4.: Trajtimi i mbeturinave të rrezikshme (shëndetësore, industriale, shtazore);

Objektivi 7.5.: Përdorimi i teknologjive të avancuara për riciklim të mbeturinave dhe shfrytëzimi i tyre për energji.

3.2.1.3. *Infrastruktura e transportit*

Qëllimi 1: Rrjet i organizuar dhe eficient i transportit

Objektivi 1.1: Përmirësimi i kapacitetit dhe nivelit të shërbimit për rrugët ekzistuese deri në vitin 2031;

Objektivi 1.2: Lirimi i trafikut të brendshëm të qytetit deri në vitin 2025;

Objektivi 1.3: Forcimi i komunikimit të banorëve të fshatrave me qytetin;

Objektivi 1.4: Përmirësimi i sigurisë në trafik.

Qëllimi 2: Mobilitet urban gjithëpërfshirës dhe SMART

Objektivi 2.1.: Fuqizimi i transportit publik urban;

Objektivi 2.3: Inkurajimi i lëvizjes jo-motorike në komunë;

Objektivi 2.4.: Ndryshimi i hierarkisë së lëvizjes në trafik deri më 2024.

3.2.1.4. Infrastruktura publike/sociale

Qëllimi 1: Shërbime cilësore shëndetësore dhe të qasshme për të gjithë

Objektivi 1.1: Ofrimi i shërbimit i kujdesit shëndetësor dytësor për banorët e vendbanimeve rurale deri në vitin 2031;

Objektivi 1.2.: Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe Avancimi i sistemit informativ shëndetësor deri në vitin 2025.

Qëllimi 2: Shërbime cilësore dhe gjithëpërfshirës në arsim

Objektivi 2.1.: Ndërlidhja e arsimit me nevojat e tregut të punës;

Objektivi 2.2.: Përmirësimi i infrastrukturës fizike të arsimit;

Objektivi 2.3: Ngritja e kapaciteteve profesionale arsimore;

Objektivi 2.4.: Inkurajimi i arsimit tërëditor në të gjitha vendbanimet deri në vitin 2025.

Qëllimi 3: Shërbime cilësore administrative dhe gjithëpërfshirje institucionale

Objektivi 3.1.: Fuqizimi i bashkësive lokale deri në vitin 2025.

Qëllimi 4: Përkrahje sociale për të gjithë banorët në nevojë

Objektivi 4.1.: Ngritja e kapaciteteve strehimore të përkohshme deri në vitin 2031;

Objektivi 4.2.: Përkrahja e aftësimit të personave me aftësi të kufizuara;

Objektivi 4.3.: Menaxhim adekuat i Qendrës për Punë Sociale.

Qëllimi 5: Mjedis i qëndrueshëm institucional për zhvillimin e artit, kulturës dhe sportit

Objektivi 5.1: Krijimi i hapësirave të përshtatshme për komunitetin artistik;

Objektivi 5.2.: Promovimi i vlerave të artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore;

Objektivi 5.3.: Promovimi i sportit profesional përmes fuqizimit të infrastrukturës adekuate;

Objektivi 5.4.: Promovimi i sportit rekreativ;

Objektivi 5.5.: Përkrahja e aktiviteteve kulturore dhe artistike.

Qëllimi 6: Infrastruktura e përshtatshme për varreza

Objektivi 6.1.: Sigurimi i sipërfaqeve të mjaftueshme për varreza publike.

Qëllimi 7: Hapësira të hapura publike të qasshme për të gjithë

Objektivi 7.1.: Krijimi i hapësirave publike të gjelbra dhe ndërlidhja e tyre përmes korridoreve.

3.2.1.5. Mjedis

Qëllimi 1: Mbrojta dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i resurseve mjedisore

Objektivi 1.1.: Stimulimi i shfrytëzimit të energjisë alternative deri në vitin 2031;

Objektivi 1.2.: Përmirësimi i cilësisë së ajrit;

Objektivi 1.3.: Mbrojtja e burimeve ujore deri në vitin 2031;

Objektivi 1.4.: Inventarizimi i florës dhe faunës në gjithë territorin e komunës;

Objektivi 1.5.: Themelimi i kopshtit botanik;

Objektivi 1.6.: Stimulim i përdorimit të automjeteve elektrike në qytet;

Objektivi 1.7.: Përkufizimi dhe zhvillimi i tamponit të gjelbër mbrojtës të zonës urbane në faza deri më 2027.

Qëllimi 2: Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore

Objektivi 2.1.: Hartimi i politikave për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore;

Objektivi 2.2.: Zgjerimi i kapaciteteve institucionale për sistemin e paralajmërimit të hershëm;

Qëllimi 3: Rritja e fondit drusor përmes pyllëzimit dhe ripyllëzimit të sipërfaqeve pyjore;

Objektivi 3.1.: Pyllëzimi dhe ripyllëzimi i zonave të përcaktuara deri në vitin 2031.

3.2.1.6. Trashëgimia natyrore dhe kulturore

Qëllimi 1: Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore për zhvillim të qëndrueshëm

Objektivi 1.1.: Ruajtja dhe konservimi aktiv i aseteve të trashëgimisë kulturore;

Objektivi 1.2.: Ruajtja dhe konservimi i vlerave të trashëgimisë natyrore dhe peizazhit;

Objektivi 1.3.: Promovimi i aseteve të trashëgimisë kulturore në funksion të zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm deri në vitin 2031;

Objektivi 1.4.: Krijimi i sistemit të menaxhimit dhe financimit për përkujdesjen dhe rigjenerim të aseteve të trashëgimisë kulturore;

Objektivi 1.5: Krijimi i sistemit të dokumentimit dhe informimit për asetet e trashëgimisë kulturore.

3.2.1.7. Vendbanimet

Qëllimi 1: Zhvillim kompakt dhe i qëndrueshëm i vendbanimeve

Objektivi 1.1.: Definimi i kufijve ndërtimor në të gjitha vendbanimet;

Objektivi 1.2.: Inkurajim i dendësisë dhe ri-zhvillimit të tokave në zonat e ndërtuara;

Objektivi 1.3.: Sigurimi i llojllojshmërisë së dendësive brenda vendbanimeve;

Objektivi 1.4.: Ofrimi i qasjes në shërbime dhe infrastrukturë publike për të gjithë banorët;

Objektivi 1.5.: Inkurajim i shfrytëzimeve të përziera brenda vendbanimeve;

Objektivi 1.6.: Sigurimi i mundësisë së zhvillimit të fshatrave edhe përtej zonës së definuar për zgjerim në rastet kur investimi lidhet drejtpërsëdrejti me objektivat strategjike të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm të fshatrave, promovimit të bujqësisë dhe turizmit rural. Çdo zhvillim i tillë do të jetë në përputhshmëri të plotë me parimet e arkitekturës së qëndrueshme në kuptimin e përdorimit të materialeve, relacionit me natyrën, përdorimin e resurseve natyrore në arkitekturë.

Qëllimi 2: Zhvillim policentrik në zonën urbane

Objektivi 2.1.: Krijimi i zonave me intensitet të lartë. Parametrat e zhvillimit të këtyre zonave do të përcaktohen përmes detyrave projektuese të konkurseve arkitekturore ndërkombëtare me qëllim të krijimit të referencave arkitekturore të njoftuara ndërkombëtarisht si potencial i zhvillimit ekonomik dhe identitar.

Objektivi 2.2.: Koncentrimi i zhvillimit në zonat e ndërtuara dhe përmirësimi i strukturave ekzistuese.

Qëllimi 3: Bashkëpunim i qëndrueshëm ndërkomunal

Objektivi 3.1.: Përgatitja e kornizës për bashkëpunim ndërkomunal me komunat fqinje

Qëllimi 4: Trajtimi i ndërtimeve pa leje dhe parandalimi i ndërtimeve të reja pa leje

Objektivi 4.1.: Zhvillimi i fushatës informuese dhe vetëdijësuese për regjistrim dhe trajtim të ndërtimeve pa leje deri në vitin 2024;

Objektivi 4.2.: Trajtimi i të gjitha ndërtimeve pa leje konform legjislacionit në fuqi.

3.2.1.8. Banimi

Qëllimi 1: Banim cilësor dhe i qëndrueshëm

Objektivi 1.1.: Rritja e densitetit të banesave në zonat ekzistuese urbane;

Objektivi 1.2.: Promovimi i formave inovative të banimit me fokus në bashkëpronësi deri më 2025.

Qëllimi 2: Banim i gjelbër

Objektivi 2.1.: Inkurajimi i strategjive të mençura për ruajtjen e ujit;

Objektivi 2.2.: Inkurajimi i strategjive për ruajtjen e energjisë;

Objektivi 2.3.: Promovimi i përdorimit të materialeve të qëndrueshëm të ndërtimit.

Qëllimi 3: Banim i përballueshëm dhe gjithëpërfshirës

Objektivi 3.1.: Inicimi i procesit të rigjenerimit urban në lagje të ndryshme ;

Objektivi 3.2.: Krijimi i një trusti të banimit të komunitetit.

Objektivi 3.3.: Krijimi i fondit banesor në pronësi të komunës përmes kontributit obligator të ndërtesave/zhvilluesve për komunitetin.

3.2.1.9. Shfrytëzimi i tokës

Qëllimi 1: Shfrytëzimi efikas i tokës për një zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik dhe mjedisor

Objektivi 1.1.: Ruajtja e harmonisë mes shfrytëzimit të tokës për banim dhe shfrytëzimeve të përziera, industrisë, rekreacionit dhe institucioneve deri në vitin 2031;

Objektivi 1.2.: Mbajtja nën kontroll e zhvillimit të vendbanimeve, me theks të veçantë në ato lineare dhe të shpërndara;

Objektivi 1.3.: Ruajtja dhe konsolidimi i tokës bujqësore.

3.3. Koncepti i zhvillimit hapësinor

Roli vendimtar që luajnë kryeqytetet në arritjen e një urbanizmi “gjithpërfshirës, të sigurt dhe rezilient”, (Qëllimi 11 i OZHQs), dhe në zhvillimin e sistemeve urbane më të balancuara dhe të qëndrueshme, do të thotë që Prishtina si “qytet ndërmjetës” duhet të bëhet më e spikatur në realizimin e Agjendës 2031 dhe Agjendës së Re Urbane dhe zbatimin e tyre.

Sfidat me të cilat ballafaqohet Komuna e Prishtinës përfaqësojnë gjithashtu një mundësi unike për të marrë përgjegjësinë e saj të plotë për inovacionin në menaxhimin urban dhe zhvillimin e qëndrueshëm, përmes një shpërndarjeje të drejtë të pushteteve, financave dhe kapaciteteve, duke kapitalizuar afërsinë dhe shkallën njerëzore (human scale) të Kryeqytetit duke forcuar kapacitetet e planifikimit urban dhe menaxhimin e tokës për të parandaluar përhapjen urbane dhe për të ngritur profilin kombëtar duke e quajtur dhe promovuar veten si një qendër rajonale dhe evropiane e inovacionit, për prosperitetin, ndërmjetësimin, ofrimin e shërbimeve dhe promovimin e trashëgimisë së tij të larmishme kulturore.

Prishtina do të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm lokal dhe kombëtar duke inkurajuar bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet qyteteve kryesore, zonave të tyre rurale, si dhe partneriteteve ndërkomunale, për të krijuar mundësi të reja ambicioze dhe për të kapërcyer sfidat ekonomike globale dhe kombëtare.

Kryeqyteti i Kosovës do ta shtyjë komunën të trajtojë pabarazinë e mundësive duke zhvilluar politika sociale që sigurojnë qasje të përballueshme në shërbimet bazë, shëndetësi dhe arsim, për të reduktuar deficitin mjedisor urban për të luftuar degradimin e mjedisit, ndryshimet klimatike dhe kërcënimin e fatkeqësive natyrore, sigurimin e aksesit dhe pjesëmarrjes në kulturën dhe jetën kulturore për të gjithë.

Skenarët e propozuar hapësinor

Prishtina ka një pozicion strategjik për qarkullimin e njerëzve, mallrave dhe kapitalit në një nivel rajonal ndërkombëtar në Ballkanin perëndimor. Pozicionimi i saj reflekton disa kahje qarkullimi, si;

- Korridori Porti Durrës-Tiranë-Prishtinë, i cili vijon më tej drejt Evropës Qendrore përmes;
- Korridorit Prishtinë-Merdar-Nish-Budapest;
- Korridorit Porti Selanik-Shkup-Prishtinë, që vijon në drejtim të veriut edhe përmes;
- Korridorit Prishtinë-Mitrovicë-Serbi.

Është e një rëndësie të veçantë zbërthimi i konceptit të Planit Hapsinor të Kosovës dhe implikimet e tij në territorin e Komunës Prishtinë. PHK e konsideron Komunën e Prishtinës si porta hyrëse në Kosovë. Prishtina është në fakt porta kryesore hyrëse në vend si dhe adresa dhe destinacioni kryesor për vetë funksionin dhe rëndësinë që ka për vendin. Por ky koncept nuk reflekton vetëm aspektin e qarkullimit por edhe aspektin e prezantimit të vendit përmes Prishtinës dhe potencimin e rolit që ka Prishtina si kryeqytet i vendit.

PHK gjithashtu thekson edhe rëndësinë e krijimit të një trekëndëshi të zhvillimit ekonomik që shtrihet mes Prishtinës, Lipjanit dhe Drenasit. Në fakt kjo zonë përbën edhe motorin kryesor ekonomiko-prodhues në vend.

Prishtina në fakt ka një marrëdhënie dinamike me vendbanimet dhe komunat përreth. Komuna gëzon ekzistencën e disa korridoreve të rëndësishme rajonale që kanë ndikim në disa aspekte të zhvillimit:

Ekonomik - Koncepti potencon ekzistencën dhe zhvillimin e disa korridoreve. Qartazi Prishtina ka një korridor zhvillimi në drejtim të Fushë-Kosovës me aktivitete ekonomike të rëndësishme të tregtisë dhe produkteve jetike të sektorëve të rëndësishëm ekonomik. Në drejtim të veriut, korridori Prishtinë-Obiliq apo korridori Prishtinë-Merdare kanë fituar me kohën një rëndësi të konsiderueshme sidomos për

aktivitete prodhuese. Korridori Prishtinë-Lipjan-Ferizaj në vitet e fundit ka një zhvillim dinamik dhe i është dedikuar aktiviteteve tregtare dhe të shërbimit.

Qarkullim - Koncepti evidenton edhe potencialin dhe rëndësinë që ka Prishtina në këtë aspekt. Lidhja me 3 pika kufitare drejt korridoreve ndërkombëtare, Merdare, Vërmicë, Kaçanik, Mitrovicë e paraqet Prishtinën në një pozicion nyje mes këtyre korridoreve. Lidhja me aeroportin Adem Jashari, është një tjetër element i rëndësishëm që ka ndikimin e vet në këtë drejtim. Fakti që aeroporti është jashtë territorit administrativ komunal është një tjetër argument mbi nevojën e ndërtimit të një koncepti të tillë rajonal. Koncepti potencon edhe nevojën e stacionit multimodal si një 'port/nyje' (hub) e rëndësishme për një hap cilësor në flukset qarkulluese rajonale.

Infrastruktura - Nevoja për një infrastrukturë cilësore nuk mund të shterohet duke e adresuar vetëm në nivel komunal. Urbanizimi imponon nevojën e adresimit të disa infrastrukturave në nivel rajonal. Edhe aktualisht sistemi i ujësjellësit siguron shërbime për tre komuna njëkohësisht; Prishtina, Fushë-Kosova dhe Obiliqi. Procesi i urbanizimit ka vënë nën presion të konsiderueshëm këtë rrjet dhe nevoja e rritjes së kapaciteteve prodhuese dhe burimeve mund dhe duhet të adresohet në nivel rajonal. Edhe më jetik bëhet ky koncept nëse flitet për infrastrukturën e kanalizimit. Nevoja bashkëkohore e trajtimit të ujërave të zeza përmes impiantit të ri të trajtimit imponon nevojën për dakordim midis Komunës së Prishtinës dhe komunave fqinje. Ngjashëm ky koordinim është imperativ edhe në adresimin e çështjes së mbetjeve dhe ndërtimit të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane që nuk do i shërbejë vetëm kryeqytetit por edhe rajonit. Koncepti rajonal potencon nevojën e krijimit të një pikturë rajonale zhvillimi që kalon kuptimin e ngushtë administrativ.

Funksionet - Koncepti potencon rolin e Prishtinës sidomos në fushat e shëndetësisë dhe arsimit jo thjeshtë si një pol rajonal por si qendra më e rëndësishme për të gjithë vendin. Si e tillë Prishtina nuk mund dhe nuk duhet të konceptojë politikat në këto sektorë si nevoja komunale por, në bashkëpunim me qeverinë qendrore, duhet ta impostojë zhvillimin në nivel kombëtar. Gjithashtu në zbatim të koncepteve të PHK potencon edhe bashkëpunimin rajonal si një aplikim të koncepteve të policentrizmit dhe zhvillimit të balancuar rajonal. Në këtë aspekt, koncepti thekson edhe nevojën e një zhvillimi të balancuar urban-rural duke sugjeruar forcimin e komponentit të zhvillimit të turizmit në pjesën lindore të Prishtinës, por edhe të ekonomive të energjisë alternative.

3.3.1.1. Skenari 1 – Trendi aktual

Skenari 1 është skenar i ndërtuar mbi zhvillimet dhe propozimet e bëra ndër vite, dhe mbulon planifikimet nga dokumentet ekzistuese të Komunës së Prishtinës, këtu të përfshirë Plani Zhvillimor Komunal, Plani Zhvillimor Urban dhe Plane Rregulluese Urbane.

Ky skenar paraqet një zhvillim kryesisht monocentrik, duke parashikuar koncentrim të popullsisë në vendbanimin kryesor, Prishtinën. Si skenar monocentrik, ky skenar planifikon zhvillimin e qëndrueshëm të hapësirës urbane, bazuar në shfrytëzimin racional të të gjitha mundësive dhe resurseve lokale, duke shtuar mundësinë për ruajtjen e vlerave mjedisore për gjenerata të ardhshme. Vendbanimet tjera ekzistuese, do të trajtohen mjaftueshëm brenda kufijve aktual.

Me qëllim të ndërlidhjes së zonave të ndryshme të qytetit dhe shkarkimin e trafikut që shkaktohet në qendër, sipas këtij skenari planifikohet ndërtimi i unazës së qendrë dhe unazës së qytetit të Prishtinës.

Sa i përket zhvillimit ekonomik, skenari propozon forcimin e rolit të zonës ekonomike në perëndim të qytetit të Prishtinës. Gjithashtu theksohet nevoja e zhvillimit dhe mbështetjes së aktiviteteve ekonomike në zonat rurale duke përfshirë këtu investimet në energji alternative (energji e erës) si dhe rëndësia e vlerave natyrore të Parkut të Gërmisë si mushkëria kryesore e komunës së Prishtinës.




Figura 10 Skenari 1 - Trendi aktual

Përparësitë

- **Sigurimi i infrastrukturës bazike për fshatra**
- **Lidhje të mira me rajonin**
- **Zhvillim i hovshëm i zonës urbane**
- **Adaptim i gjendjes ekzistuese dhe asaj që veç ka filluar të zhvillohet**

Mangësitë

- **Shtirje e madhe e zonës urbane**
- **Dëmtim i zonës bujqësore dhe asaj pyjore**
- **Mundësi të mëdha për shtirje të pa planifikuara jashtë kufirit ndërtimor**
- **Shpërndarje jo e barabartë e zhvillimeve në mes të zonës urbane dhe asaj rurale**
- **Mundësi për nxitje të zbrazjes së vendbanimeve të skajshme rurale**
- **Hapësira jo të mjaftueshme për kulturë, rini, sport e rekreacion;**
- **Mos shfrytëzimi i potencialit për zhvillimin e sektorit të turizmit**

Konkluzioni

Ky skenar, bazuar në vlerësimin e përparësive dhe dobësive trajton fushat kryesore por nuk i plotëson të gjitha kërkesat për t'u marr si skenar bazë për analiza të mëtejshme.

3.3.1.2. Skenari 2 – Zhvillim policentrik

Skenari 2 merr në konsideratë disa nga propozimet e politikave ekzistuese, por mban një qëndrim pak më ndryshe se sa skenari i parë. Ndryshe prej PZHK ekzistuese e cila konsideron nevojën e shtrirjes së urbanizimit në një territor prej mbi 7.000 ha duke u shtrirë edhe në lindje të parkut të Gërmisë, Skenari 2 e kufizon procesin urbanizues dhe mban qëndrim kritik ndaj kësaj shtrirjeje. Sipas këtij skenari forcohet roli mjedisor i Parkut të Gërmisë. Në të njëjtën frymë të ruajtjes së tokave me vlerë në komunë, ndërtimi i unazës së jashtme nuk është planifikuar në këtë skenar.

Sipas këtij skenari sugjerohet edhe forcimi i disa vendbanimeve sekondare përveç Prishtinës, të cilat do të tërhiqnin disa shërbime publike komunale si ura lidhëse mes zonës më të madhe urbane dhe zonave rurale të komunës. Këto zona mes vete nuk zhvillohen me karakter konkurrues, por më tepër si plotësim i njëra tjetrës. Zona urbane shfrytëzon potencialet që ka përbrenda, ndërsa zonat rurale, duke iu falënderuar qendrave sekondare dhe shfrytëzimit racional të resurseve natyrore me një përparim paralel të potencialeve ekonomike, fiton një perspektivë të vërtetë për zhvillim.

Skenari forcon rolin e zonës ekonomike në ambicet për zhvillimin ekonomik lokal të Komunës. Gjithashtu propozon edhe më fuqishëm forcimin e potencialit turistik që ka Prishtina bashkë me aktivitete rurale. Promovon agro-turizmin duke krijuar një bosht të qartë dhe të fuqishëm në pjesën lindore të komunës si një nga komponentët më të rëndësishme të këtij skenarit.

Njëjtë si në skenarin 1, propozohet përforcimi i komponentit të investimeve në energji alternative, përkatësisht në energjinë e erës, të cilat vlerësohen si potencial për zhvillimin ekonomik lokal të komunës.

Në këtë skenar, potencohet fuqizimi i rolit të Komunës së Prishtinës në aspektin e arsimit dhe të shëndetësisë duke tejkaluar nevojat komunale dhe duke investuar në shndërrimin e Prishtinës në një pol kombëtar në ofrimin e shërbimeve cilësore dhe specifike në këto fusha. Ngritja në një nivel tjetër e zonës spitalore apo krijimi dhe forcimi i Kampusit Universitar janë elementet kryesore në këtë drejtim.




Figura 11 Skenari 2 - Zhvillimi Policentrik

Përparësitë

- **Zhvillim i balancuar mes zonës urbane dhe asaj rurale**
- **Ruajtje e tokës bujqësore, resurseve natyrore etj.**
- **Mundëson zhvillimin e zonave turistike dhe rekreativo-turistike**
- **Lidhje e mire e fshatrave me qendrën urbane**
- **Kompaktësim i zonës urbane**

Mangësitë

- *Nuk siguron ndërprerjen e plotë të emigrimeve nga zonat rurale*
- *Zonat urbane dhe qendrat sekondare mund të kenë nevojë për PRRH*
- *Zhvillimi i zonës urbane mund të ngadalësohet në funksion të zhvillimit të harmonizuar me zonën rurale*

Konkluzioni

Ky skenar, bazuar në vlerësimin e përparësive dhe dobësive trajton fushat kryesore por nuk i plotëson të gjitha kërkesat për t'u marr si skenar bazë për analiza të mëtutjeshme.

3.3.1.3. Skenari 3 – Zhvillim i qëndrueshëm dhe kompakt

Skenari 3 parasheh zhvillim gjithëpërfshirës, koheziv, rezilient, multi-sektorial dhe multi-funksional për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe kompakt të vendbanimeve në komunë.

Në përgjithësi ky skenar është i bazuar në planifikim strategjik dhe të zhvillimit të qëndrueshëm për komunën e Prishtinës duke marrë parasysh: Impaktin e pandemisë Covid-19, sfidat e përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike si dhe transformimin dixhital. Këto dinamika mund të perceptohen si kërcënime për mjedisin urban, por ato gjithashtu paraqesin mundësi të rëndësishme dhe kanë detyruar ndryshime në mjedisin urban, të cilat një vit më parë do të dukeshin të largëta, përfshirë këtu dixhitalizimi i shërbimeve, transformimi i zinxhirëve të furnizimit, riaktivizimi i zonave periferike, rritjen e numrit të automjeteve elektrike dhe puna në distancë, e shumë të tjera.

Prishtina planifikohet të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm lokal dhe kombëtar duke inkurajuar bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet qyteteve kryesore, zonave të tyre rurale, si dhe partneriteve ndërkomunale, për të krijuar mundësi të reja ambicioze dhe për të kapërcyer sfidat ekonomike globale dhe kombëtare.

Kryeqyteti i Kosovës do ta shtyjë komunën të trajtojë pabarazinë e mundësive duke zhvilluar politika sociale që sigurojnë qasje të përballueshme në shërbimet bazë, shëndetësi dhe arsim, për të reduktuar deficitin mjedisor urban për të luftuar degradimin e mjedisit, ndryshimet klimatike dhe kërcënimin e fatkeqësive natyrore, sigurimin e qasjes dhe pjesëmarrjes në jetën kulturore për të gjithë.

Skenari 3 propozon zhvillimin e zonës urbane të Prishtinës si tri tërësi hapësinore me karaktere unike:

1. Prishtina e vjetër me vlerat arkitektonike historike ,
2. Unaza qendrore si nyja kryesore administrative dhe financiare, dhe
3. Prishtina e re me karakterin e saj me shfrytëzim të përzier.

Në këtë skenar planifikohet edhe identifikimi i lokacioneve strategjike me potenciale të jashtëzakonshme zhvillimore të cilat do të japin kahje zhvillimi gjithë zonës përreth.

Gjithashtu planifikohet përcaktimi i profileve të veçanta (identitare) të vendbanimeve rurale si mundësi/potencial i zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm, me fokus në parandalimin e depopullimit të vendbanimeve përmes krijimit të mirëqenies ekonomike dhe sociale.

Sa i përket vendbanimeve rurale, me këtë skenar planifikohet fuqizimi i tyre përmes investimeve në infrastrukturë rrugore, teknike, publike dhe sociale të cilat shërbejnë si ura lidhëse me zonën urbane të komunës. Zhvillimi i këtyre vendbanimeve bazuar në potencialet e tyre natyrore dhe kulturore, duke inkurajuar lloje të ndryshme të turizmit dhe industrisë përmirëson cilësinë e jetës për banorët dhe rrjedhimisht ndalon depopullimin e tyre. Në këtë skenar pjesa veriore e vendbanimit Prishtinë, duke qenë e vetmja tokë cilësore bujqësore që ka kjo komunë sugjerohet që të zhvillojë aktivitete në funksion të agro-turizmit.




Figura 12 Skenari 3 - Zhvillimi i qëndrueshëm dhe kompakt

Skenari 3 fuqizon rolin e zonës ekonomike dhe synon forcimin e rolit prodhues të saj, ndërkohë që aktiviteti tregtar i dedikohet kryesisht korridorit të jugut. Ngjashëm si në skenarët paraprak, në komunën e Prishtinës planifikohen investimet në energji të ripërtërishme, përkatësisht në energji të erës dhe atë solare.

Përparësitë

- ***Sigurohet mënyra urbane e jetesës, me të gjitha funksionet për një zhvillim të qëndrueshëm***
- ***Qyteti zhvillohet fuqishëm me të gjitha elementet e strukturës urbane komplete***
- ***Adaptohen Konventat ndërkombëtare dhe Agjendat Urbane për planifikim të qëndrueshëm dhe cilësi jetese***
- ***Mundëson zhvillimet dhe planifikimet e nivelit qendror***
- ***Mundëson ofrim më të lehtë dhe me kosto më të ulët të shërbimeve ndaj qytetarëve***
- ***Implikime me të ulëta financiare për implementim miqësorë me mjedisin***
- ***Përqendrimi i zhvillimeve e bën të mundshme mbrojtjen e natyrës dhe tokës bujqësore***
- ***Mundëson zhvillimin e zonave turistike dhe rekreativo-turistike***
- ***Zhvillimet ekonomike adaptojnë zhvillimet ekzistuese dhe planifikimet e zhvillimit të nivelit qendror-trekëndëshi i zhvillimit ekonomik***
- ***Në përputhje me strategjitë nacionale, ky skenar mundëson lidhjen e mirë dhe funksionale në nivel nacional dhe korridoret pan-evropiane.***
- ***Lidhje e mirë e fshatrave me qendrën urbane***
- ***Shpërndarje e volitshme e institucioneve dhe e infrastrukturës teknike dhe sociale***

Mangësitë

- *Nuk siguron ndërprerjen e plotë të emigrimeve nga zonat rurale*
- *Zonat urbane dhe qendrat sekondare mund të kenë nevojë për PRRH*
- *Zhvillimi i zonës urbane mund të ngadalësohet në funksion të zhvillimit të harmonizuar me zonën rurale*

Konkluzioni

Skenari 3 përzgjidhet të përpunohet tutje, pasi vlerësohet si skenari me favorshëm dhe me i mundshëm të realizohet, i cili do të siguronte një ekuilibër hapësinor, zhvillim ekonomik e social.

3.3.1 Elementet e konceptit të zhvillimit hapësinor

Koncepti i Zhvillimit Hapësinor për Komunën e Prishtinës u zhvillua duke përdorur konceptet hapësinore vijuese për të arritur qëllimet dhe objektivat hapësinore.

Në konceptin kryesor të Zhvillimit Hapësinor janë marrë parasysh dhe është reflektuar në gjendjen aktuale, edhe zhvillimet e planifikuara. Është caktuar logjika hapësinore, është bërë integrimi i kërkesave të planifikimit hapësinor që rrjedhin prej vizionit të Komunës së Prishtinës, qëllimeve dhe objektivave përmes tërësive të zgjidhjeve të planifikuara. Në mënyrë të përgjithshme më poshtë janë prezantuar nëpërmjet përshkrimit tekstual dhe hartave konceptuale hapësinore për të gjitha strategjitë sektoriale edhe propozimet për zhvillim të komunës.

Kështu, Koncepti i Zhvillimit Hapësinor është baza kryesore e zhvillimit dhe e shfrytëzimit të tokës për hartat tematike të PZHK-së, kushteve dhe masave të HZK-së.

Nyjet – Si element i konceptit, nyjet paraqesin pikat hapësinore të përqendruara ku promovohet densifikimi i ndërtimeve, intensifikimi i funksioneve dhe aktiviteteve të ndryshme. Në këtë koncept, qyteti i Prishtinës paraqitet si nyja kryesore e komunës e cila do të vazhdojë të mbetet qendra kryesore administrative, kulturore, edukative si dhe qendra kryesore e aktiviteteve bankare dhe shërbyese në komunë.

Duke parë Prishtinën si qendër metropolitane, pika të rëndësishme të saj të rëndësisë së veçantë për nga potenciali hapësinor, ekonomik dhe zhvillimor do të trajtohen si nënnyje të veçanta. Këto pika do ti nënshtrohen proceseve të konkurseve arkitekturore të cilat do ti përcaktojnë parametrat konkret të zhvillimit brenda trekëndëshit Përmbajtje - Kontekst - Koncept (Content – Context – Concept).

Korridoret – konsiderohen lidhjet ndërmjet nyjave, përgjatë të cilave natyrshëm mund të nxitet dhe inkurajohet një intensitet i rritur i zhvillimit. Në këtë koncept, përfshihen linjat e transportit që bëjnë ndërlidhjen e vendbanimeve në mes veti, por edhe janë nyje kryesore për gjithë Kryeqytetin e Prishtinës. Rëndësi të veçantë kanë edhe korridoret e gjelbra në kuadër të zonës urbane të komunës, të cilat mundësojnë qarkullim të lehtë të këmbësorëve dhe mjeteve të tjera jo-motorike. Sa i përket korridoreve të zhvillimit, propozohet fuqizimi i korridoreve që shkojnë në drejtim të qyteteve kryesore, si: Ferizaj, Mitrovicë, Gjiilan, Podujevë dhe Fushë Kosovë, duke i rehabilituar zhvillimet ekzistuese, kurse zhvillimi përreth korridoreve të reja planifikohet me kujdes në përputhshmëri me potencialet.

Plotësim dhe dendësim - paraqet mundësi dhe potencial të mbushjes dhe densifikimit të hapësirave me zhvillime të caktuara, për të arritur zhvillim hapësinor kompakt. Ky koncept ofron plotësim dhe dendësim në zonën urbane, në funksionon të kompaktësimit të qytetit. Sipas nevojave plotësimi dhe dendësimi, planifikohet edhe në vendbanime tjera, mirëpo gjithmonë të monitoruara dhe duke i ruajtur zonat bujqësore.

Mbajtja nën kontroll - i referohet nevojës për të kufizuar zhvillimin joefikas me dendësi të ulët, përmes përdorimit të kufirit për zhvillim urban për një periudhë të përkufizuar kohore. Në këtë koncept synohet mbajtja nën kontroll e të gjithë kufijve të rinj ndërtimor, qoftë të zonës urbane, qoftë të vendbanimeve rurale, e sidomos në zonat rurale ku jetojnë një përqindje më e vogël e banorëve, duke mos lejuar shtrirje të reja dhe intensitet të ndërtimeve jashtë zonave të definuara për ndërtim.

Mbrojtja - i referohet nevojës për mbrojtjen e resurseve të vlefshme natyrore, kulturore, ekonomike dhe të trashëgimisë. Në këtë koncept, planifikohet mbrojtja e tokës bujqësore, mbrojtja e tokës pyjore mbrojtja e pasurive të tjera natyrore dhe kulturore, qoftë nëntokësore apo sipërfaqësore për t'u shfrytëzuar ose marr masat e duhura sipas planit në funksion të qëndrueshmërisë afatgjate.

Zonat e rritjes - paraqet zhvillim të zonave ekzistuese me intensitet më të lartë dhe zhvillim të tokës së zbrazët të përshtatshme për plotësim, në mënyrë që të sigurohet shfrytëzimi racional i tokës. Ky

koncept përcakton zonat e rritjes bazuar të resurset dhe potencialet për zhvillim, me mundësi fokusi në tokat e zbrazëta të përshtatshme për plotësim.

3.3.2 Zhvillimi sipas sektorëve

3.3.2.1 *Ekonomia*

Me këtë Plan Zhvillimor Komunal (PZHK) janë planifikuar hapësirat, infrastruktura dhe institucionet komunale që do kontribuojnë në aftësimin e resurseve humane, zhvillimin e ekonomive familjare, që do të reflektojnë në uljen e papunësisë, duke zhvilluar zona dhe sektorë, duke ngritur kapacitete dhe mundësi tjera, ashtu që shumica e qytetarëve të Prishtinës ta gjejnë veten në tregun e punës.

Prishtina do të veprojë si qytet promovues i aktiviteteve ekonomike, të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si instrument kyç i zhvillimit për të ardhmen e vendit. Duke pasur parasysh të gjithë faktorët relevant në nivelin lokal si, burimet natyrore dhe njerëzore, menaxhimin e bizneseve, interesimin nga komuniteti ndërkombëtar, përmirësimin e sistemit kreditor dhe politikave fiskale, kryeqyteti e sheh sektorin privat si një nga bartësit kryesorë për rritjen dhe zhvillimin ekonomik në të ardhmen. Ky sektor sigurisht që do të ndihmojë në ngritjen e të hyrave në buxhetin komunal. Plani është në funksion të krijimit të një klime miqësore për biznesin, diversifikimit të sektorëve ekonomik, dhe sigurimit e zhvillimit të hapësirave, përmbytjeve e infrastrukturës në komplet territorin e Komunës së Prishtinës.

Për të implementuar vizionin e zhvillimit ekonomik, Prishtina do të ndërmerr veprimet e mëposhtme të cilat përfshijnë:

- **Ofrimi i shërbimeve** për bizneset në sektorë të ndryshëm të ekonomisë;
- **Investime direkte** në infrastrukturë, asete, shërbime, ngjarje dhe aktivitete të cilat e përmirësojnë funksionimin e qytetit;
- **Planifikim efektiv** për t'u siguruar që Prishtina bëhet një ndër qendrat e preferuara në rajon për biznes, shkollim, kulturë e sport;
- **Marketing dhe promovim** për të inkurajuar investimet, turizmin dhe vizitat tjera, dhe mundësitë biznesore;
- **Eliminimi i barrierave administrative** për ta bërë më të lehtë investimin në Prishtinë;
- **Mbështetja e të tjerëve** përmes granteve dhe ndihmave tjera, të dizajnuara për të nxitur më shumë aktivitete në biznes, por edhe sfera tjera të jetës;
- **Inkurajimi i partneriteteve dhe bashkëpunimit** në mes entiteteve qeveritare, në mes bizneseve dhe qytetit, por edhe në mes sektorit jo-qeveritar, për të arritur qëllimet e përbashkëta.

Prishtina qytet konkurrues në rajon

Prishtina do të bëhet më konkurruese në relacion me kryeqytetet e rajonit. Si qytet me pozicion strategjik, Prishtina do të forcojë lidhjet e saj me tregjet ndërkombëtare, duke e rritur ndër-veprimin me ekonominë rajonale, por edhe ato botërore. Fuqia e këtyre lidhjeve do të tregohet përmes rritjes së prezencës së korporatave multi-nacionale dhe rritjes së bizneseve ndërkombëtare.

Ekonomia e Prishtinës do të ndërtohet mbi disa prej sektorëve të fuqishëm që ka aktualisht, siç është industria financiare, ajo e teknologjisë informative, industria e logjistikës, tregtia me shumicë, ndërtimi, universitetet dhe edukimi, mediat dhe industritë tjera me vlerë të shtuar. Prishtina konkurruese në nivel rajoni, do të jetë qytet me diversitet, me komunitet i cili pasurohet nga studentët të cilët vijnë nga vende të ndryshme të rajonit, por edhe nga punëtorë të shumtë të qyteteve të rajonit. Duhet të theksojmë se Prishtina është qytet në të cilin veprojnë edhe shumë organizata ndërkombëtare, të cilat e rrisin nivelin e njohurive në vend. Për të konkurruar në rajon dhe më gjerë, Prishtina duhet të jetë qytet i jetueshëm,

qytet ku studentët kanë dëshirë të studiojnë, qytet ku profesionistët zgjedhin për të punuar, dhe qytet ku vizitorët vijnë për festivale e për turizëm kulturor e sportiv.

Vizioni i kryeqytetit është që të ketë një ekonomi të qëndrueshme, ku arrihen norma të qëndrueshme të rritjes ekonomike, dhe ku sektorët kryesor ekonomik kanë rritje të vazhdueshme. Një ekonomi e cila prodhon vende pune dhe mundësi për qytetarët e saj, por edhe për të tjerët që dëshirojnë të jetojnë në Prishtinë. Një ekonomi në të cilën bizneset shohin mundësi zhvillimi.

Kryeqyteti duhet të ndihmojë bizneset që ato të rrisin produktivitetin dhe të hapen mundësi të reja për të gjithë. Zhvillimi i bizneseve dhe mirëqenia e qytetarëve të Prishtinës janë të pandashme me njëra-tjetrën. Shumë nga sfidat me të cilat përballen qytetarët e Prishtinës, janë edhe sfida të biznesit. Ne të gjithë ndajmë sfidat e njëjta, si komunikacioni i ngarkuar, mungesa e parkingjeve, mungesa e hapësirave për biznese, mungesa e aftësive tek të rinjtë që kërkojnë punë, kaosi urbanistik, menaxhimi i mbeturinave e shumë probleme tjera. Largimi i barrierave për zhvillim të biznesit dhe rritja e produktivitetit në Prishtinë, janë vizioni për të ardhmen. Bizneset e vogla dhe ndërmarrjet e sapo krijuara (start-up) janë motori i ekonomisë së kryeqytetit, andaj kryeqyteti duhet t'i mbështes në çdo formë, edhe me financa, për t'u rritur dhe për të krijuar vende të reja të punës për të rinjtë tanë.

Arritja e Vizionit për Kryeqytetin

Plani Zhvillimor Komunal identifikon katër prioritetet strategjike të cilat do të japin rezultatet e nevojshme për arritjen e vizionit të kryeqytetit. Prioritetet strategjike fokusohen në ndërtimin e bazave ekonomike për sukses, marrjen e veprimeve për të adresuar sfidat e identifikuar dhe shfrytëzimin e përparësive për të arritur zhvillim ekonomik. Këto prioritetet strategjike janë:

- Fuqizimi i konkurrueshmërisë së kryeqytetit;
- Përmirësimi i produktivitetit dhe kapaciteteve të qytetit;
- Promovimi i mundësive të kryeqytetit; dhe
- Tërheqja e investimeve të jashtme.

Për të arritur vizionin, në fushën e zhvillimit ekonomik, planifikohen sa më shumë investime në ekonominë dhe industrinë informative, për të cilën planifikohet hapësirë, infrastrukturë e zbatim duke filluar me edukim dinjitoz; infrastrukturë teknike, transport, dhe infrastrukturë publike e sociale të përshtatshme.

Bujqësia është pjesë shumë e rëndësishme e ekonomisë së Prishtinës - kërkohet rritje e përkrahjes për sektorin e blegtorisë, gjedhtarisë, bletarisë, prodhimtarisë organike, perimtarisë, dhe kultivimin e pemëve të imta. Gjithashtu, në mënyrë që të zhvillohet bujqësia kërkohet ndërtimi i stallave, furnizimi me pajisje për mjelje, ftohje dhe dhoma të qumështit, pajisje për përgatitjen e ushqimit të koncentruar dhe racioneve të kafshëve dhe përmirësim i infrastrukturës përcjellëse në fermë. Kryeqyteti duhet të përmirësojë, zgjerojë dhe avancojë sistemin e ujitjes. Duhet më shumë përkrahje për bujqit në kultivimin e bimëve mjekuese dhe aromatike, financim të pikave të reja grumbulluese për bimë mjekuese dhe aromatike.

Përkrahje nga Komuna për fuqizimin e pikave grumbulluese, frigoriferike, duke u fokusuar më shumë në çështjet që ndihmojnë plasimin e produkteve në treg. Mbështetja në ngritjen e kapaciteteve të fermerëve përmes trajnimeve; me trajnime do të përkrahen kryesisht fermerët e hortikulturës (pemëve dhe perimeve), blegtorisë dhe bletarisë. Përkrahja e grave në biznes, kryesisht grave që merren me përpunimin e pemëve dhe perimeve, përmes kësaj përkrahjeje do të bëhet fuqizimi i ekonomive shtëpiake dhe promovimi i produkteve tradicionale "home-made", të grave punëtore të Prishtinës.

Qyteti i Prishtinës në mënyrë të përhershme duhet të angazhohet në promovimin e ngjarjeve të shumta industriale dhe tregtare që ndodhin në qytetin e Prishtinës. Një ndër to mund të jenë panairët e shumta të prodhimeve industriale dhe tregtare vendore. Prishtina si kryeqytet ofron turizëm tregtar

përmes aktiviteteve të shumta tregtare prej qendrave të mëdha tregtare të cilat tërheqin një numër të madh të qytetareve nga gjithë territori i Kosovës, por edhe nga vendet fqinje deri tek tregjet tradicionale që organizohen në komunën e Prishtinës. Përveç qendrave tregtare komuna e Prishtinës ofron një numër të panairëve të ndryshme promovuese dhe tregtare të produkteve vendore të cilat panairë tërheqin një numër të madh qytetareve në kryeqytet.

Ky dokument planifikimi ka për qëllim edhe ri-zhvillimin (zonat që munden të rrënohen dhe rrizhillohen) e zonave të caktuara për efekte ekonomike (rritjen e vlerës së potencialit ekonomik dhe fizik) por edhe duke ulur shkallën e rrezikshmërisë nga vjetërsia dhe dëmtimi i strukturave.

- Tregu te Ulpiana dhe korridori deri te katedralja;
- Lagjja Pejton;
- Rruga Agim Ramadani (zona afër parlamentit).

Ky dokument planifikon **zhvillimin e qëndrueshëm dhe të mençur të tregtisë industrisë dhe gastronomisë**:

- Prishtina si kryeqytet do të vazhdoj të jetë qendra kryesore e Kosovës por edhe e rajonit sa i përket kapaciteteve dhe hapësirave për tregti të mallrave ushqimore, teknologjisë, materialeve dhe makinerive ndërtimore, elementeve tjera etj.;
- Tregtia me shumicë do zhvillohet në korridoret kryesore zhvillimore por edhe disa zona të veçanta tregtare brenda qytetit;
- Tregtia me pakicë do shtrihet në gati të gjitha pjesët e zonës urbane por edhe zonat rurale;
- Tregu i banimit do jetë i larmishëm dhe i konsoliduar;
- Tregu i automjeteve do akomodohet në mënyrë adekuate;
- Kujdes do i kushtohet edhe funksionimit të tregut të përhershëm dhe tregjeve ditore në disa zona duke përfshirë edhe ri-zhvillimin e tregun e vjetër;
- Gastronomia, shërbimet hotelerie, restoranteve dhe kafeneve;
- Industria e lehtë dhe rëndë, planifikimin e disa zona të veçanta industriale brenda qytetit.

Ky dokument i planifikimit ka si qëllim definimin e zonave, zhvillimin e infrastrukturës dhe ndërtimin e kapaciteteve për të promovuar **sektorin e energjisë dhe infrastrukturën energjetike**, me theks të veçantë në **energjinë e ripërtëritshme**.

Për këtë qëllim synohet:

- Për fillim energjia termike synohet të zhvillohet me fazën e dytë të kogjenerimit;
- Planifikohet ngrohje edhe nga energjia diellore (solare), ngrohje me panele solare;
- Mbulim me ngrohje i disa zonave të reja të Prishtinës nga faza e parë e gazifikimit në sisteme dhe zona të vogla, deri sa të jetësohet gazsjellësi për Kosovën rrjedhimisht edhe Prishtinën;
- Projektet e EU-së për ndërtesa me sisteme të veçanta të ngrohjes me panele solare, dhe sisteme tjera;
- Efiçencë energjetike tek banimi dhe objektet publike;
- Ndriçimi publik me energji të ripërtëritshme; dhe
- Sistemi i ftohjes së Prishtinës përmes ko-gjenerimit.

PZHK e ka për qëllim edhe identifikimin e fushave dhe shërbimeve për **partneritete publiko private (PPP)** ose modalitete tjera si elemente të rëndësishme e zhvillimit ekonomik. Dokumenti synon ofrimin e shërbimeve në disa fusha e sektorë si dhe përmirësimin cilësisë:

- Do vazhdoj në kompletimin e fushës së infrastrukturës së transportit, paketa e parkingjeve mundet të kompletohet përveç disa parkingjeve që janë dhënë me PPP;

- Disa shërbime nga infrastruktura publike dhe sociale (përvoja me çerdhe, shërbime tjera të nivelit parashkollor, shkollor e universitar dhe infrastruktura tjera publike, deri te aktivitetet dhe infrastruktura kulturore sportive mund të analizohen si aset për PPP ose modalitete tjera (duhet të jenë rezultat i studimeve të arsyeshmërisë fizibiliteti);
- Edhe shërbimet e ndryshme teknike, të sigurisë nëpër zonat dhe institucionet e ndryshme por edhe fusha e sektorë tjera si banimi etj.

Qëllim tjetër është zhvillimi i kapaciteteve dhe infrastrukturës për zhvillimin e **Turizmit** në përgjithësi dhe turizmit të mençur në veçanti.

- Prishtina do të zhvilloj turizmin urban dhe rural, brenda zonës urbane do zhvillohen të gjitha llojet e turizmit ndërsa në disa zona rurale kryesisht agro-turizmi;
- Zona historike, trashëgimia kulturore në përgjithësi por edhe ajo arkitektonike, historike, shpirtërore janë asete të rëndësishme që do shfrytëzohen për zhvillimin e turizmit (me plan sipas kompetencave do të intervenohet ashtu që këto asete të jenë në funksion të zhvillimit ekonomik bazuar në studime dhe koncepte bashkëkohore);
- Në disa zona rurale do zhvillohet infrastruktura dhe elemente rekreativo-atrakte për të nxitur dhe zhvilluar edhe një lloj agro-turizmi (produkte bujqësore, bujtina, shteg për ecje, fusha dhe elemente sportive dhe rekreative, kapacitetet hoteliere, restorantet dhe përmbajtjet tjera të nevojshme);
- Prishtina do zhvilloj një zonë rekreative në afërsi të Obiliqit;
- Prishtina do të zhvilloj shumë elemente në zonën urbane për ta bërë Prishtinën tërheqëse, atraktive për t'u vizituar nga turistët (mbrojtja dhe zhvillimi i disa aseteve të trashëgimisë, vlerave dhe institucioneve të kulturës, sportit, distriktet inovative, hapësirave për lojëra, si dhe do zhvilloj më tutje kapacitetet hoteliere, restorantet dhe elementet tjera të infrastrukturës së qëndrueshme turistike); dhe
- Prishtina do zhvilloj identitetin, markën, turizmin virtual, riorganizimi i sektorit të mikpritjes dhe argëtimit.

Turizmi konferenciar /shkencor - Qyteti i Prishtinës, duke pasur parasysh traditën e shumtë në organizim të ngjarjeve të shumta shkencore, dhe duke marrë parasysh vizionin për të ardhmen e saj, atraktiv dhe me ekonomi të njohurive, duhet të planifikoj për mbështetje të konferencave të shumta shkencore dhe profesionale, konferenca për më shumë ndërkombëtarë. Kjo do të sjellë rritje të të ardhurave për qytetin, meqë para jo vetëm do të shkoj për ngjarjen e tillë, por do të shkoj dhe në jetë të natës, akomodim, ngjarje kulturore etj. Qytetet botërore i lidhin ato dhe i kombinojnë ngjarjet e shumta kulturore dhe ngjarjet sportive apo shkencore për të pasur një laramani të ngjarjeve. Sot në botë turizmi shkencor dhe i konferencave është një ndër gjeneratorët e shumtë të të ardhurave për qytete të shumta. Konkurrimi i Prishtinës në këtë kuptim do të ishte shumë i favorshëm për të.

Turizmi shëndetësor - Qyteti i Prishtinës mund të jetë konkurrent në ofrimin e shërbimeve shëndetësore në mënyrë të organizuar (siç e bën Shkupi apo Tirana). Qytetarët tanë nga diaspora gjatë pushimeve në Kosovë, i bëjnë të gjitha vizitat nëpër klinika të ndryshme mjekësore si stomatologji, estetike, mbjellje të flokëve etj. Qytetet në rajon dhe në botë, e kanë dhe turizmin shëndetësor të ndërlidhur me ngjarje kulturore dhe turistike ku mund të jetë shumë i favorshëm për qytetin e Prishtinës në aspektin ekonomik. Megjithatë turizmi shëndetësor nuk duhet vlerësuar vetëm si një shërbim shëndetësor apo vetëm si një shërbim turistik. Tërësia e shërbimeve turistike, që u ofrojnë njerëzve një jetesë më të shëndetshme, mund të trajtohen në kuadrin e turizmit shëndetësor. Disa mundësi konkrete për këtë janë "turizmi mjekësor", që përmbledhë ndërhyrjet kirurgjike apo trajtimet e tjera mjekësore nëpër spitale; "turizmi natyrës i kombinuar me mjekësi", që ofron shlodhje dhe qetësim psikofizik në komplekset natyrore; si dhe "turizmi i të moshuarve dhe i personave me aftësi të kufizuara", i cili krijon mundësinë e pjesëmarrjes në aktivitete sociale të llojllojshme dhe atë të akomodimit për një kohë të

gjatë në hotele apo qendra rehabilitimi. Të gjitha këto mundësi mund të vlerësohen si turizëm shëndetësor të cilat komuna e Prishtinës mund të ofroj. Turizmi shëndetësor, në bashkëpunim me shërbimet turistike dhe ato shëndetësore, kontribuon dukshëm në zhvillimin e të dy sektorëve, duke rritur investimet dhe punësimin jo vetëm në sektorin e turizmit, por edhe në atë të shëndetësisë. Turizmi shëndetësor siguron më shumë rritje ekonomike dhe punësim.

Turizmi kulturor - Qyteti i Prishtinës duke u bazuar në resurset e trashëgimisë kulturore, historisë së qytetit, ngjarjeve të shumta e të reja historike të kohës së re, ngjarjeve të shumta muzikore, artistike, mund të jetë qendër e artit dhe e kulturës bashkëkohore moderne, me të cilën duhet të mbajë dhe kultivojë përmes marketingut, konkurseve të shumta ndërkombëtare për ngjarje kulturore, që të mbajë dhe kultivojë pozitën e saj konkurruese. Mbështetja për marketing të qytetit të Prishtinës, duhet të shkojë për të gjitha pikat e forta të qytetit dhe me të cilat ka pse të mburret dhe të josh të tjerët për të ardhur dhe kaluar e shpenzuar në kryeqytet. Hapave të tillë është duke shkuar Prishtina. Kualiteti i jetës në kuptim të zbatimjeve të shumta që ofron qyteti duhet të jetë motiv dhe shtytje për investime të shumta nga qyteti në kombinim me partnerët privat, porse gjithsesi duke e parë këtë si një pjesë të strategjisë për rritjen ekonomike të qytetit të Prishtinës. Joshja përmes marketingut të qytetit duhet të shikohet si favor në joshjen e vizitorëve që të vijnë dhe qëndrojnë në Prishtinë, për më pak apo më shumë ditë, për të jetuar dhe/apo punuar, për të investuar, argëtuar, parë një koncert apo marrë pjesë në një festival.

Qendra Historike e Prishtinës përbën një nga zonat identitare të qytetit, ku janë të koncentruara objektet kryesore të trashëgimisë kulturore. Që të promovohet edhe më tutje kjo zonë është përcaktuar zona historike dhe zona mbrojtëse e zonës historike ku kërkohet që të bëhet një plan i veçantë.

Turizmi rekreativ e sportiv – Qyteti i Prishtinës me të rinjtë e saj brenda qytetit, kapacitetet e shumta të rinjve studentë, do të mund të organizon konkurse për ngjarje të shumta ndërkombëtare të pranueshme për ngjarje të ndryshme sportive, siç janë maratona vrapimi, gara çiklizmi, turnire të ndryshme sportive që mund të tërheqin ekipe sportive të ndryshme nga rajoni dhe më gjerë. Aktivitetet e tilla do të mund të ofrojnë kënaqësi për qytetarët dhe vizitorët. Prishtina në këto ngjarje ka traditë, vetëm se do të duhej të shikoheshin dhe të punohet se si të promovohen së bashku me organizimin e tyre. Qyteti i Prishtinës do të duhej të mbështeste dhe të ndiqte iniciativat e tilla me investime kapitale, të cilat investime do të mund të përdoren për ngritje të kualitetit të jetës. Të gjitha sportet vetanake, noti, mundja, boksi, sportet marcialë si dhe sportet grupore dhe të afërta me shoqërinë prishtinase si futbollit dhe basketbollit do të mund të mbështeten dhe të jenë qasje shumë e logjikshme dhe efikase në ngritjen e cilësisë së jetës, mbajtjen e të rinjve në qytet, joshjen e të rinjve në studime, joshjen e familjeve të reja dhe të kualifikuara të jetojnë dhe veprojnë në Prishtinë. Komuna e Prishtinës planifikon hapësira rekreative sportive të cilat hapësira do të ofronin dhe përmbushnin kërkesat e të rinjve dhe ekipeve të kategorive të ndryshme sipas nevojave të tyre.

Turizmi rural bujqësor - Komuna e Prishtinës ka analizuar potencialet e mundshme të zhvillimit të agro-turizmit, këto potenciale janë akomoduar në skenarët zhvillimor të komunës për vitet në vazhdimësi duke e mbështetur me objektiva dhe veprime konkret në arritjen e zhvillimit të këtij turizmi mjaft aktual në vend dhe më gjerë. Se si do të arrihet fuqizimi dhe zhvillimi i turizmit rural komuna ka paraqitur disa objektiva kryesore:

- Promovimi i politikave dhe sistemeve të qëndrueshme dhe të përqendruara në ushqim cilësor;
- Të promovohen dhe të zgjerohen mundësitë që konsumatorët dhe turistët të blejnë ushqim vendor, përfshirë tregjet lokale;
- Ruajtja dhe promovimi i traditave të veçanta lokale të ushqimit në nivel të BE-së dhe me organe të tilla si Këshilli i Shijes dhe Ushqim i Ngadaltë;
- Ritmi i diversifikimit ekonomik bujqësor është dhe do të jetë e nevojshme në komunitetin bujqësor;

- Ndërlidhja e bujqësisë prodhuese me turizëm rural.

Për ta përmbledhur gjithë këtë, mund të thuhet që rritja e prodhimeve agro-kulturore dhe rritja e agroturizmit mund të bëhet përmes ndihmës së ndërtimit të një kulture ushqimore vendore, përmes sigurimit të një përfshirjeje më të madhe lokale në prodhimin dhe përpunimin vendor dhe krijimin e tregjeve për fermerë.

Qëllim tjetër është edhe **zhvillimi i kapitalit njerëzor**, me institucione dhe infrastrukturë shkollore publike dhe private. Në kushtet e ekonomisë së re, ekonomisë së bazuar në dituri, kapitali njerëzor i mishëruar në popullsinë e Prishtinës është aset ekonomik më i rëndësishëm i vendit. Ashtu si edhe në vendet e tjera, suksesi i sistemit arsimor në ofrimin e shkathtësive kyçe që kërkohen në tregun e punës do të jetë një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e ardhshëm ekonomik. Qasja e barabartë në një sistem arsimor modern është gjithashtu një faktor po aq i rëndësishëm. Në këtë drejtim, Prishtina do të kompletoj dhe fuqizoj infrastrukturën shkollore publike dhe private dhe do të ofroj hapësira për këto institucione. Një faktor tjetër veçanërisht i rëndësishëm për ekonominë e Prishtinës por edhe të tërë Kosovës është arsimimi modern në promovimin e shkathtësive kyçe të cilat nxisin vetëpunësimin. Së fundi, nivelet më të larta të rezultateve në arsim rrisin shanset edhe për të konkurruar me sukses në tregjet e huaja të punës, krahas tregut të brendshëm.

Planifikohen investime në kapitalin njerëzor të cilat do të japin rezultatet e tyre në faza të mëvonshme, por kthimi në investime është i sigurt. Një fuqi punëtore më e aftë do të siguroj jo vetëm normë më të lartë të rritjes ekonomike, por edhe rritje gjithëpërfshirëse. Themelimi i shkollave profesionale dhe ndërlidhja e tregut të punës do t'i mundësoj fuqisë punëtore nga familjet e varfra të fitojnë aftësitë dhe shkathtësitë e duhura për t'u integruar në tregun e punës. Prishtina me këtë plan synon ngritjen e aftësive të fuqisë punëtore. Në një kohë kur papunësia në vend është shumë e lartë, paradoksi është se shumë ndërmarrje kanë problem të gjejnë punëtorë të shkathët. Mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar i dekurajon investimet dhe është pengesë për ndërmarrjet tona që të rrisin produktivitetin dhe konkurrueshmërinë e tyre.

Qëllim tjetër e ka edhe zhvillimin e institucioneve dhe infrastrukturës shëndetësore publike dhe private. Shëndetësia përpos aspektit social dhe cilësisë së jetës ka ndikim të madh edhe në ekonomi. Në këtë drejtim, Prishtina do të kompletoj dhe fuqizoj infrastrukturën shëndetësore publike dhe private dhe ofroj hapësira për këto institucione, një faktor tjetër veçanërisht i rëndësishëm për ekonominë e Prishtinës por edhe të tërë Kosovës është zhvillimi i të gjitha reparteve dhe shërbimeve. Së fundi, cilësia më e lartë dhe rezultatet në shëndetësi rrisin shanset edhe investime brenda Prishtinës/Kosovës dhe mos shpenzim të mjeteve të shumta financiare për trajtim jashtë vendit sikur se deri tani.

- Prishtina do të ndërtoj Spitalin e Qytetit;
- Prishtina do planifikoj hapësirat por edhe lehtësoj kushtet për institucionet shëndetësore publike e private ekzistuese të të gjitha niveleve dhe repartet;
- Prishtina do planifikoj hapësirat por edhe lehtësoj kushtet për institucionet shëndetësore publike e private që eventualisht munden të ofrohen me kërkesa qoftë për infrastrukturë, hapësirë, kushte etj.
- Analizoj dhe mundësoj bashkëpunim deri të partneritetet;
- Inicijoj debat për nevojat e spitaleve, reparteve shëndetësore por edhe industrisë së prodhimit të barnave dhe do mundësoj kushte të mjedisit fizik për institucionet, infrastrukturën dhe aktivitetet që lidhen me këto kërkesa në komplet territorin e komunës dhe kryeqytetit;

Ky dokument planifikimi njërin nga qëllimet e ka edhe **prodhimin dhe përpunimin e materialeve ndërtimore dhe mobilierive** duke alokuar hapësirë, krijuar infrastrukturë dhe kapacitete për përpunim të drurit, metalit plastikës etj. Sektori i ndërtimtarisë në vazhdimësi është duke u zhvilluar me një

shpejtësi të madhe në gjithë botën, ky trend ka prekur edhe qytetin e Prishtinës i cili është duke u ndërtuar me një fluks të madh. Ky sektor është një ndër sektorët me potencial të lart ekonomik në vend i cili sektor punëson një numër të madh të qytetarëve të cilët punojnë drejtpërdrejt në ndërtim apo në aktivitete që ndërlidhen me ndërtimtarinë. Duke analizuar potencialet ekonomike të sektorit të ndërtimtarisë dhe aktiviteteve që ndërlidhen me këtë sektor si: depo ndërtimore, betonierat, hapësira për makineri ndërtimore është e domosdoshme të planifikohet një hapësirë që do të centralizonte këtë sektorë të rëndësishëm ekonomik.

Komuna e Prishtinës ka për qëllim zhvillimin e bujqësisë dhe bujqësisë së mençur duke alokuar zona dhe infrastrukturë për grumbullim, përpunim dhe konservim të pemëve dhe perimeve, industri të përpunimit të miellit, industri të mishit, qumështit etj., lidhja e zinxhirit ekonomik bujqësor, rryllëzim dhe rryllëzim me dru industrial i zonave të caktuara. Komuna e Prishtinës synon me plan të ketë ekonominë bujqësore (veprimtari ekonomike në të cilën fitohen produkte finale me origjinë bimë dhe shtazore) të zhvilluar. Prishtina do të jetë lider në:

- Zinxhirin bujqësorë: grumbullim - përpunim (trajtim), konservim dhe tregtim të pemëve, perimeve, qumështit, bimëve, etj., përfshirë frigoriferët për ruajtje;
- Modernizimi i tregut të produkteve bujqësore;
- Rritja e kapaciteteve agro-prodhuese dhe përpunuese;
- Diversifikimi dhe zhvillimi i bizneseve të vogla bujqësore duke u bazuar në burime lokale dhe kryesisht për agro-turizëm;
- Integrim i bujqësisë alternative me turizmin, ferma agro-turizmi, vreshtari, frutikulturë;
- Industri të përpunimit të miellit dhe të mishit;
- Zhvillim i blegtorisë për agro-turizëm;
- Rryllëzim dhe rryllëzim me dru me kapacitete mjedisore si pjesë e bujqësisë së mençur dhe dru industrial në zona të caktuara të komunës së Prishtinës.

Prishtina do planifikoj hapësirat por edhe lehtësoj kushtet për zhvillimet bujqësore qoftë me iniciativë publike ose private që eventualisht munden të ofrohen me kërkesa qoftë për infrastrukturë, hapësirë, kushte zhvillimore. Prodhimi i qëndrueshëm bujqësor është shfaqur si një nevojë për të gjetur mënyra të prodhimit bujqësor që nuk degradojnë resurset natyrore dhe që në të njëjtën kohë sjellin prodhime bujqësore dhe të ardhura të larta. Meqenëse bujqësia varet kryesisht nga shërbimet e ofruara nga ekosistemet, bujqësia e qëndrueshme synon të zvogëlojë ndikimet negative mjedisore antropogjene përmes përdorimit të teknologjive të avancuara në ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së burimeve natyrore. Qëllimi i planit është zhvillimi i sistemit bujqësor që është produktiv dhe fitimprurës, ruan bazën e burimeve natyrore, tokën bujqësore me kualitet të lartë në pjesën veriore të qytetit të Prishtinës, konkretisht në fshatrat Bernicë e Epërme dhe e Poshtme, Progoc, Barilevë, Drenoc dhe Vranidoll, mbron mjedisin dhe rritë cilësinë dhe sigurinë e ushqimit. Po ashtu, është identifikuar dhe përkrahur sektori i agro-turizmit si potencial i zhvillimit, i cili sjellë mundësi të zhvillimit ekonomik, duke mundësuar një ndërlidhje mes prodhimit në fermë dhe gastronomisë në zonat rurale me potencial të zhvillimit të kësaj veprimtarie.

Agro-industria (përpunimi) si sektorë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik do të fuqizohet në të mirë të krijimit të një stabiliteti ekonomik dhe krijim e vendeve të punës. Bujqësia dhe agrobiznesi po zhvillohen me shpejtësi, tregjet ndërkombëtare po liberalizohen, sjellja e konsumatorëve po ndryshon dhe tregjet e reja si bioenergji dhe biokarburantet po evoluojnë. Duke marrë parasysh sipërfaqen e kufizuar të tokës për një familje, si dhe dendësinë e popullsisë, është e qartë se në kushtet aktuale vetëm bujqësia nuk mund të sigurojë zhvillim të suksesshëm rural. Megjithatë, në viset rurale janë duke u zhvilluar disa biznese që mund të kenë perspektivë edhe më tutje: grumbullimi dhe përpunimi i produkteve bujqësore (me theks të veçantë pemët), përpunimi i drurit që kohëve të fundit po zhvillohet mjaftë shumë, bizneset për grumbullimin e kërpudhave dhe frutave të tjera pyjore, bletaria, bimët

mjekuese, prodhimi dhe përpunimi i mishit. Një mundësi tjetër ka të bëjë me turizmin fshatar, i cili është fare pak prezent. Pra, duke pasur parasysh të gjitha mundësitë dhe potencialet që ka komuna e Prishtinës do të ishte e rëndësishme krijimi i një zone agro-industriale ku do të orientonte dhe përqendronte industrinë bujqësore.

Sektori i qumështit, një nga sektorët më të rëndësishëm, organizohet në disa ndërmarrje prodhuese dhe tregtare, të cilat merren me përpunimin dhe grumbullimin e qumështit nga fermerët nëpër shumë pika grumbulluese. Produktet kryesore janë: qumështi i pasterizuar, kosi me kajmak, jogurti, djathi, specat me ajkë, kajmak i freskët shtëpiak, dhe gjiza. Shitja e prodhimeve bëhet kryesisht në tregun e brendshëm.

Ky dokument planifikimi njërin nga qëllimet e ka edhe **zhvillimin e modeleve të kontraktimit të jashtëm, TIK-u**, programimi dhe procesi i zhvillimit dhe fuqizimit të bizneseve në funksion për tregjet brenda Prishtinës, Kosovës e sidomos në tregjet e jashtëm:

- Bazuar në faktet nga analiza e gjendjes së globalizimit është një koncept gjithnjë e më i theksuar në të gjitha dimensionet, dhe bota po lëviz drejt një tregu të vetëm. Në këtë proces të liberalizimit të tregut, jo me kufi tërreptë tregtar për vendet.
- Prishtina planifikon që kontraktimin e jashtëm ta trajtoj si një shans dhe mundësi për zhvillim, korporatat shumëkombëshe duhet të kenë interes: së pari, kostot e punës janë më të lira, është e lehtë të hysh në treg, qasja në lëndët e para, zinxhiri i furnizimit dhe aktivitetet e logjistikës janë më të lehta sesa vendet perëndimore, të gjitha këto ulin shpenzimet operative.
- Për këto arsye edhe shumë të tjera disa nga kompanitë planifikohet se munden ti transferojnë aktivitetet e tyre të brendshme dhe të drejtat e vendimit për veprim tek furnitorët ose kompanitë e Prishtinës. Këto kompani të huaja mund të punësojnë ndonjë kompani nga Prishtina për të bërë një pjesë të punës së saj, në vend që të përdorë punonjësit e saj për ta bërë atë.
- Përmirësimi i cilësisë së produktit ose shërbimit, hyrja në tregje më të mëdha dhe rritja e numrit të klientëve të bizneseve të tjera janë objektiva të kësaj komponente.
- Prishtina do fusë në lëvizje kapitalin njerëzor dhe infrastrukturë të bollshme me kosto të ulët
- Qeveria komunale e Prishtinës dhe ajo e Kosovës duhet të orientohet në marrëveshje të jashtme si një pionier për zbutjen e papunësisë por edhe zhvillimin ekonomik, si një platformë ekonomike që përshpejton futjen e teknologjive të reja, fondeve të mëdha të brendshme dhe formë e investimeve të qëndrueshme
- Planifikohet të shfrytëzohet mundësia e globalizimit që ka prekur të gjithë botën dhe vendet e zhvilluara dëshirojnë të përdorin fuqinë punëtore të lirë të vendeve në zhvillim, lëndët e para, energjinë etj. Ata kanë filluar të përfitojnë nga më shumë mundësi. Kompanitë përdorin vendet në zhvillim për prodhim, për shkak të kostove më të ulëta duke bërë që këto vende të arriten të krijojnë një zinxhirë vlerash më efikase.
- Plani e merr si referim ekonominë e njohur, duke forcuar kështu prezencën në territorin e biznesit dhe qendrave të reja (BQR) dhe inkubatorëve, ashtu që me lidhjen e kërkimeve me botën e korporatave mund të ndihmojë fillimin e procesit të ndërmarrjeve të reja, dhe në këtë drejtim për kompani fillestare duhet sigurohen: hapësirat adekuate, përkrahje me ngritje të kapaciteteve për operim në këto tregje (për bashkëpunim të mirë në rrjetet ndërkombëtare të biznesit, parakushti kryesor për ndërmarrjet është që të kemi një platformë të fortë kombëtare të shkencës themelore me dalje në biznesin e aftësive R&D. Ky është roli i BIC dhe i inkubatorëve, infrastrukturës adekuate etj.

- Prishtina do planifikoj hapësirat por edhe lehtësoj kushtet për zhvillimin e modeleve të kontraktimit të jashtëm, TIK-u, programimi dhe procesi i zhvillimit dhe fuqizimit të bizneseve në funksion për tregjet brenda Prishtinës, Kosovës e sidomos në tregjet e jashtëm;
- Prishtina do planifikoj hapësirat por edhe lehtësoj kushtet për zhvillimet e tilla që eventualisht mundën të ofrohen me kërkesa qoftë për infrastrukturë, hapësirë, kushte etj.;
- Analizoj dhe mundësoj bashkëpunim deri te partneritetet, inicioj debat për nevojat e zhvillimeve të lartpërmendura, do mundësoj kushtet të mjedisit fizik për të gjithë të interesuarit, infrastrukturën dhe aktivitetet që lidhen me këto kërkesa në komplet territorin e komunës dhe kryeqytetit;

Bashkëpunimi me komunat fqinje është synim tjetër shumë i rëndësishëm i komunës së Prishtinës. Në funksion të zbatimit të konceptit të Trekëndëshit të Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, Prishtinës Metropolitane por edhe të interesave të ndërsjella me komunat fqinje, PZHK e Prishtinës do vihet në funksion të zhvillimit të përbashkët ekonomik.

- Funksionalizimi i planifikuar i korridoreve zhvillimore Prishtinë-Lipjan, Prishtinë-Graçanicë, Prishtinë-Obiliq, Prishtinë-Podujevë;
- Funksionalizimi i planifikuar i zonës Ekonomike Prishtinë-Fushë Kosovë;
- Zona ekonomike me Obiliqin dhe zona rekreative turistike;
- Rritjes së bashkëpunimit në shfrytëzimin e potencialeve turistike si vlerave të trashëgimisë kulturore, natyrore dhe potencialeve tjera;
- Ndërtimit, funksionalizimit dhe modernizimit të infrastrukturës së transportit dhe transportit duke përfshirë edhe stacionin multimodal e hekurudhën;
- Rritjes së bashkëpunimit në shfrytëzimin e resurseve tjera minerare (nëntokësore) dhe pasurive sipërfaqësore, përfshirë energjinë e ripërtërishme;
- Rritjes së bashkëpunimit në shfrytëzimin e infrastrukturës teknike dhe sociale;
- Rritjes së bashkëpunimit në përmirësimin e cilësisë së tokës, ujit, ajrit dhe reagim ndaj fatkeqësive deri te rezilienca.

Ky dokument planifikimi njërin nga qëllimet e ka edhe krijimin e kushteve dhe infrastrukturës për zhvillimin e sektorit të ndërtimtarisë. Ndërtimtaria është zhvilluar si në kuptimin e materialeve, teknologjive dhe elementeve të para-fabrika, dhe të gjitha munden të përdoren në atë që quhet zgjidhje e mençur:

- Ofrohen zona për prodhim dhe përpunim të materialeve ndërtimore (prodhimi i betonit, zhavorrit, asfaltit dhe materialeve tjera si dhe përpunimi i drurit, metalit, plastikës etj.);
- Zyrtat e kompanive dhe byrove projektuese mund të vendosen gjithandej zonës urbane por me fokus në korridoret zhvillimore;
- Duhet të planifikohen edhe zona të caktuara për makineritë e kompanive dhe depot e materialeve ndërtimore;
- Riorganizimi i sektorit të ndërtimit, ndërtim bashkëkohor dhe i përballueshëm;
- Duhet të mendohet edhe tërheqja e ndonjë prodhuesi vendor ose ndërkombëtar të makinerive dhe veglave të ndërtimit.


Zonat ekonomike - Fatkeqësisht, Komuna e Prishtinës nuk ka ndjekur trendin e komunave tjera në krijimin e një zone ekonomike, të mbështetur në Ligjin për Zona Ekonomike. Me PZHU janë të detajuara një zonë ekonomike dhe dy zona industriale. Zonat industriale shtrihen në aksin rrugor Prishtinë-Fushë Kosovë. Nuk ekzistojnë të dhëna apo studime lidhur me strukturën e bizneseve dhe punësimit ose të dhëna më të detajuara lidhur me aktivitetin ekonomik në këto zona. Zgjerimi i hapësirave ku do të koncentroheshin veprimtaritë ekonomike dhe industriale, u planifikuan edhe në Planin Strategjik 2004

për Prishtinën. Plani kishte planifikuar zonat ekonomike dhe industriale duke i vendosur në dy tërësi hapësinore:

1. Në kuadër të zonave industriale ekzistuese përgjatë aksit Prishtinë-Fushë Kosovë, dhe
2. Duke planifikuar zgjerim të zonave ekonomike-industriale për 600ha të shtrira në pjesët veri-perëndimore të komunës.

Vlerësimi rezultoi se në kuadër të zonave ekzistuese, nuk u zhvillua industri prodhuese apo përpunuese, por aty u vendosën një sërë objektivësh arsimorë dhe u zhvilluan veprimtari tregtare, por jo në masë të kënaqshme. Gjithashtu, në këto hapësira u zhvillua banimi joformal ndër vite. Zgjerimi i zonave industriale ekonomike për 600ha shtesë, nuk ndodhi, ndonëse u hartua edhe një Plan Rregullues Urban-Zona Ekonomike, me qëllim të lehtësimit të vendosjes së veprimtarive. Këto biznese ishte e paraparë të shfrytëzojnë infrastrukturë ndërlidhëse, dy unaza të jashtme, të cilat për shkak se nuk u ndërtuan, bizneset të tërhequra nga inercioni, shumica e tyre komerciale dhe industriale, u vendosën në mënyrë të paplanifikuar përgjatë korridorit Prishtinë-Lipjan, lokacion ku furnizimi i bizneseve ishte më efektiv dhe më i shpejtë.

Zhvillimi më i madh ka ndodhur në aksin rrugor Prishtinë-Ferizaj që është vetëm hapësirë e identifikuar, pa infrastrukturë përcjellëse dhe në shumë raste shumë afër banimit. Për zhvillimin e kapaciteteve industriale në këtë zonë, prioritet duhet dhënë edhe aktiviteteve ekonomike që bëjnë punësim më të madh, janë industri të pastra, nuk janë shpenzues të mëdhenj të energjisë elektrike dhe të ujit industrial.



Harta 35 Koncepti i zhvillimit ekonomik

Në kuadër të Komunës së Prishtinës, nevojitet krijimi i një **Zone të lirë ekonomike apo Parku teknologjik**, ku me koncentrimin e veprimtarive të ndryshme ekonomike, do të mundësohej infrastrukturë adekuate, dhe do të ofroheshin lehtësime të ndryshme.

Zhvillimi i zonave ekonomike rrugës për Fushë-Kosovës, në Veternik, rrugës për Mitrovicë, në drejtim të Obiliqit nga Qendra e Panairëve, në drejtim të Podujevës, në drejtim të Graçanicës, në zona

të tjera publike dhe private, duke promovuar dhe integruar edhe komunat e vogla përreth në qasjen e zhvillimit metropolitan të Prishtinës.

3.3.2.2 Infrastruktura teknike

Rrjeti i ujësjellësit

Konceptet themelore të planifikimit dhe modelimit të sistemeve të furnizimit me ujë janë formuar mirë dhe aktualisht përdoren gjerësisht. Sistemi unik i ujësjellësit siguron ujë me cilësi të pijshëm pa marr parasysh numrit të konsumatorëve dhe sasisë së nevojshme për ujë.

Pavarësisht, nga disponueshmëria e teknologjisë së përparuar, koncepti zhvillimor i ujësjellësit premtan planifikim dhe furnizim të qëndrueshëm për furnizim me ujë të pijes në të ardhmen.

Në vizionin e konceptit është paraqitur nevoja për ujë të sigurt dhe disponueshëm për të gjithë për të mbështetur nevojat themelore të qytetarëve dhe integritetin e ekosistemit. Zhvillimi i qëndrueshëm i qyteteve varet kryesisht nga zhvillimi i qëndrueshëm i ujit pasi çdo pore e jetës lidhet ngushtë me burimet ujore.

Ekzistojnë një numër faktorësh që sfidojnë furnizimin e qëndrueshëm me ujë në komunën e Prishtinës të cilëve në kuadër të këtij koncepti ju është qasur në mënyrë serioze në ofrimin e zgjidhjeve për të ardhmen. Disa nga këta faktorët të cilëve ju është dhënë zgjidhje janë si: vjetërsimi i infrastrukturës së ujësjellësit mungesa e një strategjie për ofrimin e shërbimeve të ujit, çështjet specifike të ujëmbledhësve (ndryshimet klimatike), mungesa e njohurive në lidhje me hidrologjinë e tanishme dhe të ardhshme, parashikimi i saktë i kërkesës për ujë, funksionimi optimal i sistemeve të furnizimit me ujë, cilësia e ujit (ndotja e ujit), mungesa e ujit, rrjedhjet e ujit, përdorimi i pakontrolluar i ujit, urbanizimi i shpejtë, rritja e popullatës, migrimi, zhvillimi ekonomik, mungesa e burimeve alternative të ujit, sistemet dinamike dhe të pasigurta të ujit urban, rrjetet inteligjente të ujit (që nuk mbështeten nga teknologjia e informacionit dhe komunikimit).

Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë të vitit 2011, komuna e Prishtinës kishte 198,897 banorë dhe një normë të projektuar të rritjes së numrit të popullsisë, në vitin 2021 Komuna e Prishtinës kishte 219,017 banorë. Prej tyre, me shërbime të ujësjellësit janë 201,452 banorë, apo 92%, kurse me shërbime të kanalizimit komuna qëndron më mirë sesa ato të ujësjellësit, ku 203,221 kanë qasje në shërbimet e kanalizimit, apo rreth 92.8% e popullsisë.

Numri i konsumatorëve në Prishtinë është 90.576 prej tyre: Amvisëri (78,309); Biznesi (11.767); Institucione (500); OJQ (15). Komuna e Prishtinës përmbushë obligimet në furnizimin e rregullt të gjithë qytetarëve me ujë të pijshëm dhe atë: 83% të ditëve në vit me furnizim të pa ndërprerë me ujë të pijshëm me furnizim sipas raporteve vitit 2020-2021 të kompanisë së ujësjellësit rajonal.

Sfida kryesore të furnizimit të qëndrueshëm me ujë është mungesa e politikave zhvillimore të përshtatshme për furnizimin me ujë. Koncepti arrin në përfundimin se ekziston nevoja për të hartuar politika dhe programe që marrin në konsideratë diversitetin urban për të lehtësuar shërbimet e qëndrueshme të furnizimit me ujë.

Resurset ujore

Komuna e Prishtinës si kryeqytet i Republikës së Kosovës, me një densitet të lartë të zhvillimit urban ka sfida të theksuara në furnizimin e qëndrueshëm me ujë, prandaj koncepti zhvillimor ka paraqitur zgjidhje profesionale në ofrimin e shërbimeve të qëndrueshëm për ujë të pijes për të gjithë qytetaret gjatë gjithë kohës. Koncepti zhvillimor ngërthen në vete një zhvillim të qëndrueshëm duke fuqizuar dhe mbrojtur burimet kryesore të ujit, si mundësi të vetme për furnizim stabil dhe në vazhdimësi. Mbrojtja e

këtyre burimeve është e mbështetur në UA për kriteret e përcaktimit të zonave të mbrojtura sanitare të burimeve të ujit i cili ka përcaktuar qartazi parimet për mbrojtjen e burimeve ujore.

Liqeni i Badovcit, Batllavës, si burim furnizimi me ujë për pjesën e Prishtinës, për arsye të afërsisë me qytetin, do të jetë edhe resurs që mund të shfrytëzohet për aktivitet relaksuese për banorët e Prishtinës, por gjithmonë duke ruajtur prioritetin si resurs i furnizimit me ujë. Mbrojtja dhe implementimi i zonave mbrojtëse për liqenin është e rregulluar me Ligjin e ujërave.

Koncepti fuqizon edhe përdorimin e ujit teknik në disa zona, si burimet e Kolovicës me një sasi prej 50-60l/s do të mund të përdoren si burime teknike të ujit për ujitjen e parqeve, fushave sportive dhe pishina, ku në kombinim me sasi të ujit të lumit Prishtina do të mundësonin krijimin e një lagune ujore që do të shërbente edhe si akumulim për mbrojtje nga vërshimet.

Burimet e Gërmisë duhet të rregullohen dhe vendosen si burime të mbrojtura nga qyteti i Prishtinës, si burime me rëndësi për pushuesit e shumtë në Parkun e Gërmisë dhe njëkohësisht të përdoret gjatë sezonit veror si ujë i freskët për pishinën e Gërmisë si dhe burimet artificiale, ku uji i cili do të grumbullohet nga pullazet e ndërtesave e shtëpive individuale dhe sipërfaqet e urbanizuara do të grumbullohen, përpunohen dhe do të përdoren për ujitjen e parqeve, fushave sportive dhe pishina.


Përveç, burimeve ujore koncepti fuqizon edhe ndërtesat (fabrikat) për përpunimin e ujit si dhe sugjeron rritjen e kapaciteteve përpunuese dhe prodhuese të ujit duke rritur kapacitetet e prurjeve të ujit nga burimet kryesore për të plotësuar kërkesat për ujë në tërë qytetin e Prishtinës. Për të arritur një furnizim të qëndrueshëm përveç mbrojtjes së burimeve ujore dhe shtimin e kapaciteteve prodhuese dhe përpunuese të ujit, që ky furnizim të jete real është planifikuar edhe infrastruktura përcjellëse si fuqizimi i gypave kryesorë, zëvendësimi i atyre të vjetërsuar dhe me përmbajtje Azbest-Çimentos, Çelik etj., krijimin e zonave (DMA) për monitorimin e ujit i cili do të ndikoj në zvogëlimin e humbjeve teknike dhe komerciale, zgjerimi dhe ndërtimi i rezervarëve të rijë për depozitimin e ujit dhe rritjen e kapaciteteve të pompimit në pjesë të ndryshme të rrjetit me qëllim të furnizimit stabil dhe gjithëpërfshirës, duke mbuluar edhe zonat e larta me ujë.

Furnizimi me ujë të pijes

Plani i furnizimit me ujë të pijes parasheh zgjerimin e fabrikës së ujit Shkabaj, zgjerimin, ndërtimin e rezervuarve të rinj dhe stacioneve të pompave. Zgjerimi i rezervuarëve është planifikuar në Shkabaj, Veternik dhe Mat (Mirdita IV), ndërsa rezervuarët e rinj janë planifikuar në Veternik, Mat (Mirdita VI), Hajvali, Bardhosh dhe Grashticë në pika që arrijnë mbulimin e zonave me presion të mjaftueshëm. Zgjerimi i stacionit të pompave në Park me $Q=400 \text{ l/sec}$, si stacion qendror që do të transportonte ujin nga rezervuari i Arbërisë në drejtim të Matit dhe stacioni i pompave në Emshir që do të transportonte ujin nga Shkabaj në drejtim të Veternikut, do të jenë stacionet kryesore për furnizimin e një pjese të madhe të qytetit. Gjithashtu, stacionet e pompave në Badovc, Mati III, Veternik dhe Bërnice do të shërbejnë si stacione furnizuese dhe për mbajtje të presionit.

Koncepti zhvillimor i furnizimit me ujë ka përcjellur gjithashtu zhvillimet urbanistike duke ofruar zgjidhje dhe furnizim me ujë në zonat e parapara për zgjerim ndërtimor pra, duke mundësuar ofrimin e shërbimeve për të gjithë qytetaret në gjithë territorin. Përveç zonës urbane koncepti ka analizuar dhe ofruar zgjidhje edhe për zonat rurale ku në pjesën më të madhe të vendbanimeve rurale janë ofruar zgjidhje profesionale të furnizimit me ujë dhe infrastrukturë të ujësjellësit. Ndërsa zonat me të thella rurale me topologji të vështira hapësinore janë propozuar mundësi të puseve kolektive të cilat do të mundë të realizoheshin me kosto me të arsyeshme financiare dhe do të mund të jenë të kontrolluara nga IKSHP, por përveç mënyrës së furnizimit me puse kolektive, komuna varësisht prej politikave të tyre mund të ofroj shërbime të ujit duke shfrytëzuar kapacitetet e burimeve ekzistuese duke përdorur

Përveç, furnizimit të qëndrueshëm me ujë të pijes dhe përmirësim të infrastrukturës koncepti zhvillimor orienton zhvillimet duke përdorur konceptin smart në infrastrukturën e ujit, duke propozuar vendosjen e ujë matësve zonal smart, njëhësor të mençur me lexim në distancë si dhe sensor për monitorim të rrjetit të ujësjellësit.



Ujitja, drenazhimi dhe ujërat atmosferik

Koncepti zhvillimor jep drejtim në mundësitë dhe potenciale të cilat posedon komuna e Prishtinës në rivitalizimin dhe zgjerimin e sistemit të ujëtjes të tokave bujqësore në këtë komunë.

Komuna, përveç ujitjes së tokave bujqësore ka zhvilluar konceptin e shfrytëzimit të ujërave atmosferik me mundësi të depozitimit duke planifikuar rezervuarët për deponim të ujërave industrial dhe teknik, ujërat e depozituar në rezervuar industrial i cili duhet të ketë një kapacitet prej 5000 m³ i vendosur

në lokacion afër zonës industriale të Prishtinës ku do të mund të shfrytëzohet nga ndërmarrjet industriale. Ndërsa në rezervarët e ujërave teknik do të grumbullohet uji nga reshjet atmosferike dhe pastaj do të mund të përdoret për ujitjen e parqeve dhe oazave të gjelbërta. Gjithashtu komuna ka paraparë mundësinë e shfrytëzimit të burimeve ujore në Gërmë, Kolovicë dhe Llukarë me mundësi të shfrytëzimit të këtyre ujërave për ujë teknik për parqe, zjarrfikës, larje të rrugëve dhe forma të tjera.

Tjetër koncept për ruajtje të ujit të pijes komuna planifikon mundësinë e shfrytëzimit të ujërave nëntokësore për ujitjen e parqeve dhe oazave të gjelbra duke hapur puse dhe pastaj duke instaluar sisteme të ujitje pik-pikë, sistem të cilat janë mjaft efikase në ujitjen e hapësirave të gjelbra (drunjtë, lulishte etj.).

Sa i përket ujërave atmosferik komuna posedon një mbulueshmëri të ulët me rrjet të largimit të ujërave atmosferik i cili gjithashtu ballafaqohet me probleme të menaxhimit për arsye të kyçjeve ilegale të kanalizimeve fekale. Sa i përket trajtimit të këtyre ujërave në të ardhmen, komuna e Prishtinës planifikon ndërtimin e rrjeteve të reja për menaxhim të këtyre ujërave dhe pastaj duke i trajtuar dhe shfrytëzuar këto lloje ujërave në aspektin teknik. Po ashtu koncepti sugjeron që në të ardhmen të gjitha rrugët e reja që do të ndërtohen do të dizajnohen dhe realizohen duke përmbytur rrjetin e veçanta të ujërave atmosferik.

Ndarja e ujërave të zeza nga ato të bardha është e domosdoshme në të ardhmen për arsye të menaxhimit më të lehtë të ujërave.

Ujërat e ndotura (Kanalizimi)

Infrastruktura teknike me të gjitha degët e saj është një faktor shumë i rëndësishëm që ndikon në zhvillimin ekonomik dhe social të një vendi.

Duke qenë se Komuna e Prishtinës si kryeqytet ka një densitet të lartë urban, për shërbimet të kanalizimit komuna qëndron më mirë sesa ato të ujësjellësit, ku 203,221 kanë qasje në shërbimet e kanalizimit, apo rreth 97%, por një pjesë e popullsisë ballafaqohet me sfida të mëdha në menaxhimin e ujërave të ndotura e sidomos vendbanimet rurale, andaj me qëllim të përmirësimit të mirëmbajtjes dhe funksionalizimit të rrjetit ekzistues të kanalizimit në Komunën e Prishtinës, komuna në bashkëpunim me K.R.U. Prishtina, kanë paraparë disa projekte në aspektin e rivitalizimit të rrjeteve ekzistuese dhe shtrirjen e rrjeteve të reja në zonat dhe vendbanimet të cilat nuk kanë shërbime me theks të veçanta në vendbanime rurale, kërkohet të shikohet mundësia e ofrimit të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të zeza. Vlen të përmendet se një pjesë e vendbanimeve rurale nuk është e kyçur në rrjetin e kanalizimit që shkakton probleme për mjedisin.

Largimi dhe trajtimi i ujërave të ndotur, do të përfshijë gjithë territorin komunal. Largimi do të bëhet përmes implementimit të projekteve të ndërtimit të kolektorëve kryesorë që do të largojnë (transportojnë) ujërat e ndotur nga të gjitha zonat në mënyrë gravitacionale do të përcjellin tërë sasinë deri në impiantin për trajtimin e ujërave të ndotur në periferi të qytetit të Fushë Kosovës, Obiliqit dhe në impiante të veçanta në zonat e Prishtinës. Në zonat e pandërtuara dhe që janë në proces të ndërtimit, do të zbatohen sistemet e ndara të kanalizimeve, ndërsa në zonat ekzistues, intervenimet në sistemin ekzistues dhe rehabilitimet, do të mundësojnë zvogëlimin e sistemit të kombinuar në mënyrë që sasia e ujit të ndotur në impiantin për trajtim, të jetë sa më pak me ujëra të shiut.


Kështu, duke pasur parasysh gjendjen ekzistuese në Komunën e Prishtinës dhe vështirësitë e menaxhimit të rrjeteve ekzistuese, janë planifikuar kolektor me qëllim të grumbullimit të ujërave të zeza në zonat e përcaktuara si në hartë si dhe është paraparë ndërtimi i impiantit, me opsione të sugjeruara në aspektin hapësinor në Komunën e Fushë Kosovës apo në komunën e Obiliqit me qëllim të trajtimit të ujërave të zeza.

Po ashtu, në zona rurale trajtimi i ujërave të zeza është parapare përmes dy opsioneve, opsioni i para përmes gropave septike kolektive ku do të mund të menaxhoheshin nga K.R.U. Prishtina si dhe opsioni i ndërtimit të dy mini-implianteve dhe kolektorëve për trajtimin e ujërave të zeza të cilat në aspektin menaxhimit dhe mirëmbajtjes janë më të favorshme, por në të ardhmen do të definohen përmes masterplaneve apo fizibilitetit.

Prandaj, për përmirësimin e gjendjes ekzistuese në aspektin e menaxhimit dhe rivitalizimit të rrjetit të ujërave të zeza ka ndërmarr këto veprime: Ndërtimin i implantit kryesor për trajtimin e ujërave të zeza, ndërtimin e kolektorëve për grumbullimin e ujërave të zeza, ndërtimi i dy mini-implianteve dhe kolektorëve në zona rurale si dhe shtrirjen e rrjeteve të reja të ujërave të zeza.

Lokacionet e përcaktuara për sistem të trajtimit të ujërave të ndotur, kanë marrë parasysh kushtet teknike sa më të favorshme për grumbullimin e ujërave të zeza, kostot më të ulëta, përfshirjen sa më të lartë të lidhjes së banorëve dhe relacionet me komunat tjera, si dhe kushtet mjedisore për vendosjen e sistemeve të trajtimit.

Në zonat e pandërtuara dhe që janë në proces të ndërtimit, do të zbatohen sistemet e ndara të kanalizimeve, ndërsa në zonat ekzistues, intervenimet në sistemin ekzistues dhe rehabilitimet, do të mundësojnë zvogëlimin e sistemit të kombinuar në mënyrë që sasia e ujit të ndotur në impiantin për trajtim, të jetë sa më pak me ujëra të shiut.



Harta 37 Koncepti i zhvillimit të sistemit të kanalizimit

Dy kolektorët - ai i Prishtinës dhe kolektori paralel me Lumin Graçanka, bashkë me ujërat e Fushë Kosovës dhe Graçanicës do të shkojnë në fabrikën e trajtimit në Fushë Kosovë, ndërsa ujërat e shiut do të shkarkohen përmes kolektorëve të ndarë në lumenjtë që mundëson konfiguracioni i terrenit . Kolektori nga pjesa e zonës së Shkabajve, një pjesë e Kodrës së Trimave dhe Arbërisë do të transportohen në drejtim të Obiliqit dhe që bashkë me ujërat e ndotur të Obiliqit, do të trajtohen në një sistem të trajtimit të përbashkët. Pjesa veriore e Prishtinës përmes kolektorit paralel me Lumin Siçeva dhe Bërnica dhe së bashku me ujërat e ndotur të disa fshatrave të Prishtinës, mund të trajtojnë ujin e ndotur në një impiant të veçantë në periferi të Bardhoshit. Sasia e përgjithshme e ujit që do të shkarkohet

dhe do të trajtohet, do të jetë $Q=1550$ l/sec. Trajtimi i ujërave të ndotur konform edhe Studimit të fizibilitetit nga Komisioni Evropian, planifikohet të ndërtohet në periferi të qytetit të Fushë Kosovës dhe që do të përfshinte edhe trajtimin e ujërave të ndotur nga Prishtina, Fushë Kosova dhe Graçanica. Realizimi i projektit të kolektorëve dhe trajtimit të ujërave të ndotur, do të duhej të finalizohet brenda afatit prej shtatë vjetësh, ndërsa kriteret e trajtimit të ujërave të ndotur, duhet të plotësojnë kriteret ligjore për ujin, që dalin nga trajtimi dhe largohen në efluate (trupi uhor pranues i ujërave të shkarkuara) në harmoni edhe me rregullativën mjedisore të BE-së.

Poashtu edhe një pjesë e zonës rurale do të mbulohet me kolektor, përkatësisht fshatrat: Makoc-Grashticë-Mramor, Mramor-Busi, Kukë-Slivov, Dabishec-Gllugovicë-Marec, Nishec-Prapashticë, Ballaban-Keqekollë-Sharban-Rimanisht-Koliq, Vranidoll-Drenoc-Bërrnic e epërme.

Energjia elektrike

Bazuar edhe në planet zhvillimore të Korporatës Energjetike të Kosovës, strategjinë e energjisë 2017 - 2026 dhe strategjitë e transmisionit KOSST janë nxjerrë edhe planifikimet konkrete të sektorit të energjisë që janë në harmoni me vlerësimin e gjendjes dhe të gjeturat kryesore nga kjo analizë. Burimet e energjisë do të jenë ato nga strategjia për energjinë që nënkupton termo-elektranat dhe burimet e ripërtërishme, Prioritetet e listuar më poshtë dhe implementimi i tyre do të sigurojnë një qëndrueshmëri në furnizimin me energji elektrike.

- Ndërrimi i trafo-stacioneve 35/10 kv me trafo-stacione 110/20(10)kv, e cila kërkohet me Master Planin e Republikës së Kosovës;
- Ndërtimi i linjave dhe trafo-stacioneve të reja për ta zvogëluar mbingarkesën dhe për t'iu përgjigjur kërkesave në rritje të konsumatorëve;
- Koordinimi i vendosjes së kabllave energjetike nëntokësore;
- Planifikimi me kohë i kanalizimit kabllor nëntokësor për rrjetin energjetik, telekomunikues dhe të ndriçimit publik;
- Planifikimi i stacioneve transformatorike në përputhje me rritjen e banorëve sipas projeksioneve demografike;
- Kushtëzimi i ndërtimeve me përdorimin e energjisë elektrike në mënyrë eficiente, përdorimin e energjisë alternative;
- Krijimi i hapësirave për panele solare për prodhimin e energjisë elektrike.

Përmirësimi i rrjetit ekzistues

Gjatë periudhës në vazhdim synohet të zëvendësohen të gjitha shtyllat me qëllim të evitimit të rrëzimit të tyre me ç'rast një numër i madh konsumatorëve mund të mbesin pa tension, meqenëse shumica e tyre janë të vjetra. Gjithashtu brenda një periudhe të shkurtër parashihet të zëvendësohet përçuesi, meqë rrjeti ekzistues nuk ka asnjë përçues të izoluar sepse ai është zëvendësuar me përçuesit kabllorë (të izoluar). Në shumicën e rasteve në zonën urbane, në vend të instalimit të kutive në shtylla, kutitë janë instaluar të shtrënguara në tokë, kështu që rrjeti ajror zëvendësohet me kabllot nëntokësore. Projekti në vete përfshinë ose nuk përfshinë vendosjen e transformatori të ri apo të rinj, varësisht prej zonave, që nënkupton edhe rehabilitimin e rrjetit ekzistues 10 kV.

Përforcimi i rrjetit – Projektet MMO dhe PLC

Problemet kryesore të rrjetit të shpërndarjes janë të përqendruara në nivelet e ulëta të tensionit. Për këtë arsye investimet janë përqendruar kryesisht drejt investimeve në rrjetin e tensionit të ulët. Duhet pranuar që rrjeti i shpërndarjes nuk është ende në nivelin e kënaqshëm dhe nevoja për rehabilitimin e

rrjetit si dhe zgjerimi i tij, përmirësimi i sistemit të leximit dhe ulja e humbjeve mbeten ende prioritetet e larta.

Për të arritur objektivat e rrjetit dhe për të përmirësuar situatën në terren, OSSH së bashku me komunën ka orientuar investimet e saj kryesisht në projektet e tensionit të ulët, përkatësisht në fushën më problematike në të cilën ka nevojë për një zgjidhje emergjente. Duhet theksuar se përmes këtyre projekteve, përfitojnë një numër më i madh i konsumatorëve dhe efekti i sigurisë së shtuar të furnizimit është më i madh. Përmirësimi i kapaciteteve të kufizuara në sistemet e mbingarkuara me tension të lartë dhe krijimi i kushteve për zhvillimin e rrjetit të tensionit të ulët konsiderohet si kriter bazë meqë plotëson kushtet teknike dhe ekonomike për planifikimin e rrjetit të shpërndarjes dhe siguron furnizim cilësor dhe të sigurt për pjesën më të madhe të konsumatorëve.

Projekti MMO përmban në vetvete dy nënprojekte: përmirësimin e rrjetit ekzistues (shtyllat e reja, përçuesi i ri, montimi i ormanëve, lidhjet e reja shtëpiake etj.) dhe zhvendosjen e njehsorëve jashtë shtëpive.

Zhvendosja e kutive - njehsorëve jashtë shtëpive

Zhvendosja e pikave matëse nga shtëpitë në piken e jashtme në shtyllë lehtëson qasjen e shumë ekipeve në leximin dhe kontrollin e pikave matëse, dhe në këtë rast mundësia e keqpërdorimit të energjisë elektrike reduktohet në një masë të madhe. Në këtë rast njehsorët barten jashtë shtëpive në kutitë që ndërtohen paraprakisht si dhe montohen PLC-të njëkohësisht.

Projektet e përforcimit të rrjetit janë të ndërthurura kryesisht me projektet MMO dhe PLC që më parë ishin të ndara. Këto projekte të rehabilitimit përfshijnë disa pika nën vete:

- Ndërtimi i transformatorëve distributiv të rinj 10(20)/0.4 kV (një apo më shumë) në një trafo-regjion apo më shumë ku vlera e humbjeve teknike dhe komerciale në rrjetin e tensionit të ulët është shumë e madhe. Ka rast kur nuk ka nevojë të shtohet ndonjë transformator;
- Rehabilitimi i rrjetit ekzistues 10 kV deri të transformatori i ri;
- Rehabilitimi i rrjetit ekzistues ose ndërtimi i rrjetit të ri në TU;
- Montimi i kutive (kuadrove) nëpër shtylla nëse është rrjet ajror dhe nëpër kuadro të tokës nëse është rrjet nëntokësor;
- Ndërtimi i kyçjeve shtëpiake prej kutive nëpër shtylla e deri nëpër shtëpi
- Vendosja, gjegjësisht bartja e njehsorëve prej shtëpive për t'u vendosur nëpër kuadrot e montuar në shtylla;
- Ndërrimi i njehsorëve mekanik me ata 'të mençur'
- Montimi i PLC-ve;
- Montimi i koncentratorëve;

Fokusi kryesor i investimeve në fazën e parë të planit zhvillimor, duke marrë parasysh rrethanat aktuale, do të jetë përforcimi i rrjetit të tensionit të ulët, përfshirë ndërtimin e nënstacioneve të reja në nivelet e tensionit të ulët por në disa raste edhe përforcimin e rrjetit të tensionit të ulët gjithashtu.

Përdorimi i SCADA në energji elektrike

Megjithëse kostot fillestare të projektit SCADA mund të duken të larta, norma e kthimit është 14%, respektivisht vetë sistemi është i aftë të amortizohet në një periudhë të shkurtër kohore, duke pasur parasysh përfitimet e saj, të cilat janë: Sistemi mund të monitorohet në çdo kohë, fitimi i kohës dhe fuqisë së punës, aftësi për të regjistruar dhe analizuar të dhënat e prodhimit, monitorimi dhe ruajtja e sistemit të energjisë, marrja e informatave nga lokacioni dhe ndërhyrja e menjëhershme, regjistrimi i ndërhyrjeve në sistem, zbulimi i zonave me rrezik mosfunksionimi dhe sistemi ka avantazhe të mëdha të tilla si informacione të menjëhershme rreth funksionimit/operimit.

Për më tepër, sistemet moderne SCADA po kontribuojnë dhe luajnë një rol kyç në shumë ndërmarrje drejt arritjes së:

- Niveleve të reja në besueshmërinë e rrjetit elektrik - rritja e të ardhurave;
- Zbulimi dhe zgjidhja proaktive e problemeve - besueshmëria më e lartë;
- Përmbytja e kërkesave të domosdoshme të cilësisë së energjisë - rritja e kënaqësisë së klientit;
- Vendimmarrja strategjike në kohë reale - ulja e kostos dhe rritja e të ardhurave.


Energjia alternative

Stimulimi për shfrytëzimin e energjisë alternative është objektiv i PZHK-së. Burimet si energjia e erës dhe ajo solare, do të mundësonin kursimin e energjisë elektrike dhe njëkohësisht do të ndikonin në përmirësimin mjedisor. Stimulimi i vendosjes së paneleve diellore dhe shfrytëzimin e energjisë së erës, si për objekte publike dhe banim, do të mundësonte një përmirësim në furnizimin e përgjithshëm të banorëve me energji elektrike.

Janë identifikuar zona me potencial për energji alternative në kuadër të komunës së Prishtinës si të përshtatshme për ngritjen e impianteve të turbinave të erës, kriteret kryesore të përdorura për të identifikuar këto zona janë:

- Zona të ngritur (kodra) që është e rrahur nga era në më shumë se 6 muaj brenda vitit;
- Zonë kryesisht e zhveshur, pa drunjë të lartë dhe kryesisht shkëmbore;
- Të jenë larg vendbanimeve;
- Nuk preferohen të jenë me larg se 4 km nga trafo-stacioni 220/110 kv.

Pavarësisht zonave të identikuara me potencial për energji alternative përmes turbinave të erës, nuk përjashtohet mundësia e vendosjes së tyre edhe në lokacione tjera kodrinore ku hulumtimet e zhvilluara nga palët e interesuara tregojnë për potencial për një gjë të tillë.



Harta 38 Koncepti i zhvillimit të energjisë elektrike

Eficienca e energjisë

Komuna e Prishtinës planifikon të hartojë një rregullore e cila do të kërkonte prezantimin e masave për eficiencë të energjisë në sektorin e ndërtimit (ndërtesat e reja), e në të njëjtën kohë planifikon të hartojë edhe një plan për renovimin e ndërtesave të vjetra, me qëllim të përmirësimit të performancës energjetike. Planifikohet renovimi dhe zbatimi i masave të eficiencës së energjisë për ndërtesat publike në komunë.

Me qëllim të rritjes së eficiencës së energjisë dhe uljes së kostos së mirëmbajtjes, ndriçimi publik në rrugët e kryeqytetit planifikohet të zëvendësohen me ndriçues LED. Përfitimet specifike përfshijnë reduktimin e emetimit të gazrave serë, përmirësimin e shikueshmërisë gjatë natës dhe pasqyrimin më të mirë të ngjyrave.

Energjia termike

Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ngrohjes qendrore në qytetin e Prishtinës është nevojë e domosdoshme ku përmes këtij plani janë propozuar disa skenarë për rritjen e energjisë termike në dispozicion nga sistemi i kogjenerimit, rehabilitimit dhe zgjerimit të rrjetit primar si dhe shumë aspekte tjera të ndërlidhura me këtë çështje. Rekomandimet nga ky plan pritet të zbatohen përmes projekteve të financuara nga donatorë dhe fonde të ndryshëm të cilat janë në fazën përfundimtare të përgatitjes për implementim apo planifikohen për vitet në vijim. Prandaj, fakti i posedimit të një udhërrëfyesi për orientimin e investimeve në të ardhmen, në atë mënyrë që ndër të tjera të sigurohet edhe qëndrueshmëria teknike dhe financiare, determinon në përgatitjen e një Plani Zhvillimor afatgjatë.

Planifikimi për zhvillimin dhe rritjen e sistemit të ngrohjes qendrore të NP "Termokos", është mbështetur kryesisht në dokumentin e masterplanit dhe në Strategjinë e energjisë së Republikës së Kosovës (2017- 2026). Kërkesat për kyçe të reja në rrjetin e ngrohjes qendrore, duhet të analizohen në bazë të të dhënave të këtyre planeve dhe të aprovohen nëse janë në përputhje me kriteret dhe arsyeshmëritë e përcaktuara për këtë lloj të investimeve. Përcaktimi i prioritetëve të investimeve, qofshin ato donacione apo mjete vetanake, është vendimtar për të siguruar që përfundimi i këtyre investimeve të bëhet me sukses të plotë.

Për të plotësuar kërkesat në rritje të qytetit të Prishtinës për energji termike, Termokosi planifikon zgjerimin dhe modernizimin e rrjetit të shpërndarjes. Në këtë drejtim, janë planifikuar një numër i projekteve kryesore për periudhën 2020-2029, të financuara nga donatorë dhe nga mjetet vetanake të cilat projekte janë përshkruar në planin e veprimit. Zgjerimi i rrjetit të ngrohjes që nga viti 2024 do të bëhet në lagjet e reja si Dodona dhe Mati I, të cilat janë vlerësuar pas analizës hidraulike të rrjetit dhe rezervave të energjisë termike në pozicione të caktuara.

Ofrimi i shërbimeve të ngrohjes për qytetaret e Prishtinës do të vazhdojë në vazhdimësi deri në mbulueshmërinë e gjithë zonës urbane, ky shërbim do të mund të ofrohet me dyfishimin në kapaciteteve të kogjenerimit dhe eliminimin e humbjeve të energjisë termike si pasojë e gypave të vjetruar, andaj ky proces do të realizohet sipas fazave të cilat janë të përcaktuara në harta konceptuale por duke u mbështetur me një plan të fizibilitetit për detajet teknike dhe financiare.


Energjia termike për ngrohje paguhet për sipërfaqe të banueshme, gjë që nuk promovon përdorim ekonomik, parashihet që sistemi të ndërrohet ashtu që detyrimi të jetë i bazuar në vëllimin e energjisë termike të shfrytëzuar duke vendosur njëhësor matës për energjinë e ngrohjes, vendosja e matësve të energjisë termike në njësi banuese do të realizohet në këtë vit, ku me vendosjen e matësve të energjisë termike në njësi banuese do të mundëson kursimin e energjisë termike dhe mundësinë e zgjerimit të rrjetës së ngrohjes.

Gazifikimi apo gazit natyror për ngrohje, është pjesë e rëndësishme e konceptit hapësinor, duke ditur se në një të ardhmë të afërt planifikohet shtrirja e rrjetit të gazifikimit (TAP) i cili projekt do të prek edhe Kosovën prandaj sugjerohet që rrjeti i ri që do të realizohet në të ardhmen të vendoset infrastrukturë e përshtatshme që të mund të përdoret edhe për gazifikim. Duke ndjekur shembullin e disa qyteteve në Maqedoninë e Veriut, komuna e Prishtina do të duhet analizuar dhe përvetësuar një sistem të gazifikimit, ku gazi natyror do të importohet nëpërmjet kamionëve me cisterna, dhe i njëjti do të distribuohet nëpër komunë, për tu përdorur për ngrohje. Importi i gazit të kompresuar, është një zgjidhje e përkohshme, derisa lidhja e tubacionit kombëtar të gazit në nivel kombëtar për Kosovën (ashtu siç është parashikuar në Planin Hapësinor të Kosovës) do të ndodhte në vitet e ardhshme, zgjidhja më e përshtatshme për mbulimin e territorit të komunës me energji të ngrohjes është gazifikimin.

Energji termike përmes energjisë diellore

Në bazë të studimit të fizibilitetit “Kosovo, Termokos District Heating Network - Solar Thermal Project”, janë propozuar 3 lokacione të mundshme për ngritjen e impianteve për panele solar: Pjesa e mihjes në Fushë Kosovë e cila do të furnizonte zonën industriale të Prishtinës me energji termike, Impianti në Shkabaj me një sipërfaqe prej 25 ha e cila do të furnizon lagjen Tophane dhe Arbëria 2 me energji termike dhe impianti në Kalabri i cili energjinë termike të akumuluar do të përcjell direkt në rezervuarin në Termokos.

Përveç këtyre lokacioneve të analizuara me studim fizibiliteti komuna e Prishtinës ka kapacitete për prodhim të energjisë alternative për shfrytëzim për ngrohje, do të bëhet një studim i fizibilitetit për të parë dhe analizuar hapësirat potenciale për shfrytëzim.



Harta 39 Koncepti i zhvillimit të sistemit të ngrohjes

Projektet e planifikuara për energjinë termike

I. Ndërtimi i impiantit të ri me energji diellore për ngrohje qendrore

Solar4Kosovo II - Solar District Heating është projekt zhvillimor në Republikën e Kosovës dhe Komunën e Prishtinës ("Projekti") financuar nga grantet e Qeverisë së Republikës Federative të Gjermanisë dhe Unioni Evropian (WBIF) nëpërmes të KfW dhe kredisë nga Banka Evropiane për Rekonstruim dhe Zhvillimi (BERZH). Termokos do të siguroj kontributin e vet në këtë projekt.

Projekti përfshinë ndërtimin e impiantit termik diellor dhe integrimin në systemin ekzistues të ngrohjes qendrore duke përfshirë zgjerimin e rrjetit deri në 50MW në Prishtinë. Projekti përbën komponentet kyqe në vijim:

1) Impianti i ngrohjes qendrore

- Ndërtimi i kolektorëve diellor me afërsisht 58.000 m²
- Ndërtimi i rezervoarit sezonal me kapacitet afërsisht 410.000 m³
- Ndërtimi dhe instalimi i pompës termike me absorpcion (AHP) me elemente përcjellëse të ngrohjes (AHC) dhe lidhja me rezervoarin sezonal.

2) Komponentet e sistemit të ngrohjes qendrore dhe integrimi

- Ndërtimi i afërsisht 1,6 km linjë e lidhjes në mes të sistemit termik diellor dhe pikës më të afërt nga Kosova B të rrjetin gypor të stacioni termik në Termokos apo lidhjes me të afërt ekzistuese me flongje.
- Ndërtimi i afërsisht 4,2 km linjës së lidhjes në mes të sistemit termik diellor dhe linjes ekzistuese të rrjetit termik (në Tophane)
- Zgjerimi i rrjetit deri në 50MW (në harmoni me Master Planin e zhvilluar si pjesë e bashkëpunimit të vazhdueshëm)

Ky projekt është projekti më i madh në Ballkan dhe i dyti në Evropë për nga kapaciteti i instaluar. Qëllimi i projektit është të kontribojë furnizim me ngrohje efikase, të besueshme dhe miqësore me ambientin për shtëpitë, institucionet publike dhe bizneset në Prishtinë.

Kostoja e projektit 80.5 Milio Euro. Financimi nga: 31.6 million EUR - grant nga GA; 22.5 million EUR grant nga WBIF GA, Kredi 22 Milion EUR nga BERZH dhe kontribut nacional 4,4 million EUR.

II. Dyfishimi i kapacitetit të kogjenerimit

Projekti ERI-ITA financuar nga Banka Evropiane e Investimeve (BEI) përfshinë përkrahjen e investimeve në N.P Termokos për dyfishimin e kapacitetit të Kogjenerimit nga Termocentrali Kosova B.

Aktualisht Banka Evropiane e Investimeve (BEI) është duke përgaditur projektin, i cili do të lejojë nxjerrjen e kapacitetit shtesë të nxehtësisë prej 140 MWth nga TPP Kosova B si dhe zgjerimin e rrjetit NQ të Termokos për të lidhur konsumatorët e rinj me sistemin NQ. Huamarrësi do të jetë Qeveria e Kosovës dhe promotori i projektit do të jetë Termokos, i cili është në pronësi të Komunës së Prishtinës.

Projekti mundeson zgjerimin e kapacitetit aktual të prodhimit të nxehtësisë duke operuar të dyja njësitë e TCKB në modalitetin që nxjerr sasinë maksimale të avullit nga secila njesi. Testet shtesë në turbinat me avull kanë konfirmuar një mundësi të nxjerrjes deri në 140 MWth kapacitet shtesë, që në mënyrë efektive do të thotë dyfishim i furnizimit me ngrohje deri në 280 MWth. Kjo do t'i lejojë Termokos të sigurojë ngrohjen për rreth 13.5 mijë klientë shtesë në Prishtinë.

Plani i Dekarbonizimit për Ngrohtoren e qytetit të Prishtinës

Si pjesë e projektit të asistencës teknike, është edhe plani i dekarbonizimit për Termokos që demonstroi planin afatmesëm dhe afatgjatë deri në vitin 2050. Ky plan qartëson orijentimet strategjike të Termokos për uljen e ndjeshme të emitimit të CO₂ në atmosferë si rezultat i prodhimit të ngrohjes, përdorimit të infrastrukturës së ngrohjes dhe shfrytëzimit të shërbimeve të ngrohjes nga konsumatorët. Një plan dekarbonizimi është një plan i besueshëm i veprimit i kufizuar në kohë që përshkruan qartë se si Termokosi do të udhëheqë operacionet e saj në një trajektore që i përshtatet politikave dhe caqeve kombëtare lidhur me klimën, si dhe me udhërrëfyesin e BE-së për periudhën deri në vitin 2050.

Qellimi i këtij plani është dekarbonizimi i sistemit të ngrohjes në qytetin e Prishtinës duke zvogluar humbjet energjetike, përmirësuar performancën energjetike të objekteve që shfrytëzojnë ngrohjen nga ngrohtorja e qytetit dhe duke integruar burime të ripërtrishme të energjisë (BRE) si burime alternative për ngrohje, ndaj burimit ekzistues TCKB (në vitin 2045 pritet TCKB të dekomisionohet). Planin përfshinë periudhat 2025-2035 dhe 2035- 2050.

Master plani

Projekti përfshinë hartimin e Masterplanit për qytetin e Prishtinës, ku bëhet analiza detale e kërkesës për ngrohje në lagjet ekzistuese të Prishtinës si dhe lagjeve të reja të cilat aktualisht nuk janë të kyçura në sistemin e ngrohjes, dhe planifikohet shtrirja e rrjetit gypor për ti kyçur ndërtesat e reja shumëbanesore në sistemin e ngrohjes qendrore. Analiza termike dhe hidraulike për rrjetin ekzistues dhe lagjet e reja, krijon mundësinë e hartimit të planit investiv për shpërndarjen e shërbimeve të ngrohjes tek konsumatorët e ri në Prishtinë, të cilat aktualisht ngrohen me ngrohje alternative, por kryesisht me energji elektrike.

Projektet investive në infrastrukturën e ngrohjes

Projekti përbën komponentet kyqe në vijim:

1) Ndërtimi i stacionit të ri për nxjerrjen e nxehtësisë (HES2)

Përfshinë të gjitha punimet përkatëse për ndërtimin e Stacionit të ri të Nxjerrjes së Nxehtësisë 2 (HES2) që ndodhet brenda ambienteve të termocentralit Kosova B, pranë stacionit ekzistues HES1. Stacioni i ri do të ketë kapacitetin termik prej 140 MWth, ku së bashku me stacionin ekzistues do të ketë kapacitetin maksimal të ngrohjes prej 280 MWth. Stacioni përfshinë ndërtimin e sistemit të ri të kondenzatit, sistemin e pompave, armaturave përcjellëse dhe sistemit automatik për operim të stacionit.

2) Rrjeti i gypave të ngrohjes

Projekti përfshinë edhe instalimin e gypit furnizues të ngrohjes nga Termocentrali Kosova B, gjegjësisht stacioni i nxjerrjes së nxehtësisë HES2, përgjatë trasesë ekzistuese të ndërtuar në vitin 2014 deri në Prishtinë në Termokos tek stacionin HRS 1. Gjatësia e trasesë së gypit do të jetë 10.5 km, diametri Ø 800 mm. Projekti përfshinë instalimin e gypit të tretë Ø 800 mm, i cili do të shfrytëzohet si gyp furnizues për ngrohje, ndërsa dy gypat ekzistues Ø 600 mm do të shfrytëzohen si gypa për kthyes të sistemit të ngrohjes.

3) Stacioni i pranimit të nxehtësisë

Në kauder të projektit do të ndërtohet stacioni i pranimit të nxehtësisë HRS në Termokos i cili do të mundësojë akomodimin e 100 MWth shtesë në sistemin ekzistues të ngrohjes për qytetin e Prishtinës. Projekti përfshinë këmbyesit e nxehtësisë, sistemin e pompave qarkulluese dhe komplet armaturat përcjellëse dhe automatiken për operimin e stacionit.

4) Zgjerimi i rrjetit të ngrohjes

Nga Master Plani punohet projekti i zgjerimit të rrjetit të ngrohjes në lagjet e qytetit të Prishtinës dhe planifikohet shtrirja e rrjetit gypor për ti kyçur ndërtesat shumëbanesore në sistemin e ngrohjes qendrore. Kjo mundëson zgjerimin e shërbimeve të ngrohjes për lagjet e reja, përmirësimin e cilësisë së ajrit në qytetin e Prishtinës dhe sigurimin e ngrohjes për qytetarët e Prishtinës me kosto të përballueshme. Së paku edhe 5 lagje të reja do të mbulohen me shërbimet e ngrohjes nga ngrohëtorja e qytetit si dhe do të ketë zgjerim të rrjetit në disa lagje ekzistuese për të përfshirë konsumatorë të rinj. Projekti përfshinë shtrirjen e rrjetit gypor dhe instalimin e nënstacioneve termike në objektet e reja.

Kostoja e projektit afërsisht 50 mil EUR. Grante nga EU rreth 25 million EUR, Kredi e butë nga EIB 25 million EUR.

Mundësitë e reja të aplikimit të burimeve termike

Potenciali i madh për rritje të kërkesës për ngrohje në të ardhmen qëndron në furnizimin me ujë sanitar, për konsumatorët e ngrohjes qendrore. Uji i ngrohtë normalisht furnizohet me temperaturë në mes 50 °C deri 60 °C. Për Hotele dhe kuzhina profesionale uji me 65 °C mjafton për të përmbushur shumicën e standardeve higjienike.

Uji i ngrohtë sanitar në ndërtesat e reja mund të lidhet në sistemin e ngrohjes qendrore pasi që ato janë projektuar për të qenë kompatible për kyçje në sistemin e ngrohjes. Problemi mund të paraqitet të objektet e vjetra, të cilat nuk kanë sistem të instaluar të ujit të ngrohtë sanitar. Riparimi, natyrisht është i mundshëm, por nevojiten investime shtesë. Të gjitha këto investime varen nga faktorët e poshtëcekur:

- Planifikimi shkallë-shkallë i operimit vjetor të rrjeteve;
- Shkalla e instalimeve të rrjetit të ujit sanitar në ndërtesa (kryesisht objekte të banimit kolektiv, pasi që objektet komerciale kanë kërkesa më të vogla për ujë sanitar);
- Konsumi për apartament, duhet të jetë i matur në mënyrë që mënjanohej konsumi i panevojshëm.

Prandaj, në ndërtimet e reja preferohet instalimi i sistemeve të përshtatshme për shfrytëzim të ujërave sanitar nga ujërat termale.

Ftohja në largësi në Prishtinë

Prishtina po zgjerohet me një shpejtësi të madhe si zgjerimi i ndërtimeve të objekteve administrative, hoteleve, moteleve dhe në tërësi, të objekteve që kanë kërkesa të rritura për ftohje edhe në periudhat e dimrit, fenomen që paraqitet edhe në tërë Evropën, aplikimi i ftohjes në largësi është një opsion shumë atraktiv si nga aspekti teknik, ashtu edhe nga ai ekonomik.

Ftohja është proces termik, i cili i bën mjediset tona urbane shumë më produktive dhe më komfore jo vetëm gjatë periudhës së verës. Sot, shumica e objekteve komerciale dhe publike në Prishtinë kanë sistemet e ftohjes, ndërsa kërkesa rritet në mënyrë substanciale. Për më tepër, ftohja në largësi është përgjigje e qëndrueshme ndaj kërkesave të rritura për ftohje edhe në komplekset e banimit individual dhe kolektiv.

Ftohja në largësi mundëson kombinimin e burimeve të ndryshme termike, varësisht nga kushtet lokale si që janë ftohja natyrale, uji i liqeneve, lumenjve apo nga burimet nga toka si dhe burimet e tepricave të energjisë.

Mundësia, e cila paraqitet si më optimale për qytetin e Prishtinës, është kyçja në sistemin e ri të ko-gjenerimit dhe rrjetit distributiv të ngrohjes si dhe konvertimi i energjisë së ngrohjes në energji për ftohje përmes pajisjeve për ftohje me absorbim. Përmes këtij kombinimi unik të përdorimit të energjisë së

humbur nga kulla ftohëse e sistemit për ftohje në B1 dhe B2 si burim i energjisë dhe përdorimit të teknologjive efikase për konvertimin e energjisë për ngrohje në atë për ftohje me sistemet e absorbimit, ftohja në largësi paraqitet ndotës shumë më i vogël në emetimin e CO2 se sa sistemet konvencionale të centraleve për trajtim të ajrit.

Telekomunikimi

Shërbimet telekomunikuese tani renditen në listën e shërbimeve primare për një familje. Lajmërimi i ndihmës së parë, zjarrfikësve, policisë, mësimi online në shkollë, puna prej shtëpisë, programet edukativo-arsimore, sistemet monitoruese nga distanca, sistemet e alarmeve, janë vetëm disa prej nevojave jetësore të cilat ofrohen përmes shërbimeve telekomunikuese.

Koncepti zhvillimor i shërbimeve telekomunikuese premtan planifikim dhe shërbim të qëndrueshëm me shërbime telekomunikuese për të gjithë qytetarët e Komunës së Prishtinës.

Ekzistojnë një numër faktorësh që sfidojnë ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme telekomunikuese për banorët e komunës së Prishtinës të cilëve në kuadër të këtij koncepti ju është qasur në mënyrë serioze në ofrimin e zgjidhjeve për të ardhmen.

Disa nga këta faktorët të cilëve ju është dhënë zgjidhje janë: infrastruktura ekzistuese e cila është ndërtuar pa ndonjë koordinim në mes të operatorëve të kompanive telekomunikuese, mos unifikimi i infrastrukturës në mes të operatorëve, mungesa e ofrimit të shërbimeve nëpër fshatra të thella. Teknologjia në infrastrukturë, ofrimi i shërbimeve bëhet përmes sistemit kabllor HFC (Hybrid Fiber Coax) në mbi 70% të rasteve, dhe në 30% të rasteve përmes GPON (Fiber), Shërbimet “fiber to home” në nivel minimal, mungesa e shërbimeve telekomunikuese Mobile dhe Fikse në zonat e largëta dhe më pak të banueshme.

Sfida më e madhe për përmirësimin e shërbimeve është infrastruktura e cila është ndërtuar pa ndonjë koordinim në mes të operatorëve. Për momentin shumica e operatorëve shfrytëzojnë shtyllat e distribucionit për shtrirjen e kabllave, kjo përveç që ndikon në ofrimin e shërbimeve jo stabile, ka krijuar një pamje jo të këndshme për ambientin.

Shërbimet Telekomunikuese Mobile

Duke parë që mbulueshmëria me shërbime “voice” është e kënaqshme, Koncepti orientohet kryesisht në përmirësimin e shërbimeve “data” 3G dhe LTE në zonat urbane ndërsa në zonat e thella rurale, ku ka mungesë të shërbimeve 3G dhe LTE janë propozuar mundësi që Komuna e Prishtinës në bashkëpunim me operatorët të ndërtojë infrastrukturë nëntokësore e cila do të jetë pronë komunale dhe e cila do të iu lehtësojë operatorëve ofrimin e shërbimeve në këto zona.

Trendi global i shërbimeve telekomunikuese mobile po shkon drejtë teknologjisë 5G. Nevojat e qytetarëve për kapacitete më të mëdha në shërbimet mobile, kryesisht në “data” edhe në Kosovë, obligon operatorët që të implementojnë edhe në Kosovë teknologjinë 5G. Për të implementuar projekte të ndryshme si: Smart Home, Internet of Things, është e domosdoshme të implementohet teknologjia 5G.

Parakushte për të implementuar këtë teknologji të re janë: përmirësimet në infrastrukturë, kryesisht në transport, dhe lirim i brezave të reja frekuencore nga autoriteti rregullator - ARKEP, siç janë brezat 800 MHz, 2100 MHz dhe 2600 MHz.

Nevoja për kapacitete më të mëdha nga shfrytëzuesit është gjithnjë në rritje, kjo tregon që edhe zonat me mbulueshmëri të mirë në ditët e sotme, në një të ardhme jo të largët nuk do të jetë e mjaftueshme. Për këtë nevojitet përmirësim në infrastrukturë dhe teknologji.

Për të përmbushur kërkesat e qytetarëve për kapacitete të mjaftueshme, Komuna e Prishtinës në bashkëpunim me operatorët do të duhet të:


- Lehtësoje procedurat që operatorët të rrisin numrin e BTS-ve në zonat me koncentrim më të madh të qytetarëve. Mënyrë me e përshtatshme për ta bërë këtë, rekomandohet që të ndërtohen BTS të përbashkët nga dy operatorët, gjë që do të ulë edhe kostot e tyre të operimit, njëkohësisht do të përmirësonte edhe mbulueshmërinë me shërbime për qytetarët.
- Rrisin kapacitetet duke zëvendësuar transportin me wireless, me atë me fije optike. Edhe në këtë rast mund të përdorin infrastrukturë të përbashkët nëntokësore që mund të jetë pronë e operatorëve, pronë publike komunale, apo edhe ndonjë operatori të shërbimeve FIX-e, të cilët do ta ndajnë të njëjtën infrastrukturë gjithashtu.
- Do të sigurojë që ndërtimi i BTS (shtyllave) të reja do të bëhet duke respektuar standardet dhe kushtet për ndërtimin, instalimin dhe mbikëqyrjen e infrastrukturës telekomunikuese të përshkruara në HZK.

Shërbimet telekomunikuese Fikse, Internet dhe DTV

Edhe pse shërbimet me internet në Komunën e Prishtinës janë të mira, problemi qëndron në infrastrukturën ekzistuese e cila është ndërtuar pa ndonjë koordinim në mes të operatorëve të kompanive telekomunikuese dhe nuk është e unifikuar.

Shpërndarja e teknologjive dhe e rrjetave të avancuara në Prishtinë është zhvilluar me një ritëm jo të regullt dhe në mënyrë të pakoordinuar.

Infrastruktura në të cilën këta operatorë operojnë nuk është aspak e kënaqshme. Në mbi 90% të rasteve në Komunën e Prishtinës, këta operatorë shfrytëzojnë infrastrukturën ajrore përmes shtyllave të distributorit shpërndarës të energjisë. Numri i madh i operatorëve që e shfrytëzojnë atë infrastrukturë ka bërë që ato shtylla të jenë të mbingarkuara, të duken keq, dhe mbi të gjitha të paraqesin rrezik për punëtorët e operatorëve apo distribucionit.



Harta 40 Koncepti hapësor i zhvillimit të telekomunikacionit

Koncepti arrin në përfundimin se ekziston nevoja që Komuna e Prishtinës në bashkëpunim me operatorët e shërbimeve telekomunikuese, KEDS dhe Ndërmarrjen Publike Banesore të hartojë një plan të detajuar në lidhje me zhvendosjen e infrastrukturës ajrore në infrastrukturë nëntokësore të planifikuar e cila do të shfrytëzohet nga të gjithë operatorët. Kjo infrastrukturë do të jetë pronë Komunale në shfrytëzim nga operatorët. Koncepti parasheh që planifikimi, dizajni dhe implementimi i zhvendosjen së infrastrukturës ajrore në infrastrukturë nëntokësore të planifikuar, të përbashkët për të gjithë operatorët do të realizohet në tërë qytetin e Prishtinës deri në vitin 2031.

Koncepti zhvillimor do të jetë sipas prioriteteve të ndara në zona duke filluar nga zonat më problematike dhe vitale për qytetin e Prishtinës duke vazhduar deri në rehabilitimin dhe sistemimin e rrjetave të telekomunikimit në standardet e kërkuara.

Koncepti i zhvillimit të Telekomunikacionit gjithashtu orientohet edhe në ofrimin e shërbimeve internet dhe DTV edhe në zonat rurale ku është propozuar edhe ndërtimi i rrjetit primar Fiber nga Prishtina deri te fshatrat e thella të Komunës së Prishtinës.

Gjithashtu Komuna e Prishtinës duhet t'i obligojë operatorët që të shfrytëzojnë infrastrukturën e përbashkët:

- Në zonat urbane dhe lidhja primare me zonat rurale të bëhet me infrastrukturë të përbashkët nëntokësore, ku të gjithë operatorët shfrytëzojnë të njëjtën infrastrukturë.
- Në zonat më të largëta, Rrjeti Primar duhet të jetë të shfrytëzohet edhe infrastruktura ajrore – shtyllat e distribucionit, por të përmirësuara. Ato duhet të jenë prej betoni, që sigurojnë shërbime të sigurt dhe lehtësim të punës për operatorët.

Koncepti parasheh që për çdo kërkesë për leje për gropim, të realizohet në bazë të planifikimit ku të gjithë operatorët, si ata të distribucionit të energjisë, ashtu edhe operatorët kabllor, të realizojnë infrastrukturë të përbashkët nëntokësore, në mënyrë që rrjetat ajrore të largohen plotësisht nga rrugët përkatëse.

Komuna e Prishtinës në bashkëpunim me të gjithë operatorët brenda një viti duhet të ndërtojë një plan të detajuar në lidhje me zhvendosjen e infrastrukturës ajrore në infrastrukturë nëntokësore. Komuna duhet të propozojë mundësinë e ndërtimit të infrastrukturës nëntokësore nga vet komuna, dhe t'u jep me qira operatorëve infrastrukturën në shfrytëzim.

Menaxhimi dhe grumbullimi i mbeturinave

Komuna e Prishtinës mbulon 100% të territorit të saj me menaxhim dhe grumbullim të mbeturinave. Ofrimi i këtij shërbimi do të vazhdojë të realizohet bazuar në "Rregulloren lokale për menaxhim të mbeturinave" dhe do të vazhdojë të bëhet nga operatori i kontraktuar i komunës, Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi".

Sa i përket strategjive dhe planifikimeve, Komuna e Prishtinës përmes drejtorisë së Shërbimeve Publike planifikon të rritë angazhimin rreth menaxhimit të mbeturinave, duke pas parasysh lidhjen direkte të kësaj fushe me ndikimet në ambient dhe cilësinë e jetës së qytetarëve. Strategji tjetër e komunës është bashkëpunimi me MMPHI në Projektin për Ngritjen e Kapaciteteve për Menaxhimin e Mbeturinave Drejt një Shoqërie të Shëndoshë.

Rëndësi të veçantë ka ndërgjegjësimi dhe vetëdijësimi i popullatës përkrah kauzave të ambientit dhe sasisë së mbetjeve që ata prodhojnë. Përveç kësaj, Komuna planifikon të ofroj mundësi të ndarjes së mbeturinave në burim, duke vënë në funksion grumbullimin e diferencuar të mbeturinave në kontejnerët përkatës: letër, qelq, plastikë apo mbetjet e njoma (që janë mbetjet ushqimore), që do ta fillonte procesin e klasifikimit të mbeturinave, për të vazhduar deri në ripërdorim dhe riciklim. Në ditët e

sotme, procesi i riciklimit ka një zhvillim të gjerë në shumë fusha industriale si ato të hekurit, drurit, plastikës, të qelqit (për të përmendur këtu më të rëndësishmet).

Për ti arritur këto, Komuna e Prishtinës planifikon riorganizimin e rrjetit të grumbullimit të mbeturinave; Ndajmë qytetin në katër zona për menaxhim të mbeturinave. Riorganizojmë tërë rrjetit të grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave, duke investuar në rritje të kapaciteteve, grumbullim sipas nevojës dhe jo sipas orareve të paracaktuara. Përcaktim i orareve të sakta të grumbullimit të mbeturinave kolektive dhe atyre derë më derë, duke shtuar numrin e kontejnerëve dhe pikave grumbulluese si dhe duke caktuar lokacionin për pikën grumbulluese të mbeturinave të vëllimshme (orendi, tavolina, karrige, televizor dhe pajisje të tjera të amvisërisë); caktimi lokacioneve për deponinë e mbeturinave nga konstrukt-demolimet dhe pastrimi i deponive të egra.

Ky projekt synon që në 8 vitet e ardhshme kontejnerët në disa zona të Prishtinës të futen në tokë dhe të jenë të ndarë për llojin e mbeturinës. Kontejnerët do të jenë të qasshëm për banorët e lagjes përmes kartelave, për të mundësuar një menaxhim sa më efikas dhe për të ndaluar keqpërdorimin e tyre. Ky projekt planifikohet fillimisht ta bëjë funksionalizimin e kontejnerëve nëntokësorë në zonën 1, zona qendrore e Prishtinës, duke vazhduar me zonën 2, dhe në fazë të fundit zonën 3, që përfshinë vendbanimet rurale me numër më të madh të popullsisë që ndodhen në rrethin e Prishtinës. Vendbanimet tjera rurale planifikohet që të vazhdojnë me grumbullim të mbeturinave derë më derë, mirëpo gjatë fazës së tretë, edhe në këto vendbanime mund të fillohet me ndarje të mbeturinave në burim. Për të përmbyllur këtë proces, do të ndërtohen edhe fabrika të riciklimit brenda territorit të komunës apo në rajon. Këto fabrika mund të jenë me skemën PPP, apo ndonjë formë tjetër menaxhimi. Për këtë komuna do të gjej lokacionet e caktuara dhe projektet të detajohen më tutje me plane përkatëse.


Përveç kësaj, planifikohet eliminimi i të gjitha deponive ilegale dhe trajtim i deponisë ekzistuese rajonale në Mirash, me qëllim edhe të shtimit të kapaciteteve dhe eliminimit të ndotjeve të ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor nëpërmjet shtrirjes së shtresës mbrojtëse – gjeo-membranë adekuate. Për të rritë efikasitetin e procesit, Komuna planifikon ndërtimin e disa deponive transite në Prishtinë, për grumbullimin e mbeturinave në një pikë të përbashkët para dërgimit në deponinë rajonale në Mirash apo në deponinë inerte.

Komuna, gjithashtu planifikon menaxhimin e mbeturinave inerte dhe ato shtazore sipas praktikave adekuate, duke krijuar deponi të posaçme për trajtimin e këtyre lloje të mbeturinave. Për këtë, janë dhënë tri propozime për vend-ndodhje të mundshme të deponisë inerte (shih hartën), ku në aspektin profesional duke analizuar ndikimet që mund të ketë kjo deponi si ndotjet rreth zonës dhe ndotja e ujërave nëntokësor sugjerojmë lokacionin në Mramor i cili plotëson kushtet në mënyrën më përshtatshme, përveç caktimit të lokacionit të deponisë inerte planifikohet edhe klasifikimi i këtyre mbeturinave para se të deponohen për arsye të ripërpunimit të mundshëm të këtyre mbeturinave.

Poashtu, komuna planifikon që të vazhdoj marrëveshjen për trajtimin e mbeturinave farmaceutike në kuadër të impiantit që gjendet në kompleksin e QKUK-së, impiant i cili përmbushë kërkesat për trajtim të këtyre mbeturinave për gjithë territorin e komunës. Po ashtu komuna e Prishtinës duhet të arrijë marrëveshje bashkëpunimi me komunën e Fushë Kosovës për trajtimin e mbeturinave shtazore pasi që në kuadër të territorit të kësaj komuna planifikohet ndërtimi i një deponi për trajtim të mbetjeve shtazore e cila deponi ka kërkesa specifike në aspektin e menaxhimit të këtij lloje mbeturinave të cilat mund të jenë shumë të rrezikshme.

Mbeturinat e rrezikshme – Komuna e Prishtinës ka disa hotspote të mbeturinave të rrezikshme si atyre industriale, radioaktive apo goditje me uranium të varfëruar. Komuna e Prishtinës duhet të bëjë një studim të veçantë mbi këto lloje mbeturinave mbi identifikimin e sakte të lokacioneve dhe llojet e këtyre

mbeturinave dhe pastaj të aplikohen masa adekuate për trajtimin dhe menaxhimin e këtyre mbeturinave mjaft të rrezikshme dhe specifike.



Harta 41 Koncepti hapësinor i zhvillimit të menaxhimit të mbeturinave

3.3.2.3 Infrastruktura e transportit

Në komunën e Prishtinës nevojitet një qasje holistike ndaj lëvizshmërisë (mobilitetit), jo vetëm si infrastrukturë, por gjithashtu duke përfshirë ide të tilla si siguria e këmbësorëve, qasja në këmbë në shërbimet bazë urbane, kostoja e transportit publik ose mirëmbajtja e mirë e objekteve bazë. Lëvizshmëria mund të shihet si një sistem i përbërë nga transporti, por edhe aktiviteti dhe lokalizimi, dhe për rrjedhojë financimi i lëvizshmërisë nënkupton gjetjen e një fluksi financimi për tre nën-sisteme (transporti, aktiviteti dhe lokalizimi).

PZHK njërin nga qëllimet e ka edhe **zhvillimin e transportit, infrastrukturës së transportit dhe sa ma shumë elemente të transportit të mençur**. Ekonomia e Prishtinës e cila me këtë PZHK planifikohet si magnet i zhvillimit ekonomik, është e lidhur ngushtë me tregtinë e jashtme, për këto funksione është planifikuar zhvillimi i mëtejshëm i rrjeteve (ndër) kombëtare të infrastrukturës së transportit dhe transportit tokësor e ajror por edhe lidhje me transportin detar.

- Planifikohet lidhje e mirë me korridoret ndërkombëtare me infrastrukturën e transportit rrugor e cila planifikohet të zgjerohet përmes përfundimit të autoudhëve ndërkombëtare (me theks te autoudha Prishtinë-Gjilan-Serbi, Prishtinë-Podujevë-Serbi si dhe negocimi për lidhjen me Maqedoninë e Veriut dhe korridoret ndërkombëtare) që janë në ndërtim e sipër, dhe përmirësimit të kapacitetit të rrugëve nacionale dhe rajonale në nivel vendi;
- Infrastruktura e transportit rrugor duhet të zgjerohet përmes përfundimit të autoudhëve ndërkombëtare që janë në ndërtim e sipër dhe përmirësimit të kapacitetit të rrugëve nacionale dhe rajonale në nivel vendi;
- Planifikohet lidhja e Prishtinës me korridoret hekurudhore ndërkombëtare përmes modernizimit të linjës hekurudhore ndërkombëtare - Linja 10 (148 km e gjatë) prej Fushë

Kosovës në Maqedoni (linja jugore) dhe prej Fushë Kosovës në Serbi (linja veriore) si dhe lidhjes nëpërmes Linjës 7 hekurudhore Fushë Kosovë-Prishtinë-Kufiri me Serbinë-korridore ndërkombëtare. Duhet të theksohet se edhe linjat e reja ose modernizim i linjave është planifikuar: linja hekurudhore (Fushë Kosovë-Klinë-Pejë) të jetë linjë një-binarësh dhe e elektrifikuar, linja hekurudhore (Klinë-Prizren) të jetë linjë një-binarësh dhe e elektrifikuar, linja e re hekurudhore (Kramovik-Gjakovë), linja e re hekurudhore (Prizren-Durrës në Shqipëri), Linja e re hekurudhore (Ferizaj-Gjilan-Bujanoc në Serbi) si dhe Linja e re hekurudhore (Pejë-Bijelo Polje në Malin e Zi), linjë me dy binarë paralel dhe elektrifikuar;

- Prishtina do të jetë zonë LOGJISTIKE që tërheq korridorin Durrës-Nish-Selanik duke e kompletuar dhe modernizuar infrastrukturën e transportit dhe duke planifikuar platformën për shpërndarjen e transportit të mallrave (HUB) tek stacioni multimodal;
- Sa i përket lidhjeve me transportin ajror planifikohet mirëmbajtje e lidhjes me autobus dhe lidhje e re hekurudhore Prishtinë-Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, si dhe vijat ndërkombëtare, lidhje me Aeroportin e Tiranës, Shkupit, Kukësit etj.
- Fuqizimi dhe modernizimi i infrastrukturës për lidhjet me portin e Durrësit, Shën Gjinit etj
- Në funksion të Prishtinës Metropolitane fuqizimi i lidhjeve dhe infrastrukturës së transportit dhe modaliteteve;
- Planifikohet zhvillimi i mëtejshëm i transportit urban, urban-rural, metropolitan, ndër-urban dhe ndërkombëtar si në vëllim, cilësi dhe shpejtësi duke u ndërlidh edhe me komponentët "SMART";
- Zgjerimi dhe modernizimi edhe i stacionit të autobusëve; dhe
- Zgjerimi dhe modernizimi edhe i stacionit hekurudhor në Prishtinë.

Prandaj, në kuadër të këtij dokumenti, ekziston një mundësi për të plotësuar dhe përditësuar studimin ekzistues të Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban përmes rimendimit të mobilitetit, i cili sjell mundësi të reja për përdorim efektiv dhe efikas të hapësirës publike dhe ta trajtojë atë si një aset, veçanërisht kur ajo është duke u nën ose mbi përdorur, duke i bërë ato asete publike të paqëndrueshme. Nuk është çudi që barra për financimin e llojeve të reja të lëvizshmërisë shpërndahet ndërmjet sektorit publik, kompanive dhe individëve privat, gjë që i bën këto procese komplekse dhe të gjata për të arritur ofrimi i shërbimit në nivele të mira gjithëpërfshirëse. Politikat dhe zgjedhjet e lëvizshmërisë në mjetet e transportit dhe energjinë që ato përdorin ndikojnë drejtpërdrejt në ndotjen, ndryshimet klimatike dhe ekonominë familjare të komunës. Këto sfida ndërsektoriale paraqesin një mundësi për të përshtatur mirë planin e lëvizshmërisë në dispozicion të dinamikës së strategjive të zhvillimit.

Një mundësi e tillë është paraqitur përmes projektit të **Portit të thatë** për Prishtinën të cilin qeveria e Kosovës e miratoi në korrik 2022, Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes së Bashkëfinancimit për Studimin e Fizibilitetit dhe Projekt-Idenë për Lidhjen Hekurudhore Durrës-Prishtinë. Qëllimi i marrëveshjes është përcaktimi i procedurave dhe ndarja e kostove ndërmjet palëve, për financimin e Studimit të Fizibilitetit të Hekurudhës Durrës-Prishtinë, në zbatim të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Edhe pse ky është një projekt kombëtar i menaxhuar nga qeveria qendrore, ndikimi i tij hapësinor, social, ekonomik dhe mjedisor duhet të merret parasysh në planifikimin strategjik të lëvizshmërisë së qëndrueshme për komunën e Prishtinës. Projekti i fizibilitetit do të përfshijë edhe portin tokësor të kontejnerëve në Prishtinë, i cili në gjuhën teknike quhet "port i thatë". Një port i thatë është një terminal intermodal i brendshëm i lidhur drejtpërdrejt me rrugë ose hekurudha me një port detar, (në këtë rast porti i Durrësit në Shqipëri) që funksionon si një qendër për transferimin e ngarkesave.

Bazuar në zhvillimet dhe kërkesat e flukseve të trafikut, në kuadër të këtij plani nuk ripropozohet unaza e jashtme e Prishtinës, e cila ishte paraparë me PZHU, por që sipas PMQU-së është konstatuar se ndërtimi i një unaze të tillë nuk është praktike dhe e nevojshme për komunën e Prishtinës. Ndërkohë,

me qëllim të devijimit të trafikut tranzit në drejtim të pjesëve qendrore të qytetit propozohen unaza e qytetit. Kjo rrugë unazore-qarkore shtrihet përgjatë gjurmës së unazës nga planet paraprahe dhe përgjatë gjurmëve natyrore të lëvizjeve në vendbanimin e Prishtinës.

Sigurimi i infrastrukturës dhe shërbimeve të transportit

Transporti i njerëzve dhe i mallrave në territorin e komunës bëhet përmes transportit rrugor dhe më pak atij hekurudhor. Komuna e Prishtinës posedon një rrjet të rrugëve që ofrojnë lidhje të mira me komunat tjera në Kosovë dhe shtetet fqinje. Rrjeti i rrugëve: autoudhë, nacionale dhe rajonale që administrohen nga niveli qendror, dhe janë në gjatësi prej 124.1 km. Rrugët lokale janë në gjatësi prej 1217.49 km dhe janë përgjegjësi e komunës. Vija hekurudhore në relacionin F. Kosovë-Prishtinë-Podujevë është e gjatë 20.89 km e cila është funksionale vetëm Prishtinë - F. Kosovë.

Unaza e qytetit

Kjo unazë e re do ta ndryshojë hierarkinë e lëvizjes në trafik: këmbësori do të jetë i pari, transporti publik dhe ai alternativ i dyti, kurse veturat të tretat. Të gjitha hapësirat publike do të kenë trajtim elementesh që ndërlidhen me qytetarin. Asfalti do të shndërrohet në gjelbërim, në kalldrëme, e në materiale që njihen si të këmbësorëve. Qendra e re do të ndërlidhet me të gjitha lagjet përreth dhe ky dimension i ri komunikimit do të krijohet duke e pas parasysh lëvizjen e personave me nevoja të veçanta, të këmbësorëve dhe të transportit alternativ.

Sipas Planet Strategjike të Zhvillimit të Prishtinës është paraparë të iniciohet ndërtimin i menjëhershëm i rrugëve kyçe, si: rruga A, rruga B, rruga C, që do t'i mundësojë një numri të madh të veturave të tangjentojnë qytetin, pa u futur në qendër, sepse nuk do të ketë nevojë. Orientimi i trafikut jashtë qendrës, dhe reduktimi i automjeteve që qarkullojnë në zonat e qytetit me ngarkesë të lartë.

Pas analizës së flukseve të trafikut dhe ngarkesës së rrjetit rrugor nga automjetet motorike, është konstatuar se ngarkesa më e madhe nga flukset e trafikut shkaktohet në hyrje të udhëkryqit në lagjen Veternik. Me qëllim të riorientimit të trafikut nga drejtimet e Gjilanit dhe Ferizajt të cilat mbledhen në këtë pikë, në pjesën jugore është propozuar një rrugë transite-bypass. Kjo rrugë transite e cila lidhë rrugët nacionale N-22.5 (Gjilan – Prishtinë) dhe N 2 (Ferizaj - Prishtinë) do të devijoj trafikun tranzit që nuk ka synim qytetin e Prishtinës duke ofruar alternativa të lëvizjes jashtë udhëkryqit në disnivel në lagjen Veternik.

Duke vlerësuar zhvillimet në pjesën jug-lindore të qytetit dhe parashikimin e kërkesave të flukseve të trafikut gjithnjë në rritje, duhet të mbahet dhe zhvillohet karakteri i rrugëve me kapacitet dhe nivel të lartë të shërbimit. Duhet bërë një studim për vazhdimin e trasesës nga rruga “Bajram Bahtiri” (rrugës “B”), duke mundësuar lidhjen funksionale me rrugën e planifikuar “A” dhe me qarkoren e brendshme si dhe me Hajvalinë.




Figura 13 Propozimi i unazës së qytetit dhe rrugëve primare

Përmirësimi i kapacitetit dhe nivelit të shërbimit të rrugëve

Në territorin e Prishtinës, aktualisht janë dy lloj mjete transporti që përdoren: transporti rrugor dhe transporti hekurudhor. Transporti rrugor e ka rolin kryesor në transportin e udhëtareve dhe të mallrave. Prishtina është e lidhur me rrugë jo vetëm në linja interurbane, por edhe ndërkombëtare që lidhen me shtetet fqinje. Të gjitha këto linja rrugore çojnë te stacioni kryesor - Stacioni i Autobusëve të Prishtinës. Ndërmodaliteti mes rrugëve dhe hekurudhave duhet të shtyjë drejt ndërtimit të rrugëve dhe terminaleve të hekurudhave pranë njëra-tjetrës, sepse deri tani ndodhen larg dhe lidhen nëpërmjet rrugës Prishtinë-Fushë Kosovë.




Figura 14 Klasifikimi funksional dhe kyçjet në rrjetin rrugor

Aktualisht, infrastruktura e transportit në Prishtinë është e përbërë nga një strukturë dhe klasifikimi jo funksional të rrjetit rrugor. Kyçjet e shpeshta dhe të pakontrolluara në aspektin hierarkik të rrugëve,

në të cilin rast rrugët e rangut më të ulët kyçen direkt në rrugët e rangut më të lartë, kanë ndikuar direkt në zvogëlimin e kapacitetit të lëvizjes dhe uljen e nivelit të shërbimit të infrastrukturës rrugore.

Nevoja për përmirësimin e strukturës dhe klasifikimin hierarkik të rrjetit rrugor mbetet opsioni i vetëm për përmirësimin e kapacitetit, sigurisë në trafik dhe nivelit të shërbimit të rrjetit rrugor.

Përmirësimi i mobilitetit urban

Zhvillimi i një sistemi të integruar të transportit publik është parakusht për përmirësimin e mobilitetit urban, duke synuar përmirësimin e qasjes në të gjithë qytetin dhe përmirësimin e lidhjes ndërmjet vendbanimeve të tjera urbane në partneritet me ofruesit e transportit publik.

Në kuadër të Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU) është propozuar zhvillimi i transportit publik përmes rrjetit të ri “kryesor” të autobusëve që do të ofrojë shërbim më të shpejtë dhe më të shpeshtë. Nga ana tjetër, kjo do të tërheqë një numër më të madh të shfrytëzuesëve, e shoqëruar me një qasje të re të projektimit për vendet kryesore ku mund të ndërrohet mënyra e transportit (‘pikat e transferimit’ – “hubs”) për të krijuar kapacitete shtesë dhe lehtësi lëvizjeje për udhëtarët, me vonesë minimale mes shërbimeve. Përveç shërbimeve të reja bazë që janë propozuar, rekomandohet një nivel tjetër shërbimi, përmes shërbimit të rrjetit ‘dytësor’, të cilat do të operojnë me shpeshtësi më të ulët sesa shërbimet kryesore por do të sigurojnë lidhje të rëndësishme me zonat e banimit, periferitë e qytetit dhe fshatrat.

- Sa i përket transportit urban, përveç rrjetit kryesor dhe dytësor të transportit urban me autobus, drafti i PZHK-së propozon edhe këto veprime kryesore për të përmirësuar mobilitetin urban të njerëzve, si:
- Transformimin e hekurudhës ekzistuese Fushë Kosovë-Prishtinë-Podujevë në linjë të transportit urban në masë më të madhe (linjë metropolitane), me ndalesa që ofrojnë transfer, vende parkingje intermodale dhe depo në varg;
- Krijimin e akseve të forta të transportit publik të dedikuar për autobusë.

Në aspektin më afatgjatë, propozohet krijimi i një lidhje të re të transportit të shpejtë që shtrihet në mes të pjesës jugore të Prishtinës dhe qendrës së qytetit, duke siguruar një lidhje të re të transportit publik, me kapacitet më të lartë, me qendrën urbane.

Një stacion multimodal/terminal i qendrës së qytetit në vendndaljen ekzistuese të trenit (ish stacioni i trenit) në lagjen Arbëria do të lidhë Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” me qendrën e qytetit dhe do të ofrojë alternativa të tjera të udhëtimit për përdoruesit.

Me qëllim të rritjes së sigurisë gjatë kalimeve hekurudhore me rrugën, si dhe mundësinë që linja metropolitane të ketë në tërë gjatësinë e saj binarë çift, është i nevojshëm një studim për mundësinë e futjes së hekurudhës nën tokë në segmentin para rrethrotullimit të madh te stacioni i autobusëve deri disa metra pas kryqëzimit të unazës qendrore me rrugën magjistrale në drejtim të Podujevës. Me këtë rast, edhe rruga në unazën qendrore do të mund të kishte tri korsi për lëvizje njëkahëshe të automjeteve personale dhe një korsi për lëvizjen e automjeteve të transportit publik urban, në tërë gjatësinë e saj. Futja e një segmenti të hekurudhës nën tokë (në gjatësi rreth 3 km) ishte paraparë edhe në kuadër të PZHU (2012 – 2020). Komuna e Prishtinës duhet të synojë arritjen e marrëveshjes me autoritetet përgjegjëse menaxhuese të linjave hekurudhore lidhur me studimin e një projekti të tillë.




Figura 15 Rrjeti i planifikuar i hekurudhës nëntokësore

Stacioni multimodal

Propozohet krijimi i një stacioni të ri multi-modal në zonën afërsi të stacionit të tanishëm të autobusëve në Prishtinë, duke përdorur hekurudhën ekzistuese dhe duke kaluar nëpër qendrën e Prishtinës. Kjo do të ndihmojë në sigurimin e qasjes më të mirë për mënyrat e ndryshme të transportit për lëvizjen e udhëtarëve dhe të mallrave, si dhe lidhjen e bërthamës urbane të qytetit me komunat përreth, qendrat rajonale dhe kryeqytetet e vendeve fqinje dhe më gjerë.

Për përzgjedhjen e lokacionit adekuat dhe lidhjeve funksionale të stacionit multimodal, duhet të bëhet një studim i fizibilitetit, por bazuar në planet paraprake, lokacioni adekuat do të ishte në piken hyrëse të kryeqytetit nga Fushë Kosova, gjegjësisht në hapësirën e stacionit ekzistues të autobusëve në Prishtinë.

Përveç propozimeve për krijimin e një stacioni të ri qendror të autobusëve në Prishtinë, propozohet të zhvillohen një sërë pikash më të vogla ("hubs") të shkëmbimit/ndërrimit të autobusëve që do të lehtësonin një transferim të lehtë dhe pa pengesa ndërmjet shërbimeve të ndryshme të autobusëve, si dhe me mënyrat e tjera si çiklizmi dhe udhëtimi me taksì.

"Pikat e shkëmbimit" ofrojnë pika të hyrjes dhe daljes në rrjetet e ndryshme të transportit brenda një zone si dhe ofrojnë pika ndërrimi mes mënyrave të ndryshme të udhëtimit. Në nivelin më të thjeshtë, pikat e tilla mund të jenë lokacione ku udhëtimi në këmbë shndërrohet në udhëtim në një formë tjetër të lëvizjes. Pikë e tillë mund të jetë vendndalja e autobusit. Në anën tjetër, pikat e mëdha mund të akomodojnë një numër të madh udhëtarësh që lidhen me shumë mënyra të ndryshme të udhëtimit.

"Pikat e shkëmbimit" të udhëtimit ("hubs") nuk duhet që detyrimisht të përmbajnë infrastrukturë në nivel të lartë, shumica prej tyre mund të jenë të përmasave më të vogla, duke siguruar një ndërrim të thjeshtë mes mënyrave të ndryshme të udhëtimit, ku përdoruesit mund të kenë qasje në një mënyrë

tjetër të transportit për udhëtimin e tyre të mëtejshëm. Një nga llojet e “pikave të shkëmbimit” që kuptohet më së miri është vendndalja e autobusit, në të cilën mund të ofrohen shërbime të linjave të shumëfishta të autobusëve dhe në të cilën mund të sigurohet parkimi i biçikletave ose i veturave.

Punim i mëtejshme i fizibilitetit do të identifikojë dizajnet specifike, ashtu që plani i propozuar i secilës “pikë të shkëmbimit” duhet të jetë i dizajnuar sipas standardeve të veçanta të dizajnit, duke mundësuar qasjen e lehtësuar të autobusëve, pritjes së pasagjerëve dhe hipjes/zbritjes, si dhe infrastrukturën përkatëse rrugore.

Lokacionet për “Pikat e shkëmbimit” janë paraparë në kuadër të PMQU dhe këto lokacione duhet të karakterizohet nga një numër i madh opsionesh që synojnë lehtësimin e udhëtimit multi-modal dhe rritjen e cilësisë së përvojës së udhëtimit.




Figura 16 Stacioni multimodal

Krijimi i një sistemi efikas të parkimit

Koncepti për parkim në Prishtinë është promovimi i zhvillimit të një qyteti të qëndrueshëm dhe të qasshëm. Kjo mund të arrihet përmes ofrimit dhe menaxhimit efektiv të parkimit në qytet, veçanërisht në korridoret strategjike radiale, në korridoret e transportit publik dhe në lokacionet me kërkesa të larta. Çështjet kryesore për politikën e suksesshme të parkimit në Prishtinë ndërlidhet me funksionimin dhe zbatimin e rregullave të parkimit.

Qeveria e Kosovës ka miratuar propozimin e komunës së Prishtinës për themelimin e ndërmarrjes publike “Prishtina Parking”. Me këtë vendim kryeqyteti merr qasje të drejtpërdrejtë në organizimin e parkingjeve kaotike që janë bërë pengesë për përditshmërinë e qytetarëve.

Në përputhje edhe të masave nga PMQU të Prishtinës për menaxhimin e parkingjeve, propozohet përcaktimi i zonave për parkim me pagesë. Si pjesë e aktivitetit të zonimit, duhet të vlerësohen çështjet e tilla si çmimi i parkimit dhe kohëzgjatja e qëndrimit për pjesë të ndryshme të qytetit. Zona qendrore e

qytetit klasifikohet si zona më e shtrenjtë me kohëzgjatjen më të shkurtë të lejuar të parkimit, gjersa pjesët periferike të qytetit lejojnë periudha më të gjata kohore dhe kanë çmim më të ulët.

Në Prishtinë duhet synuar krijimin e konceptit 'Parko dhe Udhëto' (Park & Ride – P+R), ku parkingjet e lokalizuara në distanca më të mëdha larg qendrës së qytetit janë të lidhura me një shërbim tërheqës të transportit publik me qendrën kryesore urbane. Sigurimi i hapësirave të parkimit në periferi të qytetit ka për qëllim të ndërpresë trafikun e udhëtarëve, si dhe të turistëve dhe banorëve dhe t'i transportojë ata në qendër të qytetit përmes lidhjes së shpejtë, të shpeshtë dhe me cilësi të lartë të transportit publik. Kjo do të zvogëlojë nivelin e mbingarkesës në qendër të qytetit dhe do të mundësojë rialokim të hapësirës për qëllime të tjera. Në mënyrë që sistemi "Parko dhe Udhëto" të funksionojë në Prishtinë, shërbimi nga ky parking duhet të jetë i shpejtë, i shpeshtë dhe të ketë depërtim të mirë drejt qendrës së qytetit. Projektimi dhe plani i situacionit për secilin objekt duhet të përfshijë qasje të mirë në lokacion nga rrugët kryesore dhe në përgjithësi kjo duhet të jetë e një standardi më të lartë të projektimit sesa parkimet në zonën qendrore, sepse lokacionet e 'Parko dhe Udhëto' kanë më shumë gjasa të ndërpresin trafikun që lëviz me shpejtësi.

Lokacionet e mundshme për 'Parko dhe Udhëto' në Prishtinë

Në PMQU, janë propozuar një numër i mundshëm i lokacioneve për shërbimin 'Parko dhe Udhëto' në lokacione të ndryshme në Prishtinë. Duke vlerësuar lokacionet e propozuara, të njëjtat rekomandohen edhe në kuadër të PZHK-së. Lokacionet e mundshme janë si në vijim:

- Në pjesën veriore të Prishtinës, në rrugën "Basri Canolli" (N9), përkatësisht prapa blloqeve të banimit social në Kolovicë. Lokacioni "P+R" me përafërsisht 700 vendparkime;
- Në afërsi të rrugës nacionale N-2, në kufirin e qytetit të Prishtinës, afër udhëkryqit të rrugëve "Lekë Matranga" dhe Mitrovica, është propozuar lokacioni "P+R" me përafërsisht 1100 vendparkime;
- Ndërmjet rrugëve "Vudro Vilson", "Ahmet Krasniqi", "4 Korriku" dhe "Radovan Zogoviq" është propozuar lokacioni "P+R" me përafërsisht 400 vendparkime;
- Afër terminalit të ri (Stacionit Qendror) në rrugën N-9 (rruga Lidhja e Pejës) është propozuar lokacioni "P+R" me rreth 370 vendparkime;
- Në rrugën "Shkupi", afër 'pikës së transferimit' të propozuar të autobusëve është propozuar lokacioni tjetër "P+R" me përafërsisht 300 vendparkime;
- Në rrugën E 65 në Veternik, rruga Rrafshi i Kosovës (afër udhëkryqit të ndarë në nivele të rrugëve M-2 dhe M-25.2) propozohet objekti P+R me përafërsisht 150 vendparkime.
- Në rrugën N-25 në dalje të Prishtinës, rruga nacionale Prishtinë – Podujevë. Vende të tjera alternative për lokacionet e mundshme 'Parko dhe Udhëto' (P+R) janë identifikuar në rrugët kryesore që lidhen me Prishtinën dhe të gjitha lokacionet e 'Parko dhe Udhëto' (P+R) tregohen në skemën e mëposhtme.

Këto lokacione mund të ndryshojnë varësisht nga analizat gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit në të ardhmen.




Figura 17 Propozimi i lokacioneve për sistemin e parkimit "P&R"

Ullja e shkallës së motorizimit dhe krijimi i kushteve për lëvizje jo motorike

Sa i përket zhvillimit të një rrjeti të ri të rrugëve për këmbësorë në Prishtinë, duke u bazuar edhe në PMQU- në e Prishtinës, vëmendja është përqendruar në përmirësimin e cilësisë dhe largimin e barrierave në trotuare, si dhe në qasjen pa pengesa në ndërtesa administrative publike dhe shtetërore, shërbime shëndetësore dhe sociale, shkolla, dyqane, objekte kulturore dhe ndërtesa tjera. Duhet synuar në krijimin dhe mirëmbajtjen e kushteve për lëvizjen pa pengesa të banorëve, vizitorëve dhe personave me aftësi të kufizuara. Është e domosdoshme të krijohet një koncept për rrugë gjithëpërfshirëse dhe pa pengesa që u mundësojnë të gjithë qytetarëve lëvizje të lirë dhe të sigurt përgjatë rrugëve të këmbësorëve si dhe në të gjitha mënyrat e transportit. Për më tepër, duhet të sigurohet qasje pa pengesa në shërbime.

Koncepti i rrjetit të rrugëve për këmbësorë duhet të formojë një rrjet funksional të rrugëve pa pengesa. Zona kryesore e këtij rrjeti do t'i përfshijë tri sheshet kryesore, "Bulevardin Nënë Tereza", sheshin "Zahir Pajaziti" dhe sheshin e "Pavarësisë", si dhe sheshet e reja në Bulevardin Gjorgj Bush dhe Bulevardin Dëshmorët e Kombit, e po ashtu edhe sheshet më të vogla përpara ndërtesave publike siç janë sheshi "Adem Jashari" dhe platoja e Pallatit të Rinisë si dhe lagjet "Qendra", "Dardania", "Ulpiana" dhe "Lakrishte". Për më tepër, nëpërmjet skemës së zgjeruar për këmbësorë, rrjeti do të shtrihet përgjatë rrugëve pa pengesa drejt parkut të qytetit, parkut "Taukbahqe" dhe parkut të "Gërmisë" dhe lagjeve tjera të qytetit me qëllim të zgjerimit dhe promovimit të mëtejshëm të këtij koncepti. Koncepti i rrjetit të rrugëve për këmbësorë duhet të përdoret edhe për qendrën historike të Prishtinës.

Zgjerimi i mëtejshëm i rrjetit për këmbësorë drejt zonës historike që mbetet për tu definuar. Komuna aktualisht është duke punuar për përcaktimin zyrtar të zonës historike dhe kufijve të saj dhe sapo të përcaktohet, mund të zbatohet koncepti i rrjetit të këmbësorëve.

Gjithashtu, edhe skema e propozuar e çiklizmit në kuadër të PMQU-së duhet të merret në konsideratë edhe për PZHK. Në konceptin e infrastrukturës për çiklist, përfshihen, lagjet “Qendra”, “Tophane” – duke u shtrirë drejt “Kodrës së Trimave”, “Medresës”, “Pejtonit”, “Lakrishtes”, “Arbërisë”, “Kalabarisë”, “Dardanisë”, “Ulpianës”, “Bregut të Diellit”, “Aktashit”, “Muhaxherëve”, “Velanisë” (parku) dhe zonës së QKUK-së. Një shteg i ri çiklizmi parashihet nga qendra e qytetit drejt parkut të Gërmisë nëpërmjet rrugëve “Haxhi Zeka”, “Nazim Gafurri” dhe “Shpëtim Robaj”. Rrjeti gjithashtu shtrihet në drejtim të zonave “Prishtina e Re” dhe Hajvalisë, nëpërmjet shtigjeve që hyjnë në këto zona dhe çojnë në drejtim të vendbanimit të Zllatarit dhe liqenit të Badovcit. Skema e propozuar e çiklizmit do të vlerësohet më plotësisht nëpërmjet punës së mëtejshme të fizibilitetit para çdo pune implementimi.

Me qëllim të krijimit të kushteve për lëvizje jo motorike është e rëndësishme të zhvillohen shtigje cilësore të ecjes dhe çiklizmit, ndërmjet zonave apo lokacioneve më të frekuentuara, zonave të banimit në të gjithë qytetin dhe vendeve të tjera të interesit, që do të ofrojnë një mjedis të cilësisë së lartë për këmbësorët dhe çiklistët dhe një mjedis që është i sigurt, i përshtatshëm dhe i këndshëm për t'u përdorur. Kjo kërkon realizimin e kontrolleve të shtigjeve në rrugët kryesore në zonat urbane për të siguruar që standardet e projektimit janë plotësuar. Një numër veprimesh kyçe janë të nevojshme për të arritur këtë, si:

- Zhvillimi i një “rrjeti kryesor” të shtigjeve për këmbësorë me cilësi të lartë (si pjesë e një rrjeti të përgjithshëm), që do të ofronte mjedise të cilësisë së lartë për përdoruesit, duke përfshirë rrugët drejt shkollave, kolegjeve dhe vendeve të punës, qendrave të lagjeve/rrethinave, qendrave tregtare, zyra të ndryshme komunale etj. dhe objekteve të transportit publik;
- Kontrolli i cilësisë së shtigjeve të këmbësorëve dhe çiklizmit në rrugët kryesore dhe qendrat e lagjeve/rrethinave për të identifikuar nevojat për përmirësim;
- Identifikimi i cilësisë së mjedisit për ecje dhe çiklizëm duke përdorur 5 kriteret – të lidhura, të rehatshme, të përshtatshme, miqësore dhe të dukshme – të cilat do të mundësojnë përcaktimin e prioritetëve për ndërhyrje; dhe
- Marrja parasysh e nevojave të grupeve të ndryshme të përdoruesve: udhëtarëve të rregullt, blerësve, atyre që i përdorin këto shtigje për rekreacion / në kohë të lirë, personave me nevoja të veçanta dhe fëmijëve – vende të ndryshme do të dizajnohen sipas nevojës së përdoruesit.

Mobiliteti urban i zgjuar/mençur (smart mobility)

Mobiliteti urban i zgjuar (mençur) – është element kyç për arritjen e lëvizshmërisë së qëndrueshme përmes zgjidhjeve të përmirësuara të Sistemit të Transportit Inteligent (STI), i cili mundëson orientim më mirë në trafik dhe që informon udhëtarët për mënyrën më të mirë të udhëtimit dhe kohën e duhur. Në këtë mënyrë, zgjidhjet inteligjente mund të kontribuojnë për uljen e përdorimit të automjeteve private.

Një segment i rëndësishëm i mobilitetit urban dhe zhvillimit të përgjithshëm të qytetit të Prishtinës është komponenta e qytetit të mençur/zgjuar (smart city). Në kuadër të konceptit për qytet të mençur mund të zgjerohen këto aspekte të funksionimit të qytetit:

- Transport publik i mençur
- Ndriçim i mençur rrugor
- Menaxhim i mençur me trafikun
- Parking i mençur
- Zgjidhje e mençur për sigurinë publike dhe të sigurisë në trafik
- Huazim i mençur i biçikletave etj.

Transport publik i mençur - Për transportin publik propozohet një zgjidhje modulare e cila përfshin sistemin e gjetjes automatike të automjeteve të transporti publik dhe sistemin e pagesës elektronike të biletave (sistemi i integruar i biletimit), përmes të cilave sigurohen informata nga të gjitha automjetet dhe pajisjet e lidhura dhe mundësohet kontrolli dhe optimalizimi i aktiviteteve të lidhura me transportin publik, në kohë reale. Me gjetjen automatike të vendndodhjes së automjeteve të transportit publik sigurohet optimizimi dhe rritja e efikasitetit të rrjetit të linjave të transportit, përmirësimi i informacioneve që u sigurohen udhëtarëve, e me këtë rritja e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve: vijueshmëri e rregullti, siguri dhe saktësi e autobusëve. Me pagesën elektronike të biletave që tanimë aplikohet, mundësohet pagesa me kartela elektronike të cilat mund të mbushen përmes internetit, në aparate automatike ose në rrjetin e vendeve shërbyese të operatorit të transportit publik si dhe me telefon celular. Në këtë mënyrë mundësohet efikasitet dhe kontroll gjatë punës, ndërsa qytetarëve u mundësohen shërbime efikase dhe moderne, përshtatur nevojave të tyre.

Ndriçimi rrugor i mençur - Me qëllim të të përmirësimit të ndriçimit rrugor, propozohet miratimi i një zgjidhjeje me ndriçim bazuar në ndriçimi inteligjent (Smart Lighting), i cili ka aftësinë të kontrollohet nga një sistem qendror menaxhimi në mënyrë që të ofrojë funksionalitet më të mirë dhe ndriçim fleksibël.

Ndriçimi rrugor i mençur përfshinë:

- Poçe elektrike të bazuara në teknologjinë e përparuar LED, me kohëzgjatje të madhe, të cilat mundësojnë shpenzim të zvogëluar të energjisë elektrike dhe mbrojtje të ambientit jetësor;
- Senzorë të cilët mundësojnë përshtatje të intensitetit të dritës;
- Pajisje rrjetore e cila mundëson komunikimin ndërmjet poqeve dhe sistemit qendror.

Menaxhim i mençur me trafikun - Menaxhim i mençur i trafikut në Prishtinë duhet të mundësoj një pasqyrë të përgjithshme të trafikut në kohë reale, duke i kombinuar vendndodhjet e automjeteve, me çka u ndihmon administratës së qytetit në menaxhimin e trafikut nëpër qytet. Zgjidhja analizon sasi të mëdha të dhënash mobile, në kohë reale, që të sigurojnë pasqyrim të plotë në zhvillimin e trafikut. Me qëllim të rritjes së mobilitetit të mençur/inteligjent propozohet rritja e përdorimit të zgjidhjeve SIT (Sistemeve Inteligjente të Transportit) për përmirësimin e planifikimit të transportit si nga operatorët e autobusëve ashtu edhe nga udhëtarët.

Për menaxhim të mençur dhe efikas të trafikut, Komuna e Prishtinës duhet krijuar mundësi për sigurimin e të dhënave nga detektorët e trafikut, semaforët, sistemet e menaxhimit të rrugëve, kamerat e mbikëqyrjes ose sistemet e informimit për kushtet kohore, për një pasqyrë edhe më të gjithmbarshme të gjendjes së trafikut dhe mbi bazën e këtyre të dhënave të rëndësishme për zhvillimin e trafikut, administrata e qytetit do të ketë mundësi që në mënyrë automatike dhe në kohë reale të përcjell në sistemet e jashtme, në formë të raporteve për trafikun. Me mbështetjen e shpërndarjes më efikase të informatave prej qytetit kah qytetarët sigurohet ndihmë për lëvizjen e tyre në trafik, pastaj një analizë më cilësore e trafikut, komunikim i përmirësuar i problemeve në trafik, pasqyrime më të thjeshtësuara të hartave, kohë më e mirë e reagimit, ndarjes së informatave etj.

Parkim i mençur - Opsioni “parkim i mençur” propozohet si mundësi dhe ndihmë për ngasësit e mjeteve për të kursyer kohë për gjetjen e vendparkimit, uljen e ndotjes dhe zvogëlimin e rrezikut që qytetarët të bëjnë shkelje gjatë parkimit. Gjithashtu, mundësohet menaxhim më i mirë me të gjitha sfidat e lidhura me zhvillimin e shërbimit efektiv për parkim publik.

Në versionin e vet themelor, zgjidhja “parkim i mençur” thjesht e ndjek statusin e vendparkimeve të lira/të zëna, mund të përdoret për evidencën e hyrjes në parkingjet e mbyllura dhe mund t'i tregojë informatat kyçe në aplikimin me celular ose të shenjave të vendosura strategjike në afërsi të parkingut. Në Prishtinë, një sistem i tillë është në realizim e sipër, por zgjidhja mund të zgjerohet me funksione më të avancuara, siç janë dhënia e lejeve për parking (për banorët rezident, për ngasësit me aftësi të

kufizuara, taksi, autobusë të qytetit dhe automjete për shpërndarje mallrash), zbatimi i kundërvajtjeve për parkim, pagesa e shërbimit të parkimit etj.

Zgjidhje e mençur për sigurinë publike dhe të sigurisë në trafik - Zgjidhja e mençur e sigurisë publike dhe sigurisë në trafik si, qasja në informata në kohë reale dhe krijimi i një databaze për numrin dhe lokacionet e aksidenteve, mund të jetë ndihmë për organet kompetente që të monitorojnë rrjetin rrugor dhe sipërfaqet publike, me qëllim të detektimit, në kohë të duhur, të ngjarjeve dhe incidenteve specifike dhe jo të rëndomta. Në këtë mënyrë mundësohet edhe intervenim i shpejtë në terren, që është veçanërisht i rëndësishëm në situata urgjente. Zgjidhja e mençur e sigurisë në trafik mundëson që të përmirësohet siguria e përgjithshme në qytet dhe të rritet efikasiteti i zbatimit të ligjit përmes përdorimit të kamerave të rrjetëzuara për mbikëqyrje, në kombinim me një spektër të gjerë modulesh më bashkëkohore nga video-incizimet.

Huazim i mençur i biçikletave - Në përputhje me PMQU, Prishtina ka ndërmarrë disa veprime konkrete në investimin e korsive për biçikleta³⁷, por përdorimi i biçikletave mbetet shumë i kufizuar. Sigurimi i banorëve me një mënyrë të lehtë të marrjes me qira dhe të përdorimit të biçikletave mund të ndihmojë në stimulimin e përdorimit më të gjerë. Shumë qytete kanë adoptuar sisteme me qira të biçikletave me stacione përreth qytetit, por trendi i fundit është për sistemet e qirasë të biçikletave që përdorin teknologjinë wireless për t'i mundësuar përdoruesve të kontrollojnë dhe shikojnë biçikleta.

Huazimi i mençur i biçikletave është koncept i ri dhe shumë i rëndësishëm, i cili u ofron qytetarëve dhe turistëve mënyrë ekonomike transporti dhe mundësi kursimi të një kohe të konsiderueshme gjatë kalimit të largësive të shkurtra nëpër qytet. Gjatë aplikimit të teknologjive të mençura dhe inovative, qytetarëve dhe turistëve do t'u ofrohen shërbime bashkëkohore dhe praktike, duke u mundësuar, njëherësh, fleksibilitet të plotë dhe lehtësi gjatë përdorimit.

Lidhja me nyjet kryesore të transportit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar


Me realizimin e autoudhës Durrës - Prishtinë - Merdar, Prishtina fiton lidhje direkte me qytetet e tangjentuara sikurse që një pjesë e trafikut ndërkombëtar nga Evropa Lindore mund të ridrejtohet përmes Prishtinës për në portin e Durrësit dhe atë të Shëngjinit, për të vazhduar më tej.

Lidhja e propozuar e sistemit të transportit me rrjetet dhe korridoret e rëndësishme pan evropiane. Linja hekurudhore 10 dhe Rruga R6 dhe R7 seksioni i mbetur Besi-Merdare, sigurojnë, në të ardhmen, rrugë alternative për korridoret hekurudhore X dhe VIII.

³⁷ Raport: Mbështetje për hartimin e kornizës për zhvillimin e modaliteteve të transportit të pa-motoriuar në Prishtinë, me fokus në çiklizëm, Prishtinë 2020



Figura 18 Lidhja e Prishtinës në nivel rajonal dhe në korridoret pan-evropiane



Harta 42 Koncepti hapësitor i zhvillimit të transportit

3.3.2.4 Infrastruktura Publike dhe Sociale


Shëndetësia

Për të realizuar konceptin e zhvillimit hapësinor të planifikuar për institucionet publike të kujdesit shëndetësor dytësor, komuna e Prishtinës planifikon ndërtimin e një spitali të përgjithshëm me sipërfaqe prej 4.51 ha.

Për ofrimin e shërbimeve cilësore shëndetësore për të gjithë banorët e komunës, planifikohet edhe ndërtimi i qendrës së shëndetit publik dhe mikrobiologjik si dhe ndërtimi i poliklinikës stomatologjike në komunë.

Sa i përket institucioneve të kujdesit shëndetësor parësor, duke marrë parasysh vlerësimin e gjendjes ekzistuese që konstaton se vendbanimet e zonës rurale të komunës janë të mbuluara me shërbime të këtyre institucioneve, planifikohet vetëm përmirësimi i infrastrukturës fizike dhe teknike në këto institucione. Në të njëjtën kohë, me qëllim të zbatimit të elementeve të Smart City-t në komunë, planifikohet edhe përmirësimi i sistemit informativ shëndetësor, i cili mundëson qasje më të lehtë në të dhëna dhe statistika shëndetësore stafin profesional të këtyre institucioneve, dhe rrjedhimisht ndikon në rritjen e efijencës në ofrimin dhe pranimin e shërbimeve për qytetarët.

Në anën tjetër, vlerësimi i gjendjes ekzistuese ka konkluduar në nevojën për ndërtimin e disa QMF-ve në pika të ndryshme të zonës urbane, me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore më standarde një QMF/10000 banorë. Kështu, sipas Planeve Rregulluese të Hollësishme në zonën urbane janë planifikuar të ndërtohen edhe 21 QMF të reja, një AMF si dhe Spitali i Qytetit. Lokacionet dhe shpërndarja hapësinore e këtyre institucioneve shëndetësore janë paraqitur në hartën në vijim.




Harta 43 Koncepti hapësinor i zhvillimit të institucioneve shëndetësore

Arsimi

Komuna e Prishtinës ka për qëllim ofrimin e shkollimit në një ndërrim dhe me aktivitete jashtë-kurrikulare për fëmijët, prandaj është planifikuar ndërtimi i objekteve të reja shkollore. Sipas Planeve Rregulluese të Hollësishme janë planifikuar 24 shkolla të nivelit të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët në lagje të ndryshme të qytetit si: Sofali, Kodrina, Qëndresa, Arbëria, Kalabria, Kodra e Trimave, Prishtina e re etj.


Sa i përket institucioneve të arsimit të mesëm të lartë, në komunë planifikohet të ndërtohet 6 shkolla të mesme. Gjimnazi “Ahmet Gashi”, shkolla e muzikës, artit dhe dramës dhe gazetarisë. Në frymën e krijimit të kapaciteteve profesionale në sektorët më të rëndësishëm si ai i Teknologjisë informative, planifikohet edhe themelimi dhe fuqizimi i shkollave të mesme profesionale në komunë.



Harta 44 Koncepti hapësiror i zhvillimit të infrastruktures arsimore – shkollat fillore dhe të mesme

Në nivelin e arsimit parashkollor, planifikohen investime në objekte të institucioneve parashkollore në të gjitha lagjet ku ato mungojnë, qoftë si objekte të veçanta apo si pjesë e objekteve ekzistuese të institucioneve të arsimit fillor. Për shkak të mungesës së hapësirave të mjaftueshme në objektet e institucioneve publike të arsimit parashkollor, këto nevoja i kanë plotësuar objektet e arsimit parashkollor privat në komunë. Për të mbështetur dhe barazuar rëndësinë e sektorit privat me atë publik, planifikohet subvencionimi i një pjese të kostos së çerdheve private për familjet të cilat nuk kanë mundësi të regjistrojnë fëmijët e tyre në çerdhe publike.

Sipas Planeve Rregulluese të Hollësishme janë planifikuar gjithësej 67 institucione parashkollore të shpërndara nëpër të gjitha lagjet e kryeqytetit.



Harta 45 Koncepti hapësinor i zhvillimit të infrastruktures arsimore – institucionet parashkollore

Administrata publike

Komuna e Prishtinës synon të zhvillohet bazuar në konceptin e policentrizmit, duke krijuar nyje të shumta nëpër vendbanime, me qëllim të shpërndarjes sa më eficiente të shërbimeve publike dhe gjithëpërfshirjen institucionale në vend. Për arritjen e këtij qëllimi, është planifikuar fuqizimi i bashkësive lokale brenda zonës urbane të komunës si dhe ndërtimi i tri bashkësive të tjera lokale, specifikisht në lagjet Mati 1, Veternik dhe në lagjen Qendër.


Institucionet e mirëqenies sociale dhe të komunitetit

Një nga elementet kryesore të cilat janë marrë për bazë gjatë hartimit të këtij plani strategjik për komunën e Prishtinës, është ndikimi i drejtpërdrejt dhe ai indirekt i pandemisë Covid-19 në jetën e qytetarëve dhe në mënyrën e qeverisjes dhe administrimit të institucioneve. Mirëqenia sociale e qytetarëve të komunës së Prishtinës është e një rëndësie të veçantë, prandaj edhe planifikimet për përmirësimin e shërbimeve të komunitetit janë vlerësuar si të nevojshme. Për arritjen e këtij qëllimi, është planifikuar ndërtimi i objektit të ri të Qendrës për Punë Sociale dhe ngritja e kapaciteteve profesionale dhe teknike në këtë institucion. Në të njëjtën kohë, planifikohet edhe përkrahja institucionale e të moshuarve ku planifikohet të ndërtohet shtëpia e të moshuarve, pastaj përkrahja e personave me nevoja të veçanta, komuniteteve të marginalizuara, si dhe komunitetit LGBT në komunë, me ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale për ofrimin e kushteve më të mira për jetesë. Po ashtu planifikohet ndërtimi i qendrave të sigursë të policisë dhe zjarrfikësit.

Kultura

Komuna e Prishtinës ka traditë të artit, kulturës dhe kreativitetit në përgjithësi. Prandaj mbështetja e aktiviteteve të tilla është shumë e nevojshme për zhvillimin e Prishtinës si qendër rajonale të artit dhe kulturës. Për të arritur këtë zhvillim, është planifikuar ndërtimi i objekteve të ndryshme të kulturës dhe artit, që përfshijnë:

- Qendra multifunksionale
- Pallati i Operas dhe Baletit
- Qendra kulturore
- Qendra kulturore religjioze
- Salla koncertale
- Ndërtimi i Teatrit të qytetit
- Ndërtimi i Galerisë së qytetit
- Themelimi i muzeut të artit
- Themelimi i orkestrës së qytetit
- Themelimi i shkollës së artit
- Funkcionalizimi i katër qendrave kulturore me bazë në komunitet
- Zgjerimi i degëve të Bibliotekës Komunale.
- Muzeu i dhimbjes - deportimit



Harta 46 Koncepti i zhvillimit të hapësirave publike dhe sociale

Sa i përket projekteve të cilat janë planifikuar nga niveli qendror, përkatësisht nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, janë me rëndësi të përmenden:

- Muzeu Përkujtimor, që trajton luftën e fundit në Kosovë, përfshirë viktimat e luftës, eksodin dhe rezistencën e popullit të Kosovës
- Muzeu i Sistemit Paralel

- Muzeu i Shkencave të Natyrës
- Muzeu Arkeologjik dhe Historik
- Muzeu i Shkencës
- Muzeu i Bashkëjetesës Fetare
- Muzeu i Gjuhës Shqipe
- Tempulli i Paqes


Prishtina si qendër kulturore e Kosovës dhe qendra kryesore kreative duhet të zhvillojë artin publik. Përveç artit publik që lidhet direkt me heronjtë dhe shprehje socio-realiste, arti dhe skulpturat bashkëkohore planifikohet të përdoren si elemente nxitëse të komunikimit dhe të krijojnë e shënjojnë vende të reja gravituese dhe peisazhore në qytet.

Sporti

Zhvillimi i institucioneve dhe infrastrukturës sportive publike dhe private konsiderohet si qëllim i këtij PZHK. Në kushtet e ekonomisë së tregut, sporti është aset dhe industri ekonomike shumë e rëndësishme e vendit. Ashtu si edhe në vendet e tjera, suksesi i sistemit të sportit në ofrimin e cilësive dhe shkathtësive kyçe që kërkohen në sportin ndërkombëtarë do të jetë i një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e ardhshëm ekonomik. Në këtë drejtim, Prishtina do të kompletoj dhe fuqizoj infrastrukturën sportive publike dhe private dhe do të ofroj hapësira për këto institucione. Një faktor tjetër veçanërisht i rëndësishëm për ekonominë e Prishtinës por edhe të tërë Kosovës është zhvillimi i të gjitha disiplinave sportive moderne. Së fundi, nivelet më të larta të rezultateve në sport rrisin shanset edhe për të konkurruar me sukses në klubet e huaja, krahas klubeve brenda Kosovës.

- Prishtina do planifikoj hapësirat por edhe lehtësoj kushtet për institucionet sportive publike e private ekzistuese të të gjitha niveleve (me theks në Futboll);
- Prishtina do planifikoj hapësirat por edhe lehtësoj kushtet për institucionet sportive publike e private që eventualisht mundën të ofrohen me kërkesa qoftë për infrastrukturë, hapësirë, kushte etj.;
- Analizoj dhe mundësoj bashkëpunim deri te partneritetet;
- Inicijoj debat për nevojat e disiplinave të sportit dhe do mundësoj kushtet të mjedisit fizik për institucionet, infrastrukturën dhe aktivitetet që lidhen me këto kërkesa në komplet territorin e komunës dhe kryeqytetit.

Sporti shkollor, profesional dhe ai rekreativ janë planifikuar të mbështeten në aspektin institucional me renovimin e objekteve ekzistuese sportive nëpër shkolla, organizimin e ligës shkollore të shkollave të mesme në kryeqytet, ndërtimin e Qendrës multi-funksionale për sport dhe stadiumin kombëtar, ndërtimin e pishinës olimpike të notit, hapjen e shtigjeve të reja për ecje dhe biçikleta në zona rekreative si në Gërmirë dhe fshatrat e Gollakut si dhe krijimin e terreneve të sporteve të ndryshme në pjesë të ndryshme të komunës.



Harta 47 Koncepti i zhvillimit të hapësirave sportive

Hapësirat publike të hapura

Hapësirat publike janë të njohura si asete jetik urbane për një jetesë të shëndetshme urbane, dhe strategjitë e zhvillimit rajonal të këtyre hapësirave janë shfaqur gjithashtu si një strategji kryesore urbane për të krijuar një mjedis më të jetueshëm dhe për të rritur reziliencën urbane, duke përdorur zgjidhje të bazuara në natyrë dhe duke lidhur rrjetin e gjelbër me jetën publike. Në mënyrë të ngjashme, edhe strategjitë e zhvillimit rajonal janë shfaqur si një nga komponentët qendrorë të urbanizmit të qëndrueshëm dhe luftës urbane kundër ndryshimeve klimatike.

Për këtë arsye, Kryeqyteti Prishtina planifikon sigurimin e dizajnit, menaxhimit dhe mirëmbajtjes së suksesshme të hapësirave publike pasi hapësirat publike të suksesshme ofrojnë përfitime të mëdha ekonomike, sociale dhe mjedisore për komunitetet e tyre dhe më gjerë. Kështu planifikohet zgjerimi i shesheve dhe hapësirave për këmbësor, krijimi i parqeve, hapësirave rekreative dhe hapësirave të gjelbra.

Një nga qëllimet kryesore në lidhje me hapësirat e hapura publike është sigurimi i një rrjeti të hapësirave të gjelbra me qasje të lehta, të ndërlidhura dhe të shpërndara njëtrajtësisht nëpër lagje³⁸. Projekt kryesor që rrjedh nga qëllimi i lartcekur për hapësirat publike është lidhja e hapësirave të gjelbra përmes krijimit të korridoreve të gjelbra, të cilët do t'u mundësojnë qytetarëve lëvizje nga një pikë e qytetit në tjetrën, kryesisht përmes korridoreve të pastër dhe të sigurtë për këmbësorë e transport alternativ, si biçikleta e trotineta motorik. Qëllimi është të krijohet një vazhdimësi e hapësirave të gjelbra që lidhin lagjet dhe që plotësohen me elemente për sporte dhe palestër në natyrë, si dhe parqe rekreative me kënde lojërash dhe mobilierë të përshtatshëm urban. Korridoret e gjelbra nuk do të përfshijnë vetëm gjelbërimin në nivel horizontal, por edhe drunjtë dhe gjelbërimin vertikal (si muret e

³⁸ Qyteti I Prishtinës, Plani I veprimit për Qytet të Gjelbër, 2021

të Komunës.³⁹


Harta 48 Koncepti i zhvillimit të hapësirave të hapura publike dhe të gjelbërta

Objektet e religjionit dhe varrezat publike

Gjatë analizës së sipërfaqeve kadastrale për kokë banori në numrin e parashikuar për vitin 2031 për secilin vendbanim të komunës së Prishtinës, është vlerësuar se hapësira ekzistuese e varrezave është e mjaftueshme për periudhën e ardhme deri në vitin 2031. Njëkohësisht, objektet fetare kanë një shpërndarje të mirë në vendbanimet e komunës, ndaj është vlerësuar se këto hapësira janë të mjaftueshme për periudhën e ardhme deri në vitin 2031.

Komuna e Prishtinës planifikon mirëmbajtjen e objektet fetare dhe hapësirat e varrezave. Në zonën urbane planifikohet të alokohet hapësirë e veçantë për krematorium, duke pasur parasysh kriteret për përcaktimin e këtij lokacioni dhe masat mbrojtëse ndaj ndikimeve negative që mund të ketë kjo veprimtari në mjedisin përreth. Poashtu disa objekte fetare që janë të vjetra dhe konsiderohen pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore tu kushtohet një kujdes i veçantë.

³⁹ Qyteti i Prishtinës, Plani i veprimit për Qytet të Gjelbër, 2021



Harta 49 Koncepti i zhvillimit të menaxhimit të varrezave

3.3.2.5 Mbrojtja e mjedisit, trashëgimisë kulturore dhe natyrore

Mbrojtja e mjedisit në komunën e Prishtinës është mision i veçantë marrë parasysh vlerat e saja natyrore siç janë ato pyjore, ujore dhe tokën bujqësore. E gjithë kjo krijon një natyrë që është potencial për zhvillim të turizmit. Për të luajtur rolin që i përshkruhet duhet të mbrohet ajri, uji dhe toka. Territori i komunës së Prishtinës, vazhdimisht është ballafaquar me fatkeqësi natyrore dhe aksidente të ndryshme, ku në masë të madhe shkaktohen dëme materiale si në pjesën urbane ashtu edhe në atë rurale.

Komuna ka paraparë si të domosdoshme ndërtimin e impiantit kryesor për ujërat e zeza dhe impiante tjera në fshatrat të cilat për shkak të konfiguracionit të terrenit nuk mund të lidhen me atë kryesor. Për më tepër edhe çdo operator industrial duhet të parasheh masa për trajtimin e ujërave të zeza (ndërtimin e sistemeve të brendshme të filtrimit të ujërave industrial - impianteve vetanake), e gjithë kjo me qëllim të mbrojtjes së lumenjve dhe tokës nga degradimi që mund të shkaktojnë mbetjet industriale. Zgjerimi i kapaciteteve të deponisë rajonale dhe eliminimi i deponive ilegale është hapi tjetër në funksion të mbrojtjes së mjedisit.

Mbrojtja e ujit

Në Komunën e Prishtinës, lumenjtë dhe derdhjet e tyre që kalojnë përgjatë qytetit dhe disa fshatra janë të ndotura në shkallë të madhe. Komuna planifikon të ndërmerr masa për mbrojtjen e zonave ujore, burimeve të ujërave nëntokësor, ujërat sipërfaqësorë dhe ujë rrjedhat e hapura, të bëjë mirëmbajtjen e ujërave, kontrollimin e zhvillimeve dhe ndërtimeve etj. Përveç masave të cekura më lartë, për mbrojtjen e ujërave do të bëhet eliminimi i deponive ilegale dhe menaxhimi efektiv i mbeturinave, si dhe trajtimi i problemit të derdhjes së ujërave të ndotura të pa trajtuara në përroje, dhe në lumenjtë si Prishtevka, Llapi dhe Graçankë.

Për të mbrojtur trupat ujqor, koncepti planifikon ndarjen e rrjetit të kanalizimit të ujërave të ndotura nga kanalizimi i ujërave atmosferike, dhe ndërtimin e fabrikës për trajtimin e ujërave të zeza në Prishtinë,

që do të parandalonte derdhjen e ujërave të zeza në lumenj dhe përroska të Prishtinës. Përgjatë rrugëve dhe brigjeve të lumenjve do të mbillen pemë për të krijuar breza të gjelbërimit dhe amortizuar ndotjen nga pluhuri, gazrat dhe zhurma. Po ashtu do të ndërmerren masa në lidhje me trajtimin e mbeturinave dhe përdorimin e energjisë që lirohet nga trajtimi i mbeturinave. Për më tepër edhe masat e buta si fushata vetëdijësuese, trajnimeve dhe ligjërata mbi rëndësinë dhe ruajtjen e trupave ujqor duhen të ndërmerren.

Mbrojtja e ajrit

Sipas vlerësimit, ndotja e ajrit kryesisht shkaktohet nga: emetimet e gazrave nga trafiku, dhe nga Korporata Energjetike e Kosovës edhe pse kjo e fundit nuk është në territorin e Prishtinës. Gjithashtu, në mungesë të përfshirjes së gjithë qytetit në rrjetin e ngrohjes qendrore, ndotje shtesë paraqesin të gjitha njësitë e banimit që ngrohen përmes burimeve alternative me dru, pelet dhe thëngjill.

Mirëpo, bazuar në Ligjin nr. 03/L-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, komuna në bashkëpunim me MMPHI duhet të bëjë kontrollimin e vazhdueshëm të emetimeve të pluhurit dhe tymit përmes matësve të cilësisë së ajrit. Prishtina ka stacione për matjen e parametrave të ajrit që monitorohen nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, ndërsa komuna ka 6 stacione të tjera në menaxhim, të cilat janë të vendosura në këto lagje: Bregu i Diellit - Rr. Enver Maloku, Ulpiana - Rr. Mujë Krasniqi, Kodra e Trimave - Rr. Vëllazërit Fazliu, Dodona - Rr. Afrim Loxha, Dardania - Rr. Ilaz Kodra, Qendra – Sheshi Zahir Pajaziti që masin vlerat e PM₁₀, PM_{2.5}, SO₂, NO_x, O₃, CO. Sipas raportit të AMMK 2018 për të gjitha këto parametra kemi vlera në rritje. Në mënyrë që të zvogëlohen pasojat nga ndotësit e ajrit, komuna duhet të hartojë Plan Lokal të Veprimit të Cilësisë së Ajrit, ku do të përcaktohen masat për veprime 8 vjeçare për menaxhimin e cilësisë së ajrit për tërë territorin e komunës në pajtim me Strategjinë e Cilësisë së Ajrit.

Mbrojtja e tokës

Bazuar në të dhënat se nga sipërfaqja totale e komunës së Prishtinës 523.22 km² (52,323 ha), vlerësohet se 12,269.52 ha e kësaj sipërfaqeje është tokë bujqësore me kualitet të lartë të bonitetit (I-IV) dhe 31,819.56 ha e këtyre sipërfaqeve janë pyje si aset nacional, ekonomik dhe mjedisor. Bazuar në UA nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit këto asete duhet të mbrohen parimisht nga degradimi dhe ndërtimi i shpërqendruar. Përveç kësaj, koncepti parasheh mbrojtjen e tokës bujqësore nga:

- Gazrat e shkarkuara, pesticidet dhe plehrat kimikë apo përdorimi i tepruar i tyre në bujqësi;
- Grumbullimi në tokë i Plumbit dhe metaleve të rënda, gazrat dhe mbetjet e tjera;
- Përzjerja me tokën nëpërmjet reshjeve të gazrave të dëmshme që ndotin ajrin;
- Erozionet që vijnë nga shkatërrimi i pyjeve;
- Ndërtimet e shpërndara;
- Fragmentimet e shpeshta dhe të paplanifikuara të tokës bujqësore.

Për secilin prej tyre aplikohen masa të veçanta për mbrojtje. Sa i përket ndjeshmërisë së tokës në komunën e Prishtinës, në hartën e ndjeshmërisë së tokës vërehet se toka përgjatë rrjedhave të lumenjve dhe me bonitet më të lartë ka një sensitivitet më të lartë. Në komunën e Prishtinës, ruajtja e shtretërve të lumenjve nga erozioni dhe nga hedhja e mbeturinave të ngurta dhe të lëngshme, mbron tokën bujqësore edhe bonitetin e lartë përreth trupave ujqor.

Mbrojtja dhe rehabilitimi i pyjeve do të ketë ndikim pozitiv edhe në parandalimin e erozionit. Toka pyjore mbrohet duke ndërmarrë masa për parandalimin e shpyllëzimit, mbrojtjes dhe rregullimit përmes pyllëzimit dhe ripyllëzimit. Pyllëzimi duhet të bëhet përmes mbjelljeve të bimëve apo farës. Gjithashtu edhe për mbrojtje të biodiversitetit duhen të ndërmerren masa të veçanta sidomos për speciet endemike të florës dhe faunës si dhe mbrojtjes së peizazhit

Biodiversiteti

Meqë Peizazhi i Mbrojtur - Gërmia paraqet një rajon shumë të rëndësishëm dhe interesant në aspektin floristik, vegjetativ, faunistik dhe turistik-rekreativ është e domosdoshme që të ndërmerren masa adekuate për mbrojtjen e saj nga degradimi i vazhdueshëm. Prandaj për ruajtjen e Parkut të Gërmisë si peizazh i mbrojtur por edhe të tërë masivit të Gërmisë nga degradimi i mëtutjeshëm duhet një angazhim më i madh duke filluar prej qytetarit, ndërmarrjes menaxhuese, organeve komunale të Prishtinës, e deri te instancat më të larta shtetërore. Pra duke e ditur se ruajtja e masivit të Gërmisë është me interes të madh për Prishtinën, me gjelbërimin që do të mbillet në të ardhmen në komunën e Prishtinës duhet ti përshtatet biodiversitetit të kësaj Komune.

Parandalimi dhe mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore

Bazuar në Ligjin nr. 04/L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, komuna e Prishtinës, përkatësisht sektori për Mbrojtje dhe menaxhimin e fatkeqësive duhet të ketë "Planin për Reagim Emergjent Komunal", i cili përcakton procedurat, përgjegjësitë dhe detyrat e strukturave komunale dhe tjera në ballafaqimin me fatkeqësitë natyrore, bën evidentimin e mjeteve për reagim emergjent në komunë dhe vlerëson nevojën për ngritje të kapaciteteve teknike dhe njerëzore. Për më tepër komuna për të parandaluar rreziqet dhe fatkeqësitë natyrore duhet të krijoj dhe funksionalizoj Qendrën Operative Emergjente Komunale (QOEK).

Analiza e rreziqeve paraqet dukuritë kryesore që ndodhin në komunë, e që janë vërshimet, zjarret, erërat e forta, erozionet dhe incidentet me materie të rrezikshme.

Mbrojtja nga erozioni

Në komunën e Prishtinës janë identifikuar zonat me shkallë të lartë të erozionit që gjenden në pjesën për rreth lumenjve dhe këto zona erozive të intensitetit të lartë janë të paraqitura në hartën e erozionit. Shfrytëzimi i tokës në komunën e Prishtinës, shpyllëzimi dhe shtrirja urbane kanë ndikuar në ngritjen e shkallës së erozionit. Koncepti me përcaktim të shfrytëzimit të tokës për tërë territorin e komunës, shtrirjen e kontrolluar të vendbanimeve me ndërtime dhe me veprime për pyllëzim promovon praktika të qëndrueshme të shfrytëzimit të tokës, që ndikon në parandalim të erozionit.

Zonat në të cilat erozioni është me intensitet më të madh sipas Ligjit të ujërave duhen të shpallen "zona erozive". Për të parandaluar aktivitetin eroziv në këto zona duhen të ndërmerren veprime anti-erozive si hidroteknike, bujqësore, si dhe biologjike varësisht nga rasti. Shpesh këto masa duhet të kombinohen për të arritur rezultate më të mira anti-erozive.

Masat bujqësore:

- Mirëmbajtja e tokave bujqësore me mekanizma modern.
- Zhvillimi i një sistemi të ujitjes dhe kullimit.

Masat biologjike:

- Mbrojtja e pyjeve ekzistuese nga prerjet e pa kontrolluara dhe nga zjarri;
- Mbjelljen e drunjëve që do të mbulonin brezin prej 10 m largësi nga lumi për të kufizuar erozionin në lumenjtë kryesor;
- Pyllëzimi i viseve të zhveshura dhe atyre të degraduara;
- Krijimi i brezave të gjelbër në ato rajone ku shkalla e erozionit është e lartë;

Mbrojtja nga vërshimet

Vërshimet janë një ndër fenomenet të cilët më së shpeshti sulmojnë sipërfaqet e ndryshme të komunës, që ndodhin në përmasa të ndryshme varësisht nga të reshurat atmosferike.

Në Prishtinë janë identifikuar zonat me rrezikshmëri të lartë nga vërshimet, dhe koncepti parasheh masa mbrojtëse nga vërshimet si :

- Rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe përroskave duke ndërtuar argjinatura (rregullim i bankinave) në disa pjesë të Lumit Prishtevka, Graçankë dhe Llapi.
- Përcaktimi i brezave mbrojtës për lumenjtë, ku ndalohen ndërtimet sipas ligjit .
- Mirëmbajtjen e shtretërve të rrjedhave ujore, përmirësimin e argjinaturave mbrojtëse.
- Pastrimin e kanaleve të ujitjes dhe të kanalizimit atmosferik të cilat bëhen pengesë e rrjedhjes së ujërave në rastet e reshjeve më të mëdha.
- Hapjen dhe rregullimin e shtretërve të, Prishtevka, Graçankë dhe Llapi për të evituar vërshimet në rast të reshjeve të mëdha dhe shkrirjes së borës.
- Ndërtimin e pendave për mbrojtje nga erozioni që shkaktojnë përrrenjtë nga malet.

Masat për mbrojtje nga zjarri

Bazuar në Ligjin nr. 04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri, komuna është përgjegjëse për hartimin e Planit për mbrojtje nga zjarri në nivel komunal që merr për bazë vlerësimin e rrezikut nga zjarri dhe praktikatat e deritashme si dhe është në pajtim me Planin shtetëror për mbrojtje nga zjarri. Komuna e Prishtinës e ka të hartuar këtë plan në vitin 2011, ku ka të përcaktuara përgjegjësitë për fatkeqësi përkatëse si dhe mjetet teknike për ballafaqim me fatkeqësitë në këtë rast për njësinë e zjarrfikësve dhe automjetet.

Në Prishtinë janë prezente zjarret të shkaktuara kryesisht nga temperaturat e larta, nga lartpërçuesit të vjetër elektrik dhe zjarrvëniet dhe veprimtaritë e pakujdesshme njerëzore. Gjithashtu janë evidentuar vatrat e zjarreve në pyje, siç janë pyjet në afërsi të vendbanimeve Prishtinë, Llukar, Koliq, Keqekollë, Prapashticë, Nishec, Dabishec, Hajkobillë, Glllogovicë, Kukaj, Dragoc dhe në disa vendbanime tjera. Në këtë aspekt duhet të ndërmerren masa për parandalimin e përhapjes së zjarreve eventuale.

Masat mbrojtëse parashihen konform situatave, ku qeveria komunale bazuar në Planin emergjent formon shtabet e krizave në përkrahje të shërbimit të zjarrfikësve. Në këtë kontekst masat që duhet ndërmarrë janë:

- Inspektimi për parandalim të zjarrvënies të qëllimshme në zonat pyjore dhe tokat bujqësore;
- Respektimi i kushteve të ndërtimit të përcaktuara me kornizën ligjore për mbrojtje nga zjarri;
- Sigurimi i elaborateve për siguri nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për të gjitha projektet e ndërtimit për të gjitha kategoritë konform ligjeve përkatëse.
- Planifikimi i tampon zonave në mes të zonave pyjore dhe të tjera të cilat janë të ndjeshme nga zjarri si dhe një tampon zonë në brezin kufitar për të penguar përçimin eventuale të zjarrit.
- Vendorsjen e hidrantët në vende të caktuara në qytet dhe vendbanime.
- Sigurim i qasjes së automjeteve të zjarrfikësve deri të çdo njësi banimi.

Në kuadër të vlerësimit janë identifikuar zona me rrezikshmëri sizmike të shkallës 8.0 mk ku për secilën zonë do të ndërmerren masa adekuatë. Në tërë komunën e Prishtinës duhet aplikuar Euro kodin 8 në ndërtimet e infrastrukturës dhe objekteve të banimit për t'i përballuar intensitetit të dridhjeve dhe për minimizimin e pasojave në raste rreziku. Po ashtu duhet të bëhet një analizë mikro sizmike për komunën e Prishtinës dhe kujdes të veçantë duhet kushtuar ndërtimeve të larta >P+4, objekteve industriale dhe infrastrukturës rrugore, e sidomos urave.

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore

Sipas Strategjisë së Këshillit të Evropës për Trashëgiminë Kulturore Evropiane ekziston një nevojë urgjente që shoqëria në tërësi, autoritetet shtetërore dhe komunitetet që janë roje të trashëgimisë, të pozicionojnë politikën e trashëgimisë kulturore në atë mënyrë që për ta vënë atë në qendër të një qasjeje të integruar që synon ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë.

Përvojat kanë dëshmuar se vetëm restaurimi dhe konservimi i trashëgimisë kulturore nuk janë të mjaftueshme për mbrojtjen aktive, afatgjate dhe efikase të saj. Në praktikë po tregohet me rëndësi destinimi i ri i trashëgimisë si aset dhe në kuadër të kontekstit urban promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe shfrytëzimin e tyre për zhvillim ekonomik dhe të turizmit. Historitë dhe kujtimet, krenaria e dikurshme janë burimi i zhvillimit urban dhe identitetit dhe mund të ringjallen, interpretohen dhe shndërrohen në jetë të re. Kjo jetë e re përfshin ripërdorimin e ndërtesave të trashëgimisë si qendra për rinovimin kulturor, zhvillues të kapitalit social.

Kjo kërkon kycjen e planifikimit urban, hapësinore dhe promovimit të vlerave të aseteve, shfrytëzimi aktiv i tyre dhe i vlerave ambientale dhe historike urbane. Gjithashtu kërkon gjetjen e metodologjisë për investime aktive në trashëgimi dhe në kontest urban e jo vetëm kalkulime të përfitimeve nga trashëgimia dhe turizmi kulturore. Është e mirëseardhur analiza e planifikimit të gjerë urbanistik i cili do të mundësonte shfrytëzimin e benefiteve nga trashëgimia kulturore – ku trashëgimia kulturore trajtohet si strategji për zhvillimin e turizmit kulturore dhe të eko-turizmit.

Trashëgimia kulturore do të shndërrohet në faktorë të fuqishëm të zhvillimit social, ekonomik, mjedisor dhe kulturor si nëpërmjet aktiviteteve ashtu edhe nëpërmjet politikave. Prandaj, do të implementohet një qasje e integruar e cila përqendrohet në ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë.

Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm përfshin katër komponentë kryesorë:

- Komponentin kulturore-asetet e trashëgimisë kulturore janë shpesh pikë referente hapësinore të cilat karakterizojnë peisazhin dhe i japin identitet.
- Komponenti social-ripërdorimi i ndërtimit të lënë pasdore mund të krijojë dinamikë sociale dhe të kontribuojë në renovim urban.
- Komponenta mjedisore - ndërtimin e qyteteve të qëndrueshme
- Komponenta ekonomike - rritja e atraktivitetit të zonës, zakonisht ka të bëjë me komponentë turistike e cila po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme, ku synimi nuk është vetëm të gjenerojë të ardhura dhe të zhvillojë turizmin, por edhe të ruajë, rigjallërojë dhe promovojë më tej trashëgiminë.

Modelet e trajtimit të trashëgimisë kulturore që do të përdoren janë:

- **Modeli i mbrojtjes** – parandalimi i dëmeve për shkak të përdorimit ku trashëgimia mbrohet nga dëmet gjatë shfrytëzimit,
- **Modeli i zhvillimit** – hulumtimi, rivitalizimi, përshtatja, me të cilin rriten vlera potenciale e trashëgimisë dhe mundësia e shfrytëzimit bashkëkohorë,
- **Modeli i shfrytëzimit**: shoqëror, arsimor, teknologjik, kulturor, turizëm etj. Pritshmëria është që ky model të ndihmojë në zhvillim të qëndrueshëm. Në këtë kontekst duhet të analizohen modelet e turizmit kulturore në funksion të rivitalizimit dhe përmirësimit të trashëgimisë kulturore.

Gjithashtu mund të shqyrtohet edhe **modeli i përmirësimit** të trashëgimisë kulturore - rigjenerim, transformimi etj. Mund të themi se, pavarësisht nga qasja, trashëgimia luan një rol kyç në të gjitha shoqëritë dhe se mbrojtja e saj do të integrohet duke zhvilluar një model "të integruar" të mbrojtjes dhe

përmirësimit të trashëgimisë në kuadrin e zhvillimit të qëndrueshëm urban, i cili përfshinë angazhimin aktiv të komunitetit lokal dhe të gjithë aktorëve të interesuar.


Posaçërisht janë të rëndësishme programet të cilat e integrojnë trashëgiminë materiale dhe jo materiale me programet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të ndryshimeve klimatike.

Në Prishtinë do të merret parasysh edhe një faktor tjetër – pasojat e ndryshimeve klimatike janë sidoqoftë më të buta se në vendet tjera të Evropës. Kjo përparësi do të shfrytëzohet për promovim të turizmit, eko-turizmit dhe të trashëgimisë kulturore.

Qendra Historike e Prishtinës përbën një nga zonat identitare të qytetit, ku janë të koncentruara objektet kryesore të trashëgimisë kulturore. Që të promovohet kjo zonë dhe të ofrohet qasje në të, planifikohet të projektohet një rrugë, që do t'i përshkojë të gjitha monumentet arkitektonike-kulturore. Me këtë projekt, parashihet gjithashtu të intervenohet edhe në elemente arkitektonike të zonës, rehabilitim të disa shtëpive banuese, si dhe në aspekte tjera infrastrukturore (ndriçim publik, shenjëzim etj.). Por para së gjithash, përcaktimi i kufirit zyrtar dhe hartimi i planit të menaxhimit apo planit të konservimit për këtë zonë është elementi kyç për integrimin e trashëgimisë kulturore në kornizat e planifikimit hapësinor, për një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Për momentin, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është në proces të hartimit të studimit të fizibilitetit dhe planit të konservimit apo planit të menaxhimit të Qendrës Historike të Prishtinës, dhe komuna e Prishtinës planifikon që dokumentet e tilla relevante të nivelit qendror të azhurnohen menjëherë pas hyrjes në fuqi me dokumentet e planifikimit të nivelit lokal.

Pazari i Vjetër i Prishtinës përfaqëson një nga zonat më të vjetra të qytetit, ndonëse ka ndryshuar me kohë duke e humbur origjinalitetin, ende funksionon si treg për shitje të perimeve, frutave dhe produkteve të bulmetit. Ky pazar do të ridimensionohet në një model të ri investimi dhe në hapësirë komunitare. Përveç tregimit të prodhimeve bujqësore, do të ofrojë produkte artizanale, kafe dhe bare tradicionale përreth dhe hapësirë për zhvillimin e aktiviteteve artistike kulturore, siç janë festat, panairët dhe të ngjashme.

Arkitektura moderne e realizuar pas Luftës së Dytë Botërore deri në fund të viteve 80-ta të shek. XX., specifike për nga prurjet origjinale arkitekturore për kohën në të cilën u shfaq, gjithashtu do të trajtohet si potencial për pasurimin e identitetit kulturor të kryeqytetit.



Harta 50 Plani për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore

Zonat e veçanta të mbrojtura

Zona e veçantë e mbrojtur Tyrbja e Bajraktarit në Shkabaj dhe Monumenti Memorial i Gazimestanit janë të definuar me harte dhe me kufi të cilët i rrethojnë ato, në funksion të mbrojtjes nga çdo zhvillim apo aktivitet i cili mund të dëmtojë kontekstin e tyre historik, kulturor dhe arkitektural. Këto zona gëzojnë trajtim të veçantë të mbrojtjes që garantohet me Ligjin NR. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura. Masat për mbrojtjen e tyre duhet t'i përmbahen U. A. për Normat teknike të planifikimit MMPH Nr. 08/2017 (shtojca, Kapitulli II paragrafi 7.)

Trashëgimia natyrore

Vlerat e mbrojtura të natyrës do të përdoren dhe avancohen në mënyrën e cila e mundëson mbrojtjen dhe avancimin e tyre afatgjatë, në përputhje me Ligji Nr. 02/L-18 Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës.

Në pjesën e mbrojtur të natyrës nuk mund të zhvillohen aktivitete të cilat e rrezikojnë ekuilibrin natyror, llojlojshmërinë biologjike dhe peisazhore, hidrografinë, gjeomorfologjinë, gjeologjinë, vlerat kulturore ose në çfarëdo mënyrë degradojnë cilësitë dhe veçoritë e vlerave të natyrës. Duhet ndërmarrë masa të veçanta për ruajtjen dhe shfrytëzimin e vlerave të mbrojtura të kulturës dhe të natyrës.

Në të njëjtën kohë, pas vlerësimit se një numër i madh i aseteve të trashëgimisë natyrore nuk janë të identifikuar si vlera të mbrojtura të natyrës nga autoritetet përgjegjëse të nivelit qendror, komuna e Prishtinës do të bëjë identifikimin e tyre dhe do të bëjë propozim për mbrojtje ligjore të këtyre aseteve. Këto asete do të zhvillojnë potencialin e komunës për ofrimin e turizmit rural të natyrës në formën e shtigjeve turistike duke bërë ndërlidhjen e zonave të ndryshme rurale dhe asaj urbane mes vete.

Sa i përket Gërmissë, mbrojtja e kësaj hapësire planifikohet të shtohet, prioritet do të jetë shpyllëzimi, apo rrallimi i pyjeve ku është e nevojshme dhe diversifikimi natyror i hapësirave të shpyllëzuara pa kontroll. Qasja e qytetarëve në drejtim të Gërmissë do të jetë më direkte dhe e lehtësuar, do t'i shtohen dhe funksione tjera rekreative, që janë eko-miqësore dhe multi-funksionale. Organizimi i aktiviteteve

rekreative kulturore në Gërmi do të bëhen duke ndërmarrë masa përkatëse për mbrojtje për të mos rrezikuar florën dhe faunën e asaj zone. Shtigjet ekzistuese të këtij parku do të zhvillohen dhe do të përshtaten për të gjitha grupet e turistëve, sipas interesave të tyre rekreacionale (p.sh. për ecje, vrapim, biçikleta etj.).

3.3.2.6 Vendbanimet, banimi dhe trajtimi i vendbanimeve joformale

Koncepti i zhvillimit hapësinor të vendbanimeve

Për të ruajtur tokën bujqësore dhe për një përdorim më racional të territorit dhe mbrojtjes së burimeve, komuna synon një zhvillim më kompakt me dendësi më të lartë të shfrytëzimit të tokës. Një qytet më kompakt, është një qytet që konsumon më pak burime dhe mund të zbatojë sisteme të transportit në mënyrë më efektive me një kosto më të ulët. Qëllimi kryesor është që të sigurojë mundësi për një zgjerim të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm urban, duke shmangur shtrirjen e pakontrolluar të hapësirës, duke ofruar lehtësirat e nevojshme, objektet dhe zonat e aktivitetit për të formuar lagje të integruara dhe atraktive për të jetuar.

Komuna e Prishtinës planifikon të angazhohet në përgatitjen e një Kornize Bashkëpunimi Ndërkomunal me komunat fqinje për të siguruar një komunikim të hapur / transparent me palët e interesuara, sidomos kur marrin parasysh vendimet për përdorimin e tokës dhe zhvillimin e saj. Gjithashtu, komuna do të ketë bashkëpunim në kornizat e përbashkëta të planifikimit, zhvillimit dhe funksionimit me komunat fqinje që adresojnë koordinimin efektiv dhe me kosto efektive të përdorimeve të tokës, zonave të ardhshme të rritjes, sistemeve të transportit, infrastrukturës komunale dhe shërbimeve komunale përmes politikave sociale.

Realiteti i ri urban në Prishtinë është i karakterizuar nga zhvillimi urban periferik. Forma policentrike urbane është një alternativë e mundshme për zhvillimin urban radial, karakterizuar me marrëdhëniet e kohëve të fundit ndërmjet qendrës së qytetit dhe rrethinave. Zhvillimi policentrik është parimi i organizimit të një rajoni rreth disa qendrave publike, sociale dhe financiare. Zhvillimi i këtyre qendrave do të sigurojë ofrimin e shërbimeve publike të mjaftueshme dhe të barabartë në pjesë të ndryshme të qytetit, që do të thotë ofrimin e shërbimit për njerëzit që nuk do të duhet të lëvizin nga mjediset e tyre. Ky zhvillim tenton t'i ofroj qytetarëve shërbime publike dhe sociale, kulturore e ekonomike dhe administrative në afërsi duke u mundësuar qasje të barabarta.

Koncepti i zhvillimit hapësinor rekomandon zhvillim kompakt dhe të balancuar, duke filluar nga zona urbane e deri tek vendbanimet në zonën rurale. Zhvillimi kompakt do të arrihet duke parandaluar zhvillimet në drejtim të tokës bujqësore në vendbanimet e shpërndara dhe lineare.

Komuna e Prishtinës me një popullsi kryesisht në rritje, planifikon ngritjen e cilësisë së jetesës duke planifikuar për një zhvillim të balancuar mes vendbanimeve. Komuna e Prishtinës planifikon të adoptojë konceptin e qytetit 7 minutësh, duke bërë një shpërndarje të ekuilibruar të shërbimeve publike dhe funksioneve tjera sociale në largësi jo më shumë se 7 minuta në këmbë ose me transport alternativ nga çfarëdo pike e qytetit. Duke marrë parasysh shpërndarjen e zonave të ndërtuara nëpër vendbanimet rurale, është vlerësuar që koncepti i qytetit 15 minutësh (derivat i konceptit të lartpërmendur) mund të adaptohet për ato vendbanime. Karakteristikat kryesore të këtyre koncepteve janë:

- **Afërsia** - çdo shërbim duhet të jetë sa më afër qytetarëve
- **Diversiteti** - Shfrytëzimet e tokës duhet të jenë të përziera për të ofruar një shumëllojshmëri të gjerë të shërbimeve aty pranë.
- **Dendësia** - Duhet të ketë njerëz të mjaftueshëm për të mbështetur një shumëllojshmëri biznesesh në një zonë toke kompakte.

Sa l përket planifikimit për një zhvillim të ekuilibruar, koncepti i zhvillimit hapësinor planifikon një lidhje më të mirë mes zonës urbane me vendbanimet rurale dhe përmirësim të qasjes nga vendbanimet

rreth zonës urbane në zonë urbane. Sigurimi i hapësirave të reja në fshatra (veçanërisht të fshatrave në rritje) bazuar në principet e menaxhimit të qëndrueshëm është pjesë e konceptit zhvillimor. Gjithashtu, duke përdorur veprime strategjike të zhvillimit të turizmit, koncepti tenton të inkurajojë zhvillimin në vendbanimet malore si dhe të ulë dyndjen e tyre në zonën urbane.

Koncepti i zhvillimit hapësinor vetë-mbështet konceptin e shpërndarjes hapësinore të funksioneve të vendbanimeve, nëpërmjet strukturimit të vendbanimeve në nivele të ndryshme hierarkike. Varësisht nga niveli i tyre hierarkik, vendet qendrore bartin lloje të ndryshme të ofrimit të shërbimeve publike si dhe sociale. Klasifikimi hierarkik bëhet për arritje të funksioneve publike të baraspeshuara dhe për rritje të cilësisë së jetesës. Çdo vendbanim do të zhvillohet bazuar në potencialet për zhvillim dhe shërbimet bazë të cilat duhet t'i ofrojë.

Qendër kombetare/Kryeqytet - Qyteti i Prishtinës (zona urbane) përveç se është qendra komunale e cila bartë të gjithë barrën e zhvillimit të komunës, ajo konsiderohet edhe qendër rajonale e cila ofron kushtet e nevojshme për zhvillimin e vendbanimeve dhe komunave përreth. Zona urbane do të jetë qendër ekonomike, turistike, kulturore, edukative dhe shëndetësore dhe shërben tërë komunën dhe rajonin. Fitimi dhe humbja e hapësirës duhet të balancohet në zhvillimin hapësinor të komunës, prandaj krijohen nënqendra të tjera komunal, të cilat veprojnë si gjeneratorë shtytës për zonat rurale, që ofrojnë edhe autonomi dhe kushte të krahasueshme jetese dhe pune.

Zona urbane si qendër kombetare/Kryeqytet e përcaktuar në konceptin e zhvillimit hapësinor planifikohet të ofrojë këto funksione:

- Qendër administrative duke ofruar shërbime administrative për gjithë shtetin, rajonin, qytetin, qendrat e rendit të mesëm dhe gjithë fshatrat në territor të komunës së Prishtinës;
- Shfrytëzime industriale dhe komerciale që kënaqin "kërkesat periodike" duhet të koncentrohen në qytetin e Prishtinës;
- Të siguroj infrastrukturë universitare, para universitare, trajnime profesionale dhe tërë-jetësore për meshkuj dhe femra;
- Të siguroj infrastrukturë për shërbimet më të larta publike dhe sociale në komunë;
- Planifikohet intensifikimi i densitetit banimor në qytet;
- Mbushja dhe zgjerimi urban i qytetit do të bëhet sipas kufirit urban të paracaktuar;
- Përmirësimi i infrastrukturës teknike në një nivel më të lartë;
- Përmirësimi i transportit publik drejt qyteteve tjera, qendrave të rendit të mesëm dhe drejt vendbanimeve rurale.

Qyteti i Prishtinës do të jetë qendra zhvillimore e komunës, andaj koncepti parashikon hapësirë zhvillimore të mjaftueshme për akomodim të rritjes së popullsisë, si nga dyndjet, po ashtu edhe nga rritja natyrale e popullsisë. Zhvillimi në qendër do të bazohet në dy shtresa: 1) arritje të zhvillimit kompakt, duke adoptuar elementin hapësinor si mbushje urbane, dhe 2) integrim i zhvillimeve ekzistuese periferike në aspekt të planifikimit të vazhdimësisë zhvillimore dhe shpërndarjes së shërbimeve publike dhe sociale.

Me zhvillim të konceptit policentrik, Prishtina ka tri qendra: Qendra 1 (Qendra ekzistuese e Prishtinës), Qendra 2 (Qyteti i vjetër) dhe Qendra 3 (Qendra e Re e Prishtinës në Jug).

Njëkohësisht, kjo zonë krijon Boshtin Urban të Prishtinës, zonë e konsoliduar urbane, me shfrytëzim të përzier, duke ofruar funksione administrative, kulturore, shërbime, tregti, rekreacion, banim e të tjera.



Figura 19 Boshti Urban

Boshti urban me infrastrukturë qendrore lidhet nga qyteti i vjetër deri te zona e liqenit të Badovcit dhe ofron:

- Funksionet qendrore të qytetit
- Qeverinë/Ministritë/Selitë e organizatave ndërkombëtare
- Universitetin/Arsimin qendror
- Spitalin
- Biznes/Tregti, Administratë
- Kulturë/ Kinema, Teatër, Muze
- Sport/ Rekreacion, Parqe urbane, shtigje çiklizmi, arena sportive
- Qendra kulturore

Nënqendrat komunale do të ofrojnë shërbime bazë për vendbanimet përreth, duke mundësuar mbulim të përgjithshëm të komunës dhe rrjedhimisht të ofrojnë zhvillim të balancuar.

Vendbanimet Mramor, Bardhosh dhe Keqekollë përcaktohen si nënqendra komunale. Zgjedhja e vendbanimeve që të veprojnë si nënqendra është bazuar në strukturën, funksionin, densitetin dhe morfologjinë urbane ekzistuese të vendbanimeve dhe në parakushtet për zhvillim të mundshëm në të ardhmen. Indikatorët për përzgjedhjen e nënqendrave janë popullata, numri i shtëpive, infrastruktura e mirë shoqërore dhe teknike si dhe potencial për zhvillim tregtar, bujqësor dhe kulturor. Qendrat e tilla do të jenë të pajisura me shkolla kryesore, qendra të mjekësisë familjare, do të kenë qasje të mirë rrugore dhe të cilat tanimë janë qendra sekondare ekonomike ose kanë një numër më të lartë të biznese ekzistuese.

Funksionet e nënqendrave komunale janë:

- Të ofrojnë infrastrukturë të institucioneve të arsimit para-universitar (shkolla të mesme të ulëta dhe të mesme të larta);
- Të ofrojnë infrastrukturë shëndetësore të nivelit dytësor- qendra të mjekësisë familjare, duke siguruar shërbime bazike mjekësore dhe disa specialistë;

- Dyqanet ofrojnë të mira të nevojshme (gjëra ushqimore, pastrimi, etj.) të cilat kënaqin “kërkesat ditore”;
- Ndërmarrjet vendosen në zonat e reja komerciale dhe industriale në qendra të rendit të mesëm;
- Planifikim për zgjerim të balancuar me intensitet të ulët e të mesëm, posaçërisht për shfrytëzime të banimit ;
- Përmirësimi i infrastrukturës teknike, publike dhe sociale dhe qasjes në shërbime publike;
- Lidhje të mira me rrjetin e rrugëve kryesore;
- Sigurim të transport publik urbane - rural drejt qytetit.

Qendrat e rendit të ulët paraqesin nivelin më të ulët brenda hapësirës lokale të gravitimit. Ato përfshijnë plotësimin e nevojave bazike ditore të popullatës dhe ofrojnë infrastrukture minimale.

Qendrat e tilla varësisht nga rezultatet e studimeve të fizibilitetit ekonomik, planifikohet të u lejohet zhvillimi bazuar në potencialet e mundshme të paraqitura.

Funksionet e qendrave të rendit të ulët:

- Të ofrojnë infrastrukturë të institucioneve të arsimit para-universitar (shkolla fillore dhe të mesme të ulëta)
- Të ofrojnë infrastrukturë shëndetësore të nivelit parësor- (punte të mjekësisë familjare)
- Dyqanet ofrojnë të mira të nevojshme (gjëra ushqimore, pastrimi, etj.) të cilat kënaqin “kërkesat ditore”;
- Planifikim për zgjerim të balancuar me intensitet të ulët, posaçërisht për shfrytëzime të banimit
- Përmirësimi i infrastrukturës teknike, publike dhe sociale dhe qasjes në shërbime publike;
- Lidhje të mira me rrjetin e rrugëve kryesore;
- Sigurim të transport publik urbane - rural drejt qytetit.

Disa fshatra në Prishtinë karakterizohen me një numër të vogël të banorëve dhe një numër të vogël të shtëpive me tendenca të zvogëlimit dhe numër të vogël të nxënësve dhe bizneseve të vogla. Komuna do të garantojë kushte të mira të jetesës për banorët e fshatrave të largëta duke ofruar shërbime publike sa më afër tyre që është e mundur në vetë fshatrat ose, nëse është e nevojshme, duke aranzhuar transport të sigurt deri te infrastruktura e shërbimeve publike në fshatrat tjera. Promovim dhe mbështetje të zhvillimit me intensitet të ulët ekonomik, kryesisht zhvillim bujqësor dhe iturizmit rekreativ është po ashtu pjesë e konceptit për zhvillim të këtyre fshatrave.

Vendbanimet joformale

Komuna e Prishtinës përmes planeve rregulluese të miratuara më herët apo vendimeve tjera për këto raste ka arritur t’i shqyrtoj vendbanime jo-formale brenda territorit të saj.

Megjithëse këto vendbanime edhe pas trajtimit të tyre shfaqin problematika të tjera përveç atyre pronësore, koncepti zhvillimor i këtij plani tenton ti adresoj ato, duke i përfshirë në planifikimet e ardhshme. Këtu hyjnë zhvillimet e planifikuara për mbulueshmëri me infrastrukturë teknike, publike, sociale dhe transporti, e njëkohësisht edhe pjesëmarrje në procese vendim-marrëse dhe politika publike.

Ndërtimet pa leje

Me këtë koncept, gjithashtu, janë identifikuar dhe vlerësuar të gjitha ndërtimet pa leje dhe është trajtuar raporti në mes sipërfaqeve të ndërtuara dhe të pa ndërtuara në kuadër të vendbanimeve. Prej hyrjes në fuqi të Ligjit dhe udhëzimeve administrative për Trajtim të Ndërtimeve pa Leje, Komuna vepron konform kësaj baze ligjore drejt legalizimit të ndërtimeve pa leje.

Për ndërtimet pa leje, të identifikuara në pronat me pronësi komunale, duhet të bashkëpunohet me Kuvendin Komunal Prishtinë, si dhe ti bashkërendojnë aktivitetet.

Për ndërtimet pa leje të identifikuara në pronat me pronësi shoqërore (nëse eventualisht ekzistojnë), Komuna e Prishtinës, gjatë trajtimit të të njëjtave duhet të bashkëpunojnë me AKP-në (në nivel regional dhe qendror), si dhe ti bashkërendojnë aktivitetet. Ndërtimet pa leje të identifikuara në pronat me pronësi shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, Ligji Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, menaxhohen dhe trajtohen nën mandatin e AKP-së.

Koncepti i zhvillimit hapësinor të banimit

Banimi, si funksion kryesor i çdo vendbanimi, është vendimtar për stabilitet social, ambient të shëndoshë, shëndet të mirë dhe për një mirëqenie njerëzore, në përgjithësi. Duke qenë shfrytëzuesi më i madh i hapësirës dhe aktiviteti themelor i vendbanimeve, ai ndikon në rrjedhën e zhvillimit të gjithmbarshëm të shoqërisë dhe është komponent i rëndësishëm i zhvillimit socio-ekonomik, përkatësisht të standardit jetësor të qytetarëve në përgjithësi.

Në këtë kontekst, qëllimet kryesore të PZhK-së për banimin e komunës dhe rritjen e cilësisë së jetës janë:

- Sigurimi i banimit të qëndrueshëm për të plotësuar nevojat e tanishme dhe të ardhme të qytetareve
- Rritja e resurseve efikase dhe e shëndetit publik si dhe ulja e ndikimeve negative në ambient duke përdorur strategjitë e ndërtimit të banimit të gjelbër
- Sigurimi i banimit të përballueshëm dhe gjithëpërfshirës

Komuna duhet të plotësojë të gjitha nevojat për banim, andaj numri i njësive të banimit të nevojshme për të ardhmen është planifikuar sipas rritjes së parashikuar demografike, strukturës së popullsisë por dhe kërkesave të tregut. Gjithashtu, pas analizës së kushteve të banimit, përfshirë rekomandimet për zhvillimin e banimit, planifikohet përmirësimi i kushteve të banimit duke ofruar qasje në infrastrukturë adekuate, hapësira adekuate si dhe standard të efikasitetit energjetike.

Komuna e Prishtinës, në veçanti në zonën urbane, duhet të planifikojë njësitë e reja të banimit bazuar në parashikimet demografike dhe në harmoni me trendin e zvogëlimit të madhësisë së ekonomisë familjare.

Bazuar në parashikimet për rritje të popullsisë (kapitulli për demografi), deri në vitin 2031 parashikohet rritje përafërsisht prej 71 000 banorë në komunën e Prishtinës (duke i përfshirë edhe personat që janë në lëvizje afër 56000 banor). Numri i ekonomive familjare parashikohet të rritet afërsisht për 17 750 ekonomi familjare. Aktualisht sipas të dhënave nga komuna e Prishtinës lëshohen mesatarisht 150 leje për ndërtime të reja në vit. Nëse supozojmë që 50% e këtyre lejeve është për ndërtime shumë banesore, dhe mesatarja e njësive të banimit për ndërtesa shumë banesore është 30, llogaritet që çdo vit fondi i banimit në komunë të rritet për rreth 2500 njësi të banimit.

Konceptualisht, propozimi për zhvillimin e ardhshëm përkrah densifikimin e sipërfaqes ekzistuese të ndërtuar sidomos asaj përgjatë indit kryesor urban, në mënyrë që qyteti të jetë më funksional dhe banorët të kenë qasje më të afërt dhe më të mirë të të gjitha shërbimet e nevojshme publike në distanca optimale.

Pas një analize të ndërtesave të banim mund të konstatohet se ka pasur një trend më të lartë të ndërtimit të ndërtesave për banim viteve të fundit, i cili planifikohet të vazhdoj edhe për sa kohë do ketë kërkesa dhe çmime në rritje të ndërtesave për banim. Duke marr parasysh rritjen natyrore të popullsisë, ndryshimin e strukturës familjare si dhe kërkesat e tregut, zona urbane do të vazhdojë të jetë në presion

për njësi të reja banimi, në tipologji banim me shumë njësi, sidomos në pjesën qendrore të qytetit, andaj edhe ky koncept promovon dendësim dhe plotësim, me theks të veçantë banim me shumë njësi.

Rekomandohet që hapësirat të jenë shumë-funksionale dhe se në aspekt të kontrollit të zhvillimeve, të mos lejohet ndërtimi i lagjeve të ndara suburbane me një funksion të vetëm atë të banimit individual.

Cilësia e jetës në komunë gjithashtu ndikohet edhe nga vlerat rekreative të trashëgimisë së saj natyrore, zhvillimin e objekteve dhe pajisjeve për një infrastrukturë adekuate sociale dhe teknike, e cila i merr parasysh nevojat e banorëve dhe ngritjen e kushteve për banim të shëndetshëm dhe atraktiv në zonat urbane dhe zonat rurale. Promovohet ndërtim i objekteve sipas standardeve në hapësirat jo të ndërtuara dhe masat mbrojtëse për reduktimin e pasojave nga tërmetet, vërshimet, erozionet etj. dhe vënia në zbatim e rregullave të ndërtimit për banim në dobi të rritjes së dendësisë për sipërfaqe në zonat e banimit.

Çdo ndërtim i ri duhet të respektojë masat për Eficiência të Energjisë sipas rregullores për kërkesat minimale të performancës energjetike të ndërtesave (MMPH Nr. 04/18). Për më shumë, inkurajohet adaptimi i teknologjive të tjera të mençura/smart në banesa, për të ulur koston e shpenzimeve dhe ndotjen e ambientit.

Teknologjia smart mund të përdoret qysh prej fazave të ndërtimit, për uljen e koston së ndërtimit dhe rritjen e kualitetit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve. Kjo mund të lidhet me tipologjitë e ndërtimit të një banese, nga ato të parafabrikuara, por edhe me llojet e materialeve të përdorura gjatë ndërtimit, për të parandaluar shpenzimet e energjisë gjatë banimit dhe për të kaluar në shpenzime eficiente të energjisë. Të dhënat e sistemeve smart mund të përdoren në planifikimet e ardhshme duke mundësuar që komuna të përmirësojë kualitetin e banimit, dhe në të njëjtën kohë të akomodojë kërkesat për njësi të reja të banimit.

Banimi social dhe banimi i përballueshëm

Komuna e Prishtinës planifikon të ofrojë banim për të gjitha kategoritë shoqërore, qoftë në formën e banimit social apo banimit të përballueshëm. Në fushën e mirëqenies sociale, veçmas në zgjidhjen e çështjes së banimit për rastet sociale, është planifikuar sigurimi i hapësirës së nevojshme dhe ndërtimi i objekteve për strehim të këtyre familjeve.

Deri tani, Komuna ka ofruar banim social për 100 familje në vitin 2016, dhe 50 familje të tjera në vitin 2017. Gjatë kërkesës së fundit për banimin, në 2017, për nevojë strehimi aplikuan 331 familje, nga të cilat përfituan 50 prej tyre. Sipas kërkesave zyrtare në Komunën e Prishtinës, numri i familjeve të cilat ende kërkojnë strehim, meremetim dhe ndërtim të shtëpisë deri më tani është 281.

Përveç kategorisë së banimit social, Komuna e Prishtinës në bashkëpunim me Ndërmarrjen Banesore, ka planifikuar një Lagje Model për banim të përballueshëm. Kjo lagje targeton punëtorët e sektorit publik duke u ofruar 600 banesa në Bërnice. Gjithashtu, MMPHI ka planifikuar një projekt për ofrimin e banimit të përballueshëm në komunë përmes 3 metodave: metoda e parë është sigurimi i njësive të banimit të përballueshëm përmes subvencionimit të materialeve izoluese të disa ndërtesave ekzistuese; metoda e dytë është përmes investimit të partneritetit publiko-privat për ndërtimin e një blloku të banimit shumëkatësh, dhe kompensimi me rreth 15% të njësive të banimit të ndërtuara; metoda e tretë është përmes investimit kapital në ndërtimin e një blloku, ku të gjitha njësitë e banimit do të ofrohen me çmim të përballueshëm.

Sipas Planit tre vjeçar të banimit, komuna në skemat e banimit social përfshin kategoritë:

- Familjet që nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale;
- Familjet që posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e banimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike;

- Kategoritë e dala nga lufta dhe ish të përndjekurit politik;
- Të kthyerit dhe komunitetet RAE (Minoritetet);
- Të riatdhesuarit;
- Të moshuarit;
- Të rinjtë;
- Të punësuarit nga buxheti shtetëror

Për këto kategori, Komuna planifikon të zhvillojë programe për sigurimin e kushteve të volitshme për jetesë. Për saktësimin e skemave dhe planifikimet konkrete, ky koncept do të adaptoj dhe inkuadroj në vete projektet dhe zgjidhjet që dalin nga Planet 3 vjeçare të banimit nga Komuna.

3.3.2.7 Shfrytëzimi i planifikuar i tokës

Pas analizave të shumta në aspektin e nevojave për ndërtim, trendët e zhvillimit të strukturave që i përshtaten funksionalisht zonës urbane të komunës dhe me qëllim të kontrollimit të shpërndarjes urbane nëpër tokat bujqësore të klasit I-IV në anën perëndimore të komunës, është caktuar kufiri i ri i zonës urbane të kryeqytetit. Ky kufi shtrihet përgjatë autoudhës në anën veriperëndimore të komunës dhe përfshinë kufirin e zonës kadastrale të Bërnicsë së Epërme. Në anën lindore, kufiri ndjek trasenë e rrugëve ekzistuese, për të evituar ndarjen e parcelave kadastrale private nga ky kufi. Ndërsa në pjesën jugore të komunës, kufiri i zonës urbane është përputhur me kufirin e poshtëm të komunës, duke përfshirë brenda zonës urbane edhe vendbanimin e Hajvalisë dhe Çagllavicës, të cilat sipas analizës së dendësisë banimore bëjnë pjesë në vendbanimet me dendësi shumë të lartë të banorëve.


Gjatë përcaktimit të shfrytëzimit të planifikuar të tokës, është marrë në konsideratë dinamika e zhvillimit të kryeqytetit në mënyrë fleksibile varësisht nga nevojat e paraqitura. Në të njëjtën kohë, koncepti i zhvillimit hapësinor të komunës planifikon zhvillim kompakt dhe të kontrolluar të ndërtimeve, prandaj në hartën e shfrytëzimit të planifikuar të tokës janë paraqitur sipërfaqet e përcaktuara si sipërfaqe të ndërtuara, që përfshijnë shfrytëzimet e banimit, industrisë, komerciales, shërbimeve publike dhe sociale dhe teknologjike, si dhe hapësirat e rezervuara për zgjerim në zonën urbane dhe atë rurale. Destinimet bazuar në kodin HILUCS të UA.08/2017 të NTPH brenda këtyre sipërfaqeve do të përcaktohen me hartimin e Hartës Zonale të Komunës.

Me këtë PZHK planifikohet shfrytëzim racional i tokës me qëllim që të ofrojë një organizim të qëndrueshëm të vendbanimeve dhe përmirësim të kushteve të jetesës për të gjitha vendbanimet urbane dhe rurale. Parimi i përgjithshëm përveç hierarkisë së vendbanimeve merret me menaxhimin në rritje të shfrytëzimit të tokës duke u kujdesur për faktorët e mjedisit. Mbrojtja e mjedisit veçanërisht e pasurive natyrore siguron zhvillim të qëndrueshëm dhe efikas.

Zona urbane është zonë e cila në mënyrë të vazhdueshme është në presion të zhvillimit dhe si e tillë do të akomodojë zhvillim kompakt dhe të balancuar. Shfrytëzimet e tokës të cilat planifikohet të lejohen brenda kësaj zone janë: shërbim publik; shërbim tregtar; shërbim profesional financiar dhe i informacionit; banim, shërbim i komunitetit; shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ; industri e lëndës së parë, industri e prodhimeve të rënda dhe të lehta. Parimisht, zona urbane do të përmbajë të gjitha shfrytëzimet e tokës të nevojshme për të udhëheqë zhvillimin bazuar në vizionin e planit.

Planifikohet një zhvillim i kompaktësuar i vendbanimeve të cilat në analizë kanë rezultuar si të shpërndara dhe me humbje më të madhe të tokës bujqësore. Në zonën urbane pjesa qendrore parashihet si zhvillim i zonës kryesisht bazuar në zhvillime administrative duke fuqizuar boshtin urban e cila ndërlidhë zonën qendrore deri tek Pallati i Drejtësisë. Në perëndim planifikohet zhvillimi i zonave ekonomike dhe industriale, zona këto të planifikuara edhe me planet paraprake hapësinore. Në perëndim planifikohet edhe një brez i gjelbër mbrojtës, brez ky i cili kryesisht do të jetë i formuar nga

drunjtë të lartë të cilët do të ndikojnë në uljen e CO2 në ajër, i cili vjen nga termocentrali në komunën e Obiliqit.



Harta 51 Koncepti i shfrytëzimit të tokës / i planifikuar

Tabela 119 Shfrytëzimi i planifikuar i tokës

	Shfrytëzimi i planifikuar i tokës	Sipërfaqja (ha)
1	Sipërfaqe e ndërtuar	5320.71 ha
2	Hapësirë e rezervuar për zgjerim – Zona Urbane	7585.75 ha
3	Hapësirë e rezervuar për zgjerim – Zona Rurale	601.19 ha
4	Sipërfaqe ujore	214.85 ha
5	Bujqësi	9694.21ha
6	Pylltari	31929.38 ha
7	Zonë e Mbrojtur – Peizazh i mbrojtur i natyrës	1948.97 ha
8	Zonë e Veçantë e Mbrojtur	53.46 ha

Në këtë koncept është planifikuar që zonat rurale kryesisht të jenë të koncentruara në zhvillimin e turizmit rural, kulturor, malor dhe agroturizmit, menaxhim dhe konservim të peizazhit gjithashtu edhe në mbrojtje të vlerave natyrore. Duke pasur parasysh konfiguracionin e terrenit kushtet klimatike si dhe analiza të tjera si studime të fizibilitetit, rezulton që në vendbanimet si Dragoc, Kukaj dhe Marec ka kapacitete për zhvillim të energjisë së ripërtëritshme duke shfrytëzuar energjinë e erës ndërsa në vendbanimet Keqekollë, Marec dhe Mramor ka kapacitete për zhvillimin e energjisë duke shfrytëzuar energjinë solare, ku në këto vendbanime është planifikuar edhe zhvillimi i kësaj industrie të prodhimit të energjisë elektrike.

4 PRIORITETET STRATEGJIKE DHE PLANI I VEPRIMIT

4.1 Prioritetet Strategjike

Tabela 120 Prioritetet strategjike

<i>Prioriteti Strategjik</i>	<i>Afati kohor</i>	<i>Kapacitetet financiare</i>
1 <i>Prishtina si identitet global</i>	<i>Afatgjatë</i>	
2 <i>Zhvillimi ekonomik dhe fuqizimi i konkurrueshmërisë</i>	<i>Afatgjatë</i>	<i>Lartë</i>
3 <i>Përmirësimi i infrastrukturës teknike të kryeqytetit</i>	<i>Afatmesëm</i>	<i>Lartë</i>
4 <i>Zhvillimi i turizmit, artit dhe kulturës</i>	<i>Afatgjatë</i>	<i>Mesëm</i>
5 <i>Rritja e sigurisë së lëvizjes</i>		
6 <i>Mbrojtja e tokës bujqësore në zonat me potencial të zhvillimit të bujqësisë dhe agroturizmit.</i>	<i>Afatgjatë</i>	<i>Lartë</i>
7 <i>Densifikimi i ndërtimeve brenda kufijve ekzistues të vendbanimeve</i>	<i>Afatgjatë</i>	<i>Lartë</i>

Prishtina si oaza kryesore e kulturës sportit e artit, ka një karakter të veçantë. Njihet për njerëzit e ngrohtë e bujarë, të cilët janë nikoqir të një komuniteti shumë të diversifikuar social. Fokusi i rinisë së Prishtinës në zhvillimin e teknologjisë do të mundësojnë fuqizimin e konkurrueshmërisë në ekonominë e vendit e më gjerë. Në të njëjtën kohë, pasuritë natyrore si peizazhi i mbrojtur i parkut Gërmia e hapësirat rekreative e natyrore në fshatrat e Gollakut do të ofrojnë mundësi për zhvillimin e turizmit malor e kulturor. Zhvillimi i të gjitha këtyre elementeve karakteristike për kryeqytetin e Kosovës do të lehtësohet me përmirësimin e infrastrukturës adekuate, duke u ofruar banorëve një cilësi të mirë dhe të qëndrueshme të jetesës.

Në përgjithësi, potencialet e kryeqytetit në aspektin ekonomik, social e natyror janë shtyllat kryesore mbi të cilat do të krijohet identiteti global për të cilin do të njihet Prishtina anë e mbanë botës.

4.2 Plani i veprimet

Qëllimet dhe objektivat e përcaktuara në kuadër të kornizës së zhvillimit hapësinor janë prioritetizuar sipas rëndësisë me qëllim të zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal si dhe alokimit të kapaciteteve financiare dhe njerëzore.

LEGJENDA	Lloji i Implikimit	Vlera në EUR.	Veprimet Sipas Prioritetit	Ngjyra e Fushës	Kohëzgjatja	Vitet
	MINIMALE	1 - 20.000	Veprimet me Pr. të Lartë		AFATSHKURTËR	2023-2024
	ULËT	20.001 - 50.000	Veprimet me Pr. të Mesëm		AFATMESE	Deri në vitin 2027
	MESËM	50.001 - 200.00	Veprimet me Pr. të Ulët		AFATGJATË	Deri në vitin 2031
	LARTË	200.000+			VAZHDIMËSI	

VEPRIMET/PROJEKTET/PROGRAMET	INSTITUTICONI PERGJEGJES	SUBJEKTE TJERA TË PËRFSHJIRA	PRIORITETI	KOHËZGJATJA	IMPLIKIMET FINANCIARE	BUXHETI
Qëllimi 1: Zhvillim i qëndrueshëm dhe i mençur i tregtisë dhe industrisë						
Objektivi 1.1.: Zhvillimi i zonave me potencial të ekosistemeve inovative deri në vitin 2031						
Objektivi 1.2. Ri-zhvillimi i zonave të caktuara me potencial ekonomik						
Ndërtimi i tregut të ri të qytetit	DIKMK		I lartë	Afatmesëm	Lartë	
Fonde për projekte të ndryshme, të bashkë financuara me Ministrinë e Industrisë, Ndërtimtarisë dhe Tregtisë	DIKMK		I lartë	Afatmesëm	Lartë	€3,750,000
Rregullimi i tregut të Ulpianës	DIKMK		I lartë	Afatmesëm	Lartë	€450,000
Përcaktimi i zonave të veçanta industriale brenda qytetit	DIKMK	DSHP	I lartë	Afatgjatë	Lartë	
Zbatimi i Green City framework	DIKMK		I lartë	Afatgjatë	Lartë	€5,524,160
Objektivi 1.3.: Planifikimi i qëndrueshëm i korridoreve tregtare dhe hapësirave për tregti të mallrave dhe ushqimeve deri në vitin 2031						
Objektivi 1.4.: Zhvillimi i zonave të përshtatshme për energji alternative						
Definimi i zonave për prodhimin e energjisë alternative	DIKMK		I lartë	Afatgjatë	Lartë	

Inkurajimi I efijencës energjetike në sektorin e banimit dhe objektet publike	DIKMK	FKEE	I lartë	Afatgjatë	Lartë	
Objektivi 1.5.: Krijimi i kushteve për zhvillimin e sektorit të ndërtimtarisë						
Alokimi i hapësirave për zhvillimin e sektorit të prodhimit dhe përpunimit të materialeve ndërtimore dhe mobilerive	DPS	DIKMK, DSHP, DU	I lartë	Afatgjatë	Mesëm	
Qëllimi 2: Zhvillimi i bujqësisë dhe bujqësisë së mençur me infrastrukturë adekuate						
Objektivi 2.1: Rritja e sipërfaqeve me kultura bujqësore.						
Krijimi i sipërfaqeve të reja të tokës bujqësore, dhe rehabilitimi i sipërfaqeve ekzistuese të pashfrytëzuara.	DB		I mesëm	Afatmesëm	Mesëm	€50,000
Ndërtimi i kanaleve anësore për shmangie artificiale të vërshimeve.	DSHP	MMPHI	I mesëm	Afatgjatë	Lartë	€200,000
Rritja e sipërfaqes së tokës bujqësore duke adoptuar zonat kodrinore ose ato më pak të përshtatshme nën ujë	DB		I mesëm	Afatmesëm	Lartë	€200,000
Objektivi 2.2: Ngritja e kapaciteteve përpunuese për prodhime bujqësore blegtorale dhe BMA						
Përkrahja e fermerëve për kultivimin e kulturave bujqësore në formë të pagesave direkte	DB		I lartë	Afatgjatë	Lartë	€4,000,000
Ndërtimi i therrores	DB		I lartë	Afatmesëm	Lartë	€5,000,000
Ndërtimi i kapaciteteve për ruajtje dhe përpunim të pemëve dhe perimeve.	DB		I mesëm	Afatgjatë	Lartë	€2,100,000
Objektivi 2.3.: Krijimi i zinxhirit bujqësor – Grumbullim, përpunim, konservim dhe tregtim						
Alokimi i hapësirave dhe infrastrukturës së nevojshme për krijimin e zinxhirit bujqësor	DB	DPS, DSHP	I mesëm	Afatgjatë	Lartë	
Objektivi 2.4.: Diversifikimi dhe zhvillimi i bizneseve të vogla bujqësore						
Mbështetja e fermerëve të vegjël dhe të rinj	DB		I ulët	Afatmesëm	Mesëm	€100,000
Përkrahja e fermerëve në themelimin e ndërmarrjeve të vogla bujqësore	DB		I ulët	Afatshkurtër	Ulët	€40,000
Përkrahja në krijimin apo zgjerimin e kapaciteteve për produkte organike	DB		I ulët	Afatgjatë	Mesëm	€150,000
Qëllimi 3: Përmirësimi i infrastrukturës në zonat rurale						
Objektivi 3.1: Lehtësimi i qasjes në parcelat punuese.						
Objektivi 3.2: Rritja e ujitjes së sipërfaqeve bujqësore.						
Zgjerimi i rrjetit ekzistues të ujitjes si dhe ndërtimi i kapaciteteve të reja.	DB		I mesëm	Afatgjatë	Minimale	€1,400,000
Ndërtimi i infrastrukturës rurale për qasje në parcela bujqësore	DB		I mesëm	Afatgjatë	Minimale	€350,000

Qëllimi 4: Zonimi i sipërfaqeve bujqësore						
Objektivi 4.1: Përcaktimi i zonave me prioritet për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë						
Objektivi 4.2: Përcaktimi i zonave për prodhimtarinë organike.						
Përcaktimi i zonave bujqësore sipas kualitetit të tokës dhe kapacitetit prodhues	DB			Afatmesëm	Mesëm	€150,000
Vlerësimi i tokave bujqësore duke u bazuar në standartet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me prodhimtarinë organike	DB			Afatmesëm	Mesëm	€150,000
Qëllimi 5: Rritja e kapaciteteve për turizëm dhe zhvillim rural						
Objektivi 5.1: Rritja e numrit të programeve për promovimin e turizmit rural						
Objektivi 5.2: Rritja e numrit të shtëpive pritëse (bujtinave) dhe kapaciteteve të ngjashme akomoduese (restorante me ushqim tradicional)						
Organizimi i konferencave, programeve, panairove me qëllim promovimin e turizmit rural	DB			Afatmesëm	Mesëm	€100,000
Përkrahja e familjeve për rritje të kapaciteteve turistike në zonat rurale (bujtinat, akomodimi, restorantet me ushqim)	DB		I lartë	Afatmesëm	Lartë	€300,000
Ndërtimi i kapaciteteve të reja dhe renovimi i atyre ekzistuese.	DB			Afatgjatë	Lartë	€1,000,000
Qëllimi 6 : Furnizim i mjaftueshëm me ujë cilësor						
Objektivi 6.1: Ofrimi i shërbimeve të qëndrueshme të furnizimit me ujë në të gjithë komunën deri në vitin 2031						
Intervenime dhe mirëmbajtje të pompave shtytëse të ujit, puseta dhe ujëmbledhës	KRU	DIKMK	I mesëm	Afatmesëm	Lartë	€388,351
Ngritja e kapacitetit pompues në SP Parku dhe SP në zonën e shërbimit	KRU	DIKMK	I lartë	Afatshkurtër	Mesëm	€160,000
Mirëmbajtja dhe mbrojtja e burimeve ujore	KRU	DIKMK	I lartë	Afatgjatë	Mesëm	€80,000
Ndërtimi dhe riparimi i pusetave të ujësjellësit dhe kanalizimit	KRU	DIKMK	I mesëm	Afatgjatë	Mesëm	€80,000
Ndërtimi ujësjellësit Mramor, Grashticë, Besi, Slivovë, Faza-II	KRU	DIKMK	I ulët	Afatgjatë	Lartë	€750,000
Ndërtimi i rezervarëve të ujit në Veternik, Mat, Hajvali, Bardhosh, Grashticë	KRU	DIKMK	I lartë	Afatmesëm	Lartë	€500,000
Ndërtimi i stacioneve të pompimit	KRU	DIKMK	I lartë	Afatmesëm	Lartë	€500,000
Objektivi 6.2: Zvogëlimi dhe monitorimi i humbjeve të ujit të pijshëm në rrjetin ekzistues						
Ndërrimi dhe ndërtimi i rrjetit të ujit për përmirësimin e furnizimit dhe zvogëlimin e humbjeve në zonën e shërbimit të KRU "Prishtina"	KRU	DIKMK	I lartë	Afatgjatë	Lartë	€730,000
Furnizimi me ujëmatës të profileve të ndryshme për ndërrim të vazhdueshëm të ujëmatësve dhe pllomba për pllombimin e ujëmatësve në vazhdimësi	KRU	DIKMK	I mesëm	Afatmesëm	Mesëm	€110,000

Furnizimi dhe montimi me ujëmatës të profileve Fi 1/2 deri 2" për ndërrimin e ujëmatësve ekzistues në pajtim me rregullat e parapërcaktuara, në zonën e shërbimit	KRU	DIKMK	I mesëm	Afatshkurtë r r	Mesëm	€185,000
Furnizimi dhe instalimi i ujëmatësve zonal, ujëmatës kontrollues dhe ujëmatës prodhimi në zonën e shërbimit të KRU "Prishtina" sh.a. (përfshirë pusetat) dhe llogaret e presionit	KRU	DIKMK	I lartë	Afatmesëm	Mesëm	€195,000
Rehabilitimi i rrjetit primar të ujësjellësit në lagjen e Medresesë	KRU	DIKMK	I lartë	Afatmesëm	Lartë	€350,000
Ndërrimi i gypit të ujit nga stacioni i pompimit Mirëdita II- Kashagia	KRU	DIKMK	I lartë	Afatmesëm	Mesëm	€110,000
Ndërrimi i gypit të ujit nga stacioni i pompimit Arbëria- Rezervuari Kodër	KRU	DIKMK	I lartë	Afatmesëm	Lartë	€250,000
Ndarja e sistemit të pompave të stacioneve pompuese Mirëdita II dhe Mirëdita III	KRU	DIKMK	I lartë	Afatmesëm	Mesëm	€90,000
Rehabilitimi i rrjetit primar të ujësjellësit në lagjen e Bregu i Diellit apo aty ku është me urgjencë (e nevojshme)	KRU	DIKMK	I lartë	Afatmesëm	Lartë	€430,000
Qëllimi 7: Menaxhim i qëndrueshëm i infrastrukturës së ujërave të zeza						
Objektivi 7.1.: Parandalimi i ndotjes së ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor nga ujërat e zeza deri në vitin 2031						
Ndërtimi i impiantit për ujëra të zeza (Faza I)	KRU	DIKMK	I lartë	Afatgjatë	Lartë	€32,420,000
Zgjerimi i impiantit për ujërat e zeza (Faza II)	KRU	DIKMK	I lartë	Afatgjatë	Lartë	€12,723,000
Kolektori kryesor i kanalizimit nga Prishtina deri tek FTUZ	KRU	DIKMK	I lartë	Afatmesëm	Lartë	€3,667,148
Interceptori i kanalizimeve në qytetin e Prishtinës	KRU	DIKMK	I lartë	Afatmesëm	Lartë	€2,956,518
Sistemi i ri i zgjeruar me MË-PR/Shkabaj	KRU	DIKMK	I lartë	Afatmesëm	Lartë	€4,850,582
Plani i fizibilitetit për trajtim të ujërave të zeza në zonën rurale	KRU	DIKMK	I lartë	Afatshkurtë r	Mesëm	€50,000
Ndërtimi i kolektorëve për grumbullim të ujërave të zeza në zona rurale	KRU	DIKMK	I lartë	Afatgjatë	Lartë	€715,000
Ndërtimi i gropave septike për trajtimin e ujërave të zeza në zonat rurale	KRU	DIKMK	I lartë	Afatgjatë	Lartë	€892,000
Ndërtimi i dy mini-impianeteve për trajtimin e ujërave të zeza në zonat rurale	KRU	DIKMK	I lartë	Afatgjatë	Lartë	€2,000,000
Objektivi 7.2: Zgjerimi dhe ri-vitalizimi i rrjetit të kanalizimit atmosferik dhe fekal						
Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në zonën urbane	KRU	DIKMK, DSHP	I lartë	Afatmesëm	Lartë	€330,000
Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit të Prishtinës	KRU	QK, DIKMK, DSHP	I lartë	Afatgjatë	Lartë	€28,420,668
Rritja e mbulueshmërisë me rrjet të kanalizimit në zonën rurale për 5%	KRU	DIKMK,	I lartë	Afatgjatë	Lartë	€700,000

çdo vit sipas prioriteteve		DSHP				
Ndërtimi i kolektorit kryesor prej Prishtinës deri në FTUZ	KRU	DIKMK, DSHP	I lartë	Afatmesëm	Lartë	€3,667,148
Ndërtimi i kanalizimeve atmosferike në zonat potencialisht të vërshuara	KRU	DIKMK	I mesëm	Afatgjatë	Lartë	€1,000,000
Mirëmbajtja e kanaleve ekzistuese të ujërave atmosferike	KRU	DIKMK	I mesëm	Afatgjatë	Lartë	€300,000
Ndërtimi i dy rezervarëve për grumbullim të ujërave atmosferik	KRU	DIKMK	I lartë	Afatgjatë	Ulët	€40,000
Ndërtimi i rezervarit për grumbullim të ujërave atmosferik për përdorim industrial	KRU	DIKMK	I lartë	Afatmesëm	Ulët	€20,000
Hapja e puseve për ujitje të parqeve dhe sistemet pikë-pikë	KRU	DIKMK	I lartë	Afatshkurtër	Mesëm	€100,000
Funksionalizimi i burimeve të ujit në Gërmi dhe Fushën e Pajtimt për nevoja të ujit teknik	KRU	DIKMK	I mesëm	Afatmesëm	Mesëm	€100,000
Studimi i fizibilitetit për ujërat atmosferike dhe trajtimi i tyre	KRU	DIKMK	I lartë	Afatshkurtër	Ulët	€40,000
Qëllimi 8: Menaxhim i qëndrueshëm i rrjetit të përmirësuar të ujitjes						
Objektivi 8.1.: Zgjerimi, funksionalizimi dhe mirëmbajtja e sistemit ekzistues të ujitjes Ibër-Lepenc						
Rifunksionalizimi i rrjetit ekzistues të ujitjes në komunë	Ibër Lepenci	DSHP, DB		Afatmesëm		
Qëllimi 9: Prodhim i energjisë së ripërtërishme elektrike						
Objektivi 9.1.: Rritja e kapaciteteve të furnizimit me energji të ripërtërishme deri në vitin 2031						
Studim i fizibilitetit për energji të ripërtërishme	DU	DSHP		Afatshkurtër	Ulët	€50,000
Qëllimi 10: Shërbime cilësore të energjisë termike						
Objektivi 10.1.: Shfrytëzim maksimal i kapaciteteve ekzistuese të sistemit të ngrohjes qendrore						
Instalimi i matësve (njehsorëve) në njësitë e banimit të kyçur në sistemin qendror të ngrohjes	Termokos	DSHP, MCC	I lartë	Afatmesëm	Lartë	€10,900,000
Studim i fizibilitetit për rritje të kapaciteteve prodhuese	Termokos	DSHP	I lartë	Afatshkurtër	Mesëm	€20,000
Objektivi 10.2.: Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe cilësor me energji termike për qytetin e Prishtinës						
Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të ngrohjes në zonë urbane	Komisioni Evropian	Termokos, DSHP	I lartë	Afatshkurtër	Lartë	€8,300,000
Rehabilitimi i termostacioneve	Komisioni Evropian	Termokos, DSHP	I lartë	Afatshkurtër	Lartë	€7,800,000

Ndërtimi i nënstacioneve të reja	Komisioni Evropian	Termokos , DSHP	I lartë	Afatshkurtër	Lartë	€1,200,000
Zëvendësimi dhe zgjerimi i rrjetit	Komisioni Evropian	Termokos , DSHP	I lartë	Afatgjatë	Lartë	€5,000,000
Shtrirja e rrjetit të ri të kogjenerimit	Komisioni Evropian	Termokos , DSHP	I lartë	Afatgjatë	Lartë	€1,500,000
Zgjerimi i rrjetit të pompave qarkulluese	Termokos	DSHP	I lartë	Afatgjatë	Lartë	€500,000
Ndërtimi i objektit të ri për administratë	Termokos	DSHP	I lartë	Afatshkurtër	Lartë	€530,000
Objektivi 10.3: Prodhim i energjisë termike për ngrohje me energji të ripërtërishme solare						
Ndërtimi i impiantit për prodhim të energjisë duke u bazuar në studime të fizibilitetit	Termokos	PPP, KK	I mesëm	Afatgjatë	Lartë	€45,000,000
Shtrirja e rrjetit të ngrohjes nga impianti deri tek nënstacionet e objekteve në lagjet e reja ku nuk ka rrjet të ngrohjes.	Termokos	PPP, KK	I mesëm	Afatgjatë	Lartë	€7,000,000
Qëllimi 11: Infrastrukturë e telekomunikimit me shërbim efektiv						
Objektivi 11.1: Avancim i pajisjeve dhe shërbimeve telekomunikuese						
Planifikimi, Dizajnimi , Modernizimi i sistemit kabllor dhe infrastrukturës së rrjetit të shërbimeve telekomunikuese	Posta, Kompanitë	DSHP, MMPHI	I mesëm	Afatgjatë	Mesëm	€150,000
Planifikimi, Dizajnimi dhe zhvendosja e infrastrukturës telekomunikuese nga infrastruktura ajrore në infrastrukturë nëntokësore	Posta, Kompanitë	DSHP, MMPHI	I mesëm	Afatgjatë	Lartë	€6,900,000
Objektivi 11.2: Shtrirje e rrjetit të telekomunikimit në të gjithë vendbanimet e komunës deri në vitin 2026						
Zgjerimi me rrjet optik kabllor	DSHP	Kompanitë	I mesëm	Afatgjatë	Lartë	€250,000
Planifikimi dhe zgjerimi i mbulueshmërisë së zonave rurale me shërbime mobile, duke shtuar numrin e BTS-ve	DSHP	Kompanitë	I mesëm	Afatgjatë	Lartë	€460,000
Qëllimi 12: Menaxhim i qëndrueshëm i mbeturinave						
Objektivi 12.1.: Ofrimi i qasjes së lehtë për grumbullimin e mbeturinave						
Funksionalizimi i kontejnerëve nëntokësor dhe zgjerimi me pikat e reja SMART	Pastrimi	DSHP	I mesëm	Afatmesëm	Lartë	€600,000
Vendosja e kontejnerëve në të gjitha vendbanimet sipas kapaciteteve	Pastrimi	DSHP	I lartë	Afatmesëm	Lartë	€600,000
Harmonizimi I orarit të mbledhës së mbeturinave me nevojën për shkarkimin e mbeturinave sipas nevojës në vendbanime të caktuara	Pastrimi	DSHP	I mesëm	Afatmesëm	Minimale	

Objektivi 12.2: Trajtimi i mbeturinave të rrezikshme (shëndetësore, industriale, shtazore)						
Funksionalizimi i deponisë dhe trajtimi i mbeturinave inerte	Pastrimi	DSHP		Afatmesëm	Lartë	
Ndërtimi I Qendrës së grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave ndërtimore	Pastrimi	DSHP		Afatgjatë	Lartë	€300,000
Ndërtimi i deponisë për trajtim të mbeturinave të rrezikshme	Pastrimi	DSHP		Afatgjatë	Lartë	€991,146
Objektivi 12.3: Përdorimi i teknologjive të avancuara për riciklim të mbeturinave dhe shfrytëzimi i tyre për energji						
Objektivi 12.4: Inkurajimi i ekonomisë qarkore						
Qëllimi 13: Rrjet i organizuar dhe eficient i transportit						
Objektiva 13.1: Përmirësimi i kapacitetit dhe nivelit të shërbimit për rrugët ekzistuese deri në vitin 2031						
Zgjerimi i rrugës Nacionale N9, segmenti Prishtinë - Mutivodë, Faza I	Qeveria e Kosovës	MMPHI		Afatmesëm	Lartë	€990,000
Hapja e rrugëve të reja në komunën e Prishtinës	DIKMK			Afatgjatë	Lartë	€750,000
Sanimi i gropave dhe deformimeve të shtresave të asfaltit në rrugë dhe trotualet e Komunës së Prishtinës	DIKMK			Afatshkurtër	Lartë	€1,200,000
Objektivi 13.2.: Lirimi i trafikut të brendshëm të qytetit deri në vitin 2025						
Ndërtimi i rrugës A	DIKMK			Afatshkurtër	Lartë	€3,000,000
Vazhdimi i rrugës B	DIKMK			Afatshkurtër	Lartë	€900,000
Implementimi i Planit të Mobilitetit, pjesa Urbane	DIKMK		I lartë	Afatshkurtër	Lartë	€4,262,612
Ri - projektimi dhe riorganizimi i qarkullimit në unazën qendrore	DIKMK		I lartë	Afatshkurtër	Lartë	
Krijimi i sistemit të parkingjeve zonale	DSHP			Afatmesëm	Lartë	
Objektivi 13.3: Forcimi i komunikimit të banorëve të fshatrave me qytetin						
Ndërtimi i rrugëve në pjesën rurale me infrastrukturë përcjellëse	DIKMK	QK	I mesëm	Afatgjatë	Lartë	€8,217,710
Ndërtimi i rrugës Prishtinë - Podujevë	Qeveria e Kosovës	MMPHI	I lartë	Afatmesëm	Lartë	€14,336,875
Objektivi 13.4: Përmirësimi i sigurisë në trafik						
Furnizimi dhe montimi i kamerave të sigurisë në kryeqytet	DSHP	DIKMK	I lartë	Afatshkurtër	Lartë	€350,000

Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik në të qytetin SMART	DSHP		I lartë	Afatshkurtë r	Lartë	€900,000
Ndriçim sinjalizues për vendkalime për siguri	DSHP		I lartë	Afatshkurtë r	Lartë	€200,000
Ndërtimi I rrethojave për siguri në mobilitet	DSHP		I mesëm	Afatshkurtë r	Lartë	€400,000
Qëllimi 14: Mobilitet urban gjithëpërfshirës dhe SMART						
Objektivi 14.1: Fuqizimi i transportit publik urban						
Ndërtimi i stacionit multimodal në lokacionin e stacionit ekzistues të autobusave.	DSHP	PPP		Afatgjatë	Lartë	€50,000,000
Implementimi i masave të planifikuara me PMQU	DSHP			Afatgjatë	Lartë	
Krijimi i ITS (Intelligent Transport System) qendrës	DIKMK	DSHP	I mesëm	Afatgjatë	Lartë	€9,500,000
Furnizimi dhe montimi i kamerave të sigurisë në kryeqytet -	DIKMK	DSHP	I mesëm	Afatshkurtë r	Mesëm	€100,000
Zhvillimi sistemit parko dhe udhëto (Park & Ride)	DSHP			Afatmesëm	Lartë	€10,000,000
Objektivi 14.2: Inkurajimi i lëvizjes jo-motorike në komunë						
Ndërtimi - shenjëzimi i shtigjeve të biçikletës në rrugën kryesore të Qytetit	DIKMK	DSHP	I lartë	Afatmesëm	I lartë	€900,000
Stimulimi i përdorimit të transportit alternativ	DSHP			Afatmesëm	Lartë	
Qëllimi 15: Shërbime cilësore shëndetësore dhe të qasshme për të gjithë						
Objektivi 15.1.: Ofrimi i shërbimit i kujdesit shëndetësor dytësor për banorët e Komunës						
Ndërtimi i Spitalit të Prishtinës	DSH, MSH	MPB, Administrata publike	I lartë	Afatshkurtë r	Lartë	€30,000,000
Ndërtimi i Qendrës e Shëndetit Publik dhe Mikrobiologjik	DSH, MSH	IKSHPK	I mesëm	Afatmesëm	Lartë	€1,000,000
Ndërtimi i Poliklinikës Stomatologjike	DSH		I mesëm	Afatmesëm	Lartë	
Objektivi 15.2.: Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe Avancimi i sistemit informativ shëndetësor						
Përmirësimi i infrastrukturës së shëndetit parësor	DSH		I lartë	Afatgjatë	Lartë	€1,500,000
Përmirësimi i sistemit informativ shëndetësor	DSH, MSH	Solaborat e	I mesëm	Afatgjatë	Mesëm	
Qëllimi 16: Shërbime cilësore dhe gjithë përfshirje në arsim						
Objektivi 16.1: Ndërlidhja e arsimit me nevojat e tregut të punës						

Krijimi i Qendrës për Këshillim në Karrierë	DKA, MASHT		I mesëm	Afatmesëm	Lartë	
Krijimi i profileve të teknologjisë informative dhe turizmit në nivel të shkollave profesionale	DKA, MASHT		I mesëm	Afatmesëm	Mesëm	
Objektivi 16.2: Infrastrukturë fizike e përmirësuar e institucioneve të arsimit						
Mirëmbajtja fizike e institucioneve parashkollore në komunë	DKA		I lartë	Afatmesëm	Lartë	
Mirëmbajtja fizike e institucioneve të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët në komunë	DKA		I lartë	Afatmesëm	Lartë	
Mirëmbajtja fizike e institucioneve të arsimit të mesëm të lartë në komunë	DKA		I lartë	Afatmesëm	Lartë	
Objektivi 16.3: Ngritja e kapaciteteve profesionale arsimore						
Organizimi i trajnimeve për mësimdhënësit	DKA	MASHT	I lartë	Afatshkurtër	Mesëm	
Menaxhimi i Asociacionit të drejtorëve të shkollave	DKA		I mesëm	Afatgjatë	Mesëm	
Organizimi i aktiviteteve për mbështetjen e zhvillimit profesional të nxënësve	DKA		I mesëm	Afatgjatë	Mesëm	
Objektivi 16.4: Inkurajimi i arsimit tërëditor në të gjitha vendbanimet						
Ndërtimi i 7 shkollave fillore në zonën urbane	DKA		I lartë	Afatmesëm	Lartë	
Qëllimi 17: Shërbime cilësore administrative dhe gjithëpërfshirje institucionale						
Objektivi 17.1: Fuqizimi i bashkësive lokale deri në vitin 2025						
Ndërtimi i 3 bashkësive lokale (Mati 1, Veternik dhe Qendër)	DA		I mesëm	Afatmesëm	Mesëm	
Ndërtimi i objektit të Arkivës së komunës	DA		I mesëm	Afatmesëm	Lartë	
Ndërtimi i objektit të zjarrëfikësive	DA		I mesëm	Afatmesëm	Lartë	
Qëllimi 18: Përkrahje sociale për të gjithë banorët në nevojë						
Objektivi 18.1: Menaxhim adekuat i Qendrës për Punë Sociale						
Ndërtimi i objektit të ri për Qendrës për Punë Sociale	DMS		I lartë	Afatshkurtër	Lartë	€500,000
Inventarizimi i Qendrës për Punë Sociale aktuale dhe qendrës së re	DMS		I mesëm	Afatshkurtër	Mesëm	€20,000
Ndërtimi i këshillimores paramartësore	DMS		I mesëm	Afatmesëm	Mesëm	€100,000
Objektivi 18.2: Ngritja e kapaciteteve strehimore të përkohshme deri në vitin 2031						
Ndërtimi i shtëpisë me bazë në komunitet për strehim të fëmijëve pa përkujdesje prindërore	DMS		I mesëm	Afatmesëm	Mesëm	€150,000

Ndërtimi i shtëpisë me bazë në komunitet për persona me çrregullime mendore dhe pa kujdes familjar	DMS		I mesëm	Afatmesëm	Mesëm	€150,000
Ngritja e qendrës për ofrimin e shërbimit të strehimit Afatshkurtër për persona në situatë rruge	DMS		I mesëm	Afatmesëm	Mesëm	€150,000
Ndërtimi i shtëpive dhe banesave për banim social të përkohshëm apo përhershëm	DMS		I lartë	Afatgjatë	Lartë	€500,000
Inventarizimi i shtëpive dhe banesave për banim social të përkohshëm apo përhershëm	DMS		I mesëm	Afatgjatë	Mesëm	€100,000
Ndërtimi dhe funksionalizmi i shtëpive aktuale dhe të reja nëpër lagje për të moshuar me qëndrim ditor	DMS		I lartë	Afatgjatë	Ulët	€30,000
Objektivi 18.3: Përkrahja e aftësimit të njerëzve me nevoja të veçanta						
Ndërtimi i qendrës rehabilituese për përdorues të substancave narkotike	DMS		I mesëm	Afatmesëm	Mesëm	€150,000
Inventarizimi i qendrës rehabilituese për përdorues të substancave narkotike	DMS		I mesëm	Afatmesëm	Minimal	
Qëllimi 19: Mjedis i qëndrueshëm institucional për zhvillimin e artit, kulturës dhe sportit						
Objektivi 19.1: Krijimi i hapësirave të përshtatshme për komunitetin artistik						
Ndërtimi i Sallës Koncertale	DK	QK	I lartë	Afatgjatë	Lartë	€5,000,000
Shndërrimi i Bibliotekës së Qytetit ‘Hivzi Sylejmani’ në Galeri	DK		I lartë	Afatgjatë	Lartë	€200,000
Muzeu Shtëpive-Shkolla, në ndërtesën e shtëpisë së Hërticëve në Kodrën e Trimave	DK		I lartë	Afatgjatë	Lartë	€600,000
Strehimorja e Artit	DK		I lartë	Afatgjatë	Ulët	€50,000
Tunelli i Kurrit	DK		I lartë	Afatgjatë	Mesëm	€100,000
Rruga “Model”	DK		I lartë	Afatgjatë	Lartë	€276,529
Qendra kulturore me fokus në Bibliotekën në Kodrën e Trimave	DK		I lartë	Afatgjatë	Lartë	€550,000
Muzeu Hulumtues Rilindja	DK		I lartë	Afatgjatë	Lartë	€200,000
Shndërrimi i tulltores në qendër multidisciplinare kulturore	DK		I lartë	Afatgjatë	Lartë	€1,000,000
Ndërtimi i Galerisë së Qytetit të Prishtinës	DK	QK	I mesëm	Afatgjatë	Lartë	€300,000
Muzeu i Artit Modern dhe Bashkëkohor	DK	QK	I mesëm	Afatgjatë	Lartë	€310,000
Muzeu i Qytetit të Prishtinës	DK		I mesëm	Afatgjatë	Lartë	€600,000
Muzeu i Pajtimt të Gjaqeve	DK		I lartë	Afatgjatë	Mesëm	€70,000
Shëndrimi i kino Rinisë në hapësirë multifunksionale kulturore	DK		I mesëm	Afatgjatë	Mesëm	€100,000
Qendrat Socio-Kulturore në lagjet e qytetit	DK		I lartë	Afatgjatë	Lartë	€500,000

Rifunksionalizimi i Qendrave Kulturore në fshatrat e Komunës së Prishtinës (Hajvali, Keqekoll, etj.).	DK	QK	I mesëm	Afatgjatë	Ulët	€30,000
Shndërrimi i Dispanserit të Mushkërive në hapësirë kulturore që dokumenton veprimtarinë e shoqatës “Nënë Tereza” gjatë sistemit paralel në vitet e 90-ta.	DK		I ultë	Afatmesëm	Mesëm	€150,000
Muzeu i Muzikës	DK		I ultë	Afatmesëm	Lartë	€400,000
Muzeu Përkujtimor, që trajton luftën e fundit në Kosovë, përfshirë viktimat e luftës, eksodin dhe rezistencës e popullit të Kosovës	DK	QK	I lartë	Afatgjatë	Lartë	€1,400,000
Muzeu i Sistemit Paralel	DK	QK	I lartë	Afatgjatë	Lartë	€200,000
Muzeu i Shkencave të Natyrës	DK	QK	I lartë	Afatgjatë	Lartë	€700,000
Muzeu Arkeologjik dhe Historik	DK	QK	I lartë	Afatgjatë	Lartë	€300,000
Muzeu i Shkencës	DK	QK	I lartë	Afatgjatë	Lartë	€500,000
Muzeu i Bashkëjetesës Fetare	DK	QK	I lartë	Afatgjatë	Lartë	€300,000
Muzeu i Gjuhës Shqipe	DK	QK	I lartë	Afatgjatë	Lartë	€200,000
Tempulli i Pages	DK	QK	I lartë	Afatgjatë	Lartë	€2,000,000
Objektivi 19.2: Promovimi i vlerave të artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore						
Rigjenerimi i pikave ikonike të kryeqytetit	DK, DU		I lartë	Afatmesëm	Lartë	€600,000
Krijimi i muzeut të Herticëve	DK		I lartë	Afatmesëm	Lartë	€1,500,000
Themelimi i orkestrës së qytetit	DK		I lartë	Afatmesëm	Lartë	€300,000
Objektivi 19.3: Promovim i sportit profesional përmes fuqizimit të infrastrukturës adekuate						
Ndërtimi i kampusit sportiv në Bërnice të Epërme	DS	DSHP, DIKMK	I lartë	Afatmesëm	Lartë	
Objektivi 19.4: Promovimi i sportit rekreativ						
Organizimi i aktiviteteve agroturistike	DK	DSHP, DU	I mesëm	Vazhdueshëm	Lartë	€1,200,000
Organizimi i aktiviteteve për krijimin e artit në hapësirat publike	DK	DSHP, DU	I mesëm	Afatmesëm	Lartë	€850,000
Qëllimi 20: Infrastrukturë e përshtatshme për varreza						
Objektivi 20.1.: Sigurimi i sipërfaqeve të mjaftueshme për varreza publike						
Analiza e gjendjes ekzistuese dhe vlerësimi i nevojave të reja në komunë	DSHP		I mesëm	Afatshkurtër	Ulët	€70,000
Qëllimi 21: Hapësira të hapura publike për të gjithë banorët						

Objektivi 21.1: Krijimi i hapësirave publike të gjelbërta						
Krijimi i parqeve në kuadër të lagjeve urbane	DP, DSHP		I lartë	Afatshkurtër	Lartë	€1,300,000
Krijimi i xhепave urban nëpër qytet	DP, DSHP		I mesëm	Afatshkurtër	Lartë	€292,000
Objektivi 21.2.: Krijimi i rrjetit të korridoreve të gjelbra						
Parku linear në lagjen e Spitalit	DP, DSHP		I mesëm	Afatshkurtër	Lartë	€280,000
Korridoret e gjelbra përgjatë rrugëve hyrëse deri në qendër	DP, DSHP		I lartë	Afatmesëm	Lartë	€200,000
Qëllimi 22: Mbrojta dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i resurseve mjedisore						
Objektivi 22.1.: Përmirësimi i cilësisë së ajrit						
Planifikimi i barrierave të gjelbërta me drunjtë me kapacitete mjedisore përgjatë perimetrit të rrugëve kryesore dhe zonës industriale për Fushë Kosovë dhe rrugën kryesore që e lidh me Prishtinën dhe Obiliqin	DPS	DSHP	I Lartë	Afatmesëm	Ulët	€40,000
Studim i detajuar për sigurimin e drunjve me kapacitete mjedisore për të siguruar një brez mbrojtës në kufi me Obiliqin që do të ndikonte në zvogëlimin e ndotjes së ajrit që vjen nga termocentralet.	DPS	DP	I mesëm	Afatgjatë	Mesëm	€50,000
Largimi i deponive të mbeturinave dhe rivitalizimi i këtyre zonave	DSHP		I Lartë	Afatmesëm	Ulët	€20,000
Stimulimi i shfrytëzimit të energjisë alternative në objekte rezidenciale dhe komerciale	DSHP	DPS, FKEE	I mesëm	Afatgjatë	Lartë	
Stimulim i përdorimit të mjeteve elektrike në qytet	DU, DSHP			Afatgjatë	Lartë	
Objektivi 22.2.: Mbrojtja e burimeve ujore deri në vitin 2031						
Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave industriale në zonën ekonomike	DPS		I Mesëm	Afatmesëm	Lartë	€200,000
Eliminimi i deponive në shtretërit e lumenjve.	DPS		I Lartë	Afatmesëm	Mesëm	€50,000
Parandalimi i shfrytëzimit ilegal të burimeve ujore	DPS	DSHP		Afatgjatë	Lartë	
Objektivi 22.3: Inventarizimi i florës dhe faunës në gjithë territorin e komunës						
Themelimi i kopshtit botanik	DP, DSHP	Banka Botërore, Super Wien	I Mesëm	Afatgjatë	Lartë	
Hartimi i planit lokal për Biodiversitet	DPS	DP	I Mesëm	Afatshkurtër	Ulët	€35,000

Qëllimi 23: Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore						
Objektivi 23.1.: Hartimi i politikave për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore						
Hartimi I Planeve operative emergjente	DI			Afatgjatë	Mesëm	
Hartimi I planit të vlerësimit të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësive tjera	DI			Afatgjatë	Lartë	
Hartimi I planit të mbrojtjes nga zjarri	DI			Afatgjatë	Mesëm	
Projekti për intervenime emergjente	DI			Afatmesëm	Lartë	
Identifikimi I lokacioneve me rrezikshmëri nga shembja e dheut, vërshimet, fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera	DI			Afatmesëm	Mesëm	
Objektivi 23.2.: Zgjerimi i kapaciteteve të reja të institucioneve në nivel qendror dhe lokal për sistemin e paralajmërimit të hershëm; në vazhdimësi deri në vitin 2029						
Pastrimi, përmirësimi dhe rregullimi i shtratit të lumit Llap	DSHP		I Lartë	Afatshkurtë r	Lartë	€200,000
Ndërtimi i një rezervari të ujit për nevoja të zjarrfikësve në Fshatrat ku janë të rrezikuara.	DSHP		I Mesëm	Afatmesëm	Mesëm	€100,000
Zgjerimi i Rrugëve malore në Zonat e afektuar nga zjarret	DSHP		I Mesëm	Afatmesëm	Mesëm	€100,000
Hartimi I hartës mikro-sizmike për zonën urbane	DSHP		I Mesëm	Afatgjatë	Mesëm	€55,000
Ndërtimi i murit mbrojtës në rrugën Basri Canolli magjistralja Prishtinë—Grashticë „ në rrugën Malush Kosova, në Marec rruga Viti Bullaj, në rrugën Siqevë-Radashec dhe në Ballaban	DSHP		I Lartë	Afatmesëm	Mesëm	€180,000
Rregullimi i bankinave dhe kasketave për mbrojtjeje Të lumit Prishtevka në Llukar për parandalimin nga vërshimet	DSHP		I Lartë	Afatshkurtë r	Mesëm	€100,000
Rregullimi i Kolektorin nga Matiqani e deri në Prishtinë për zvogëlimin e dëmeve nga Vërshimet	DSHP		I Lartë	Afatmesëm	Mesëm	€70,000
Studimi i detajuar për rrëshqitjen e dheut në Lagjen Arbëria dhe në lagjen Veternik	DSHP		I Mesëm	Afatshkurtë r	Mesëm	€70,000
Qëllimi 24: Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore për zhvillim të qëndrueshëm						
Objektivi 24.1.: Ruajtja dhe konservimi aktiv i aseteve të trashëgimisë kulturore						
Renovimi, restaurimi dhe rekonstruimi i aseteve të trashëgimisë kulturore	DK		I lartë	Afatmesëm	Lartë	€1,050,000
Krijimi i koleksionit publik të trashëgimisë së luajtshme, themelimi dhe funksionalizimi i Muzeut të Komunës së Prishtinës	DK		I mesëm	Afatmesëm	Lartë	€1,200,000
Hartimi i Strategjisë, Politikës dhe Programit të Integruar për konservim/rigjenerimin e aseteve dhe sipërfaqeve të trashëgimisë kulturore	DK	DPS	I mesëm	Afatmesëm	Mesëm	€100,000

Busti i Hasan Prishtinës	DK		I ulët	Afatgjatë	Ulët	€45,000
Operim turistik	DK		I mesëm	Afatgjatë	Lartë	€647,132
Hamami i Vjetër, Studimi i Konservimit, Restaurimi dhe Adaptimi si qendër rekreative SPA/Bashkëfinancim me TIKA	DK		I mesëm	Afatshkurtë r r	Lartë	€1,600,000
Tregu i ri Qytetit (çarshia e vjetër vazhdimi i projektit të tenderuar në vitin 2020)	DK		I mesëm	Afatmesëm	Lartë	€3,650,000
Tuneli Agim Ramadani (vazhdimi i projektit të tenderuar në vitin 2020)	DK		I mesëm	Afatmesëm	Lartë	€1,800,000
Hartimi i studimit të fizibilitetit dhe Planit të konservimit/menaxhimit të Qendrës Historike të Prishtinës	MKRS	DK, DPS, DU, UN-Habitat	I lartë	Afatshkurtë r	Mesëm	€120,000
Objektivi 24.2.: Ruajtja dhe konservimi i vlerave të trashëgimisë natyrore dhe peizazhit						
Hartimi i Planit të menaxhimit të Peizazhit të mbrojtur “ Gërmia”	DP, DK	MKRS, MMPHI, IPH, APK, AMMK	I lartë	Afatmesëm	Mesëm	
Objektivi 24.3.: Promovimi i aseteve të trashëgimisë kulturore në funksion të zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm deri në vitin 2031						
Krijimi i sistemit të menaxhimit dhe financimit për përkujdesjen dhe rigjenerim të aseteve të trashëgimisë kulturore	DK	DSHP		Afatmesëm	Lartë	
Krijimi i sistemit të dokumentimit dhe informimit për asetet e trashëgimisë kulturore	DK	DSHP		Afatmesëm	Lartë	
Krijimi i inventarit të aseteve të trashëgimisë kulturore të Komunës së Prishtinës, në ndërlidhje me DB të MKRS, të kompletuar me planet e demarkacionit të perimetrit dhe zonave të mbrojtjes rreth aseteve të trashëgimisë kulturore, si dhe kriteret, kushtet dhe kërkesat e konservimit dhe adaptimit të tyre për përdorim.	IKMM, QRTK	MKRS, MMPHI, DK, DPS		Afatmesëm	Mesëm	€100,000
Krijimi i politikave dhe programeve të përbashkëta për ruajtje dhe konservimi/ rigjenerim të aseteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.	DPS	MKRS, DK, IKMM	I mesëm	Afatshkurtë r		
Krijimi i Këshillit të Komunës për rigjenerimin e aseteve dhe sipërfaqeve të trashëgimisë kulturore, natyrore, rekreacion dhe turizëm.	Komuna	DK, IKMM, QRTK, AKK, MMPHI	I mesëm	Afatshkurtë r		
Themelimi & funksionalizimi i Zyrës së Komunës për rigjenerim,	DPS		I mesëm	Afatshkurtë		

menaxhimin dhe mirëmbajtjen e aseteve dhe sipërfaqeve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, me destinacion zhvillimi ekonomik, rekreacion dhe turizëm.				r		
Trajnime sistematik i personelit	DPS		I mesëm	Afatshkurtë r	Mesëm	€100,000
Krijimi politikave të financimit / investimeve për konservim / rigjenerimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, në partneritet publiko-privat, lehtësira fiskale, grante dhe donacione vendore e ndërkombëtare.	DPS		I mesëm	Afatshkurtë r	Mesëm	€100,000
Digjitalizimi i aseteve të trashëgimisë kulturore	DK	DSHP		Afatmesëm	Lartë	
Qëllimi 25: Zhvillim kompakt dhe i qëndrueshëm i vendbanimeve						
Objektivi 25.1.: Inkurajim i dendësimit dhe ri-zhvillimit të tokave në zonat e ndërtuara						
Definimi i kufinjve ndërtimor në të gjitha vendbanimet	DU, DPS			Afatshkurtë r	Mesëm	
Objektivi 25.2.: Inkurajim i shfrytëzimeve të përziera brenda vendbanimeve						
Sigurimi i llojllojshmërisë së dendësive brenda vendbanimeve	DU, DPS			Afatgjatë	Lartë	
Ofrimi i qasjes në shërbime dhe infrastrukturë publike për të gjithë banorët	DU, DPS			Afatgjatë	Lartë	
Qëllimi 26: Zhvillim policentrik në zonën urbane						
Objektivi 26.1.: Koncentrimi i zhvillimit në zonat e ndërtuara dhe përmirësimi i strukturave ekzistuese						
Krijimi i zonave me intensitet të lartë	DU, DPS			Afatgjatë	Lartë	
Qëllimi 27: Bashkëpunim i qëndrueshëm ndërkomunal						
Objektivi 27.1.: Përgatitja e kornizës për bashkëpunim ndërkomunal me komunat fqinje						
Qëllimi 28: Trajtimi i ndërtimeve pa leje dhe parandalimi i ndërtimeve të reja pa leje						
Objektivi 28.1: Trajtimi i të gjitha ndërtimeve pa leje konform legjislacionit në fuqi						
Zhvillimi i fushatës informuese dhe vetëdijësuese për regjistrim dhe trajtim të ndërtimeve pa leje	DU, DI			Afatgjatë	Lartë	
Qëllimi 29: Banim i përballueshëm cilësor dhe i qëndrueshëm						
Objektivi 29.1.: Rritja e densitetit të banesave në zonat eksistuese urbane						
Objektivi 29.2.: Krijimi i rregulloreve të reja që promovojnë forma inovative të banimit, deri në vitin 2025						
Respektimi i parametrave rregullativ në lidhje me banimin dhe aspekti i planifikimit dhe projektimit (qasjet, orientimet etj.)	DU, DI		I lartë	Afatgjatë	Mesëm	
Ndërtimi I 50 njësive të reja banesore të cilat do të jepen me qira jo-	DMS	DU	I ulët	Afatmesëm	Lartë	€1,500,000

profitabile për kategori të ndryshme.						
Adaptimi i objekteve ekzistuese të dala jashtë funksionit, të cilat janë në pronësi komunale që mund të transferohet për programet e veçanta të banimit.	DMS	DU	I lartë	Afatshkurtër	Lartë	€5,514,943
Ndërtimi i objekteve në pronësi komunale apo private me bashkëfinancim për sigurim të banimit me çmime të përballueshme- Lagja Model me 600 njësi.	DMS	DU	I mesëm	Afatmesëm	Lartë	€40,000,000
Qëllimi 30: Banim i gjelbër						
Objektivi 30.1.: Inkurajimi i strategjive të mençura për ruajtjen e ujit						
Objektivi 30.2.: Inkurajimi i strategjive për ruajtjen e energjisë						
Objektivi 30.3.: Promovimi i përdorimit të materialeve të qëndrueshëm të ndërtimit						
Aplikimi i materialeve ekologjike ndërtimore	DU, DI			Afatgjatë	Mesëm	
Qëllimi 31: Banim i përballueshëm dhe gjithëpërfshirës						
Objektivi 31.1.: Inicimi i procesit të rigjenerimit urban në lagje të ndryshme						
Plani I rigjenerimit në lagjen Kodra e Trimave	DU, DPS			Afatshkurtër	Mesëm	
Plani I rigjenerimit në lagjen Kolovica	DU, DPS			Afatshkurtër	Mesëm	
Qëllimi 32: Shfrytëzimi efikas i tokës për një zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik dhe mjedisor						
Objektivi 32.1.: Ruajtja e harmonisë mes shfrytëzimit të tokës për banim dhe shfrytëzimeve të përziera, industrisë, rikrijimit dhe institucioneve deri në vitin 2031.						
Objektivi 32.2.: Mbajtja nën kontroll e zhvillimit të vendbanimeve, me theks të veçantë në ato lineare dhe të shpërndara						
Objektivi 32.3.: Ruajtja strikte dhe konsolidimi i tokës bujqësore						

5 ZBATIMI DHE MONITORIMI

5.1 Dispozitat për zbatim

Dispozitat për Zbatim përmbajnë një mekanizëm për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të komunës drejt arritjes së të gjitha aspekteve të planit, në bazë të treguesve të matshëm.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor (Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Zhvillimi të Qëndrueshëm) pas aprovimit të Planit Zhvillimor Komunal në Kuvend Komunal dhe publikimit zyrtar, fillon të kryej përgjegjësitë ligjore që ka lidhur për zbatimin e Planit Zhvillimor të Komunës. Në këtë drejtim Drejtoria për Planifikim strategjik dhe zhvillimi të qëndrueshëm do filloj me një punë mjaft komplekse dhe të vështirë në koordinimin dhe bashkëpunimin me drejtoritë sektoriale brenda komunës.

Duhet theksuar se zbatimi i Planit Zhvillimor Komunal varet nga shumë faktorë në mënyrë direkt dhe indirekte dhe përpos punës brenda sektorëve të komunës, në funksion të krijimit të një sistemi transparent dhe të qëndrueshëm, sistem i cili prezanton edhe një nga kërkesat ligjore, duhet punuar edhe me grupet tjera të interesit, e cila nuk mund të bëhet pa ngritur edhe cilësinë e informimit dhe komunikimit si dhe fuqizimin e faktorëve tjerë.

Drejtoria për Planifikim strategjik dhe zhvillimi të qëndrueshëm dhe Ekipi punues në rend të parë zbatimin do e bëjnë në harmoni me Planin e Veprimit për Zbatim të Planit Zhvillimor të Prishtinës, duke punuar Planet e Zbatimit Sektorialë të secilës Drejtori të Komunës së Prishtinës.

Gjatë zbatimit të PZHK përpos autoriteteve lokale dhe qendrore është e rëndësishme të jenë akterë dhe të ftuar edhe organizatat e tjera si kompanitë publike, OJQ, përfaqësuesit e fermerëve, përfaqësues të industrive që kanë ndikim në komunë e më gjërë, bizneset dhe të tjerët që janë akter kyç dhe të rëndësishëm për zbatimin e planit, gjithnjë në pajtim me parimet që dalin nga U.A . MMPH Nr.-11/2015 neni 4. paragrafi 1.3.

5.1.1 Formimi i ekipit

Një nga faktorët fillestar dhe të rëndësishëm të zbatimit të PZHK-së është krijimi i Ekipit Komunal të Prishtinës, ky Ekipi komunal do ketë obligimet për përkrahje në zbatim të PZHK-së, por edhe për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit, në të njëjtën kohë pasi që Komuna e Prishtinës nuk ka Ekip edhe për zbatim dhe monitorim të PZHK-së, ky Ekip duhet ti kryej edhe ato detyra.

Komuna e Prishtinës në funksion të zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të PZHK-së, si pjesë e këtij dokumenti, e parasheh krijimin e këtij Ekipi, që përpos rëndësisë së madhe në zbatim, do shërbej edhe si një mekanizëm për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të komunës drejt arritjes së të gjitha aspekteve të planit, në bazë të treguesve të matshëm.

Ky Ekip Punues duhet të themelohet nga Kryetari i Komunës, i cili bazuar në kompetencat ligjore që ka ose e themelon vet ose i propozon Kuvendit të Komunës emërimin e Ekipit Punues për zbatimin e Planit Zhvillimor të Prishtinës, si dhe për Monitorim dhe Raportim lidhur me zbatimin e Planit, për arsye praktike Ekipi i njëjtë do ketë obligimet e njëjta edhe për HZK-në e Prishtinës.

Në kuadër të vendimit duhet përshkruhet përbërja e Ekipi, detyrat lidhur me zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit, periudhat e raportimit, kompensimin nëse aplikohet etj.

Ekipi Punues përbëhet nga përgjegjësit e të gjitha drejtorive, udhëheqësi i Autoritetit Përgjegjës Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor (Drejtoria për Planifikim strategjik dhe zhvillimi të qëndrueshëm) është edhe koordinatori i Ekipit.

Detyrat e Ekipit janë të koordinoj dhe bashkërendoj aktivitetet, lidhur me përgatitjen e Planeve Vjetore, për çdo drejtori brenda komunës së Prishtinës, Planet vjetore duhet përgatitur për Drejtoritë: Drejtoria për Planifikim strategjik dhe zhvillimi të qëndrueshëm, Urbanizëm, Administratë, Shëndetësi, Mirëqenie Sociale, Arsim, Kulturë, Sport, Bujqësi, Financa, Pronë, Kadastra, Inspeksioni, Investime kapitale dhe menaxhim i kontratave, Shërbime publike, mbrojtje dhe shpëtim, Parqe.

Është detyrë e secilit përgjegjës që është pjesë e ekipit, nga secila drejtori të kujdesen për këto Plane Vjetore, dhe e koordinatorit të Ekipit të kujdeset për planin e Drejtorisë për Planifikim strategjik dhe zhvillimi të qëndrueshëm, por në cilësinë e koordinatorit dhe si udhëheqës i Ekipit Punues edhe koordinoj dhe ndihmojë edhe planet vjetore të drejtorive tjera.

Detyrë tjetër është që të verifikoj se Planet Vjetore Sektoriale të jenë të bazuara dhe në harmoni me Planin e Veprimit për Zbatim nga PZHK-ja si dhe të:

- Përcjell, koordinoj dhe bashkërendoj zbatimin praktik të projekteve dhe komponentës hapësinore në baza ditore, javore e mujore të punës.
- Merr edhe shënime për mundësitë, sfidat dhe problemet e zbatimit ashtu që të mundësoj përmirësimin e zbatimit në vitin tjetër të radhës.
- Bashkëpunojnë me anëtarët nga të gjitha drejtoritë komunale, në mënyrë që të organizojnë dhe funksionalizojnë sistemin e Zbatimit të Planit si dhe Raportimin.
- Informojë, nëpërmjet Zyrës për Informim, edhe qytetarët 15 ditë para datës së raportimit në një tubim të qytetarëve për gjetjet në procesin e zbatimit të planit, dhe në atë takim kërkon edhe propozimet e qytetarëve për masa, zhvillime dhe projekte që, do të mund të futeshin në rishikim të buxhetit dhe KAB, përmes: Shpalljeve publike të vendosura në objektet publike, dhe vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës, Mediave lokale, Ueb faqes zyrtare të Komunës.

Koordinatori i Ekipit, bashkë me Ekipin ftojnë përfaqësuesit e Drejtorive, që të marrin pjesë në takime për t'u konsultuar dhe diskutuar lidhur me zbatimin e planeve, dhe përfaqësuesit e Drejtorive raportojnë për zhvillimet, por edhe propozojnë masat e aktivitetëve që i kontribuojnë zbatimit të planeve.

Konsultime organizohen edhe me kryetar të Këshillave Lokale të Fshatrave, të Vendbanimeve, të Lagjeve Urbane dhe përfaqësues të Shoqërisë Civile që të:

- Kontribuojnë me propozime, sugjerime dhe komente gjatë procesit të zbatimit të planeve për të gjitha fushat;
- Informojnë nëpërmes formave të ndryshme për zhvillimet ilegale në vendbanimet, lagjet urbane dhe përgatiten për projekt-propozimet;
- Definojnë masat dhe zhvillimet e parapara me plane në periudhën e dëgjimeve publike për buxhet;
- Zhvillojnë tubimet e rregullta publike;
- Zhvillojnë takimet për planifikim strategjik që organizohen nga Komuna, përkatësisht Kuvendi i Komunës ose Kryetari.

Së paku një anëtar i Këshillit Lokal të Fshatit, të Vendbanimit apo të Lagjes urbane duhet të jetë person kontaktues për Zbatim të Planit në fshat, vendbanim apo lagje urbane.

Ky person, mund të jetë personi i cili, me rregulloren për Këshilla të Fshatrave, është përfshirë në grupet punuese komunale për planifikim të planit zhvillimore komunal.

Kryetari i Komunës, duhet që (së paku) të organizojë dy takime në vit me Ekipin Punues. Takimet, duhet të mbahen së paku një herë në gjashtë muaj, edhe pse preferohet çdo tre muaj të ketë takime.

Për rendin e ditës, duhet të konsultohen edhe nëse konsiderohet se raportimi për zhvillimet lidhur me zbatimin e planeve dhe përgatitja e raporteve gjashtëmujore dhe njëvjeçare, duhet të jetë pika kryesore.

Kuvendi i Komunës, mund të kërkojë një opinion nga Ekipi për çështje të caktuara me interes për qytetarët, dhe institucionet.

Procesi i zbatimit mbështet në parimin e Ligjshmërisë sipas të cilit parim, Komunitat ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre brenda kushtetutës, ligjeve dhe akteve të tjera normative të Republikës së Kosovës. Zbatimi i këtij parimi, nënkupton edhe zbatimin e parimit të Transparencës, dhe në këtë mënyrë komunitat, promovojnë transparencën e organeve Legjislative, Ekzekutive dhe Administrative, duke e rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në zbatimin e planeve në nivel lokal, dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të komunës.

5.1.2 Informimi dhe komunikimi në procesin e zbatimit të PZHK-së së Prishtinës

Informimi dhe Komunikimi në procesin e Zbatimit të PZHK-së së Prishtinës luajnë një rol të jashtëzakonshëm, andaj Komuna e Prishtinës dhe aktorët e tjerë relevantë, duhet të kontribuojnë ndjeshëm në krijimin e kushteve për zbatimin e Planit Zhvillimor.

Fusha e informimit dhe e komunikimit, në funksion të zbatimit të këtij dokumenti, do jetë një mbështetje e madhe e drejtuesve të institucioneve, dhe të vet institucioneve komunale.

Ndërtimi i marrëdhënieve të mira me publikun, do të ndikonte drejtpërdrejt në përmirësimin e praktikave të zbatimit të planeve, në përmirësimin e mbledhjes dhe përdorimit të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, në përdorimin efektiv të aseteve të komunës, në krijimin e një klime miqësore me bizneset, në inkurajimin e shoqërisë civile dhe të sektorit privat etj. Nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm të buxhetimit me pjesëmarrje, do të inkurajohen qytetarët në përfshirjen e tyre në zbatimin e projekteve, objektivave qëllimeve dhe përmbajtjeve tjera të PZHK-së, në vlerësimin e nivelit të shërbimeve publike dhe në rritjen e transparencës në përdorimin e fondeve publike. Komuna është e detyruar të zbatojë kuadrin ligjor në lidhje me transparencën dhe informimin e publikut, në lidhje me tërë veprimtarinë ekonomiko-financiare të komunës dhe në këtë funksion, plani i informimit dhe i komunikimit do të përmbushë edhe këtë kërkesë, nga kuadrin ligjor.

Në vijim, Komuna e Prishtinës do të respektojë me rigorozitet procedurat ligjore të transparencës gjatë zbatimit të Planit Zhvillimor. Planin i informimit dhe i komunikimit, është baza mbi të cilën duhet të zhvillohet procesi i zbatimit transparent të PZHK-së, dhe i sigurimit të përkrahjes së gjerë nga të gjithë aktorët në proces të zbatimit. Në këtë drejtim, komuna do t'i shfrytëzojë të gjitha mjetet e informimit dhe të komunikimit, për qasje sa më të gjerë dhe të qëndrueshme në institucione dhe dokumente, aty ku ligjërisht është e mundur për publikun dhe aktorët e tjerë relevant.

Në këtë drejtim në funksion të zbatimit të dokumentit rekomandohet: Të ketë komunikim dhe motivim lidhur me strategjinë dhe planin e informimit dhe komunikimit me të gjithë aktorët, duhet mbahet plani në fokus të të gjithëve, botojeni atë dhe bëjeni le të shihet në gazeta, Postoni atë në Ueb faqen tuaj të Internetit dhe, Referojuni sa më shpesh që të jetë e mundur në mënyra të ndryshme dokumenteve të planifikimit. Këto udhëzime, do të ndihmojnë për të ndërtuar dhe fuqizuar dinamikën e zbatimit të planit.

Një udhëzim tjetër i dobishëm në këtë drejtim, është një "Memo vjetore", dërguar nga Kryetari i Komunës të gjithë liderëve të vendbanimeve, shoqatave jo qeveritare, bizneseve, qeverisë qendrore, institucioneve publike etj. Kjo memo, i përkujton ata në lidhje me Planin Zhvillimor Komunal aktual dhe me këtë rast nga dhe anëtarët e grupeve të tjera të interesit, mund të kërkojnë komente dhe sugjerime lidhur me informimin, me komunikimin, zbatimin e dokumentit si dhe për çështjet tjera me interes.

Si shumë me interes për zbatim të Planit konsiderohet analiza, informimi dhe komunikimi adekuat, cilësor etj., me të gjithë aktorët dhe veçanërisht, me ata që ndihmuan në hartimin e planit. Njerëzit të cilët kanë ndihmuar me inpute, duhet mbajtur të përfshirë në vazhdimësi, përmes fuqizimit të informimit dhe të komunikimit, si një komponentë e rëndësishme dhe strategjike e zbatimit.

5.1.3 Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në funksion të zbatimit të planeve

Përkundër që në Komunën e Prishtinës mund të thuhet lirisht se kishte një proces cilësorë gjatë përgatitjes së PZHK-së në kuptimin e gjithëpërfshirës edhe të zbatimit të ligjit në fuqi, për kundër që bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në mes të drejtorive gjatë hartimit të dokumentit ishte i mirë, vlerësohet se ende ka mjaft shumë hapësirë për informim, bashkëpunim dhe bashkëveprim në mes të drejtorive, sidomos sa i përket zbatimit të Planit Zhvillimor të Komunës.

Në këtë drejtim, çdo drejtori duhet të jetë e përgatitur që të jetë në funksion të zbatimit të dokumentit, duhet të jetë e pajisur me të gjithë mekanizmat dhe mjetet e nevojshme duke filluar: nga posedimi i kopjeve të shtypur dhe digjitale të Planit, stafi i secilës drejtori duhet të informohet me përmbajtjen, detyrat, si dhe me obligimet që dalin nga PZHK-ja.

Drejtoritë, duhet të komunikojnë dhe t'i koordinojnë veprimet për projektet, objektivat qëllimet dhe përmbajtjet tjera të PZHK-së por edhe aktivitetet tjera që janë rezultat i Planit, por edhe të jenë të informuara për zhvillimet tjera që janë të veçanta brenda drejtorive, si dhe duhet komunikuar edhe për kufizimet dhe mundësitë ligjore nga fushat e tyre kompetente që prekin drejtoritë por, edhe projektet, objektivat, qëllimet dhe dimensionin hapësinor të dokumentit.

Vlerësohet shumë i rëndësishëm krijimi i një sistemi digjital, i cili do të mundësoj komunikimin adekuat, azhurnimin e shpejtë dhe cilësor, transparencën në mes të drejtorive, por edhe transparencën ndaj aktorëve të tjerë. Një sistem i tillë, e ngritë shkallën e zbatimit (implementimit) të Planit, dhe mundëson informim dhe koordinimin efikas, cilësorë, dhe në masë të madhe e ngritë edhe shkallën e zbatimit të detyrave, si dhe përgjegjësinë dhe transparencën ndaj të gjithë aktorëve relevant. Krijimi i sistemit të përbashkët të GIS-it, shihet si domosdoshmëri nga që është edhe mundësi shumë më e madhe e informimit dhe e komunikimit të shpejtë dhe të saktë në mes të drejtorive. Por, deri sa të krijohet ky sistem, drejtoritë duhet t'i shfrytëzojnë mjetet më pak të sofistikuar ose, ato mjete që i kanë në dispozicion.

Drejtoritë komunale, gjithsesi duhet të vazhdojnë të i shkëmbejnë informatat, të bashkëpunojnë dhe të bashkëveprojnë në mënyrë cilësore mes tyre për zbatim të dokumentit. Zbatimi i Planit, i projekteve, objektiveve, qëllimeve dhe i zhvillimeve të tjera fillon menjëherë pasi që ato të jenë aprovuar nga Kuvendi Komunal, mirëpo për lehtësimin e zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal vlerësohet hartimi i planeve të punës për çdo drejtori dhe zbatimi i tyre sipas sektorëve përkatës, bazuar edhe në plane të lartpërmendura. Këto plane sektoriale, do të prezantohen para Ekipit Punues për Zbatim për tu analizuar, për koordinim të aktiviteteve por edhe për të ndihmuar në zbatimin e tyre. Nga fusha e bashkëpunimit dhe e bashkëveprimit në mes të gjitha drejtorive, duhet theksuar se një rol të madh dhe strategjik ka Drejtoria e Inspektionit, ose inspektorët e fushave të ndryshme të nivelit komunal. Zbatimi i dokumentit është i lidhur ngushtë edhe me punën e inspektorëve të fushave përkatëse. Vlerësohet mjaftë i rëndësishëm dhe duhet bashkëpunuar ngushtë për t'i informuar ata me zhvillimet e planifikuara, si dhe për t'i pajisur me harta (të shtypura me përpjesë të duhur ose digjitale) adekuate për këto zhvillime, dhe për kufijtë ndërtimor në veçanti, por edhe për zhvillime të tjera.

Kjo bëhet pastaj, edhe për ta funksionalizuar bashkëpunimin dhe bashkëveprimin në mes të drejtorive në funksion të zbatimit sa më efikas dhe cilësor të planit.

Vlen të theksohet se rolin kryesor në fushën e bashkëpunimit me inspektoratin ose edhe me inspektorët, e mbanë Drejtoria për Planifikim strategjik dhe zhvillimi të qëndrueshëm por, në funksion të zbatimit të planit një rol të rëndësishëm e ka edhe Ekipi Punues për Zbatim, si dhe instancat e tjera të nivelit komunal dhe qendror.

Edhe Drejtoritë tjera komunale të cilat duhet të jenë të informuar për zhvillimet e parapara me plan, sidomos duhet të jenë të informuara me projektet konkrete nga plani si dhe për prioritetet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjatë, pasi që shumë projekte, zhvillime të parapara me PZHK duhet të jenë pjesë e parashikimit buxhetore të trevjeçarit të ardhshëm që njihet si KAB Korniza Afatmesme Buxhetore. Vetëm me futjen e këtyre projekteve, objektivave qëllimeve dhe përmbajtjeve tjera të PZHK-së në kalendarët buxhetor dhe aprovimin e tyre në nivelin komunal dhe qendror, jemi një hap më përpara në zbatimin e tyre.

Mund të konstatohet se në funksion të zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal në këtë rast, por edhe çfarëdo dokumenti tjetër, bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në mes të drejtorive gjatë zbatimit duhet fuqizohet dhe avancohet.

Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në funksion të zbatimit të planit duhet zgjeruar edhe me gjykatat për disa lëndë potenciale, edhe me byrotë projektuese për tu sqaruar për zonat dhe kufijtë ku lejohen ndërtimet, e në këtë vij edhe projektimet edhe shoqëria civile për rolin, rëndësinë por edhe interesat që mbrojnë.

5.1.4 Bashkëpunimi me institucionet e nivelit qendror

Pasi që PZHK-ja është dokument multi-sektorial, lirisht mund të themi se edhe kompetencat, përgjegjësitë dhe ndikimet janë të ndryshme (si për nga niveli, ashtu edhe për nga fushë veprimtaria), bashkëpunimi në mes të institucioneve të caktuara, është njëra ndër shtyllat tjera ku duhet mbështetur për zbatim të PZHK-së.

Në këtë drejtim, aktivitetet dhe masat për zbatim, do jenë një bazë e mirë për informim, për komunikim dhe për bashkëpunim dhe bashkëveprim drejt zbatimit të PZHK-së. Dihet fare mirë se, çfarë roli ka MMPHI-ja, MBPZHR-ja, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit por edhe ministrinë e tjera në zbatim dhe në përcjellje të zbatimit të PZHK-së.

Është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi në mes të niveleve të caktuara për zbatim të PZHK-së. Dihet se ministrinë e ndryshme si për shembull MMPHI-ja, mundet që edhe të lëshoj leje. Siç thuhet në ligjin për planifikim, autoritetet duhet t'i lëshojnë lejen secilit aplikues, derisa propozimi për ndërtim përputhet me dispozitat e ligjit të planifikimit, dhe me ligjet e tjera dhe planet zhvillimore komunale dhe hartat Zonale dhe dokumentet tjera të planifikimit. Duke i ditur edhe kompetencat për ujin, për Tokën dhe për ajrin që i ka (në këtë rast) MMPHI-ja, një fuqizim i bashkëpunimit do të ndihmonte shumë në zbatimin e dokumentit.

Qeveria e vendit, me propozim të MMPHI-së ka nxjerr akt të veçantë me të cilin, e rregullon mbikëqyrjen, por edhe ndëshkimin dhe marrjen e masave të përcaktuara me ligj të planifikimit. Prandaj, mbikëqyrja e akteve të përgjithshme dhe veç e veç, e kushteve dhe e mënyrës së punës të personave të juridik dhe fizik dhe marrja e masave është e përcaktuar po me këtë ligj dhe nga ministria nëpërmjet inspektorëve. Në këtë drejtim, përpos procesit të nxjerrjes së dokumenteve dhe të akteve të tjera, zbatimin e tyre, si dhe aplikimin e procedurave i inspekton MMPHI.

Bashkëpunimi, informimi dhe komunikimi është çelësi i zbatimit të PZHK-së. Një rol të rëndësishëm, e ka edhe MBPZHR, e cila është kompetente për zhvillime të qëndrueshme bujqësore por, edhe për zhvillime të pyjeve. Në këtë drejtim, edhe mbrojtja e tokës bujqësore, është fushë ku gërshetohen interesat e nivelit lokal dhe qendror. Në këtë drejtim, planet për zbatim do të jenë një bazë e mirë për

informim, për komunikim dhe për bashkëpunim dhe bashkëveprim drejt zbatimit. Fuqizimi i lidhjeve me këtë ministri, është çelës i mbrojtjes së tokës bujqësore për çka është i themeluar edhe Inspektorati i Bujqësisë i cili me anë të inspektorëve të tij kryen punë inspektuese në fushat e bujqësisë: në tokat bujqësore, në sferën e Pylltarisë dhe të Gjuetisë, të mbrojtjes së Bimëve, të Blegtorisë dhe të Peshkatarisë, si dhe të Veterinarisë dhe të sigurisë së Ushqimit. Edhe përmes kësaj ministrie si dhe përmes inspektoratit të saj, duhet fuqizuar informimin, komunikimin dhe bashkëpunimin dhe bashkëveprimin për mbrojtjen e tokës bujqësore, si dhe të fushave të tjera relevante dhe ky, do të konsiderohej si një hap i rëndësishëm drejt zbatimit të PZHK-së.

Pasi që planifikimi është multisektorial, gati të gjitha ministrinë dhe të gjitha agjencitë e tjera publike, kanë një fushë-veprimtari, kompetencë dhe ndikim që prekë edhe zbatimin e PZHK-së. Vlerësohet se, një bashkëpunim cilësor duhet krijuar në funksion të zbatimit të PZHK-së edhe në mes të niveleve, dhe dihet mirë se zonat e veçanta arkeologjike, arkitektonike janë fusha për zhvillim të përbashkët, mbrojtje por edhe zbatim, njëjtë si edhe një pjesë e madhe e granteve që vijnë nga niveli qendror. Lirishtë, duhet theksuar se cilësia e këtij bashkëpunimi, konsiderohet si mjaft përmbajtësore për zbatim të PZHK-së.

5.1.5 Mbështetja administrative

Komuna e Prishtinës, duhet të ofrojë një mbështetje cilësore administrative për zbatim të PZHK-së, duke e synuar lirimin nga vonesat burokratike dhe duke reaguar me cilësi ndaj vështirësive ligjore, duke vendosur afate dhe orare të duhura etj.

Parashikohet edhe shfrytëzimi i teknologjive, si dhe i aplikimeve online për zhvillime.

Informimi, komunikimi dhe bashkëpunimi për thjeshtim sa më të madh të procedurave administrative, ndikon dukshëm në zbatim të dokumentit. Në këtë drejtim aplikimi online, matja e kohës se për zbatimin e projekteve, objektivave dhe qëllimeve janë parametra shumë të rëndësishëm për zbatim por, edhe për transparencë në zbatim.

Për tu mundësuar zbatimi i PZHK-së, si mbështetje administrative duhet ofrohet mundësia e hartimit të Hartës Zonale të Komunës, më të cilën mund të epen kushtet zhvillimore dhe kushtet ndërtimore, por për shkak mos trajtimit në nivel parcele, dhe mundësisë për trajtim jo të barabartë të parcelave dhe pronarëve të ndryshëm, në funksion të sigurimit të hapësirave publike, gjelbërimit dhe përmbajtjeve tjera urbane, duhet trajtuar edhe me PRRH.

Kështu mbështetja administrative përpos transparencës, përgjegjësisë shkon edhe në kompletimin me dokumentet tjerë të nevojshëm për zbatim të plotë të PZHK-së.